
PZHK - K.K OBILIQ

Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit

2022- 2030



Bartës i hartimit të dokumentit: Komuna e Obiliqit, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe sektorët tjerë të Komunës.

Mbështetja teknike dhe profesionale është realizuar nga kompania konsulente "INSI" ShPK.

Obiliq, 2022

FJALA E KRYETARIT

Duke e konsideruar Planin Zhvillimor Komunal si dokumentin më të rëndësishëm multi-sektorial, i cili paraprinë rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin hapësinor të komunës, Komuna e Obiliqit ka marrë vendimin për hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, procesi i hartimit të këtij dokumenti mbështetet në nevojën për planifikimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të mbrojtjes dhe zhvillimit të planifikuar të komunës së Obiliqit, si dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 04L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i Obiliqit, për ne është një dokument shumë me rëndësi, sepse, ofron një vizion të qartë dhe përcakton orientimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik, shoqëror, fizik dhe hapësinor të qytetit të Obiliqit nga viti 2022 deri në vitin 2030. Obiliqi ka filluar një histori te re të zhvillimit që nga viti 2014, me përkushtim realizuam projekte të shumta që ndikuan drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit të Obiliqit, trajtuam secilin sektor me prioritet. Komuna e Obiliqit, si komunë multietnike, ka ofruar transparencë të plotë në raport me qytetarin, duke krijuar mundësi dhe kushte te barabarta për secilin qytetarë pa dallim. Në Obiliq kemi krijuar një standard të ri, sa i përket zhvillimit të projekteve dhe funksionimit të punës dhe përgjegjësive tona, çdo qytetarë është afër me çdo zhvillim që ndodhë, sepse ne jemi zotuar dhe kjo do të ndodhë në vazhdimësi, që së bashku me qytetarët, çdo projekt që nis në Obiliq, bashkë do ta zgjedhim, bashkë do ta mbikëqyrim dhe së bashku do ta gëzojmë.

Obiliqi, si një qytet me zhvillim të hershëm industrial, në 72% të territorit operon Korporata Energjetike e Kosovës, u votua një ligj, i cili e trajton Obiliqin si zonë të veçantë, që nga viti 2019 ky ligj ka filluar implementimin e tij, duke krijuar mundësi të reja të planifikimit dhe zhvillimit të projekteve kapitale. Andaj, procesi i hartimit të Plani Zhvillimor Komunal, u zhvillua në kohë dhe rrethanat më të favorshme, duke marrë parasysh dhe trajtuar të gjitha temat që shqetësojnë banorët, gjendjen ekzistuese dhe planifikimet hapësinore të miratuara viteve të fundit, zbatimi i tij do të bëhet në rrethana edhe më të përshtatshme dhe të gjithë ne së bashku do të kemi privilegjin por edhe përgjegjësinë, për zbatimin sa më të përpiktë të këtij plani, i cili do të jetë udhërrëfyes në fazën e zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në arritjen e standardeve ekonomike, sociale dhe ambientale.

Falë implementimit të ligjit për Obiliqin, rritjen buxhetore, Obiliqi tashmë po ndryshon dhe përmes këtij plani, do të vihen në pah shtyllat kryesore të zhvillimit të ardhshëm të komunës, me prioritet të plotë do punohet në finalizimin e sheshit të qytetit "Dëshmorët e Kombit", në realizimin e projektit të koogjenerimit për qytetarët e Obiliqit, ndërtimin e sheshit "Adem Preniqi", në hapësirat ku është bërë rrënimi i objekteve të vjetruara të cilat kanë paraqitur rrezikshmëri për banorët përreth, po ndërtohet Biblioteka e Qytetit, një ambient i përshtatshëm për të gjitha grupmoshat që të kalojnë kohën e lirë përmes leximit.

Për herë të parë në komunën e Obiliqit, do të realizohet projekti i gërmimeve arkeologjike, për të ruajtur vlerat e trashëgimisë tonë kulturore, do të restaurohet Mulliri i Hysenajve në fshatin Grabofc, Shtëpia Muze në fshatin Hamidi, varri i Hoxhë Breznicës, do ndërtohen gjashtë fusha të hapura sportive në fshatrat e Obiliqit, shkolla në fshatin Breznicë dhe shkollës në Obiliqin e vjetër, do të kompletohen me infrastrukturën përcjellëse, do ndërtohen sallat e edukatës fizike, do punojmë në aspektin e rindërtimit kadastral, përmirësimin e infrastrukturës, përmes kompletimit të infrastrukturës rrugore dhe asaj nëntokësore në tërë territorin e Obiliqit, do të punojmë në përputhje me Planin Zhvillimor, në krijimin e kushteve në zonën industriale, duke rritur numrin e investitorëve në këtë zonë, që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe uljen e shkallës së papunësisë në Obiliq, do bëjmë përpjekje që tokat e pashfrytëzuara të Korporatës Energjetike të Kosovës t'i shndërrojmë në parqe dhe sheshe, do vazhdojmë përkushtimin tonë në rritjen e cilësisë në arsim, përmes ndërtimit të çerdheve publike në fshatin Mazgit dhe Milloshevë, ndërtimin e anekseve shkollore, plotësimin dhe renovimin e kabineteve shkollore, rritjen e shërbimeve shëndetësore, përkrahjen e kulturave bujqësore dhe agro-bizneseve, turizmin e bazuar në potencialin natyror dhe atë kulturor.

Në komunën e Obiliqit do të punohet në aftësimin e të rinjve për punë në sektorin e industrisë së rëndë, duke patur parasysh që në Obiliq operon KEK-u dhe kemi një popullatë shumë të re dhe entuziaste për punë. Duke parë rëndësinë e hartimit të një Plani Zhvillimor Komunal, në procesin e hartimit të tij, kemi dëshmuar përkushtim, përgjegjshmëri në punë, jemi treguar shumë bashkëpunues në raport me qytetarët, OJQ-të dhe bizneset. Me këtë rast, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim për asamblenë komunale të Obiliqit, ekzekutivin e komunës së Obiliqit, grupet punuese, përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare, sektorin privat, përfaqësuesit e të gjitha partive politike si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm. Një mirënjohje të veçantë për të gjitha qytetarët e Obiliqit për kontributin e tyre të dhënë gjatë përpilimit të këtij dokumenti. Komuna pret nga institucionet, donatorët, partnerët dhe miqtë e komunës së Obiliqit që të ndihmojnë zbatimin e këtij dokumenti në mënyrë që bashkërisht të hapim perspektiva të reja për zhvillim të qëndrueshëm.

Për fund, me lejoni të ritheksoj se ka shumë punë, sfida e përgjegjësi përpara nesh, por vullneti dhe angazhimi ynë për të realizuar projekte madhore për qytetarët, nuk do të mungojë, prandaj ftoj të gjithë qytetarët e Obiliqit që të tregohen unik dhe të bashkuar në realizimin e këtij vizioni për zhvillimet e ardhshme në komunën e Obiliqit.

Xhafer Gashi,

Kryetar i Komunës së Obiliqit

LISTA E KONTRIBUUESVE

Udhëheqësit e projektit

Emri e mbiemri	Pozita	Emri e mbiemri	Pozita
Xhafer Gashi	Kryetar i Komunës	Arben Berisha	Koordinator i projektit
Ibush Mjekiqi	Nënkryetar i Komunës	Merita Simnica	Menaxher i projektit

Drejtorët kontribues sektorial të planifikimit

Emri e mbiemri	Drejtoria	Emri e mbiemri	Drejtoria
Fatmir Berbatovci	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	Fitore Hashani	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit
Agim Spahiu	Drejtoria e Arsimit	Arben Berisha	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë
Bejtullah Mjekiqi	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Vlora Kabashi	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Zarife Behluli	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa	Naim Miftari	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Burim Ismaili	Drejtoria për Inspekcion	Lindita Bekteshi	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Ilire Kelmendi Shema	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		

Koordinatorët sektorial të planifikimit

Emri e mbiemri	Drejtoria	Emri e mbiemri	Drejtoria
Leonarda Emini	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	Shaip Mehmeti	Drejtoria e Kadastrës
Ibrahim Krasniqi	Drejtoria për Inspekcion	Suzana Hashani	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Faton Grajçevci	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Bejtullah Mjekiqi	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Naim Grajçevci	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	Daut Mjeku	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
Lulzim Mjekiqi	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit	Fatime Beka	Drejtoria e Arsimit
Haki Jashari	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë		

Lista e kontribuesve komunal të përfshirë në planifikim

Emri e mbiemri	Drejtoria	Emri e mbiemri	Drejtoria
Leonarda Emini	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	Shaip Mehmeti	Drejtoria e Kadastrës
Ibrahim Krasniqi	Drejtoria për Inspekcion	Suzana Hashani	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Faton Grajçevci	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Bejtullah Mjekiqi	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Naim Grajçevci	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	Daut Mjeku	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
Lulzim Mjekiqi	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit	FatimeBeka	Drejtoria e Arsimit
Haki Jashari	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë		

Lista e kontribuuesve nga INSI

Emri e mbiemri	Sektori	Emri e mbiemri	Sektori
Ismajl Baftijari	Msc. i Ndërtimtarisë / Planer Urban	Mevlan Bixhaku	Dr.sc. Fusha e Trafikut dhe Transportit
Flamur Kuçi	Dr.sc. Planifikim Urban	Arben Hajrizi	Msc. i Ndërtimtarisë Drejtimit Hidroteknik
Arlinda Rushaj Sadiku	Msc. Arkitekturë dhe Planifikim Urban	Blerim Morina	Msc. i Inxhinierisë Mekanike
Gresa Neziri	Msc. Planifikim Urban dhe Menaxhim	Lulëzim Kryeziu	Msc. i Inxhinierisë Mekanike
Armend Sokoli	Msc. Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor	Astrite Neziri	Msc. i Elektroteknikës
Valon Gërmizaj	Msc. i Arkitekturës	Alban Frrokaj	Msc. Shkenca Bujqësore
Fidan Kuraja	MSc. Banka dhe Financa / Ekonomist	Nysret Gashi	GIS Ekspert
Rrustem Baftijari	Bsc. i Arkitekturës	Visar Brahimi	Bsc. i Gjeografisë
Sylejman Berisha	Dr.sc. Shkenca Mjedisore	Bexhet Basha	Msc. Shkenca Bujqësore

DRAFT

Përmbajtja tekstuale

1. HYRJE....22
1.1. Informata për vendimet e Kuvendit të Komunës në lidhje me PZHK-në....22
1.1.1. Vendimi i Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK-së....22
1.1.2. Vendimi i Kuvendit të Komunës për miratim dhe zbatim të PZHK-së....23
1.2. Informata për miratimet e PZHK-së....23
1.2.1. Vendimi për pëlqimin mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së....23
1.2.2. Vendimi i miratimit të PZHK-së nga MMPHI....27
1.3. INFORMATA PËR KORNIZËN STRATEGJIKE TË MARRA PARASYSH GJATË HARTIMIT TË PZHK-së....27
1.3.1. Strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror....27
1.3.2. Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale....34
1.3.3. Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje....35
1.3.4. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit, siç janë planifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës. 41
1.4. INFORMATA PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT....44
1.4.1. Listimi i prezantimeve publike, konsultimeve, takimeve rishikuese dhe mekanizmave të përdorur për të angazhuar publikun në procesin e planifikimit 44
1.4.2. Të dhënat e marra nga qytetarët dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë procesit të planifikimit....45
1.5. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E SHKURTËR E PZHK-SË....45
1.5.1. Sfidat kryesore....45
1.5.2. Mundësitë për Zhvillim 46
1.5.3. Qëllimet dhe objektivat 46
2. PROFILI KOMUNAL 48
2.1. Karakteristikat e përgjithshme të komunës....48
2.1.1. Historia e zhvillimit 48
2.1.2. Pozita gjeografike karakteristikat natyrore 48
2.1.3. Veçoritë mjedisore....49
2.2. DEMOGRAFIA....58
2.2.1. Zhvillimi Demografik 59
2.2.2. Mosha dhe struktura gjinore e popullsisë....59
2.2.3. Dendësia e popullsisë....60
2.2.4. Niveli i arsimimit 60
2.3. EKONOMIA 60
2.3.1. Ekonomitë familjare....61
2.3.2. Tregu i punës 61
2.3.3. Bizneset, ndërmarrjet dhe ambienti i biznesit 62
2.3.4. Sektorët ekonomik....64
2.3.1. Zonat ekonomike 65
2.3.2. Bujqësia....66
2.3.3. Turizmi....69
2.3.4. Resurset nëntokësore dhe sipërfaqësore 70
2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE 71
2.4.1. Energjia elektrike....71
2.4.2. Energjia termike....77

DRAFT

2.4.3. Ujësjellësi....77
2.4.4. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza)....78
2.4.5. Ujitja e tokës bujqësore....79
2.4.6. Drenazhimi-kanalizimi i ujërave atmosferike....80
2.4.7. Telekomunikacioni....80
2.4.8. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave....81
2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI PUBLIK....82
2.5.1. Rrjeti rrugor....83
2.5.2. Shtrirja dhe kategorizimi i rrugëve nga niveli qendror....83
2.5.3. Vlerësimi i intensitetit dhe kapaciteti i rrugëve....85
2.5.4. Trafiku hekurudhor....87
2.5.5. Trafiku ajror....87
2.5.6. Siguria në trafik në Komunën e Obiliqit....87
2.5.7. Modelet e qarkullimit të trafikut....88
2.5.8. Transportit Urban – linjat transportuese ndër komunale dhe brenda komunës....88
2.5.9. Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe modelet e tjera të transportit....89
2.5.10. Hapësirat për parkim....89
2.5.11. Transporti hekurudhor....89
2.5.12. Transporti Ajror....89
2.5.13. Transporti urban dhe ndërurban....89
2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE....89
2.6.1. Shëndetësia....90
2.6.2. Institucionet arsimore....91
2.6.3. Administrata publike....96
2.6.4. Mirëqenia sociale....96
2.6.5. Objektet e kulturës....97
2.6.6. Objektet e rinisë, sportit dhe rekreacionit....98
2.6.7. Hapësirat publike dhe parqet publike....99
2.6.8. Objektet e religjionit dhe varrezat....100
2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI....103
2.7.1. Mjedisi....103
2.7.2. Sipërfaqet me rrezikshmëri....107
2.8. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE, NATYRORE DHE TURISTIKE....110
2.8.1. Asetet e trashëgimisë natyrore....110
2.8.2. Asetet e Trashëgimisë Kulturore....110
2.8.3. Asetet e Trashëgimisë Arkeologjike....111
2.8.4. Zonat e Veçanta të Mbrojtura....111
2.9. VENDBANIMET....112
2.9.1. Karakteri Urban Rural....112
2.9.2. Madhësia dhe numri i banorëve....114
2.9.3. Funksionaliteti dhe rrjeti ndërlidhës....114
2.9.4. Lloji dhe lartësia mbidetare....115
2.9.5. Sipërfaqet e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve....115
2.9.6. Zona Urbane....116

DRAFT

2.9.7. Zonat rurale ... 117
2.10. Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje ... 117
2.10.1. Ndërtimet pa leje ... 119
2.11. BANIMI ... 120
2.11.1. Banimi social ... 121
2.12. SHFRYTËZIMI I TOKËS ... 122
2.12.1. Shfrytëzimi aktual i tokës ... 123
3. VLERËSIMI I GJENDJES ... 125
3.1. TRENDËT DHE PROGNOZAT DEMOGRAFIKE ... 125
3.1.1. Lëvizjet natyrore të popullsisë ... 126
3.1.2. Lëvizjet mekanike të popullsisë ... 127
3.1.3. Numri i ekonomive familjare ... 128
3.1.4. Projeksionet e popullsisë dhe ekonomive familjare ... 128
3.2. ZHVILLIMI EKONOMIK ... 130
3.2.1. Gjendja e sektorëve ekonomik ... 130
3.2.2. Lidhja e veprimtarive ekonomike me komunat fqinje ... 137
3.2.3. Gjendja e punësimit dhe papunësisë ... 137
3.2.4. Trendët e zhvillimit ekonomik ... 138
3.2.5. SWOT Analiza ... 143
3.2.6. Sfidat zhvillimore ... 144
3.2.7. Nevojat zhvillimore ... 144
3.3. INFRASTRUKTURA TEKNIKE ... 145
3.3.1. Ujësjellësi ... 145
3.3.2. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza) ... 147
3.3.3. Drenazhimi-kanalizimi i ujërave atmosferike ... 148
3.3.4. Ujitja e tokës bujqësore ... 148
3.3.5. SWOT Analiza- Ujësjellësi, kanalizimi, drenazhimi dhe ujitja ... 149
3.3.6. Energjia Elektrike ... 150
3.3.7. Infrastruktura e Ngrohjes Qendrore ... 154
3.3.8. Telekomunikimi ... 155
3.3.9. Menaxhimi i mbeturinave ... 157
3.4. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI ... 160
3.4.1. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese ... 160
3.4.2. Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror ... 161
3.4.3. Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të rrugëve ... 161
3.4.4. Modelet e qarkullimit të trafikut ... 161
3.4.5. Linjat transportuese ndërkomunale e brenda komunës urbane dhe rurale ... 161
3.4.6. Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit ... 161
3.4.7. Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim ... 162
3.4.8. Rrjeti hekurudhor ... 162
3.4.9. Vlerësim të nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese ... 163
3.4.10. Analiza SWOT ... 163
3.5. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE ... 163
3.5.1. Trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat ... 164

DRAFT

3.5.2. Institucionet arsimore 165
3.5.3. Institucionet shëndetësore 168
3.5.4. Institucionet e administratës publike 170
3.5.5. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit 171
3.5.6. Institucionet kulturore 172
3.5.7. Institucionet sportive, rekreative 172
3.5.8. Varrezat 174
3.5.9. Sfidave, gjetje kyçe, dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 174
3.5.10. Gjetje kyçe dhe supozime të pranuara 175
3.5.11. Identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 175
3.6. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI 175
3.6.1. Mjedisi 175
3.6.2. Ndotja e Ajrit 176
3.6.3. Ndotja e Ujit 181
3.6.4. Ndotja e Tokës 182
3.6.5. Zhurma 184
3.6.6. Sipërfaqet me rrezikshmëri 186
3.6.7. Identifikimi i sfidave 190
3.6.8. Gjetjet kyçe 191
3.6.9. Identifikimi i problemeve 191
3.6.10. Konstatimet kryesore 192
3.7. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE 194
3.7.1. Asetet e trashëgimisë natyrore 194
3.7.2. Asetet e trashëgimisë kulturore 196
3.7.3. Sfidave, gjetje kyçe, dhe supozime të pranuara, identifikimi I problemeve dhe konstatimet kryesore 199
3.7.4. Gjetje kyçe dhe supozime të pranuara 199
3.7.5. Identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 199
3.8. VENDBANIMET 200
3.8.1. Vendbanimet sipas madhësisë dhe numrit të banorëve 200
3.8.2. Vendbanimet sipas funksionalitetit dhe rrjetit ndërlidhës 201
3.8.3. Vendbanimet sipas llojit dhe lartësisë mbidetare 201
3.8.4. Raporti në mes të sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara 201
3.8.5. Zona urbane 202
3.8.6. Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia 202
3.8.7. Trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat 202
3.8.8. Depopullimi i vendbanimeve 203
3.8.9. Zgjerimi i vendbanimeve 203
3.8.10. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 205
3.8.11. Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet - Analiza SWOT 206
3.9. Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje 207
3.9.2. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 209
3.9.3. Ndërtimet pa Leje 210
3.10. BANIMI 210
3.10.1. Fondi i banimit 211

DRAFT

3.10.2. Nevojat për banim 211
3.10.3. Kushtet e banimit 212
3.10.4. Shfrytëzimi i fondit të banimit 212
3.10.5. Trendet e ndërtimit të ndërtesave për banim dhe çmimet mesatare të ndërtesave për banim 213
3.10.6. Identifikimin e tokës së mjaftueshme për banim 213
3.10.7. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore 214
3.11. SHFRYTËZIMI AKTUAL I TOKËS 215
3.11.1. Banim / Banim i përhershëm 217
3.11.2. Banimi Social 217
3.11.3. Prodhim Parësor / Bujqësi 218
3.11.4. Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë 219
3.11.5. Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit 220
3.11.6. Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor 221
3.11.7. Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar 222
3.11.8. Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile 222
3.11.9. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit 224
3.11.10. Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile 225
3.11.11. Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative 226
3.11.12. Modelet e shfrytëzimit 226
3.11.13. Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet / Analiza Swot 227
3.11.14. Gjetjet kyçe 228
4. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE TË KOMUNËS 229
4.1. Kapacitetet njerëzore 229
4.2. Performanca financiare në të kaluarën 229
4.3. Supozimet parashikuese 231
4.3.1. FUSHAT POTENCIALE PËR INTERVENIM DHE PËRKRAHJE 234
5. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 236
5.1. VIZIONI 236
5.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTA 237
5.2.1. Zhvillimi ekonomik 239
5.2.2. Infrastruktura teknike 240
5.2.3. Infrastruktura e transportit 241
5.2.4. Infrastruktura publike dhe sociale 242
5.2.5. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri 243
5.2.6. Trashëgimia natyrore dhe kulturore 244
5.2.7. Vendbanimet 244
5.2.8. Vendbanimet jo- formale 244
5.2.9. Banimi 244
5.2.10. Shfrytëzimi i tokës 245
5.3. SKENARËT E PROPOZUAR HAPËSINOR 247
5.3.1. SKENARI 1 - SKENARI KRYESOR NGA PZHK E KALUAR 247
5.3.2. SKENARI 2 250
5.3.3. SKENARI 3 253
5.3.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR 262

DRAFT

5.3.2. ZHVILLIMET E PLANIFIKUARA SIPAS FUSHAVE 264
5.4. PRIORITETET E ZHVILLIMIT STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT 286
5.5. PLANI I VEPRIMIT 288
5.5.1. Prioritetet strategjike për zhvillimin ekonomik 288
5.5.2. Prioritetet strategjike për infrastrukturë teknike 291
5.5.3. Prioritetet strategjike për infrastrukturë të transportit 294
5.5.4. Prioritetet strategjike për arsim 295
5.5.5. Prioritetet strategjike për shëndetësi 296
5.5.6. Prioritetet strategjike për mirëqenie sociale dhe komunitet 296
5.5.7. Prioritetet strategjike për hapësirat kulturore 296
5.5.8. Prioritetet strategjike për hapësira sportive dhe të gjelbra 296
5.5.9. Prioritetet strategjike për hapësira të hapura publike 297
5.5.10. Prioritetet strategjike për varreza 297
5.5.11. Prioritetet strategjike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore 298
5.5.12. Përcaktimi i masave mbrojtëse për mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri 299
5.5.13. Prioritetet strategjike për vendbanimet 299
5.5.14. Prioritetet strategjike për vendbanimet joformale 301
5.5.15. Prioritetet strategjike për banim 301
5.5.16. Prioritetet strategjike për shfrytëzim të tokës. 301
6. ZBATIMI DHE MONITORIMI 303
6.1. Dispozitat për zbatim 303
6.1.1. Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm 303
6.1.2. Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së 307
6.1.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës 310
6.1.4. Kuptimi i vlerësimit 310
6.1.5. Autoritetet kompetente për Zbatim dhe Monitorimin e zbatimit të PZHK-së së Obiliqit 310
7. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE 311
7.1. Hyrja në fuqi 311
7.2. Validiteti / vlefshmëria 311
7.3. Vlerësimi 311

DRAFT

Tabela e përmbajtjes së pjesës hartografike

1. Harta e Planit të Zhvillimit Ekonomik;
2. Harta e Planit të Infrastrukturës së Transportit;
3. Harta e Planit tëTransportit urban dhe rural;
4. Harta e Planit të Energjisë Elektrike dhe Termike;
5. Harta e Planit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit;
6. Harta e Sistemit të Ujitjes dhe të drenazhimit;
7. Harta e Planit të Telekomunikacionit dhe Instalimeve të Ngjashme;
8. Harta e Planit të Hapësirave Publike dhe Sociale;
9. Harta e Planit të Hapësirave Sportive;
10. Harta e Planit të Hapësiravetë Hapura Publike dhe të Gjelbra;
11. Harta e Planit të Menaxhimit të Varrezave; dhe
12. Harta e Planit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore.
13. Harta e Planit për Mbrojtjen nga Rreziqet Natyrore; dhe
14. Harta e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Riciklim.

DRAFT

Lista e akronimeve dhe shkurtesat

Shkurt.	Institucioni	Shkurt.	Institucioni
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	IVE	Indeksi i varfërisë më ekstreme
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës	IZhNj	Indeksi i zhvillimit njerëzor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës	NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
BB	Banka Botërore	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian	RZHNJ	Raporti i Zhvillimit Njerëzor
BPV	Bruto Produkti i Vendit	ZKL	Zyra e Komuniteteve Lokale
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	VJF	Vendbanime Jo Formale
ESK	Enti Statistikor i Kosovës	IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	QRTK	Qendra Regjionale e Trashëgimisë Kulturore
GND	Të ardhurat nacionale në dispozicion	DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
KKS	Kuvendi Komunal i Obiliqit	DAP	Drejtoria e Administratës Publike
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DI	Drejtoria për Infrastrukturë
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor	ZGjC	Zyre e Gjendjes Civile
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal	ShFMU	Shkollë Fillore dhe e Mesme e Ultë
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	ShML	Shkollë e Mesme Ultë
OJQ	Organizata joqeveritare	MI	Ministria e Infrastrukturës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
PZHKU	Plani Zhvillimor Komunal Urban	ITUZ	Impianti për trajtimin e ujërave te zeza
PZHU	Plani Zhvillimor Urban	PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
HZK	Harta Zonale e Komunës	IP	Investitor Privat
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillim	SSh	Stabiliment Shpërndarës
UNHCER	Komisioni i lartë i kombeve të bashkuar për refugjatë	KURK	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit
DAP	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme	DA	Drejtoria e Arsimit
DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	DEF	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
DI	Drejtoria e Inspekcionit	DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DMM	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit	DPUKP	Drejtoria për Planifikim Urban Kadastër dhe Pronë
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	DSHPE	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
DAKL	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore

DRAFT

Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e takimeve dhe diskutimeve publike 45
Tabela 2. Veçoritë gjeologjike 51
Tabela 3 Llogaritjet e këndit të rrënjës së terrenit janë bërë duke u bazuar në modelin digjital relievor "EUDEM", i cili ka përmasat e rezolucionit hapësinor 25*25m. 55
Tabela 4 Numri i banorëve sipas grup-moshave, ASK 2011 59
Tabela 5 Numri i banorëve sipas etnicitetit, ASK 2011 59
Tabela 6 Numri i banorëve sipas besimit fetar, ASK 2011 59
Tabela 7 Numri i banorëve të lindur dhe vdekur sipas viteve, ASK 2011 59
Tabela 8 Karakteristikat e ekonomive familjare, ASK 2011 59
Tabela 9 Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtareve, ASK 2011 59
Tabela 10 Banorët sipas moshës dhe strukturës gjinore e popullsisë, ASK 2011 60
Tabela 11. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve 60
Tabela 12 Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit, njohjes së shkrim-leximit, gjinisë dhe komunës, ASK 2011 60
Tabela 13. Ekonomitë familjare sipas vendbanimeve, 2019. Burimi: Zyra e tatimit në pronë, Komuna e Obiliqit 61
Tabela 14. Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Komunën e Obiliqit, 2020 62
Tabela 15. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë 62
Tabela 16. Numri i ndërmarrjeve ekonomike, sipas pronësisë 62
Tabela 17. Ndërmarrjet ekonomike, sipas sektorëve ekonomik 63
Tabela 18. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë 63
Tabela 19. Numri i ndërmarrjeve ekonomike, sipas vendbanimeve 64
Tabela 20. Numri i të punësuarve, sipas vendbanimeve 64
Tabela 21. Prodhimtaria bujqësore e drithërave sipas hektarëve 66
Tabela 22. Prodhimtaria bujqësore e perimeve sipas hektarëve 67
Tabela 23. Prodhimtaria bujqësore e foragjereve sipas hektarëve 67
Tabela 24. Prodhimtaria bujqësore e pemëve sipas hektarëve 67
Tabela 25. Numri i kafshëve në Komunë 67
Tabela 26. Numri i fermave familjare sipas vendbanimeve 67
Tabela 27. Numri i ekonomive bujqësore sipas ASK-së 2014, Obiliq 68
Tabela 28. Të punësuarit si bartës të ekonomisë bujqësore 69
Tabela 29. Të punësuarit sipas anëtarëve të ekonomisë bujqësore (ASK) 69
Tabela 30. Fondi blegtoral dhe ekonomitë bujqësore 69
Tabela 31. Nënstacionet, fuqitë dhe numri i transformatorëve nga furnizohet Obiliqi 75
Tabela 32. Korridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja kabllore nëtokësore ekzistuese dhe ndërtime te reja 76
Tabela 33. Korridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja kabllore nëtokësore ekzistuese dhe ndërtime te reja 76
Tabela 34. Kategoritë e rrugëve 83
Tabela 35. Rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre 85
Tabela 36. Infrastruktura dhe shërbimet sociale dhe publike të shëndetësisë 90
Tabela 37. Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet profesionale 91
Tabela 38. Veçoritë e institucionit të vetëm parashkollor publik 92
Tabela 39. Numri i fëmijëve në institucionet parashkollore 92
Tabela 40. Institucionet arsimore fillore dhe të mesme të ulëta 93

DRAFT

Tabela 41. Veçoritë e ShFMU....94
Tabela 42. Veçoritë e ShFMU....94
Tabela 43. Institucionet arsimore të mesme të larta....94
Tabela 44. Veçoritë e ShML....95
Tabela 45. Institucionet administrative....96
Tabela 46. Numri i personave ne nevojë për përkrahje sociale....97
Tabela 47. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, kapacitetet profesionale, 2018....97
Tabela 48. Veçoritë e institucioneve kulturore....97
Tabela 49. Veçoritë hapësinore të institucioneve kulturore....98
Tabela 50 Veçoritë e objekteve të rinisë, sportit dhe rekreacionit....98
Tabela 51 Veçoritë hapësinore të objekteve të rinisë, sportit dhe rekreacionit....99
Tabela 52. Hapësira publike të hapura rekreative....99
Tabela 53. Hapësira private të mbuluara rekreative....99
Tabela 54. Hapësirat publike në zonën urbane....99
Tabela 55. Hapësirat publike në zonën rurale....100
Tabela 56. Objektet religjioze në vendbanime....101
Tabela 57. Vendbanimet me varreza dhe sipërfaqja e tyre (ha)....101
Tabela 58. Fatkeqësitë natyrore sipas kategorive kryesore (ha)....103
Tabela 59. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj në vitin 2020....104
Tabela 60. Emisionet aktuale të termocentraleve të KEK- ut....104
Tabela 61. Matjet e ndotjes së ujërave sipërfaqësor në Grabofc dhe Obiliq....104
Tabela 62. Ujërat nëntokësor sipas shkallës së ndjeshmërisë....105
Tabela 63. Sipërfaqet dhe përqindja e territorit e rrezikuar nga erozioni....108
Tabela 64 Trashëgimia natyrore nën mbrojtje, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore....110
Tabela 65 Trashëgimia kulturore nën mbrojtje, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore, 2018....110
Tabela 66 Asetetet e Trashëgimisë Arkitekturore - Monument/Ansambël nën mbrojtje të përkohshme para vitit 2020....110
Tabela 67 Asetet e trashëgimisë kulturore me vlera historike lokale....111
Tabela 68 Monumentet arkeologjike, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore, 2018....111
Tabela 69 Zonat e Veçanta te Mbrojtura, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, dhe shtrirjes hapësinore, 2018....112
Tabela 70. Asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje nga Agjencia për Menaxhimin e Kompleksеve Memorialë të Kosovës....112
Tabela 71. Vendbanimet në komunë, 2018....114
Tabela 67. Vendbanimi shumë i vogël urban....114
Tabela 68. Vendbanimi i madh rural....114
Tabela 69. Vendbanimet e mesme të mëdha rurale....114
Tabela 70. Vendbanimet e vogla rurale....114
Tabela 76. Vendbanim i vogël rural....114
Tabela 77. Vendbanimi shumë i vogël rural....114
Tabela 78. Ritmet e Rritjes Urbane....114
Tabela 79. Lartësisë mbidetare sipas zonave kadastrale....115
Tabela 80. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara....115
Tabela 81. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara....116
Tabela 82. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara....116
Tabela 83. Vendbanimet joformale....118
Tabela 84. Numri i ndërtimeve pa leje sipas Zonave Kadastrale....119

DRAFT

Tabela 85. Numri i njësive, sipërfaqja e përgjithshme (m2), m2/njësi dhe përqindja e njësive sipas llojit 121
Tabela 86. Numri i ndërtesave të banimit dhe % sipas llojit 121
Tabela 87. Kërkesat për zgjidhje të çështjes së banimit 121
Tabela 88. Gjendja aktuale e banimit social 121
Tabela 89 Sipërfaqja e përfshirë ne plane urbane 123
Tabela 90 Shfrytëzim i tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes. 123
Tabela 91 Sipërfaqet e shërbimeve sipas sipërfaqeve (ha)në zona kadastrale 124
Tabela 92 Zonat e Mbrojtura sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale 124
Tabela 93 Sipërfaqet komerciale sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale 124
Tabela 94 Sipërfaqet e komunikacionit dhe transportit sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale 124
Tabela 95 Sipërfaqet rekreative dhe turistike sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale 124
Tabela 96 Numri dhe përqindja e popullsisë sipas vendbanimeve ndër vite 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011, ASK 2011 126
Tabela 97 Numri i anëtarëve për ekonomi familjare në vitet 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011 126
Tabela 98 Numri i ekonomive familjare sipas vendbanimeve ndër vite 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011, ASK 2011 128
Tabela 99 Vlerësimet ndër vite të numrit të popullsisë rezidente në Obiliq. Vjetari Statistikor, ASK, 2020. 129
Tabela 100 Projeksioni i Popullsisë, Komuna Obiliq 2021- 2029 sipas Skenarëve (Pesimist, Realist dhe Optimist) 129
Tabela 101 Projeksioni i numrit të banorëve në vitet 2021-2030 130
Tabela 102 Projeksioni i numrit të ekonomive familjare në vitet 2021-2030 130
Tabela 103 Ndërmarrjet ekonomike, punësimi për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas pronësisë 138
Tabela 104 Ndërmarrjet ekonomike, punësimi për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas vendbanimeve 138
Tabela 105 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas pronësisë .. 138
Tabela 106 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas vendbanimeve 139
Tabela 107 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas sektorëve ekonomik 140
Tabela 108 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të punësimit sipas për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sektorëve ekonomik 140
Tabela 109 Trendët e prodhimtarisë (ha) së drithërave, 2017- 2020 140
Tabela 110 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së drithërave, 2020- 2028 140
Tabela 111 Prognoza për prodhimtarinë (ha) e drithërave sipas kulturave bujqësore deri 2028 141
Tabela 112 Trendët e prodhimtarisë (ha) së perimeve, 2017- 2020 141
Tabela 113 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së perimeve, 2020- 2028 141
Tabela 114 Prognoza për prodhimtarinë (ha) e perimeve sipas kulturave bujqësore deri 2028 141
Tabela 115 Trendët e prodhimtarisë (ha) së foragjereve, 2017- 2020 141
Tabela 116 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së foragjereve, 2020- 2028 141
Tabela 117Prognoza për prodhimtarinë (ha) e foragjereve sipas kulturave bujqësore deri 2028 141
Tabela 118 Trendët e prodhimtarisë (ha) së pemëve, 2017- 2020 142
Tabela 119 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së pemëve, 2020- 2028 142
Tabela 120. Prognoza për prodhimtarinë (ha) e pemëve sipas kulturave bujqësore deri 2028 142
Tabela 121. Korridoret e linjave energjetike kabllovike nëntokësore 152
Tabela 122. Korridoret e linjave energjetike ajrore 152
Tabela123 Analiza SWOT për infrastrukturën publik edhe sociale 164
Tabela 124. Analiza SWOT për infrastrukturën publike dhe sociale 165
Tabela 125 Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike parashkollore sipas NTPH 165

DRAFT

Tabela 126. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas NTPH 166
Tabela 127. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë sipas NTPH 167
Tabela 128. Kërkesat hapësinore për institucione parashkollore publike sipas NTPH për vitin 2030 168
Tabela 129. Kërkesat hapësinore për Shkolla Fillore dhe të Mesme të Ulëta publike sipas NTPH për vitin 2030 168
Tabela 130. Kërkesat hapësinore për shkolla të mesme të larta sipas NTPH për vitin 2029 168
Tabela 131. Numri i shërbimeve mjekësore të ofruara gjatë vitit 2020 168
Tabela 132. Numri i shërbimeve mjekësore të ofruara gjatë vitit 2020 168
Tabela 133. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione shëndetësore sipas NTPH 169
Tabela 134. Vlerësimi i nevojës për sipërfaqe të parcelave kadastrale për institucione publike shëndetësore sipas NTPH për vitin 2029 170
Tabela 135. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të administratës publike sipas NTPH 171
Tabela 136. Kërkesat hapësinore për institucionet e administratës publike sipas NTPH për vitin 2030 171
Tabela 137. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit sipas NTPH 171
Tabela 138. Kërkesat hapësinore për institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit sipas NTPH për vitin 2030 172
Tabela 139. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione kulturore - bibliotekë publike sipas NTPH 172
Tabela 140. Kërkesat hapësinore për institucione kulturore sipas NTPH për vitin 2030 172
Tabela 141. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione sportive dhe fushave rekreative publike sipas NTPH 173
Tabela 142. Kërkesat hapësinore për infrastrukturës se institucioneve sportive dhe fushave rekreative sipas NTPH për vitin 2030 173
Tabela 143. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për hapësira të hapura publike sipas NTPH 174
Tabela 144. Kërkesat hapësinore për infrastrukturës së hapësirave të hapura publike sipas NTPH për vitin 2030 174
Tabela 145. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Obiliq 2017 – 2020 176
Tabela 146. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Dardhishtë 2017 – 2020 177
Tabela 147. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Palaj 2017 – 2020 177
Tabela 148. Matjet e substancave ndotëse të lumit Drenica në njësinë matëse në Grabofc 2017 – 2020 179
Tabela 149. Matjet e substancave ndotëse të lumit Sitnica në njësinë matëse në Obiliq 2017 – 2020 180
Tabela 150. Ujërat nëntokësore sipas shkallës së ndjeshmërisë 182
Tabela 151. Sipërfaqet dhe përqindja e territorit e rrezikuar nga erozioni 187
Tabela 152 Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit 188
Tabela 153. Analiza SWOT për trashëgiminë natyrore, kulturore dhe turistike 196
Tabela 154. Klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë 200
Tabela 155. Kategorizimi i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë 2011 dhe 2020, sipërfaqes totale dhe dendësisë së popullsisë 201
Tabela 156. Raporti i sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pandërtuara në kuadër të vendbanimeve 202
Tabela 157. Vendbanimet që parashihet të zgjerohen dhe ato që parashihet të kompaktësohen 203
Tabela 158. Kategorizimet e vendbanimeve 206
Tabela 159. Analiza SWOT për vendbanimet 207
Tabela 160. Vendbanimet joformale dhe karakteristikat e tyre: 208
Tabela 161. Analiza SWOT për vendbanimet joformale 210
Tabela 150 Të dhënat për numër dhe sipërfaqe të banimit 210
Tabela 163.Numri i ndërtesave të banimit në zonë urbane dhe rurale 211

DRAFT

Tabela 164.Numri i ndërtesave të banimit në zonë urbane dhe rurale 211
Tabela 165. Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit 211
Tabela 166 Simulimi dhe shpërnadrja e sipërfaqeve të banimit ekzistues 212
Tabela 155. Shfrytëzueshmëria e fondit të banimit 212
Tabela 168 Numri i njësive të banimit me një njësi para dhe pas vitit 1999 213
Tabela 169 Numri i ndërtesave dhe njësive të banimit me shumë njësi para dhe pas vitit 1999 213
Tabela 170. Analiza SWOT për banim 215
Tabela 171 Shfrytëzimi i Tokës sipas Planit të Veprimit në mjedis 2012-2019 dhe Urban Atlas Copernicus (Infrastruktura e trasnsportit) 216
Tabela 172 Shfrytëzimi aktual i Tokës 2020 216
Tabela 173 Diferenca në mes të shfrytëzimit aktual të tokës sipas Planit të Veprimit në Mjedis 2012, Urban Atlas Copernicus (Infrastruktura e transportit) dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2020. 216
Tabela 174 Sipërfaqja totale e zonave rekreativo - turistike e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve. 226
Tabela 175 Gjetjet kyçe gjatë vlerësimit të profilit të shfrytëzimit të tokës 228
Tabela 176. Numri i të punësuarve sipas drejtorive komunale 229
Tabela 177. Numri i të punësuarve sipas përvojës së punës dhe drejtorive komunale 229
Tabela 178. Numri i të punësuarve sipas përvojës së punës dhe drejtorive komunale 229
Tabela 179. Buxheti i shpenzuar nëpër vite 230
Tabela 180. Komuna e Obiliqit –Mbledhja e të hyrave vetanake në të kaluarën 2017-2020 230
Tabela 181. Parashikimi i të hyrave vetanake nga tatimi në pronë për vitet e ardhme 231
Tabela 182. Parashikimi i të hyrave vetanake nga regjistrimi i automjeteve për vitet në vijim 231
Tabela 183. Parashikimi i të hyrave vetanake nga lejet ndërtimore për vitet në vijim 231
Tabela 184. Parashikimi i të hyrave vetanake nga regjistrimi i trashëgimisë 231
Tabela 185. Parashikimi i të hyrave vetanake nga ndërrimi i destinimit të tokës për vitet në vijim 231
Tabela 186. Parashikimi i të hyrave vetanake nga ngarkesat tjera administrative 232
Tabela 187. Parashikimi i të hyrave vetanake nga tatimet për ushtrimin e veprimtarive 232
Tabela 188. Parashikimi i të hyrave vetanake nga participimi në arsim 232
Tabela 189. Parashikimi i të hyrave vetanake nga participimi në shëndetësi 232
Tabela 190. Sipërfaqet e tokës ndërtimore, të planifikuar dhe ekzistuese dhe intensiteti i planifikuar 283

DRAFT

Lista e figurave

Figura 1. Trëndafili i Erës....57
Figura 2. Shtrirja e rrjetit 400 CV (linjat dhe nënstacionet)....72
Figura 3. Shtrirja e rrjetit 220kV (linjat dhe nënstacionet)....73
Figura 4. Shtrirja rrjetit 110 kV (linjat dhe nënstacionet)....74
Figura 5. Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 35 kV (linjat dhe nënstacionet)....75
Figura 6. Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV (linjat dhe nënstacionet)....76
Figura 7. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën nacionale N2 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)....86
Figura 8. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën rajonale R220 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)....86
Figura 9. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën rajonale R220 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)....87
Figura 10. Ndërtimet në zonën e komasacionit 133
Figura 11. Gjendja e tokave bujqësore nën sistem të ujitjes.... 134
Figura 12. Zonat në sistem të ujitjes.... 149
Figura 13. Vendbanim joformal- Kryshefc.... 208
Figura 14. Të hyrat vetanake në raport me buxhetin komunal për vitet 2017- 2020.... 230
Figura 15. Zbërthimi i Objektivave sipas konceptit SMART.... 238
Figura 16. Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshinë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.... 239

DRAFT

Lista e hartave në pjesën tekstuale

Harta 1 Strategjia e Zhvillimit Hapësinor nga PHZVE "Fusha e Mihjes së Re" - Burimi: IPH / MMPH 30
Harta 2 Shfrytëzimi i parashikuar i tokës për në vitin 2020 - Burimi: IPH / MMPH 31
Harta 3 Shpërndarja e gazrave SO2 dhe NOx nga TC KR dhe Kosova B nën ndikimin e erës në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH 32
Harta 4 Masat mbrojtëse ndaj erozionit dhe vërshimeve më të theksuara në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH 33
Harta 5. Modeli i zhvillimit hapësinor PZHK 2010- 2020+ 34
Harta 6. Modeli i zhvillimit hapësinor qyteti PZHU 2010- 2020+ 35
Harta 7. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Gllogocit 37
Harta 8. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Podujevës 39
Harta 9. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Prishtinës 40
Harta 10. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Fushë Kosovës 41
Harta 11. Porti i Kosovës – Zona e Kaltër, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+ 42
Harta 12. Kufiri i zonës së FMR-së me sipërfaqe prej 150km2. - Burimi: IPH / MMPHI 43
Harta 13 Pozita gjeografike 49
Harta 14. Përbërja pedologjike 50
Harta 15. Formacionet gjeologjike 51
Harta 16. Përshtatshmëria e Integruar e Tokës , (ILS) 52
Harta 17. Rrjeti hidrogjeologjik 53
Harta 18. Njësitë hidrogjeologjike 53
Harta 19. Hipsometria e terrenit 54
Harta 20. Pjerrtësisë së terrenit në komunën e Obiliqit 56
Harta 21. Ekspozicioni i terrenit në komunën e Obiliqit 57
Harta 22 Vlerat e llogaritura të biodiversitetit (EBV) 58
Harta 23. Shtrirja hapësinore e zonave industriale dhe ekonomike 65
Harta 24. Shtrirja hapësinore e minierave sipërfaqësore 66
Harta 25. Shtrirja e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit të tokave bujqësore 68
Harta 26. Resurset minerale dhe natyrore 70
Harta 27. Harta e zhvillimit ekonomik 71
Harta 28. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura (zeza) i ndërtuar deri në 2019 78
Harta 29. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit 79
Harta 30. Shtrirja e tokave bujqësore në komasacion dhe nën ujitje 80
Harta 31. Mbulueshmëria me rrjet e operatorit Kujtesa 81
Harta 32. Rrugët nacionale dhe rajonale 84
Harta 33. Shtrirja hapësinore e institucioneve shëndetësore 91
Harta 34 Shtrirja e institucioneve shkollore 95
Harta 35. Shtrirja e institucioneve administrative 96
Harta 36. Hapësirat rekreative-sportive 100
Harta 37. Shtrirja e objekteve religjioze dhe varrezave 101
Harta 38. Shtrirja e varrezave 102
Harta 39 Ndjeshmëria mjedisore e ujërave (GWS) 105
Harta 40. Ndjeshmëria mjedisore e tokës (ELS) 106
Harta 41. Sipërfaqet ujore dhe vërshimet 107
Harta 42. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit 108
Harta 43. Shtrirja e zonave sizmike dhe të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës 109

DRAFT

Harta 44. Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural 113
Harta 45. Harta e vendbanimeve joformale 119
Harta 46 Shtrirja e ndërtimeve pa leje në Komunën e Obiliqit 120
Harta 47. Shtrirja e rrjetit të largpërçuesve 153
Harta 48 Mbulushmeria me rrjet e KUJTESA-net 157
Harta 49. Mbulueshmëria e territorit me institucione publike parashkollore sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH 166
Harta 50 Mbulueshmëria e territorit me shkolla publike fillore dhe të mesme të ulëta sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH 167
Harta 51. Mbulueshmëria e territorit me qendra të mjekësisë familjare sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH .. 169
Harta 52. Mbulueshmëria e territorit me e punkteve të mjekësisë familjare sipas rezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH 170
Harta 53. Mbulueshmëria e territorit me institucione sportive dhe fushave rekreative sipas rezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH 173
Harta 54 Rreziku nga ndotja e ujërave nëntokësor 182
Harta 55 Ndjeshmëria mjedisore e tokës 183
Harta 56. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit 187
Harta 57 Vendbanimet qe i nenshtrohen zhvendosjes nga zgjerimi i minierave te lignitit 204
Harta 58 Zonat qe kufizojnë zhvillimet e ndërtimeve 205
Harta 59. Shpërndarja e ndërtimeve pa leje në komunën e Obiliqit 210
Harta 60. Skenari sipas PZHK- së në fuqi 249
Harta 61. Skenari i dytë 252
Harta 62 Skenari i tretë 255
Harta 63 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Obiliqit 263
Harta 64 Koncepti i zhvillimit ekonomik të komunës së Obiliqit 266
Harta 65 Koncepti i zhvillimit të Infrastrukturës Teknike 271
Harta 66 Koncepti i zhvillimit të Infrastrukturës Publike dhe Sociale 275
Harta 67 Koncepti i Mbrojtjes se Mjedisit dhe siperfaqeve në rrezikshmëri 278
Harta 68 Koncepti i zhvillimit hapësinor të vendbanimeve 281

DRAFT

Lista e fotografive

Foto 1. Vendimi i Kuvendit Komunal për hartim të PZHK-së së komunës së Obiliqit.....22
Foto 2. Vendimi i Kuvendit Komunal për plotësimin e e vendimit për hartim të PZHK-së së komunës së Obiliqit 22
Foto 2. Pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së 2021- 2029 24
Foto 4. Pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së 2021- 2029 26
Foto 3. Deponia e mbeturinave, Mirash"Zona e Interesit të Veçantë Ekonomik – Fusha e Mihjes së Re, zonë e menaxhuar me kujdes, në përputhje me standardet e BE-së në dobi të rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe gjendjes së kënaqshme mjedisore." 43
Foto 3. Deponia e mbeturinave, Mirash 109
Foto 3. Deponia e mbeturinave, Mirash 109

Lista e referencave

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018*, Prishtinë, 2018
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014*, Prishtinë, 2014
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë TM1-2018*, Prishtinë, 2018
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Parashikimi I Popullsisë së Kosovës 2017-2061*, Prishtinë, 2017
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe vendbanimit 2011*, Prishtinë, 2013
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Banesat dhe ndërtesat sipas komunave 2013,* Prishtinë, 2013
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Të dhënat e bujqësisë sipas komunave 2013*, Prishtinë, 2013
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Të dhënat e tregut te punës sipas komunave 2013,* Prishtinë, 2013
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Të dhënat kryesore demografike sipas komunave 2013,* Prishtinë, 2013
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Të dhënat socio ekonomike sipas komunave 2013*, Prishtinë, 2013


DRAFT

1. HYRJE

1.1. Informata për vendimet e Kuvendit të Komunës në lidhje me PZHK-në

1.1.1. Vendimi i Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK-së

Me qëllim që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës së Obiliqit, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore në përputhje me Nenin 10, paragrafin 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor në 30/10/2017, Kuvendi i Komunës ka marrë vendimin nr. I- 100 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Obiliqit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ
MUNICIPALITY OF OBILIC

Në bazë të nenit 12 dhe 17 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 5 nënparagrafi 1.2 dhe nenet 10,11,15 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 i datës:31.07.2013 (Gazeta Zyrtare nr.30 të datës:23.08.2013), Udhëzimi administrativ i MMPH-Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.-I-34-2016 të datës 25.04.2016 , Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr. II-708, të dt.18.10.2017 në mbeldhjen e mbajtur me dt. 30.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lloji i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

Të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr.-I-65, të dt.28.06.2017, për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Obiliqit.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

Me anë të këtij Vendimi bëhet përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor,Planit Zhvillimor të Komunës i cili do të jetë në përputhje me Ligjin e planifikimit hapësinor nr.04/L-174 dhe udhëzimin administrativ nr. 24/2015.

Plani Zhvillimor është Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor i cili bazohet në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës për periudhën nëntë (9) vjeqare.

Neni 8

Konsultimet Publike

Projekti i Planit Zhvillimor të Komunës para finalizimit duhet të vihet në diskutim publik dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e projekt Planit Zhvillimor të Komunës së Obiliqit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit hartohet për periudhën kohore 9 (nëntë) vjeqare.

Neni 10

Gjuha Zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor duhet të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij Vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit të paraparë me nenin 11 pika 1.3. të Ligjit për Planifikim Hapsinor Nr.04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës , në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.04/L-040 dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

T' i dërgohet:
-Kryetarit;
-Nënkryetari;
-Krycsuesit;
-MAPL-së;
-DAP-së;
-DPUKP-së;
-Këshilltarëve;
-Arkivit.

Kryesues i Kuvendit Komunal
Adem Preniqi

Foto 1. Vendimi i Kuvendit Komunal për hartim të PZHK-së së komunës së Obiliqit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, kerkesa e DPUPK –së nr.V-826, dt.28.05.2021.Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

1. **Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr. –I-100, të dt.30.10.2017, të Kuvendit Komunal Obiliq**
2. **Ndryshimi bëhet vetem tek nenin 2 dhe neni 9 i vendimin I-100 – (Lloji i dokumentit të Planifikimit Hapësinor) , nga afti (9) vjeçar bëhet në atë (8) vjeçar**
3. **Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.**

T'idërgohet
- Kryetarit
- Nënkryetarit
- DEFZH
- MPL
- Anëtarëve të KK
- Arkivit

Kryesues i Kuvendit Komunal
Burim Gërguri

Foto 2. Vendimi i Kuvendit Komunal për plotësimin e vendimit për hartim të PZHK-së së komunës së Obiliqit

1.1.2. Vendimi i Kuvendit të Komunës për miratim dhe zbatim të PZHK-së

Pas një procesi cilësor, gjithëpërfshirës, duke i kaluar të gjitha fazat dhe siguruar parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët, dhe pasi komuna është pajisur me të gjitha pëlqimet, dhe ka kryer të gjitha obligimet ligjore në funksion edhe të aprovimit formal të PZHK-së, në përputhje me Nenin 10, paragrafin 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor në datën XX/XX/XXXX Kuvendi i Komunës ka marrë vendimin nr. XXXXXXX për miratimin dhe zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Obiliqit.

1.2. Informata për miratimet e PZHK-së

1.2.1. Vendimi për pëlqimin mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së

Hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është detyrim ligjor, i cili parashihet në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr. 04/L-174. Në raportin e VSM-së janë të përfshira edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga përmbajtjet e përgjithshme zhvillimore dhe zbatimi i PZHK-së dhe alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Duke e kuptuar rëndësinë e VSM-së komuna ka kryer në një proces cilësor me VSM-në e PZHK-së dhe ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe procedurale të parapara ligjore dhe me datë 22/09/2020, Komuna ka pranuar vendimin për **pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së 2022- 2030** të paraqitur në vijim**.**

DRAFT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
Nr. Prot. 3963-2/20
Data: 22.09.20
PRISHTINË/A NO.2

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Kabineti i Ministritit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Ministër

DATË/A:	14.09. 2020
REFERENC-Ë:	20/3413/MEA
PËR/ZA/TO:	"Komunën e Obiliqit" Obiliq, Drejtorinë për Planifikim Urban Pronë dhe Kadastër
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Blerim Kuçi, Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Prishtinë/a

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, e ka pranuar Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit me nr.: 20/3413/MEA, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1.Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit.

Me respekt,

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail. zsp.mmph@ks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Ministër

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230, nxjerr këtë:

V E N D I M

"Komuna e Obiliqit " Obiliq , Drejtoria për Planifikim Urban Pronë dhe Kadastër,pajiset me **Pëlqim Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit.

A r s y e t i m

"Komunës së Obiliqit " Obiliq , Drejtorisë për Planifikim Urban Pronë dhe Kadastër, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit, proces verbalin i Debatit Publik për draft Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit., listen e pjesmarrësve në Debat Publik, Proces verbalin e debatit publik të dorëzuar nga "Komuna e Obiliqit " Obiliq , Drejtoria për Planifikim Urban Pronë dhe Kadastër.

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit merr vendim për lëshuarjen e **Pëlqimit Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Nr.: 20/3902/1 -444/ /20 datë: 14.09.2020

Prishtinë

Blerim Kuçi
Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit

T'i dërgohet:
1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VSM*
3. *Inspektoratit të MIA-së*
4. *Zyrës të Sekretarit të* Përgjithshëm
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Arkivi i MEA-*
7. *Kuvendit të Komunës së Gllogocit*

Faqe 3 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Foto 4. Pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së 2022- 2030

VSM ka marrë në konsideratë të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i këtij plani dhe qëllimi i VSM-së është: 1) përmirësimi i planit në mënyrë që të minimizohet ndikimi i tij i mundshëm negativ në

mjedis dhe të maksimizohet ndikimi pozitiv dhe 2) të sigurohet që ndikimet e mundshme negative që nuk mund të shmangen të menaxhohen siç duhet dhe të amortizohen gjatë zbatimit të planit.

1.2.2. Vendimi i miratimit të PZHK-së nga MMPHI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në funksion të kryerjes së obligimeve të veta ligjore pasi që u sigurua në përputhshmërinë e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit me Planin Hapësinor të Kosovës (PHK) si dhe sigurimit në cilësinë e procesit, pas pranimit të të dhënave digjitale , dhe sigurimit se dokumenti është punuar bazuar në normat teknike të planifikimit hapësinor, dhe po ashtu në përputhje me Nenin 9, paragrafin 2.3.1. të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor në datën XX/XX/XXXX MIA ka marrë vendimin nr. XXXXXXX për dhënien e pëlqimit për procedim të mëtejmë të Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit për aprovim nga Kuvendi Komunal.

1.3. INFORMATA PËR KORNIZËN STRATEGJIKE TË MARRA PARASYSH GJATË HARTIMIT TË PZHK-së

1.3.1. Strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror

Fillimisht, komuna e Obiliqit, gjegjësisht ekipet hartuese të PZHK-së, të sfiduara nga reforma ligjore krijuan kuptimin e njëjtë për procesin dhe pjesëmarrësit në proces të Planin Zhvillimor Komunal duke konstatuar se: kemi të bëjmë me një dokument të planifikimit hapësinor i nivelit lokal, ku hapësira është determinant kryesor i zhvillimit. Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik, dhe planifikimi strategjik, pasi të ketë analizuar situatën strategjike me një proces cilësor, përcakton vizionin, qëllimet, objektivat, prioritetet strategjike dhe definon strategjitë për të arritur vizionin, çdo herë duke u bazuar në përmbajtjen determinuese të PZHK-së.

Sipas kornizës së re ligjore kemi dy nivele të planifikimit: nivelin qendror dhe nivelin lokal, ku rjedhimisht komuna konstaton se strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal duhet jenë njëra nga bazat e hartimit të dokumentit, si dhe strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të nivelit qendror duhet jenë baza tjetër pasi ato punohen për t'u zbatuar në nivel të shtetit dhe rrjedhimisht, për aq sa është relevante, edhe në territorin e Obiliqit. Andaj, gjatë përgatitjes së PZHK-së, komuna është mbështetur në strategjitë sektoriale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror, organizuar në fushat vijuese:

Fusha ekonomike- Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë:

- Zyra e Kryeministrit: Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016- 2021; Prishtinë, Janar, 2016; Qeveria e Republikës së Kosovës
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural:
- Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Prishtinë,
- Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 –2020, Prishtinë, 2010;
- Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 – 2020, Prishtinë, 2009;
- Ministria e Financave:
- Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publike - Private për Republikën e Kosovës, Prishtinë 2014;
- Ministria e Mirëqenies Sociale,
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Prishtinë 2014; Ministria e Diasporës,
- Komuna e Obiliqit:
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, Prishtinë Korrik 2013;
- Strategjia për Zhvillim Socio- Ekonomik Lokal 2017- 2021;
- Strategjia për Zhvillim Ekonomik 2019- 2023.

Duke u bazuar në përcaktimet kryesore të nivelit qendror në këto strategji kombëtare, Komuna e Obiliqit ka integruar disa përcaktime zhvillimore në dokument si dhe ka marrë iniciativë për realizimin e tyre, si rritjen e rendimenteve bujqësore, ruajtjen e tokës bujqësore nën sistem të ujitjes (sistemeve funksionale), rezervimi i zonës së mihjeve nga zhvillimet e reja, krijimi i Zonës Industriale në Llazarevë, krijimi i hapësirave të reja për zhvillim ekonomik, krijimi i mundësive të reja për punësim, si dhe zhvillimi i mundësive për Partneritete Publike – Private në komunën e Obiliqit.

Fusha e Infrastrukturës teknike- Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive, dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë**:**

1. Ministria e Ekonomisë:

- Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017 – 2016, Prishtinë, Mars 2017;
- Strategjia e Ngrohjes së Republikës së Kosovës 2011 – 2018, Prishtinë, Gusht 2011;

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022, Prishtinë, 2013;
- Komuna e Obiliqit, Studimi i fizibilitetit Ngrohja në Largësi (Ngrohtore e Qytetit me Rrethinë), Obiliq 2019

Duke u bazuar në përcaktimet kryesore të nivelit qendror në këto strategji kombëtare, Komuna e Obiliqit ka integruar disa përcaktime zhvillimore në dokument si dhe ka marrë iniciativë për realizimin e tyre, si rezervimi i hapësirës për Termocentralin Kosova e Re, studimi i potencialeve për gjenerim të energjisë së ripërtërishme, zhvillimi i ngrohtores dhe rrjetit të koogjenerimit, si dhe inicimi i pilot projekteve për riciklim të mbeturinave, dhe trajtimi i ujërave të zeza.

Fusha e Infrastrukturës së transportit dhe transporti - Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive, dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë**:**

- Ministria e Infrastrukturës, Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025, Prishtinë, 2015.

Duke u bazuar në përcaktimet kryesore të nivelit qendror në këto strategji kombëtare, Komuna e Obiliqit ka integruar disa përcaktime zhvillimore në dokument si dhe ka marrë iniciativë për realizimin e tyre, si zhvillimi i një stacioni multimodal në Obiliq dhe mbështetja e rikonstruimit të hekurudhës.

Fusha e Infrastrukturës publike dhe sociale- Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive, dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë**:**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë Korrik 2016;
- Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Para-universitar në Kosovë, Prishtinë 2016; Raporti i Gjelbër, Prishtinë, 2015;
- Ministria e Shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Prishtinë, Nëntor 2016.

Duke u bazuar në përcaktimet kryesore të nivelit qendror në këto strategji kombëtare, Komuna e Obiliqit ka integruar disa përcaktime zhvillimore në dokument si dhe ka marrë iniciativë për realizimin e tyre, ku planifikohen infrastruktura publike dhe sociale në komunë të Obiliqit.

Fusha e Mjedisit dhe sipërfaqet me rrezikshmëri- Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive, dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë**:**

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,

- Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën 2019- 2028;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit 2011- 2021, Prishtinë, 2011;
- Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020;
- Komuna e Obiliqit, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012- 2017, Obiliq 2011.

Duke u bazuar në përcaktimet kryesore të nivelit qendror në këto strategji kombëtare, Komuna e Obiliqit ka integruar disa përcaktime zhvillimore në dokument si mbrojtja nga ndryshimet klimatike, si rregullimi i shtretërve të lumenjve, mbrojtja e biodiversitetit me mbrojtjen e pyjeve, si dhe mbrojtja nga përhapja e zjarreve në pyje, mbrojtja e cilësisë së ajrit me instalimin e filtrave në TC Kosova B, si dhe ndalimin e djegies së qymyrit për ngrohje shtëpiake, etj.

Fusha e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike- Te kjo fushë janë marrë për bazë një numër i konsiderueshëm i strategjive, dhe ndër më të rëndësishmet po i listojmë**:**

2. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit;

- Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2019, Prishtinë;
- Lista e Zonave të Mbrojtura 2019, Prishtinë;
- Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2016-2026, Prishtinë 2016;
- Komuna e Obiliqit, Rajonal i Trashëgimisë Qendër 2015 – 2018, Prishtinë 2015.

Komuna e Obiliqit ka vlerësim të plotë për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, andaj, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë për një turizëm të qëndrueshëm është pjesë e integruar e këtij plani.

Fusha e Banimit, Vendbanimet Joformale (VJF) dhe Fusha e Shfrytëzimit të tokës- Edhe te këto fusha mund të veçojmë vetëm nga:

1. Programi Trevjeçar i Banimit 2016 – 2019;
2. Projekt-Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë 2011-2015;
3. Doracaku për rregullimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë, tetor 2012;
4. Raporti për Mbulushmerinë e Sipërfaqes së Tokës - CLC2012, Prishtinë, 2016.

DRAFT

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) ka përcaktuar edhe veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë, të cilat janë trajtuar dhe integruar edhe strategjitë rajonale në procesin e hartimit të PZHK-së.


Të listuara në përmbledhjen më lartë, janë marrë parasysh të gjitha strategjitë sektoriale të nivelit kombëtar dhe lokal, ku konsiderohet se të gjitha strategjitë e komunave fqinje janë integruar në procesin e hartimit të kësaj PZHK-je.

Te fusha e Ekonomisë -Porti i Kosovës (Hapësira e kaltër) - administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike, rrjedhin nga strategji e dokumente që konsiderohen vlera rajonale ose strategji të komunave që gravitojnë në Prishtinë. Po ashtu, është dhe Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë Fusha e Mihjes së Re 2010- 2020+ si që siguron kornizën hapësinore dhe investive për zonën energjetike në fjalë dhe më gjerë dhe në ndërtimin e impiantit (termocentralit) të ri - TC "Kosova Re" brenda saj, që përmban synimet kryesore vijuese:

- Synimi 1. Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes
- Synimi 2. Planifikim dhe kontroll e procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së
- Synimi 3. Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore, dhe
- Synimi 4. Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë.


Në vijim janë paraqitur disa kufizime zhvillimore në Fushën e Mihjes së Re:

DRAFT




Harta 25. Strategjia e zhvillimit hapësinor të FMR-së - Burimi: IPH / MMPH.

Harta 1 Strategjia e Zhvillimit Hapësinor nga PHZVE "Fusha e Mihjes së Re" - Burimi: IPH / MMPHI




Harta 26. Shfrytëzimi i parashikuar i tokës për në vitin 2020. - Burimi: IPH / MMPH

Harta 2 Shfrytëzimi i parashikuar i tokës për në vitin 2020 - Burimi: IPH / MMPHI



Harta 3 Shpërndarja e gazrave SO2 dhe NOx nga TC KR dhe Kosova B nën ndikimin e erës në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPHI



Harta 4 Masat mbrojtëse ndaj erozionit dhe vërshimeve më të theksuara në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPHI

Gjithashtu, zona energjetike në përgjithësi është trajtuar sipas Planit Zhvillimor të Mihjeve (KEK), sipas viteve të eksploatimit 2019-2040.

Te fusha e Transportit –modernizimi i hekurudhës dhe avancimi i rrugës nacionale janë rezultat i strategjive nacionale por me efekt rajonal dhe kombëtar.

Te infrastruktura teknike – Në kuadër të territorit të komunës së Obiliqit shtrihen asetet më të rëndësishme të gjenerimit të rrymës elektrike (mihjet dhe termocentralet) që ka ndikim kombëtar, rajonal por dhe lokal. Gjithashtu, ka strategji dhe dokumente të hartuara nga kompanitë rajonale që ofrojnë shërbime nga Obiliqi për komunat fqinje.

Mbrojtja e Mjedisit- Sipas Raportit për Mbeturinat e rrezikshme industriale në Kosovë, ku trajtohen deponitë të mbetjeve industriale që kanë ndikim rajonal e sidomos lokal, si dhe deponia e Mirashit që i shërben rajonit. Trajtim i veçantë duhet t'i jepet edhe lumit Sitnica dhe ndotjes nga deponitë dhe termocentralet.


Nga fusha e Trashëgimisë - kemi Planin Rajonal të Trashëgimisë Qendër 2015 – 2018, dhe në territor të komunës së Obiliqit shtrihen dy asete kombëtare të trashëgimisë kulturore (Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve).

Fusha e Sigurisë- Po ashtu trajtohet në strategjitë e ndryshme dhe kemi ndarje rajonale ose strategjitë e komunave fqinje, reagimet ndaj skenarit: reagimet ndaj tërmeteve që mund të kenë ndikim fatal në termocentralet dhe më gjerë, zjarret, vërshimet, pandemitë, siguria nga kërcënimet njerëzorë (të gjitha këto strategji: Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave Maj 2010, Prishtinë, Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë, Dhjetor 2010; Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Prishtinë, Korrik, 2016; Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020) synojnë struktura dhe organizime rajonale.

1.3.2. Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale

1.3.2.1. Strategjitë prej PZHKU 2010- 2020+


Duke e marrë për bazë rëndësinë e Planit Zhvillimor Komunal, është meritore të konstatohet se ky plan nuk fillon nga zero, por do të bazohet në një masë të konsiderueshme në Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban të mëparshëm të nivelit të njëjtë (PZHK), e miratuar në vitin 2010 me periudhë kohore 2010- 2020+ në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 2003/ 14 për Planifikimin Hapësinor. Duhet marrë për bazë se PZHK e mëparshme është ende në fuqi dhe ka prodhuar efekte në hapësirë, andaj është kryer edhe analiza e zbatimit të këtij Plani, dhe në përgjithësi janë marrë në konsideratë zhvillimet dhe përmbajtjet që duhet vazhduar edhe në këtë PZHK, ku ekipi e ka marrë në konsideratë se kërkesat e ligjit të ri janë më të gjëra dhe më të veçanta.



Harta 5. Modeli i zhvillimit hapësinor PZHK 2010- 2020+

Qëllimet, objektivat, strategjitë dhe projektet e trajtuara në PZHKU 2010- 2020+ janë bazë edhe për këtë PZHK. Edhe modelet e zhvillimit të ardhshëm hapësinor janë trajtuar në baza të zhvillimit të ardhshëm hapësinor. Strategjitë dhe veprimet për zbatim janë marrë për bazë edhe për të vlerësuar disa nga arsyet pse zhvillimet e caktuara nuk kanë arritur të zbatohen.

Duke i konsideruar të rëndësishme edhe ndryshimet ligjore të cilat vendosin theksin e trajtimit të zonës urbane dhe zonave rurale brenda PZHK-së, është meritore të konstatohet se ky plan në të ardhmen zëvendëson Planin Zhvillimor Urban për sa i përket disa përmbajtjeve të zonës urbane, andaj, në një masë të konsiderueshme ajo që është trajtuar në Planin Zhvillimor Urban me periudhë kohore 2010- 2020 në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 2003/ 14 për Planifikimin Hapësinor, do jetë baza kryesore e trajtimit të zonës urbane.



Harta 6. Modeli i zhvillimit hapësinor qyteti PZHU 2010- 2020+

Nga aspekti i pozicionimit hapësinor, PZHK 2010- 2020 përcakton Obiliqin- qytet dhe tri zona zhvillimore, gjegjësisht zhvillim policentrik me një qendër kryesore- Obiliqin dhe tri nën- qendra: Breznica, Millosheva, dhe Grabofc i Epërm. Shërbimet kryesore janë propozuar të ofrohen në qendrën urbane dhe shërbime dytësore në nën-qendrat. Mirëpo, ky zhvillim i komunës është i pa definuar, nuk është i elaboruar qartë në aspektin e realizimit. Qëllimet, objektivat, janë të përgjithshme dhe janë të shkëputura nga sfidat zhvillimore të identifikuara. Prioriteteve strategjike u mungon ndërlidhja direkte me koncepte të propozuara zhvillimore, kurse afatet kohore dhe implikimet financiare të përcaktuara janë formale, joreale çka e dëshmojnë edhe projektet e realizuara, që i bën jo të matshme. Sidoqoftë, prioritetet strategjike të përcaktuara në PZHK 2010- 2020 janë marrë për bazë në të gjitha fazat e hartimit të kësaj PZHK-je.

Nga PZHK e mëparshme, harta e konceptit zhvillimor edhe nga PZHU e mëparshme, strukturat urbane/destinimi i sipërfaqeve janë marrë si baza kryesore, por edhe hartat tjera. Koncepti hapësinor i PZHU-së 2010- 2020 është përforcimi i qendrës së qytetit duke përqendruar funksionet e rëndësishme dhe duke e densifikuar me intensitet më të lartë se sipërfaqet përreth. PZHU 2010- 2020 që integron konceptin e gjerë zhvillimor dhe prioritetet strategjike të PZHK-së 2010- 2020.

Edhe **Planet Rregulluese** duke i marrë në konsideratë përmbajtjet që i trajtojnë dhe obligimet ligjore, janë marrë për bazë gjatë hartimit të këtij dokumenti: Plani Rregullues Urban Qendra dhe Plani Rregullues Urban Hade.

1.3.3. Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje

1.3.3.1. Strategjitë e PZHK-ës së Komunës së Gllogocit

Në vijim janë radhitur Prioritetet Strategjike të Komunës së Gllogocit të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit

2020-2028:

Vendbanimet - Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës

Zhvillimi ekonomik

Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)

Ujësjellësi, kanalizimi dhe ujitja

Qëllimi 2: Zhvillimi I infrastrukturës se ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)

Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë

Infrastruktura publike dhe sociale (Arsimi)

Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë

Zhvillimi ekonomik - Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit te bujqësisë

Mirëqenia sociale - Qëllimi 3: Përmirësimi i mirëqenies sociale

Mbeturinat - Qëllimi 3: Përmirësimi I sistemit te menaxhimit te mbeturinave te tere territorin e komunës

Infrastruktura teknike (Energjetika)

Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim te qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore - Qëllimi 4: Krijimi i qasjes se integruar në mbrojtje te trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Infrastruktura publike dhe sociale (Shëndetësia) - Qëllimi 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore te shëndetësisë me zhvillim te vazhdueshëm profesional

Infrastruktura sociale – Kultura, sporti, hapësirat publike dhe hapësirat e gjelbra

Qëllimi 4: Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit dhe rritja e hapësirave publike dhe te gjelbra

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) - Qëllimi 3: Sigurimi i një mjedisi me te sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera

Transporti - Qëllimi 4: Sigurimi I transportit të integruar për komunën e Gllogocit


Zhvillimi ekonomik - Qëllimi 3: Zhvillimi i resurseve njerëzore ne përputhje me kërkesat e tregut

Banimi - Qëllimi 2: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues te banimit

Banimi - Qëllimi 3: Plotësimi i nevojave për banim

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi) - Qëllimi 2: Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv

DRAFT



Harta 7. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Gllogocit

1.3.3.2. Strategjitë e PZHK-ës së Komunës së Podujevës

Në vijim janë radhitur Prioritetet Strategjike të Komunës së Podujevës të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal të Podujevës 2016 - 2025:

Qëllimi 1. Administratë funksionale dhe efikase

Synimi 1 (Q1S1): Kuadër profesional

Synimi 2 (Q1S2): Avancimi i sistemit elektronik

Synimi 3 (Q1S3): Digjitalizimi i administratës

Qëllimi 2. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi

Synimi 1 (Q2S1): Ndërtimi i objekteve shkollore në ato vendbanime ku janë identifikuar kërkesat

Synimi 2 (Q2S2): Zgjerimi i hapësirave dhe ngritja e cilësisë fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore

Synimi 3 (Q2S3): Rritja e numrit të kuadrit të kualifikuar profesional, në arsim dhe shëndetësi

Synimi 4 (Q2S4): Programe dhe trajnime të vazhdueshme profesionale në arsim dhe shëndetësi

Synimi 5 (Q2S5): Sigurimi i pajisjeve teknike për shërbime arsimore dhe shëndetësore

Synimi 6 (Q2S6): Shtrirja e arsimit para fillor edhe në vendbanimet tjera

Qëllimi 3. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë

Synimi 1 (Q3S1): Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut

Synimi 2 (Q3S2): Sigurimi i punës sezonale

Synimi 3 (Q3S3): Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme

Qëllimi 4. Krijimi i kushteve më të mira në viset rurale

Synimi 1 (Q4S1): Lidhje funksionale me qendrën urbane

Synimi 2 (Q4S2): Ofrim adekuat i shërbimeve publike

Qëllimi 5. Zhvillim kompakt dhe funksional i vendbanimeve

Synimi 1 (Q5S1): Formimi i qendrave sekondare

Synimi 2 (Q5S2): Përpilimi i Hartës Zonale të Komunës në përputhshmëri me Ligjin Nr. 04/L-174 e cila do të trajton sipërfaqen deri në nivel të Kushteve Ndërtimore (sipas nenit 16).

Synimi 3 (Q5S3): Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale

Qëllimi 6. Mjedis të pastër me shfrytëzim racional dhe mbrojtje efikase

Synimi 1 (Q6S1): Parandalimi dhe largimi i mbeturinave nga trupat ujor dhe mjedise tjera

Synimi 2 (Q6S2): Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale ne lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave të zeza

Synimi 3 (Q6S3): Ndërmarrja e masave anti-erozive

Synimi 4 (Q6S4): Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

Synimi 5 (Q6S5): Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore

Synimi 6 (Q6S6): Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve

Qëllimi 7. Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik

Synimi 1 (Q7S1): Zhvillim dhe rritje e prodhimtarisë në bujqësi (drithërave, pemëtarisë dhe perimtarisë)

Synimi 2 (Q7S2): Përkrahja e zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë

Synimi 3 (Q7S3): Funksionalizimi i zonave industriale

Synimi 4 (Q7S4): Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore (drurit, inerteve, etj.)

Synimi 5 (Q7S5): Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit

Synimi 6 (Q7S6). Krijimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme

Qëllimi 8. Infrastrukturë e planifikuar

Synimi 1 (Q8S1): Asfaltimi i rrugëve për zonat me prioritet.

Synimi 2 (Q8S2): Përmirësim i rrjetit energjetik


Synimi 3 (Q8S3): Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara,

Synimi 4 (Q8S4): Shtrirja e telefonisë fikse dhe internetit në zonat me prioritet.

DRAFT

Synimi 5 (Q8S5): Zgjerim dhe kontroll i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Synimi 6 (Q8S6): Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre.



Harta 8. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Podujevës

1.3.3.3. Strategjitë e PZHK-ës së Komunës së Prishtinës

Në vijim janë radhitur Prioritetet Strategjike të Komunës së Prishtinës të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës 2012 - 2022:

1. Arritja e një sistemi të transportit publik, duke rritur edhe dendësinë urbane

2. Përmirësimi i qasjes së territorit dhe qytetit nëpërmjet riorganizimit të sistemit të rrugëve

3. Ruajtja dhe vlerësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

4. Krijimi i një mjedisi më përfshirës, duke përmirësuar vendbanimet ekzistuese dhe duke iu ofruar shërbime, zona të gjelbëruara dhe vende të ndërveprimit social si dhe krijimi i shtigjeve për të ecur në këmbë dhe biçikletë në mënyrë të sigurt

5. Identifikimi i strategjive zhvillimore për zonat rurale dhe ofrimi i shërbimeve pranë vendbanimeve.

6. Ofrimi i një sistemi të trajtimit të kanalizimeve për qytetin, një sistem për mbledhjen e mbeturinave, përmirësimi i ofrimit të energjisë elektrike, përmirësimi i ofrimit të ujit të pijshëm dhe zhvillimi i strategjive për rritjen e efikasitetit të energjisë.

7. Ndërtimi i deponisë për mbeturinat nga konstruksioni dhe demolimi, përkatësisht riciklimi i tyre.

Në vijim janë radhitur Prioritetet Strategjike të Komunës së Prishtinës të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës 2012 - 2022:

Objektivat për rritjen e qëndrueshme urbane

1. Përforcimi i boshtit kryesore urban për rolin e kryeqytetit
2. Një qytet i këndshëm për të gjithë qytetarët
3. Një zhvillim policentrik urban hapësinor


Politikat sektoriale për t'i mbështetur këto strategji janë:

a) Një lëvizshmëri të qëndrueshme për të mbështetur rritjen urbane

b) Madhësia dhe dendësia e popullsisë urbane

Objektivat për zhvillimin e zgjuar (rritjen e vlerave) janë:

1. Vlerat kulturore dhe natyrore: ruajtjen e identitetit, përmirësimin dhe vlerësimin
2. Rritja e vendbanimeve rurale, model për një zhvillim të ri bujqësor
3. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban
4. Përkrahja e 'Start Up' për ndërmarrjet e reja




Harta 9. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Prishtinës

1.3.3.4. Strategjitë e PZHK-ës së Komunës së Fushë Kosovës

Në vijim janë radhitur Prioritetet Strategjike të Komunës së Fushë Kosovës të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës 2013 - 2023:

- Mbrojtja e tokës bujqësore - kontrolli i zhvillimit dhe zgjerimit të vendbanimeve
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore si dhe promovimi i turizmit në këto dy fusha
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbimet tjera publike / komunale
- Ndërtimi i rrugëve të reja (11 – 22 - 33) në rrjetin komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor
- Lidhja Aeroport - Fushë Kosovë – Prishtinë
- Impianti për trajtimin e ujërave të zeza
- Parandalimi i ndotjes nga Ferronikeli dhe Termoelektranat në koordinim me komunat përkatëse si dhe MMPHI.



Harta 10. Modeli i zhvillimit hapësinor të Komunës së Fushë Kosovës

1.3.3.5. Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje

1.3.4. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit, siç janë planifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës.

Edhe se Plani Hapësinor i Kosovës (PHKos) 2010 – 2020+ është punuar viteve 2004-2008 dhe aprovuar në vitin 2010, ende paraqet një bazë ligjore për t'u bazuar gjatë hartimit të planeve, dhe në këtë rast Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit. Dokumenti me titull "Kosova Shtëpia jonë" i përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor në bashkëpunim me sektorët tjerë të Qeverisë së Kosovës, në përmbajtje të vetin ka udhëzimet dhe sfidat që duhet adresuar, është dokument qendror i planifikimit hapësinor, me qëllim të sigurimit të zhvillimit të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, të gjitha komunat duhet t'i përmbahen zhvillimeve të planifikuara në PHK, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, i cili mbështet vizionin vijues:

"Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinje, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të gjithëve".[1]

Komuna e Obiliqit brenda PHKos-it trajtohet si: **Porti i Kosovës (Hapësira e kaltër).**

Po ashtu që sipas PHKos (faqe 127) Obiliqi përfshihet në: ***3.2.1.2.2. Qendrat e vogla**, ku:*


"Obiliqi, Fushë Kosova, Drenasi, Lipjani, Podujeva dhe Novobërda (Zona e Kaltër); Skenderaj, Vushtrria, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi (Zona e Gjelbër); Istogu, Klina**,** Suhareka, dhe Dragashi (Zona e Portokalltë); Deçani, Rahoveci, Malisheva, Vitia, Kamenica, Shtimja, Kaçaniku dhe Shtërpce (Zona e Verdhë) **përfaqësojnë grupin e qendrave të cilat në zhvillimet e ardhshme hapësinore duhet të luajnë rol aktiv në:**

"Përmirësimin e ofertës së shërbimeve dhe ato të jenë më efikase, në forcimin e lidhjeve me fshatrat përreth dhe në përpjekjen që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të përcaktuara zhvillimore."

Strategjia Zhvillimore Hapësinore e PHK-së bazohet në strategjitë sektoriale. Në sfidat e zhvillimit hapësinor që trajtohen dhe janë relevante janë: Ekonomia dhe punësimi, Trashëgimia dhe zhvillimi i qëndrueshëm, Shfrytëzimi joracional i hapësirës, Mjedisi jo kualitativ jetësor, Niveli i ulët i shëndetësisë dhe arsimimit, Shkalla e lartë e varfërisë dhe sfidat tjera.

Ndër përgjegjësitë dhe kërkesat tjera që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit hapësinor është te Struktura Hapësinore e Zhvillimit dhe Organizimit të ardhshëm në Kosovë, brenda strukturës së trajtuar si: Porti i Kosovës – Zona e Kaltër: administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agroindustriale, turistike.

PHK përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë. Strategjia për zhvillim hapësinor i identifikon veçoritë karakteristike të qendrave kryesore urbane në Kosovë, së bashku me rrethinat më të afërta të tyre, dhe i përcakton katër grupe të ndryshme të zhvillimit.



Harta 11. Porti i Kosovës – Zona e Kaltër, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+

Dhe Vizioni i zonës është:

> ***Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrente me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Prishtina si kryeqytet, me seli të qeverisë dhe zyrave diplomatike, lidhje të mira me qytetet fqinje kosovare dhe ato jashtë kufijve, përmes rrjetit të infrastrukturës fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, energjetike) si dhe asaj administrative dhe institucionale.***

Me Qëllimet e përgjithshme si:

[1] MMPH, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, Prishtinë, 2010

- Zhvillimi i rrjetit atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazi sociale,
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda zonave urbane, ndër urbane me hapësirat tjera dhe më gjerë, lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së),
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktivitetesh në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinacionale,
- Mbështetje aktiviteteve H&ZH, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative,
- Zhvillim i aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agroindustriale e turistike.


Dhe në kuadër të sinergjive që duhet jenë si bazë, trajtohen si më poshtë:

- Zhvillimi i TZHEK-ut ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës, rritjen e atraktivitetit të qytetit të Prishtinës-investimet e huaja/joshjen e kompanive ndërkombëtare, zhvillimin dhe aplikimin direkt të hulumtimeve dhe zhvillimeve, orientimin investimeve kapitale për infrastrukturë fizike.
- Zhvillim potencial i TZHEK-ut -Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, do të ishte në konflikt me strategjitë për: tokën bujqësore, mjedisin dhe banimin.
- Spektri i veprimeve - i përmbledhur për nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes, janë të aspektit institucional e ligjor dhe financiar.

PHK-ja përcakton zonën e mihjes sipërfaqësore të linjitit dhe prodhimit të energjisë, zonë me interes të veçantë për Kosovën dhe zonën e rigjenerimit të mjedisit të degraduar që do të rishfrytëzohen për qëllime tjera si deponitë e mbetjeve industriale në Obiliq.

Instituti i Planifikimit Hapësinor ka hartuar Plan Hapësinor 2010- 2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”.

Plani Hapësinor 2010- 2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”.



Harta 12. Kufiri i zonës së FMR-së me sipërfaqe prej 150km2. - Burimi: IPH / MMPHI

Deklarata e Vizionit ka këtë përmbajtje:

“Zona e Interesit të Veçantë Ekonomik – Fusha e Mihjes së Re, zonë e menaxhuar me kujdes, në përputhje me standardet e BE-së në dobi të rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe gjendjes së kënaqshme mjedisore.”

Plani Hapësinor 2010- 2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” ka përcaktuar këto qëllime:

Q.1.: Prodhimi dhe Furnizimi i Sigurt me Energji Elektrike;

Q.2.: Planifikim dhe Kontrolli i Procesit të Zhvendosjes dhe Zhvillimit të Vendbanimeve, brenda dhe përreth Zonës Së FMR-së;

Q.3. Menaxhim i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore;

Q.4. Përmirësimi i Gjendjes Mjedisore dhe Përkujdesja ndaj Trashëgimisë.

Me shumë rëndësi për PZHK-në e komunës së Obiliqit janë **Zonat Industriale –** Gjenerimi i energjisë elektrike - Lokacionet e TC-ve „Kosova A" dhe „Kosova B" janë zonat e vetme me rëndësi industriale në këtë hapësirë. Po ashtu në kundër të këtyre zonave në afërsi të TC Kosova A gjenden edhe Repartet e Gazifikimit, Ngrohjes Industriale, Tertoret, Separacionet dhe ato për prodhimin e Plehrave Artificiale, të cilat janë lënë jashtë përdorimit më se dy dekada më parë. Sot ato paraqesin një problem të madh mjedisor për shkak të kontaminimit kryesisht me fenolë dhe substanca tjera.

1.4. INFORMATA PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT

1.4.1. Listimi i prezantimeve publike, konsultimeve, takimeve rishikuese dhe mekanizmave të përdorur për të angazhuar publikun në procesin e planifikimit

Mund të konstatohet se, kërkesat minimale për pjesëmarrje publike gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të cilat ishin që: Të sigurohet të paktën një diskutim publik në secilën fazë të procesit të planifikimit hapësinor, janë plotësuar dhe të njëjtat janë listuar më poshtë. Ka pasur përpjekje serioze të komunës dhe INSI-të që të sigurohet diskutimi publik i cili sjell së bashku të gjitha palët e interesuara dhe relevante (qytetarët, sektorin publik dhe privat, OJQ-të, ekspertët etj.) dhe se në këtë fushë kemi pasur pak ngecje, për kundër faktit që janë bërë njoftime publike për diskutimet publike para mbajtjes se diskutimit, janë shfrytëzuar edhe platforma elektronike, dhe materialet janë vënë në dispozicion të publikut.

Mund të konstatojmë se janë shqyrtuar të gjitha propozimet dhe vërejtjet që janë adresuar në proces nga akterë të ndryshëm dhe janë përfshirë në projekt dokument. Është organizuar edhe Punëtoria e Vizionimit, nga datat 11-12 Qershor në Obiliq, me pjesëmarrje të akterëve të ndryshëm.

Ndër mekanizmat e përdorur për të angazhuar publikun në procesin e planifikimit kanë qenë strukturat institucionale nëpër lagje dhe vendbanime, takimet publike nëpër lagje dhe vendbanime, platformat elektronike, ftesa, publikime, etj.

Në procesin e hartimit të dokumentit ka pas me dhjetëra takime me Ekipin Komunal të Planifikimit ,por edhe me Grupet Punuese në të gjitha fushat tematike dhe grupet konsultative.

Vendi i Takimit	Data	Nr. i Pjesëmarrësve	Qëllimi i Takimeve
Zyra e kryetarit	23.05.2019	15	Kryetari dhe ekzekutivi
Kuvendi Komunal	28.05.2019	18	Njoftimi me procedurat për hartimin e PZHK-së
Kuvendi Komunal	12.06.2019	16	Njoftimi edhe i akterëve tjerë kyç në hartimin e PZHK-së
Kuvendi Komunal	05.10.2019	20	Njoftimi i komisionit me detyrat e punës
Kuvendi Komunal i Obiliqit	23.12.2019	26	Prezantimi i profilit të komunës
Zyra e kryetarit	22.01.2020		Kryetari dhe ekzekutivi
Kuvendi Komunal i Obiliqit	28.01.2020	26	Prezantimi i skenarëve të zhvillimit
Zyrat e KOSTT	05.02.2020	8	Harmonizimi i interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
INFRAKOS	05.02.2020	10	Harmonizimi i interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
KEK	06.02.2020	8	Harmonizimi i interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
KEDS	10.02.2020	8	Harmonizimi i interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
Breznicë	18.02.2020	8	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Baimofcë	18.02.2020	8	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Milloshevë	18.02.2020	12	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Raskovë, Bakshi	18.02.2020	6	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Mazgiti ulët, Mazgit i Lartë, Llazarevë, Dardhishtë	19.02.2020	9	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Kuvendi komunal i Obiliqit	21.02.2020	18	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së, qytetarët e Obiliqit të Ri, Obiliqi i Vjetër dhe Plemetin
Hade, Palaj, Lajthishtë, Sibovc,	25.02.2020	12	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së

Hamidi, Shipitullë, Grabofc			
Kuvendi Komunal i Obiliqit	19.05.2020	14	Takim me kryetarin dhe drejtorët lidhur me njoftimin e punës rreth PZHK dhe prezantimi i Vizionimit
Hotel "Amazona" Baimofc	12.06.2020	31	WSH i Vizionimit
Hotel "Amazona" Baimofc	13.06.2020	28	WSH i Vizionimit
Halla sportive "Adem Jashari", Obiliq	15.07.2020	25	VSM

Tabela 1. Lista e takimeve dhe diskutimeve publike

1.4.2. Të dhënat e marra nga qytetarët dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë procesit të planifikimit.

Duhet theksuar se, duke e marrë parasysh kornizën e re ligjore dhe formatin e të dhënave të kërkuara, ishte më e komplikuar marrja e të dhënave drejt për së drejti nga qytetarët, përpos kur ata ishin të organizuar nëpërmes OJQ-ve dhe përfaqësuesve të vendbanimeve të lagjeve, apo komuniteteve fetare, etj. Duhet përmendur përpjekjet për të marrë të dhëna nga qytetarët në takimet nëpër vendbanime dhe diskutime publike dhe takime tjera të veçanta, dhe mund të thuhet se nëpërmes ekipeve janë evidentuar, janë digjitalizuar dhe janë trajtuar gjatë procesit të planifikimit.

I tërë procesi dhe kërkesat e qytetarëve në hollësi janë detajuar në **Raportin mbi ecurinë e punës së hartimit të PZHK 2022- 2030, Obiliq**, i cili është i bashkangjitur këtij dokumenti. Vlen të veçohen kërkesat nga qytetarët e zonës nën mihje për çështjen e banimit, ku që nga ajo kohë, banorëve nuk i është lejuar ndërtimi e as nuk është bërë zhvendosja e popullatës, ku ata kanë mbetur në gjendje të mjerueshme, pastaj kanë problem me infrastrukturë teknike, sociale, publike.

Problem tjetër nga qytetarët u paraqit sistemi i ujitjes si dhe komasacioni, ku qytetarët nuk kanë mundësi ndërtimi. Edhe pse objektet ekzistojnë në parcelat që janë nën masën e komasacionit, kërkuan që atyre t'iu mundësohet ndonjë zgjidhje në këtë aspekt.

1.5. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E SHKURTËR E PZHK-SË

Në këtë pjesë të hyrjes, si një përmbledhje jo-teknike e PZHK-së, fillimisht duhet t'i përshkruajmë temat dhe përmbajtjet kryesore, që janë të ndryshme nga PZHK-të e mëparshme, Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit si dokument i planifikimit hapësinor përmban **dhjetë fusha tematike** në krahasim me PZHK-në e më hershme e cila është hartuar duke përmbledhur katër fusha tematike, **hartohet për tërë territorin e komunës**, për pjesën Urbane dhe Rurale, duke i trajtuar në mënyrë përmbajtjesore; **Pjesëmarrje publike** gjate hartimit të këtij dokumenti bëhet bazuar në udhëzimin administrativ; sigurimin e të dhënave narrative dhe **digjitalizimin e të dhënave** të Planifikimit Hapësinor, si bazë për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumentit të planifikimit hapësinorë (bazuar në aneksin e udhëzimit administrativ); **Normat teknike të planifikimit hapësinor** si bazë unifikuese e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në tërë territorin e vendit, janë të detyrueshme të përcaktuara me Ligjin për Planifikimin Hapësinor, të cilat sigurojnë planifikim hapësinor, menaxhim të shfrytëzimit të tokës dhe të sistemit të zhvillimit të tokës kodifikues dhe normativ; dhe direktivat Evropiane: **INSPIRE**, Përdorimi i Tokës **HILUCS** (Hierarchical Land Use Classification) SHKShT (Sistemit Hierarkik i Klasifikimit të Shfrytëzimit të Tokës) si dhe Rregullat Mbështetëse **HSRLC** "Hierarchy of Supplementary Regulation Code List" KHRrP (Kodi Hierarkik i Rregullimit Plotësues), të cilat duhet përdoren gjatë hartimit të dokumentit. Në vazhdimësi jemi fokusuar në temat thelbësore komunale, sfidat përkatëse dhe mundësitë për zhvillim, si dhe qëllimet dhe objektivat e planifikimit të zhvillimit.

1.5.1. Sfidat kryesore

Sfidat në procesin e hartimit të PZHK-së ishin kryesisht në: krijimin e kuptimit të njëjtë për procesin dhe dokumentin; grumbullimin e numrit të madh të dhënave për profilin e PZHK-së, sidomos gjenerimi i të dhënave në fushat ku kishte mungesë e të dhënave ose cilësi të kufizuar, edhe digjitalizimi i të dhënave dhe kodifikimi ishin mjaft sfiduese; sigurimi i pjesëmarrjes publike; aplikimi i normave teknike të planifikimit; zbatimi i direktivave Evropiane: INSPIRE, HILUCS dhe HSRLC dhe sfidë tjetër në procesin e hartimit të dokumentit ishte edhe roli dhe përvoja e ekipit punues si bartës kryesor në hartimin e dokumentit.

Ndërsa sa i përket sfidave zhvillimore që duhet trajtuar në PZHK, janë identifikuar sfidat nga dokumentet e nivelit lokal dhe qendror që do të trajtohen dhe krijojnë një materie e cila do të pasurohet në proces. Në vijim janë radhitur sfidat kryesore të cilat cenojnë zhvillimin e qëndrueshëm të komunës:

- Sigurimi i gjenerimit të energjisë elektrike duke marr parasysh teknologjitë e vjetruara dhe nevoja për investim të lartë të nevojshëm për teknologji moderne të gjeneruese.
- Furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike dhe sigurimi i furnizimit afatgjatë me energji elektrike duke marr parasysh rritje të vazhdueshme për energji elektrike.

DRAFT

- Rritja e kostos së prodhimit duke marr parasysh nevojën për shpronësime të kushtueshme.
- Nevoja për zhvendosje të disa vendbanimeve për të liruar hapësirë për mihje sipërfaqësore të reja.
- Reduktimi deri te eliminimi i tërësishëm i ndotjes së: ajrit nga termocentralet; mjedisit nga mbetjet industriale të deponive të mihjeve; ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat industriale dhe ato të zeza.
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe sipas standardeve evropiane të resurseve natyrore në Obiliq.
- Shfrytëzimi racional i hapësirës dhe krijimi i mjedisit kualitativ jetësor duke pasur dy termocentrale në zonën urbane.
- Sigurimi i infrastrukturës për të gjithë, veçanërisht për fshatrat që do të zhvendosen.
- Sigurimi i hapësirave të reja banuese për fshatrat që do të zhvendosen.
- Ndalja e imigrimit të hovshëm të popullatës nga fshatrat kodrinore në ato të rrafshit dhe në qytet.
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe punësimi, ulja e shkallës së lartë e papunësisë, ndërtimi i infrastrukturës funksionale për zhvillim në të gjitha sektorët dhe shfrytëzimi i resurseve lokale për zhvillim industrial, turistik dhe bujqësor.
- Zhvillimi i një ekonomie të pavarur nga prodhimi i energjisë elektrike dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare.
- Mbrojtja e tokës bujqësore kualitative nga zhvillimet degraduese të përhershme.
- Mbrojtje e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

1.5.2. Mundësitë për Zhvillim

Në vijim janë radhitur mundësitë madhore për zhvillimin qëndrueshëm të Komunës:

- Ndërtimi i njësive të reja gjeneruese/Termocentralin Kosova e Re, me teknologji më të avancuar në përputhje me standarde të BE-së, gjegjësisht bazuar në direktivën për impiante të mëdha me djegie[2].
- Integrimi i teknologjive djegëse gjeneruese me parametra sub ose super kritike me efikasitet të lartë, siç janë CFB (djegia në shtresën e fluidizuar) ose PF (djegia me imtësim në formë të pluhurit).[3]
- Ndërtimi i mihjes së re të linjitit për furnizim të kapaciteteve ekzistuese dhe të reja
- Eksploatimi i burimeve të energjisë me linjit dhe burimeve tjera të rinovueshme të energjisë (si burimet e ujit, erës, biomasës, solare, etj.) për të plotësuar kërkesat e Kosovës për energji elektrike në periudhën afatgjatë.
- Rehabilitimi teknik dhe mjedisor të blloqeve në TC Kosova B.
- Optimizimi dhe komplementimi i dy sistemeve energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë me aprovimin e linjës 400 kV Shqipëri-Kosovë.
- Shfrytëzimi i ujit procesor për ngrohje qendrore për Obiliq dhe komunat fqinje.
- Rehabilitimi i deponimeve të hirit dhe rikultivimi i tyre.
- Shfrytëzimi i potencialeve ekonomike të magjistraleve M2 dhe M9.
- Shfrytëzimi i hirit dhe gjipsit për prodhimtari ndërtimore.
- Zhvillimi i bujqësisë dhe pylltarisë.
- Zhvillimi i turizmit malor dhe rekreativ.

Të gjithë këto mundësi zhvillimore, Komuna e Obiliqit në bashkëpunim me nivelin qendror, mund t'i zbatojë duke eksploatuar dhe shqyrtuar mundësitë ligjore, ekonomike dhe financiare, si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit.
- Grandit financiar shtesë për Obiliqin, sipas Ligjit nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit.
- Mundësitë që janë krijuar me anëtarësimin e Kosovës në FMN (Banka Botërorë) dhe BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim).
- Mundësitë nga procesi i Asociim Stabilizimit të Kosovës në Evropë
- Mundësia e huamarrjes dhe marrjes së kredive nga komunat
- PPP (Partneritetet Publiko Private)
- Grandet qeveritare dhe donacionet tjera ndërkombëtare.

1.5.3. Qëllimet dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Obiliqit, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

[2] Large Combustion Plant Directive

[3] Instituti për Planifikim Hapësinor, Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë: Fusha e Mihjes së Re 2010- 2020+, Prishtinë 2011.

Po ashtu, ky dokument ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.

Ky dokument gjithashtu synon **Zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm** gjatë hartimit dhe zbatimit të PZHK-së.

Është mjaft e rëndësishme të thuhet se dokumenti do zhvillojë te korniza e Zhvillimit Hapësinorë **Qëllimet dhe objektivat** specifike, gjithnjë bazuar në qëllimet dhe objektivat e planeve dhe strategjive të nivelit lokal dhe qendror, duke i analizuar në një proces cilësor dhe që do jetësojnë atë që u shkrua më lartë.

DRAFT

2. PROFILI KOMUNAL

Profili i gjendjes në komunë, është ndër pjesët më të rëndësishme të PZHK-së së Obiliqit, ku identifikohen, mblidhen dhe strukturoren informatat bazë mbi fushat tematike.

"Profili Komunal", ka përmbledhur dhe shqyrtuar të dhënat lidhur me: historinë e zhvillimit të komunës së Obiliqit, gjendjen ekzistuese të komunës si dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës.

Mbledhja e të dhënave për Profilin Komunal është bërë në pajtueshmëri me Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Gjatë përgatitjes së profilit, është hasur në vështirësi për shkak të mungesës, mos koordinimit dhe burimeve të të dhënave, por pas një angazhimi shtesë, janë siguruar shumica e të dhënave.

2.1. Karakteristikat e përgjithshme të komunës

2.1.1. Historia e zhvillimit

Obiliqi ka funksionuar si Komunë (nahi) qysh gjatë kohës së sundimit turk. Në vitin 1873, është ndërtuar hekurudha Shkup-Mitrovicë, ndërsa në Obiliq si qendër gjeostrategjike e rrafshnaltës së Kosovës është ndërtuar stacioni hekurudhor grumbullues. Kështu vendbanimi i atëhershëm i quajtur Gllobodër u ngrit në një qendër rajonale – Komunë. Në vitin 1912 merr emërtimin e ri Obiliq. Statusin e Komunës e kishte gjithashtu pas luftës së parë dhe të dytë botërore gjithnjë deri në vitin 1962, kur është përfshirë në kuadër të komunës së Prishtinës. Më 27 nëntor 1989 prapë konstituohet si Komunë.

Më 20.12.1999 me vendimin e Këshillit Komunal është formuar komisioni për emërtimin e vendbanimeve me të cilin vendim edhe qyteti i Obiliqit emërtohet Kastriot.

2.1.2. Pozita gjeografike karakteristikat natyrore

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10km në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Magjistralja Prishtinë-Mitrovicë (M2), autoudha „Ibrahim Rugova“, e cila ka hyrje dhe dalje në fshatin Mazgit, (Aeroportin ndërkombëtar „Adem Jashari“ 23km, Porti i Durrësit 264km, Porti i Shëngjinit 233km. Dy linja hekurudhore (Fushë Kosovë-Shkupë, Fushë Kosovë-Pejë, Fushë Kosovë-Mitrovicë).

Territori i komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 104.84 km² dhe zënë një hapësirë rreth 1% të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica dhe lumit Llap, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).


Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 105 km² dhe zë një hapësirë rreth 1 % të territorit të Kosovës dhe pozitë qendrore të Rrafshit të Kosovës, përkatësisht në pjesën veriore të saj. Obiliqin e definojnë koordinatat 42° 41’ të gjerësisë veriore gjeografike dhe 21° 5’ të gjatësisë lindore gjeografike.

Nga tërë territori i Komunës, afro 75 % është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku 25 % janë teren malor dhe atë kryesisht pjesët periferike të territorit të cilat edhe kufizojnë komunën e Obiliqit me Komunën e Gllogocit dhe të Podujevës.

Në Komunë të Obiliqit shtrihen 18 zona kadastrale dhe 20 vendbanime si Obiliqi (i ri dhe i vjetër), Mazgiti i Ulët, Mazgiti i Lartë, Llazareva, Millosheva, Bakshia, Raskova, Baimofci, Breznica, Kozarica, Plemetini, Hamidia, Sibovci, Grabofci i Epërm, Shipitulla, Hadja, Dobrosellë, Leshkoshiq, Cërkvena Vodicë dhe Kryshefc, që janë të banuara me komunitete të përkatësive etnike si: shqiptar, serb, rom, ashkali, egjiptas, boshnjak, turk, goran.

Komuna e Obiliqit shtrihet në afërsi të gjigantit të KEK-ut dhe si e tillë është një qendër ekskluzivisht industriale me rezerva të mëdha të linjitit. Deri më tani janë konstatuar rezerva rreth 13 miliardë tonelata. Kjo bën që Obiliqi të jetë një ndër komunat më të ndotura në Kosovë.

DRAFT



Harta 13 Pozita gjeografike

2.1.3. Veçoritë mjedisore

Komuna e Obiliqit duke qenë e vendosur në fushëgropën e Kosovës, sikur mbahet mbi supet e maleve të Qyqavicës dhe Shalës së Bajgores. Kjo komunë përshkon tërthorazi këtë fushëgropë prandaj edhe ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore prej 1,0531ha, që përbën 48% e territorit të komunës së Obiliqit, gjersa 37% është tokë pyjore.

Miniera e re e Sibovcit do marrë më së shumti tokën e bukës, diku rreth 13% e territorit te komunës së Obiliqit. Ne këtë fushë të paraparë për minierë sipërfaqësore, 86% e territorit është tokë e bukës ose ara kurse pjesa tjetër vendbanime, rrugë dhe pyje. Dukuria e ndërtimit përgjatë akseve rrugore është e theksuar edhe në komunën e Obiliqit, një sipërfaqe e konsiderueshme e kësaj pasurie është duke humbur nga ndërtimet e pakontrolluara kryesisht me përmbajtje biznesi. Sipas një analize të bërë në qendrat e mëdha urbane, për periudhën 1980 deri në vitin 2000 kur janë bërë fotografimet ajrore, është konstatuar se zonat urbane nëse një zonë urbane ka pasur sipërfaqe prej 1.000 ha, pas periudhës së përmendur zona në fjalë është rritur në 2.700 ha, që do të thotë janë humbur 1.700 ha.

2.1.3.1. Pedologjia


Paleozoiku (Pz) – është i përfaqësuar me Rreshpet kristalin (që janë të përfaqësuara me argjiloshiste, filite dhe rrallë herë me rreshpe amfibolike) dhe Gëlqerorët kristalin (që në shumicën e rasteve shtrihen mbi rreshpe, kurse pjesa më e vogël e tyre gjendet në mesin e serisë rreshpore). Gëlqerorët kristalin ndodhen në pjesën e skajshmen perëndimore të zonës, në anët lindore të Malit të Qyqavicës, dhe janë të shpërndarë në formë të thjerrëzave të shumta.

Në grupe të vogla gëlqerorët janë të silifikuar deri në atë masë sa me vështirësi dallohen nga filitet dhe kuarcitet. Në rreshpet kristalin dhe gëlqerorët kristalin deri më tani nuk është gjetur fauna, dhe nga kjo çështja e moshës së tyre është mbetur e hapur.

Mezozoiku (Mz) – është i përfaqësuar nga Serpentinitet, Flishi i Kretakut të Sipërm dhe Gëlqerorët. Serpentinitet dhe Peridotitet paraqiten në disa zona të radhitura në drejtimin V-VP –dhe J-JL. Masa të vogla paraqiten edhe në JP të fshatit Sibovc, përkatësisht në vijën kryesore shkarëse, përgjatë të cilës është formuar pellgu i Kosovës.

Kenozoiku (Kz) - është i përfaqësuar nga sedimentet e Terciarit dhe të Kuaternarit. Terciari (Tc), përfaqësohet nga shkëmbinjtë andezito – dacit dhe tufet, si dhe sedimentet e Neogjenit (Ng).

Kuaternari (Q), në pjesën më të madhe është i përfaqësuar me rëra aluviale dhe zhavorre.



Harta 14. Përbërja pedologjike


2.1.3.2. Gjeologjia dhe tokat

Sa përket përbërjes gjeologjike të tokës në territorin e Komunës, me 43.98% dominon përbërja balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht e linjitit, pastaj 21.79% është përbërje lymore dhe 12.04% është përbërje proluvium.


Kategoritë gjeologjike	Sipërfaqja (ha)	%
Albite diorite	4.57	**0.04%**
Alluvium	1098	**10.47%**
Balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht e linjitit	4611	**43.98%**
Diabase, spilite, bazalt	4.86	**0.05%**
Gabro	17.65	**0.17%**
Heterogeneousbreccia	31.74	**0.30%**
Sedimentet e liqenit dhe lumenjve	20.46	**0.20%**
Mermer	17.94	**0.17%**
Mermer, rreshpe gëlqerore	116.4	**1.11%**
Gur mermeri, gur ranor, gur gëlqeror, tuffite, pjesërisht linjit	65.15	**0.62%**
Mica quartzite, metasandstone, metamudstone	34.38	**0.33%**
Proluvium	1262	**12.04%**
Pyroclastite of the andesite group with tuff, lappilli, breccia	180.8	**1.72%**
Quartzite, metaquartzsandstone, conglomerate	17.09	**0.16%**
Reeflimestone, breccias, sandyflyschwitholistoliths	58.19	**0.56%**
Lymore	2285	**21.79%**

Sandstone, phyllite, marble, calcareousschist	49.57	**0.47%**
Sandstone, siltstone, marlstone, mudstonewitholistoliths (sandyflysch)	56.08	**0.53%**
Serpentinite	34.89	**0.33%**
Volcanic-sedimentaryseries	518.5	**4.95%**

Tabela 2. Veçoritë gjeologjike



Harta 15. Formacionet gjeologjike



Harta 16. Përshtatshmëria e Integruar e Tokës , (ILS)[4]


2.1.3.3. Karakteristikat hidrografike

Në territorin e komunës ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: "Sitnica", "Drenica" dhe "Llapi". Ka edhe një kanal artificial që është Kanali Ibër - Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit "Ibër". Lumi "Sitnica" përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80% të ujërave në drejtim të veriut. Lumi "Sitnica" derdhet në lumin "Ibër" në Mitrovicë. Lumi "Drenica" rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin "Sitnicë" para hyrjes në jug në territorin e komunës. Lumi "Llap" rrjedhë në lindje, i cili derdhet në lumin "Sitnicë" në veri të territorit të komunës. Lumi "Sitnicë" është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m3/s, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkrirja e borës, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m3/s. Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi "Sitnica" del jashtë shtratit dhe përmbytë sipërfaqe të tokave punuese përreth, duke i shkaktuar dëme të mëdha bujqësisë.


Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të lumit "Sitnicë" në lindje dhe dy në drejtim të lumit "Drenica" në perëndim. Përgjatë lumit "Sitnicë" shtrihet një fushë, që përmbytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy blloqet e TC "Kosova B". Lumi "Sitnicë" është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit.

Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i lumit "Sitnicë" duhet kategorizuar si Ujë i Klasës IV, sipas sistemit të klasifikimit (pra, "ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special") dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë.

[4] ILS nënkupton Integrated Land Suitability, *Përshtatshmëria e e integruar e tokës*



Harta 17. Rrjeti hidrogjeologjik



Harta 18. Njësitë hidrogjeologjike

Konstatimi i përgjithshëm i cili i takon problematikës së hidrogjeologjisë, brenda territorit të zonës me interes të veçantë ekonomik, konsiston kryesisht në mbulesën e dheut, mbi dhe në vet shtresën e thëngjillit. Nga hulumtimet e shumta hidrogjeologjike është konstatuar se ujërat nëntokësore takohen shumë afër sipërfaqes në thellësi nga 3 – 5m dhe janë ujëra me nivel të lirë (freatike). Është me rëndësi të theksojmë se gjatë punimeve për largimin e ujërave nga miniera e Mirashit dhe Bardhit, shpeshherë ka ardhur deri te shpërthimi i ujërave nëntokësore nga të çarat e shtresave të thëngjillit. Me shpime dhe punime minerare është konstatuar se ujëmbledhësi kryesor i ujërave nëntokësor janë aluvionet në të dy anët e lumit Sitnicë, si dhe aluvionet e lumit Drenicë.


2.1.3.4. Lartësia mbidetare

Komuna e Obiliqit ka kontraste relievore pasi që pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa pjesët tjera të reliefit në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra e lugina (male të degëve të maleve të Albanikut (Kopaonikut).

Rrjedhë se 75% e sipërfaqes së komunës është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku rreth 25% janë terrene malore. Pika më e lartë e territorit të komunës është në fshatin Kozaricë me 740 m lartësi mbidetare, kurse pika më e ulët është tek ura në mes të fshatit Cërkvena Vodicë dhe qytetit të Obiliqit me 530 m lartësi mbidetare. Në qoftë se marrin piken me të lartë dhe piken më të ulët të Komunës së Obiliqit atëherë lartësia mesatare e Komunës së Obiliqit është 635m .

Komuna e Obiliqit shtrihet rreth koordinatave gjeografike: 42° 41 24 V dhe 21° 04 40 L.

Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe 105m² dhe zë një hapësirë rreth 1% të Territorit të Kosovës. Kjo sipërfaqe përbën një relief të ndryshëm me terrene malore dhe sipërfaqe të rrafshëta dhe me tokë pjellore.



Harta 19. Hipsometria e terrenit

2.1.3.5. Pjerrtësia e shpatijeve

Reliefi është favorizues për rrëzime të masave shkëmbore, veprimtaria e ujërave dhe ndër më kryesoret është mbulesa vegjetative cila ndikon shumë në qëndrueshmërinë e shpatijeve. Shpyllëzimet e bëra pa kriter kohët e fundit kanë bërë që të

shkëputen masa shkëmbore. Vendosja poshtë e shkëmbinjve të dobët dhe sipër shkëmbinj të fortë, në këtë rast ndodh "lodhja" ose rrjedhja e shkëmbinjve, duke humbur aftësinë mbajtëse dhe duke u shpërbërë në copëra masive të tëra formacionesh.

Përcaktimi i pjerrtësisë së territorit e sidomos i pjerrtësisë së shpateve jo stabile ka rëndësi të madhe praktike. Nëpër sipërfaqet e shpateve të pjerrëta zhvillohen shumë veprimtari njerëzore dhe procese natyrore morfodinamike. Proceset si erozioni, rrëshqitjet, shembjet etj. mund të jenë jashtëzakonisht të dëmshme në ato hapësira në të cilat paraqiten. Kriteret për kategorizimin e sipërfaqeve sipas pjerrtësisë së terrenit ndryshojnë varësisht nga qëllimet e kërkimeve shkencore dhe kategorizimit sipas autorëve të ndryshëm.

Sipas A. Bognarit (1991)[6]ka bërë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë se pjerrësisë së terrenit për ndërtim,7 i cili kategorizim është pak i dallueshëm me kategorizimin e lartpërmendur. Sipas këtij kategorizimi terrene shumë të përshtatshme për ndërtim janë ato me pjerrtësi 0- 20,terrene të përshtatshme për ndërtim 2- 50, terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate 5-120, terrene të papërshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara 12- 320 dhe mbi 320 terrene të pa përshtatshme për ndërtim.

Këndi i rënies	Emërtimi
0 - 20	Terrene shumë të përshtatshme për ndërtim
2 - 50	Terrene të përshtatshme për ndërtim
5- 120	Terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate
12-320	Terrene të papërshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara
Mbi 320	Terrene të pa përshtatshme për ndërtim

Tabela 3 Llogaritjet e këndit të rrënjës së terrenit janë bërë duke u bazuar në modelin digjital relievor "EUDEM", i cili ka përmasat e rezolucionit hapësinor 25*25m.


2.1.3.6. Diellosja

Në Komunën e Obiliqit ka ekspozicion qendror si Komunë ku dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, perëndimin dhe pjesa qendrore e komunës është pjesë fushore që shtrihet rreth Lumit Sitnica . Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç në lindje dhe perëndim ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit Komunës së Obiliqit është i ndryshueshëm dhe i pa eksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dhe hedhja e mbeturinave rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore.

Diellosja (insolacioni) është e rëndësishme për botën e gjallë (bimët, kafshët, njerëzit), për bujqësi, turizëm, shëndetësi etj. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), relievi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat. Në gjerësitë tona gjeografike (42-43 shkallë) diellosje vjetore do të duhej të zgjaste 4450-4460 orë në vit ose 12,2 orë në ditë.

Në të vërtetë diellosja në Kosovë zgjatë 2079 orë ose 5,7 orë në ditë, që është 47% nga diellorja e mundshme. Diellosja më e vogël është në viset malore dhe afër tyre dhe gjatë muajve të dimrit. Diellosja në muajin dhjetor është mesatarisht 54 orë gjithsej ose 1,7 orë në ditë, kurse gjatë muajve të verës (mbi 250 orë në muaj ose 8,3 orë në ditë).

DRAFT



Harta 20. Pjerrtësisë së terrenit në komunën e Obiliqit

2.1.3.7. Kushtet klimatike

Zona e FMR-së ju nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko- teknologjike si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike. Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolët dhe elementet e tjera klimatologjike. Për shkak të proceseve kimiko-teknologjike, zona në të cilën planifikohet të ndërtohet TC Kosova e Re ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që varion nga 95% - 47%, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45%- 56%.


Temperatura e ajrit është e ndryshueshme ku vlera mesatare vjetore (shih fig. 4) është 10.2 °C (Celsius), ngaqë muaji më i ftohët është Janari me -1.5 °C, përderisa muaji më i nxehtë është Gushti, me temperaturë mesatare vjetore në 20.5 °C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9 °C, ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5 °C.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të kësaj zone dhe rrethinës, ndikim parësor kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme, të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga jugu, nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit, si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga veriu dhe verilindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810mm.

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre, mund të konstatohet se qetësit lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7%. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga:

- Veri-Verilindja me 20.3%;
- Veriu me 19.4% ;
- Perëndimi me 4 %; dhe
- Jugu me 5%.

Era nga drejtimi verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin gusht e më së paku në muajin prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit mars në shumë vite, dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin shtator 1.8 m/sekondë.



Harta 21. Ekspozicioni i terrenit në komunën e Obiliqit





Figura 1. Trëndafili i Erës

2.1.3.8. Biogjeografia dhe biodiversiteti

Peizazhi në territorin e Komunës, gjerë më tani, nuk ka ndonjë peizazh që është shpallur i mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi.

Peizazhi natyror në një pjesë të territorit të komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të "TC-A dhe TC-B", kështu që kemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët e tjera të territorit të Komunës kemi një pamje të mirë të peizazhit natyror.

Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen; rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale e peizazhit natyror.



Harta 22 Vlerat e llogaritura të biodiversitetit (EBV)[8]

Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore, siç janë:

- Burim i ujit mineral në Grabofc të Epërm;
- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Cërkvena Vodicë);
- Trung druri i vetëm bliri (Tilia spec.), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe;
- Grup trungjesh druri të bungut (3x Quercus spec., 1x Quercuscerris), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).
- Në afërsi të fshatrave mund të gjendet vegjetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit "Sitnica" dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjinden në perëndim.
- Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kulumbria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjendën veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj.
- Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit, etj.
- Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, thëllëza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.

2.2. DEMOGRAFIA

[8] EBV nënkupton Essential Biodiversity Variables, Variabilet Esenciale të Biodiversitetit

2.2.1. Zhvillimi Demografik

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)[9] të vitit 2011, Komuna e Obiliqit ka 20 vendbanime, ku jetojnë 21.549 banorë.

	0-4 vjeç	5-14 vjeç	15-19 vjeç	20-64 vjeç	≥ 65 vjeç
Nr. i banorëve	2088	4331	1998	11893	1239
% e banorëve	9.69%	20.10%	9.27%	55.19%	5.75%

Tabela 4 Numri i banorëve sipas grup-moshave, ASK 2011

Pjesa më e madhe e banorëve prej 92.13% i takon etnisë shqiptare, gjersa sa i përket përkatësive tjera, përqindja më e lartë është 3.07%, përkatësisë Rome.

	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë
Nr. i banorëve	19854	276	2	58	661	578	27	5	48
% e banorëve	92.13%	1.28%	0.01%	0.27%	3.07%	2.68%	0.13%	0.02%	0.22%

Tabela 5 Numri i banorëve sipas etnicitetit, ASK 2011

Me 97.68% pjesa dërmuese e banorëve i takon besimit islam, gjersa 1.25% i takojnë besimit ortodoks.

	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Pa religjion	Nuk janë në dispozicion
Nr. i banorëve	21050	269	4	11	1	214
% e banorëve	97.68%	1.25%	0.02%	0.05%	0.005%	0.99%

Tabela 6 Numri i banorëve sipas besimit fetar, ASK 2011

Sipas të dhënave të fundit numri i të lindurve dhe vdekurve në komunë është me një përqindje relativisht konstante ndër vite.

	2014		2015		2016		2017		2018	
	Lindje	Vdekje	Lindje	Vdekur	Lindje	Vdekur	Lindur	Vdekur	Lindur	Vdekur
Nr. i banorëve	398	104	333	139	377	131	355	121		
% e banorëve	1.85%	0.48%	1.55%	0.65%	1.75%	0.61%	1.65%	0.56%	%	%

Tabela 7 Numri i banorëve të lindur dhe vdekur sipas viteve, ASK 2011

Sipas regjistrimin të fundit zyrtar të vitit 2011, i cili rezulton se në Komunë jetojnë gjithsejtë ekonomi familjare 3,852 ku 1,272 në zonë urbane dhe 2,580 në zonë rurale.[10]

	Ekonomi familjare	% e ekonomive familjare	Anëtarë	% e anëtarëve
Zonë urbane	1272	33.02%	6864	31.85%
Zonë rurale	2580	66.98%	14685	68.15%

Tabela 8 Karakteristikat e ekonomive familjare, ASK 2011

Numri më i madh i ekonomive familjare sipas anëtarëve është familja 5 anëtarëshe që përbënë 19.94% dhe pastaj familjet 6 anëtarëshe 17.16%.

Numri I anëtarëve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10>
Nr. i ekonomive familjare	113	212	341	646	768	661	434	283	148	246
% e ekonomive familjare	2.9	5.5	8.8	16.8	19.9	17.2	11.3	7.3	3.8	6.4

Tabela 9 Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtareve, ASK 2011

2.2.2. Mosha dhe struktura gjinore e popullsisë

Sa i përket përbërjes së moshës, me 29.79% pjesa më e madhe e popullsisë i përket grup-moshave 0-14 vjeçare dhe me 9.27% i përket grup-moshës 15-24 vjeçare. Dallimi në mes strukturës gjinore është minimal, pasi që vetëm 2.03% ka më shumë banorë të gjinisë mashkullore se sa të gjinisë femërore.

Grup moshat	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+	Gjith.
Meshkuj	3,239	1,033	1,031	995	770	772	595	612	525	389	304	620	10,885

[9] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë, 2013

[10] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020, Prishtinë, 2020

Femra	3,180	965	968	860	847	754	641	601	467	402	360	619	10,664
Gjithsej	6,42	1,99	1,99	1,85	1,62	1,53	1,23	1,21	992	791	664	1,24	21,55
%	29.8	9.3	9.3	8.6	7.5	7.1	5.7	5.6	4.6	3.7	3.1	5.7	

Tabela 10 Banorët sipas moshës dhe strukturës gjinore e popullsisë, ASK 2011

2.2.3. Dendësia e popullsisë

Territori i Komunës shtiret në sipërfaqe prej 105km^2 me një dendësi prej 205.23km^2. Në Komunë shtrihen: 1 vendbanim me mbi 500 banorë për km^2, 3 vendbanime 450-500 banorë për km^2, 1 vendbanim 350-400 banorë për km^2, 1 vendbanim 250-300 banorë për km^2, 4 vendbanime 200-250 banorë për km^2, 1 vendbanim 150-200 banorë për km^2, 4 vendbanime 100-150 banorë për km^2 dhe 2 vendbanime nën 100 banorë për km^2.

Zonat kadastrale	Vendbanimet	Sipërfaqja km^2	Nr. i banorëve	Dendësia b/km^2
Raskovë	Raskovë	0.92	640	695
Obiliq	Obiliq	12.50	5648	487
	Obiliq i vjetër		1160	
Mazgit	Mazgiti i ultë	6.38	1441	452
	Mazgiti i lartë		1445	
Millosheve	Millosheva	7.35	2920	397
Llazareva	Llazareva	2.10	429	204
Bakshi	Bakshi	2.03	602	296
Baimofc	Baimofc	8.04	1680	209
Breznicë	Breznicë	14.32	1292	123
	Kozaricë		469	
Plemetin	Plemetin	5.73	2588	452
Hamidi	Hamidi	1.74	147	85
Sibovc	Sibovc	7.51	963	129
Grabofc i Epërm	Grabofc i Epërm	8.60	340	39
Shipitullë	Shipitullë	2.96	295	100
Hade	Hade	4.91	534	109
Dobrosellë	Mirash	2.32		
Leshkoshiq (Lajthishtë)	Leshkoshiq (Lajthishtë)	3.69	715	194
Cërkvena Vodicë (Palaj)	Cërkvena Vodicë (Palaj)	7.11	1463	206
Kryshefc	Dardhishtë	6.64	1580	238

Tabela 11. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

2.2.4. Niveli i arsimimit

Nga 17,317 banorë të cilët janë të moshës 10+ vjeçare, 38.74% kanë përfunduar arsimimin e mesëm të, gjersa 4.32% banorë nuk dinë shkrim dhe lexim.

	Nuk dinë shkrim dhe lexim	Nuk kanë përfunduar arsimin	Shkollë fillore	Mesëm të ulët	Të mesëm të lartë	Të diplomuar	Diplomë pasuniversitare (master, PHD)	Gjithsej
Meshkuj	163	635	1,006	2,047	4,482	550	34	8,917
Femra	585	1,159	1,675	3,143	2,226	351	9	9,148
	4.3%	10.3%	15.5%	29.9%	38.7%	5.2%	0.25%	

Tabela 12 Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit, njohjes së shkrim-leximit, gjinisë dhe komunës, ASK 2011

2.3. EKONOMIA

Bartësit kryesor të zhvillimit në komunën e Obiliqit sot janë termoelektranat, minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I – IV dhe veprimtaritë ekonomike përgjatë rrugës magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë.

Komuna e Obiliqit është e pasur me thëngjill dhe tokë kualitative bujqësore(kat. I– IV) më shumë se 60% të territorit të përgjithshëm. Komuna e Obiliqit ishte një ndër qendrat më të mëdha të gjenerimit të energjetikës në Kosovë. Tani kjo komunë

trashëgon të gjitha potencialet që ishin dikur, sigurisht jo në gjendjen funksionale të atëhershme. Kjo do të thotë që, përveç përparësisë që ofron kjo trashëgimi kryesisht industriale, ka edhe problemet e veta në lidhje me nevojat për investime të mëdha, për ndërrimin e teknologjisë, për specializimin e punëtorëve, për mbrojtjen e mjedisit dhe hapjen e mihjeve të reja me pasojë të zhvendosjes së fshatrave. Edhe sot, barrën e zhvillimit të energjetikës në Kosovë e mban komuna e Obiliqit.

Në Komunë të Obiliqit janë evidentuar rreth 521 subjekte afariste dhe gjithsejtë 6980 punëtorë[11]. Nga këto shifra, shihet se rreth 30% e popullsisë së përgjithshme është e punësuar. Numri i të papunëve në komunën e Obiliqit të regjistruar në zyrën e punësimit është 5082, një shifër jo reale. Po ashtu kur dihet se në mesin e të punësuarve ka edhe punëtorë nga komunat tjera, arrijmë tek përfundimi që papunësia është një problem këtu edhe përkundër faktit se dikasteri kryesor energjetik i vendit KEK, është i vendosur në territorin e kësaj komune. Siç kuptohet, shfrytëzimi i tokës për nevoja të ekonomisë është shumë i madh në komunën e Obiliqit. Për dallim prej komunave tjera të cilat ballafaqohen me dukurinë e zënies së tokës së bukës përgjatë rrugëve për nevoja të biznesit, komuna e Obiliqit, përveç kësaj dukurie, ka edhe problemin e "grabitjes" së tokës bujqësore nga mihjet sipërfaqësore, të cilat zgjerohen dhe shkaktojnë zhvendosjen e fshatrave të tëra. Kjo tokë ka një kosto, i takon dikujt, dikush jeton nga kjo tokë, andaj politikat nacionale që atakojnë këtë komunë duhet të jenë racionale dhe duhet ta mbrojnë interesin e qytetarëve.

2.3.1. Ekonomitë familjare

Në Komunë jetojnë 7.381 ekonomi familjare. Me 37.31% më shumti ekonomi familjare jetojnë në Obiliq, gjersa në Mazgit jetojnë 30.31% ekonomi familjare. Me 0.35% më së pakti ekonomi familjare ka në Hamidi. [12]

Baimofc	Bakshi	Breznicë	Cërkvena Vodicë	Dobrosellië	Grabofc i Epërm	Hade	Hamidi	Kozaricë	Kryshefc	Leshkoshiq	Llazarevë	Mazgit	Millosheve	Minierë e Kosovës	Obiliq	Plemetin	Raskovë	Sibovc	Shipitullë
442	144	391	234	0	107	200	26	0	339	154	110	761	580	0	2754	639	158	242	100
5.9%	1.9%	5.3%	3.2%	0%	1.4%	2.7%	0.3%	0 %	4.6%	2.1%	1.5%	10.3%	7.8%	0%	37.3%	8.6%	2.1%	3.2%	1.3%

Tabela 13. Ekonomitë familjare sipas vendbanimeve, 2019. Burimi: Zyra e tatimit në pronë, Komuna e Obiliqit

2.3.2. Tregu i punës

2.3.2.1. Punësimi dhe papunësia

Nga 6.976 të punësuar, 80.50% i takojnë gjinisë mashkullore gjersa 19.50% i takojnë gjinisë femërore.

Sa i përket veprimtarisë kryesore, me 65% më së shumti të punësuar ka sektorin e energjisë elektrike, gazit dhe ujit, kurse 0% të punësuar ka në sektorin e pasurisë së patundshme, dhënia me qira dhe shërbimet për ndërmarrjet.[13]

	2019	2020	2021	2022
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	147	162	185	199
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	78	92	102	112
C- Industria përpunuese	115	138	163	172
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	4520	4520	4520	4520
E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	36	46	52	65
F- Ndërtimtaria	65	72	76	82
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	136	155	172	187
H- Transporti dhe magazinimi	39	45	49	59
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	478	495	514	528
J- Informimi dhe komunikimi	14	15	16	18
K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	68	74	75	79
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	0	0	0	0
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	28	32	33	38

[11]Burimi: Statistikat sipas Qendrës Komunale për regjistrimin e Bizneseve, Komuna e Obiliqit.

[12]Zyra e Tatimit në Pronë, Komuna e Obiliqit.

[13]Burimi: QKRB, Zyra e personelit dhe zyra e administratës.

P- Arsimi	25	29	31	33
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	15	19	22	25
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	38	40	42	44
S- Aktivitetet tjera shërbyese	35	42	49	50
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	149	152	158	168
Gjithsej	426	461	492	523

Tabela 14. Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Komunën e Obiliqit, 2022

Sipas raportit të punësimit të MPMS të Republikës së Kosovës (2008-2018), në komunën e Obiliqit janë rreth 1,546 punë kërkues aktiv.

2.3.2.2. Shkalla e varfërisë

Komuna e Obiliqit edhe pse është komunë industriale, ka një numër mjaft të madh të familjeve me nevojë sociale. Sipas raportit të skemës sociale, për çdo muaj ka afro 800 familje që varen nga asistenca sociale duke përfshirë këtu: shqiptar, serb, rom, ashkali, egjiptian, prej tyre rreth 200 familje janë raste ekstrem të varfra dhe pa zgjidhje të banimit të përhershëm.

Rreth gjysma e popullsisë i shtojnë të ardhurat për 10% nga prodhimet bujqësore (shitja e qumështit dhe bylmetit), kurse 40% e popullsisë plotësojnë të hyrat buxhetore nga shitja e prodhimeve të tjera bujqësore duke ngritur të ardhurat e përgjithshme familjare për 20%. Ndërsa, 15% e popullsisë përmes prodhimeve të mishit ngritin të ardhurat e tyre për 40%. Prerja e drunjëve i shton të ardhurat për 10% të buxhetit familjar të 25% e popullsisë së anketuar.[14]

2.3.3. Bizneset, ndërmarrjet dhe ambienti i biznesit

Komuna e Obiliqit ishte një ndër qendrat më të mëdha të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Kjo komunë trashëgon të gjitha potencialet që ishin dikur, sigurisht jo në gjendjen funksionale të atëhershme. Edhe sot, barrën e zhvillimit të energjetikës në Kosovë e mban komuna e Obiliqit. Bartësit kryesor të zhvillimit të ekonomisë në Komunën e Obiliqit janë:

- Termocentralet;
- Minierat e thëngjillit;
- Toka bujqësore prej klasës së parë deri në të katërtën;
- Bizneset private.

Në komunën e Obiliqit shumica janë të punësuar ndërmarrjet publiko- shoqërore me 4520 të punësuar, ndërsa sektori privat 2456 persona.

	2019	2020	2021	2022
Private	1946	2126	2296	2456
Publike- Komunale				-
Publiko (Komunale)- Private				-
Publike- Shoqërore	4520	4520	4520	4520
Publiko (Shoqërore)- Private				-
Gjithsej	6466	6646	6816	6976

Tabela 15. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë

Bazuar në gjendjen aktuale, në Komunë aktualisht ka 512 ndërmarrje private aktive dhe 9 ndërmarrje publike- shoqërore.

	2019	2020	2021	2022
Private	269	352	432	512
Publike- Komunale				-
Publiko (Komunale)- Private				-
Publike- Shoqërore	9	9	9	9
Publiko (Shoqërore)- Private				
Gjithsej	278	361	441	521

Tabela 16. Numri i ndërmarrjeve ekonomike, sipas pronësisë

[14] Instituti për Planifikim Hapësinor, Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë: Fusha e Mihjes së Re 2010- 2020+, Prishtinë 2011.

DRAFT

Sa i përket ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik në komunë, me 166 më së shumti ka ndërmarrje që merren me aktivitetet tjera shërbyese, 86 ndërmarrje që merren me tregti me shumicë dhe pakicë, 69 që ofrojnë akomodim dhe shërbim të ushqimit, 39 ndërmarrje që merren me industri përpunuese dhe 38 ndërmarrje që merren me bujqësi, pylltari dhe peshkim.

	2019	2020	2021	2022
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	20	22	32	38
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	1	1	1	1
C- Industria përpunuese	25	28	32	39
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	9	9	9	19
E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	6	6	8	8
F- Ndërtimtaria	21	22	24	23
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	44	47	71	86
H- Transporti dhe magazinimi	6	7	7	7
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	42	43	53	69
J- Informimi dhe komunikimi	2	2	2	2
K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	12	12	12	14
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	2	2	2	2
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	8	8	8	8
P- Arsimi	2	3	3	4
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	6	8	9	9
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	10	22	25	32
S- Aktivitetet tjera shërbyese	58	115	139	166
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	4	4	4	4
Gjithsej	278	361	441	521

Tabela 17. Ndërmarrjet ekonomike, sipas sektorëve ekonomik

Bazuar në gjendjen aktuale, në Komunë aktualisht ka 4,520 të punësuar në ndërmarrje publike- shoqërore dhe 2,456 në ndërmarrje private.

	2019	2020	2021	2022
Private	1946	2126	2296	2456
Publike- Komunale				-
Publiko (Komunale)- Private				-
Publike- Shoqërore	4520	4520	4520	4520
Publiko (Shoqërore)- Private				-
Gjithsej	6466	6646	6816	6976

Tabela 18. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë

Sa i përket vendbanimeve, në Obiliq ka gjithsejtë 303 ndërmarrjeve ekonomike, pastaj Millosheva me 53 dhe Mazgiti me 45.

	Numri i ndërmarrjeve ekonomike në 2021	Numri i ndërmarrjeve ekonomike në 2020	Numri i ndërmarrjeve ekonomike në 2021	Numri i ndërmarrjeve ekonomike në 2022
Obiliq	118	189	245	303
Kryshefc	14	15	15	16
Orlloviq	7	9	15	15
Llazarevë	10	10	10	12
Mazgit	40	45	48	45
Bakshi	8	9	9	11
Raskovë	2	2	3	3
Milloshevë	31	32	44	53
Baimofc	13	15	16	20
Breznicë	9	11	11	12
Kozaricë	0	0	0	0
Cërkvena Vodicë	1	1	1	1

DRAFT

Plemetin	19	17	18	24
Lajthishtë	1	1	1	1
Shipitullë	1	1	1	1
Grabofc	2	2	2	2
Cërkvena Vodicë	2	2	2	2
Gjithsej	278	361	441	521

Tabela 19. Numri i ndërmarrjeve ekonomike, sipas vendbanimeve

Sa i përket vendbanimeve, në Obiliq punojnë gjithsejtë 3,590 të punësuar, pastaj Mazgiti me 596, Kryshefc me 595 të punësuar dhe Millosheva me 514 punonjës.

	Numri i të punësuarve në 2019	Numri i të punësuarve në 2020	Numri i të punësuarve në 2021	Numri i të punësuarve në 2022
Obiliq	3192	3281	3451	3590
Kryshefc	580	591	593	595
Orlloviq	138	145	146	148
Llazarevë	147	158	160	165
Mazgit	580	587	596	596
Bakshi	108	102	102	104
Raskovë	201	205	204	205
Milloshevë	498	513	514	514
Baimofc	115	125	126	126
Breznicë	130	138	140	140
Kozaricë	56	60	31	40
Cërkvena Vodicë	118	125	128	128
Plemetin	198	201	206	206
Lajthishtë	189	193	195	195
Shipitullë	70	74	75	75
Grabofc	90	92	93	93
Cërkvena Vodicë	56	52	56	56
Gjithsej	6466	6642	6816	6976

Tabela 20. Numri i të punësuarve, sipas vendbanimeve

2.3.4. Sektorët ekonomik

2.3.4.1. Tregtia

Tregtia në këtë zonë është bërë sektori më aktiv, sidomos në dekadën e fundit. Tregtia ka marrë hov në zhvillimin e saj në formë të bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa, shumica e ndërmarrjeve apo bizneseve të regjistruara në lokalitetet e fshatrave të kësaj komune janë biznese të vogla tregtare që kanë të punësuar 2-3 persona.

Autoritetet në Komunën e Obiliqit kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve, duke filluar nga: lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve mjedisore, lejet e punës dhe tarifat e kapshme për biznese. Nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve rezulton se sektori i tregtisë është dominues ndaj sektorëve të tjerë.

2.3.4.2. Ndërtimtaria


Për sa i përket strehimit të banorëve, gjendja e vështirë pas lufte, për shkak të shkatërrimeve shumë të mëdha të shtëpive të banimit dhe infrastrukturës, bëri të domosdoshme edhe nevojën për një zhvillim të hovshëm të ndërtimtarisë. Gjatë kësaj periudhe u formuan shumë ndërmarrje ndërtimore private, të cilat kryejnë punët ndërtimore dhe prodhojnë elementë betoni dhe materi- ale ndërtimore. Trendi i rritjes së numrit të ndërmarrjeve ndërtimore ka vazhduar viteve të fundit duke para kërkesat e larta për ndërtim. Në këto ndërmarrje punojnë një numër i madh punëtoresh. Ky numër konsiderohet të jetë më i lartë pasi që këtu nuk janë përfshirë punëtorët e paregjistruar dhe ata sezonal.

Në komunën e Obiliqit, ndërtimtaria është një nga veprimtaritë biznesore më të zhvilluara, më numër më të madh të punësuarve, prej 130 apo 3.4% të punësuarve në nivelin komunal. Në komunën e Obiliqit operojnë rreth 24 kompani që merren me ndërtim.

DRAFT

2.3.4.3. Industria

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Ndër bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik në komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit. Veprimtarinë ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energjetike e Kosovës - KEK SH.A. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive të cilat janë prona të KEK SH.A. Zona e KEK-ut, gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e Lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra. Të dyja minierat aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë duke avancuar në drejtime të kundërta. Ngjitur me TC A, gjendet një zonë e braktisur industriale ku kanë qenë në veprim impianti i gazifikimit të thëngjillit dhe azotikut deri para më shumë se 10 viteve.



Harta 23. Shtrirja hapësinore e zonave industriale dhe ekonomike


TC A ka 5 blloqe të cilat janë ndërtuar në dy faza (nga 1962 deri 1964 dhe nga 1970 deri 1975). TC B ka dy blloqe që janë ndërtuar nga 1983 deri 1984. Dy termocentralet janë të ndryshme në kuptim të ndikimeve mjedisore për shkak të dallimit në moshë dhe teknologjisë. Në vitin 2005 ishte e domosdoshme të ndërmerren masa ristrukturimi, ngase dy mihjet e hapura sipërfaqësore të Bardhit e Mirashit ndërthureshin në masë të shtuar. Që atëherë të dyja mihjet e hapura sipërfaqësore zhvillohen si një minierë e vetme. Sido që të jetë, minierat edhe më tej quhen sipas emrave të tyre origjinal. Kanë filluar aktivitet minerare në dy miniera të reja në Sibovcin JP (në veri të Bardhit) dhe në sektorin Sitnica, afër fshatit Kryshefc.

2.3.1. Zonat ekonomike

2.3.1.1. Zona industriale në Llazarevë

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës së Obiliqit për periudhën 2009- 2020+ të miratuar me vendimin e Kuvendit Komunal Nr.01-166/10 të datës 26.07.2010, Komuna e Obiliqit ka planifikuar zhvillimin e zonës industriale në Llazarevë. Në këtë zonë janë të vendosura një numër i konsiderueshëm i bizneseve të cilat paraprakisht janë paisur me leje ndërtimore duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal në fuqi dhe legjislacionin adekuat pozitiv, po ashtu vlen të ceket se janë edhe një numër i konsiderueshëm i bizneseve serioze në nivel vendi të cilat kanë shprehur interesim për të operuar në këtë zonë e të cilat

gradualisht janë të përfshira në procedurën e marrjes së tokave komunale në shfrytëzim e të cilat pas kësaj faze do të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm përkatësisht me leje ndërtimore e që përmes këtij procesi dhe kësaj zone Komuna synon që të gjeneroj vende të reja të punës për qytetarët tanë . Ndonëse Zona Industriale në Llazarevë ka kushte ideale për të krijuar ekonomi të qëndrueshme për zhvillim të bizneseve, po ashtu vlen të ceket se komuna ka planifikuar buxhetin për investim për rregullimin e infrastrukturës përcjellëse.



Harta 24. Shtrirja hapësinore e minierave sipërfaqësore

2.3.2. Bujqësia

Rreth 48% e territorit komunal është në shfrytëzim për nevoja të bujqësisë, që d.m.th. gati gjysma e territorit të komunës së Obiliqit. Prej tyre 6.677 ha janë pronë private dhe 3.854 ha janë pronë shoqërore.

2.3.2.1. Agrobiznesi

Klima mesdhetare krijon mundësi për rritjen dhe zhvillimin një bimësie të shumtë e të larmishme si ajo e arrave, perimeve, bimëve etero vajore, hardhia etj. Kulturat kryesore bujqësore janë: gruri, elbi, misri, tërshëra, bimët industriale, patatet, dhe perimet. Nga drithërat, me 1,200 ha në komunë më së shumti kultivohet gruri, nga pemët, me 150 ha më së shumti kultivohet patatja, me 180 ha nga foragjeret më shumti prodhohet misri i gjelbër dhe nga pemët, ne 8 ha më së shumti prodhohen molla dhe kumbulla.

	2017	2018	2019	2020
Grurë	1450	1500	1800	1200
Misër	650	720	760	1100
Elb	10	15	20	20
Tërshërë	5	10	20	20

Tabela 21. Prodhimtaria bujqësore e drithërave sipas hektarëve

	2017	2018	2019	2020
Patate	60	65	91.5	150
Speca	32	40	45	48

Qepë	8.5	7	6	6
Lakër	1	1.5	1.5	2
Presh	0.45	0.45	0.9	1.2

Tabela 22. Prodhimtaria bujqësore e perimeve sipas hektarëve

	2017	2018	2019	2020
Misër I gjelbër	80	110	140	180
Jonxha	10	20	30	40
Kunguj foragjer	15	18	20	22
Përzierje bari	10	12	10	10

Tabela 23. Prodhimtaria bujqësore e foragjereve sipas hektarëve

	2017	2018	2019	2020
Mollë	8	12	12	8
Kumbull	4	6	8	8
Lajthi	2.5	4	4.5	4.5
Vishnje	1	4	4	4
Mjedër		12	10	6

Tabela 24. Prodhimtaria bujqësore e pemëve sipas hektarëve

2.3.2.2. Blegtoria

Në Komunën e Obiliqit më së shumti ka lopë, gjithsejtë 1,500, pastaj qengja, gjithsejtë 870, dhe dele mbarështimi, gjithsejtë 812.

Lope	Mëshqerre	Gjithsej	Dele mbarështimi	Qengj	Dhi
1,500	780		812	870	100

Tabela 25. Numri i kafshëve në Komunë

Në komunën e Obiliqit bletaria është njëri nga sektorët i cili është duke u zhvilluar mjaft mirë. Prej vitit 2015 komuna ka përkrahur bletarët me koshere bletësh, si dhe pogaçe luledielli. Nga 2000 koshere që kanë qenë në vitin 2015, numri i tyre është rritur në 4000. Në Komunë 8,082 ferma familjare dhe vetëm në 2 vendbanime nuk ka asnjë fermë familjare, gjersa më shumti ka në Breznicë, Obiliq, Milloshevë, Mazgit, Baimofc dhe Plemetin. Në komunën e Obiliqit vitin e kaluar janë prodhuar gjithsejtë 369.341 litra qumësht.

Breznicë	Obiliq	Milloshevë	Mazgit	Baimofc	Plemetin	Sibovc	Leshkoshiq	Kryshefc	Bakshi	Cërkvena Vodicë	Raskovë	Grabofci i Fshatit	Hade	Shipitullë	Kozaricë	Llazarevë	Hamidi
148	126	106	103	88	82	63	59	44	43	43	43	39	36	31	25	16	14

Tabela 26. Numri i fermave familjare sipas vendbanimeve

2.3.2.3. Përshtatshmëria (Boniteti) e tokës bujqësore

Komuna e Obiliq ka një tokë bujqësore të kualitetit të lartë, pjesa më e madhe e sipërfaqes mbi 60% i takon përshtatshmërisë së tokës bujqësore klasës I-IV, ndërsa pjesa tjetër i takon kualitetit V-VIII.

Sipërfaqja e tokës bujqësore është 6,852 ha, ndërsa 4,261 ha tokë e punueshme, 74. 39 ha janë pemishte, kullosa/livadhe 326.78 ha, djerrina 29.05 ha si dhe 190.3 tokë e zhveshur.

Në Komunë nuk ka tokë bujqësore në pronësi komunale, apo shoqërore, gjersa në pronësi private janë rreth 8,082 ha nga e cila 6,853 ha shfrytëzohen për kultivime bujqësore.

2.3.2.4. Pylltaria

Pyjet, në territorin e Komunës, zënë një hapësirë prej 1.153 ha ose marrin 11% nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore shtrihen pyje të ulëta që mbulohen nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardhi– Querrcus Frainetto, Qarri – Qurqus Cerris, Shkoza e zezë Carpinus Orientalis, Ahu – Fagus Moesiaca.

2.3.2.5. Ekonomitë bujqësore dhe punësimi në bujqësi


Në nivel nacional toka shfrytëzohet nga 130,775 Ekonomi Bujqësore, që merren me prodhimin e kulturave bujqësore, prej të cilave:

- 113.231 ekonomi bujqësore në Republikën e Kosovës kultivojnë kultura njëvjeçare Drithëra (grurë 50%, misër 19%, etj.) dhe Perime (4%);
- 11.677 ekonomi bujqësore në Republikën e Kosovës kultivojnë kultura shumëvjeçare Pemë (mollë 56%, kumbull 20%, etj.), dhe
- 6.242 ekonomi bujqësore në Republikën e Kosovës të tjera që kultivojnë Rrush (për verë 59% dhe për tryezë 41%); ndërsa
- 91.227 ekonomi bujqësore në Republikën e Kosovës (me 281.747 njësi blegtore) merren me rritjen e gjedheve (71%), shpezëve (17%), deleve (7%), etj.

Në nivelin lokal organizimi i ekonomive familjare është si më poshtë:

Lloji i ekonomisë	Numri i ekonomive bujqësore	% pjesëmarrjes
Kultivimi Drithërave	1532	29.80
Kultivimi Perimeve	540	10.50
Kultivimi Pemëve	159	3.09
Mbarështimi Blegtoral	1027	19.98
Shpezë	1040	20.23
Bletë	81	1.58
Livadhe dhe Kullota	762	14.82
Gjithsej	5141	100.00

Tabela 27. Numri i ekonomive bujqësore sipas dhe llojit të veprimtarisë bujqësore ASK-së 2014, Obiliq



Harta 25. Shtrirja e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit të tokave bujqësore

Në sektorin e bujqësisë janë të angazhuar një numër i lartë i të punësuarve. Sipas ASK-së, numri i të punësuarve në këtë sektor është mbi 3826 punëtor të rregullt si dhe një numër i madh i atyre sezonal nga e cila kuptojmë se bujqësia është një sektor shumë

i rëndësishëm në sigurimin e jetesës të një numri të madh të ekonomive bujqësore. Sipas të dhënave që disponon Drejtoria e Bujqësisë në komunën e Obiliqit, numri i bizneseve që ushtrojnë veprimtari bujqësore është afro 384, ndërsa numri i fermerëve është 1005.

Të punësuarit si bartës të ekonomisë bujqësore	Numri i të punësuarve	% pjesëmarrjes
Nën 25 vjeç	43	2.21
Nga 25 deri nën 35 vjeç	159	8.17
Nga 35 deri nën 45 vjeç	391	20.08
Nga 45 deri nën 55 vjeç	536	27.53
Nga 55 deri nën 65 vjeç	466	23.93
65 vjeç e më shumë	352	18.08
Gjithsej	1947	100.00

Tabela 28. Të punësuarit si bartës të ekonomisë bujqësore

Të punësuarit sipas anëtarëve të ekonomisë bujqësore	Numri i të punësuarve	% pjesëmarrjes
Nën 25 vjeç	347	18.47
Nga 25 deri nën 35 vjeç	445	23.68
Nga 35 deri nën 45 vjeç	398	21.18
Nga 45 deri nën 55 vjeç	347	18.47
Nga 55 deri nën 65 vjeç	216	11.50
65 vjeç e më shumë	126	6.71
Gjithsej	1879	100.00

Tabela 29. Të punësuarit sipas anëtarëve të ekonomisë bujqësore (ASK)

Ekzistojnë më se 1027 ekonomi bujqësore të cilat kultivojnë kafshë për nevoja familjare dhe një fond prej 4887 krerë. Mbarështimi i gjedheve zë hapësirën të kultivimit me rreth 53.80% të numrit të krerëve, pastaj dhenëtaria zë pjesën më numri të krerëve me 24.33%, dhit me 1.78% dhe derra 20.09%.

Kategoria kafshëve	Numri kafshëve	% pjesëmarrjes	Nr. Ekonomive bujqësore	% pjesëmarrjes
Gjedhe	2629	53.80	824	81.34
Dele	1189	24.33	24	2.37
Dhi	87	1.78	22	2.17
Derra	982	20.09	143	14.12
Gjithsej	4887	100.00	1013	100.00

Tabela 30. Fondi blegtoral dhe ekonomitë bujqësore

2.3.3. Turizmi

Grabofci i Epërm shquhet për trashëgimi natyrore dhe disa nga këto pasuri janë futur nën përkujdesjen e komunës dhe në të ardhmen e afërt të veçohen me një mbrojtje ligjore si zona me interes të veçantë, si: vendet e quajtura "Maja e Zezë", "Bota e Kuqe", "Gurët e Gjelbër", "Burimi i Ujit Mineral". Si vendbanim është i përshtatshëm për ngritjen e qendrave atraktive sportive, fushim malor, kampim, gjueti, shtigje për ecje, pasi që shtrihet përgjatë maleve të Qyqavicës, një vijë të gjatë nëpër pyje që përshkon me Komunën e Drenasit dhe atë të Vushtrrisë.

Malet e Qyqavicës me shtrirje në Sibovc posedojnë një trashëgimi të pasur natyrore. Si vende të veçuara janë: "Kroi i Bardh", "Trungjet e Dushkut", "Trungu i Blirit", dhe "Guri i Sibovcit".

Kozarica shtrihet përgjatë maleve të Kopaonikut (Albanikut) dhe përfshihet në territorin e tri komunave të Republikës së Kosovës, me një peizazh të bukur natyror, në një lartësi mbi detare 740 m, dhe një lidhje të pyjeve me territorin e komunës së Vushtrrisë që përshkon një vijë nëpër pyje deri në Shalë të Bajgorës në Komunën e Mitrovicës. I përshtatshëm për zhvillim të turizmit dhe shtrirjen e aktiviteteve sportive malore si dhe i përshtatshëm për ngritjen e bujtinave dhe vikend shtëpizave. Nga llojet e rëndësishme të faunës që gjendet në këtë zonë veçohet: Ariu i murrmë, Kaprolli, Mace e egër, Shqarthi etj., dhe si aktivitet në këtë pjesë që zhvillohet është e njohur gjuetia gjatë sezonit të stinës së dimrit.

Në Lajthishtë gjendet bunari me një të kaluar shumë vjeçare i cili ka shërbyer për furnizimin e banorëve me ujë të pijes "Bunari i Dashnisë".


Territori i Komunës së Obiliqit është i pasur me trashëgimi historike-kulturore, monumente të periudhave të ndryshme historike si dhe objekte e lokalitete të vendbanimit antik. Në disa vendbanime janë gjetur fragmente të qeramikës si tjegulla, tulla dhe enë, të periudhës së antikës dhe mesjetës, si në fshatin Hade në lagjen Mirena. Në toponimin "Lugu i Bucakut" qeramikë e periudhës

mesjetare. Në fshatin Baimofc vendbanim parahistorik dhe romak, në fshatin Bakshi në vendin e quajtur "çukishtë" u gjetën fragmente qeramike (enëve) të shumta që janë me glazurë. Fshati Sibovc, në lokalitetin lagja e Qurillëve- kisha janë evidentuar fragmente të qeramikës të antikitetit të vonë, ndërsa në fshatin Raskovë janë dëshmuar gjurmët e një vendbanimit të kohës së eneolitit. Fshati Plemetin, në lokalitetin "Markovac" fare pranë varrezave të reja ortodokse janë hasur gjurmë të fragmenteve të qeramikës atipike por që mbase i takojnë periudhës së antikitetit të vonë-mesjetës së hershme. Gjurmimet arkeologjike dëshmojnë edhe për vendbanime si në Dardhishtë dhe Grabofc i Epërm. Në Grabofc të Epërm, ndër pika të rëndësishme mund të renditet "Lugu i Kishës" dhe "Maja e Zezë".


2.3.4. Resurset nëntokësore dhe sipërfaqësore

Komuna e Obiliqit është një qendër ekskluzivisht industriale. Në këtë komunë gjenden rezerva të mëdha të linjitit. Deri më tani janë konstatuar rezerva rreth 13 miliard tonelata.

Zhvillimet e deritashme tregojnë për një menaxhim jo efikas dhe joracional të pasurive nëntokësore. Mihjet e vjetra sipërfaqësore që nga eksploatimi e deri më sot, janë jashtë përdorimit dhe të degraduara. Planet parciale të eksploatimit të linjitit, të aplikuara deri më sot kanë ndikuar në paraqitjen e shpeshtë të problemeve hapësinore, mjedisore, ekonomike dhe sociale. Rezultat i këtyre aktiviteteve është mungesa e shpeshtë e linjitit që në fakt ka ndikuar edhe në furnizimin e pamjaftueshëm me energji elektrike dhe rrezikimin e banorëve nga rrëshqitjet e terrenit.



Harta 26. Resurset minerale dhe natyrore



Harta 27. Harta e zhvillimit ekonomik

2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

2.4.1. Energjia elektrike

Në komunën e Obiliqit ka një rrjet të shtrirë mjaft të dendur dhe ky rrjet është në pronësi të ndërmarrjeve energjetike të cilat menaxhojnë me rrjetit kombëtar si KEK-ut, KOSTT-it dhe KEDS-it.

Kjo dendësi e rrjetit ka ndikim si në aspektin mjedisor po ashtu edhe vizual, pasi që në këtë komunë ndodhen dy termocentralet:

- TC Kosova A 220/110/35 kV
- TC Kosova B, 400/220 kV.

Këto nënstacione janë pika të forta të sistemit elektro-energjetik të Kosovës, prej nga dalin një numër i madh i linjave 400 kV, 220 kV dhe 110kV.

Pastaj në territorin e komunës së Obiliqit janë të shtrira mihjet sipërfaqësore nga të cilat bëhet furnizimi i termocentraleve me thëngjill, nënstacionet Kosova B dhe Kosova A.

Konsumi i komunës së Obiliqit furnizohet nga nënstacionet 35/10 kV dhe atë: **Mazgiti, Bardhi dhe Fushë Kosova.** Duhet theksuar se me rrjetin e nivelit energjetik 400/220/110 kV menaxhohet nga KOSTT, ndërsa që rrjeti distributiv është nën menaxhim të ndërmarrjes shpërndarëse KEDS. Ndërsa që për furnizimin e mihjeve sipërfaqësore MS Bardhi dhe asaj Mirashi, pastaj furnizimet e pajisjeve për nevoja të elektranave si dhe mbarë konsumin brenda nënstacioneve është nën pronësi të KEK-ut.

Gjendja ekzistuese e rrjetit të transmisionit që shtrihet në komunën e Obiliqit.

Rrjeti i transmisionit në komunën e Obiliqit përbëhet nga:

- Linjat 400 kV,220 kV dhe 110 kV
- Nënstacion 400/220 kV
- Nënstacion 220/110 kV

- Nënstacionet 110/35) kV.

Linjat 400 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

- Linja 400 kV numër 445/1 NS Kosova B-TC Kosova BG1,
- Linja 400 kV numër 445/2 NS Kosova B-TC Kosova B,
- Linja 400 kV numër 420 NS Kosova B-NS Ferizajt 2,
- Linja 400 kV numër 437/1 NS Kosova B-NS Peja 3,
- Linja 400 kV numër 407 NS Kosova B-NS Nish,
- Linja 400 kV numër 408 NS Kosova B-NS Tiranë.




Figura 2. Shtrirja e rrjetit 400 CV (linjat dhe nënstacionet)

Linjat 220 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

1. Linja 220 kV numër 2306 NS Kosova B-NS Kosova A,
2. Linja 220 kV numër 267 NS Kosova B- NS Kosova A.
3. Linja 220 kV numër 2304 NS Kosova B- NS Prishtina 4,
4. Linja 220 kV numër 2305 NS Kosova B- NS Prishtina 4,
5. Linja 220 kV numër 205/1 NS Kosova B- NS Podujeva,
6. Linja 220 kV numër 2298 NS Kosova B- SSH Drenas,
7. Linja 220 kV numër 293/1 NS Kosova B- SSH Drenas,
8. Linja 220 kV numër 290 NS Kosova B-TC Kosova B.




Figura 3. Shtrirja e rrjetit 220kV (linjat dhe nënstacionet)

Linjat 110 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

1. Linja 110 kV numër 1114 NS Kosova A-NS Prishtina 1,
2. Linja 110 kV numër 118/1 NS Kosova A-NS Prishtina 1,
3. Linja 110 kV numër 1139/1 NS Kosova A-NS Prishtina 3,
4. Linja 110 kV numër 112 NS Kosova A-NS Lipjani,
5. Linja numër 1807 NS Kosova A-NS Prishtina 5,
6. Linja numër 1808 NS Kosova A-NS Prishtina 5,
7. Linja 110 kV numër 1801 NS Kosova A-NS Bardhi.
8. Linja 110 kV numër 163/1 NS Kosova A-NS Bardhi.
9. Linja 110 kV numër 125/1 NS Kosova A-NS Vushtrria 2,
10. Linja 110 kV numër 163/2 NS Bardhi-NS Mitrovica 2.

DRAFT



Figura 4. Shtrirja rrjetit 110 kV (linjat dhe nënstacionet)

Nënstacionet 400/220 kV, 220/110 kV dhe 110/35 kV.

1. NS Kosova B 400/220 kV, kapaciteti 3x400MVA=1200 MVA
2. NS Kosova A 220/110 kV , kapaciteti 3x150MVA=450MVA
3. NS Bardhi 110/35 kV, kapaciteti total 3x40 MVA=120 MVA

Rrjeti i shpërndarjes 10 kV.

Furnizimin e rreth 22255 banorëve apo rreth 6606 konsumatorëve me energji elektrike bëhet nëpërmjet rrjetës distributore e cila menaxhohet nga KEDS-i dhe në këtë kuadër janë të angazhuar 127 transformatorë të cilët janë të vendosur nëpër lagjet dhe vendbanimet e komunës së Obiliqit.

Fshatrat dhe qyteti i Obiliqit furnizohen nga tre nënstacione energjetike 35/10 kV dhe atë NS Mazgiti, NS Bardhi (Palaj) dhe një pjesë e konsumit nga NS F Kosova.

Më poshtë në tabelën 27 janë paraqitur të dhënat për nënstacionet 35/10kV që furnizojnë konsumin e Obiliqit, pastaj drejtimet e fshatrave si dhe fuqitë e transformatorëve të instaluar në ato drejtime, si dhe numri i konsumatorëve që furnizojnë këto transformatorë.

Nënstacioni	Drejtimi	Fuqitë e trafostacioneve (kVA)							Konsumatorë
NS Mazgiti	Breznicë	1000	630	400	250	160	100	50	404
		0	0	0	3	7	2	0	
	2070	0	0	0	750	1120	200	0	
	Llazarevë	1000	630	400	250	160	100	50	979
		2	2	3	3	1	2	0	
	5570	2000	1260	1200	750	160	200	0	
	Lumi i Madh	1000	630	400	250	160	100	50	1697
		0	4	9	9	6	3	0	
	9630	0	2520	3600	2250	960	300	0	
	Plemetin	1000	630	400	250	160	100	50	1533
		0	6	2	12	2	2	0	
	8100	0	3780	800	3000	320	200	0	

DRAFT

	Shkabaj	1000	630	400	250	160	100	50	855
		1	4	4	8	7	6	1	
	8890	1000	2520	1600	2000	1120	600	50	
	Qyteti	1000	630	400	250	160	100	50	471
		0	1	3	2	2	0	0	
	2650	0	630	1200	500	320	0	0	
Palaj 35/10kV	PALAJ-Dalja 1	1000	630	400	250	160	100	50	268
			1		1		1		
	980	0	630	0	250	0	100	0	
F. Kosova 35/10kV	Krushevci	1000	630	400	250	160	100	50	399
			1	2	2		0		
	1930	0	630	800	500	0	0	0	
Total	**39820**	3	**19**	**23**	**40**	**25**	**16**	1	**6606**

Tabela 31. Nënstacionet, fuqitë dhe numri i transformatorëve nga furnizohet Obiliqi




Figura 5. Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 35 kV (linjat dhe nënstacionet)




Figura 6. Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV (linjat dhe nënstacionet)

Shiritat Mbrojtës rreth Stabilimenteve Energjetike.

Me rastin e inicimit të procesit të ndërtimit të linjave dhe stabilimenteve energjetike, përpos kërkesave tjera ligjore dhe ekonomike është e nevojshme të sigurohen shirit mbrojtës (korridore) brenda të cilave ka shumë kufizime.

Shfrytëzimi i këtyre shiritave rregullohet me norma teknike si dhe me ligje përkatëse (UA) dhe më tutje këto konsiderohen si zona të sigurisë dhe shërbejnë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi. Për këtë qëllim për linja energjetike kabllovike nëntokësore duhet të sigurohen korridore:

Nr	Linja kabllovike nëntokësore	Gjerësia (m) e korridorit përgjatë rrjetit ekzistues	Gjerësia (m) e korridorit përgjatë rrjetit të planifikuar
1	2x 400 kV	10	16
2	400 kV	8	14
3	2x 220 kV	8	14
4	220 kV	6	12
5	2x 110 kV	6	12
6	110 kV	5	10
7	35 kV	3	5
8	20 kV	2	5
9	10 kV	2	5

Tabela 32. Korridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja kabllore nëntokësore ekzistuese dhe ndërtime te reja

Nr	Linja kabllovike ajrore	Gjerësia (m) e korridorit përgjatë rrjetit ekzistues	Gjerësia (m) e korridorit përgjatë rrjetit të planifikuar
1	2x400 kV	80	100
2	400 kV	70	80
3	2x220 kV	60	70
4	220 kV	50	60
5	2x110 kV	50	60
6	110 kV	40	50
7	35 kV	30	30
8	20 kV	20	20
9	10 kV	15	15

Tabela 33. Korridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja kabllore nëntokësore ekzistuese dhe ndërtime te reja

Planifikimi i ndriçimit të rrugëve

Ndriçimi aktual i lagjeve nuk është i kompletuar në të gjitha rrugët ashtu si duhet. Për këtë arsye duhet të parashihen të ndriçohen të gjitha rrugët dhe hapësirat publike në lagje. Duhet planifikuar që ndriçimi të bëhet me llamba ekonomike të teknologjive më të reja LED- efiçiente, të vendosura në shtylla metalike apo edhe në shtylla betoni në zonat rurale. Numri i llambave për ndriçimin e rrugëve të lagjes do të përcaktohet me projekt detal-zbatues dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare për ndriçim të rrugëve.

Furnizimi i këtyre llambave do të bëhet nga nënstacionet e reja të vendosura në ato lagje, ku edhe do të vendoset grupi matës i energjisë së nevojshme për ndriçim. Pajisjet për komandim të ndriçimit të jashtëm duhet të vendosen në trafostacionet në kuadër të veçantë. Këto pajisje duhet të mundësojnë kyçje automatike në mbrëmje dhe shkyçjen në mëngjes, dhe në vende ku frekuenca e qarkullimit është e vogël pas orës 24 mundet që të zvogëlohet për 50%.

2.4.2. Energjia termike

Sektori i amvisërisë dhe ai i shërbimeve janë sektorët më të mëdhenjtë të konsumit të energjisë termike. Momentalisht, Komuna e Obiliqit nuk ka sistem të ngrohjes qendrore, dhe rrjedhimisht amvisëritë dhe të tjerët detyrohen të shfrytëzojnë thëngjillin apo drurin si lëndë djegëse për ngrohje. Ngrohja e bazuar në rrymë në Obiliq për shkak të kostos dhe të intensitetit jo stabil të rrymës elektrike, është rast më i rrallë.

Në drejtim të zgjidhjes së problemit me ngrohjen, komuna në vitin 2019 ka hartuar një studim të fizibilitetit për kogjenerimin të ngrohjes qendrore. Studimi i fizibilitetit ka rezultuar se për termofikimin e qytetit të Obiliqit burimi më i përshtatshëm i energjisë termike është ndërtimi i një sistemi **Ngrohtore qendrore dhe Stacion këmbyes**, duke u furnizuar me energji termike nga termocentrali "Kosova B" nëpërmjet sistemit të kogjenerimit. Në ndërkohë, sipas të gjeturave në studimin e fizibilitetit, është duke u punuar edhe projekti për kogjenerimin e ngrohjes qendrore në Obiliq.

2.4.3. Ujësjellësi

Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë dy sisteme vijuese për furnizim me ujë cilësor të pijes: Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KUR "Prishtina" e që furnizon 70% të zonës urbane të Obiliqit dhe tetë vendbanime tjera rurale me ujë, një sistem tjetër (puset në "Obiliqin e Vjetër") që menaxhohen nga KUR "Prishtina" që furnizon 30% të zonës urbane të Obiliqit, dhe pesë vendbanime tjera rurale, dhe disa vendbanime nga burimet nëntokësore nga bunarët individual, të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHMS.

Furnizimi me ujë nga këto dy sistemet është e cilësisë së mirë në këto vendbanime. Sasia e furnizuar, përkundër kufizimeve, është në nivel të kënaqshëm. Reduktimet më të shpeshta bëhen gjatë stinës së verës. Njëri prej shqetësimeve është rrjeti i ujësjellësit në qytet, për shkak të vjetërsisë, dhe ekziston mundësia permanente që uji të kontaminohet.

Vendbanimet e mëposhtme që furnizohen me ujësjellës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjetër, Mazgiti i Ulët, Mazgit i Epërm, Millosheva, Llazareva, Bakshia, Baimofci, Breznica, Plemetini, Hamidi, Sibovci, Hade, Dobrosellë, Leshkoshiq, Cërkvena Vodicë, dhe Kryshefc.

Furnizimi me ujë në komunën e Obiliqit bëhet përmes Ujësjellësit Rajonal të Prishtinës, nga ujësjellësi komunal dhe në disa vendbanime furnizimi me ujë bëhet nga burimet nëntokësore (nga bunarët dhe puset). Furnizimi i vendbanimeve me ujë nga ujësjellësi rajonal i Prishtinës dhe nga ai komunal bëhet në 13 vendbanime apo 72% të vendbanimeve të komunës. Mirëpo, edhe pse rrjeti i ujësjellësve shtrihet në 13 vendbanime të komunës, megjithatë e tërë popullata e këtyre vendbanimeve nuk furnizohet me ujë nga rrjetet e ujësjellësve.

Sipas informatave nga institucionet komunale të Obiliqit, 95% e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm. Në këto vendbanime uji është i kualitetit të mirë. Ujësjellësi komunal ka kapacitet furnizues 42 l/sek. Sasia e furnizimit përkundër restrikcioneve është në nivel të kënaqshëm. Restrikcionet më të shpeshta janë gjatë sezonit veror. Shqetësim paraqet rrjeti i ujësjellësit në qytet që është i vjetër dhe gjithnjë ekziston rreziku për kontaminimin e ujit të pijshëm.

Furnizimi me ujë nga burimet nëntokësore (bunarët ose puset) bëhet në 5 vendbanime apo 27% të vendbanimeve të komunës. Burimet nëntokësore të ujit për pije (bunarët ose puset) kanë kualitet të mirë të ujit dhe i përgjigjen standardeve minimale për ujë të pijes, përveç në lokalitetet që janë afër stabilimenteve të KEK-ut siç janë Hade, Lajthishtë dhe Hamidi. Vendbanimet të cilat furnizohen me ujë nga puset (bunarët) janë: Sibovc, Hamidi, Hade, Baimofc dhe Breznicë (dhe në Kozaricë).

Sipas institucioneve komunale janë bërë disa investime në shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësve në Komunën e Obiliqit. Ato investime dhe projekte të realizuara janë:

- Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Hamidi nga Plemetini me gjatësi 3 km', me donator CDF, viti 2001,
- Rrjeti i ujësjellësit Cërkvena Vodicë Hade -Leshkoshiq me gjatësi rreth 12 km', donator USAID.
- Renovimi i rrjetit të ujësjellësit brenda qytetit të Obiliqit, me gjatësi 2 km', donator CDF, viti 20012002,
- Rrjeti i ujësjellësit Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Bakshi me gjatësi 11 km, donator CDF,

Synim prioritar i komunës është instalimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Sibovc, Breznicë, Kozaricë dhe Baimofc.

2.4.4. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza)


Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura, e cila përfshin tubacionet kryesore, d.m.th. primare, sekondare, pusetat etj. është e projektuar dhe ndërtuar gjatë viteve 1970, 1985,1990, 2000, 2011, e cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Sot, punimet për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit bëhen në vazhdimësi. Rrjeti i kanalizimit, përveç grumbullimi të ujërave të ndotura urbane, grumbullon edhe ujërat atmosferike. Shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në tetë pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin "Sitnicë". Derdhja e ujërave të zeza-sanitare nëpër sipërfaqe të hapura në ato vendbanime që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit dhe shkarkimi i ujërave të zeza-sanitare të pa trajtuara në lumenjtë "Llap", "Drenicë" dhe "Sitnicë" janë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Andaj, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza-sanitare, është çështje që kërkon zgjidhje të shpejtë.

Ky rrjet ka shtrirje në 17 vendbanime apo 95% të vendbanimeve të tërë komunës, por në të nuk ka qasje e tërë popullata e këtyre vendbanimeve. Sipas të dhënave nga institucionet komunale të Obiliqit, rreth 90% e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit. Ky rrjet shtrihet në Obiliq të Ri, Obiliq të Vjetër, Mazgit 1, Mazgit 2, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Plemetin, Muzakaj, Raskovë, Bakshi, Llazarevë dhe Baimofc, Sibovc, Kozaricë, Hamidi, Shipitullë, Hade. Pjesa e fshatit Orlloviq që shtrihet në territorin e komunës së Obiliqit ka rrjet të kanalizimit. Rrjeti shumë i vjetër i kanalizimit dhe derdhja e ujërave fekale të papërpunuar në lumin Sitnica, janë probleme që kërkojnë zgjidhje të ngutshme. Andaj renovimi i rrjetit dhe ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave fekale i cili do të shfrytëzohet edhe nga komunat fqinje, shihen si zgjidhje të këtyre problemeve. Mbulimi i vendbanimeve me rrjet të kanalizimit dhe përqindja e kyçeve të ekonomive familjare në territorin e komunës janë të pasqyruara në tabelën në vijim.

Emri i vendbanimit	Popullsia	Numri i amvisërive	Po / Jo	Numri i amvisërive të kyçur	% e popullatë së kyçur në	Nëse jo, si shkarkohen ujërat e zeza	Vendshkarkimi i ujërave të zeza
Obiliq	5648	1050	Po	950	100 %		Sitnicë
Obiliqi i vjetër	1160	232	Po	190	95 %		Sitnicë
Mazgit i ultë	1441	250	Po	270	95 %		Sitnicë
Mazgiti i lartë	1445	250	Po	270	95 %		Sitnicë
Llazareva	429	71	Po	68	95 %		Llap
Millosheva	2920	323	Po	420	95 %		Llap
Bakshi	602	114	Po	100	95 %		Llap
Raskovë	640	100	Po	100	95 %		Llap
Bajmofc	1680	210	Po	280	95 %		Sitnicë
Breznicë	1292	190	Po	260	95 %		Sitnicë
Kozaricë	469	68	Po	290	95 %		Sitnicë
Plemetin	2588	320	Po	190	95 %		Sitnicë
Hamidi	147	27	Po				
Sibovc	963	166	Po			Sipërfaqe të hapura	
Grabofci i Epërm	340	57	Jo			Sipërfaqe të hapura	
Shipitullë	295	48	Po				
Hade	534	179	Po			Sipërfaqe të hapura	
Lajthishtë	715	130	Po			Sipërfaqe të hapura	
Cërkvena Vodicë	1463	180	Po	300	95 %		Llap
Kryshefc	1580	198	Po			Sipërfaqe të hapura	
Orlloviq	Pjesa e fshatit Orlloviq që shtrihet në territorin e komunës së Obiliqit ka rrjet të kanalizimit.						

Harta 28. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura (zeza) i ndërtuar deri në 2019


DRAFT



Harta 29. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

2.4.5. Ujitja e tokës bujqësore

Në komunë shtrihet rrjeti i ujitjes së tokës bujqësore që nga menaxhohet nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh. a. Sipërfaqja e tokës bujqësore nën ujitje është 2,153 ha, gjersa nën komasacion shtrihen gjithsejtë 469.84 ha.



Harta 30. Shtrirja e tokave bujqësore në komasacion dhe nën ujitje

2.4.6. Drenazhimi-kanalizimi i ujërave atmosferike

Rrjeti i drenazhimit dhe ujërave atmosferik në komunën e Obiliqit ka një shtrirje të vogël, i cili mbulon vetëm pjesën e ngushtë të qendrës së Obiliqit. Ndërsa, në zonat tjera ky lloj kanalizimi është i përzier më atë të ujërave të ndotur.

2.4.7. Telekomunikacioni


2.4.7.1. Rrjeti i Telekomit

Rrjeti i telefonisë fikse është i shtrirë në një pjesë të madhe të komunës së Obiliqit, përkatësisht në nëntë vendbanime si; Obiliqi i ri dhe i vjetër, Millosheve, Raskovë, Bakshi, Cërkvena Vodicë, Plemetin, Baimofc, Mazgit, Llazarevë. Trendi i kohës moderne me internet dhe telefonia mobile ka bërë që edhe kërkesa të jetë e vogël.

Në territorin e komunës së Obiliqit ekziston rrjeti i telefonisë fikse e gjithashtu ky territor mbulohet edhe nga valët e telefonisë mobile. Centrali i telefonisë fikse është i sistemit të vjetër me gjithsejtë 1391 numra dhe ende i pa digjitalizuar. Rrjeti i telefonisë fikse ka shtrirje në Obiliq të Ri, Obiliq të Vjetër, Mazgit I, Mazgit II, Cërkvena Vodicë, Plemetin, Muzakaj, Raskovë, Bakshi dhe Baimofc. Valët e telefonisë mobile mbulojnë 100 % territorin e komunës së Obiliqit. Aktualisht të vetmit operatorë të telefonisë mobile në Kosovë janë Vala 900 dhe IPKO.

2.4.7.2. Rrjeti Kujtesa

Në komunën e Obiliqit, operatori Kujtesa ka një shtrirje të gjerë ku pjesën më të madhe të vendbanimeve i mbulon me shërbime të internetit dhe kabllovikut.



Harta 31. Mbulueshmëria me rrjet e operatorit Kujtesa

2.4.8. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Përshkrimi aktual i sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale, pajisjeve dhe mekanizmi teknik në këtë sektor na shërben për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të proceseve që lidhen me llojet e mbeturinave dhe të krijimit të një baze për identifikimin, dhe përcaktimin e aspekteve në të cilat nevojitet të bëhen ndryshime. Përshkrimi i bazuar në informata nga kompania, si dhe nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të të gjithë sistemit të shërbimeve që përfshin operimin, pajisjet, impiantet, kostot dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen. Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompani:

- Kompania rajonale për mbeturina "Pastrimi" në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi. Këtë shërbim në nivel lokal e kryen njësia operative e KRM që vepron në Komunë.
- Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës KMDK e cila e menaxhon deponinë rajonale të Prishtinës në Mirash në të cilën deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës.

Organizimi i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është i bazuar në këto skema:

- Hedhja e mbeturinave në pikat e grumbullimit (PGM)

Banorët, bizneset dhe institucionet i hedhin (dorëzojnë) mbeturinat e ngurta komunale si të pandara (pa selektuara) në pikën më të afërt të grumbullimit. Pikat e grumbullimit të mbeturinave janë pajisje adekuate, kontejnerë me vëllim 1.1 m^3, shporta prej 120l ose pajisje jo adekuate, siç janë kosha nga llamarina (bure) prej vitit 200l të vendosura në sipërfaqe të vogla publike, si dhe mënyra e grumbullimit e quajtur "derë me derë" nëpërmes të qeseve të plastikës. Numri i kontejnerëve që disponon kompania në territorin e komunës është rreth 240, që nuk i mbulon të gjitha pikat për grumbullimin e mbeturinave. Gjendja e kontejnerëve nuk është e mirë, janë të vjetruar dhe pjesërisht të shkatërruar. Në pikat e grumbullimit ku janë të vendosur pajisjet për grumbullimin e mbeturinave, shpesh herë ka hedhje të mbeturinave jashtë pajisjeve, si dhe mbushje të tepërta të kontejnerëve për shkak të dinamikës jo të mjaftueshme për zbrazjen e tyre.

- Shërbimi i grumbullimit menaxhimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi

Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda komunës. Shpeshtimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektorë të banimit:

- Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë;
- Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet një herë në javë dhe;

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, kompania në disponim i ka dy kamionë special. Sasia ditore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe transporti i tyre në deponi është rreth 15.500 kg. ose 341.000 kg. për një muaj. Në sistem të mbledhjes së mbeturinave përfshihet e gjithë komuna me 18 fshatra në sistem individual dhe atë kolektiv. Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompanitë vijuese:

- Kompania rajonale për mbeturina (KRM) "Pastrimi" në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi; dhe
- Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK) e cila menaxhon deponinë rajonale të Prishtinës e ndodhur në fshatin Mirash, në të cilin deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës.

Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira nëntë vendbanime ose 1085 ekonomi familjare, nëse shprehet në përqindje i bie 45 % e vendbanimeve, ose 20 % e ekonomive familjare.

Në vijim po i paraqesim informacionet për vendbanimet e mbuluara me shërbim të organizuar, përqindjen e ekonomive familjare të mbuluara me këtë shërbim, dinamikën dhe sasinë e mbeturinave që deponohen në deponi.

Në njëmbëdhjetë vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, përgjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

Deponia rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën e shterur të linjitit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtuar si deponi sanitare e tipit rajonal, e që me shërbimet e deponimit të mbeturinave i mbulon këto komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën. Deponia ka një sipërfaqe prej 50 ha. Deponia është në një gjendje jo të mirë, e cila nuk plotëson standardet elementare.

Në njëmbëdhjetë vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

Deponia rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën sipërfaqësitë të shterur të linjitit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtuar si deponi sanitare e tipit rajonal që me shërbimet e deponimit të mbeturinave i mbulon këto Komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën, ka një sipërfaqe prej 50 ha me kohë zgjatje për 15 vite, kapaciteti total i deponisë është 3.5 milionë m^2, ndërsa kapaciteti mujor 6000 t. Deponoja e posedon edhe lagunën për ujëra të zeza në kapacitet prej 4000 m^3.

Deponinë rajonale të Prishtinës në Mirash e menaxhon Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës e regjistruar si kompani aksionare me emrin Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh. A. – Prishtinë.

Në përgjithësi deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK sa i përket gjendjes së tyre nuk kanë ndryshime të mëdha ndërmjet vete dhe pa përjashtim janë në gjendje të keqe, si pasoje e mos menaxhimit të duhur të tyre, e sidomos në gjendje të vështir është deponia në Mirash. Arsyeja kryesore, por jo e vetmja, është se KMDK nuk ka mundur të i arkëtoj në tërësi borxhet nga KRM, të cilat kanë pjesëmarrje të madhe në biznesin e KMDK.

Ndërmarrja ka pesë punëtorë në deponi, që punojnë me një buldozer total të amortizuar. Mbetjet transportohen nëpërmjet një rruge të vogël të deponisë, shkarkohen aty dhe shpërndahen me buldozer. Shumë pjesë të deponisë nuk janë të disponueshme, si rezultat i përmbytjes. Punëtorët thjeshtë i mbulojnë këto zona duke hedhur mbetje të tjera mbi to. Nuk ekzistojnë pajisjet bazë dhe makineritë, siç është për shembull kompaktori (ngjeshësi).

Performanca mjedisore e deponisë është katastrofike për shkak të çdo aspekti të emetimeve potenciale. Mjedisi rrethues i deponisë vuan nga ndotja e mbetjeve, liqeta që rrjedh nga deponia në ujërat nëntokësorë, emetimet e pakontrolluara të biogazrave, e gjithashtu vetë ndezjet janë bërë dukur e shpeshtë në deponi në kohë të thatë të verës, duke shkarkuar përqendrime të larta të gazra të ndryshme që shkaktojnë dioksina dhe furane të llojllojshme.

2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI PUBLIK

2.5.1. Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor i Komunës se Obiliqit përfshinë autoudhë, rrugët nacionale, rajonale dhe lokale.

Përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim të autoudhëve, rrugëve magjistrale dhe rajonale, është Ministria e Infrastrukturës, ndërsa përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime është Komuna.

Nëpër territorin e komunës së Prishtinës kalojnë rrugët magjistrale, të cilat kanë karakter transit nëpër zonën urbane por të rëndësishme për të mundësuar komunikimin me qytetet tjera të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera përreth, Rrugët lokale, të cilat lidhin zonën urbane me vendbanimet përreth, dhe Rrugët nëpër vendbanime.

Autoudha (R7): Autoudha "Ibrahim Rugova" e cila ka kyçjen dhe shkyçjen në fshatin Mazgit përshkon qytetin e Obiliqit në pjesën perëndimore të territorit të komunës si dhe përveç lidhjes me Shqipërinë, përmes saj bëhet qarkullim më i mirë dhe i shpejtë në drejtim të aeroportit "Adem Jashari". Përgjatë territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 4.4 km të autoudhës.

Rrugë Nacionale (M): Nëpër komunën e Obiliqit kalon rruga nacionale M2 që lidhë kryeqytetin, Prishtinën me Mitrovicën, ndërsa brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë 7.8 km të kësaj rruge nacionale. Kjo rrugë e karakterit nacional, e njohur edhe si rruga E - 65 është një nga rrugët më të rëndësishme nacionale ne Kosove. Rruga shkon nga pika kufitare e Bërnjakut mes Kosovës dhe Serbisë përmes Mitrovicës, Prishtinës, Ferizajt deri në piken kufitare të Hanit të Elezit mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Rrugë Rajonale (R): Nëpër territorin e Komunës së Obiliqit, kalon edhe rrugët rajonale R-120 dhe R-220 të cilat lidhin Obiliqin me komunën e Fushë Kosovës, Podujevës dhe Vushtrrisë. Brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 21.2 km të rrugëve rajonale.

Rrugë Lokale: Rrugët lokale lidhin gjithsej 18 zona kadastrale. Nga gjithsej 1,663 segmente rrugore në territorin e komunës së Obiliqit në gjatësi të përgjithshme prej 244.1 km, rrugë të asfaltuara janë 114.123 km. Kurse të trajtuara me zhavorr ose rrugët të rendit të IV-të janë 60 km rrugë nëpër fshatra e lokalitete.

	Kategoria e Rrugëve	Gjatësia (m)	Gjatësia (km)
1	Autoudha	4400	4.4.
2	Rruge Nacionale	7800	7.8
3	Rruge Rajonale	21200	21.2
4	Rruge Lokale	244100	244.1
5	Totali:	277500	277.5

Tabela 28. Gjatësia e rrjetit rrugor ekzistues në Komunën e Obiliqit

	Kategoria	Përgjegjësi
1	Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës
4	Rrugë kryesore lokale dhe në vendbanime	Komuna

Tabela 34. Kategoritë e rrugëve

2.5.2. Shtrirja dhe kategorizimi i rrugëve nga niveli qendror

2.5.2.1. Autoudha – Lidhja e Obiliqit me rrjetin ndërkombëtar

Në territorin e komunës së Obiliqit kalon autoudha R7 ("Ibrahim Rugova"). Kjo autoudhë e tangjenton komunën e Obiliqit në pjesën veri-lindore. Në këtë pjesë gjendet edhe nyja e autoudhës që mundëson kyçjen me rrugën nacionale N2 e pastaj edhe me rrugën rajonale R220. Ndërtimi i autoudhës ka rëndësi të madhe si për komunikacionin brenda Kosovës, ashtu edhe për lidhjet ndërkombëtare. Autoudha përshkon vendbanimet Kryshefc, Obiliq, Mazgit dhe Llazarevë e cila përshkon një gjatësi prej 4.4 km.

Në pjesën veri-lindore të Komunës së Obiliqit kalon një pjesë e autoudhës "Ibrahim Rugova" (R7). Kyçja në autoudhë mundësohet në fshatin Shkabaj përmes rrugës rajonale R-220. Përmes autoudhës "Ibrahim Rugova" (R7) dhe rrugës nacionale N2 rrjeti rrugor i Obiliqit mundëson lidhjen e qytetit te Obiliqit me rrjetin rrugor ndërkombëtar. Përmes autoudhës "Ibrahim Rugova" mundësohet lidhja e Obiliqit me Shqipërinë dhe Serbinë, ndërsa autoudha "Arbër Xhaferi" mundëson lidhjen me shtetin e Maqedonisë së Veriut.

2.5.2.2. Rrugët nacionale


Rrjeti rrugor i Obiliqit, përveç se përfshinë nyjën kryesore lidhëse ndërmjet autoudhës R7 dhe rrugës nacionale N2, shërben edhe si qendër e lidhjes së Obiliqit me kryeqendrën Prishtinën dhe rrugët tjera nacionale të Republikës së Kosovës. Rruga nacionale N2,

e cila lidhë Prishtinën me Mitrovicën, kalon në territorin e komunës së Obiliqit, konkretisht në vendbanimet Obiliq, Mazgit, Milloshevë dhe Baimofc.

2.5.2.3. Rrugët rajonale

Nëpër territorin e komunës së Obiliqit kalojnë dy rrugë rajonale. Rruga rajonale R220 e cila kyçet në rrugën nacionale N2, dhe autoudhën "Ibrahim Rugova" mundëson lidhjen e Obiliqit me Prishtinën dhe Mitrovicën si dhe rrjetin tjetër rrugor në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Rruga rajonale R120 e lidhë Obiliqin me Fushë Kosovën dhe përmes kyçjes në pjesën veri-lindore në rrugën nacionale M-25 mundëson lidhjen me Podujevën.

Parametrat teknik të rrugëve rajonale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte te mira për qarkullim te mjeteve motorike. Në hyrje të qytetit, në këto rrugë, janë realizuar punime te rehabilitimit dhe rikonstruimit me qëllim të përmirësimit të kushteve të qarkullimit dhe ofrimit të qasjes më të lehtë për pjesëmarrësit në trafik.



Harta 32. Rrugët nacionale dhe rajonale

2.5.2.4. Rrugët lokale

Vlen të theksohet se rrjeti rrugor lokal në komunën e Obiliqit ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale. Rrugët lokale, ku përfshihen edhe rrugët urbane, kryesisht janë dy shiritore (me nga një shirit qarkullues për kahe), ku rrugët primare të cilat lidhin qendrën e qytetit dhe institucionet kryesore janë të pajisura edhe me trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Rrugët brenda qytetit, në aspektin e funksionalitetit përgjithësisht ofrojnë qasje të mirë për pjesëmarrësit në trafik, përveç lëvizjeve të pa motorizuara.

Rrugët tjera lokale të cilat mundësojnë lidhjen me zonat periferike dhe fshatrat e komunës së Obiliqit në disa raste nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për qarkullim, sidomos mungesa e sinjalistikës, trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për automjete, këmbësorë dhe çiklistë.

Rrugët lokale urbane shërbejnë si rrugë ushqyese dytësore, të cilat drejtpërsëdrejti çojnë në rrugët e rangut më të lartë (rajonale apo nacionale) si dhe mundësojnë lidhjen me zonat periferike.

2.5.2.5. Trafiku transit

Trafiku i destinacioneve ndër urbane, që nuk kanë nevojë të hyjnë në qytet, është mbajtur jashtë qytetit duke i anashkaluar rrugët rajonale në brendi të qytetit përmes një unaze të jashtme jugperëndimore. Kjo rrugë unazore e bënë edhe lidhjen e rrugëve rajonale R220 dhe R120 jashtë qytetit dhe nuk lejon transportin e rëndë industrial të kalojë përmes qytetit. Gjithashtu rruga anësore e mbledh dhe shpërndanë trafikun lokal nga një distrikt i qytetit në tjetrin, duke e bërë magjistralen të papengueshme për trafikun dhe zhvillimin e tij në të dyja anët e saj.

Një sistem i rrugëve kryesore e drejton trafikun përmes qytetit dhe jashtë qendrës se tij. Sistemi i rrugëve kryesore është i lidhur me rrugën unazore në disa pjesë. Një rrugë kryesore e qytetit e lidh Mazgitin e Poshtëm, tanimë si pjesë e qytetit me vetë Obiliqin.

Kategoria, relacionet dhe gjatësia e rrjetit rrugor në Komunën e Obiliqit është dhënë në tabelën vijuese:

Kategoritë e rrugëve	Relacioni	Gjatësia në km.
Nacionale	Shkabaj – Mazgit – Milloshevë -Baimofc	9
Rajonale	Obiliq – Milloshevë -Raskovë	8
	Obiliq-Kryshefc	6
	Obiliq – Cërkvena Vodicë– Lajthishtë – Shipitullë- Grabofc	14
	Total	28
Lokale	Obiliq (qyteza)	25
	Obiliq- Mazgit	4
	Obiliq- Plemetin	4
	Breznicë- Kozaricë	10
	Milloshevë – Raskovë - Bakshi	5
	Llazarevë- Subotiq	2.5
	Mazgit- Mazgit	3
	Lajthishtë - Hamidi	3
	Lajthishtë- Sibovc	5
	Total	61.5
Rrugët lokale të rendit të 4, të paasfaltuara	Brenda vendbanimeve	40

Tabela 35. Rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre

2.5.3. Vlerësimi i intensitetit dhe kapaciteti i rrugëve

Nëpër territorin e Komunës së Obiliqit kalon rruga nacionale N2 e cila lidhë Prishtinën me Mitrovicën. Kjo rrugë është e ndërtuar viteve të fundit dhe ka nga dy korsi për kahe të ndara fizikisht. Bazuar në matjet e fluksit të qarkullimit, kjo pjesë e rrugës është mjaft e ngarkuar me qarkullim të automjeteve. Nga matjet e qarkullimit të automjeteve, rezulton se brenda 12 orëve, në këtë pjesë të rrugëve kalojnë rreth 20.000 aut/12 orë.

DRAFT




Figura 7. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën nacionale N2 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)

Intensiteti i qarkullimit të automjeteve është vlerësuar edhe për rrugët rajonale të cilat kalojnë nëpër territorin e Komunës së Obiliqit. Bazuar në matjet e fluksit të qarkullimit, rruga rajonale R220 ka një ngarkim mesatar të qarkullimit të automjeteve. Nga matjet e qarkullimit të automjeteve, rezulton se brenda 12 orëve, në këtë pjesë të rrugës rajonale kalojnë rreth 5500 aut/12 orë.




Figura 8. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën rajonale R220 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)

Ndërsa, në rrugën rajonale R120 ngarkesa e trafikut është më e vogël nga qarkullimi i automjeteve. Nga matjet e qarkullimit të automjeteve, rezulton se brenda 12 orëve, në këtë pjesë të rrugës rajonale kalojnë rreth 3000 aut/12 orë.




Figura 9. Ndryshimi i qarkullimit në rrugën rajonale R220 për periudhën 12 orë (06:00-18:00)

2.5.4. Trafiku hekurudhor

Transporti hekurudhor ka shtrirje në territorin e komunës së Obiliqit, por aktualisht nuk funksionon. Linja e transportit hekurudhor është shumë e vjetër, në relacionin Shkup – Mitrovicë, ndërsa në Obiliq si qendër gjeostrategjike e rrafshnaltës së Kosovës është ndërtuar stacioni hekurudhor grumbullues.

Nëpër territorin e komunës së Obiliqit kalojnë dy linja të hekurudhave: linja Fushë Kosovë – Mitrovicë me tre stacione hekurudhore si ai i Dardhishtës, i Obiliqit dhe ai i Plemetinit dhe linja Fushë Kosovë – Pejë me stacionin në Grabofc.

Nga gjithsejtë 20 vendbanime në komunën e Obiliqit, vetëm në 7 vendbanime kalon rruga hekurudhore, apo 35% të vendbanimeve të komunës. Rrjeti hekurudhor- binarët hekurudhorë kalojnë nga Kryshefc-Obiliq-Plemetin dhe Grabofc i Epërm.

Hekurudha kalon në anën jugperëndimore të qendrës së qytetit. Aty do të formohet një qendër mobiliteti, i cili lidh stacionin e transportit publik dhe mobilitetit. Pasi që infrastruktura hekurudhore aktualisht është në gjendje të amortizuar dhe jashtë funksionit, paraqitet nevoja për riparime dhe investime në ngritjen e nivelit të saj me qëllim të vënies në funksionim.

2.5.5. Trafiku ajror

Në komunën e Obiliqit nuk ka transport ajror, por qytetarët e komunës së Obiliqit për nevojat e tyre e shfrytëzojnë aeroportin "Adem Jashari" në Fushë Kosovë, i cili është në një distancë prej 26.50km prej një periudhë kohore 25 minuta.


2.5.6. Siguria në trafik në Komunën e Obiliqit

Kjo analizë ofron të dhëna analitike për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Prishtinës, ku këtu përfshihet edhe Obiliqi. Duke ruajtur trendin e njëjtë të sigurisë rrugore në nivel regjional, paraqesim të dhënat për komunën e Obiliqit, pasi që kjo komunë, në aspektin e qarkullimit, nuk ka ndonjë karakteristikë të veçantë në krahasim me regjionin e Prishtinës në tërësi. Të dhënat janë paraqitur për vitin 2018 dhe për qëllim krahasimi janë përdorur të dhënat nga viti 2017. Gjatë vitit 2018 në regjionin e Prishtinës ka ndodhur gjithsejtë 6493 aksidente trafiku, të ndara sipas pasojave.

Aksidente fatale			Persona të vdekur			Aksidente me lëndime			Persona të lënduar			Aksidente me dëme materiale			Total		
2017	2018	%	2017	2018	%	2017	2018	%	2017	2018	%	2017	2018	%	2017	2018	%
31	34	9.6	35	43	22.8	2347	2185	-6.9	4604	4466	-2.9	5226	4274	-18.2	7604	6493	-14.6

Tabela 30. Krahasimi i aksidenteve për periudhën janar-dhjetor 2017-2018 në regjionin e Prishtinës

Me qëllim të pasqyrimit sa më të mirë dhe njohjen me shkaqet dhe ndikimet e tyre, aksidentet e ndodhura janë ndarë sipas pasojave, vendit (rrugës) dhe ditëve të javës.




	Prishtinë	
Viti	2018	%
Aksidente fatale	34	34
Persona të vdekur	43	33.3
Aksidente me lëndime	2185	35.1
Persona të lënduar	4466	36.1
Aksidente me dëme materiale	4274	45.3
Total	6493	41.2

Figura 10. Krahasimi i aksidenteve për periudhën Janar-dhjetor 2017-2018 në regjionin e Prishtinës

Numri i aksidenteve me fatalitet të Regjionin e Prishtinës, në krahasim me numrin e përgjithshëm të rasteve në nivel vendi, përbën numër relativisht më të madh (41.2%). Sipas karakterit të rrugës aksidentet me fatalitet paraqiten në rrugët magjistrale, rajonale, qytet dhe fshatra. Kjo gjë arsyetohet me shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve.

Duke analizuar të dhënat rezulton se numri më i madh i aksidenteve kanë ndodhur në rrugët urbane (brenda qytetit) 62.7 % e të gjitha aksidenteve. Sipas numrit të aksidenteve në rrugët rajonale kanë ndodhur më së paku aksidente. Duke parë këto të dhëna dhe duke njohur strukturën e qarkullimit në qytet, rezulton se në planifikimet e së ardhmes duhet fokusuar në mbrojtjen sidomos të këmbësorëve për shkak të frekuencës së lartë të aksidenteve. Në aspektin e shpërndarjes kohore brenda javës nuk kemi ndonjë dallim të madh të aksidenteve të ndodhura në ditë të caktuara. Kjo gjë ndërlidhet me dinamikën e lëvizjeve (ditët e punës së administratës, ditë tregu, etj.).



Regjioni i Prishtinës		
Viti	2018	%
Nacionale	1583	24.3
Rajonale	232	3.5
Qytet/Urban	4076	62.7
Fshat/Rural	549	8.4
Të tjera	53	0.8
Gjithësej	6493	

Fig... Krahasimi i aksidenteve për periudhën Janar-dhjetor 2017-2018 në regjionin e Prishtinës

2.5.7. Modelet e qarkullimit të trafikut

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës së Obiliqit realizohet kryesisht përmes transportit rrugor, ndërsa transporti hekurudhor aktualisht nuk është funksional. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale (N2, R-220, R-dhe R-120) dhe rrugët lokale, i mundësojnë komunës së Obiliqit lidhje të mira me kryeqytetin dhe komunat tjera në Kosovë. Modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor. Rrjeti i rrugëve lokale është i pa kategorizuar, pa funksion të qartë dhe dizajn adekuat.

2.5.8. Transportit Urban – linjat transportuese ndër komunale dhe brenda komunës

Transporti publik në qytet dhe ne komune është i bazuar në autobusë. Hapi i mëtejmë nga autobusët lokale dhe urbane në autobusë rajonale është i mundshëm përmes stacionit qendror te autobusëve. Sa i përket mbulueshmërisë, shërbimi i transportit publik me autobus dhe me kombi-bus mbulon rreth 14 vendbanime apo 65% të vendbanimeve të komunës, përderisa në 7 vendbanime apo 35% të vendbanimeve nuk ka transport publik. Shërbimi i transportit publik në territorin e komunës së Obiliqit është në një nivel të kënaqshëm edhe pse nuk zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës. Vendbanimet në të cilat zhvillohet transporti publik janë: Obiliq (Obiliq i Ri dhe Obiliq i Vjetër), Cërkvena Vodicë, Hade, Lajthishtë, Sibovc, Hamidi, Muzakaj, Raskovë, Bakshi, Llazarevë, Breznicë, Kozaricë, Shkabaj, Kryshefc, Shipitullë, Grabofc i Epërm, Plemetin dhe Baimofc. Në komunën e Obiliqit pa transport publik **(për momentin në mungesë të udhëtarëve)** kemi fshatrat Grabofc i Epërm, Shipitullë dhe Hade. Në Grabofc të Epërm nuk zhvillohet transporti publik për shkak të pozicionit (konfiguracionit). Mobiliteti duhet të planifikohet në atë mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në ambient, në njërën anë, ndërsa nga ana tjetër duhet ta rrisë qasshmërinë e qytetarëve në destinacione të dëshiruara, duke ndikuar pozitivisht edhe në sigurinë në trafik dhe në cilësinë e jetës.

DRAFT

2.5.9. Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe modelet e tjera të transportit

Rrugët e qytetit të Obiliqit në kuadër të zhvillimit të transportit (lëvizjeve) karakterizohen me përdorues të ndryshëm:

- Lëvizjet e motorizuara (veturat për përdorim personal dhe autobusët urban) dhe
- Të pa motorizuara (lëvizja e këmbësorëve dhe çiklisteve).

Formë tjetër e transportit- lëvizjeve në kuadër të qytetit nuk realizohet. Duke analizuar dimensionet dhe shtrirjen e rrjetit rrugor të qytetit të Obiliqit, rezulton se në shumicën e gjatësisë së rrjetit përgjatë rrugëve primare prioritet i është dhënë lëvizjeve të motorizuara në kuptimin e akomodimit të lëvizjeve.

Shfrytëzimi i këtyre rrugëve nga lëvizjet e pa motorizuara–këmbësorët, në përgjithësi është adaptuar pjesa e jashtme e rrugës – trotuari, pa marrë në konsideratë madhësinë e fluksit të lëvizjeve si dhe lëvizjet e personave me aftësi të kufizuara. Në shumicën e gjatësisë së trotuareve, paraqiten pengesa fizike konstruktive, automjete të parkuara në mënyrë gjatësore. Edhe përkundër masave të ndërmarra nga organet komunale për ndarje fizike në mes lëvizjeve të këmbësorëve dhe automjeteve përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Obiliqit, përsëri gjerësia e hapësirës së dedikuar është e pamjaftueshme.

2.5.10. Hapësirat për parkim

Në komunën e Obiliqit janë tri parkingje publike dhe disa kënde. Por, duke vlerësuar se, në vitet e fundit Obiliqi ka pasur një rritje të konsiderueshme në përdorimin e automjeteve private. Bazuar në rritjen e shkallës së motorizimit, të dhënat sugjerojnë se kjo rritje është duke vazhduar edhe në ditët e sotme dhe nevoja për parkingje është e nevojshme. Dihet se nivelet e larta të përdorimit të automjeteve shpesh krijojnë probleme si mbingarkesa në trafik, e cila shpesh përkeqësohet në periudhat kulmore. Për këtë arsye paraqitet nevoja për parkingje të reja, të cilat janë të parapara të kryhen vitet në vijim.

2.5.11. Transporti hekurudhor

Nëpër territorin e komunës së Obiliqit kalojnë dy linja të hekurudhave: linja Fushë Kosovë – Mitrovicë me tre stacione hekurudhor si ai në Dardhishtë, Obiliq dhe në Plemetin dhe linja Fushë Kosovë – Pejë me stacionin në Grabofc.

Nga gjithsejtë 20 vendbanime në komunën e Obiliqit, vetëm në 7 vendbanime kalon rruga hekurudhore, apo 35% të vendbanimeve të komunës. Rrjeti hekurudhor- binaret hekurudhor kalojnë nga Kryshefc-Obiliq-Plemetin dhe Grabofc i Epërm.

	Drejtimi	Gjatësia (m)	TOTAL
1	Fushë Kosovë- Mitrovicë	1222.00	7707.40
2	Fushë Kosovë- Mitrovicë	641.40	
3	Fushë Kosovë- Mitrovicë	3199.00	
4	Fushë Kosovë- Mitrovicë	2645.00	
	Fushë Kosovë- Pejë	4110.00	4110.00
	Industriale	571.40	
	Industriale	3940.00	4511.40

Tabela 30 Gjatësia (m) e rrjetit hekurudhor që shtrihet në Komunë të Obiliqit

2.5.12. Transporti Ajror

Në komunën e Obiliqit nuk ka transport ajror por, qytetaret e komunës së Obiliqit për nevojat e tyre e shfrytëzojnë aeroportin e Adem Jashari në Fushë Kosovë i cili është në një distancë prej 26.50 km prej një periudhë kohore 25 minuta.

2.5.13. Transporti urban dhe ndërurban

Transporti publik në qytet dhe ne komune është i bazuar në autobusë. Në nivel të transportit urban, qyteti i Obiliqit është i lidhur me qytetin e Prishtinës përmes linjës së rregullt (Linja nr. 2) nga "Trafiku Urban" i Prishtinës. Ndërsa në nivel ndërurban lidhja e Obiliqit me fshatra realizohet me autobus dhe me kombi-bus. Vendbanimet në të cilat zhvillohet transporti publik janë: Obiliq (Obiliq i Ri dhe Obiliq i Vjetër), Cërkvena Vodicë, Hade, Lajthishtë, Sibovc, Hamidi, Muzakaj, Raskovë, Bakshi, Llazarevë, Breznicë, Kozaricë, Shkabaj, Kryshefc, Shipitullë, Grabofc i Epërm, Plemetin dhe Baimofc. Në komunën e Obiliqit pa transport publik **(për momentin në mungesë të udhëtarëve)** kemi fshatrat Grabofc i Epërm, Shipitullë dhe Hade. Në Grabofc të Epërm nuk zhvillohet transporti publik për shkak të pozicionit (konfiguracionit).

2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

2.6.1. Shëndetësia

Në territorin e komunës së Obiliqit, shëndetësia në sektorin publik është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 6 objekte shëndetësore: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila ndodhet në Obiliq, Qendra Mjekësisë Familjare (QMF) në Milloshevë dhe Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) në Plemetin si dhe 3 punkte ambulantive: Ambulantet e Mjekësisë Familjare (AMF) në Breznicë, Baimofc dhe Sibovc, ndërsa 2 AMF të cilat ndodhen në Shipitullë dhe Cërkvena Vodicë aktualisht janë jofunksionale. Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të mirë. Në Komunën e Obiliqit ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Gjendja shëndetësore e popullsisë në Komunën e Obiliqit është shumë e varur nga indikatorët mjedisor (ndotja e vazhdueshme e tokës, ujit dhe ajrit), ku si pasojë e ekspozimit ndaj tyre , numri i pacientëve me probleme shëndetësore është gjithnjë në rritje. Sipas statistikave të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Obiliqit, në vitin 2018 janë regjistruar 98.149 kontrolle mjekësore, ku:

- janë regjistruar 136.812 shërbime mjekësore,
- janë regjistruar 29 raste të reja me sëmundje malinje.

Sipas Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), prania e sëmundjeve malinje te popullsia e komunës së Obiliqit është 30% më e lartë sesa mesatarja e vendit. Nga të dhënat statistikore të marra nga QKUK dhe spitalet tjera rajonale të Kosovës për grup moshat mbi 18 vjeç, del se në viset e tjera të Kosovës të cilat janë më pak të ndotura, përqindja e sëmundjeve të organeve respiratorë është rreth 14.26%, ndërsa në komunën e Obiliqit është rreth 30%. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se ndotja e ambientit ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në kualitetin e jetës, shëndetin dhe jetëgjatësinë e banorëve të Komunës së Obiliqit. Ndotja e mjedisit në Komunën e Obiliqit ka dhënë edhe efekte tjera shëndetësore negative si: kollitje, sulme astmatike, çrregullime të ritmit të zemrës, çrregullime të shtypjes së gjakut ,sulme në zemër, sulme në tru, lindje të parakohshme me peshë të vogël të frytit, çrregullime të sistemit nervor dhe dëgjimit, etj. Grupet e popullatës më të ndjeshme ndaj ndotjes së ambientit janë: fëmijët, të moshuarit, personat me astma, personat me sëmundje kronike respiratorë, gratë shtatzëna, të porsalindurit dhe fëmijët.

Në territorin e Komunës, në sektorin publik shëndetësia është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 6 objekte shëndetësore, ku një prej tyre është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e cila ndodhet në Obiliq, ndërsa të tjerat janë Qendra të Mjekësisë Familjare të cilat ndodhen në: Milloshevë, Plemetin dhe Ambulant Mjekësore Familjare në Breznicë, Sibovc.

Vendbanimet	Obiliq	Milloshevë	Plemetin	Breznicë	Baimofc	Sibovc
Institucioni	QKMF	QMF	AMF	AMF	AMF	AMF
Viti I themelimit	1989	2018	2001	2020	1992	1979
Lagja/ zona gravituese	Obiliq, Kryshefc, Mazgit, Cërkvena Vodicë	Milloshevë, Bakshi, Raskovë, Llazarevë	Plemetin	Breznicë, Kozaricë	Baimofc	Grabofc, Shipitullë, Hamidi, Sibovc
Numri i banoreve	9,234	4178	1381	1,271	316	1,501
Mjek te përgjithshëm (nr.)	7	1	1	0	1	0
Mjek ne specializim (nr.)	0	0	0	0	0	0
Mjek te specializuar (nr.)	18	1	0	1	1	1
Farmacist (nr.)	1	0	0	0	0	0
Sipërfaqja e parcelës (ha)	0.6	0.08	0.08	0.1	0.05	0.05
Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	0.12	0.03	0.01	0.02	0.012	0.013
Sipërfaqja e lirë (ha)	0.48	0.05	0.04	0.08	0.038	0.037
Sipërfaqja (m^2)	1050	300	100	200	120	130
Etazhiteti (P)	1	1	1	1	1	1
Sipërfaqja e ndërtesës ndihmëse (m^2)	200	0	0	0	0	0
Etazhiteti i ndërtesës ndihmëse (P)	1					
Vendpakingje për vizitor	25	7	4	7	3	5
Vendpakingje për zyrtar	10	3	2	5	2	3
Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)	0.07	0.03	0.02	0.02	0.03	0.015

Tabela 36. Infrastruktura dhe shërbimet sociale dhe publike të shëndetësisë


Ekzistojnë edhe tri AMF tjera në Cërkvena Vodicë, Shipitullë dhe Mazgit, mirëpo, aktualisht janë jashtë funksionit. Në institucionet shëndetësore te nivelit parësor janë të punësuar gjithsejtë 101 punonjës mjekësor.

Specialist të Mjekësisë Familjare	Specialist të Mjekësisë Emergjente	Specialist të Pediatrisë	Specialist të Epidemiologjisë	Specialist të Gjinekologjisë	Specialist të Radiologjisë	Specialist të Shëndetit Oral	Specialist i Biokimisë Klinike	Magjistër i Farmacisë	Specializant të Mjekësisë Familjare	Specializant të Mjekësisë Emergjente	Specializant të Protedeotikës	Doktor të Mjekësisë së Përgjithshme	Doktor të Stomatologjisë	Kuadri i lartë jo shëndetësor	Kuadri i mesëm shëndetësor	Kuadri i mesëm dhe i ulët jo shëndetësor
11	1	2	1	1	1	2	1	1	2	1	2	3	1	2	51	19

Tabela 37. Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet profesionale

Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të konsiderueshme. Gjithashtu, duhet cekur se në këtë territor ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Gjendja e mirë shëndetësore është shumë e varur edhe nga indikatorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.

Nëse bëhet krahasimi i pjesëmarrjes së sëmundjeve respiratorë në sëmundjet e përgjithshme nëpër viset tjera më pak të ndotura të Kosovës, ku sëmundjet e organeve respiratorë të evidentuara në QKUK dhe në spitalet rajonale të Kosovës për grup-moshat mbi 18-vjet është rreth 14.26 %, ndërsa në Obiliq me rrethinë është rreth 30%, atëherë mund të kolaudojmë me siguri se termoelektranat gjatë gjithë këtyre viteve jo vetëm që kanë shkaktuar një ambient të ndotur dhe të dëmshëm, por në mënyrë të drejtpërdrejt kanë ndikuar në kualitetin e jetesës, shëndetin e njerëzve dhe shkurtimin e jetës.



Harta 33. Shtrirja hapësinore e institucioneve shëndetësore

2.6.2. Institucionet arsimore

Sistemi i arsimimit para universitar në komunën e Obiliqit është i organizuar sipas Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulës Bërthamë (e rishikuar në vitin 2016) në katër nivele. Në bazë të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA) edukimi para universitar është i organizuar në katër nivelet vijuese:

1. KNSA 0 - Edukimi parashkollor;
2. KSNA 1 – Arsim Fillor I-V (klasa përgatitore I-II);
3. KSNA 2 – Arsim i mesëm i ultë VI – IX;
4. KSNA 3 – Arsim i Mesëm i Lartë X-XII.

Në komunën e Obiliqit, viti shkollor 2018-2019, arsimimi dhe edukimi është organizuar në shtatë shkolla fillore të mesme të ulëta me nëntë paralele të ndara, që mësojnë në gjuhën shqipe, katër shkolla fillore në gjuhën serbe dhe tri shkolla të mesme të larta, prej tyre dy në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe. Numri i objekteve arsimore publike gjithsej është 24, 1 institucion parashkollor, 20 institucione të arsimit të fillor dhe te mesëm të ultë dhe 3 institucione të arsimit mesëm të lartë. Në dy objekte shkollore mësimin e zhvillojnë nga dy shkolla.

Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin.

Në procesin mësimor gjatë vitit shkollor 2018-2019 janë të përfshirë rreth 5036 nxënës,(184 nxënës romë, të cilët mësojnë në SHF "Sveti Sava" në Plemetin nuk janë raportuar nga kjo shkollë. Mirëpo, numri i këtyre nxënësve është marrë nga OJQ "Balkan Sun Flowers" në Plemetin, Qendra për mësim shtesë.

Raporti nxënës-mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 22 nxënës, mesatarja për një mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në aspektin e përgjithshëm të mësim nxënies kushte janë jo të kënaqshme, sidomos në vendbanimet e thella rurale. Këto objekte shkollore kanë nevojë për investime, renovime, ujësjellës, kanalizim, për rregullim të oborreve dhe të fushave sportive, pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme arsimore.

Institucionet parashkollore

Për fëmijët parashkollor, brenda territorit të komunës është e organizuar një çerdhe publike, IP "Rrita jonë", dhe dy private, të cilat janë "SMILE KID`S "dhe "AKSA- F ".Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin.

Në kuadër të SHFMU zhvillohet mësimi edhe me parashkollor, që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës pesë vjeç. Numri i përgjithshëm i klasave me parashkollor është 14, me 18 paralele me 330 para fillor, me të cilët punojnë 12 edukatorë.

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së institucionit parashkollor publik është 0.2 hektarë, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtuar është 0.15 hektarë me sipërfaqe të përgjithshme të lirë 0.05 hektarë. i përgjithshëm i klasave është 9, gjersa numri i përgjithshëm i edukatoreve është 9.

Vendbanimet	Emri I institucionit	Viti I themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banoreve	Nxënës te regjistruar (nr.)	Edukatore (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja (m^2) e ndërtesës kryesore	Etazhiteti i ndërtesës kryesore (P)	Sipërfaqja e klasave (m^2)	Numri i klasave (nr.)	Vendparkingjet për vizitorë (nr.)	Vendparkingjet për zyrtar (nr.)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)
Obiliq	"Rrita jonë"	1979	Zona urbane	4,802	79	9	0.2	0.07	0.13	730	P	208.1	6	0	0	0.11

Tabela 38. Veçoritë e institucionit të vetëm parashkollor publik

Institucioni parashkollor publik ka 80 fëmijë të regjistruar.

	Emri i institucionit	Vendbanimi	Shqiptarë			Ashkali			Romë	Serb	Gjithsej	Nr. I ndërrimeve
			Mashkull	Femër	Gjithsej	Mashkull	Femër	Gjithsej	M &F	M &F		
1	Rrita Jonë	Obiliq	49	31	80	0	0	0	0	0	80	I

Tabela 39. Numri i fëmijëve në institucionet parashkollore

Shkollat fillore të mesme të ulëta

Në Komunë ekzistojnë 20 institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë ku vijojnë mësimet rreth 3,990 nxënës, ku vijojnë mësimin 3,294 nxënës shqiptarë, 335 serb, 177 ashkali, dhe 184 Rom. Në 11 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, mësimi zhvillohet në 2 ndërrime dhe 9 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta zhvillojnë mësimin në një ndërrim.

Numri i përgjithshëm i klasave (I-IX) është 187, gjersa numri i përgjithshëm i mësimdhënësve është 268.

Shumica e mësimdhënësve me klasat (VI-IX) punojnë edhe në paralelet e ndara e disa edhe në shkolla tjera, për plotësimin e normave. Në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq zhvillohet edhe arsimi joformal (nga klasa I-IX).

	Emri i institucionit	Vendbanimi	Shqiptarë			Ashkali			Romë	Serbë		Nr. i ndërrimeve
			Mashkull	Femër	Gjithsej	Mashkull	Femër	Gjithsej	M &F	M &F	Gjithsej	
1	Naim Frashëri	Breznicë	217	0	217	0	0	0	0	0	217	II
2	Naim Frashëri 1	Kozaricë	74	0	74	0	0	0	0	0	74	II
3	Abdurrrahmon Gërguri	Kryshefc	134	0	134	0	0	0	0	0	134	II
4	Migjeni	Sibovc	162	0	162	0	0	0	0	0	162	I
5	Migjeni 1	Shipitullë	12	0	12	0	0	0	0	0	12	II
6	Migjeni 2	Grabofc	42	0	42	0	0	0	0	0	42	I
7	Hasan Prishtina 1	Milloshevë	718	17	718	17	10	27	0	0	745	I
8	Hasan Prishtina 2	Raskovë	54	0	54	0	0	0	0	0	54	II
9	Fazli Graiçevci	Hade	35	0	35	0	0	0	0	0	35	I
10	Fazli Graiçevci 1	Leshkoshiq	112	0	112	0	0	0	0	0	112	II
11	Fazli Graiçevci 2	Cërkvena Vodicë	47	7	47	7	6	13	0	0	60	I
12	Pandeli Sotiri	Obiliq I Vjetër	242	3	242	3	0	3	0	0	245	I
13	Pandeli Sotiri 1	Plemetin	58	60	58	60	55	115	0	0	173	II
14	Dr. Ibrahim Rugova	Obiliq	1056	9	1056	9	10	19	0	0	1075	II
15	Dr. Ibrahim Rugova 1	Mazgit i Epërm	174	0	174	0	0	0	0	0	174	II
16	Dr. Ibrahim Rugova 2	Mazgit i Ulët	157	0	157	0	0	0	0	0	157	I
17	Millan Rakiq	Baimofc	0	0	0	0	0	0	0	92	92	II
10	BrankoRadiqeviq	Obiliq	0	0	0	0	0	0	0	32	32	I
19	Dositej Obradoviq	Cërkvena Vodicë	0	0	0	0	0	0	0	54	54	I
20	Sveti Sava	Plemetin	0	0	0	0	0	0	184	157	341	II
Gjithsejtë			1660	1634	3294	96	81	177	184	335	3990	

Tabela 40. Institucionet arsimore fillore dhe të mesme të ulëta

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta është 2.037 hektarë, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtuar është 0.493 hektarë me sipërfaqe të përgjithshme të lirë 1.803 hektarë.

Emri i institucionit	Vendbanimi	Viti i themelimit	Numri i banorëve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Etazhiteti	Nr. I klasave	Mësimdhënës (nr.)
"Milan Rakiq "	Baimofc	1981	392	0.360	0.063	0.297	P	5	6
"Naim Frashëri "	Breznicë	1952	1302	0.803	0.073	0.766	P+1	8	24
"Fazli Grajqevci "	Cërkvena Vodicë, paralele e ndarë	1946	733	0.300	0.042	0.279	B+P	7	
"Dositej Obradoviq"	Cërkvena Vodicë	1927	733	0.300	0.150	0.150	P+1	10	4
"Migjeni"	Grabofc, paralele e ndarë	2001	341	0.300	0.026	0.274	P	5	33
"Fazli Grajqevci "	Hade	1962	534	0.673	0.064	0.641	P+1	9	
"Naim Frashëri "	Kozaricë, paralele e ndarë	2002	469	0.300	0.046	0.254	P	6	
"Abdurrahmon Gërguri"	Kryshefc	2002	1053	0.400	0.040	0.360	P	5	15
"Fazli Grajqevci "	Leshkoshiq , paralele e ndarë	1958	703	0.149	0.042	0.108	P	5	
"Dr. Ibrahim Rugova"	(ish -Mazgiti i Epërm)	1969	2886	0.317	0.035	0.282	P	5	
"Dr Ibrahim Rugova"	(ish -Mazgiti i Poshtëm)	2002	2886	1.130	0.037	1.093	P	6	

"Hasan Prishtina"	Milloshevë	1962	1819	1.390	0.413	1.287	B+P+2	24	39
"Dr. Ibrahim Rugova"	Obiliq	1958	6864	0.850	0.526	0.719	B+P+2	21	80
"Pandeli Sotiri "	Obiliq	2010	6864	0.400	0.446	0.177	P+1	22	24
"Pandeli Sotiri "	Plemetin, paralele e ndarë	2009	1381	0.600	0.053	0.547	P	9	
"Sveti Sava"	Plemetin	1950	1381	0.637	0.117	0.578	P+1	8	10
"Hasan Prishtina"	Raskovë, paralele e ndarë	1970	640	0.556	0.034	0.522	P	4	
"Migjeni "	Sibovc	1966	963	0.650	0.080	0.570	P	11	28
"Migjeni"	Shipitullë , paralele e ndarë	1957	291	0.675	0.030	0.645	P	5	
"Branko Radiqeviq"	Obiliq	1958	6864				P+1	6	

Tabela 41. Veçoritë e ShFMU

Emri i institucionit	Vendbanimi	Sipërfaqja e ndërtesës kryesore	Etazhiteti i ndërtesës kryesore	Sipërfaqja e klasave (m^2)	Numri i klasave (nr.)	Sipërfaqja e ndërtesës ndihmëse (m^2)	Etazhiteti i ndërtesës ndihmëse (kate)	Vendparkingje për vizitor (nr.)	Vendparkingje për zyrtar (nr.)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)
"Milan Rakiq "	Baimofc	532	P	40	5	/	/	/	/	/
"Naim Frashëri "	Breznicë	400	P	340	8	40	P	12	/	0.8
"Naim Frashëri "	Kozaricë, paralele e ndarë	280	P	220	5	/	P	/	/	0.7
"Dositej Obradoviq"	Cërkvena Vodicë									
"Migjeni"	Grabofc, paralele e ndarë	448	P	165	5	/	/	/	6	30
"Migjeni "	Sibovc	682	P	290	10	60	P	/	9	8
"Abdurrahmon Gërguri"	Kryshefc	400	P	48	1	/	/	6	1	0.36
"Fazli Grajqevci "	Hade	640	P+1	250	9	32	P	/	/	0.641
"Fazli Grajqevci "	Leshkoshiq , paralele e ndarë	412	P+1	180	6	60	P	7	/	0.108
"Fazli Grajqevci "	Cërkvena Vodicë, paralele e ndarë	415	P+1	140	7	24	P	8	/	0.151
"Dr. Ibrahim Rugova"	Obiliq	5,268	B+P+2	1,232	20	100	P	10	10	1.3
"Dr Ibrahim Rugova"	(ish -Mazgiti i Poshtëm)	408	P	286	6	24	P	5	/	0.9
"Dr. Ibrahim Rugova"	(ish -Mazgiti i Epërm)	586	P	362	10	29	P	5	/	0.02
"Hasan Prishtina"	Milloshevë	4,600	B+P+2	54	24	800	P	0	1	0.8
"Hasan Prishtina"	Raskovë, paralele e ndarë	1,000	P	49	6	/	/	0	1	0.44
"Pandeli Sotiri "	Obiliq	3400	2	56	22	65	P	10	10	0.15
"Pandeli Sotiri "	Plemetin, paralele e ndarë	430	1	56	8	45	P	5	5	0.45
"Sveti Sava"	Plemetin	1172	P+1	44	11	72	P	/	6	0.65
"BrankoRadiqeviq"	Obiliq									

Tabela 42. Veçoritë e ShFMU

Shkollat e mesme të larta

Në komunë ekzistojnë 3 institucione arsimore të mesme të larta ku vijojnë mësimet rreth 1,046 nxënës, 751 nxënës shqiptarë, 157 serbë, 7 ashkali, dhe 131 romë. Në dy shkolla të mesme të larta mësimi zhvillohet në 1 ndërrim dhe një 1 shkollë të mesme të mesme të ultë zhvillojnë mësimin në 2 ndërrime.

	Emri I institucionit	Vendbanimi	Shqiptarë			Ashkali			Rom	Serb	Gjithsej	Nr. I ndërrimeve
			Mashkull	Femër	Gjithsej	Mashkull	Femër	Gjithsej	M &F	M &F		
1	Ismail Dumoshi	Obiliq	291	149	440	5	2	7	0	0	447	I
2	17 Shkurti	Obiliq	90	221	311	0	0	0	0	0	311	I
3	Sveti Sava	Plemetin	0	0	0	0	0	0	131	157	288	II
Gjithsejtë			381	370	751	5	2	7	131	157	1046	


Tabela 43. Institucionet arsimore të mesme të larta

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave të Shkollave të Mesme të Larta është 2.04 hektarë, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtuar është 0.50 hektarë me sipërfaqe të përgjithshme të lirë 1.80 hektarë. Numri i përgjithshëm i klasave është 42, gjersa numri i përgjithshëm i mësimdhënësve është 74.

Emri i institucionit	Vendbanimi	Viti themelimit	Numri banorëve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Etazhiteti	Nr. I klasave	Mësimdhënës (nr.)
"Ismail Dumoshi"	Obiliq	1948	6864	0.700	0.3	0.600	P+2	24	45
"17 Shkurti"	Obiliq	2008	6864	0.700	0.076	0.625	1	10	18
"Sveti Sava"	Plemetin	1988	1381	0.637	0.117	0.578	P+1	8	11

Tabela 44. Veçoritë e ShML

Emri i institucionit	Vendbanimi	Sipërfaqja e ndërtesës kryesore	Etazhiteti i ndërtesës kryesore	Sipërfaqja e klasave (m^2)	Numri i klasave (nr.)	Sipërfaqja e ndërtesës ndihmëse (m^2)	Etazhiteti i ndërtesës ndihmëse (kate)	Vendparkingje për vizitor (nr.)	Vendparkingje për zyrtar (nr.)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)
"Ismail Dumoshi"	Obiliq	3596	P+1	144	24	524	P+0	/	19	1946
"17 Shkurti"	Obiliq	830	P+1	514.5	10	/	/	/	/	/
"Sveti Sava"	Plemetin	/	/	/	/	/	/	/	/	/




Harta 34 Shtrirja e institucioneve shkollore

2.6.3. Administrata publike

Ndërtesat administrative dhe publike janë të përqendruara në pjesën më të madhe në qytetin e Obiliqit si hapësirë urbane. Në këtë qytet janë të shtrira institucionet e nivelit komunal si Kuvendi i Komunës, Objekti i Gjendjes Civile, Shtëpia e Kulturës, Enti i Punësimit, Posta, Stacioni i Policisë.

Objekti / Institucioni	Lokacioni	Sip. e ngastrës	Sip. e zhvilluar	Etazhiteti
Kuvendi Komunale	Obiliq	0.40	0.20	P+2
Objekti i gjendje civile	Obiliq	0.05	0.04	P+1
Enti i punësimit	Obiliq	0.05	0.04	P
Qendra për punë sociale	Obiliq	0.10	0.05	P
Objektet policore	Obiliq	0.10	0.10	P+1
Posta	Obiliq	0.13	0.10	P
Zyre e gjendjes civile	Mazgit	0.03	0.03	P

Tabela 45. Institucionet administrative



Harta 35. Shtrirja e institucioneve administrative

2.6.4. Mirëqenia sociale

Sa i përket mirëqenies sociale, në komunë jetojnë gjithsejtë 179 të cilët pranojnë përkujdesje sociale.

Kategoritë sociale	Numri i personave në nevojë
Fëmijë pa përkujdesje prindërore	15
Fëmijë me sjellje asociale	35
Delikuentë të mitur	35
Persona me marrëdhënie te çrregulluara në familje	36
Persona të moshës së shtyrë	2
Persona me sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike	6

Persona me aftësi të kufizuara mendore	4
Persona me sëmundje mendore	5
Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi	8
Viktima të dhunës në familje	1
Viktima të trafikut të qenieve njerëzore	1
Persona me varësi nga alkooli ose drogat	0
Viktima të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu	31
Gjithsejtë	179

Tabela 46. Numri i personave ne nevojë për përkrahje sociale

Sa përket institucioneve të përkujdesjes sociale në Komunë ka Agjencinë e Punësimit, Qendrën për Punë Sociale dhe Shtëpinë e Pleqve me kapacitet prej 4 shtretërve.

Institucionet	Sipërfaqja e ndërtuar (m^2)
Agjencia Punësimit	308m^2
Qendra për Punë Sociale	330m^2
Shtëpia e Pleqve	170m^2
Gjithsejtë	808m^2

Tabela 47. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, kapacitetet profesionale, 2018

2.6.5. Objektet e kulturës

Në Komunë ka gjithsejtë 8 institucionet kulturore Në nivel komunal, institucionet kulturore përbëhen prej:

- Shtëpia e Kulturës "Xhavit Haziri"
- Biblioteka e Qytetit
- Qendra Rinore
- Ansambli I Qytetit
- Shtëpia e Kulturës
- Qendra Kulturore Rinore
- Shtëpia e Kulturës
- Biblioteka Lokale

Vendbanimet	Institucioni	Viti I themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri I banoreve	Numri I zyrtareve (nr.)	Vendparkingje për vizitorë	Vendparkingje për zyrtarë
OBILIQ /01	Shtëpia e Kulturës "Xhavit Haziri	2019	Sheshi"Dëshmorët e Kombit"	6,864	2	25	0
OBILIQ/02	Biblioteka e Qytetit	2020	Rr."Rasim Hashani"	6,864	1	20	4
OBILIQ/03	Qendra Rinore	2011	Rr."Hasan Prishtina"	6,864	3	15	0
OBILIQ/04	Ansambli I Qytetit	2020	Shtëpia e Kulturës "Xhavit Haziri"	6,864	3	0	0
MILLOSHEVË/05	Shtëpia e Kulturës	1928	" Prapashtica"	1,819	7	6	0
PLEMETIN/06	Qendra Kulturore Rinore	2005	"Kosovka Devojka"	1	1	0	0
BABIMOST/07	Shtëpia e Kulturës	2006	Bamimost	392	1	0	0
BREZNICË/08	Biblioteka Lokale	1984	Rr."Hoxhë Breznica"	1,302	1	0	0

Tabela 48. Veçoritë e institucioneve kulturore

Institucioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtesës kryesore (m^2)	Etazhiteti i ndërtesës kryesore (P)	Sipërfaqja e zyrave (m^2)	Numri i zyrave (nr.)	Sipërfaqja e sallave ekspozuese (m^2)	Numri i sallave ekspozuese (nr.)	Numri i sallave audio-vizive (nr.)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)
Shtëpia e Kulturës "Xhavit Haziri	0.55	0.08	0.46	1,552	P+1	810	3	103	3	1	1,505	0.08

Biblioteka e Qytetit	0.11	0.02	0.09	375	P+1	366	6	40	4		340	0.02
Qendra Rinore	0.07	0.04	0.03	375	1	30	1				90	0.04
Ansambli I Qytetit								170	1			
Shtëpia e Kulturës	0.41	0.39	0.02	270	1	100	3	180	1		3,592	0.39
Qendra Kulturore Rinore	0.42	0.24	0.18	240	1	60	2	180	1		2,420	0.24
Shtëpia e Kulturës	0.88	0.02	0.86	180	1	80	1	100	1		1,520	0.02
Biblioteka Lokale	1.01	0.02	0.99	140	1	40	2	100	1		9,561	0.02

Tabela 49. Veçoritë hapësinore të institucioneve kulturore

2.6.6. Objektet e rinisë, sportit dhe rekreacionit

Në komunën e Obiliqit ekziston një infrastrukturë relativisht e mirë për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Ekzistojnë gjithsej 7 fusha publike sportive, ku 3 prej tyre janë në qytetin e Obiliqit me një sipërfaqe totale prej 15,000 m2. Në qytet po ashtu ekziston edhe halla sportive me sipërfaqe prej 4000 m^2, një sallë e edukatës fizike prej 450m2, si dhe 2 poligone me sipërfaqe totale prej 1600 m^2. Përveç kësaj, ekziston edhe një infrastrukturë private sportive, duke përfshirë qendrën trajnuese Katana me hapësirë 1800m2 si dhe 2 "ballon salla të mbyllura", një në Milloshevë dhe një në Raskovë në sipërfaqe nga 800m2 secila. Ekzistojnë po ashtu edhe Poligonet sportivë nëpër 8 shkolla (Obiliq, Breznicë, Baimofc, Plemetin, Raskovë, Sibovc, Cërkvena Vodicë dhe Hade), secila me një hapësirë prej 800m2. Përveç stadiumit, aktualisht mungojnë fushat sportive të lojërave me top dhe sporteve të tjera në natyrë. Jeta sportive është e organizuar dhe zhvillohet në kuadër të 12 klubeve sportive dhe tri shkollave private. Klubet Sportive janë:

1. Klubi i Futbollit KEK-u;
2. Klubi i Hendbollit KEK-u (vajza);
3. Klubi i Hendbollit KEK-u(meshkuj);
4. Klubi i Basketbollit;
5. Karatesë;
6. Futsallit;
7. Notit;
8. Klubi i Hendbollit "Verona"(vajza);
9. Klubi i Boksit;
10. Klubi i Skijimit;
11. Klubi i Pikturave dhe Muzikës;
12. Klubi Paraglajding, si dhe
13. 3 Shkolla private të futbollit "KEK-u", "Urbano", dhe "Ardhmëria".

Vendbanimet	Institucioni	Viti I themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri I banoreve	Numri I zyrtareve (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)
Obiliq	Palestra Sportive Adem Jashari	2015	Tërë Komuna	6864	2	0.71	0.31	0.4
Obiliq	Stadiumi Agron Rama	1940	Tërë Komuna	6864	0	8.22	3.95	4.27
Obiliq	Stadiumi në Milloshevë	2000	Tërë Komuna	1819	0	0.79	0.79	0
Obiliq	Stadiumi në Raskovë	2000	Tërë Komuna	640	0	1.73	0.67	1.06

Tabela 50 Veçoritë e objekteve të rinisë, sportit dhe rekreacionit

Vendbanimet	Institucioni	Sipërfaqja e ndërtesës kryesore	Etazhiteti i ndërtesës kryesore	Sipërfaqja e zyrave	Numri i zyrave (nr.)	Sipërfaqja e sallës sportive (m^2)	Sipërfaqja e sallës ndihmëse (m^2)	Vendparkingje për vizitor (nr.)	Vendparkingje për zyrtar (nr.)
Obiliq	Palestra Sportive Adem Jashari	4,000	P	29	2	1,535	152	15	60
Obiliq	Stadiumi Agron Rama	/	P	/	/	/	/	5	30
Obiliq	Stadiumi në Milloshevë	/	P	/	/	/	/	/	/

DRAFT

Obiliq	Stadiumi në Raskovë	/	P	/	/	/	/	/	/

Tabela 51 Veçoritë hapësinore të objekteve të rinisë, sportit dhe rekreacionit

Përveç stadiumit aktualisht mungojnë fushat sportive të lojërave me top dhe sporteve të tjera në natyrë, mungojnë pishinat. Në Komunë aktualisht ka gjithsejtë 9 hapësira publike rekreative të hapura që mbulojnë një sipërfaqe prej 23,850 m².

Nr.	Fushat sportive	Vendi	Numri i fushave sportive	Sipërfaqja në m²
1.	Fusha sportive	Obiliq	3	15000 m²
2.	Fusha sportive	Milloshevë	1	500 m²
3.	Fusha sportive	Baimofc	1	500 m²
4.	Fusha sportive	Plemetin	1	500 m²
5.	Fusha sportive	Raskovë	1	500 m²
6.	Ballon salla	Plemetin	1	800 m²
7	Poligoni sportiv	Obiliq	2	1600 m²
8.	Halla sportive	Obiliq	1	4000 m²
9.	Salla e edukatës fizike	Obiliq	1	450 m²

Tabela 52. Hapësira publike të hapura rekreative

Në komunë aktualisht ka gjithsejtë 3 hapësira private rekreative të mbuluara që mbulojnë një sipërfaqe prej 3,400 m².

Nr.	Fushat sportive ekzistuese:	Vendi	Numri i fushave sportive	Sipërfaqja në m²
1.	Qendra trajnuese "Katana"	Obiliq	1	1800 m²
2.	Ballon salla e mbyllur	Milloshevë	1	800 m²
3.	Ballon salla e mbyllur	Raskovë	1	800 m²

Tabela 53. Hapësira private të mbuluara rekreative

Në komunë aktualisht ka gjithsejtë 13 poligone sportive (Obiliq, Breznicë, Baimofc, Plemetin, Raskovë, Sibovc, Cërkvena Vodicë, Hade, Leshkoshiq, Kryshefc, dhe Llazarevë) në kuadër të infrastrukturës së objekteve shkollore që mbulojnë një sipërfaqe prej 9,600m².

2.6.7. Hapësirat publike dhe parqet publike

Hapësirat publike në Komunën e Obiliqit janë të shtrira në disa kategori si parqe, sheshe, varreza dhe gjelbërim përgjatë rrugëve si dhe oaza të gjelbra.

Në zonën urbane ka gjithsejtë 9 hapësira të hapura publike me sipërfaqe të përgjithshme prej 5.14 ha.

Lloji i hapësirës publike	Hapësirat e gjelbërta	Hapësirat me kubëza	Fusha Sportive	Hapësirat e lodrave	Totali m²	Vendparkingje për vizitor	Vendparkingj e për zyrtar
Parku te rruga 17 shkurti	6,036	1,902	296	377	8,611	5	0
Parku te lapidari Ferid Curri	10,771	2,793	554	390	14,508	10	0
Parku te ish banesat e Hades	1,657	170	0	0	1,827	8	0
Parku te banesat e Kuqe	529	232	0	0	761	10	0
Parku te rruga Faruk Begolli	303	150	0	0	453	20	0
Parku te palestra Adem Jashari	2,083	387	0	0	2,470	25	5
Parku te ish restoranti i KEK-ut	2,150	1,061	0	0	3,211	7	0
Sheshi Dëshmorët e Kombit	1,856	6,644			8,500	4	0
Sheshi Adem Preniqi	11,100				11,100	7	0
Gjithsejtë	**36,485**	**13,339**	**850**	**767**	**51,441**	**88**	**5**


Tabela 54. Hapësirat publike në zonën urbane

Në zonën urbane ka gjithsejtë 9 hapësira të hapura publike me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.98 ha.

Lloji i hapësirës publike	Hapësirat e gjelbërta	Hapësirat me kubëza	Fusha Sportive	Hapësirat e lodrave	Totali m²	Vendparkingje për vizitor	Vendparkingje për zyrtar
Parku të shkolla në Mazgit	6,475	1,508	489	404	8,876	3	0
Parku nen Hekurudhe	2,472	1,423	0	0	3,895	5	0
Parku te Shtëpia e Kulturës Milloshevë	1,476	622	0	0	2,098	4	0
Parku te lagjja e Hashanëve	6,853	1,587	0	0	8,440	5	0
Parku në fshatin Llazarevë	1,522	922	0	0	2,444	6	0

Parku në fshatin Palaj	1,094	505	0	0	1,599	13	0
Sheshi Aziz Zhilivoda	965	822	0	0	1,787	4	0
Parku në Plemetin	456	211	0	0	667	2	0
Gjithsejtë	**21,313**	**7,600**	**489**	**404**	**29,806**	**40**	**0**

Tabela 55. Hapësirat publike në zonën rurale



Harta 36. Hapësirat rekreative-sportive


2.6.8. Objektet e religjionit dhe varrezat

Në Komunën e Obiliqit sipas regjistrimit të fundit të popullsisë mbi 95 % e popullsisë i përkasin religjionit Islam dhe si e tillë numri i xhamive është 14, dy Kisha Ortodokse dhe dy tyrbe.

Vendbanimet	Objektet religjioze	Sipërfaqja (m^2)
Obiliq	Kisha në Obiliq	**~3508.24 m^2**
	Xhamia në Qendër	**~2717.85 m^2**
	Xhamia në lagjen e Hashanëve	**~853.83 m^2**
Mazgit i Ulët	Xhamia e fshatit	**~2075.03 m^2**
Mazgit i Epërm	Tyrbja e Sulltan Muratit	**~3440.04m^2**
	Tyrbja e Bajraktarit (Gazi Pashës)	**23 (ha)**
	Xhamia e Fshatit	**~1258.59 m^2**
Hade	Xhamia në Hade	**~836.37m^2**
Hamidi	Xhamia (nga shek.-XVIII)	**~1470.24m^2**
Sibovc	Xhamia e Fshatit	**~344.17m^2**
Grabofc	Xhamia e Fshatit	**~1052.62m^2**
Milloshevë	Xhamia (nga shek.-XVIII)	**~374.65m^2**
	Xhamia e Fshatit	**~1944.67 m^2**

Baimofc	Kisha ortodokse	**~1829.05m ²**
Breznicë	Xhamia e Fshatit	**~927.10m ²**
Plemetin	Kisha ortodokse	**~385.76 m ²**
	Xhamia e Fshatit	**~4113.16m ²**
Dardhishtë	Xhamia e fshatit	**~896.84m ²**
Bakshi	Xhamia e fshatit	**~963.81m ²**
Kozaricë	Xhamia e fshatit	**~902.59m ²**
Raskovë	Xhamia e Fshatit	**~791.30m ²**
Lajthishtë	**Xhamia e Fshatit**	**~1456.75m²**

Tabela 56. Objektet religjioze në vendbanime




Harta 37. Shtrirja e objekteve religjioze dhe varrezave

Në komunë aktualisht shtrihen gjithsejtë 20 hapësira të varrezave në 14 vendbanime të ndryshme që mbulojnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 19.42 ha.

Baimofc	Breznicë	Cërkvena Vodicë	Grabofc i Epërm	Plemetin	Hade	Hamidi	Kryshefc	Leshkoshiq	Mazgit	Millosheve	Obiliq	Raskovë	Sibovc	Gjithsejtë
0.75	0.8	1.48	0.16	3.05	1.4	0.50	0.75	0.9	1.75	0.78	6.85	0.15	0.65	15.98

Tabela 57. Vendbanimet me varreza dhe sipërfaqja e tyre (ha)



Harta 38. Shtrirja e varrezave

2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

2.7.1. Mjedisi

Komuna e Obiliqit është njëra ndër komunat me mjedis më të ndotur në Kosovë. Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", ngrohtorja, thertorja. Gjatë prodhimit të energjisë elektrike në termocentrale vjen deri te djegia e thëngjillit me ç 'rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe në formë të ujërave pas proceseve teknologjike.

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i imitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit. Mostrajtimi i ujërave nga procesi teknologjik, ujërave që rrjedhin nga minierat sipërfaqësore, gjendja jo e mirë e rezervarëve dhe baseneve të ujërave fenolike dhe fenolit të koncentruar në zonën e gazifikimit dhe shpëlarja e tokës nga të reshurat atmosferike, në tërë zonën e KEK-ut, e cila gjatë kohës është ndotur me fenole, shkakton në masë të madhe ndotjen e lumit Sitnica, me theks të veçantë me fenole. Probleme shtesë janë edhe deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milionë tonelata hi, duke uzurpuar kështu rreth 242 ha tokë punuese, deponia nga TC "Kosova-A" dhe 150 ha deponia TC "Kosova-B", si dhe gropat e hapura gjatë mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit.

Aktivitetet minerare dhe gjenerimi i energjisë elektrike në të kaluarën, por edhe tani shkaktojnë ndotje të ashpër të mjedisit, ajrit, ujit, tokës, imitime të zhurmës dhe degradim të biodiversitetit natyror në territorin e Komunës. Ndotja e mjedisit karakterizohet edhe nga aktivitet urbane siç janë trafiku në komunikacion, menaxhimi joefikas i planifikimit hapësinor të territorit, trajtimi i ujërave të zeza-sanitare, si dhe menaxhimi jo i mirë i mbeturinave komunale.

Erozioni	Tërmetet	Vërshimet	Rrëshqitjet	Zjarret pyjore	Zjarret fushore	Gjithsejtë
/	/	1.5	/	358.5	289.5	360

Tabela 58. Fatkeqësitë natyrore sipas kategorive kryesore (ha)

2.7.1.1. Ndotja e ajrit

Zonat me ndotje më të madhe të ajrit në komunë janë në rreze prej 8 km nga zona industriale dhe përfshinë këto vendbanime: Kryshefc, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Cërkvena Vodicë dhe Lajthishtë. Procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga termoelektranat përcillet me emision të pluhurit dhe gazrave siç janë: SO2, NOX, CO, CO2, H2S, bloza, thërrmijat ajrore sendimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj).

Dëmtimi i shëndetit zakonisht rritet me rritjen e nivelit të imitimit dhe kohëzgjatjen e ndotjes së ambientit. Pra, edhe imitimet afatshkurtra të koncentrimeve të mëdha të ndotësve, si dhe imitimi afatgjatë me përqendrime të vogla në ajër mund të shkaktojnë çrregullime të caktuara të shëndetit të popullatës. Sipas mendimit të disa ekspertëve të mjekësisë sociale, veprimi afatgjatë i materieve të dëmshme me përqendrim të vogël paraqet rrezik më të madh për shëndetin e njerëzve për arsye se përqendrimet e vogla tolerohen për shkak të mungesës së paraqitjes dramatike të sëmundjeve dhe vdekshmërisë, ndërsa veprimet afatshkurta të këtyre dëmtueseve vërehen menjëherë dhe për pasojë edhe ndërmarrja e masave mbrojtëse është më e shpejtë. Gjatë procesit të djegies së qymyrit përveç imitimit të ndotësve të njohur si pluhur fluturues, thërrmija të pluhurit, SO2, NOx, blozë etj., ato emitojnë edhe grimca organike kancerogjene (hidrokarburet policiklike), grimca të metaleve të rënda (merkur, plumb, arsen etj.).

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze. Burimet e ndotjes së ajrit në territorin e Komunës janë:

- Ndotja e ajrit nga aktivitetet minerare dhe minierat e qymyrit (linjitit);
- Ndotja e ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në TC-A dhe TC-B;
- Ndotja e ajrit nga deponimi i hirit dhe;
- Ndotja e ajrit nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse banesore.
- Në Obiliq janë tri pika monitoruese që matin cilësinë e ajrit, janë në monitorim të institutit hidrometeorologjik të Kosovës dhe publikohen në ueb-faqe AMMK.

Instituti INKOS bënë matjet dhe paraqet pasqyrën mbi gjendjen mjedisore në disa pika të për caktuara, gjegjësisht përqendrimin e emisioneve (ndotësve kryesor) në ajër, përfshirë SO2, blozën, thërrmijat ajrore dhe pluhurin e depozituar (sendimentet), të cilat raportohen në KEK.

Ndotësi	Obiliq	Dardhishtë	Palaj
PM 2.5 (µg/m3)	21.43	20.97	**13.20**
PM 10 (µg/m3)	29.83	**30.42**	**18.21**
CO (Monoksidi I Karbonit)	1.55	**2.03**	**0.25**
SO2 (Dyoksidi I Sulfurit)	14.62	14.81	**12.13**

Tabela 59. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj në vitin 2022

Nuk ka matje të vazhdueshme mbi NOx-in. Nga të dhënat e pasqyruara nuk mund të konsiderohen si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit. Sipas Memorandumit për themelimin e Unionit Energjetik (Memorandumi i Athinës), i nënshkruar edhe nga Kosova (22 mars 2005), kërkesat e Direktivës 2001/80/EC duhet të përmbushen deri më 31 dhjetor 2017.

Emisionet aktuale të termocentraleve të KEK-ut sipas direktivës 2001/80/EC duhet të arrihen sipas standardeve të cekura në tabelën në vijim.

Ndotësi	Limiti	Të arrihet
Pluhur	50	**31 dhjetor 2017**
SO2	400	**31 dhjetor 2017**
NOx	500	**31 dhjetor 2017**

Tabela 60. Emisionet aktuale të termocentraleve të KEK- ut

2.7.1.2. Ndotja e ujit

Territorin e Komunës së Obiliqit e përshkojnë ujërat e lumenjve Sitnica, Llapi dhe Drenica. Shkalla e ndotjes së lumenjve në komunën e Obiliqit është e lartë e sidomos e lumit Sitnica si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industrialë. Shkalla më e lartë e ndotjes së lumenjve të Kosovës është ajo e lumit Sitnica që tejkalon vlerat maksimale dhe bën pjesë në shkallën e IV të ndotjes. Nga proceset teknologjike lirohen: nitratet, nitritet, kloruret, amoniaku, vlera e lartë e PH, fenole etj. Shkallën e ndotjes e rrit edhe shkarkimi i ujërave të zeza që përcillen nga komunat tjera si e Prishtinës, Fushë Kosovës, Lipjanit, Drenasit, Obiliqit si dhe vendbanimeve rurale që shtrihen përgjatë shtratit të lumit Sitnica.

KEK– u është ndër ndotësit kryesor të ujërave në Sitnicë. Pasojat e ndotjes së ujërave sipërfaqësor janë prezentë në vendbanimet që shtrihen përgjatë shtratit të lumit Sitnica. Ndotja është prezent edhe në ujërat nëntokësore e sidomos tek puset që përdoren nga popullata lokale dhe kështu rrezikon shëndetin e saj. Pasojat janë të mëdha edhe në vet rrjedhën lumore duke ndikuar negativisht për arealin e saj. Edhe lumi Llap është po ashtu i ndotur, me shkallë IIb nga shkarkimi i ujërave të zeza nga komuna e Podujevës dhe fshatrat përgjatë lumit Llap.

Kategoria	Grabofc - Lumi Drenica	Obiliq – Lumi Sitnica
Vlera E pH (mg) l	8.12	8.50
Nitritet, (mg) l	0.062	0.092
Nitratet (mg) l	1.60	1.80
Hekuri (mg) l	0.20	0.14
Fenolet (mg) l	0.002	0.014

Tabela 61. Matjet e ndotjes së ujërave sipërfaqësor në Grabofc dhe Obiliq

Çdo banor shkarkon 16.46m³ ujëra të zeza. Shkarkimi i ujërave të zeza vetëm në qytezën e Obiliqit është 87238 m³/në vit ose rreth 3 l/s. Rreth 5300 banorë të qytezës së Kastriotit kanë qasje në kanalizimin e ujërave fekale duke liruar kështu rreth 190 mg/l trupa të ngurtë. Në mungesë të të dhënave nuk janë llogaritur objektet industriale.

Lumi Sitnica ndotet nga ujërat e zeza, ku ndotja më e lartë vjen nga vendbanimet:

- Dardhishtë;
- Obiliq;
- Milloshevë; dhe
- Mazgit.

Lumi Sitnica ndotet nga ujërat e zeza, ku ndotja më e lartë vjen nga vendbanimet:

- Milloshevë;
- Raskovë; dhe
- Bakshi.

Në bazë të strategjisë për trajtimin e ujërave të zeza e punuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Ujërave, janë dhënë dy variante për trajtim të ujërave të zeza:


1. Varianti 1
   - Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza sipas të cilit çdo qytet /fshat e ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza; dhe
2. Varianti 2
   - Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm një impiant trajtues të ujërave të zeza në secilën prej shtatë kompanive regjionale ujore ku më vonë mund të kyçen edhe zonat rurale për rreth impiantit. Në këtë variant komuna e Obiliqit parashihet të përfshihet në impiantin regjional të Prishtinës, ndërtimi i të cilit parashihet në mes të fshatit Kuzmin dhe Bresje në komunën e Fushë Kosovës.

Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, ndotjen dhe degradimin e lumenjve e shkaktojnë edhe mbeturinat që i hedhë popullata lokale në shtretërit e lumenjve, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpëlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, objektet industriale etj.

Sa i përket ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor, 60.45% të sipërfaqes janë të ndjeshmërisë së mesme të ujërave nëntokësor.

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Përqindja %
Ndjeshmëri shumë e ulët e ujërave nëntokësorë	937.02	8.98%
Ndjeshmëri e ulët e ujërave nëntokësorë	128.14	1.23%
Ndjeshmëri e mesme e ujërave nëntokësore	6310.3	60.46%
Ndjeshmëri e lartë e ujërave nëntokësorë	208.28	2.00%
Ndjeshmëri shumë e lartë e ujërave nëntokësorë	2853.49	27.34%

Tabela 62. Ujërat nëntokësor sipas shkallës së ndjeshmërisë



Harta 39 Ndjeshmëria mjedisore e ujërave (GWS)[15]

[15] GWS nënkupton Groundwater Sensitivity, Ndjeshmëria e Ujërave Nëntokësor

2.7.1.3. Ndotja e tokës


Toka është e degraduar nga prania e deponive të hirit kryesisht në Kryshefc, kurse tjetra në Plemetin me sipërfaqe rreth 300 Ha, mirëpo deponi të tilla gjenden edhe në: Hamidi, Mirash, Obiliq i Vjetër, Cërkvena Vodicë, prandaj sipërfaqja e tërësishme e tokës së degraduar nga deponitë e hirit (termocentralet dhe mihjet sipërfaqësore) arrin rreth 500 Ha.

Nga mihja sipërfaqësore e Mirashit, ndotja e mjedisit bëhet kryesisht nga djegia e brendshme e thëngjillit, kështu që lirohen gazra kimikë të cilët kanë qenë në përbërje të thëngjillit. Si pasojë e kësaj dukurie formohen mjegulla të dendura sidomos në periudhat me lagështi të madhe të ajrit. Ndotja e mjedisit në territorin e komunës është e përditshme, ndërsa shkalla e ndotjes varet nga kapacitetet që janë në prodhim gjatë ditës. Disa ndotës i tejkalojnë vlerat e përqendrimit mesatar të lejuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe rrezikojnë shëndetin publik të banorëve të komunës. Përveç ndotjes industriale kemi edhe ndotjen urbane: mbeturinat e ngurta (Obiliqi i Ri dhe Obiliqi i vjetër), ujërat e zeza nga kanalizimet, transporti me lirimin e gazrave nga automjetet e vjetruara. Bartja dhe grumbullimi i organizuar i mbeturinave në deponinë qendrore është në shërbim të 43 % të banorëve të komunës.

2.7.1.4. Ndotja nga zhurma

Burimet e zhurmës janë:

- Zhurma që krijohet nga aktivitetet minerare dhe transporti i thëngjillit, pajisjet për eskavim dhe transport dhe shiritat bartës;
- Rruga që qon në miniera, kryesisht shkaktohet nga kamionët për miniera dhe ata që bartin mbeturina, por edhe nga transporti i punëtorëve;
- Shiritat transportues të linjitit;
- Zhurma operative e "TC A", si termocentral;
- Zhurma në termocentral vjen nga shiritat bartës, pajisjet thërrmuese, ndezësit, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat, kullat ftohëse dhe oxhaqet;
- Dy llojet e fundit të burimeve të zhurmës janë pasojë e drejtpërdrejt e punëve aktuale të palosjes së hirit dhe mund të modifikohen ose largohen me aplikimin e koncepteve alternative të deponimit të hirit.




Harta 40. Ndjeshmëria mjedisore e tokës (ELS)[16]

[16] ELS nënkupton Environmentally Sensitive Land, Ndjeshmëria Mjedisore e Tokës

2.7.2. Sipërfaqet me rrezikshmëri

2.7.2.1. Vërshimet

Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj : Sitnica, Drenica dhe Llapi.



Harta 41. Sipërfaqet ujore dhe vërshimet

Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jaze 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe këneta 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Kastrioti, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Plemetini dhe Hamidija.

Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap. Përveç faktorëve natyror edhe faktori njeri ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet përmes disa aktiviteteve si :

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve)
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë rritura pran brigjeve të lumenjve etj.
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

2.7.2.2. Erozioni


Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime. Rreth 6.000 km² ose 56 % e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga kjo dukuri natyrore që i takon shkallës së I, II, III të erozionit, (I erozion shumë i fortë, II erozion i fortë dhe III erozion i mesëm).

Vetëm në pellgun e Sitnicës nën ndikim të erozionit janë rreth 1.400 km² ose rreth 48 % e sipërfaqes së pellgut të lumit (kategoria I, II, III). Edhe në territorin e komunës së Obiliqit është prezent dukuria e erozionit që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonomitë familjare. Në bazë të analizave të paraqitura në hartë janë ndarë këto kategori të erozionit.

Në bazë të të dhënave, nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë erozive janë përfshirë rreth 535 ha ose 6 % e sipërfaqes së territorit të komunës, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri.

Nr.	Përshkrimi	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja %
1	Pa erozion	4996.30	47.66%
2	Erozion shumë I dobët		
3	Erozion i dobët		
4	Erozion shumë i fortë	4951	47.23%
5	Erozion i fortë	381.76	3.64%
6	Erozion shumë i fortë	153.37	1.47%

Tabela 63. Sipërfaqet dhe përqindja e territorit e rrezikuar nga erozioni



Harta 42. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit

2.7.2.3. Rrëshqitja e tokës

Në territorin e komunës së Obiliqit nga rrëshqitja e tokës (dheut) janë të prekura zonat rreth KEK-u si fshati Hade, Lajthishte, Sibovc, Shipitullë, Baimofc, Hamidi.

2.7.2.4. Tërmetet

Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikrosizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore. Sizmika - Kosova i nënshtrohet lëvizjeve tektonike vertikale dhe është në një zonë aktive sizmike të shtrirë përgjatë Rripit Orogjenik - Alpine - Himalaje. Në hartën e më poshtme, si në hartën 9, paraqiten zonat me shkallë sizmike në Kosovë bazuar në magnitudat që janë vëzhguar deri me tani me epiqendrat e tërmeteve të regjistruara gjatë periudhës një shekullore. Regjistrimet historike tregojnë se kanë ndodhur 534 tërmete, prej tyre 82 të intensitetit më të madh se 6° MSK (kategori sipas shkallës së Merkalit), 12 të intensitetit >7° MSK, 10 të intensitetit >8° MSK dhe 3 të intensitetit >9° MSK.

Harta 43. Shtrirja e zonave sizmike dhe të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës

2.7.2.5. Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot-spotet)

Kosova A dhe B - Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", Gjatë prodhimit të energjisë elektrike në termocentrale vjen deri te djegia e thëngjillit me ç 'rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe në formë të ujërave pas proceseve teknologjike.

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i imitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit.

Deponia e Mirashit - Kjo deponi e mbeturinave është regjionale dhe mbeturinat sillen nga Prishtina, Podujeva, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi. Deponia lëshon erëra të rënda dhe ndikon negativisht në gjendjen e ambientit. Kjo është konstatuar edhe nga ana e eksperteve te Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit ne Kosovë. Në pjesën dërmuese të kohës mbeturinat digjen duke shkaktuar tym të vazhdueshëm. Komuna e Obiliqit ka kompetenca për të obliguar përgjegjësit e deponisë që shkalla e mirëmbajtjes së saj të brendshme të jetë në përputhje me standardet e kërkuara duke pamundësuar kësisoj ndezjen e mbeturinave dhe shpërndarjen e tyre jashtë diametrit të deponisë.





Foto 6. Deponia e mbeturinave, Mirash

Foto 7. Deponia e mbeturinave, Mirash

2.7.2.6. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Zonat malore në fshatin Kozaricë, Breznicë, Shipitullë, Sibovc, Grabofc si dhe korporata e KEK-ut që paraqet rrezik permanent për shfaqjet e zjarrit.

2.7.2.7. Diellosja

Në Komunën e Obiliqit ka ekspozicion qendror si Komunë ku dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, perëndimin dhe pjesa qendrore e komunës është pjesë fushore që shtrihet rreth Lumit Sitnica . Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç në lindje dhe perëndim ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit Komunës së Obiliqit është i ndryshueshëm dhe i pa eksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dhe hedhja e mbeturinave rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore. Diellosja (insolacioni)është e rëndësishme për botën e gjallë (bimët, kafshët, njerëzit), për bujqësi, turizëm, shëndetësi etj. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), reliefi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat. Në gjerësitë tona gjeografike (42-43 shkallë) diellosja vjetore do të duhej të zgjaste 4450-4460 orë në vit ose 12,20 orë në ditë.

Në të vërtetë diellosja në Kosovë zgjatë 2079 orë ose 5,7 orë në ditë, që është 47% nga diellorja e mundshme. Diellosja më e vogël është në viset malore dhe afër tyre dhe gjatë muajve të dimrit. Diellosja në muajin dhjetor është mesatarisht 54 orë gjithsej ose 1,7 orë në ditë, kurse gjatë muajve të verës (mbi 250 orë në muaj ose 8,3 orë në ditë). Diellosja është diçka më e lartë në Rrafshin e Kosovës se të Dukagjinit, sepse malet në Rrafshin e Kosovës janë më të ulëta se në Rrafshin e Dukagjinit.

2.8. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE, NATYRORE DHE TURISTIKE

2.8.1. Asetet e trashëgimisë natyrore

Përpos vlerave të larta të kulturës së trashëguar materiale e shpirtërore dhe trashëgimisë arkitektonike, komuna e Obiliqit karakterizohet me një trashëgimi natyrore shumë të pasur. Veçoritë gjeografike të Komunës së Obiliqit janë të pasura, këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore dhe me peizazhe të bukura natyrore. Në komunë janë identifikuar gjithsejtë nëntë asete vijuese të trashëgimisë natyrore, një nën mbrojtje të nivelit qendror dhe nën mbrojtje të nivelit lokal:

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Trungjet e dushkut, i blirit dhe guri në Sibovc	X		~1478.90 m
Maja e Zezë –Grabofc i Epërm		X	~6 (ha)
Bota e kuqe dhe gurët e gjelbër në Grabofc të Epërm		X	~2.50 (ha)
Kroi i Mjekiqëve		X	~870.76 m²
Burimi i ujit mineral në Grabofc të Epërm		X	~3.15 ha
Çeshmja e katundit në Palaj		X	~182 .13 m²
Bunari/Çeshmja e Mulla Jahës në lagjen e Hashanëve		X	~185 .m2
Bunari i Pashës		X	~228 m²
Bunari i Dashnisë			**~162.43m**

Tabela 64 Trashëgimia natyrore nën mbrojtje, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore

2.8.2. Asetet e Trashëgimisë Kulturore

Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale.

Në disa pjesë të Komunës sonë ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Qyqavicës, midis fshatrave Grabofc i Epërm, Shipitullë e Sibovc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar.

Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në territorin e Komunës.

Komuna e Obiliqit karakterizohet me disa lloj të trashëgimisë të cilat janë nën mbrojtje.

Kategoritë	Numri
Trashëgimi arkitekturore	5
Trashëgimi arkeologjike	1
Zonat e veçanta të mbrojtura	2
Gjithsej	**8**

Tabela 65 Trashëgimia kulturore nën mbrojtje, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore, 2018

2.8.2.1. Asetet e Trashëgimisë Arkitekturore

Trashëgimia arkitekturore: Në territorin e Komunës shtrihen gjashtë monumente arkitekturore të cilat janë nën mbrojtje nga MKRS-ja.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Tyrbja e Muratit	X		350.00m²/ ~3440.04m ²
Selamllëku Shtëpia kulturore Promovuese Muze	X		90.05m²
RTK1 Radio Televizioni Valët e Mesme në Bakshi	X		0.40m²
Tyrbja e Bajraktarëve-Mazgit	X		23.00 (ha)
Monumenti Memorial i Gazimestanit	X		
Mulliri i Behramajve- Grabofc i Epërm	X		~1000.38 m ²
Mulliri I Hysenajve - Grabofc i Epërm		**X**	**~1992.93 m²**

Tabela 66 Asetet e Trashëgimisë Arkitekturore - Monument/Ansambël nën mbrojtje të përkohshme para vitit 2022

Përpos aseteve të trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje nga niveli qendror, Komuna po ashtu ka shpallur nën mbrojtje asetet vijuese të trashëgimisë kulturore:

Vendbanimet	Monumentet e trashëgimisë kulturore-historike	Sipërfaqja (m ²)
Obiliq	Monumenti i martirëve të lirisë	~234.34 m ²
	Kisha në Obiliq	~3508.24 m ²
	Objekti i stacionit hekurudhor	~216.27m ²
	Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda	~1400.84m²
	Busti i komandantit Adem Jashari	~00.2m²
	Busti i dëshmorit të kombit Fahri Fazliu	~10 m²
	Shtatorja e Heroit "Xhavit Hazirit"	200.15m²
Mazgiti Ultë	Monumenti i Ferid Currit	~324.45 m²
Hade e Re	Pllaka përkujtimore e dëshmorëve	92.35m²
Hamidi	Xhamia (nga shek.-XVIII)	~1470.24m ²
	Shtëpia Muze në Hamidi	~247.75 m ²
	Lapidari i lirisë	~411.40 m²
Sibovc	Varrezat e dëshmorëve	~350.00m2
Grabofc	Pllakë përkujtimore e dëshmorit Faik Mjeku	~1121.79 m ²
	Pllakë përkujtimore e dëshmorit Fejzullah Graiçevci	~77.91 m ²
	Mulliri i ujit (i Hysenajve)	~1992.93 m²
	Mulliri i ujit (i Behramajve)	~1000.38 m ²
Shipitullë	Monument i luftës (UÇK)	~335.55 m²
Milloshevë	Xhamia (nga shek.-XVIII)	~374.65m ²
	Shtëpia e Kulturës	~3556.89 m ²
Baimofc	Kisha ortodokse	~1829.05m ²
	Shtëpia e Kulturës	~411.72 m ²
Breznicë	Objekti i AMF-së	~344.80 m ²
	Pllaka përkujtimore për "Hoxhë Breznicën"	'~392 m ²
Plemetin	Qendra rinore/ Shtëpi e Kulturës	~365.35m ²
	Pllaka përkujtimore e martirëve të lirisë	57.90 m
Dardhishtë	Shtatorja e atdhetarit "Jusuf Shalaku"	~184.51m²
	Shtatorja e atdhetarit "Abdurrahman Gërguri"	~96.78m²
	Pllaka përkujtimore e martirëve të lirisë	~57.71 m²
Kozaricë	Shtëpia Muze (Shtabi i Zonës Operative të UÇK-së)	~262.64 m ²
Palaj	Mulliri i Palojve	217.64m²
	Objekti i AMF-së	227.19m²

Tabela 67 Asetet e trashëgimisë kulturore me vlera historike lokale

2.8.3. Asetet e Trashëgimisë Arkeologjike

Sa i përket trashëgimisë arkeologjike, në Komunë shtrihen disa lokalitete arkeologjike në disa vendbanime. Sa i përket Zonave të Veçanta të mbrojtura, në Komunë shtrihet zona e veçantë e mbrojtur e Gazimestanit, që mbulon një sipërfaqe prej 23.00 ha.

Në vijim është radhitur i vetmi aset i trashëgimisë arkeologjike – Monument/Ansambël, i cili është nën mbrojtje të përkohshme.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Lokalitet arkeologjik parahistorik shumështresor -Dardhishtë (Krushec)	**X**		**1.3 ha**

Tabela 68 Monumentet arkeologjike, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore, 2018

2.8.4. Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Në Komunë të Obiliqit shtrihet sipërfaqet vijuese të Zonave të Veçanta të Mbrojtura:

Vendbanimi, Emri	Status ligjor	Sipërfaqja (ha)
Monumenti Memorial i Gazimestanit	I Mbrojtur	

DRAFT

Tyrbja e Bajraktarit	I Mbrojtur	23.00[17]

Tabela 69 Zonat e Veçanta te Mbrojtura, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, dhe shtrirjes hapësinore, 2018

2.8.4.1. Asetet e Trashëgimisë Kulturore të shpallura nën mbrojtje nga Agjencia për Menaxhimin e Kompleksеve Memorialë të Kosovës (AMKMK)

Sipas Ligjit Nr. 04/L-146, për menaxhimin e kompleksеve memorialë të Kosovës, në territorin e komunës të Obiliqit AMKMK, ka përcaktuar statusin e tetë (8) monumenteve nga lufta e fundit nën menaxhimin dhe administrimin e kësaj agjencie.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Memoriali i Martirëve të lirisë – Obiliq	X		~234. 34 m ²
Busti i komandantit të UÇK-së " Adem Jashari" – Obiliq	X		~00. 2m²
Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda	X		~1400. 84m²
Busti i dëshmorit Fahri Fazliu –Obiliq			~10 m²
Obelisku i dëshmorit Ferid Currit –Mazgit i Ulët	X		~324. 45 m²
Lapidari i lirisë – Hamidi	X		~411. 40 m²
Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së – Sibovc	X		~350. 00m2
Monumenti i luftës së UÇK-së Shipitullë	X		~335. 55 m²
Pllaka përkujtimore e dëshmorëve Rama-Dardhishtë	X		~380. 52 m²
Gjithsej:	**10**		

Tabela 70. Asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje nga Agjencia për Menaxhimin e Kompleksеve Memorialë të Kosovës.

2.9. VENDBANIMET

Në tërë komunën e Obiliqit janë 20 vendbanime të shtrira në 18 zona Kadastrale që janë: Obiliqi, Obiliq i vjetër, Mazgit i ultë, Mazgit i Lartë, Llazarevë, Milloshevë, Bakshi, Raskovë, Baimofc, Breznicë, Kozaricë, Plemetin, Hamidi, Sibovc, Grabofci i Epërm, Shipitullë, Hade, Dobrosellë, Leshkoshiq, Cërkvena Vodicë dhe Kryshefc.

Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Në vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe ato që ndodhen afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit si dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane.

2.9.1. Karakteri Urban Rural

Komuna e Obiliqit përbëhet nga 20 vendbanime që janë pjesë e 18 zonave kadastrale, të cilat shtrihen në një territor prej 106.77 km2, prej të cilave 120 ha i takojnë zonës urbane të komunës. Nga i gjithë territori i komunës, 6524.43 ha janë tokë bujqësore, prej të cilave 6392.75 ha janë tokë e kultivuar, ndërsa pjesa tjetër 131.68 ha kullosë. Rreth 1168.04 ha janë përcaktuar si pyje.


Në qytetin e Obiliqit hapësira e banimit është e ndarë në 9 lagje si Qyqavica, Termocentralet, Dukagjini, Ulpiana, Lagja e Hashanëve, Pashtriku, Ademaj, Dardania dhe Nëna Terezë.

Sipas regjistrimit të popullatës së vitit 2011, në këtë komunë akomodohet një popullatë prej 21,549 banorë. Bazuar në këto të dhëna shihet që pjesa më e madhe e vendbanimeve është në një rend dendësie nga 100 deri në 500 banorë/ km2. Veç, Raskova është në rendin e 656 banorëve/ km2, ndërsa vetë qyteti i Obiliqit llogaritet në rendin e 548 banorëve/km2.

Rreth 5.648 banorë ndodhen në qytezën e Obiliqit, që ka një rregullim urban, dhe rreth 19.981 banorë jetojnë në zonat rurale. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar.

[17]Vërejtje: 1. Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe 2. Tyrbja e Bajraktarit sipërfaqe prej me 23.00(ha) janë të përfshira, në një zonë të veçantë të mbrojtur.

Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.



Harta 44. Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural

Zonat kadastrale	Vendbanimet		Sipërfaqja km²	Nr. i banorëve	Dendësia b/km2
Raskovë	Raskovë	Qendër bazike	0.97	640	656
Obiliq	Obiliq	Qendër e rendit të lartë	12.53	5704	548
	Obiliq i vjetër			1160	
Mazgit	Mazgiti i Ultë	Qendër e rendit të ulët	6.39	1441	295
	Mazgiti i Lartë			1445	
Milloshevë	Millosheva	Qendër e rendit të mesëm	7.33	1819	248
Llazarevë	Llazareva	Qendër bazike	2.10	429	204
Bakshi	Bakshi	Qendër e rendit të ulët	2.04	602	295
Baimofc	Baimofc	Qendër bazike	8.02	392	49
Breznicë	Breznicë	Qendër e rendit të mesëm	14.31	1302	131
	Kozaricë			469	
Plemetin	Plemetin	Qendër e rendit të ulët	5.73	1381	241
Hamidi	Hamidi	Qendër bazike	1.74	147	85
Sibovc	Sibovc	Qendër e rendit të ulët	7.49	963	128
Grabofc i Epërm	Grabofci i Epërm	Qendër e rendit të mesëm	8.60	341	40
Shipitullë	Shipitullë	Qendër bazike	2.96	291	98
Hade	Hade	Qendër e rendit të mesëm	4.91	534	109
Leshkoshiq	Lajthishtë	Qendër bazike	3.68	703	191

Cërkvena Vodicë	Palaj	Qendër e rendit të ulët	7.11	733	103
Kryshefc	Dardhishtë	Qendër e rendit të ulët	6.64	1053	159
Dobrosellë	Dobrosellë	Qendër bazike	4.24	0	0

Tabela 71. Vendbanimet në komunë

2.9.2. Madhësia dhe numri i banorëve

Në bazë të të dhënave demografike dhe sipas udhëzimit administrativ për normat teknike, klasifikimi i vendbanimeve është bërë në bazë të numrit të banorëve.

Në komunë ka një vendbanim shumë të vogël urban me numër të banorëve 5,000-10,000.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Obiliq	6,864

Tabela 72. Vendbanimi shumë i vogël urban

Në komunë ka një vendbanim rural të madh me numër të banorëve 2,500-5,000.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Mazgit	2,886

Tabela 73. Vendbanimi i madh rural

Në komunë ka katër vendbanime të mesme të mëdha rurale me numër të banorëve 1,000-2,500.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Milloshevë	1819	Breznicë	1302	Kryshefc	1053
Plemetin	1381				

Tabela 74. Vendbanimet e mesme të mëdha rurale

Në komunë ka gjashtë vendbanime të vogla rurale me numër të banorëve 500-1,000.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Sibovc	963	Leshkoshiq	703	Bakshi	602
Cërkvena Vodicë	733	Raskovë	640	Hade	534

Tabela 75. Vendbanimet e vogla rurale

Në komunë ka pesë vendbanime rurale të mesme të mëdha me numër të banorëve 200-500.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve	Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Kozaricë	469	Baimofc	392	Shipitullë	291
Llazarevë	429	Grabofc i Ep.	341		

Tabela 76. Vendbanim i vogël rural

Në Komunë ka një vendbanim shumë të vogël me numër të banorëve nën 200.

Vendbanimet	Nr. aktual i banorëve
Hamidi	147

Tabela 77. Vendbanimi shumë i vogël rural

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
OBILIQ	9263	11011	14961	21188	26595	31627	21549

Tabela 78. Ritmet e Rritjes Urbane

2.9.3. Funksionaliteti dhe rrjeti ndërlidhës

Në mungesë të planeve rregulluese, nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative-sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike, etj.

Shumica e problemeve në menaxhimin dhe planifikimin e hapësirës territoriale manifestohet për shkak të:

- Mungesës së planeve rregulluese;
- Mungesa e standardeve urbane të avancuara;
- Menaxhim i dobët i hapësirës territoriale në komunë;
- Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakontrolluar i qytetit.

2.9.4. Lloji dhe lartësia mbidetare

Relievi i territorit të komunës së Obiliqit përbëhet nga disa tërësi, megjithatë, relievi fushor dhe malor formon fizionominë kryesore të kësaj hapësire gjeografike. Pjesa më e madhe vendbanime prej 35.29% të territorit shtrihet në lartësi mbidetare 500 – 550 dhe 35.29% shtrihet në lartësi mbidetare 550 – 600, gjersa pjesa tjetër e territorit shtrihet në lartësi mbidetare 600 - 700.

Vendbanimet	Lartësitë mbidetare	Vendbanimet	Lartësitë mbidetare
Plemetin	500-550	Sibovc	550-600
Raskovë	500-550	Hade	550-600
Bakshi	500-550	Grabofci Epërm	550-800
Dobrosellë	500-550	Shipitullë	650-700
Breznicë	600-650	Hamidi	550-600
Kozaricë	700-750	Mazgit	550-600
Milloshevë	500-550	Cërkvena Vodicë	550-600
Obiliq	500-600	Leshkoshiq	550-600
Kryshefc	530-570	Baimofc	530-600

Tabela 79. Lartësisë mbidetare sipas zonave kadastrale

2.9.5. Sipërfaqet e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve

Sa përket strukturave të ndërtuara, në komunën e Obiliqit me gjithsejtë 5078 dominon numri i njësive të banimit me një njësi apo shtëpi, vijuar me 655 apartamente, 452 dyqane, 204 objekte bujqësore.

Kategoria e objektit	Baimofc		Bakshi		Breznicë		Cërkvena Vodica		Dobrosellë		Grabofc i Epërm	
	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2
Apartament	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bujqësore	13	676	12	1487	3	317	2	134	0	0	0	0
Depo / Magazinë	2	613	0	0	0	0	12	18307	1	139	0	0
Dyqan	25	6181	12	961	7	162	13	1260	0	0	2	524
E Braktisur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
E Paklasifikueshme	14	1121	3	425	33	3209	8	816	0	0	8	953
E Papërfunduar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fabrikë	1	50	0	0	0	0	2	494	0	0	0	0
Fushë Sportive	0	0	1	1250	0	0	0	0	0	0	0	0
Garazh / Parking	0	0	0	0	0	0	1	40	0	0	0	0
Hotel	3	3650	1	1140	0	0	0	0	0	0	0	0
Hurdhat e Peshqve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Komerciale e Pashfrytëzuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pasuritë e Përjashtuara	31	6811	5	200	18	1434	6	540	0	0	5	206
Pishinë	3	2924	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pishinë dhe Fushë Sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Punishte	1	129	1	150	0	0	4	5867	0	0	0	0
Restorant	6	3147	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtëpi	316	30681	121	10888	313	26949	209	16353			84	7584
Zyre	1	72	1	500	1	0	14	7651	2	51	0	0
Totali:	**416**	**56055**	**157**	**17001**	**375**	**32071**	**271**	**51462**	3	**190**	**99**	**9267**

Tabela 80. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara

Kategoria e objektit	Hade		Hamidi		Kryshefc		Leshkoshiq		Llazarevë		Mazgit	
	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2

Apartament	0	0	0	0	15	1102	1	87	0	0	5	433
Bujqësore	40	1886	0	0	15	936	22	789	4	250	6	551
Depo / Magazinë	1	16	0	0	15	5285	4	241	2	800	34	9318
Dyqan	0	0	0	0	11	2810	0	0	7	1923	0	0
E Braktisur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
E Paklasifikueshme	0	0	0	0	12	2559	4	540	1	0	20	2211
E Papërfunduar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fabrikë	0	0	0	0	13	6194	5	3148	5	10079	1	465
Fushë Sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	6400
Garazh / Parking	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hotel	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hurdhat e Peshqve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Komerciale e Pashfrytëzuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pasuritë e Përjashtuara	104	7341	0	0	35	2016	16	967	14	787	68	4210
Pishinë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pishinë/ Fushë Sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Punishte	0	0	0	0	18	7363	1	242	2	535	10	2433
Restorant	0	0	0	0	2	742	0	0	0	0	3	1460
Shtëpi	94	7041	21	1499	253	25294	128	11407	93	11236	642	66178
Zyre	0	0	0	0	18	7025	1	195	2	463	5	603
Totali:	239	16284	21	1499	407	61326	182	17616	130	26073	795	94262

Tabela 81. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara

Kategoria e objektit	**Milloshevë**		**Obiliq**		**Plemetin**		**Raskovë**		**Sibovc**		**Shipitullë**	
	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2	Nr.	Sip m^2
Apartament	1	100	632	27256	1	63	0	0	0	0	0	0
Bujqësore	12	630	55	2216	6	620	8	232	6	989	0	0
Depo / Magazinë	3	2732	47	46572	0	0	2	100	0	0	1	20
Dyqan	55	11152	305	103260	13	1011	1	20	1	25	0	0
E Braktisur	0	0	0	0	0	0	0	0	1	32	0	0
E Pa klasifikuar	31	6652	149	24810	10	1416	4	222	7	848	1	80
E Papërfunduar	0	0	0	0	0	0	0	0	5	672	0	0
Fabrikë	3	3147	49	49382	0	0	0	0	0	0	0	0
Fushë Sportive	0	0	2	8938	0	0	0	0	0	0	0	0
Garazh / Parking	0	0	0	0	0	0	0	0	3	165	0	0
Hotel	0	0	4	2132	0	0	0	0	0	0	0	0
Hurdhat e Peshqve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Komerciale e Pashfrytëzuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pasuritë e Përjashtuara	47	6136	393	41680	27	1964	4	245	4	226	41	4598
Pishinë	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pishinë/ Fushë Sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Punishte	6	1479	33	18540	0	0	1	30	0	0	0	0
Restorant	1	165	14	10770	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtëpi	477	55195	1386	134084	524	42865	138	12934	223	18616	56	5272
Zyre	7	661	79	38274	2	318	1	40	0	0	0	0
Totali:	643	88049	3149	507914	583	48257	159	13823	250	21573	99	9970

Tabela 82. Struktura dhe hapësirat e ndërtuara

2.9.6. Zona Urbane

Qyteti i Obiliqit është relativisht vendbanim i ri i karakterit urban, i cili është rritur shpejt pas vitit 2000 kur filloj të shndërrohet në një qendër politiko-administrative dhe kulturore. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, janë ndërtime të ulëta deri në dy kate, ndërsa

zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit duke formuar bërthamën urbane të qytetit. Maksimumi i lartësisë në ndërtimet e reja arrin në 6 kate, të cilat janë të rralla. Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në komunë në periudhën e fundit, e kanë gjetur të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që ka sjell rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit.

Në mungesë të planeve rregullative, nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike etj.

Në zonën kadastrale Obiliq kalojnë gjithsej 467 segmente rrugore në një gjatësi të përgjithshme prej 254.8km, prej të cilave 89.5 km janë të asfaltuara ndërsa pjesa tjetër është e pa asfaltuar.

2.9.7. Zonat rurale

Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual.

Komuna e Obiliqit ka gjithsej 19 fshatra (Mazgit i ultë, Mazgit i lartë, Llazarevë, Milloshevë, Bakshi, Raskovë, Bajmofc, Breznicë, Kozaricë, Plemetin, Hamidi, Sibovc, Grabofci i Epërm, Shipitullë, Hade, Mirash, Lajthishtë, Palaj dhe Dardhishtë), që shtrihen në 17 zona kadastrale, dhe jetojnë 19.981 banorë. Fshatrat, për nga aspekti gjeografik dhe topologjik kanë karakter kodrinoro- malor dhe të rrafshit. Shumica e fshatrave janë të tipologjisë së rrafshit, kurse fshatrat që janë më kodrinoro- malore janë Grabofci i Epërm, Breznica dhe Kozarica.

Për nga aspekti ekonomik, shumica e fshatrave kategorizohen si bujqësor ku veprimtaria kryesore ekonomike është bujqësia duke ju falënderuar tokës bujqësore me kualitet të lartë, po ashtu përparësi e kësaj është se një pjesë e fshatrave si Mazgiti, Millosheva, Raskova, Bakshi dhe pjesë e Plemetinit kanë rrjet të ujitjes së tokave bujqësore i menaxhuar nga Ibër Lepenci. Ndërsa, fshatrat Sibovc, Cërkvena Vodicë, Hade, Shipitullë, Leshkoshiq kanë përmbajtje të thëngjillit, me mundësi eksploatimi, gjegjësisht shfrytëzimi ekonomik i pasurisë nëntokësore.

Rrjeti i vendbanimeve rurale në komunën e paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në komunën e Obiliqit, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Karakteristikë kryesore e fshatrave në Obiliq është se ato janë të tipit të shpërndarë dhe i përgjigjen karakteristikave të përgjithshme të vendbanimeve në Kosovë. Në komunë të Obiliqit, kanë ndodhur dhe depopullime/ shpërngulje të detyruara, si pasojë e hapjeve të mihjeve të reja.

2.10. Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje

Plani Zhvillimor Komunal paraprak i Obiliqit në të kaluarën ka identifikuar këto vendbanime joformale:

- Kampi i Plemetinës shtrihet në pjesën veriore të Fshatit Plemetin. Ka një sipërfaqe prej 1.25ha. Në Kamp jetojnë 40 banorë ne baraka.
- Azotika shtrihet në pjesën veriperëndimore të qytetit. Ka një sipërfaqe prej 4ha. Aty janë të identifikuara 50 familje në shtëpi private me 250 banorë.
- Janina Voda shtrihet në pjesën perëndimore të Obiliqit. Ka një sipërfaqe prej 2ha. Aty janë të identifikuara 50 shtëpi private me 200 banore.
- Fshati Plemetin shtrihet në pjesën veriore të Obiliqit. Ka një sipërfaqe prej 21ha. Aty janë të identifikuara 500 shtëpi private me 2 500 banorë.
- Lagjja e Subotiqeve shtrihet në pjesën veriore të Obiliqit. Aty janë te identifikuara 30 familje me 300 banorë.
- Lagjja Obiliq i ri shtrihet në pjesën veriore te Obiliqit. Aty janë të identifikuara 100 baraka me 500 banorë.
- Fshati Dardhishtë shtrihet në pjesën jugore të Obiliqit. Aty janë të identifikuara 300 shtëpi private me 1 500 banorë.
- Lagjja në fshatin Baimofc shtrihet në pjesën veriore të Obiliqit. Aty janë të identifikuara 50 shtëpi me 1 500 banorë.

	VBJF	Sipërfaqja	Nr. i shtëpive	Nr. i banorëve	Infrastruktura fizike	Infrastruktura sociale	Prona	Gjendja	Prioritetet
1	Kampi i Plemetinës	1.25Ha	baraka	40	Po	Po	Komunale	E mirë	Jo
2	Azotika (ekziston nga 1940, i	4 Ha		250	Po	Po	Komunale	E mirë	Jo


	rindërtuar, i banueshëm nga 2003)								
3	Janina Voda	2 Ha	50	200	Po	Po	Private	E mirë	Jo
4	Fshati Plemetin	21 Ha	500	2 500	Po	Po	Private	E mirë	Jo
5	**Lagjja e Subotiqëve**		**30**	**300**	**Nuk ka**	**Nuk ka**	**Përzier**	**E keqe**	**Po**
6	Lagjja Obiliqi i ri		100	500	Po	Po	Përzier	E mirë	Jo
7	**Fshati Kryshefc**	**16 ha**	**300**	**1500**	**Pjesërisht**	**Pjesërisht**	**Private**	**E keqe**	**Po**
8	Lagjja në fshatin Baimofc		50	400	Po	Po	Private	E mirë	Jo

Tabela 83. Vendbanimet joformale sipas PZHK-ës paraprake

Mirëpo me kalimin e kohës, Komuna ka trajtuar shumicën e vendbanimeve joformale ku:

- Kampi i Plemetinit – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit;
- Azotiku – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit;
- Janina Voda (Vodica) - – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit;
- Fshati Plemetin – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit;
- Lagja Obiliqi i Ri – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit; dhe
- Lagja në Babimoc – nuk mund të radhitet në Vendbanim joformal pasi që i kanë të rregulluar si çështjet pronësore edhe çështjen infrastrukturore, e po ashtu është zgjedhur edhe çështja e banimit.

Të vetmet vendbanime joformale mbetet lagja Subotiq dhe Kryshefc ku vetëm çështja pronësore është ende e kontestueshme, gjersa e çështja infrastrukturore është e rregulluar.



Harta 45. Harta e vendbanimeve joformale

2.10.1. Ndërtimet pa leje


Në komunën e Obiliqit janë të regjistruara në regjistrin kombëtar të ndërtimeve pa leje mbi 3,523 raste të ndërtimeve pa leje me ish Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i ndërtimeve pa leje pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi, Ligji Nr. 06/L-024.

Sipas regjistrit të ndërtimeve pa leje në komunën e Obiliqit ka gjithsej 3,523 ndërtime pa leje.

Nr.	Zona Kadastrale	Nr. i ndërtimeve		Zona Kadastrale	Nr. i ndërtimeve
1	Hamidi	32	10	Bakshi	80
2	Leshkoshiq	131	11	Mazgit	415
3	Carravodicë	189	12	Raskovë	94
4	Baimofc	120	13	Plemetin	347
5	Obiliq	795	14	Breznicë	140
6	Kryshefc	165	15	Milloshevë	339
7	Llazarevë	69	16	Hade	174
8	Shipitullë	166	17	Grabofci Epërm	58
9	Dobrosellë	0	18	Sibovc	209

Tabela 84. Numri i ndërtimeve pa leje sipas Zonave Kadastrale

DRAFT



Harta 46 Shtrirja e ndërtimeve pa leje në Komunën e Obiliqit

2.11. BANIMI

Sa i përket banimit në komunë aktualisht janë gjithsejtë:

- 5,736 njësi banimi me sipërfaqe të përgjithshme të ndërtuar;
- 513,117 m^2 sipërfaqe të përgjithshme të ndërtuar;
- 23.05 m^2 sipërfaqe të përgjithshme të ndërtuar për kokë banori.

Pjesa më madhe e njësive të banimit prej 88.56% përbëhet prej njësive të banimit me një njësi, gjersa 11.44% përbëhet nga njësive të banimit me shumë njësi.

	Numri i njësive	Sipërfaqja e përgjithshme (m^2)	m^2/njësi	% e njësive
Banim me shumë njësi	656	29,041	44.27	11.44%
Banim me një njësi	5,080	484,076	95.29	88.56%

Tabela 85. Numri i njësive, sipërfaqja e përgjithshme (m2), m2/njësi dhe përqindja e njësive sipas llojit

Sa përket sipërfaqes mesatare të sipërfaqes për njësi banimi, gjendja aktuale është:

- 44.27m^2 për njësi banimi me shumë njësi;
- 95.29m^2 për njësi banimi me shumë njësi.

Pjesa më madhe e ndërtesave të banimit prej 99.26% përbëhet prej njësive të banimit me një njësi, gjersa vetëm 0.37% përbëhet nga njësive të banimit me shumë njësi.

	Numri i ndërtesave të banimit	Përqindja e ndërtesave të banimit	Etazhiteti mesatar
Banim me shumë njësi	19	0.37%	P+4
Banim me një njësi	5080	99.26%	P+1

Tabela 86. Numri i ndërtesave të banimit dhe % sipas llojit

2.11.1. Banimi social

Kategoritë përfituese të cilat do te definohen sipas kritereve qe do te përcaktohen me rastin e fillimit te procesit duke përfshirë ne përqindje te caktuar te gjitha kategoritë ashtu qe te krijohet banim i kombinuar qe ndikon ne integrimin e familjeve ne raport me rrethinën dhe ngritje e nivelit të standardit dhe kulturës së banimit.

Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		**200**
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta te banimit		3 ha
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatoret		1200
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mesatare e qirasë		30
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut		30
Nr. i objekteve/nj. banimi ne pronësi te Komunës që mund të adaptohen		0
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	4 (përkohshme)
	Vendndodhja /emërtimi	Obiliq-Plemetin
	Nr. i familjeve	60

Tabela 87. Kërkesat për zgjidhje të çështjes së banimit

Në Komunë janë gjithsejtë 150 kërkesa nga familjet me asistencë sociale.

Grupet e synuara	Kërkesa	Gjendja aktuale e investimeve
Me asistencë sociale nevoja (kërkesat nga DSHMS)	150	
Kategoritë e dala nga lufta (të finalizuara)		21 /Komuna
Te kthyerit		
Të riatdhesuarit (kërkesa 11)	11	6 shtëpi banimi MMPHI
Të moshuarit	-	n/a
Të rinjtë	-	n/a
Të punësuarit nga buxheti shtetëror	-	n/a
Minoritetet (shtëpi te ndërtuara)		150/Donatoret
Shitja e banesave në treg		400€/m2
Të dhëna me qira	n/a	
Me qira në kushte të caktuara		17 /MPB
Pa qira / Kategoritë e dala nga lufta dhe Qendra e Strehimit në Magure	Në proces të verifikimit	21+32

Tabela 88. Gjendja aktuale e banimit social

2.12. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës është 10.492Ha, 5ari e 19m^2 (105 km^2). Në këtë tërësi si pronë private është e evidentuar sipërfaqja 5683Ha, 38ari dhe 81m^2. Prej kësaj sipërfaqeje me shfrytëzim pyje është 469ha,35ari dhe 82m^2 ndërsa pjesa tjetër është zonë e banimit dhe tokë bujqësore.

Toka dhe përdorimi i tokës

Komuna e Obiliqit, është komuna më me ndikimin më të madh nga gjenerimi i energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponive të hirit dhe të djerrinës si dhe vendbanimeve, që ka nën shfrytëzim dhe pronësi private 56% ose me 5.862ha të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.620 ha ose 44%, nga e cila KEK-u posedon 15%. Shfrytëzimi i tokës në territorin e komunës ka rëndësi të madhe dhe nënkupton destinimin e sipërfaqeve apo llojin e nxënies së hapësirës, gjegjësisht të sipërfaqeve tokësore nën renditje të sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato. Në kuadër të territorit të komunës është me rëndësi të dihet pjesëmarrja e pronësisë së tokës, në vijim në formë tabelore po e paraqesim përdorimin dhe destinimin e tokës.

Pronë shoqërore sipas evidencës së Drejtorisë për Kadastër është 4809Ha. Prej gjithë pjesës shoqërore KEK –u është pronar i sipërfaqes prej 1595ha 73ari dhe 84m^2 (afro 15 % e sipërfaqes të Komunës). Toka Pyjore në pronë shoqërore zë një sipërfaqe prej 683ha, 76ari dhe 94m^2, ndërsa pjesa tjetër e pronës shoqërore ju takon organizatave dhe institucioneve të ndryshme.

Zona kadastrale Obiliq e evidentuar si zonë urbane është 1250hektar 7ari e 9m^2. Shtrihet në afërsi të gjigantit të KEK-ut dhe si e tillë është një qendër ekskluzivisht industriale me rezerva të mëdha të linjitit. Është ndër Komunat më të varfra në Kosovë si dhe me ambientin më të ndotur në Kosovë.

Rasti më i freskët i humbjes së tokë është rasti i Hades ku duhet të dislokohet fshati për nevoja të KEK –ut me një sipërfaqe prej afro 300Ha dhe ky dislokimi duhet të kryhet në territorin e Komunës d.m.th. zvogëlohet territori i Komunës për një sipërfaqe me afro 300 ha tokë. Obiliqi është një qendër ekskluzivisht industriale dhe ka rreth 5640 banorë. Dendësia e banorëve për një kilometër katror është 487 b/km^2 (mbi mesataren e Kosovës).

Qyteti i Obiliqit është relativisht vendbanim i ri i karakterit urban, i cili është rritur shpejt pas vitit 2000 kur filloj të shndërrohet në një qendër politiko-administrative dhe kulturore. Komuna e Obiliqit duke qenë e vendosur në fushëgropën e Kosovës, sikur mbahet mbi supet e maleve të Qyqavicës dhe Shalës së Bajgores. Kjo komunë përshkon tërthorazi këtë fushëgropë prandaj edhe ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Nga analiza e cila është bërë me GIS kuptohet që 48% e territorit të komunës së Obiliqit është tokë bujqësore dhe 37% është tokë pyjore.

Sipas të dhënave që janë marrë nga DBKO, komuna e Obiliqit ka gjithsejtë 1.0531ha tokë bujqësore. Rreth 48% e territorit komunal është në shfrytëzim për nevoja të bujqësisë që d.m.th. gati gjysma e territorit të komunës së Obiliqit. Prej tyre 6.677ha janë pronë private dhe 3.854ha janë pronë shoqërore. Miniera e re e Sibovcit do marrë më së shumti tokën e bukës, diku rreth 13% e territorit të komunës së Obiliqit bën pjesë në minierën e re të Sibovcit. Ne këtë fushë të paraparë për minierë sipërfaqësore, 86% e territorit është tokë e bukës ose ara kurse pjesa tjetër vendbanime, rrugë dhe pyje.

Dukuria e ndërtimit përgjatë akseve rrugore është e theksuar edhe në komunën e Obiliqit, një sipërfaqe e konsiderueshme e kësaj pasurie është duke humbur nga ndërtimet e pakontrolluara kryesisht me përmbajtje biznesi. Sipas një analize të bërë në qendrat e mëdha urbane, për periudhën 1980 deri në vitin 2000 kur janë bërë fotografimet ajrore, është konstatuar se zonat urbane kanë pësuar rritje mesatarisht për 2.7 herë. Kjo e dhënë na tregon se nëse një zonë urbane ka pasur sipërfaqe prej 1.000 ha, pas periudhës së përmendur zona në fjalë është rritur në 2.700ha, që do të thotë janë humbur 1.700ha.

Modelet e shfrytëzimit

Pjesa më e madhe e ndërtimeve janë ndërtime të ulëta deri në dy kate, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit, duke formuar bërthamën urbane të qytetit. Maksimumi i lartësisë në ndërtimet e reja arrin në 6 kate. Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në Komunë në periudhën e fundit, e gjetën të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që solli rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit.

Një nga arsyet kryesore ka qenë lëvizja e lirë e njerëzve, e cila solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kritere urbanistike, duke krijuar kështu zona joformale. Në këto zona bëhet i vështirë disiplinimi i ndërtimeve dhe krijohen vështirësi të mëdha në lidhje me infrastrukturën inxhinierike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefon etj.). Kështu, nga një zhvillim i planifikuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme. Ndërtimet pa kritere të përcaktuara urbane që një numër i konsiderueshëm nuk kanë lejë, po rëndojnë, e dëmtojnë infrastrukturën dhe po zbeh mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen. Në mungesë të planeve rregullative nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative-sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike etj.

Obiliqi është Komuna më ndikimin më të madh nga gjenerimi energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponimeve të hirit dhe të djerrinës, si dhe vendbanimeve, që kanë shfrytëzim dhe pronësi private 56% ose me 5.862ha të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.620ha ose 44%, nga e cila KEK-u posedon 15%. Shfrytëzimi i tokës në territorin e Komunës ka rëndësi të madhe dhe nënkupton destinimin e sipërfaqeve apo llojin e nxënies së hapësirës, gjegjësisht të sipërfaqeve tokësore nën renditje të sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato. Në kuadër të territorit të Komunës është me rëndësi të dihet pjesëmarrja e pronësisë së tokës, në vijim në formë tabelore është paraqitur përdorimi dhe destinimi i tokës.

	Zonat - territori i mbuluar me plane urbane	Sipërfaqja totale e Komunës	Sipërfaqja e zonës me PU	Raporti %
1.	Qyteti i Obiliqit dhe rrethina e ngushte PZHU dhe PRRU	10.500 ha	110 ha	**30%**
2.	Zona e KEK-ut (Zonë Interesi nacional)- PZHU	7.350 ha		**70%**
Total				**100%**

Tabela 89 Sipërfaqja e përfshirë ne plane urbane

2.12.1. Shfrytëzimi aktual i tokës

Në Komunën e Obiliqit me 62.08% dominon toka bujqësore, pastaj zona minierë sipërfaqësore me 11.61%, toka pyjore me 11.11% dhe banimi me 8.76%.

Banim / Banim i përhershëm	Prodhim Parësor / Bujqësi	Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit	Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor	Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile	Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar	Rjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rjetet e transportit /	Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor	Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative	Prodhim Parësor / Minierë dhe Gurore / Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë
920.72ha	6524.43ha	83.76ha	21.41ha	276.67ha	74.85ha	172.56ha	21.41ha	1168.04ha	26.09ha	1220.22ha
8.76%	62.08%	0.80%	0.20%	2.63%	0.71%	1.64%	0.20%	11.11%	0.25%	11.61%

Tabela 90 Shfrytëzim i tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes.

2.12.1.1. Zonat Kadastrale sipas llojit të shfrytëzimit

Banim / Banim i përhershëm Zonat e banimit shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 920.72ha ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim banimi më të lartë dhe më të ulët se 100 ha :

- Obiliq 223.4ha
- Mazgiti 113.29ha
- Milloshevë 117.02ha

Prodhim Parësor / Bujqësi Zonat bujqësore shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 6524.43ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim bujqësor më të lartë dhe më të ulët se 300 ha:

- Mbi 300 ha: Obiliq 728.99ha, Baimofc 725.55ha, Breznicë 1008.09ha, Plemetin 401.12, Sibovc 603.03ha, Milloshevë 593.06ha
- Nën 300 ha: Llazarevë 160.82ha, Leshkoshiq 285.67ha, Bakshi 174.81ha, Shipitullë 124.76ha, Kryshefc 194.21ha, Hamidi 164.85ha dhe Hade 189.12ha

Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë

Zonat me pyje janë në pjesën perëndimore të kësaj zone shtrihen pyje të ulëta që mbulohet nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardhi – Querrcus Frainetto, Qarri – QurqusCerris, Shkoza e zezë - CarpinusOrientalis, Ahu – FagusMoesiaca. Ndërsa, pjesa jug - perëndimore e zonës mbulohet dhe karakterizohet me një sipërfaqe të pyjeve të ngritura me anë të pyllëzimeve, kryesisht me Hartina– PinusSilvestris dhe pisha e zezë – PinusNegra. Kryesisht janë pyje të ulëta të degraduara.

Zonat Pyjore shtrihen në një të sipërfaqe të përgjithshme prej 1168.04 ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim për pyje më të lartë se 150 ha:

- Mbi 150 ha: Grabofci Epërm 619.85ha dhe Breznicë 343.89ha
- Nën 150 ha: Shipitullë 107.98ha dhe Sibovc 96.32ha

Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit

Zonat e shërbimeve shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 83.76 ha.

Raskovë	Obiliq	Mazgit	Milloshevë	Llazarevë	Bakshi	Baimofc	Breznicë	Plemetin
0.67ha	45.26ha	5.73ha	1.72ha	1.24ha	1.51ha	2.19ha	2.3ha	3.9ha
Hamidi	Sibovc	Grabofc i Epërm	Shipitullë	Hade	Leshkoshiq	Cërkvena Vodicë	Kryshefc	Dobrosellë
0.57ha	1.53ha	0.65ha	0.55ha	2.17ha	1.53ha	10.92ha	1.5ha	0.00ha

Tabela 91 Sipërfaqet e shërbimeve sipas sipërfaqeve (ha)në zona kadastrale

Zonat e Mbrojtura. Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë zona të mbrojtura me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.41 ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me Zonë të Mbrojtur :

Bakshi	Hamidi	Mazgit
0.41ha	0.01ha	20.99ha

Tabela 92 Zonat e Mbrojtura sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar

Zonat komerciale shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 74.85 ha.

Baimofc	Bakshi	Llazarevë	Carravodicë	Grabofci Epërm	Mazgit	Milloshevë	Obiliq	Plemetin
17.75ha	1.32ha	7.11ha	0.58 ha	0.51ha	8.35ha	8.96 ha	24.32 ha	5.95ha

Tabela 93 Sipërfaqet komerciale sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit

Zonat e komunikacionit, transportit shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 172.56ha.

Raskovë	Obiliq	Mazgit	Milloshevë	Llazarevë	Bakshi	Baimofc	Breznicë	Plemetin
3.06ha	48.21 ha	18.22 ha	10.56 ha	9.34 ha	2.51 ha	9.35 ha	13.13 ha	9.14 ha
Hamidi	Sibovc	Grabofci Epërm	Shipitullë	Hade	Leshkoshiq	Cërkvena Vodicë	Kryshefc	Dobrosellë
2.02 ha	8.13 ha	7.31 ha	5.47 ha	4.88 ha	3.98 ha	7.74 ha	8.39 ha	1.12 ha

Tabela 94 Sipërfaqet e komunikacionit dhe transportit sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

Shfrytëzimi për rekreativë-turistik. Zonat rekreative-turistike shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 26.09 ha.

Baimofc	Llazarevë	Kryshefc	Mazgit	Milloshevë	Obiliq	Plemetin	Raskovë
5.2ha	1.26ha	0.33ha	1.08ha	2.07ha	14.11ha	1.23ha	0.81ha

Tabela** 95 **Sipërfaqet rekreative dhe turistike sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

3. VLERËSIMI I GJENDJES


3.1. TRENDËT DHE PROGNOZAT DEMOGRAFIKE

Analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillim socio-ekonomik në të ardhmen.

Kosova ka pasur një rritje të konsiderueshme natyrale të popullsisë ndër vite. Bazuar në të dhënat e regjistrimeve zyrtare të popullsisë 1948 – 2011, ku brenda kësaj periudhe, popullsia në komunë të Obiliqit ka pasur një rritje prej rreth 43%. Nga ana tjetër, regjistrimi i popullatës në Obiliq ka reflektuar problemet politike të para dhe pas luftës. Dinamikat e popullatës kanë njohur luhatje të jashtëzakonshme sidomos përgjatë kulmimit të përndjekjes së popullatës shqiptare në vitin 1999.

Edhe përkundër trendit pozitiv të rritjes natyrore të popullsisë deri në vitin 2011, në vitin 2019 vërehet ulje e numrit të popullsisë së përgjithshme. Sipas regjistrimit të popullsisë në Kosovë (2011), komuna e Obiliqit kishte 21.549 banorë rezidentë, që është për 31% më pak se në regjistrimin e vitit 1991 (ASK, 1991). Ndërsa, sipas vjetarit të ASK-së[18], në vitin 2019, vlerësohet se në komunë të Obiliqit ka një numër të popullsisë prej 17.899 banorë.

Në këto dy dekadat e fundit, sikur Kosova ashtu edhe Komuna e Obiliqit nuk kanë pasur rritje të popullsisë krahasuar me trendët në vitet e kaluara (tri dekada më parë). Kjo situatë na bënë të kuptojmë se kemi të bëjmë me zvogëlim apo stagnim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune.



Grafiku 1. Popullsia (ndryshimet) e Komunës së Obiliqit sipas viteve, Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Baza e të dhënave ASK data-baza.

Nga numri i përgjithshëm i popullsisë, në vitin 2011, 55% e popullsisë jetonte në vendbanime rurale dhe 45% jeton në vendbanime urbane (ASK, 2011). Nga të dhënat e prezantuara në tabelën nr. 80, konstatohet se fenomenet e migrimit dhe të emigrimit kanë prekur në mënyrë më të dukshme vendbanimet rurale malore dhe jo aq shumë zonën urbane me vendbanimet përreth të shtrira në rrafsh. Për shembull vërehet një rritje e popullsisë në vendbanimet Mazgit dhe Milloshevë (vendbanime të shtrira në rrafshinë), kurse rënie në vendbanimet Breznicë dhe Grabofc i Epërm (vendbanime malore). Përqindje e konsiderueshme e depopullimit të zonave rurale ka ndodhur dhe besohet do vazhdojë të ndodhë si shkak i proceseve urbanizuese dhe migrimeve të jashtme. Urbanizimi në qytet ka rezultuar në favor të rritjes së pjesës urbane kryesore dhe zonave përreth.

Në komunë të Obiliqit ka ndodhur dukshëm fenomeni i braktisjes së vendbanimit nga ana e popullsisë etnike serbe. Sipas të dhënave të komunës, në Plemetin, de facto ka rritje të popullsisë. Gjatë regjistrimit të vitit 2011, komunitetet serbë dhe romë nuk kanë marr pjesë, andaj jo realisht sipas të dhënave statistikore paraqitet rënie e numrit të popullsisë.

Duhet theksuar se në komunë të Obiliqit, pas viteve 2003, ka pasur aktivitete të zhvendosjes së popullsisë nga disa vendbanime. Zhvendosjet kanë ndodhur, kryesisht në kuadër të zonës së mihjeve në fshatrat Hade, Lajthishtë, Shipitullë dhe Hamidi, si rezultat i shpronësimeve të organizuara nga niveli qendror si interes kombëtar të gjenerimit të rrymës elektrike. Edhe pse, niveli qendror

[18] Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2020.

kishte planifikuar Haden e Re, si vendbanim për të pranuar popullatën e zhvendosur, shumica e tyre u vendosën në qytet, apo në kryeqytet.

Viti i regjistrimit	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Vendbanimet								Përqindja e rritjes/ uljes (%)					
Baimofc	686	746	745	894	1077	1150	392	1,75	-0,02	2,00	2,05	0,68	-3,30
Bakshi	215	248	263	365	483	617	602	3,07	0,76	3,88	3,23	2,77	-0,12
Breznicë	874	910	1051	1337	1606	1810	1302	0,82	1,94	2,72	2,01	1,27	-1,40
Cërkvena Vodicë	697	820	1037	1214	1510	1535	733	3,53	3,31	1,71	2,44	0,17	-2,61
Dobrosellë	35	40	62	:	:	:	:	2,86	6,88	-10,00	:	:	:
Grabofc i Epërm	264	282	356	442	554	766	341	1,36	3,28	2,42	2,53	3,83	-2,77
Hade	986	1127	1407	1833	2105	2193	534	2,86	3,11	3,03	1,48	0,42	-3,78
Hamidi	102	120	113	134	203	223	147	3,53	-0,73	1,86	5,15	0,99	-1,70
Kozaricë	:	:	:	:	:	:	469	:	:	:	:	:	:
Kryshefc	503	831	1055	1412	1750	1912	1053	13,04	3,37	3,38	2,39	0,93	-2,25
Leshkoshiq	446	542	632	744	930	1081	703	4,30	2,08	1,77	2,50	1,62	-1,75
Llazarevë	100	69	98	136	196	230	429	-6,20	5,25	3,88	4,41	1,73	4,33
Mazgit	387	508	669	1188	1837	2218	2886	6,25	3,96	7,76	5,46	2,07	1,51
Milloshevë	583	616	758	976	1306	1588	1819	1,13	2,88	2,88	3,38	2,16	0,73
Minierë e Kosovës	311	442	479	404	262	255	:	8,42	1,05	-1,57	-3,51	-0,27	-5,00
Obiliq	1217	1613	3646	6906	8769	11612	6864	6,51	15,75	8,94	2,70	3,24	-2,04
Plemetin	656	754	929	1203	1593	1840	1381	2,99	2,90	2,95	3,24	1,55	-1,25
Raskovë	199	234	279	350	452	518	640	3,52	2,40	2,54	2,91	1,46	1,18
Sibovc	675	747	942	1189	1480	1632	963	2,13	3,26	2,62	2,45	1,03	-2,05
Shipitullë	327	362	440	461	482	447	291	2,14	2,69	0,48	0,46	-0,73	-1,74
Urban	1 604	2 121	4 315	8 094	10 606	13 830	9 750	6,83	8,75	7,00	3,03	2,60	-1,54
Rural	7 659	8 890	10 646	13 094	15 989	17 797	11 799	2,48	2,32	2,10	2,07	1,11	-1,67
Total	9 263	11 011	14 961	21 188	26 595	31 627	21 549	3,77	4,48	4,16	2,55	1,89	-1,59

Tabela 96 Numri dhe përqindja e popullsisë sipas vendbanimeve ndër vite 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011, ASK 2011

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social, nga rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik. Rreth 39% e popullsisë në komunë janë në moshë të re, gjegjësisht takojnë grup moshës 0- 18 vjeç. Derisa grup-mosha 19–35 vjeç e përbën mbi 25% të popullsisë, grup mosha 36–65 vjeç përfshin rreth 35% të popullsisë. Analizat strukturore të grup moshave tregojnë se Obiliqi ka një popullsi me rreth 60% nën moshën 35 vjeçare. Edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja, konkludohet se komuna e Obiliqit ka popullsi kryesisht të re.

Trendët dhe prognozat e numrit të anëtarëve për ekonomi familjare bazohen në të dhënat e regjistrimeve zyrtare të popullsisë 1948 – 2011, gjatë kësaj periudhe vërehet një rënie nga prej 6.49 në 5.59 anëtarë për ekonomi familjare.

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Numri i banorëve	9,263	11,011	14,961	21,188	26,595	31,627	21,549
Numri i ekonomive familjare	1,433	1,787	2,711	3,563	4,120	5,027	3,915
Numri i anëtarëve për ekonomi familjare	6.46	6.16	5.52	5.95	6.46	6.29	5.59

Tabela 97 Numri i anëtarëve për ekonomi familjare në vitet 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011

3.1.1. Lëvizjet natyrore të popullsisë

Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës dhe Komunës së Obiliqit, paraqet një komponentë mjaft karakteristike. Ato janë ndër komponentët që së bashku me migrimet, paraqesin ecurinë dhe dinamikën e lëvizjeve të përgjithshme të popullsisë. Si rezultat i rrethanave politike dhe kushteve shoqërore - ekonomike nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe Obiliqi, shtimi natyror i popullsisë ka shkuar drejt zvogëlimit. Megjithatë, trendi aktual i shtimit natyror të popullsisë në Kosovë është pozitiv krahasuar me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së. Kosova sikurse edhe Komuna e Obiliqit ende ka trend pozitiv të shtimit natyror mirëpo, me tendencë të zvogëlimit. Shtimi natyror i popullsisë së Kosovës sikurse edhe i Komunës së Obiliqit deri në vitet '90 të shekullit XX, pavarësisht disa oscilimeve ka qenë e lartë. Pas vitit 2000 ka filluar të bjerë në mënyrë shumë të shpejtë, si pasojë e emigrimit, shtyrjes së martesave, dhe faktorëve të tjerë, pasoja këto që po e ndihen edhe tani. Popullsia e komunës së Obiliqit, në vitin 2018 kishte


shtim natyror rreth 1.002% ose në numra absolute (187 banor) gjë që, është më pak më e ulët se mesatarja e Kosovës (1.02%) e që tregon për një shtim të thjeshtë të popullsisë dhe krahasuar me vitet paraprake, ka tendencë të uljes së shtimit natyror të popullsisë edhe në vitet në vazhdim. Faktorët kryesor që kanë quar në uljen e shtimit natyrorë të popullsisë janë migrimet e brendshme dhe të jashtme, vdekshmëria e lartë, gjendja socio-ekonomike, arsimimi etj. Ulja e shtimit natyror të popullsisë ka për pasojë de-balancimin e strukturave demografike, efektet në rritjen e grup-moshës së tretë, humbjen e fuqisë punëtore, zvogëlimin e numrit të nxënësve, etj. Bazuar në trendin e lëvizjeve natyrore (lindje, vdekje dhe shtimin natyror) por edhe në lëvizjet mekanike të popullsisë së Komunës së Obiliqit, komuna e Obiliqit parashikohet të ketë trend të uljes së numrit të përgjithshëm të popullsisë.

3.1.2. Lëvizjet mekanike të popullsisë

Ajo që e bën kompleks diskutimin mbi demografinë është larmia e fenomeneve demografike me të cilat është përballur e gjithë Kosova. Ajo është përballur që në vitet '70 me fenomenin e migracionit ndërkombëtar dhe kombëtar, por duke patur gjithmonë asetin e një rritje të konsiderueshme natyrale të popullsisë. Dinamikat e popullatës kanë njohur luhatje të jashtëzakonshme sidomos përgjatë kulmimit të përndjekjes së popullatës shqiptare në vitin 1999 nga regjimi serb.

Pas çlirimit të Kosovës, dinamikat e lëvizjes së popullatës brenda vendit njohën një nivel më të lartë. Proceset urbanizuese në drejtim të kryeqytetit njohën ritme të larta brenda një kohe të shkurtër. Vitet e fundit Kosova është përballur edhe me një valë lëvizjeje jashtë Kosovës. Mund të arsyetohet që fenomenet e emigrimit prekin në mënyrë më të dukshme kryesisht zonat rurale.

Komuna e Obiliqit është njëra ndër komunat e Kosovës më shkallën lartë të migracionit. Shikuar përqindjen e emigrimit në raport me popullsinë rezidente të komunës, Obiliqi hyn në 3 komunat me raportin më të madh të emigruesve. Vendet ku më së shumti kanë emigruar qytetarët nga Obiliqi janë: Zvicra, Gjermani, Austri etj. Grup-mosha që më së shumti ka emigruar është popullsia aktive (veçanërisht grup - mosha 24 – 39 vjeç) ndërsa, sa i përket raportit gjinor, kjo ka ndryshuar pas vitit 2000, me dominim të lehtë gjinia femërore. Arsyet e emigrimit janë: punësimi, familjare, lufta, etj (ASK, 2014). Gjithnjë sipas të njëjtit burim (ASK, 2014), migrimi ndërkombëtar më së shumti sikurse në nivel të Kosovë ashtu edhe në komunën e Obiliqit ka ndodhur në vitet e '90 – ta dhe pas vitit 2000. Bilanci i migrimit ndërkombëtar për vitin 2011 ishte -142 (apo -142 migrantë në 1000 banorë) në Kosovë. Komunat me bilancin më të lartë negativ të migrimit ishin: Suhareka me 40.2, Klina me 29.1, Mitrovica me 28.3 si dhe Gjakova me -25.4% (ASK, 2014), ndërsa Obiliqi -15.9%.



Grafiku 2. Migrimi ndërkombëtar sipas komunës, gjinisë dhe viteve

Persona të cilët jetojnë jashtë Komunës së Obiliqit sipas komunës së lindjes, gjinisë dhe vendit të qëndrimit aktual janë: gjithsej 4,381 qytetar prej numrit të përgjithshëm 2,418 meshkuj dhe 1,963 femra. Bilanci i migrimit ndërkombëtar në komunën e Obiliqit është -15.9% (ASK, 2014). Sa i përket migrimit kombëtar, Komuna e Obiliqit renditët në mesin e njëzet komunave të Kosovës me shkallën më të madhe të migrimit. Rreth 4,823 qytetarë kanë emigruar nga komuna e Obiliqit (emigrimi kombëtar) dhe janë vendosur në komunat tjera të Kosovës (ASK, 2014). Këto të dhëna tregojnë komuna është duke humbur një numër të konsiderueshëm të popullsisë (migrim neto negative). Bilanci i migrimit kombëtar në Komunën e Obiliqit është – 0.2%.

Pavarësisht migrimit ndërkombëtar dhe atij kombëtar, qytetarët që kanë migruar kanë pasuri të paluajtshme dhe vizitojnë Obiliqin gjatë vitit dhe, natyrisht se planifikimet në infrastrukturë dhe shërbime publike komuna duhet të planifikoj edhe për këtë kategori të qytetarëve.

3.1.3. Numri i ekonomive familjare

Regjistrimi i fundit i ekonomive familjare i vitit 2011 tregon një rënie të numrit të ekonomive familjare, sepse një pjesë e madhe e banorëve të Komunës i kanë takuar përkatësisë etnike Serbe që luftës kanë braktisur vendin, apo nuk kanë pranuar të jenë pjesë e regjistrimeve të popullsisë nga ASK të vitit 2011. Ndërsa në vitin 2022, në komunën e Obiliqit janë regjistruar 5,185 ekonomi familjare nga listat e tatimit në pronë[19], ku vërehet një diskrapancë në të dhëna.

Vitet	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Vendbanimet							
Baimofc	98	115	123	169	182	205	57
Bakshi	34	38	37	48	56	76	100
Breznicë	139	145	166	189	196	237	190
Cërkvena Vodicë	107	144	193	220	257	269	159
Dobrosellë	10	13	10	10	10	10	10
Grabofc i Epërm	31	27	42	60	70	100	58
Hade	106	129	168	246	237	269	160
Hamidi	21	21	19	19	23	28	27
Kozaricë	:	:	:	:	:	:	68
Kryshefc	70	176	177	234	268	304	197
Leshkoshiq	62	66	76	82	113	125	128
Llazarevë	18	15	23	20	29	34	71
Mazgit	63	79	103	175	277	331	487
Milloshevë	105	111	147	166	212	264	316
Minierë e Kosovës	106	121	123	77	61	53	53
Obiliq	222	325	960	1386	1554	2075	1272
Plemetin	90	105	150	212	275	321	235
Raskovë	23	27	36	45	54	64	113
Sibovc	87	87	109	155	200	217	167
Shipitullë	41	43	49	60	56	55	47
Gjithsej	1433	1787	2711	3573	4130	5037	3852

Tabela 98 Numri i ekonomive familjare sipas vendbanimeve ndër vite 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011, ASK 2011

Që nga viti 1971 e deri në vitin 1991, vërehet një rritje të numrit të ekonomive familjare prej 28%. Numri ekonomive familjare ka pasur rritje në qytetin e Obiliqit dhe vendbanimet e afërta dhe rrafshinore mirëpo, ka një tendencë të vazhdueshme të zvogëlimit në vendbanimet me distancë të theksuar nga zona urbane dhe vendbanimet kodrinore malore. Rreth 64% e ekonomive familjare janë të koncentruar në qytetin e Obiliq pastaj, në vendbanimet e rrafshit si Mazgit, Milloshevë, Plemetin dhe Krushevc.

3.1.4. Projeksionet e popullsisë dhe ekonomive familjare

Është e rëndësishme të kuptohet edhe perspektiva e dinamikës së popullsisë në 8-10 viteve që vijnë, në mënyrë që të planifikohen hapësirat dhe shërbimet në mënyrë efecientë dhe realiste. Për të simuluar dinamikën e popullsisë midis 2011 deri sot është marrë vlera e rritjes mesatare të 60 viteve të fundit të popullsisë rezidente të vendbanimeve përkatëse. Mirëpo, projeksionet demografike gjithashtu do të bazohen edhe në kushte paraprake dhe prezumime tjera përveç mesatares së rritje/uljeve të popullsisë në vendbanime. Prezumimet shërbejnë si vlera karahasimore të numrit të popullsisë rezidente/ të përgjithshme dhe si bazë për ndërtimin e skenarëve. Kushti paraprak kryesor i parë është që ka diskrapancë të numrit të banorëve të regjistruar (popullsisë rezidente) më 2011 dhe vlerësimeve të 2019 (Vjetari Statistikor, ASK, 2020), si dhe të dhënave tjera për popullsinë rezidente dhe të përgjithshme. Për shembull, 1) në vitin 2017, në komunën e Obiliqit ishin regjistruar 24,582 votues[20]. Diskrapancat e tilla janë si shkak i fenomenit se një pjesë e konsiderueshme e popullatës jeton dhe vepron jashtë vendit dhe e cila po vazhdon të mungojë në regjistrat e popullsisë rezidente në Kosovë. ASK raporton se në përgjithësi raporti mes popullsisë së përgjithshme dhe popullsisë rezidente në Kosovë qëndron mes një raporti 70%- 30%, ku rreth 30% besohet të jetë popullsia jo rezidente.

Vlerësim në vite	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019

[19] Zyra së Tatimit në Pronë, Komuna e Obiliqit, 2020.

[20] Numri i votuesve për komunat e Republikës së Kosovës. Lista Përfundimtare e Votuesve, 2017. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Numri i popullsisë	22.011	22.105	21.056	19.165	18.994	19.144	18. 660	17.899

Tabela 99 Vlerësimet ndër vite të numrit të popullsisë rezidente në Obiliq. Vjetari Statistikor, ASK, 2020.

Ndërkohë presupozohet që proceset urbanizuese do jenë ende shumë dinamike dhe të larta në efektin e tyre në zonën urbane në Obiliq. Një skenar i tillë mbështetet në hipotezën që proceset emigratore do frenohen dhe do orientohen drejt migrimit në qytet, si një vend të mirë për t'u vendosur e jetuar e për të rritur brezat e rinj. Kjo do të thoshte që Obiliqi të kthehej në një qendër atraktive jo vetëm për punësim, por për jetesë, shkollim e shërbime sociale kryesisht për familjet e reja.

Prezumimi i parë është që popullsia e Obiliqit do vazhdojë trendin e lartë të rritjes natyrale. ASK vlerëson që rritja natyrale e Kosovës është në nivelin e 0.9%-1.0%. Prezumimi i dytë është që proceset urbanizuese do të vazhdojnë edhe në 10 vjetorin që vjen. Prezumimi i tretë është që dinamikat e rritjes së popullsisë do të luhaten midis mesatares historike të këtyre proceseve dhe mesatares së tendencës së këtij fenomeni. Andaj, për të llogaritur projeksionet demografike që do të reflektonin vlera më të përafërta me numrin e përgjithshëm të popullsisë në komunë të Obiliqit, është marrë për skenar përfundimtar Skenari Realist.

Skenarët	Vitet								
Pesimist	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Urban	4,568	4,385	4,210	4,042	3,881	3,726	3,578	3,435	3,298
Rural	13,590	13 401	13,215	13,032	12,851	12,673	12,497	12,324	12,153
Total	18,157	17,786	17,426	17,074	16,732	16,399	16,074	15,758	15,450
Realist	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Urban	4,802	4,847	4,892	4,937	4,983	5,029	5,076	5,123	5,171
Rural	13,904	13,965	14,027	14,089	14,152	14,215	14,279	14,343	14,408
Total	18,705	18,812	18,919	19,026	19,135	19,245	19,355	19,466	19,578
Optimist	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Urban	7,013	7,339	7,680	8,037	8,411	8,802	9,211	9,639	10,087
Rural	14,001	14,235	14,473	14,716	14,962	15,214	15,469	15,730	15,995
Total	21,015	21,575	22,154	22,753	23,373	24,015	24,680	25,369	26,082

Tabela 100 Projeksioni i Popullsisë, Komuna Obiliq 2022- 2030 sipas Skenarëve (Pesimist, Realist dhe Optimist)

Bazuar në trendët e numrit të banorëve përgjatë 68 viteve të kaluara, si dhe prezumimeve tjera, të dhënave plotësuese, vlerësohet se pas 8 viteve, në vitin 2030 në Komunë do të jetojnë gjithsejtë 19,578 banorë, ku 5,171 banorë parashihen të jetojnë në zonën urbane, gjersa 14,408 në zonën rurale.

Vendbanimet	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Baimofc	316	317	317	318	319	319	320	321	321	322
Bakshi	649	651	652	653	655	656	658	659	661	662
Breznicë	1,233	1,235	1,238	1,241	1,243	1,246	1,249	1,251	1,254	1,257
Cërkvena Vodicë	648	649	651	652	653	655	656	658	659	660
Dobrosellë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Grabofc i Epërm	314	314	315	316	316	317	318	319	319	320
Hade	376	377	378	379	380	380	381	382	383	384
Hamidi	138	138	138	139	139	139	140	140	140	141
Kozaricë										
Kryshefc	639	640	641	643	644	645	647	648	650	651
Leshkoshiq	598	599	601	602	603	605	606	607	609	610
Llazarevë	753	754	756	758	759	761	762	764	766	767
Mazgit	3,145	3,175	3,204	3,234	3,264	3,294	3,325	3,356	3,387	3,418
Milloshevë	2 087	2 091	2 096	2 100	2 105	2 110	2 114	2 119	2 123	2 128
Minierë e Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Obiliq	4,802	4,847	4,892	4,937	4,983	5,029	5,076	5,123	5,171	5,219
Plemetin	1,271	1,283	1,295	1,307	1,319	1,331	1,343	1,356	1,368	1,381
Raskovë	689	690	692	693	695	696	698	699	701	702
Sibovc	821	823	824	826	828	830	831	833	835	837
Shipitullë	228	229	229	230	230	231	231	231	232	232
URBAN	4,802	4,847	4,892	4,937	4,983	5,029	5,076	5,123	5,171	5,219
RURAL	13,904	13,965	14,027	14,089	14,152	14,215	14,279	14,343	14,408	14,473
TOTAL	18,705	18,812	18,919	19,026	19,135	19,245	19,355	19,466	19,578	19,692

DRAFT

Tabela 101 Projeksioni i numrit të banorëve në vitet 2021-2030

Bazuar në trendët e numrit të ekonomive familjare përgjatë 68 viteve të kaluara, vlerësohet se pas 8 viteve, në vitin 2030 në Komunë parashihet të ketë gjithsejtë së paku 4,021 ekonomi familjare, nga të cilat në zonën urbane parashihet të ketë së paku 3,891 ekonomi familjare.

Vendbanimet	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Baimofc	43	44	45	46	46	47	48	49	50	51
Bakshi	128	130	133	135	138	141	144	147	149	152
Breznicë	188	191	195	199	203	207	211	215	219	224
Cërkvena Vodicë	113	116	118	120	123	125	128	130	133	135
Dobrosellë	9	9	9	10	10	10	10	10	10	11
Grabofc i Epërm	61	62	63	64	66	67	68	70	71	72
Hade	124	127	129	132	134	137	140	143	145	148
Hamidi	28	29	29	30	30	31	32	32	33	34
Kozaricë	36	36	37	38	39	39	40	41	42	43
Kryshefc	78	79	81	83	84	86	88	89	91	93
Leshkoshiq	139	142	145	147	150	153	156	159	163	166
Llazarevë	123	125	128	130	133	135	138	141	143	146
Mazgit	536	547	558	569	580	591	603	615	627	640
Milloshevë	332	339	345	352	359	366	374	381	388	396
Minierë e Kosovës	45	46	47	48	48	49	50	51	52	53
Obiliq	701	705	708	711	715	718	722	725	729	732
Plemetin	209	223	239	255	272	291	310	332	354	378
Raskovë	145	148	151	154	157	160	163	167	170	173
Sibovc	166	169	172	176	179	183	186	190	194	198
Shipitullë	38	39	40	41	41	42	43	44	45	46
URBAN	701	705	708	711	715	718	722	725	729	732
RURAL	2,541	2,602	2,664	2,728	2,794	2,862	2,933	3,006	3,081	3,159
TOTAL	3,243	3,306	3,372	3,439	3,509	3,580	3,654	3,731	3,809	3,891

Tabela 102 Projeksioni i numrit të ekonomive familjare në vitet 2021-2030

3.2. ZHVILLIMI EKONOMIK

3.2.1. Gjendja e sektorëve ekonomik

Nga analiza e cila është bërë me GIS, kuptohet që 2.6% e hapësirës së komunës së Obiliqit shfrytëzohet për nevoja të industrisë, 8.76% është hapësirë e banueshme, 62% është tokë bujqësore dhe 11% është tokë pyjore. Zona industriale dhe mihjet janë të lidhura ngushtë me zonat më shumë të populluara dhe me tokën më kualitative bujqësore. Edhe pse është një fond i konsiderueshëm i tokës bujqësore, megjithatë vështirë mund të flitet për mundësitë e zhvillimit të bujqësisë moderne, jo aq pse industria, mihjet sipërfaqësore dhe hapësirat urbane e zënë tokën më kualitative, por më shumë për arsye të ndotjes enorme që shkaktojnë kapacitetet energjetike vendore (KEK) e që mund të konsiderohen si pengesë për zhvillimin e bujqësisë.

Energjia. Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Ndër bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik në komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit. Eksploatimi i linjitit, është bërë që gati 100 vjet dhe operacionet e mëdha siç shihen sot me mihje sipërfaqësore dhe prodhim të energjisë elektrike kanë funksionuar që gati 50 vjet, pa ndonjë brengë për ndikimet në popullsi dhe mjedis. Veprimtarinë ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energjetike e Kosovës - KEK sh.a. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive të cilat janë prona të KEK sh.a. Zona e KEK-ut, gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e Lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra. Të dyja minierat aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë duke avancuar në drejtime të kundërta. Ngjitur me TC A, gjendet një zonë e braktisur industriale ku kanë qenë në veprim impianti i gazifikimit të thëngjillit dhe azotikut deri para më shumë se 10 viteve.

Qeveria ka propozuar Projektin për Asistencë Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL) dhe ka mbështetur zhvillimin e një projekti të përbërë prej tre komponentëve, përmes investimit të drejtpërdrejtë të jashtëm:

1) Ndërtimin e një termocentrali të ri, "Kosova e Re" me një kapacitet që do të mundësonte zëvendësimin në faza të kapaciteteve të vjetra të prodhimit (1,478 MW), dhe do të sigurohej furnizimi afatgjatë me energji elektrike me çmime konkurruese përderisa do të përmbushej kërkesa vendore,

2) Rehabilitimin e blloqeve të caktuara në termocentralet ekzistuese deri në ndërtimin e blloqeve të para të Kosovës së Re, për të përmbushur kërkesën vendore në kuptimin afatmesëm, dhe

3) Zhvillimin e një miniere të re për të furnizuar TC A dhe B në kuptim afatmesëm dhe furnizim me lëndë djegëse për Kosovën e Re për kohëzgjatjen e vet operacionale prej 40 vitesh.

Zona industriale. Krijimi i Zonës Industriale ka për qëllim: nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Komunë duke ju ofruar infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim të veprimtarisë, ta ndihmoj zhvillimin ekonomik në komunë-sektorin privat, gjenerimin e vendeve të reja të punës, krijimin e të ardhurave, nxitjen e investimeve në teknologji të përparuara, përqendrimin e bizneseve në një vend, rritjen e konkurrencës në bizneseve, zgjerimin e bashkëpunimit me biznese, dhe krijimin e kushteve lehtësuese për zhvillim të bizneseve.

Kësaj zone i shërben pozita e favorshme gjeografike, afërsia me kryeqytet dhe Fushë Kosovë, që të dyja zona të rëndësishme për biznes, dalja në magjistralen M2 (Prishtinë-Mitrovicë), qasje në autoudhën "Ibrahim Rugova". Pozita e mirë gjeografike vlen edhe për tërheqjen e investimeve të brendshme si dhe të jashtme, kështu duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e biznesit. Edhe toka pjellore e cila shfrytëzohet për zhvillimin e bujqësisë është një nga përparësitë e këtë më shumë e fuqizon edhe rrjeti i Ibër Lepencit i cili mundëson ujitjen e 3479 ha tokë.

Pas miratimit të një qasjeje më të lehtë në infrastrukturë lidhje të mirë me transportin, furnizimin me energji, ujësjellës, kanalizim, ndriçim (infrastrukturë urbane) si dhe shërbime tjera përcjellëse në shërbim të bizneseve. (kjo zonë është aprovuar nga asambleja Komunale dhe është në pritje nga Ministrit përkatëse për fillimin e projektit).

Shfrytëzimi i resurseve natyrore. Eksploatimi i linjitit në Kosovë është duke u bërë që gati 100 vjet dhe operacionet e mëdha siç shihen sotme mihje sipërfaqësore dhe prodhim të energjisë elektrike kanë funksionuar që gati 50 vjet, pa ndonjë brengë për ndikimet në popullsi dhe mjedis.

Zhvillimi i mihjeve të linjitit në periudhën e ardhshme është paraparë të ndodhë në pjesën veriore të basenit të linjitit "Kosova". Kjo pjesë njihet edhe me emrin "Fusha e Sibovcit" por me kërkesën e banorëve gjatë konsultimeve publike kjo fushë tani quhet "Mihja e Re". Deri në futjen në prodhim të termocentralit "Kosova e Re" do të nevojitet zgjerimi i mihjes, si vazhdimësi e mihjes në pjesën Jug-Perëndim. Sasia totale e shfrytëzueshme e linjitit në "Mihjen e Re" vlerësohet të jetë 830 milionë ton, e që do të mjafton për furnizim me linjit gjatë 40 viteve të ardhshme.

Industria prodhuese. Industria prodhuese është e vonuar në Komunën e Obiliqit. Por në vitet e fundit ka filluar veprimtaria në prodhimin e betonit, prodhimin e bllokut dhe manteve nga argjila, punime të përgjithshme mekanike, punime të dyerve dhe dritareve si dhe punime tjera nga plastika dhe nga druri i kualitetit të lartë. Për më tepër, ka filluar të rritet edhe prodhimi i disa mëlmesave dhe produkteve nga eurokremi si dhe paketimi i tyre.

Zona industriale në Llazarevë. Me përcaktimin e disa pronave komunale të Obiliqit, konkretisht pronave në Llazarevë, si zonë industriale, me Planin Zhvillimor të Komunës është paraparë që disa parcela të kësaj zone të ndahen si për investitorë të brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Me Planin Zhvillimor, parcelat e kësaj zone janë të ndara, por mungon infrastruktura për të futur në funksion zonën. Nevojitet funksionalizimi i zonës, nëpërmjet të realizimit të infrastrukturës teknike adekuate për zhvillim industrial dhe ekonomik. Viteve të fundit, bizneset industriale dhe komerciale janë koncentruar në zonën kadastrale Dardhishtë dhe Orlloviq, të shtrira përgjatë korridorit Prishtinë-Mitrovicë. Nevojitet planifikimi për biznese të tjera në këtë zonë.

Bujqësia dhe ekonomitë bujqësore. Bujqësia, si një sektor i zhvillimit ekonomik më rëndësi të madhe në aspektin e zhvillimit dhe avancimit, has në shumë probleme dhe sfida të cilat pamundësojnë zhvillimin e këtij sektori në mënyrën më të mirë të mundshme.

Edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Obiliqit, vërehet një rënie e interesimit për t'u angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël është i organizuar në ndërmarrje bujqësore. Gjithashtu, edhe blegtoria është në kufij mjaft të ulët të zhvillimit.

Sot shumë fusha me tokë kualitative bujqësore janë të lëna djerrë dhe shumica prodhojnë vetëm për konsum familjar. Përgjithësisht, rendimentet në prodhimet bujqësore janë të ulëta për disa arsye si:

- Nuk ka farëra me aftësi të larta prodhuese;
- Nuk funksionon sistemi i ujitjes;
- Plehrat kimike janë në sasi të pakta dhe;
- Nuk përdoren sasitë e duhura të pesticideve.

Shumica e ekonomive familjare në komunën e Obiliqit kultivojnë kryesisht grurin dhe misrin. Korrja dhe bluarja e drithërave kryesisht është e rregulluar në formë kooperative dhe në formë individuale. Nuk ka ndonjë fermë të madhe blegtorale, mirëpo kryesisht ka ferma të vogla dhe të mesme. Pronësia e tokës ndryshon sipas vendbanimeve, por shumica e banorëve kanë tokën në pronësi ku ata jetojnë dhe oborre e kopshte të vogla rreth shtëpisë që shfrytëzohen për prodhime bujqësore të nevojave vetanake.

Nga të dhënat për ekonomitë bujqësore konstatojmë se bujqësia në komunën e Obiliq është e organizuar në ekonomi të vogla bujqësore, ku shumica e prodhimeve përdoren për konsum vetanak dhe një pjesë e vogël destinohet për treg. Prandaj komuna apo DBPZHR duhet të krijoj politika apo mekanizma që këtë trend të zhvillimit të bujqësisë të ndryshojë dhe orientoj atë në krijimin e ndërmarrjeve bujqësore më kapacitete të larta prodhuese dhe përpunuese duke shfrytëzuar praktika dhe mekanizma modern bujqësorë konform rregullave dhe standardeve Evropiane apo edhe me gjerë.

Blegtoria dhe përpunimi i produkteve blegtorale. Momentalisht fondi i bagëtisë mbahet kryesisht për qumësht, për majmëri (mish) dhe produkte të tjera.

Pra, sektori blegtoral është i organizuar në ekonomi të vogla familjare ku pjesa e madhe e produkteve blegtorale dedikohen për konsum vetjak pra për nevoja familjare dhe pjesa tjetër plasohet në treg. ky është një indikacion që len të kuptohet se në të ardhmen duhet të investohet në krijimin e fermave intensive të kultivimit duke shfrytëzuar praktikat më të mira të mbarështimit të kafshëve.

Fondi i bagëtisë dhe ai i shpezëve nuk plotësojnë nevojat e qytetarëve të komunës së Obiliqit. Sigurisht që më pak se gjysmë litre qumësht dhe asnjë vezë e plotë për kokë banori janë shumë pak. Kjo tregon që blegtoria dhe shpezëtaria kanë pjesëmarrje të vogël në krijimin e të ardhurave të përgjithshme të qytetarëve. Blegtoria dhe shpezëtaria kanë një prodhim ditor monetar përafërsisht 5600 euro. Edhe pse ka potencial të zhvillimit të blegtorisë dhe bujqësisë duke përjashtuar ndikimin negativ të energjetikës, këto degë janë të pazhvilluara.

Po ashtu edhe përpunimi i produkteve blegtorale nuk është në gjendjen më të mirë të mundshme, në komunën e Obiliqit operojnë disa biznese që merren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve blegtorale si qumështore apo përpunues të mishit, por këto pika nuk mundë ti përmbushin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për konsum, andaj rëndësia e krijimit të ndërmarrjeve përpunuese dhe grumbullues është e rëndësishme dhe do të krijonte një impakt të lartë ekonomik duke krijuar vende të reja të punës dhe burime të ardhurave për një numër të madh të familjeve.

Krijimi i ndërmarrjeve përpunuese dhe prodhuese do të krijonte një impakt të lart në krijimin e një zinxhirit bashkëpunues ndërmjet prodhuesve (fermerëve) dhe përpunuesve, ku këta të paret do të krijonin një stabilitet në aspektin e prodhimit konsistent me potencial të rritjes duke pasur plasimin e produktit në treg të sigurt dhe çmime reale të tregut. Prandaj, institucionet duhet të krijoni politika në përkrahjen e zhvillimit të këtij zinxhirin prodhues-përpunues duke përkrahur ata me forma të ndryshme financiare dhe eliminim të barrierave të ndryshme ekonomike.

Problemet dhe sfidat e bujqësisë dhe blegtorisë. Problemet dhe sfidat më të mëdha të cilat prekin këtë sektor janë: humbja e tokës më të mirë bujqësore nga zhvillimet e ndryshme hapësinore. Fragmentimi i tokës bujqësore, shkatërrimi i tokave bujqësore me sistem të ujitjes si dhe vet sistemin, humbja e tokës në komasacion, ndotja e tokës bujqësore, vërshimi i tokave bujqësore, mos shfrytëzimi racional i tokës bujqësore, fondi i vogël i kafshëve dhe prodhimtari e ulët e produkteve blegtorale.

Humbja e tokës bujqësore: Sfida më e madhe si në nivelin nacional dhe atë lokal është mbrojtja e tokës bujqësore nga humbja apo ndryshimi i destinimit, duke ditur se zhvillimet më të madha kanë ndodhur dhe po ndodhin përkatësisht në tokat më të mira bujqësore. Sipas analizave të bëra në komunën e Obiliqit çdo vite humbet tokë bujqësore e kualitetit të lartë përkatësisht klasa 1-4 si pasojë e zhvillimeve hapësinore si: objekte banimi, objekte komerciale/afariste, infrastrukturës rrugore dhe si rezultat i saj niveli nacional ka hartuar ligje në aspektin e mbrojtjes së tokës bujqësore ku komunat obligon qe me dokumente hapësinor të definojë dhe planifikoj tokën bujqësore.

Sipërfaqja e mbetur prej 6524 ha tokë bujqësore është e ndarë në parcela me sipërfaqe jashtëzakonisht të vogla, të cilat gjenden pothuajse të tërat në pronësi private. Vlerësohet se në kuadër të tokës bujqësore kemi një humbje të konsiderueshme ku nga viti 2012 e deri në vitin 2019 kemi humbur 327.60 ha, ku i bie që për shtatë vite kemi 46.80 ha më pak për çdo vit.

Nga kjo prognozojmë që nëse vazhdohet me një trend të tillë edhe për shtatë vite të ardhshme komuna e Obiliqit do të ketë edhe 6196.43 ha, të humbura nga toka bujqësore deri në vitin 2027.

Fragmentimi i tokës bujqësore: Fragmentimi si proces në komunën e Obiliqit është i theksuar dhe si rezultat i saj sjell probleme të mëdha në ruajtjen menaxhimin dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore në formë racionale.

Fragmentimi si proces pamundëson fermerët që të zhvillojnë bujqësi intensive si rezultat i parcelave të vogla, dhe në bazë të të dhënave në Kosovë mesatarja e parcelave sillet nga 0.18 - 0.25 ha gjë që reflekton një sfidë sa i përket shfrytëzimit racional të tokave bujqësore.

Fragmentimi i tokës dëshmon të jetë pengesa kryesore kur bëhet fjalë për përdorimin e tokës përkundrejt politikave për zhvillim bujqësor në vend. Më pas, ekziston një sektor i polarizuar bujqësor me disa prona të mëdha dhe një sektor të madh të pronave të vogla. Struktura e shpërndarjes së madhësisë ilustrohet me rreth 80% të numrit të fermave që janë më pak se 4 ha dhe të fragmentuara. Vetëm 0,6% e fermave janë më shumë se 10 ha. Për këtë mund të shtohet se procesi i nënndarjes në trashëgimi po vazhdon. Madhësia mesatare e një ferme për një ekonomi familjare është 2-3ha tokë bujqësore e punueshme, zakonisht e fragmentuar në 6- 8 parcela kadastrale. Madhësia mesatare e parcelës kadastrale është 0.30 ha.

Si rezultat i zhvillimeve në aspektin e fragmentimit ministra e bujqësisë dhe zhvillimit rural ka hartuar ligjin për mbrojtjen e tokave bujqësore ku në kuadër të këtij ligji ka parashtruar masat që duhen të aplikohen në këtë aspekt.

Masat kundër fragmentuese janë:

- toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e se cilës është ≤0.50 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela;
- toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela.

Konsolidimi i tokës bujqësore (komasacioni): Për gjatë viteve të 80-ta në Kosovë ka ndodhë komasacioni i tokave bujqësore në disa qytete dhe zona të caktuara, ky proces ka prekur edhe komunën e Obiliqit ku në disa zona të caktuar ka ndodhur komasacioni i tokave bujqësore. Por, sot këto zona të cilat konsiderohen si zonat më të mira të tokës bujqësore nuk janë ruajtur dhe si rezultat i saj në këto zona kemi zhvillime në aspektin e ndërtimit dhe si pasojë humbje apo shkatërrimi të këtyre tokave të cilat konsiderohen edhe si hambari i Komunës së Obiliqit. Sipas Ligjit për Toka Bujqësore, këto ndërtime në kuadër të tokave nën komasacion konsiderohen ndërtime ilegale. Por sipas Ligjit për Ndërtimet pa leje, këto ndërtime i trajton si ndërtim në pritje, të cilat nevojitet të trajtohen në të ardhmen dhe si të tilla janë të paraqitura edhe në hartën e shfrytëzimit të tokës

Në Obiliqit në vitet 83-89, janë zbatuar plane të komasacionit në zonën kadastrale Mazgit:

- Zona kadastrale Mazgit e cila gjendet nën komasacion ka një sipërfaqe prej 639.77 ha ku përbën 6.10 % të sipërfaqes së territorit të Komunës. Momentalisht rreth 30% e sipërfaqes nën komasacion në këtë zonë kadastrale është e mbuluar me ndërtime ilegale.




Figura 10. Ndërtimet në zonën e komasacionit

Sipas Ligjit për Toka Bujqësore, këto ndërtime në kuadër të tokave nën komasacion konsiderohen ndërtime ilegale. Por sipas Ligjit për Ndërtimet pa leje, këto ndërtime i trajton si ndërtim në pritje, të cilat nevojitet të trajtohen në të ardhmen dhe si të tilla janë të paraqitura edhe në hartën e shfrytëzimit të tokës.

Po ashtu bazuar nga gjendjen faktike nga tereni shumë vite më parë ka filluar procesi i komasacionit për rregullimin e tokave bujqësore, procesi në fjalë në teren nuk ka përfunduar dhe nuk është ekzekutuar në kadastër pikërisht për faktin se realiteti në teren ka ndryshuar me ndërtimin e objekteve nga ana e pronarëve të këtyre tokave ashtu siç është cek më lartë shumë vite më parë.

Andaj përmes këtij dokumenti të planifikimit hapësinor Komuna synon zhbllokimin e këtyre tokave nga një proces i cili nuk ekziston në praktikë dhe duhet të ju jepet statusi apo epiteti i tokave ndërtimore, ndërsa ndërtimet që janë evidente i trajton Ligji për Ndërtimet pa leje si ndërtim në pritje deri në aprovimin e dokumentit hapësinor.

Ujitja e tokës bujqësore: Komuna e Obiliqit posedon sistem te ujitjes së tokave bujqësore e cila mbulon mbi 2,000 ha tokë bujqësore me ujitje të kualitetit të lartë, ky sistem i ujitjes është nën kompetenca te kompanisë regjionale 'Ibër Lepencit'. Gjendja e sistemit te ujitjes nuk është në nivelin më të mire për arsye të mos menaxhimit dhe mirëmbajtjes. Në baze të kapaciteteve ky sistem mund të mbulojë sipërfaqe më të mëdha me ujitje, por në mungesë të investimeve ky sistem nuk është shtrirë dhe avancuar me shumë. Prandaj komuna në bashkëpunim me 'Ibër Lepencin' duhet të diskutojnë dhe harmonizojnë mënyrën e investimit në këtë sistem në aspektin e mundësisë së mbulueshmërisë më të madhe dhe menaxhimit më të mirë.

Si përfundim duke ditur rëndësinë e ujit në sektorin e bujqësisë komuna së bashku me kompaninë regjionale Ibër Lepencin duhet të harmonizojnë objektivat e tyre dhe së bashku të investohet në aspektin e menaxhimit dhe zgjerimit të rrjetit.

Duke marrë parasysh që ky sistem i ujitjes së tokave bujqësore është i ndërtuat gjatë viteve 80-ta dhe që rezultat i kohës së gjatë nga ndërtimi i tij, ky sistem aktualisht në pjesën e madhe të shtrirjes hapësinore nuk është funksional dhe në shërbim të ujitjes së tokës bujqësore. Si rezultat i nevojave për banim kundrejt kufizimeve që përcaktojnë Plani Hapësinor 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" si dhe largpërçuesit të tensionit të lartë elektrik që shtrihen në territorin e Komunës së Obiliqit kanë krijuar një realitet të ri, ku vendbanimet Milloshevë dhe Mazgit janë shndërruar në nyje kryesore me intensitet të lartë të ndërtimeve për banim dhe zhvillim ekonomik. Andaj këto zhvillime duhet të shqyrtohen me një parim real gjatë planifikimit të shtrirjes hapësinore të zhvillimit të ardhëm brenda territorit të Komunë duke kompaktësuar zhvillimet e ardhme dhe kufizuar ato në zgjerime drejtë tokave në sistemin e ujitjes, gjersa në të njëjtë kohë duke përmbushur nevojat reale për zhvillimet e reja për banim dhe zhvillim ekonomik.

Siç vërehet në hartën vijuese, vlen të theksohet se në tokat të cilat janë nën sistem të ujitjes viteve të fundit ka pas zhvillime të ndërtimeve.




Figura 11. Gjendja e tokave bujqësore nën sistem të ujitjes

Si rezultat i nevojave për banim kundrejt kufizimeve që përcaktojnë Plani Hapësinor 2010 - 2020+ Zona me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" si dhe largpërçuesit të tensionit të lartë elektrik që shtrihen në territorin e Komunës së Obiliqit kanë krijuar një realitet të ri, ku vendbanimet Milloshevë dhe Mazgit janë shndërruar në nyje kryesore me intensitet të mesëm të ndërtimeve për banim dhe zhvillim ekonomik. Përderisa shumica e Komuna tjera ballafaqohen me rritjen e kërkesës për sipërfaqe të reja të banimit si rezultat i prognozave demografike dhe ndryshimeve shoqërore ku gjeneratat e reja nuk dëshirojnë të jetojnë më në bashkësi shumëfamiljare, Komuna e Obiliqit ka edhe një sfidë shtesë, atë të zhvendosjes të banorëve që aktualisht jetojnë në zonën e "Fushës të Mihjes së Re". Sfidë tjetër mbetet edhe territori që është në sistem të ujitjes jo funksional që kufizon ndërtime në këto sipërfaqe. Mirëpo, sistemi i ujitjes së tokës bujqësore brenda territorit të Komunës nuk ka qenë funksional për shumë vite dhe ende mbetet në gjendje të tillë, ku tokat bujqësore nuk kanë qasje në sistem të ujitjes, e cila dëshmohet edhe nga letra zyrtare nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh. a. të datës 06.12.2018.

Andaj këto zhvillime duhet të shqyrtohen me një parim real gjatë planifikimit të shtrirjes hapësinore të zhvillimit të ardhëm brenda territorit të Komunës duke kompaktësuar zhvillimet e ardhme dhe kufizuar ato në zgjerime drejtë tokave në sistemin e ujitjes, gjersa në të njëjtë kohë duke përmbushur nevojat reale për zhvillimet e reja për banim dhe zhvillim ekonomik.

Sipas Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re":

- Hapësirat e ndërtuara, për nevoja strehimi apo veprimi të popullatës, në vendbanime në kuadër të zonës së FMR-së, zënë rreth 11% të sipërfaqes së tërësishme të kësaj zone gjegjësisht shtrihen në 1.702 ha. Qyteti i Obiliqit dhe ai i Fushë Kosovës janë dy qendra urbane dhe njëherit të dy qendrat komunale brenda zonës së FMR-së. Të gjitha vendbanimet tjera, të cilat gjenden në këtë zonë të interesit, janë kryesisht vendbanime të karakterit rural, pra janë fshatra të banuara me popullatë që merren me veprimtari kryesisht bujqësore.
- Veprimet dhe aktivitetet, që do të zhvillohen në FMR, e që për rezultat do të sjellin ndryshime në destinimin e tokës bujqësore janë:
    - Hapja e minierës së re (në Fushën "C" ose me qendër Sibovcin);
    - Vendosja e pajisjeve për transportimin e linjitit dhe gypat për transport hidraulik të hirit;
    - Rivendosja e vendbanimeve të zhvendosura në sipërfaqet e reja të tokës bujqësorë;
    - Ndotja e tokave bujqësore për rreth termocentralit nga pluhuri qe del nga tymtarët, nga shirat acidik si dhe nga deponite e hirit (që llogariten të kenë një radius veprimi në tokat bujqësore për rreth).
- Zhvillimi i procesit të zhvendosjes - rivendosjes së popullatës nga vendbanimet në fushën e re të mihjes, gjithashtu, ka rëndësi të veçantë, bile shumë të ndjeshme. Rivendosja e tyre në vendbanimet e reja, kërkon planifikim dhe kontrollë në densifikim dhe zgjerim të vendbanimeve ekzistuese në një mjedis jetësor më të pastër. Kjo arrihet me hartimin e planeve rregulluese urbane, dhe janë më të pranueshme kur zhvillohen brenda zonës së interesit apo edhe brenda vetë komunës së Obiliqit.
- Përcaktimi i lokacionit dhe hartimi planeve për rivendosje – Përzgjedhjes së lokacionit për rivendosjen e popullatës së zhvendosur para së gjithash duhet ti paraprijnë hulumtimet dhe analizat të cilat nxjerrin në pah interesin e banorëve për rilokimin e tyre të ardhshëm. Është e domosdoshme që pas përcaktimit për lokacionet e parapëlqyera të kërkohet hartimi i planeve rregulluese për ato zona. Këtu mund të preferohen, zonat e ndërtuar (në vendbanimet ekzistuese të komunës së Obiliqit) me një shpeshtim (densifikim) të objekteve apo edhe të ndërtimeve në vertikale (në etazhe) brenda vendbanimeve (p.sh. Obiliq, Mazgit, Milloshevë dhe Graboc i Epërm), me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore. Në bashkëpunim me komunitetin dhe organet gjegjëse do të vendoset për formën dhe pozitën e objekteve të kultit, të përmendoreve dhe të varrezave si çështje më e ndjeshme shpirtërore, të cilat janë po ashtu pjesë e Planeve Rregulluese Urbane(tani Plane Rregulluese të Hollësishme) që do të hartohen për vendet e dedikuara për rivendosjen e popullatës nga vendbanimet e zhvendosura.

Siç vërehet në hartën vijuese, për shkak të kufizimeve me dispozita nga Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" , mirëpo edhe për shkak të ndotjes së mjedisit nga termocentralet Kosova A dhe B, vlen të theksohet se në tokat të cilat janë nën sistem të ujitjes viteve të fundit ka pas zhvillime të ndërtimeve duke përfshirë edhe ndërtime pa leje çka do të thotë se është krijuar realitet i ri në këto zona.

Ndotja e tokës: Një ndër sfidat më të mëdha që nga lufte e fundit e tutje në Kosovë në përgjithësi është ndotja e tokave në përgjithësi nga format dhe mënyrat e ndryshme. Edhe pse nuk kemi ndonjë raport zyrë i cili do të tregonte më saktësi nivelin formën dhe llojin e ndotjes së tokës por, ndotja është evidente.

Komuna e Obiliqit si komunë me zhvillime industriale si rezultat i pranisë së korporatave industriale dhe termocentralin Kosova A dhe B në Obiliq, të cilat me vite me radhë kanë shkaktuar ndotje të cilat ndotje kanë afektuar edhe tokat bujqësore në forma dhe nivele të ndryshme.

Shumë studime kanë hetuar kontaminimin mjedisor, kontrollin potencial dhe masat korrigjuese për të menaxhuar ndikimin mjedisor nga Termocentrali Kosova A dhe B. Dy ndikimet kryesore janë shkarkimet në ujëra sipërfaqësorë të ujërave nga minierat dhe pellgjet e sterileve, deponitë e hirit, lirimi i pluhurit nga sipërfaqet e deponive dhe tymi i cili lirohet nga këto dy korporata shtojnë një ndikim të madh në ndotjen e tokave bujqësore dhe pastaj përmes produkteve bujqësore edhe në njerëz.

Intensifikimin e ndotjes së tokës si pasoje e prodhimit bujqësor po bëhet një problem në rritje. Ndotja e tokave ndikon në cilësinë dhe funksionin e tyre, në të ushqyerit e bimëve dhe si pasoje ne të gjithë ekosistemin. Ndotja e tokës është problematike, sepse frutat që janë prodhuar në këto sipërfaqe të cilat kane absorbuar një pjesë të substancave të dëmshme përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut apo dhe substanca të dëmshme te prodhuara nga shpëlarje mund të hyjnë ne shtresat nëntokësore dhe shkaktojnë ndotjen e tyre. Burimet e ndotjes së tokës ka shumë. Shumica e substancave të dëmshme që ndotin tokën janë rezultat i aktivitetit njerëzor. Disa nga burimet kryesore të ndotjes së tokës janë:

- Përdorimi i plehrave minerale,
- Rrjedhjet industriale,
- Mbeturinave të ngurta bujqësore
- Ujë për ujitje i kualitetit të pamjaftueshëm,
- Kontaminimi i pavëmendshëm i tokës mund te behet prej kompozimeve kimike që përdoren në bujqësi (p.sh. pajisjet, siguria, plehrat e lëngshme, lubrifikantë, lëndë djegëse, etj).
- Ndotja e tokës nga pesticidet.

Vërshimet në toka bujqësore: Sipas vlerësimit të dhënave tokat bujqësore përgjatë lumenjve Sitnica, Drenica dhe Llapi janë të rrezikuara nga vërshimet dhe raste të caktuara edhe të vërshuar, dhe si rezultat i saj sjell dëme të konsiderueshme në prodhimet bujqësore. Sipas të dhënave rreth **1,700 ha** të tokës bujqësore janë të rrezikuara nga vërshimet, si pasojë e mos menaxhimit të shtarëtit të lumit nga mbeturinat dhe përmbajtje tjera natyrore. Masat dhe rekomandimet që duhet të ndërmerren për parandalimin e vërshimeve në toka bujqësore:

- Ndërtimi i rezervuarëve ose trupave ujor artificial në ujë mbledhësit për të qetësuar rrjedhat e përmbytjeve;
- Ndërtimi i skelave dhe brigjeve kundër përmbytjes rreth pronave të rëndësishme për të parandaluar përmbytjen;
- Zgjerimi i kanaleve ekzistuese ose lumenjve për të zvogëluar nivelin e përmbytjes ose për të përmirësuar regjimin e rrjedhës;
- Ndërtimi i kanaleve anësore për shmangie artificiale të përmbytjeve;
- Nxitja e zonimit të fushave lymore me masat përcjellës të planifikimit;
- Zbatimi i masave inxhinierive për kullim, gjegjësisht ruajtja e ujërave dhe objektet e pompimit
- Praktika e ruajtjes së tokës dhe masat përforcuese për brigje të lumenjve;
- Organizimi i planifikimit të emergjencës, masave dhe mobilizimit të mjeteve dhe materialeve;
- Përmirësimi i parashikimit të përmbytjes me sistemin e paralajmërimit.
- Mirëmbajtja dhe thellimi i vazhdueshëm i shtretërve të lumenjve dhe argjinaturave dhe bankinave.

Zonat me rrezik nga përmbytjet nuk preferohet të përdoren për kultivim lavërtarë, vegjetacioni natyror kultivimi i pemëve apo shfrytëzimi i përzier, pra këto hapësira janë me të përshtatshme për kultivimin e bimëve drufrutore për arsye që në rast të vërshimeve humbjet bujqësore janë më të vogla.

Prodhimtari e ulët e produkteve blegtorale. Në vitet e fundit kemi një ulje drastike të numrit të krerëve. Kjo ka ardhur për shumë arsye, si:

- Rënia e interesit për të ushtruar aktivitetin blegtoral;
- Mosfunksionimi i institucioneve që kryenin ose ndihmonin në përmirësimet racore.

Komuna së fundmi ka punuar në përmirësimin e racave blegtorale. Nga viti 2019, komuna subvencionon mbarësimin e lopëve qumështore. Gjithashtu, nga vitet 2018, komuna subvencion vaksinimin e lopëve, deleve dhe dhive.

Pylltaria. Prerja pa kriter e pyjeve dhe djegia e tyre prej veprimtarisë njerëzore, ndikon direkt në prishjen e ekuilibrave ekologjikë. Për këtë duhet rritur shkalla e ndërgjegjësimit të njerëzve për dëmin që po i shkaktojnë natyrës si rrjedhojë dhe shëndetit të tyre. Gjithashtu duhen bërë përmirësime ligjore me qëllim që pyjet dhe kullotat të kalojnë në pronësi të komunës, pasi kujdesi ndaj tyre do të jetë shumë më i madh.

Infrastruktura në shërbim të zhvillimit ekonomik. Vlerësohet se në komunën e Obiliqit duhet ende për të punuar në infrastrukturë, si në përmirësimin e situatës rrugore, rregullimin e trotuareve dhe urave, sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, me theks të veçantë në infrastrukturë të nevojshme për trajtim të ujërave të zeza dhe të mbeturinave. Me këtë synim do të përmirësohej dhe jeta e qytetarëve në përgjithësi, sidomos do të ndikonte në rritje të punësimit si dhe të hyrave financiare për komunën.

DRAFT

Turizmi. Shtëpia Muze gjendet në fshatin Hamidi, e shndërruar në "Muze Memorial i UÇK-së.", në të cilën është vendosur Shtabi i Zonës Operative të Shalës. Funksionalizimi i plotë i Shtëpisë-muze, si dhe organizimi i vizitave të nxënësve të Obiliqit e më gjerë, do të kishte ndikim në shfrytëzim të kapacitetet ekonomiko- turistik dhe zhvillimi si destinacion turistik. Në Grabofc të Epërm, në lokalitetet Lugu i Kishës dhe Maja e Zezë, duhet vazhduar eksplorimi dhe gërmimeve arkeologjike, pasi ka mbetur në harresë të kohës, pa gjurmuar themelet e saj si lokalitet. Funksionalizimi i dy monumenteve Mulliri i Behramajve[21] dhe i Hysenajve, parashihet nëpërmjet restaurimi i tij me vendosjen e kulmit, rrethoja-rregullimi i hapësirës së jashtme dhe të brendshme. Kurse, për trashëgiminë arkeologjike në fshatin Dardhishtë, si dhe më gjerë në Obiliq, nevojitet hartimi I një studim i fizibilitetit dhe master plani për gjurmime arkeologjike në tërë territorin e Obiliqit.

Fatmirësisht, në komunën e Obiliqit me malet si malet e Qyqavicës dhe malet e Kozaricës, ka potencial të fuqishëm për zhvillim të turizmi i gjuetisë dhe peshkatarisë. Këto dy zona të shpallen si zonë me interes të veçantë për zhvillim turistik- malor. Gjithashtu, edhe në pjesën veriore, posaçërisht vendasit e fshatit Zhilivodë, në mënyrë ilegale, akoma merren me aktivitete të gjuetisë. Dikur, këto rezervate, janë vizituar në mënyrë të organizuar nga njerëz të pasionuar me gjueti nga viset e ndryshme të Evropës, aktivitet ky që ka gjeneruar edhe të mira materiale. Komuna, dhe drejtoria përkatëse duhet të përcaktojnë zonat dhe zgjatjet kohore të gjuetisë, me qëllim legalizimin dhe rregullimin ekonomik dhe mjedisor të gjuetisë.

Po ashtu, me këtë PZHK dhe strategji përkatëse për zhvillim të turizmit, duhet të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të turizmit rekreativo-malor në pjesët kodrinoro-malore të komunës, siç janë: Grabofci dhe Kozarica. Mundësi tjetër për zhvillim të turizmit, është turizmit industrial, veçanërisht, në pjesët e deponive ekzistuese, apo gjatë dekomisionimit të pjesëve të termocentraleve ekzistuese.

Ndërsa, sa i përket zhvillimit të infrastrukturës në shërbim të turizmit etnologjik, nevojitet ndërtimi i një Muzeu Etnologjik në territorin e Komunës së Obiliqit-mundësisht pikë destinacioni të mbetet fshati Mazgit i Epërm- Llazarevë. PZHK ka identifikuar dhe idenë për krijimin e një Përmendore për Gruan, për kontributin e grave përgjatë viteve në periudha të ndryshme të luftërave të kombit tone.

Në përgjithësi, më këtë plan vlerësohet se duhet të fillohet menjëherë me restaurimin e objekteve kulturore dhe gërmimet arkeologjike, shenjëzimin e aseteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, organizimi i kurseve nga fusha e gastronomisë në bashkëpunim me bizneset hoteliere, si dhe të krijohen guida dhe ekspansione të kombinuara turistike të cilat do ti mundësonin turistëve të vizitojnë resurset humane dhe ato natyrore.

3.2.2. Lidhja e veprimtarive ekonomike me komunat fqinje

Bashkëpunimi ndër-komunal është një mënyrë efektive për komunat për të adresuar çështjet me rëndësi të ndërsjellë dhe çështje që tejkalojnë kufijtë e juridiksionit. Ka shumë mënyra se si komunat mund të punojnë së bashku për një çështje specifike, siç është krijimi i një zone ekonomike të përbashkët, projekte të transportit dhe infrastrukturës, mbrojtja e mjedisit, etj.

Komuna e Obiliqit ka nënshkruar një memorandum për zhvillimi e projektit dhe ndërtimin e një impianti për trajtim të ujërave të zeza. Me realizim të këtij projekti madhor, që zgjedh një problem si mjedisor por dhe social për banorët e Obiliqit, do të jepet mundësia për bashkëpunim ekonomik ndërmjet komunës së Obiliqit dhe komunave nënshkruese të memorandumit.

Bashkëpunim i ndërsjellë ekonomik, Komuna e Obiliqit ka paraqitur me rastin e planifikimit të nxehjes qendrore me kogjenerim, revitalizimin e që sjell të ardhura ekonomike por dhe sociale për banorët e Obiliqit.

Vlerësimi i hapësirave për veprimtari ekonomike- tregtare dhe industriale, rezultoi me mangësi të hapësirave/ nevojë për hapësira shtesë për veprimtari ekonomike. Komuna duhet shfrytëzuar ndërlidhjet rrugore, si M-2 shi dhe rruga për Prishtinë, si dhe së fundmi nyjellorja me autoudhën Ibrahim Rugova. Këto të fundit sjellin përparësi ekonomiko- strategjike për tërheqje të investimeve të brendshme dhe të jashtme, dhe në atë mënyrë duhet vazhduar veprimtaritë ekonomike në hapësirat përgjatë rrugës për Prishtinë dhe përgjatë M- 2. Zhvillimet përgjatë M- 2 duhet vazhduar në mënyrë të kontrolluar, gjithmonë në balancim me mbrojtjen e tokës bujqësore. Në kuadër të komunës së Prishtinës, viteve të fundit, përgjatë rrugës Prishtinë- Obiliq- Mitrovicë janë zhvilluar një sërë veprimtari ekonomike. Ndërsa, mundësitë e zgjerimit/ vazhdimit të hapësirave të përshtatshme për zona për industri/ tregti e të ngjashme edhe në territor të komunës së Obiliqit si vazhdimësi zhvillimore, duhet pasur si prioritet gjatë definimit të shfrytëzimit të planifikuar të tokës dhe zhvillimit të konceptit të zhvillimit ekonomik.

3.2.3. Gjendja e punësimit dhe papunësisë

Sa i përket punësimit në ndërmarrje ekonomike sipas pronësisë, rritja e numrit më të madh i të punësuarve për periudhën 4-vjeçare është +26% apo +7% në vit është në ndërmarrje private për periudhën .

[21] Mulliri i Behramajve është nën mbrojtje të përkohshme në listën për trashëgimi kulturore me vendim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Nr. 68/2016 dhe i radhitur me numër rendor Nr.1045, në data baza 004233.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
Private	1946	2126	2296	2456	26%	7%
Publike- Komunale				-	0%	0%
Publiko (Komunale)- Private				-	0%	0%
Publike- Shoqërore	4520	4520	4520	4520	0%	0%
Publiko (Shoqërore)- Private				-	0%	0%
Gjithsej	6466	6646	6816	6976	8%	2%

Tabela 103 Ndërmarrjet ekonomike, punësimi për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas pronësisë

Sa i përket punësimit sipas vendbanimeve, për periudhën 4-vjeçare është +12% apo +3% në vit më së shumti rritje ka në Obiliq dhe Llazarevë, pastaj për periudhën 4-vjeçare është +10% apo +2% në vit në Baimofc dhe për periudhën 4-vjeçare është +8% apo +2% në vit në Cërkvena Vodicë.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
Obiliq	3192	3281	3451	3590	12%	3%
Kryshefc	580	591	593	595	3%	1%
Orlloviq	138	145	146	148	7%	2%
Llazarevë	147	158	160	165	12%	3%
Mazgit	580	587	596	596	3%	1%
Bakshi	108	102	102	104	-4%	-1%
Raskovë	201	205	204	205	2%	0%
Milloshevë	498	513	514	514	3%	1%
Baimofc	115	125	126	126	10%	2%
Breznicë	130	138	140	140	8%	2%
Kozaricë	56	60	31	40	-29%	-7%
Cërkvena Vodicë	118	125	128	128	8%	2%
Plemetin	198	201	206	206	4%	1%
Lajthishtë	189	193	195	195	3%	1%
Shipitullë	70	74	75	75	7%	2%
Grabofc	90	92	93	93	3%	1%
Cërkvena Vodicë	56	52	56	56	0%	0%
Gjithsej	6466	6642	6816	6976	8%	2%

Tabela 104 Ndërmarrjet ekonomike, punësimi për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas vendbanimeve

Mirëqenia sociale. Komuna e Obiliqit edhe pse është komunë industriale, ka një numër mjaft të madh të familjeve me nevojë sociale. Sipas raportit të skemës sociale për çdo muaj kemi afro 800 familje që varen nga asistenca sociale duke përfshirë këtu: shqiptar, serb, rom, ashkali, egjiptian, prej tyre rreth 200 familje janë raste ekstrem të varfra dhe pa zgjidhje të banimit të përhershëm. Numri I ekonomive familjare është afër 4,167 sipas numrit të banorëve 21,549. Sipas raportit të punësimit të MPMS të Republikës së Kosovës (2008-2020) , në komunën e Obiliqit janë rreth 1,546 punë kërkues aktiv. [22]

3.2.4. Trendët e zhvillimit ekonomik

Gjatë katër viteve të fundit vërehet një rritje prej +90% për periudhën 4-vjeçare apo +23% në vit në numrin ndërmarrjeve private ekonomike.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
Private	269	352	432	512	90%	23%
Publike- Komunale				-	0%	0%
Publiko (Komunale)- Private				-	0%	0%
Publike- Shoqërore	9	9	9	9	0%	0%
Publiko (Shoqërore)- Private					0%	0%
Gjithsej	278	361	441	521	87%	22%

Tabela 105 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas pronësisë

[22]Raporti I punësimit të MPMS, Enti për Punë Sociale Obiliq, https://aprk.rks-gov.net/ Qasja në të dhëna me 20.11.2019

Numri i ndërmarrjeve në Komunë të Obiliqit ka një trend pozitiv të rritjes prej +87% për periudhë 4-vjeçare apo +22% në vit. Pjesa më e madhe e rritjes të numrit të ndërmarrjeve private ekonomike prej +157% për periudhë 4-vjeçare apo +39% në vit është në Obiliq, pastaj me 114% për periudhë 4-vjeçare apo +29% në vit në Orlloviq dhe +71% për periudhë 4-vjeçare apo +18% në vit në Milloshevë.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
Obiliq	118	189	245	303	157%	39%
Kryshefc	14	15	15	16	14%	4%
Orlloviq	7	9	15	15	114%	29%
Llazarevë	10	10	10	12	20%	5%
Mazgit	40	45	48	45	13%	3%
Bakshi	8	9	9	11	38%	9%
Raskovë	2	2	3	3	50%	13%
Milloshevë	31	32	44	53	71%	18%
Baimofc	13	15	16	20	54%	13%
Breznicë	9	11	11	12	33%	8%
Kozaricë	0	0	0	0	0	0
Cërkvena Vodicë	1	1	1	1	0%	0%
Plemetin	19	17	18	24	26%	7%
Lajthishtë	1	1	1	1	0%	0%
Shipitullë	1	1	1	1	0%	0%
Grabofc	2	2	2	2	0%	0%
Cërkvena Vodicë	2	2	2	2	0%	0%
Gjithsej	278	361	441	521	87%	22%

Tabela 106 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas vendbanimeve

Sa i përket zhvillimit të numrit ndërmarrjeve ekonomike brenda periudhës 4-vjeçare vërehet një trend pozitiv prej +87% apo +22% në vit. Gjatë 4 viteve të fundit sipas sektorëve, me +220% rritja më e madhe vërehet në sektorin R- Arte, argëtimi dhe rekreimi, pastaj +111% në D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim, +100% në P- Arsimi dhe +90% në A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi dhe +64% në I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	20	22	32	38	90%	23%
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	1	1	1	1	0%	0%
C- Industria përpunuese	25	28	32	39	56%	14%
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	9	9	9	19	111%	28%
E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	6	6	8	8	33%	8%
F- Ndërtimtaria	21	22	24	23	10%	2%
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	44	47	71	86	95%	24%
H- Transporti dhe magazinimi	6	7	7	7	17%	4%
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	42	43	53	69	64%	16%
J- Informimi dhe komunikimi	2	2	2	2	0%	0%
K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	12	12	12	14	17%	4%
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	2	2	2	2	0%	0%
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	8	8	8	8	0%	0%
P- Arsimi	2	3	3	4	100%	25%
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	6	8	9	9	50%	13%
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	10	22	25	32	220%	55%
S- Aktivitetet tjera shërbyese	58	115	139	166	65%	16%
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te	4	4	4	4	0%	0%

ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak						
Gjithsej	278	361	441	521	87%	22%

Tabela 107 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të ndërmarrjeve ekonomike për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sipas sektorëve ekonomik

Sa i përket zhvillimit të numrit të punësuarve gjatë 4 viteve të fundit sipas sektorëve, me +81% rritja më e madhe vërehet në sektorin e E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese, pastaj me +67% rritja më e madhe vërehet në sektorin Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale dhe me +51% në H- Transporti dhe magazinimi.

	2019	2020	2021	2022	Bilanci 4-vjeçar (%)	Bilanci vjetor (%)
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	147	162	185	199	35%	9%
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	78	92	102	112	44%	11%
C- Industria përpunuese	115	138	163	172	50%	12%
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	4520	4520	4520	4520	0%	0%
E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	36	46	52	65	81%	20%
F- Ndërtimtaria	65	72	76	82	26%	7%
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	136	155	172	187	38%	9%
H- Transporti dhe magazinimi	39	45	49	59	51%	13%
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	478	495	514	528	10%	3%
J- Informimi dhe komunikimi	14	15	16	18	29%	7%
K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	68	74	75	79	16%	4%
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	0	0	0	0	0	0
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	28	32	33	38	36%	9%
P- Arsimi	25	29	31	33	32%	8%
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	15	19	22	25	67%	17%
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	38	40	42	44	16%	4%
S- Aktivitetet tjera shërbyese	35	42	49	50	43%	11%
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	149	152	158	168	13%	3%
Gjithsej	426	461	492	523	23%	6%

Tabela 108 Trendët e rritjes/ zvogëlimit të punësimit sipas për periudhën 4-vjeçare dhe 1-vjeçare sektorëve ekonomik

Prodhimtaria e drithërave ka shënuar një rritje të përgjithshme mesatare për periudhë 4-vjeçare prej +100% një rritje të prodhimtarisë së elbit, +75% në prodhimtarinë e tërshërës dhe +69% në prodhimtarinë e misrit.

	Prodhimi (ha)				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2019	2020	2021	2022	2019- 2020	2020- 2021	2021- 2022	2019- 2022
Grurë	1450	1500	1800	1200	3%	20%	-33%	-17%
Misër	650	720	760	1100	11%	6%	45%	69%
Elb	10	15	20	20	50%	33%	0%	100%
Tërshërë	5	10	20	20	50%	50%	0%	75%

Tabela 109 Trendët e prodhimtarisë (ha) së drithërave, 2019- 2022

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Grurë	1,172.22	1,145.09	1,118.58	1,092.69	1,067.39	1,042.69	1,018.55	994.97	971.94
Misër	1,150.00	1,202.27	1,256.92	1,314.05	1,373.78	1,436.23	1,501.51	1,569.76	1,641.12
Elb	21.11	22.28	23.52	24.83	26.21	27.66	29.20	30.82	32.54
Tërshërë	21.67	23.47	25.43	27.55	29.84	32.33	35.02	37.94	41.10

Tabela 110 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së drithërave, 2022- 2030

Bazuar në trendët e prodhimtarisë e drithërave, në rast se nuk ka ndryshime klimatike apo të politikave të cilat mund të ndodhë, atëherë prognoza e prodhimtarisë së përgjithshme për 8 vitet e ardhme është 22,582 ha.

Grurë	Misër	Elb	Tërshërë
971.94	1,641.12	32.54	41.10

Tabela 111 Prognoza për prodhimtarinë (ha) e drithërave sipas kulturave bujqësore deri 2030

Prodhimtaria e perimeve ka shënuar një rritje të përgjithshme mesatare për periudhë 4-vjeçare prej +150% në prodhimin e patateve dhe vërehet një rritje të prodhimtarisë së preshit prej +167%, gjersa një rënie të prodhimtarisë së qepëve prej -29%.

	Prodhimi (ha)				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2019	2020	2021	2022	2019- 2020	2020- 2021	2021- 2022	2019- 2022
Patate	60	65	91.5	150	8%	41%	64%	150%
Speca	32	40	45	48	25%	13%	7%	50%
Qepë	8.5	7	6	6	-18%	-14%	0%	-29%
Lakër	1	1.5	1.5	2	50%	0%	33%	100%
Presh	0.45	0.45	0.9	1.2	0%	100%	33%	167%

Tabela 112 Trendët e prodhimtarisë (ha) së perimeve, 2019- 2022

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Patate	160.00	170.67	182.04	194.18	207.13	220.93	235.66	251.37	268.13
Speca	49.78	51.62	53.53	55.52	57.57	59.70	61.92	64.21	66.59
Qepë	5.72	5.46	5.20	4.96	4.73	4.51	4.31	4.11	3.92
Lakër	2.11	2.23	2.35	2.48	2.62	2.77	2.92	3.08	3.25
Presh	1.28	1.37	1.47	1.57	1.68	1.80	1.92	2.05	2.20

Tabela 113 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së perimeve, 2022- 2030

Bazuar në trendët e prodhimtarisë e perimeve, në rast se nuk ka ndryshime klimatike apo të politikave të cilat mund të ndodhë, atëherë prognoza e prodhimtarisë së përgjithshme për 8 vitet e ardhme është 2,493 ha.

Patate	Speca	Qepë	Lakër	Presh
268.13	66.59	3.92	3.25	2.20

Tabela 114 Prognoza për prodhimtarinë (ha) e perimeve sipas kulturave bujqësore deri 2030

Prodhimtaria e foragjereve ka shënuar një rritje të përgjithshme mesatare për periudhë 4-vjeçare dhe vërehet një rritje të prodhimtarisë së jonxhës prej +300%, gjersa rritja më ultë është e kungujve foragjerë prej +47%.

	Prodhimi (ha)				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2019	2020	2021	2022	2019- 2020	2020- 2021	2021- 2022	2019- 2022
Misër I gjelbër	80	110	140	180	38%	27%	29%	125%
Jonxha	10	20	30	40	100%	50%	33%	300%
Kunguj foragjer	15	18	20	22	20%	11%	10%	47%
Përzierje bari	10	12	10	10	20%	-17%	0%	0%

Tabela 115 Trendët e prodhimtarisë (ha) së foragjereve, 2019- 2022

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Misër i gjelbër	191.11	202.91	215.43	228.73	242.85	257.84	273.76	290.66	308.60
Jonxha	43.33	46.94	50.86	55.09	59.69	64.66	70.05	75.89	82.21
Kunguj foragjer	22.78	23.58	24.42	25.28	26.17	27.10	28.06	29.05	30.08
Përzierje bari	10.33	10.68	11.03	11.40	11.78	12.17	12.58	13.00	13.43

Tabela 116 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së foragjereve, 2022- 2030

Bazuar në trendët e prodhimtarisë e foragjereve, në rast se nuk ka ndryshime klimatike apo të politikave të cilat mund të ndodhë, atëherë prognoza e prodhimtarisë së përgjithshme për 8 vitet e ardhme është 3,104 ha.

Misër i gjelbër	Jonxha	Kunguj foragjer	Përzierje bari
308.60	82.21	30.08	13.43

Tabela 117 Prognoza për prodhimtarinë (ha) e foragjereve sipas kulturave bujqësore deri 2030

Prodhimtaria e pemëve ka shënuar një rritje të përgjithshme mesatare për periudhë 4-vjeçare vërehet një rritje të prodhimtarisë së vishnjave prej +300%, gjersa një rënie të prodhimtarisë së mjedrave prej -50%.

	Prodhimi (ha)				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2019	2020	2021	2022	2019- 2020	2020- 2021	2021- 2022	2019- 2022

Mollë	8	12	12	8	50%	0%	-33%	0%
Kumbull	4	6	8	8	50%	33%	0%	100%
Lajthi	2.5	4	4.5	4.5	60%	13%	0%	80%
Vishnje	1	4	4	4	300%	0%	0%	300%
Mjedër		12	10	6	-	-17%	-40%	-50%

Tabela 118 Trendët e prodhimtarisë (ha) së pemëve, 2019- 2022

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Mollë	8.27	8.54	8.83	9.12	9.43	9.74	10.06	10.40	10.75
Kumbull	8.44	8.91	9.41	9.93	10.48	11.07	11.68	12.33	13.01
Lajthi	4.72	4.96	5.20	5.46	5.73	6.01	6.31	6.62	6.94
Vishnje	4.33	4.69	5.09	5.51	5.97	6.47	7.00	7.59	8.22
Mjedër	5.33	4.74	4.21	3.75	3.33	2.96	2.63	2.34	2.08

Tabela 119 Projeksionet vjetore të prodhimtarisë (ha) së pemëve, 2022- 2030

Bazuar në trendët e prodhimtarisë e pemëve, në rast se nuk ka ndryshime klimatike apo të politikave, atëherë prognoza e prodhimtarisë së përgjithshme për vitin 2030 është 319 ha.

Mollë	Kumbull	Lajthi	Vishnje	Mjedër
10.75	13.01	6.94	8.22	2.08

Tabela 120. Prognoza për prodhimtarinë (ha) e pemëve sipas kulturave bujqësore deri 2030

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës së Obiliqit për periudhën 2009- 2020+ të miratuar me vendimin e Kuvendit Komunal Nr.01-166/10 të datës 26.07.2010, Komuna e Obiliqit ka planifikuar zhvillimin e zonës industriale në Llazarevë.

Në këtë zonë janë të vendosura një numër i konsiderueshëm i bizneseve të cilat paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimore duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal në fuqi dhe legjislacionin, po ashtu vlen të ceket se është edhe një numër i konsiderueshëm i bizneseve serioze në nivel vendi të cilat kanë shprehur interesim për të operuar në këtë zonë e të cilat gradualisht janë të përfshira në procedurën e marrjes së tokave komunale në shfrytëzim e të cilat pas kësaj faze do të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm përkatësisht me leje ndërtimore e që përmes këtij procesi dhe kësaj zone Komuna synon që të gjeneroj vende të reja të punës për qytetarët tanë . Ndonëse Zona Industriale në Llazarevë ka kushte ideale për të krijuar ekonomi të qëndrueshme për zhvillim të bizneseve komuna ka planifikuar buxhetin për investim për rregullimin e infrastrukturës përcjellëse, një pjesë e të cilës tashmë është ndërtuar.

Territori i komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 104.84 km² dhe rrjedhimisht paraqet një sipërfaqe shumë të vogël krahasuar me komunat tjera që përbën vetëm rreth 1% të territorit të Kosovës. Përpos territorit shumë të vogël, Komuna po ashtu ballafaqohet me edhe me kufizime zhvillimore për shkak të vendimeve të nivelit qendror në rreth 3,373 ha apo 32.17% të territorit të Komunës.

Lloji i zonës	Sipërfaqja (ha)	% në raport me territorin e komunës
1. Zonës së planifikuar të mihjes	1,307.27	12.47%
2. Zonës së tokës bujqësore nën ujitje	1,221.40	11.65%
3. Zonave mbrojtëse te largpërçuesve me tension te larte	334.39	3.19%
4. Parkut solar	20.03	0.19%
5. Rrugëve të nivelit qendror	100.00	0.95%
6. Zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore	36.00	0.34%
7. Termoelektranat	353.94	3.38%
Totali	3,373.02	32.17%

Tabela 121 Sipërfaqet mbi të cilat kufizohen zhvillimet e reja nga niveli qendor

Për më tej, jo vetëm që Komuna ka një territor të kufizuar për planifikimin e zhvillimeve të ardhme, por po ashtu ballafaqohet me një sfidë shtesë, atë të zhvendosjes së banorëve të vendbanimeve që shtrihen në "Fushën e Mihjes së Re", të planifikuar për të shërbyer ekskluzivisht për mihjen e thëngjillit.

Sipas Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re":

- Hapësirat e ndërtuara, për nevoja strehimi apo veprimi të popullatës, në vendbanime në kuadër të zonës së FMR-së, zënë rreth 11% të sipërfaqes së tërësishme të kësaj zone gjegjësisht shtrihen në 1.702 ha. Qyteti i Obiliqit dhe ai i Fushë Kosovës janë dy qendra urbane dhe njëherit të dy qendrat komunale brenda zonës së FMR-së. Të gjitha vendbanimet tjera, të cilat

gjenden në këtë zonë të interesit, janë kryesisht vendbanime të karakterit rural, pra janë fshatra të banuara me popullatë që merren me veprimtari kryesisht bujqësore.

- Veprimet dhe aktivitetet, që do të zhvillohen në FMR, e që për rezultat do të sjellin ndryshime në destinimin e tokës bujqësore janë:
  - Hapja e minierës së re (në Fushën "C" ose me qendër Sibovcin);
  - Vendosja e pajisjeve për transportimin e linjitit dhe gypat për transport hidraulik të hirit;
  - Rivendosja e vendbanimeve të zhvendosura në sipërfaqet e reja të tokës bujqësorë;
  - Ndotja e tokave bujqësore për rreth termocentralit nga pluhuri qe del nga tymtarët, nga shirat acidik si dhe nga deponitë e hirit (që llogariten të kenë një radius veprimi në tokat bujqësore për rreth).
- Zhvillimi i procesit të zhvendosjes - rivendosjes së popullatës nga vendbanimet në fushën e re të mihjes, gjithashtu, ka rëndësi të veçantë, bile shumë të ndjeshme. Rivendosja e tyre në vendbanimet e reja, kërkon planifikim dhe kontrollë në densifikim dhe zgjerim të vendbanimeve ekzistuese në një mjedis jetësor më të pastër.
- Përcaktimi i lokacionit dhe hartimi planeve për rivendosje – Përzgjedhjes së lokacionit për rivendosjen e popullatës së zhvendosur para së gjithash duhet ti paraprijnë hulumtimet dhe analizat të cilat nxjerrin në pah interesin e banorëve për rilokimin e tyre të ardhshëm. Është e domosdoshme që pas përcaktimit për lokacionet e parapëlqyera të kërkohet hartimi i planeve rregulluese për ato zona. Këtu mund të preferohen, zonat e ndërtuar (në vendbanimet ekzistuese të komunës së Obiliqit) me një shpeshtim (densifikim) të objekteve apo edhe të ndërtimeve në vertikale (në etazhe) brenda vendbanimeve (p.sh. Obiliq, Mazgit, Milloshevë dhe Graboc i Epërm), me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore. Në bashkëpunim me komunitetin dhe organet gjegjëse do të vendoset për formën dhe pozitën e objekteve të kultit, të përmendoreve dhe të varrezave si çështje më e ndjeshme shpirtërore, të cilat janë po ashtu pjesë e Planeve Rregulluese Urbane (tani Plane Rregulluese të Hollësishme) që do të hartohen për vendet e dedikuara për rivendosjen e popullatës nga vendbanimet e zhvendosura.

Nën anën tjetër, sistemi i ujitjes së tokës bujqësore brenda territorit të Komunës nuk ka qenë funksional për shumë vite dhe ende mbetet në gjendje të tillë, ku tokat bujqësore nuk kanë qasje në sistem të ujitjes, e cila dëshmohet edhe nga letra zyrtare nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh. a. të datës 06.12.2018.

Bazuar në vlerësimin mbi nevojat për zhvillim ekonomik në Komunën e Obiliqit të gjendjes ekzistuese të krijuar, si dhe planifikimet e parapara me dokumentet PZHK të Obiliqit në fuqi dhe PHZIVE-FMR, vërehet një pasqyrë e qartë për nevojat dhe trendët e zhvillimit ekonomik të Komunës së Obiliqit. Si rezultat i gjendjes së krijuar, për shkak të kufizimeve të zhvillimeve hapësinore dhe mungesës së planeve hapësinore që kanë rezultuar në një numër të konsiderueshëm të ndërtimeve pa leje. Për këtë arsye, Komuna duhet të planifikojë zhvillimet e reja ekonomike duke u bazuar në dokumente ligjore, trendët reale të zhvillimit dhe nevojave reale për akomodim të bizneseve dhe rrjedhimisht të tokës ndërtimore.

3.2.5. SWOT Analiza

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Ligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij nr. 05/L-044** ▪ **Rezerva të konsiderueshme nëntokësore të linjitit** ▪ **Staf profesional dhe punëtor me përvojë në fushën e energjetikës;** ▪ **Infrastrukturë e sistemit të transmisionit dhe lidhje e mirë me shtetet fqinje përmes linjave të interkoneksionit;** ▪ **Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike shumë të favorshme për zhvillimin të agrobiznesit;** ▪ **Dy linja hekurudhore.** ▪ **Resurset natyrore: 65.35% tokë bujqësore, 11.11% tokë pyjore, dhe resurse ujore;** ▪ **Potenciale të mjaftueshme njerëzore me përgatitje profesionale dhe me moshë të re;** ▪ **Kapacitetet të konsiderueshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;** ▪ **Kapacitetet e prodhimit të fidanëve të pemëve, analizimi dhe kontrolli i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;**	▪ 72% e territorit të komunës zonë me interes të veçantë (shfrytëzim nga KEK) ▪ Zhvendosja e vendbanimeve nga Fusha e Re e Mihjes; ▪ Vjetërsia e kapaciteteve gjeneruese të TC A; ▪ Ndotje e lartë nga TC B ▪ Shkarkimi i ujërave industriale ▪ Humbje të larta të energjisë elektrike; ▪ Prezenca e deponive të hapura të hirit; ▪ Prodhimtaria e ulët dhe cilësia jo e kënaqshme e produkteve bujqësore; ▪ Edukimi i pamjaftueshëm i fermerëve në përputhje me mënyrat e reja të prodhimit; ▪ Aplikimi i teknologjisë së vjetruar në prodhimin e produkteve bujqësore; ▪ Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore ▪ Humbje rreth 46,80ha në vit; fragmentimi i tokave bujqësore; ndotja e kanaleve të ujitjes dhe vërshimi i tokave bujqësore; ▪ Mungesa e qasjes në tregje – mos funksionimi i pikave grumbulluese në tërë territorin e komunës;

▪ **Sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore nën sistemin e ujitjes;** ▪ **Qasja ne rruge regjionale dhe hekurudhë;** ▪ **Hapësire e mjaftueshme për grumbullimin dhe përpunim të produkteve bujqësore.**	▪ Mungesa e kompetencave në menaxhim të resurseve pyjore; ▪ Deponia regjionale e mbeturinave Mirash.
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ **Hapja e vendeve të reja të punës gjatë ndërtimit të TC-së Kosova Re dhe Mihjes së re;** ▪ **Potencial për zhvillim të sektorit të minierave;** ▪ **Funksionalizimi I Zonës Industriale në Llazarevë;** ▪ **Korridori ekonomik përgjatë M2** ▪ **Shfrytëzimi i hirit dhe gjipsit për prodhimtari ndërtimore;** ▪ **Interesimi i sektorit privat për investime;** ▪ **Funksionalizimi i linjës të interkoneksionit 400 kV Shqipëri-Kosovë;** ▪ **Shfrytëzimi i ujit nga termocentralet për sistem të ngrohjes qendrore;** ▪ **Përdorimi i teknologjive më të avancuara në TC sipas standardeve të BE-së;** ▪ **Gjenerimi i energjisë elektrike nga BRE;** ▪ **Rritja e hapësirave për tregti dhe prodhim;** ▪ **Mundësi qasje në programe e projekte për përfitim nga fondet dhe skemat mbështetëse të qeverise dhe donatorëve;** ▪ **Konsolidimi i tokës bujqësore dhe organizimi i fermerëve (bashkërendimi, koordinimi);** ▪ **Bashkëpunimi me nivelin qendror në ripyllëzim;** ▪ **Rritja e interesimit për edukim në lëminë e energjisë;** ▪ **Mbrojtja e ekosistemit dhe biodiversitetit;** ▪ **Ngritja e kapaciteteve të pronarëve të pyjeve për menaxhim të pyjeve (Dhënia në menaxhim të pyjeve shoqërore banorëve të zonës);** ▪ **Shfrytëzimi i skemave të granteve dhe projekteve me PPP.**	▪ Vjetërsia e termocentraleve dhe pajisje të vjetra të mihjeve; ▪ Mosrealizimi i projektit Kosova e Re; ▪ varësi importi të energjisë elektrike ▪ Mos zbatimi i standardeve mjedisore sipas standardeve të BE-së në kapacitete ekzistuese ▪ Zvogëlimi i vendeve të punës me aplikimin e teknologjive të avancuara; ▪ Vonesa në Zhvendosje të vendbanimeve sipas planit Xehetar të avancimit të mihjes. ▪ Kosto e lartë e shpronësimit të pronës së mihjeve të reja ▪ Ndotja e tokës dhe resurseve të ujit; ▪ Braktisja e fshatrave, interesimi i ulet i rinisë për veprimtari bujqësore; ▪ Mungesa e kredive të favorshme afatgjata; ▪ Fuqia blerëse e popullsisë është e ulët; ▪ Prerja e pakontrolluar e pyjeve; ▪ Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, veçanërisht e tokës bujqësore nën komasacion dhe sistem të ujitjes; ▪ Qasja e kufizuar në mjete financiare për investime në Agrobiznes; ▪ Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në bujqësi; ▪ Konkurrenca e tregut nga importi; ▪ Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; ▪ Zvogëlimi i territorit për shkak të zgjerimit të minierave.

3.2.6. Sfidat zhvillimore

- Sigurimi i kapacitetit gjenerues të energjisë elektrike sipas kërkesave
- Eliminimi i humbjeve të energjisë elektrike
- Kosto e lartë e investimit për TC Kosova e Re,
- Instalimi i teknologjisë më të avancuar në termocentralet ekzistuese
- Nivel i ulët i industrisë prodhuese dhe përpunuese jashtë energjisë elektrike
- Rritja e kualitetit të jetës së komunitetit
- Zbatimi i programeve për zhvendosje të komunitetit.
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i resurseve natyrore
- Problemet botërore rreth shfrytëzimit të resurseve të linjitit dhe potencialit ujor.
- Rehabilitimit nga ndotja (ajrit, ujit dhe tokësh) dhe zonave të degraduara
- Shfrytëzimi i potencialeve tjera të erës, të gazit, solare, biomasës, etj.

3.2.7. Nevojat zhvillimore

- Rehabilitimi i pajisjeve ekzistuese dhe blerja e të rejave për Minierën e Re
- Ndërtimi i TC Kosova e Re dhe revitalizimi i TC Kosova B

DRAFT


- Rregullimi i energjisë elektrike dimër/verë me Shqipërinë me funksionalizimin e linjës 400 KV;
- Kabllimi i linjave të transmisionit që pengojnë zhvillimin në qytet;
- Përfundimi i zhvendosjeve të lagjeve në Shipitullë;
- Përfundimi i zhvendosjes në Hade e Re;
- Zvogëlimi i ndotjes (Rregullimi i elektrofiltrave) nga TC Kosova B sipas standardeve të BE-së
- Zhvillimi i sistemit të ngrohjes qendrore me kogjenerim
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave
- Rehabilitimi i deponive të mihjeve dhe deponisë regjionale Mirash
- Shfrytëzimi i potencialeve tjera të erës, të gazit, solare, biomasës, etj.
- Rritja e hapësirave për tregti dhe industri/ funksionalizimi i Zonës Industriale Llazarevë.

3.3. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.3.1. Ujësjellësi

Rreth 90% të popullsisë së Obiliqit kanë qasje në ujësjellës ndërsa pjesa tjetër e banorëve rreth 10 % janë pa ujësjellës. Furnizimi me ujë të pijes vazhdon të jetë 24 orë / 7ditë në javë, me përjashtim të zonave më të larta të qytetit ku për shkak të keqpërdorimeve të vazhdueshme të ujit ndodhin reduktime të kohëpaskohshme, kryesisht gjatë sezonit të verës.

Njëri prej shqetësimeve është rrjeti i ujësjellësit të qytetit, për shkak të vjetërsisë ekziston mundësia permanente që uji të kontaminohet. Vendbanimet e më poshtme që furnizohen nga Ujësjellësi Publik Rajonal i Prishtinës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjetër, Mazgiti i ultë, Mazgit i epërm, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Hade, Leshkoshiq, Plemetini, Millosheva, Raskova, Bakshia, Llazareva, Breznica, Kozarica, Sibovc, Shipitull dhe Baimofci. Jashtë furnizimit kanë mbetur dy vendbanime: Grabofc i Epërm dhe Leshkoshiq. Disa vendbanime furnizohen nga burimet nëntokësore (puset individuale) të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes. Rreth 90% e vendbanimeve kanë rrjet të ujësjellësit por në disa vendbanime nuk janë të kyçura të gjitha ekonomit familjare, si në vendbanimin: Cërkvena Vodicë.



Grafiku 1. Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit

Niveli i ujërave nëntokësore arrin në kota të ndryshme. Kapaciteti i tyre mund të arrij deri në 100 l/sec. dhe i cili posedon të gjitha karakteristikat e nevojshme të ujit për pije. Tani për tani ky kapacitet shfrytëzohet afro 40 % nga puset të cilat furnizojnë ujësjellësin në Obiliq ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohet nga banorët me puse individuale. Përveç burimeve të ujërave nëntokësore të ujit natyral Komunën e Obiliqit e karakterizojnë edhe burimet nëntokësore të ujërave të tharta burojnë në fshatin Grabofc Epërm dhe në fshatin Breznicë. Problematik tjetër në aspektin e humbjeve dhe mos furnizimit të qëndrueshëm të qytetarëve me ujë të pijes është pasojat e rrjeteve të vjetërsuara dhe vendosja e të rejave duke mos përdorur standarde dhe norma të nevojshme mbi kapacitetet e kërkuara si dhe jo përdorimi i praktikave më të mira inxhinierike në vendosjen e gypave, andaj si rezultat i saj dhe sipas raporteve vjetore të K.R.U Prishtina çdo vite kanë probleme të mëdha në sajimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit si pasoje e dëmtimit të gypave në pjesë të caktuara të komunës por me theks të veçantë në zonën urbane si pasoj e fluksit më të lartë të ndërtimit dhe zhvillimit të qytetit dhe kyçje e shumta në rrjet të ujësjellësit.

Furnizimi me ujë në komunën e Obiliqit. Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë por edhe në Prishtinë që u ofrohet konsumatorëve nga KRU- Prishtina, dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së bëhet nga K.R.U Prishtina ku nga kjo kompani furnizohen rreth 83% e vendbanimeve, ndërsa e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë por edhe në Prishtinë që u ofrohet konsumatorëve nga KRU- Prishtina, dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së ndërsa pjesa tjetër ujin e pijes e marrin nga bunarët individuale në katër vendbanime, apo 20 % e vendbanimeve të Komunës. Furnizimi me ujë nga bunarët individual, nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHMS.

Sipas udhëzimit Administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor janë përcaktuar kërkesat për ujë për kokë banori, ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri janë radhitur sipas kategorisë:

- për vendbanime ≥ 100001 banor: ≥ 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001- 100000 banor: ≥ 250- 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001- 100000 banor: ≥ 200- 250 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 5001- 20000 banor: ≥ 150- 200 litra/banor;
- për vendbanime < 5000 banor: ≥ 100 - 150 litra/banor.


Sipas prognozave demografike komuna e Obiliqit ka një numër të banorëve prej 21,549 sipas këtij numri të banorëve institucionet përkatëse duhet të sigurojë një sasi uji në ditë prej 250 litra apo 5,387.250 milion litra ujë. Ndërsa kompania regjionale K.R.U Prishtina sipas të dhënave të saj ka kapacitet në përmbushjen e kërkesave për ujë 106 litra për banorë brenda një dite, pra, sasia e ujit që KUR "Prishtina" sh. a. që i ofron për konsum qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve nuk është e mjaftueshme për plotësimin e të gjitha nevojave në momentin e dëshiruar. Për përmbushje të këtyre nevojave kompania është duke bërë përpjekje që të rrisë kapacitetet e prodhimit dhe përpunimit të sasisë së re të ujit për rreth 750 litra në sekondë. Kjo sasi e re e ujit paraqet vlerë dhe investimin më të madh në sektorin e ujit të pijes në rajon.

1. **Skenari - a.** 36000 banorë (10500 në zonën urbane dhe 25000 ne zonën rurale) për 8 vitet e ardhme deri në vitin 2030;
   - **Bazuar në kapacitetet ekzistuese të burimeve të ujit** me Q=80.0 l/s, kapaciteteve të konservimit të rezervuarëve me V=3750.0 m3 në Shkabaj dhe V=750.0 m3 në Obiliq =4500.0 m3 , kapacitetet e stacioneve të pompimit, numrit të prognozuar të banorëve prej për vitin 2030 të Skenari -a, përfshirë edhe banorët jo rezident, analizës së shpenzimeve me kërkesën mesatare prej 200 l/s sipas normave teknike të planifikimit për banor (norma e përdorimit q=200 l/për banor).Komuna ka nevojë për rritje të kapaciteteve të konservimit të ujit prej së paku Q=150.0 l/s për 8 vitet e ardhshme dhe rritjes e vëllimit të rezervuarëve në pikat ekzistuese dhe ndërtimin e tyre në pika të reja.

2. **Skenari -b.** Bilanci i kërkesës për ujë dhe kapacitetit të furnizimit sipas Skenarit të KRU Prishtina/NJOU Obiliq
   - Shtimi i parashikuar i popullsisë për komunat e zonës së shërbimit të KRUP/NJOU Obiliq është kalkuluar duke marrë për bazë trendin e njëjtë të rritjes të parashikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për Kosovë. Bazuar në këtë kalkulim, është vlerësuar se gjatë periudhës 10 vjeçare (deri në vitin 2030) popullsia në zonën e shërbimit të Kompanisë do të këtë një shtim relativisht të vogël prej rreth 6000 banorë në total krahasuar me popullsinë aktuale.

Kërkesa për ujë gjatë periudhës planifikuese pritet të rritet ndjeshëm si rezultat i rritjes së planifikuar të shkallës së mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit. Rrjedhimisht, kërkesa për ujë, në vitin 2030 , q=50.0 l/s) që është konsiderueshëm më e madhe krahasuar me atë të vitit 2019. Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Obiliqit nga të gjitha skenarët do të nevojiten burime të reja të konsiderueshme të ujit.

Për mbulimin e këtyre nevojave komuna dhe KRU Prishtina duhet planifikuar zhvillimi i resurseve të reja ujore si vijon:



Grafiku 2. Trendi i rritjes së sasisë së ujit për kokë banori në ditë *KRUP

Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re në Rrjetin e Ujësjellësit

Sipas **Skenarit A dhe B** parashihet që shkalla e mbulimit me shërbime gjatë 10 viteve të ardhshme të rritet për 8000 banorë. Kjo nënkupton se duhet që, përpos në burimet e reja të ujit, të parashihen investime edhe për zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit që nevojitet për furnizim me ujë të këtyre banorëve. Prej këtij numri prej 8000 të popullsisë që planifikohet të përfshihen me shërbime, rreth 8000 banorë do të përfshihen me sistemet që do të financohen gjatë 10 viteve të ardhshme nga donatoret e jashtëm, brendshëm dhe KRUP.


Cilësia dhe furnizimi me ujë: Kualiteti i ujit të furnizuar për konsumator nga KRU "Prishtina" në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009, ka qenë më i mirë, me vetëm 0.8 %, të mostrave të analizuara të cilat nuk kanë qenë në përputhje me standardet e përcaktuar nga IKSHPK. Furnizimi me ujë të pijes nga burimet nëntokësore nga bunarët.

Në Komunën e Obiliqit Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka kryer disa matje të cilësisë së ujit të pijshëm nga puset në zonat rurale, në bazë të rregullores për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në veçanti, dy mostra të ujit të pijshëm janë marrë në secilin prej fshatrave të përmendur në vijim: Shipitullë, Hade, Bakshi, Milloshevë, Hamidi, Lajthishtë, Sibovc, Baimofc, Breznicë dhe Kozaricë. Janë analizuar 20 mostra bakteriologjike, si dhe 20 mostra kimike. Mostrimi është kryer në katër periudha të ndryshme gjatë vitit 2002-2006, shkurt, korrik, nëntor dhe dhjetor. Mostrat janë marrë në dy pika frekuentuese të secilit fshat. Shtëpia e Shëndetit dhe shkolla (ku nuk kanë ekzistuar, mostrat merreshin nga puse individuale të banorëve të fshatit).

Rezultatet vazhdimisht tregojnë se ekziston një nivel i lartë i kontaminimi si në vijim:

- 95 % e mostrave dëshmojnë kontaminim me origjinë fekale apo në formë totale koli-forme, gjë që nuk u përmbahen treguesve të OBSH-së;
- 55 % e mostrave kanë vlera të mëdha të nitriteve dhe nitrateve, gjë që nuk përputhet me treguesit e OBSH-së;

Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë por edhe në Obiliq që u ofrohet konsumatorëve nga KRU- Prishtina, dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së në kuadër të përgjegjësive të saj për monitorim të jashtëm të përcaktuara në UA 16/2012, ka arritur një përputhshmëri me 99.20 % sa i takon standardeve mikrobiologjike të cilësisë së ujit, ndërkaq 98.00% sa i takon standardeve kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.30%. Kjo shkallë e përputhshmërisë është e bazuar në rezultatet e testeve të bëra nga laboratorët rajonal të Shëndetësisë Publike (QRSHP).



Grafiku 3. Përqindja e përmbajtjes cilësisë së ujit sipas raportit për cilësi të ujit në Kosovë

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e ujit:

- Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme me ujë të pijes për gjithë qytetaret e komunës në veçanti zonat rurale;
- Rritja e kapaciteteve furnizuese me ujë gjatë gjithë kohës;
- Zvogëlimi i humbjeve duke rivitalizuar rrjetet ekzistuese, duke përdorur praktikat më të mira;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit ujësjellësit në kuadër të KRU Prishtina

Nevojat zhvillimore për të ardhmen për furnizim me ujë

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese te ujit të pijshëm;
- Hapja e puseve të reja në vendbanime disa vendbanime rurale;
- Ndërtimi i stacioneve të pompave
- Rritja e vëllimit të Rezervuarëve dhe ndërtimi i rezervuarëve të ri;
- Mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit;
- Krijimin e zonave dhe nën zonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit.

3.3.2. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza)

Sasia e ujërave të zeza do të rritet me shpejtësi në të ardhmen, e njëjtë sikur nevoja për ujë të pijes. Rritja e nevojës për ujë për pastrim, gjendja e pjesërisht e vjetruar e rrjetit të kanalizimit, dhe nga vet fakti se Obiliqi nuk ka pajisje të punës për trajtimin ujërave të zeza, është domosdoshmëri që sistemi për menaxhimin e ujërave të zeza duhet të riparohet.

Rrjeti kryesor, gropa septike dhe kolektorët për trajtimin parësore elementare të ujërave të zeza duhet të ndërtohen përgjatë lumenjve, të cilat pastaj ujërat e zeza i përcjellin deri te impianti. Masa me urgjente është një impiant i ri i ujërave te zeza për qytetin dhe komunën. Lokacioni në pikën me të ulet në pjesën veriore të komunës është propozuar në Planin Zhvillimor Komunal. Me zgjidhje te detajuar duhet te bëhen për ta vendosur lokacionin e sakte për impiantin e ri te kanalizimit dhe mundësin e lidhjes se sa me shume fshatrave në këtë impiant.

Pra, mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në komuna e Obiliqit ka sjell probleme dhe sfida të mëdha për komunën, duke ditur se gjitha shkarkimet e ujërave të ndotur bëhen në lumenjtë duke shkaktuar ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore. Komuna e Obiliqit është duke analizuar mundësinë për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe kolektorët mbledhës për gjatë tre lumenjve të qytetit të Obiliqit.

Me zgjerimin e sistemit te kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim më gjithëpërfshirës i ujit. Elementi kryesor i menaxhimit modern të ujit është ndarja e grumbullimit te ujërave nga reshjet dhe ujërat e zeza. Përderisa ujërat e zeza duhet të grumbullohen dhe trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat e reshjeve duhet të trajtohen në mënyrë te njëjtë sikurse cikli i ujërave natyrore. Kjo përfshinë ruajtjen dhe infiltrimin e ujërave nga reshjet brenda zonave banuese dhe komerciale. Ruajtja dhe infiltrimi i ujërave nga reshjet e redukton shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohëve të rënies dhe ndihmon ne reduktimin e investimeve të nevojshme. Këto masa janë shumë të nevojshme në zonat urbane, siç është qyteti i Obiliqit.

Mbulueshmëria me rrjet të kanalizimit në komunë të Obiliqit është e mirë vetëm një vendbanim (Grabofc i Epërm) nuk posedon rrjet të kanalizimit. Pjesa tjetër e vendbanimeve, rreth 90% e ekonomive familjare, kanë qasje në rrjet për largim të ujërave të zeza.

Vlerësimi i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë të tillë - Kanalizimi i ujërave të ndotura

Bazuar në gjendjen ekzistuese të rrjeteve të kanalizimit të ujërave të ndotura dhe atmosferike dhe numrit të prognozuar të banorëve, në pjesë e qytetit dhe vendbanimeve (fshatrave) të cilat kanë nevojë për rrjete të reja të ujërave të ndotura si dhe kolektorët kryesor të cilat dërgojnë ujin deri te FTUZ. Ndërtimi i kanalizimeve të reja në zonën urbane të Obiliqit duhet të bëhet për t'i unifikuar rrjetet e fragmentuara ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në një pikë të vetme.

3.3.3. Drenazhimi-kanalizimi i ujërave atmosferike

Sa i përket kanalizimit atmosferik, problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohet ky rrjet janë: mungesa e një plani gjithëpërfshirës; mungesa e mirëmbajtjes së duhur; uzurpime të ndryshme nga qytetarët e papërgjegjshëm; kyçja e ujërave të zeza në këto kanale, etj. Të gjitha problemet e përmendura më sipër janë shkaktarë të drejtpërdrejtë të dëmtimit të vazhdueshëm të kanaleve ekzistuese. Në këtë situatë, edhe reshjet më të vogla atmosferike janë rrezik permanent për derdhjen e pa kontrolluar të ujërave nga kanalet, duke vërshuar dhe dëmtuar seriozisht rrugët dhe hapësirat e ndryshme të qytetit.

Sfidat kryesore në menaxhimin kanalizimit:

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetaret e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit të kanalizimit në kuadër të KRU Prishtina;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Ndërtimi i impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Obiliqit;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferik;

3.3.4. Ujitja e tokës bujqësore

Në Komunë shtrihet rrjeti i ujitjes së tokës bujqësore që menaxhohet nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh. a. Sipërfaqja e tokës bujqësore nën ujitje është 2,153 ha, tokë e kualitetit të mirë. Por, gjendja e rrjetit të ujitjes nuk është në nivelin më të mirë ku përballet me sfida dhe probleme të natyrave të ndryshme.

Sfida më e theksuar në kuadër të ujitjes së tokave bujqësore është ndërtimi apo shndërrimi i zonave nën sistem të ujitjes në toka ndërtimore, dhe si rezultat i saj, këto toka tashmë janë të pa shfrytëzueshme për zhvillim bujqësor. Komuna është duke hartuar Planin Zhvillimor Komunal, ku do të definojë kufijtë ndërtimor dhe definimin e zonave bujqësore në interes të mbrojtjes së këtyre tokave. Përveç tjetërsimit të sipërfaqeve të mëdha të tokave nën sistem, sfidë është edhe mirëmbajtja dhe funksionalizimi i

kanaleve ekzistuese të ujitjes. Për arsye të ndërtimeve të shumta dhe mungesës së fondeve, ky rrjet i ujitjes nuk i përmbush kërkesat për ujitje për këtë hapësirë.

Në bazë të analizave, përveç problemeve dhe sfidave në aspektin e humbjes së tokave nën sistem dhe shkatërrimin e rrjetit ekzistues, në kuadër të komunës kemi hapësira të tokave bujqësore me kualitet të lartë ku mund të zgjerohemi me kapacitete shtesë në mbulueshmëri me ujitje. Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e rrjetit për ujitjen e tokave bujqësore janë:

- Mundësia e zgjerimit të rrjetit të ujitjes;
- Koordinimi i aktiviteteve në mes komunës dhe ndërmarrjes Ibër Lepencit në menaxhim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujitjes;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen janë:

- Zgjerimi i rrjetit të ujitjes për tokat bujqësore më potencial të lartë prodhues;
- Nevoja për menaxhim të vazhdueshëm të sistemit;




Figura 12. Zonat në sistem të ujitjes

3.3.5. SWOT Analiza- Ujësjellësi, kanalizimi, drenazhimi dhe ujitja

Përparësitë	Dobësitë
▪ Sasia e mjaftueshme e ujit për pije; **▪ 95 % e popullatës furnizohet me ujë të pijes;** **▪ Burime të ujit të pijes;** **▪ Cilësia e mirë e ujit;** **▪ Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese dhe të reja është në kompetencë të njësisë KRU Prishtina në Obiliq.** **▪ Ujërat nëntokësore shtrihen në 80% të territorit të Komunës;** **▪ Vazhdimësia e ndërtimit të kanaleve të reja;** **▪ 95% e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit;** **▪ Ofrimi i ujitjes optimale përkundër kushteve minimale;**	▪ Mos shfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; ▪ 5% e popullsisë në nuk kanë qasje në ujësjellës ▪ 17% vendbanimeve nuk kanë rrjet të ujësjellësit; ▪ Reduktim i lartë i furnizimit me ujë në ditë; ▪ Mos shfrytëzim i burimeve ekzistuese të ujit për nevoja të qytetarëve; ▪ Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga materiali AC në disa zona; ▪ Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave; ▪ Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta); ▪ Mungesa e kyçjes së disa fshatrave në rrjetin kryesor; ▪ Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet);

	▪ Mungesa e koordinimit ndërmjet kompanive publike; ▪ Impianti për trajtimin e ujërave të zeza; ▪ Rrjeti i vjetruar i kanalizimit; ▪ Përzierje e rrjetit te kanalizimit me atë atmosferik; ▪ Mungesa e rrjetit atmosferik; ▪ Ndotja e ujit në kanalet e ujitjes; ▪ Humbje e tokës bujqësore nën sistem të ujitjes nga ndërtimet; ▪ Sipërfaqe e vogël e ujitur; ▪ Mënyra primitive e ujitjes;
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Shfrytëzimi i investimeve të jashtme;** ▪ **Garantët qeveritarë;** ▪ **Aplikimi i arritjeve teknologjike;** ▪ **Ekzistenca e legjislacionit përkatës;** ▪ **Ridizajnimi i sistemit të ujitjes (futja e kanaleve te hapura ne tubacione);** ▪ **Inkorporomi i kanaleve të reja të ujitjes në sistemin menaxhues të KRU Prishtina;**	▪ Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; ▪ Mostrajtimi i ujërave të zeza; ▪ Cenimi i kualitetit/sigurisë së ujit si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; ▪ Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; ▪ Keqpërdorimi i ujit; ▪ Mospjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje në procesin e ndërtimit të impiantit (çështja e ekspropriimit); ▪ Politika joadekuate; ▪ Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes;

3.3.6. Energjia Elektrike

Sipas informacioneve të siguruara nga KEK-u, KOST-i dhe KEDS -i aspekti i furnizimit me energji elektrike në Komunën e Obiliqit i gjithë territori i komunës ka mbulueshmëri me rrjete, që do të thotë çdo qytetar i komunës ka qasje në energji elektrike, por përkundër qasjes në energji ky sektor ka problem dhe sfida në aspektin e furnizimit të rregullt me energji të qytetarëve.

Furnizimi me energji elektrike është jo i qëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm, ka ndërprerje të shpeshta të rrymës elektrike. Arsyet për këtë janë kapacitetet e kufizuara të termocentraleve të Obiliqit dhe humbjet teknike dhe ato administrative, si dhe defektet e shpeshta në rrjet. Rrjeti elektrik është i vjetruar dhe shumica e objekteve të banimit furnizohen me energji nga kabllot mbitokësore, e të cilat të shumtën e rasteve janë në gjendje të keqe dhe burim rreziku për qytetarë. Rinovimi i këtij sistemi të vjetruar dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të jenë në prioritet të lartë. Ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike implikojnë përdorimin e burimeve tjera të energjisë, siç janë gjeneratorët, të cilët janë gjithashtu burim i ndotjeve të ajrit dhe zhurmës së madhe.

Problemet e shumta me furnizim me energji elektrike në mënyrë të pa ndërprerë krijohet për arsye të mungesës së kapaciteteve për furnizim prandaj KEDS ka paraparë investime në transformimin e nënstacionit NS 35/10kV në Mazgit në NS 110/10(20)kV i cili do të krijonte një furnizim më stabil me energji elektrike.

OSSH-ja[23] duke analizuar problemet mbi furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike në planin e tyre zhvillimor afatgjatë ka paraparë transformimin e rrjeteve shpërndarëse si dhe shtimin e kapaciteteve prodhuese në të mirën e eliminimit të problemeve me furnizim të qëndrueshëm:

- Zëvendësimin e transformatorëve nga 10/0.4kV në 20(10)/0.4kV;
- Ndërtimin e blloqeve të TM në nivel 20(10)/0.4kV;
- Zëvendësimin i linjave kabllore nga 10 kV të vjetërsuara dhe të mbingarkuara në 20kV ;
- Zëvendësimin i shtyllave të drurit me shtylla betoni me pajisje tjera përcjellëse;
- Zëvendësimin i kabllove të vjetërsuara të 10kV me ato 20kV
- Ndërtimi i NS 10(20)/0.4kV në rrjetet e ngarkuara të tensionit të ulët.
- Ndërtimi i NS 35/10kV në 110/10(20)kV.

[23]Operatori i sistemit shpërndarës


Problem tjetër i cili duhet të theksohet është **rrjeti i tensionit të lartë** i cili kalon në komunën e Obiliqit, Gjendja fizike e këtij rrjeti nuk është në nivelin e kënaqshëm. Po ashtu, ky rrjet kalon mbi vendbanime përkatësisht mbi shtëpi banimi; pra, nuk ka një tampon zonë mbrojtëse dhe si rezultat i saj është rrezik i lartë për jetën e qytetarëve, prandaj si e tillë është propozuar vendosja e linjës së tensionit të lartë nga Kosova A deri të Kosova B dhe vazhdon të transformatori i tensionit të lartë.

Investimet e pamjaftueshme në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike kanë bërë që ky sistem të mos mund të përballojë ngarkesën në rritje, veçanërisht të përballojë ngarkesën në sezonin e dimrit. Kjo ka pasur për pasojë nivelin shumë të lartë të humbjeve teknike që ka rënduar vazhdimisht sistemin.

Përveç aspektit të problemeve dhe sfidave për furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike OSSH-ja ballafaqohet me probleme të mëdha me humbjet e energjisë të cilat shkaktohen si pasojë:

- Vjetërsisë së njehsorëve;
- Lokacione pa njehsorë;
- Mos mbyllja e pajisjeve ku janë të vendosu njehsorët;
- Lidhjet e reja;
- Saktësia, kalibrimi i njehsorëve;
- Vështirësia e qasjes tek konsumatorët;
- Ndërhyrjet në njehsorëve;

Kërkesat për energji elektrike në të ardhmen - duke parashikuar vlerat dhe formën e saj brenda horizontit të planifikimit janë esenciale për zhvillimin e operatorit të sistemit shpërndarës i rishikon dhe zhvillon parashikimin e ngarkesave maksimale 'pikut' dhe kërkesat për energji elektrike afatshkurtër dhe afatgjatë duke përdorur teknika të ndryshme matematikore. Kërkesat dhe parashikimet për konsum të energjisë janë paraqitur në figurën e radhës.



Grafiku 4. Parashikimi vjetor për konsum të energjisë elektrike *OSSH-ja

3.3.6.1. Sfidat kryesore në sektorin e energjisë elektrike

- **Mungesa e kapaciteteve gjeneruese** - Me gjithë faktin se Kosova ka resurse shumë të mëdha energjetike nuk ka pasur një investim në ndërtimin e kapaciteteve të reja apo rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese që do të mundësonte një furnizim stabil me energji elektrike. TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë kapacitete të përbashkëta të instaluara 1478 MW por për shkak të moshës së tyre kapaciteti aktual është 915 MW.
- **Mungesa e investimeve në sistemin e rrjeteve të shpërndarjes -** Investimet e pa mjaftueshme në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike kanë bërë që ky sistem të mos mund të përballojë ngarkesat në rritje, veçanërisht të përballojë ngarkesat në sezonin e dimrit.
- **Niveli i lartë i humbjeve komerciale të energjisë elektrike -** Humbjet jo teknike si pasojë e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë dhe degradimi i një sasie të konsiderueshme të energjisë elektrike.
- **Mos shfrytëzimi i energjisë në mënyrë racionale** - Me gjithë potencialet e konsiderueshme për konsumin e energjisë, ky potencial nuk shfrytëzohet sa duhet në Kosovë.
- **Përdorimi i madh i energjisë elektrike për ngrohje -** Energjia elektrike përdoret, në masë të konsiderueshme për ngrohjen e hapësirave, gatim dhe ngrohje të ujit sanitar.

Shiritat Mbrojtës rreth Stabilimenteve Energjetike.

Me rastin e inicimit të procesit të ndërtimit të linjave dhe stabilimenteve energjetike që përpos kërkesave tjera ligjore dhe ekonomike është e nevojshme të sigurohen shirita mbrojtës (korridore) brenda të cilave ka shumë kufizime.

Shfrytëzimi i këtyre shiritave rregullohet me norma teknike si dhe me ligje përkatëse (UA) dhe më tutje këto konsiderohen si zona te sigurisë dhe shërbejnë, për ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi.

Nr	Linja kabllovike nëntokësore	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x 400 kV	10	16
2	400 kV	8	14
3	2x 220 kV	8	14
4	220 kV	6	12
5	2x 110 kV	6	12
6	110 kV	5	10
7	35 kV	3	5
8	20 kV	2	5
9	10 kV	2	5

Tabela 122. Korridoret e linjave energjetike kabllovike nëntokësore

Nr	Linja ajrore energjetike	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x 400 kV	80	100
2	400 kV	70	80
3	2x 220 kV	60	70
4	220 kV	50	60
5	2x 110 kV	50	60
6	110 kV	40	50
7	35 kV	30	30
8	20 kV	20	20
9	10 kV	15	15

Tabela 123. Korridoret e linjave energjetike ajrore

Planifikimi i ndriçimit të rrugëve

Ndriçimi aktual i lagjeve nuk është i kompletuar në të gjitha rrugët ashtu si duhet. Për këtë arsye duhet të parashihen të ndriçohen të gjitha rrugët dhe hapësirat publike në lagje. Duhet planifikuar që ndriçimi të bëhet me llamba ekonomike të teknologjive më të reja LED- efiçiente, të vendosura në shtylla metalike apo edhe në shtylla betoni në zonat rurale. Numri i llambave për ndriçimin e rrugëve të lagjes do të përcaktohet me projekt detal-zbatues dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare për ndriçim të rrugëve. Furnizimi i këtyre llambave do të bëhet nga nënstacionet e reja të vendosura në ato lagje, ku edhe do të vendoset grupi matës i energjisë së nevojshme për ndriçim. Pajisjet për komandim të ndriçimit të jashtëm duhet të vendosen në trafo stacione në kuadër të veçantë. Këto pajisje duhet të mundësojnë kyçjen automatike në mbrëmje dhe shkyçjen në mëngjes, dhe në vende ku frekuenca e qarkullimit është e vogël, pas orës 24 mundet që të zvogëlohet për 50 %.


Ndërtimi i ndriçimit publik

Realizimi i ndriçimi publik i hapësirave publike në vendbanimet duhet të bëhet në varësi të karakteristikave të përmbajtjeve të veçanta (banim, ndërtesë publike, rrugët, hapësirat për qarkullim, monumentet e kulturës, hapësirat për rekreacion etj.), edhe pse hapësirat sportive dhe rekreative duhet të trajtohen me projekt të veçantë për ndriçim.

- Kushtet e ndërtimit të ndriçimit publik do të trajtohen me leje ndërtimore, gjegjësisht në bazë të Hartës Zonale të Komunës apo Plane Rregulluese të Hollësishme, si dhe zgjidhjeve të bazuara në kushtet, dhe teknologjitë duke respektuar kërkesat e organeve për trashëgimi kulturore, ato komunale dhe të ndërmarrjeve energjetike.
- Shpërndarja e linjave të tensionit të ulët TU të ri dhe ekzistues nuk do trajtohen por ato duhet të realizohen në bazë të lejeve të përcaktuara dhe kushteve teknike mbi zonat e sigurisë, gjithnjë ku është e mundur.
- Me këtë plan parashihet shfrytëzimi racional i burimeve shtetësi ato efiçiente apo edhe të ripërtërishme - nëse ka, duke siguruar funksionalitet dhe akomodim të këtyre stabilimenteve në hapësira publike dhe tjera.

DRAFT

Gjithnjë duke u përshtatur me rrethinën dhe në pajtim me normat teknike, ndërtimin e rrjetit të ndriçimit publik të rrugëve, dhe hapësirave tjera rreth zonës së planifikuar, duhet t'i plotësojnë parametrat fotometrikë të dhënë sipas normave evropiane EN 13201.



Harta 47. Shtrirja e rrjetit të largpërçuesve

3.3.6.2. SWOT Analiza

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Furnizimi i të gjithë konsumatorëve;** ▪ **Potencial të madh për krijimin e energjisë alternative;** ▪ **Rezervat e mjaftueshme të linjitit për të prodhuar energji elektrike dhe termike me çmime konkurruese;** ▪ **Përvoja industriale për prodhim dhe eksploatim të linjitit në Kosovë;** ▪ **Kapacitete transmetuese interkonektive të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare** ▪ **Resurset humane të mjaftueshme për të rekrutuar dhe zhvilluar staf me shkathtësi që mund t'i përgjigjen kërkesave të sektorit;** ▪ **Baza ligjore në harmoni me direktivat e BE-së;** ▪ **Mekanizma institucionalë adekuatë për funksionimin e sektorit të energjisë, në veçanti autoritetet e pavarura rregullatorë dhe operatori i pavarur i sistemit të transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike;** ▪ **Potenciale relativisht të favorshme të BRE-ve, që mundëson diversitet të burimeve të energjisë;** ▪ **Potencial i lartë për efiçiencën e energjisë.**	▪ Kapacitete gjeneruese aktuale të vjetërsuara që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike; ▪ Nivel i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes; ▪ Mungesa e trafo stacioneve sipas standardeve evropiane; ▪ Linjat e tensionit të lartë në qytet dhe vendbanime tjera të rrezikshme për qytetarët; ▪ Mungesë e mos shfrytëzimit të potencialeve alternative energjetike; ▪ Mundësi të kufizuara për vetë financim të investimeve; ▪ Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese ; ▪ Furnizim jo i sigurt me energji elektrike dhe termike; ▪ Varësi e pjesshme nga importi i energjisë elektrike; ▪ Efiçienca e ulët në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë; ▪ Përdorim i lartë i energjisë elektrike për ngrohje;

Mundësitë	Rreziqet
▪ **Kërkesa në rritje për energji në Kosovë dhe rajon, mundësi për zhvillim të shpejtë të sektorit të energjisë;** ▪ **Ristrukturimi dhe reformimi i plotë i sektorit të energjisë në përputhje me Direktivat e BE-së;** ▪ **Liberalizimi i tregut në nivel rajonal dhe zhvillimi i sektorit me kapital privat;** ▪ **Mundësia e tërheqjes së investitorëve strategjikë;** ▪ **Ndërtimi i ngrohtoreve qendrore në qytetet më të mëdha;** ▪ **Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe rritja e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike;** ▪ **Rritja e EE në prodhimin e energjisë dhe shfrytëzimi efecient i energjisë nga konsumatorët fundorë;** ▪ **KOSTT si Zonë Rregulluese e pavarur.**	▪ Rritjet e paparashikueshme të çmimeve të importit të produkteve të lëndëve të lëngëta djegëse dhe pengesat e paparashikueshme të furnizimit me produkte të naftës; ▪ Krizat e mundshme financiare globale, me ndikim negativ në investimet nga jashtë; ▪ Vazhdimi i obstruksioneve nga Serbia në sektorin e energjisë; ▪ Rritje e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e kërkesës për import deri në ngritjen e kapaciteteve të reja prodhuese; ▪ Mungesa e energjisë elektrike në dispozicion në rajon; ▪ Mosfunksionimi i tregut të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon;

3.3.7. Infrastruktura e Ngrohjes Qendrore

Sistemet e ngrohjes qendrore mund të sigurojnë efikasitet më të lartë dhe kontroll më të mirë të ndotjes sesa ngrohja e prodhuar nga kaldaja individuale. Hulumtimet ka treguar se ngrohja qendrore me ngrohje nga ko-gjenerimi është metoda më e lirë për të ulur emetimet e karbonit ne ajër dhe ka një nga ndikimet më të ulëta të karbonit ne ambient krahasuar me të gjitha centralet tjera gjeneruese me lende djegëse fosile.

Komuna e Obiliqit në vitin 2019 ka hartuar studimin e fizibilitetit për ngrohjen qendrore të qytetit, studim i cili analizon dhe përcakton format dhe mënyrat e shtrirjes dhe funksionalizimit të infrastrukturës së ngrohjes në komunën e Obiliqit.


Në sistemit e shpërndarjes së qytetit të Obiliqit është paraparë sistemi dy gypor i gypave të para izoluar i cili do të shtrihet nën sipërfaqen e rrugëve të qytetit dhe do të bartë ujin e ngrohtë deri të stacionet kompakte të ndërtesave individuale ku me pastaj këmbehet energjia termike me sistemin e instalimeve sekondare te objekteve.

Analiza teknike dhe financiare të termofikimit të qytetit të Obiliqit


Analiza teknike, dhe financiare është bërë duke e ndarë sistemit e termofikimit në tri zona, analizat teknike janë paraqitur në vazhdim, ndërsa sa i përket analizave financiare të detajuara i gjeni në kuadër të planit të fizibilitetit për ngrohje qendrore të Obiliqit.

- Zona 1 që përfshinë qytetin e Obiliqit;
- Zona 2 që përfshijnë fshatrat Mazgit dhe Llazarevë;
- Zona 3 që përfshinë fshatin Milloshevë.

DRAFT



Grafiku 5. Skema e rrjetës se shpërndarjes së ngrohjes për qytetin e Obiliqit



Grafiku 6. Ndarja në zona e sistemit të termofikimit

3.3.8. Telekomunikimi

Në fushën e post-telekomit, në Komunën e Obiliqit, i tërë territori i komunës është i mbuluar me telefoni mobile nga dy operatorë: Vala dhe IPKO. Infrastruktura mbulohet me kapacitet: E, 3G, dhe LTE (4G). Operatorët privat të telefonisë mobile, Internetit dhe rrjetit të TV kabllor janë:

- Rrjeti i kompanisë IPKO;
- Rrjeti i kompanisë KUJTESA;
- Rrjeti i kompanisë ARTMOTION.

Në kuadër të këtij sektori është edhe objekti ekzistues i postes që kujdeset për telefoninë fikse në disa pjesë të komunës, e cila ka një tendencë të zvogëlimi të vazhdueshëm. Sa i përket telefonisë mobile, konkurrenca ka mundësuar shërbime më cilësore dhe çmime relativisht të arsyeshme. Gjendja e rrjetit të telekomunikacionit në Obiliq është e dobët. Gjithsej janë 11 zona rurale të mbuluara me rrjet të telekomunikacionit. Në total janë vetëm 6 pika që shpërndajnë rrjet të telekomunikacionit (me tel). Ato kryesisht shpërndajnë linjën në fshatin ku janë të vendosura, por ekzistojnë edhe rrjete të tjera që shpërndajnë linjën në fshatrat përreth. Sipas të dhënat e siguruara nga operatori Kujtesa, mbulushmëria me rrjete nga ky operator është vetëm 65% e territorit të komunës është e mbuluar me shërbime, ndërsa zona urbane ka mbulueshmëri të plotë. Gjithashtu, nga informacionet e Kujtesës, aspekti social rreth 15 mijë qytetar kanë qasje në shërbimet e kujtesës.

Një problem i cili duhet të ceket në kuadër të infrastrukturës së telekomunikimit është mënyra e shtrirjes së kabllove e cila nuk ka një formë të organizuar, ku secila kompani ka rrjetin e vet shpërndarës dhe si e tillë, sjell probleme në mirëmbajtje të saj.

Shtrirja e rrjetit të kabllove optike - fibri optik, përveç në qytetin e Obiliqit, është duke u zgjeruar edhe në hapësirat periferike urbane si dhe në vendbanimet tjera. Një pjesë e këtyre kabllove janë të vendosur në kanale nëntokësore, por pjesa më e madhe e tyre i shfrytëzojnë për shpërndarje shtyllat elektrike dhe të telefonisë. Për çështje sigurie dhe estetike duhet të planifikohet largimi i kabllove ajrore dhe zëvendësimi i tyre me optike apo vendosje në gypa nëntokësor.

PTK në përbërjen e vet ka edhe Postën që jep shërbime postare (mbledhjen, pranimin dhe shpërndarjen e dërgesave).

Vendosja e antenave për shpërndarje të valëve, duke mos përdorur asnjë standard të kërkuar, pra, vendosja e tyre mbi çatitë e shtëpive private në hapësira të vendbanimeve apo zonë të frekuentuar me qytetarë, është praktikë e gabuar dhe e rrezikshme për jetën e qytetarit, prandaj kjo dukuri duhet të eliminohet dhe të përdoren praktika të aplikueshme sipas standardeve të kërkuara me ligj.


Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e rrjetit të telekomunikimit

- Shpërndarja e rrjetit kabllor në tërë komunën, përfshirë edhe pjesët me të thella rurale;
- Shpërndarja e kabllove optike në të mirën e menaxhimit më të lehtë dhe shërbim cilësor;
- Zëvendësimi i antenave dhe vendosja e atyre të rejave sipas standardeve të kërkuara;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Shpërndarja e rrjeteve optike;
- Eliminimi i kabllove ajrore dhe vendosja e tyre në gypa nëntokësor;
- Eliminimi i antenave në hapësira ku rrezikojnë jetën e qytetarëve;

DRAFT



Harta 48 Mbulushmëria me rrjet e KUJTESA-net

3.3.9. Menaxhimi i mbeturinave

Ndërmarrja Rajonale e Mbeturinave në Prishtinë "Pastrimi" është duke organizuar marrjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave të krijuara, nga banorët që jetojnë e veprojnë brenda territoreve të komunave të Obiliqit, Prishtinës, Gllogovcit (Drenasit), Fushë Kosovës, dhe atë të Lipjanit.

Deponia Sanitare Rajonale (e pajisur me bazën e kullimit, mirëpo pa trajtim të mëtutjeshëm), është me kapacitet mujor prej 6.000 tonëve ose kapaciteti i saj i gjithmbarshëm është prej 3.500.000 m³, për deponimin e mbeturinave të grumbulluara nga 725.251 banorë. Lokacioni i Deponisë Rajonale Sanitare të Prishtinës, me shtrirjen e saj prej 50 hektarëve, është e vendosur në pjesën veri-lindore të Minierës ekzistuese të Mirashit dhe planifikohet të ketë jetëgjatësi prej 15 viteve.

Mbulueshmëria me grumbullim dhe menaxhim të mbeturinave

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës. Kompania në disponim i ka dy kamionë special. Sasia ditore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe transporti i tyre në deponi është rreth 15.500 kg ose 341,000 kg për një muaj.

Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira pjesa më e madhe e vendbanimeve ose ekonomive familjare. Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira nëntë vendbanime ose 1085 ekonomi familjare, nëse shprehet në përqindje i bie 45 % e vendbanimeve, ose 20 % e ekonomive familjare. Në vijim po i paraqesim informacionet për vendbanimet e mbuluara me shërbim të organizuar, përqindjen e ekonomive familjare të mbuluara me këtë shërbim, dinamikën dhe sasinë e mbeturinave që deponohen në deponi.

Në vendbanime ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, përgjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale, dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

Problemet në aspektin legjislativ dhe organizativ lokal

- Mungesë të rregulloreve lokale dhe kapacitete të pamjaftueshme administrative;
- Mungesa e planit lokal për menaxhimin e MNK-së;

- Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjeve në këtë sektor;
- Niveli i ulët i përfshirjes së vendbanimeve në sistem të organizuar të shërbimeve (vetëm 45%) në grumbullimin dhe transportimin në deponitë MNK;
- Mungesa e pajisjeve, kontejnerëve, shportave dhe kushte të dobëta të pajisjeve që përdoren për grumbullimin e mbeturinave;
- Mos definimi i lokacioneve për vendosje të kontejnerëve, mungon plani për caktimin e pikave (VGM) për vendosje në kontejnerëve në qytet;
- Sektori komercial nuk posedon kontejnerë të posaçëm për hedhje të mbeturinave, por ato i hedhin në kontejnerë të përbashkët me banorë; dhe
- Orari i zbrazjes së kontejnerëve, si dhe transportit të mbeturinave nuk është në përputhje me kërkesat.

Krijimi i deponive ilegale

Në disa pjesë të qytetit, si dhe në vendbanime rurale të cilat nuk janë të mbuluara me shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe të transportit të mbeturinave deri në depon rajonale, nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, përgjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale, si pasojë e këtij veprimi vjen deri te krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

Gjendja e rëndë mjedisore në deponinë rajonale të Prishtinës - Infrastruktura rrugore në deponi:

- Rruga në hyrje e deri të objektet pranuese, si dhe rrugët brenda trupit të deponisë nuk janë të rregulluara, kështu që nuk ka kushte të mira për pranimin e automjeteve që bartin mbeturina, si dhe automjeteve për rastet emergjente (p.sh. zjarrfikësit).

Stafi dhe mekanizmi i nevojshëm për menaxhim të mbeturinave

- Nuk ka staf dhe mekanizëm të nevojshëm për kryerjen e punëve operative në deponi;
- Nuk bëhet rregullisht shpërndarja, shtresimi, mbulimi me materiale inerte me shtresa 1520cm dhe ngjeshja (kompaktimi) i mbeturinave që të arrihet dendësia 1.1 deri në 1.2t/m;
- Nuk bëhet integrimi ditor i materialeve inerte e cila ndikon në mos stabilitet të trupit të deponisë, si dhe ndërtimi integral i rrugëve brenda në deponi;
- Ekziston rreziku potencial për shpërthim të zjarreve brenda deponisë;
- Mund të ndodhin lëvizje të mëvonshme të trupit të deponisë;
- Krijohen kushte për ndikimet sekondarë, siç janë: shpezët, kundërmimi, pluhuri, insektet, rreziku nga infeksionet, prodhimin e gazrave nga zbërthimi i mbeturinave;
- Mosfunksionimi i sistemit të pompave cirkulare për trajtimin e ujërave të zeza (liqetës) në trupin e deponisë;
- Është rritur niveli i ujërave të zeza në lagunë dhe kanë depërtuar në trupin e deponisë. Me këtë sasi të lartë të ujërave (përmbytje) nuk mund të bëhet kompaktimi i mbeturinave e as intervenimi në rast emergjent (mjete të rënda teknike nuk mund të operojnë mbi këtë hapësirë);
- Mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshme; dhe
- Kontrollimin e ndotjes dhe njoftimin

Gjendja e rëndë mjedisore në deponinë rajonale të Prishtinës (Mirash)

- Infrastruktura rrugore në deponi;
- Rruga në hyrje e deri të objektet pranuese, si dhe rrugët brenda trupit të deponisë nuk janë të rregulluara, kështu që nuk ka kushte të mira për pranimin e automjeteve që bartin mbeturina, si dhe automjeteve për rastet emergjente (p.sh. zjarrfikësit).
- Stafi dhe mekanizmi i nevojshëm për operim në deponi;
- Nuk ka staf dhe mekanizëm të nevojshëm për kryerjen e punëve operative në deponi;
- Nuk bëhet rregullisht shpërndarja, shtresimi, mbulimi me materiale inerte më shtresa 15-20 cm dhe ngjeshja (kompaktimi) i mbeturinave që të arrihet dendësia 1.1 deri në 1.2 t /m;
- Nuk bëhet integrimi ditor i materialeve inerte e cila ndikon në mos stabilitet të trupit të deponisë, si dhe ndërtimi integral i rrugëve brenda në deponi;
- Ekziston rreziku potencial për shpërthim të zjarreve brenda deponim;
- Mund të ndodhin lëvizje të mëvonshme të trupit të deponisë;
- Krijohen kushte për ndikimet sekondarë siç janë: shpezët, kundërmimi, pluhuri, insektet, rreziku nga infeksionet; prodhimin e gazrave nga zbërthimi i mbeturinave;
- Mosfunksionimi i sistemit të pompave cirkulare për trajtimin e ujërave të zeza (liqetës) në trupin e deponisë;

DRAFT

- Është rritur niveli i ujërave të zeza në lagunë dhe kanë depërtuar në trupin e deponisë, me këtë sasi të lartë të ujërave (përmbytje) nuk mund të bëhet kompaktimi i mbeturinave e as intervenimi ne rast emergjente (mjetet e rënda teknike nuk mund të operojnë mbi këtë hapësirë);
- Mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshme dhe;
- Kontrollimin e ndotjes dhe njoftimin.

Mbeturina industriale: Format e krijimit të deponive industriale janë të natyrave të ndryshme, varësisht nga destinimi i prodhimit apo veprimtarisë. Pothuaj çdo industri në të kaluarën ka trashëguar deponi apo mbetje të rrezikshme të cilat kanë efekte negative në mjedis. Gjithashtu, pos këtyre mbetjeve të deponuara në deponi, veçanërisht nga metalet e rënda, substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale.

Mbeturinat shtazore: Komuna e Obiliqit nuk ka deponi e cila i trajton mbetjet shtazore dhe si e tillë këto mbeturina trajtohen në forma të ndryshme të cilat janë jo legale, në shumicën e rasteve këto mbeturina vendosen tek deponia rajonale në Mirash, e cila i përmbush kriteret për trajtimin e këtij lloji të mbeturinave dhe si rezultat i kësaj komuna duhet të planifikoj që të rezervoj një hapësirë ku do të trajtohen këto lloje të mbeturinave.

3.3.9.1. SWOT analiza

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Deponia në Mirash;** ▪ **Impianti për trajtimin e mbeturinave shëndetësore;** ▪ **Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave;** ▪ **Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave ;** ▪ **Komiteti komunal për mbrojtje të mjedisit;**	▪ Mungesë e kapaciteteve për furnizim me ujë cilësor të pijes në qytet dhe në disa fshatra; ▪ Furnizim me ujë jo cilësor nga puset individuale; ▪ Niveli i ultë i përfshirjes së ekonomive familjare (20%) në sistem të organizuar të shërbimeve e në grumbullimin dhe transportin në deponi të MNK. ▪ Krijimi i deponive ilegale. ▪ Mungesë e deponisë për mbeturina inerte/demolimit. ▪ Mungesa e auditimit mjedisor; ▪ Mungon sistemi i përpunimit dhe riciklimi i mbeturinave komunale. ▪ Mos ndarje e mbeturinave në burim; ▪ Raportimet e parregullta mbi gjendjen e ofrimit të shërbimeve; ▪ Numër i lartë i deponive ilegale; ▪ Sasi e lartë e mbeturinave industriale dhe sanitare; ▪ Mungesë e hapësirave për trajtim të mbeturinave shtazore;
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Fushata vetëdijesuese;** ▪ **Krijimi i Eko-taksës** ▪ **Angazhimi i OJQ-ve mjedisore;**	▪ Rritja e ndotjes; ▪ Shfaqja e sëmundjeve infektive; ▪ Ndotje e tokave bujqësore;

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave

- Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave;
- Mungesa e deponisë për trajtimin e mbeturinave inerte/demolimit, komuna nuk ka të caktuar hapësirën e cila do ti trajtonte këtë lloje të mbetjeve dhe si e tillë duhet të planifikohet një hapësirë e cila do ti përmbushte kriteret si në aspektin vëllimor dhe atë natyrore;
- Mungesa e deponisë për trajtimin e mbetjeve shtazore, komuna nuk ka hapësirë të definuar për trajtimin e mbetjeve shtazore është e domosdoshme planifikimi i hapësirës ku do të trajtoheshin ky lloj i mbetjeve;
- Eliminimi i deponive ilegale;
- Mundësia e riciklimit të mbeturinave;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Menaxhimi efikas i deponisë regjionale të mbeturinave në Mirash;
- Caktimi i lokacionit për trajtim të mbeturinave inerte, inteligjente dhe shtazore.
- Eliminimi i mbeturinave industriale dhe atyre radioaktive konform rregullave;

DRAFT

- Funksionalizimi i fabrikës për riciklimin e mbeturinave.

3.4. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

3.4.1. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Territori i Komunës së Obiliqit është i mbuluar mirë me rrjet rrugor, sipas kërkesave për lëvizje, infrastruktura rrugore në përgjithësi është përmirësuar ne aspektin e përmbushjes se kritereve teknike dhe ofron kushte të kënaqshme për lëvizjen e mjeteve. Përveç mbulueshmërisë me infrastrukture rrugore, Komuna e Obiliqit ka mbulueshmëri edhe me infrastrukture hekurudhore, funksionalizimi dhe modernizimi i se cilës është pjese e strategjisë dhe zhvillimit nga niveli qendror.

Autoudha dhe rruga nacionale

Në territorin e komunës së Obiliqit kalon autoudha R7 (“Ibrahim Rugova”). Kjo autoudhë e tangjenton komunën e Obiliqit në pjesën veri-lindore. Në këtë pjesë gjendet edhe nyja e autoudhës që mundëson kyçjen me rrugën nacionale N2 e pastaj edhe me rrugën rajonale R220.

Komuna e Obiliqit, në kuadër të rrjetit rrugor ekzistues përmban rrugën nacionale N2 që lidhë Prishtinën me qytetin e Mitrovicës. Përmes kësaj nyje, qyteti i Obiliqit krijon qasje në rrugët e karakterit më të lartë.

Gjithashtu, rruga nacionale N2, Obiliqit i siguron qasje në rrugët me rëndësi kombëtare siç janë autoudha “Ibrahim Rugova” dhe “Arbër Xhaferi” përmes të cilave mund të lidhet edhe me rrugët e karakterit ndërkombëtar (korridoret pan evropiane).

Parametrat teknik të rrugës nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte te mira për qarkullim të mjeteve motorike.

Hyrja dhe dalja nga qyteti i Obiliqit në autoudhën “Ibrahim Rugova” -R7 realizohen përmes nyjës që gjendet në territorin e qytetit.

Rrugët rajonale

Ne kuadër te rrjetit rrugor rajonal, Komuna e Obiliqit përfshinë rrugët R220, dhe R120. Në përgjithësi, rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike. Pjesa më e madhe e tyre janë të asfaltuara, por kanë nevoje për mirëmbajte, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese më qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes.

Problematika paraqitet në pjesën e rrugës R220 që shërben për lidhje më autoudhën dhe pjesën e territorit të komunës deri në qytetin e Mitrovicës. Pothuajse në tërë gjatësinë e saj (përveç në pjesën që kalon në qytet), kjo rrugë nuk përmban pjesën e infrastrukturës për akomodim të këmbësorëve dhe biçiklistëve. Në aspektin e sigurisë së trafikut, sfidë kryesore mbeten kryqëzimet me rrugët tjera që të gjitha janë në nivel të njëjtë dhe të pasinjalizuara sipas standardeve (kryqëzimi R220 me R120). Përmes rrugës rajonale R120 nga qyteti i Obiliqit realizohet kyçja në rrugën nacionale N2, e rregulluar me mbikalim (fshati Muzakaj).

Rrugët lokale-urbane

Rrugët lokale ku përfshihen edhe rrugët urbane, kryesisht janë dy shiritore (me nga një shirit qarkullues për kahe), përveç një pjesën urbane ne brendi te qytetit, ku rrugët te cilat shërbejnë për hyrje dalje nga qyteti janë rruge me katër korsi.

Në Komunën e Obiliqit, sidomos viteve të fundit janë bërë disa investime me qëllim përmirësimin e rrugëve nëpër fshatra, duke investuar në asfaltimin e disa rrugëve dhe shtrimin e zhavorrit në disa të tjera. Këto investime janë bërë fillimisht në rrugët kryesore që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën dhe mund të konsiderohen si rrugë lokale.

Rrugët urbane brenda qytetit, në aspektin e funksionalitetit përgjithësisht ofrojnë qasje të mirë për qarkullim të automjeteve motorike, por jo edhe për lëvizje të këmbësoreve dhe çiklisteve.

Përzgjedhja e formave të kontrollit të kryqëzime nuk ofron funksionalitet dhe operim kualitativ të trafikut, prandaj është e nevojshme të bëhet një analizë dhe vlerësim i gjendjes ne mënyrë qe oferta te jete ne harmoni me kërkesën e trafikut. Zona të caktuara në brendi të lagjeve të qytetit paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak te parametrave teknik te rrugëve të cilën rezultojnë të pamjaftueshëm për te përballuar kërkesat për qarkullim te automjeteve si dhe për shkak te kërkesave te mëdha për parkingje ne afërsi te rrugës.

Modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor. Rrjeti i rrugëve lokale është i pakategorizuar, pa funksion të qartë dhe dizajn adekuat. Kërkesave për lëvizje nga ana e këmbësorëve dhe çiklisteve, ne qytetin e Obiliqit nuk u ofrohet hapësirë komode. Po ashtu dhe ne kuadër te rrjetit rrugor periferik, këmbësoret dhe çiklistet nuk kane qasje te lehte dhe kushte te mira për lëvizje te sigurt. Por, cilësia e rrugëve e problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet. Gjithashtu, pjesa më e madhe

e ndërtimeve në Obiliq janë ndërtime të ulëta, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit, duke formuar bërthamën urbane të qytetit.

3.4.2. Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror

Nga niveli qendror nuk janë planifikuar rrugë të reja për Komunën e Obiliqit. Investimet janë paraparë në digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike ne Obiliq si dhe asfaltimi e disa rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq.

3.4.3. Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të rrugëve

Sipas matjeve të qarkullimit të automjeteve, është konstatuar se në rrugën nacionale N2 qarkullimi i automjeteve sillet rreth 20.000 aut/12h[24]. Bazuar në gjendjen ekzistuese të kësaj rruge, gjerësinë e korsive dhe numrin e tyre (2+1), kapaciteti potencial do të sillet rreth 2500 – 3000 aut/h/kahe, dhe ky kapacitet do të jetë në gjendje të përballoj nevojat për qarkullimin e trafikut aktual dhe në qarkullimin në të ardhmen.

Ne kuadër te rrjetit rrugor rajonal, komuna e Obiliqit përfshinë rrugët R220, dhe R120. Në përgjithësi, rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike. Pjesa më e madhe e tyre janë të asfaltuara, por kanë nevoje për mirëmbajte, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese më qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete. Bazuar në intensitetin e qarkullimit, për rrugët rajonale R-220 rreth 5500 aut/12h dhe R-120 rreth 3000 aut/12h, rezulton se këto rrugë nuk kanë ngarkesë të madhe dhe si të tilla ofrojnë nivel mesatar të shërbimit.

3.4.4. Modelet e qarkullimit të trafikut

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës së Obiliqit realizohet kryesisht përmes transportit rrugor, ndërsa transporti hekurudhor aktualisht nuk është funksional. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale (N2, R-220, R-dhe R-120) dhe rrugët lokale, i mundësojnë komunës së Obiliqit lidhje të mira me kryeqytetin dhe komunat tjera në Kosovë. Modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor. Rrjeti i rrugëve lokale është i pakategorizuar, pa funksion të qartë dhe dizajn adekuat.

3.4.5. Linjat transportuese ndërkomunale e brenda komunës urbane dhe rurale

Transporti publik ne qytet dhe ne komune është i bazuar ne autobusë. Hapi i mëtejmë nga autobusët lokale dhe urbane ne autobusë rajonale është i mundshëm përmes stacionit qendror te autobusëve.

Sa i përket mbulueshmërisë, shërbimi i transportit publik me autobus dhe me kombibus mbulon rreth 14 vendbanime apo 65% të vendbanimeve të komunës, përderisa në 7 vendbanime apo 35% të vendbanimeve nuk ka transport publik. Shërbimi i transportit publik në territorin e komunës së Obiliqit është në një nivel të kënaqshëm edhe pse nuk zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës. Vendbanimet në të cilat zhvillohet transporti publik janë: Obiliq (Obiliq i Ri dhe Obiliq i Vjetër), Cërkvena Vodicë, Hade, Lajthishtë, Sibovc, Hamidi, Muzakaj, Raskovë, Bakshi, Llazarevë, Breznicë, Kozaricë, Orllovіq, Kryshefc, Shipitullë, Grabofc i Epërm, Plemetin dhe Baimofc. Për shkak të pozicionit (konfiguracionit), vendbanimi i vetëm i cili nuk është i mbuluara me transport publik është Mazgitit. Ky fshat nuk ka transport publik për shkake të pozicionit(konfiguracionit) ka qasje (transport) nga M2 dhe rruga Hasan Prishtina

Shërbimet e reja të propozuara të autobusëve, në kuadër të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) për qytetin e Prishtinës[25], është planifikuar rrjeti dytësor i transportit publik urban (si pjesë plotësuese e transportit kryesor urban) që do të lidhnin qendrën kryesore urbane me zonat periferike (të banimit), si dhe më gjerë. Në kuadër të këtyre shërbimeve dytësore është përfshirë edhe qyteti i Obiliqit, dhe kjo linjë mundëson lidhjen me më shumë zona rurale dhe zona periferike të qytetit me qytetin e Prishtinës. Në përgjithësi, rrjeti i ri do të ofrojë një nivel të përmirësuar të shërbimit në të gjithë qytetin në krahasim me kushtet ekzistuese.

3.4.6. Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit

Pas analizës së të dhënave, është vlerësuar se nga modalitetet e mundura transporti rrugor është dominues, ndërsa transporti hekurudhor aktualisht nuk është funksional.

Duke analizuar dimensionet dhe shtrirjen e rrjetit rrugor të qytetit të Obiliqit, rezulton se në shumicën e gjatësisë së rrjetit përgjatë rrugëve primare prioritet i është dhënë lëvizjeve të motorizuara në kuptimin e akomodimit të automjeteve motorike.

[24]Mott McDonald - Matjet e realizuara nga PMQU për qytetin e Prishtinës, , 2017.

[25]Mott McDonald - Matjet e realizuara nga PMQU për qytetin e Prishtinës, 2017.

Lëvizja e pamotorizuar përmes biçikletave aktualisht është në një nivel shumë të ulët të përdorimit. Kjo gjë mund të arsyetohet me disa nga specifikat e qytetit të Obiliqit:

- mungesa e shtigjeve për lëvizje të çiklisteve,
- perceptimi për mungesë të sigurisë së lëvizjes me biçikletë,
- mungesa e informimit për benefitet e lëvizjes me biçikletë,
- mungesa e inkurajimit në përdorimin e biçikletës etj.

Përgjatë rrugëve dytësore, pothuajse në tërë gjatësinë paraqitet mungesa e lëvizjes komode të lëvizjeve të pamotorizuara (këmbësorëve dhe çiklisteve) ku ekzistojnë trotuare në gjerësi të pamjaftueshme, si dhe në pjesët ku nuk ekzistojnë trotuaret lëvizja realizohet në hapësira të përbashkëta të qarkullimit me automjetet. Lëvizja e çiklisteve realizohet pas asnjë shënim përkatës përgjatë sipërfaqes qarkulluese duke shfrytëzuar skajin e djathtë të shiritit qarkullues.

Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për akomodimin e të gjithë pjesëmarrësve në trafik është e nevojshme. Rëndësi e veçantë duhet kushtuar kushteve për lëvizje të pamotorizuara.

3.4.7. Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim

Në qytetin e Obiliqit, krahas rritjes së shkallës së motorizimit, edhe nevojat për parkim janë në rritje. Prandaj, është e rëndësishme të menaxhohen kontrollet e parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës për të zvogëluar konfliktet e trafikut, pengesat dhe vonesat, duke siguruar që ka një regjim të përshtatshëm të zbatimit për të menaxhuar ofertën dhe rregulloret e parkimit në mënyrë efektive.

Është e rëndësishme të futen masa të kufizimit të kërkesave dhe të hulumtohen/iniciohen opsione të mëtejshme për zhvillim të ardhshëm, duke përfshirë përmirësimin e rregullores për parkimit të automjeteve në rrugë dhe jashtë rrugës (parkingje), dhe zhvillimin e kufizimeve të qasjes në zonën urbane.

Pas analizës së hapësirave ekzistuese për parkim, është vlerësuar nevoja për futjen e rregulloreve të reja të parkimit aty ku është e nevojshme dhe zbatimi i këtyre rregulloreve në mënyrë efektive. Është thelbësore të zbatohen kontrollet e parkimit në mënyrë rutinore për të siguruar se nuk ka abuzim ose aktivitet ilegal të parkimit. Gjithashtu, përdorimi i politikave të planifikimit për të kontrolluar numrin/llojin e parkingjeve të reja të automjeteve në tërë qytetin për përdorim publik.

3.4.8. Rrjeti hekurudhor

Transporti hekurudhor ka shtrirje në territorin e komunës së Obiliqit, por aktualisht nuk funksionon. Linja e transportit hekurudhor është shumë e vjetër, në relacionin Shkup – Mitrovicë, ndërsa në Obiliq si qendër gjeostrategjike e rrafshnaltës së Kosovës është ndërtuar stacioni hekurudhor grumbullues.

Nëpër territorin e komunës së Kastriotit(Obiliqit) kalojnë dy linja të hekurudhave : linja Fushë Kosovë – Mitrovicë me tre stacione hekurudhor si ai i Dardhishtës, i Obiliqit dhe ai i Plemetinit dhe linja Fushë Kosovë – Pejë me stacionin në Grabofc.

Nga gjithsejtë 20 vendbanime në komunën e Obiliqit, vetëm në 7 vendbanime kalon rruga hekurudhore, apo 35% të vendbanimeve të komunës. Rrjeti hekurudhor- binaret hekurudhor kalojnë nga Kryshefc-Obiliq-Plemetin dhe Grabofc i Epërm.

Hekurudha kalon në anën jugperëndimore të qendrës se qytetit. Aty do te formohet një qendër mobiliteti i cili lidhe stacionin e Transportit publik dhe mobilitetit.

Pasi që infrastruktura hekurudhore aktualisht është në gjendje të amortizuar dhe jashtë funksionit, paraqitet nevoja për riparime dhe investime në ngritjen e nivelit të saj me qëllim të vënies në funksionim.

Problemet e identifikuara në rrjetin hekurudhor:

- Hekurudha e paelektrifikuar dhe me linja njëfishe,
- Mosinvestimi në rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre,
- Mosintegrimi në sistemin integral të transportit të udhëtarëve dhe mallrave,
- Mosfunksionimi i linjës hekurudhore.

Njëri ndër projektet prioritare i INFRAKOS-it i cili ka rëndësi të veçantë për rrjetin hekurudhor të Kosovës dhe po ashtu edhe për Komunën e Obiliqit është Projekti i Rehabilitimit Gjeneral dhe Modernizimit të Linjës së 10 Hekurudhore. Linja e 10-të Hekurudhore i përket Rrjetit Kryesor Hekurudhor të Zgjerimit të Korridoreve të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T). Ky projekt financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe nga Qeveria e Kosovës. Faza e parë e rikonstruktimit të rrjetit hekurudhor do të fillon në linjën Prishtinë - Hani i Elezit në kufi me Maqedoninë, kurse faza e dytë, e cila kalon nëpër territorin e Obiliqit, përfshin rrjetin hekurudhor Prishtinë - Leshak, në kufirin me Serbinë. Prandaj, është e nevojshme të zbatohen gradualisht rekomandimet e nxjerra në bazë të studimit të fizibilitetit të Linjës 10 (kryer nga Konsulenca e angazhuar dhe mbështetur nga BERZH) për të pasur, së paku, këtë linjë në gjendje të mirë për operim. Pjesa jugore e linjës 10 duhet të

konsiderohet si prioritare si dhe ne një ardhme të afërt duhet rishikuar mundësit e funksionalizimit të pjesës veriore të linjës X. Në bazë të studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës X[26].

3.4.9. Vlerësim të nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese

Infrastruktura transportuese në Komunën e Obiliqit duhet të planifikohet dhe zhvillohet me një perspektivë afatgjate në të cilën merren parasysh nevojat e ardhshme dhe zhvillimet e ardhshme urbane, hapësinore dhe teknologjike. Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së transportit duhet të përqendrohet në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së hapësirave publike.

Prandaj, nevojat zhvillimore për një infrastrukture transportuese dhe funksionale në të ardhmen, për Komunën e Obiliqit janë:

- Përmirësimi i kualitetit fizik dhe zgjerimi i rrjetit rrugor për një linje për autobusë,
- Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve dhe i vendndaljeve - stacioneve për ndalje të sigurt të autobusëve lokal,
- Rikonstruktimit të rrjetit hekurudhor (në kuadër të Projektit për rehabilitimit gjeneral dhe modernizimit të linjës së 10 hekurudhore) dhe ndërtimi i terminusit në afërsi të hekurudhës;
- Hartimi i Planit të mobilitetit për transport të qëndrueshëm

Sfidat kryesore:

- Përmirësimi i sigurisë dhe kapacitetit të udhëkryqeve;
- Krijimi i kushteve për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, duke siguruar përparësi lëvizjeve të pamotorizuara (këmbësorëve dhe çiklistëve);
- Rregullimi i transportit publik me autobus, si dhe funksionalizimi i transportit publik përmes transportit hekurudhor;
- Linja të reja të transportit publik,
- Zgjerimi i rrugëve dhe krijimi i një traseje për autobusë lokalë,
- Ndërtimi i stacioneve për ndalje të autobusëve lokalë,

3.4.10. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
Lidhjet e trafikut me pjesën tjetër të Kosovës nëpërmjet transportit rrugor dhe hekurudhor. **Investimet e Komunës në përmirësimet e rrugëve që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën (rrugë lokale);** **Ekziston një infrastrukturë bazë e transportit dhe lidhja relativisht e mirë me Prishtinën dhe Mitrovicën** **Rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat në të gjitha mënyrat e transportit;** **Zhvillimi i shërbimeve të transportit publik përmes autobusëve urban dhe ndër-urban.**	Standard i ulët i disa rrugëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit; Gjendje e keqe infrastrukturës hekurudhore; Mbulueshmëria e pamjaftueshme e tërë territorit të Komunës me transport publik; Motorizimi: një numër i konsiderueshëm i makinave janë të vjetra dhe numri botëror i makinave është në rritje; Mungesa e infrastrukturës për lëvizje të lirë dhe të sigurt të këmbësorëve dhe çiklistëve (zakonisht ka mungesë të trotuareve, rrugës për këmbësorë dhe shtigjeve për biçikleta); Sinjalizimi i trafikut nëpër rrugët e Komunës nuk është i mjaftueshë**m dhe nuk është në harmoni me standardet evropiane;** Shpeshherë ndërtimet janë bërë ngjitur me cepin e rrugëve kryesore, duke përjashtuar mundësinë për zgjerim. Menaxhimi i dobët i trafikut brenda pjesës urbane.
Mundësitë	Rreziqet
Mundësia e lidhjes me qytetin e Prishtinës përmes linjave të rregullta të transportit publik urban; **Modernizimi i hekurudhës, linja 10 e hekurudhës Fushë Kosovë-Mitrovicë- Hani i Elezit (Plan i për modernizimin e hekurudhave të Kosovës);**	Investimet në infrastrukturën e transportit nuk janë integruar siç duhet në projektet e zhvillimit. Mungesa e ose pamjaftueshmëria e buxhetit komunal dhe granteve për realizimin e projekteve të parapara. Rritje potenciale e trafikut të motorizuar në mungesë të zhvillimit të transportit publik;

3.5. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

[26]Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015- 2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeqar, 2015.

3.5.1. Trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat

Bazuar në projeksionet dhe prognozën demografike për numrin e parashikuar të banorëve, Obiliqit parashihet të shënon rënie në numrin e banorëve.

Trendët e zhvillimit të investimeve dhe krijimit të hapësirave të reja të infrastrukturës publike dhe sociale janë pozitive.

Sa i përket nevojave hapësinore të Komunës për ofrimin e infrastrukturës publike dhe sociale, bazuar në numrin e parashikuar të banorëve, Komuna ka identifikuar nevojat vijuese për zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale:

- Institucione shtesë parashkollore në zonë urbane dhe rurale;
- Institucione shtesë të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë në zonë urbane;
- Institucione shtesë të administratës publike në zonë rurale;
- Institucione shtesë të mirëqenies sociale dhe komunitetit në zonë rurale;
- Bibliotekë publike;
- Hapësira të hapura publike zonë urbane dhe rurale.

3.5.1.1. Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet - Analiza SWOT

Tabela124 Analiza SWOT për infrastrukturën publik edhe sociale

Përparësitë	Dobësitë
▪ **1 institucion parashkollor publik;** ▪ **20 Shkolla Fillore dhe Mesme të ulëta;** ▪ **3 Shkolla të Mesme të larta;** ▪ **1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare;** ▪ **2 Qendra të Mjekësisë Familjare;** ▪ **3 Ambulanca funksionale të Mjekësisë Familjare;** ▪ **1 Ndërtesë e Kuvendit Komunal;** ▪ **1 Zyre të Gjendjes Civile;** ▪ **1 Qendër Kulturore;** ▪ **2 Shtëpi Kulturore;** ▪ **1 Teatër qyteti;** ▪ **1 Galeri e arteve;** ▪ **1 Bibliotekë Komunale dhe 3 nëndegë lokale;** ▪ **3 Qendra Rinore;** ▪ **7 Fusha publike sportive;** ▪ **1 Palestër Sportive;** ▪ **1 Fushë sportive;** ▪ **12 Klube sportive;** ▪ **2 Parqe publike;** ▪ **20 lokalitete të destinuara për varreza.**	▪ AMF-të në Shipitullë dhe Cërkvena Vodicë nuk janë funksionale ▪ Numri i pamjaftueshëm dhe shkalla e ulët e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollor; ▪ Hapësira e pamjaftueshme në disa prej shkollave të mesme të larta; ▪ Numri i vogël i studentëve të orientuar në drejtimet me rëndësi për zhvillimin e komunës, si turizëm dhe hotelieri, agrobiznes; ▪ Siguria pamjaftueshme e nxënësve në shkolla. ▪ Mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në disa fshatra; ▪ Degradimi i objekteve jofunksionale të disa AMF-ve; ▪ Degradimi i objekteve jofunksionale të AMF-ve; ▪ Mungesa e shtëpisë për të moshuar që plotëson nevojat aktuale; ▪ Hapësira e pamjaftueshme e QPS për shërbimet e kërkuara; ▪ Numri i madh i kërkesave në raport me numrin e përfituesve të asistencës; ▪ Mungesa e kodit të veçantë buxhetor për rastet sociale. ▪ Mungesa e objekteve kulturore sidomos nëpër fshatra. ▪ Mungesa e objekteve dhe terreneve sportive nëpër fshatra; ▪ Mungesa e hapësirave të mjaftueshme për varreza në qytet dhe në disa fshatra; ▪ Mungesa e hapësirave për Zyrat e Gjendjes Civile
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Ndërtimi i shkollave të reja, realizimi i mësimit gjithë ditor** ▪ **Ndërtimi i çerdheve/kopshteve të reja apo Sigurimi I hapësirave plotësuese në shkolla fillore** ▪ **Funksionalizimi i ekipeve për parandalimin e braktisjes së shkollës(EPRMB)** ▪ **Granti specifik nga MASHT për sigurimin e asistentëve profesional për fëmijët me nevoja të veçanta** ▪ **Zhvillimi profesional i mëtejmë i mësimdhënësve**	▪ Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla, ▪ Zvogëlimi i nxënësve në zonat rurale dhe rritja e numrit të nxënësve në zonën urbane; ▪ Ndërlidhja e pamjaftueshme të kurrikulave mësimore me kërkesat e tregut të punës; ▪ Mungesa e të rinjve të interesuar për t'u regjistruar në programet e përpunimit të metaleve dhe përpunimit të drurit;

DRAFT

▪ **Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore** ▪ **Ndërtimi i QKMF-së së re,** ▪ **Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe rehabilitimi i objekteve ekzistuese;** ▪ **Ndërtimi i kapaciteteve të reja për strehim social (Programi i banimit social).** ▪ **Krijimi i më shumë hapësirave të hapura publike.** ▪ **Shfrytëzimi i fushave sportive në kuadër të shkollave për përdorim nga komuniteti.** ▪ **Krijimi i hapësirave të reja për varreza.**	▪ Buxheti i kufizuar zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale. ▪ Kërcënimet ekonomike (kriza globale financiare) kostot në rritje të kujdesit shëndetësor ▪ Rritja e numrit të shfrytëzuesve të asistencës sociale për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik dhe rritjes së papunësisë; ▪ Rritja e numrit e të moshuarve në kategorinë e rasteve sociale. ▪ Mungesa e fondeve të nivelit qendror për të paguar punëtorë shtesë në institucionet publike dhe sociale. ▪ Mungesa e partneriteteve publiko private si alternative e qëndrueshme për aktivitete dhe infrastrukturë sportive, kulturë por edhe shkencë në komunë ▪ Mungesa e një qendre rinore - hapësire e funksionalizuar për zhvillimin e veprimit të të rinjve e licencuar nga drejtoria komunale përgjegjëse për rini ▪ Ndërrimi i strukturës së popullsisë, për shkak të ikjes së popullatës së re jashtë vendit.

Tabela 125. Analiza SWOT për infrastrukturën publike dhe sociale

3.5.2. Institucionet arsimore

Siç është përmendur tek infrastruktura sociale e komunës, planifikimi i objekteve të reja ndihmëse për shkolla dhe shërbime të tjera edukative, duhet të bazohen në një program, i cili duhet të përpunohet nga Drejtoria e Arsimit në komunë. Shkollat e mesme dhe fillore ekzistuese në qytet janë të stërmbushura nga numri i lartë i nxënësve, dhe shkollat e reja mund të jenë të domosdoshme. Përveç shkollave të reja në zgjerimin e zonave të reja të qytetit, mundësia për të ndërtuar shkolla tjera në zonat ekzistuese banuese duhet të provohet.

3.5.2.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të institucioneve arsimore

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor janë si në vijim:


- Ndërtesat e çerdheve: 0.30 m²/banor;
- Ndërtesat e kopshteve: 1.00 m²/banor.

NTPH kanë përcaktuar 1.30m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione parashkollore për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,608 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 24,318m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione parashkollore.

Komuna aktualisht ka vetëm 2,000m^2 parcelë kadastrale që shfrytëzohet për institucion parashkollor publik, kështu që Komuna **nuk plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione publike parashkollore për së paku -22,318m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	2,000	1.3	6,243	-4,243
Zonë rurale	13,904	0	1.3	18,075	-18,075
Gjithsejtë	18,706	2,000	1.3	24,318	-22,318

Tabela 126 Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike parashkollore sipas NTPH



Harta 49. Mbulueshmëria e territorit me institucione publike parashkollore sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH

Për vendbanime urbane NTPH kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për institucionet parashkollore, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore: ndërtesat e çerdheve: 300 m; dhe Ndërtesat e kopshteve: 500 m.

Për vendbanime rurale NTPH kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për institucionet parashkollore, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore, si vijon: Ndërtesat e çerdheve: 300 m; dhe Ndërtesat e kopshteve: 900 m.

Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë të institucioneve publike parashkollore vërehet një mungesë e lartë në pjesën veri-perëndimore, veri-lindore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të zonës urbane, si dhe në Mazgit dhe Milloshevë ku nuk ka asnjë institucion publik parashkollor.

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar janë: Ndërtesat e shkollave fillore: 1.60 m²/banor; Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 1.20 m²/banor; dhe Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: 1.00 m²/banor.


NTPH kanë përcaktuar 2.80m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezidentë atëherë, Komuna duhet të ketë së paku 52,377m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë. Komuna aktualisht ka 107,900m^2, kështu që komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe tejkalon atë për së paku +55,523m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	12,500	2.80	13,446	-946
Zonë rurale	13,904	95,400	2.80	38,931	+56,469
Gjithsejtë	18,706	107,900	2.80	52,377	+55,523

Tabela 127. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas NTPH

Për vendbanime urbane NTPH kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për institucionet publike shkollore fillore të mesme të ulëta, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore është 600 m në zonë urbane dhe 1,900 m në zonë rurale.

Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë të shkolla publike fillore dhe të mesme vërehet një mungesë e lartë në pjesën veri-lindore, jug-lindore, qendrore dhe jug-perëndimore të zonës urbane.



Harta 50 Mbulueshmëria e territorit me shkolla publike fillore dhe të mesme të ulëta sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 1.0m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione të arsimit të mesëm të lartë për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 18,706m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione të arsimit të mesëm të lartë. Komuna aktualisht ka 20,370m^2, kështu që Komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	14,000	1	4,802	+9,198
Zonë rurale	13,904	6,370	1	13,904	-7,534
Gjithsejtë	18,706	20,370	1	18,706	+1,664

Tabela 128. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë sipas NTPH

NTPH kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për institucionet publike shkollore mesme të larta, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore është: 1,500 m në zonë urbane; dhe 4,700 m në zonë rurale. Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë të shkolla publike të mesme të larta vërehet një mungesë e lartë.

3.5.2.2. Nevojat hapësinore për institucione arsimore për 8 vitet e ardhme

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, normat minimale për sipërfaqen e parcelës të NTPH dhe numrin e prognozuar të banorëve rezidentë për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezident, Komuna nevojitet të përcaktoj sipërfaqe të parcelave shtesë për institucione parashkollore publike prej së paku 25,600m^2.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	2,000	1.3	6,785	-4,785
Zonë rurale	14,473	0	1.3	18,815	-18,815
Gjithsejtë	19,692	0	1.3	25,600	-25,600

Tabela 129. Kërkesat hapësinore për institucione parashkollore publike sipas NTPH për vitin 2030

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, normat minimale për sipërfaqen e parcelës të NTPH dhe numrin e prognozuar të banorëve rezidentë për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezident, komuna ka plotësuar kërkesat hapësinore për shkolla fillore dhe të mesme të ulëta publike dhe ka tejkaluar ato për +52,762m^2, kështu që komuna nuk ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	12,500	2.8	14,613	-2,113
Zonë rurale	14,473	95,400	2.8	40,524	+54,876
Gjithsejtë	19,692	107,900	2.8	55,138	+52,762

Tabela 130. Kërkesat hapësinore për Shkolla Fillore dhe të Mesme të Ulëta publike sipas NTPH për vitin 2030

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, normat minimale për sipërfaqen e parcelës të NTPH dhe numrin e prognozuar të banorëve rezidentë për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezident, Komuna nuk ka nevojë për sipërfaqe shtesë për shkolla mesme të larta publike, edhe atë një sipërfaqe prej 9,992 m^2.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	14,000	1	5,219	8,781
Zonë rurale	14,473	6,370	1	14,473	-8,103
Gjithsejtë	19,692	20,370	1	19,692	678

Tabela 131. Kërkesat hapësinore për shkolla të mesme të larta sipas NTPH për vitin 2030

3.5.3. Institucionet shëndetësore

Kujdesi shëndetësor në qytet është i përbërë nga një numër i qendrave për kujdesin shëndetësor. Meqenëse popullsia është rritur ne mënyrë thelbësore ne vitet e fundit, dhe do të vazhdojë të rritet, edhe nevoja për kujdesin shëndetësor është shtuar. Nevoja për të ndërtuar ambulanca të reja dhe qendra të kujdesit shëndetësor familjar në qytet, duhet të përcaktohet nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2022 institucionet shëndetësore kanë ofruar gjithsejtë 234,961 shërbime mjekësore, respektivisht: 98,149 kontrolle mjekësore, dhe 136,812 shërbime mjekësore.

Raste të reja me sëmundje malinje	Sëmundjet respiratore	Sëmundjet Kardiovaskulare	Kontrolle Pediatrike	Kontrolle Gjinekologjike	RTG	Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare
29	6,054	7,07	11,804	676	4,443	344

Tabela 132. Numri i shërbimeve mjekësore të ofruara gjatë vitit 2022

Në Komunë janë gjithsejtë 10 institucione për shërbime shëndetësore, të cilat shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1,230m^2, mirëpo vetëm 7 prej tyre janë funksionale.

	AMF	QMF	QKMF	Gjithsejtë
Numri i institucioneve	7	2	1	10
Sipërfaqja (m^2)	410	210	610	1,230

Tabela 133. Numri i shërbimeve mjekësore të ofruara gjatë vitit 2022

3.5.3.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të institucioneve shëndetësore


Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor janë 0.20 m^2/banor.

NTPH kanë përcaktuar 0.20m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione shëndetësore për kokë banori. Duke marrë parasysh që në komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezident, atëherë komuna duhet të ketë së paku 3,741m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuara për institucione shëndetësore.


Komuna aktualisht ka gjithsejtë 12,200m^2 parcela kadastrale kështu që Komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuara për institucione shëndetësore dhe tejkalon atë për së paku +8,459m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	6,000	0.2	960	+5,040
Zonë rurale	13,904	6,200	0.2	2,781	+3,419
Gjithsejtë	18,706	12,200	0.2	3,741	+8,459

Tabela 134. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione shëndetësore sipas NTPH



Harta 51. Mbulueshmëria e territorit me qendra të mjekësisë familjare sipas rrezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH



Harta 52. Mbulueshmëria e territorit me e punkteve të mjekësisë familjare sipas rezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH

Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë të qendrave të mjekësisë familjare, territori i komunës është mjaftueshëm i mbuluar me këto institucione të kujdesit parësor shëndetësor. NTPH kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore është 10 km.

Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë të punkteve të mjekësisë familjare, territori, zonat rurale, janë mjaftueshëm të mbuluara me ndërtesa të kujdesit parësor shëndetësor.

3.5.3.2. Nevojat hapësinore për institucione shëndetësore për 8 vitet e ardhme

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 1,230m^2 dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2030 prej gjithsejtë 19,692 banorë rezident, rezulton që Komuna ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas NTPH për infrastrukturë të institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësorë, dhe ka tejkaluar atë për +8,262m^2.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	6,000	0.2	1,044	+4,956
Zonë rurale	14,473	6,200	0.2	2,895	+3,305
Gjithsejtë	19,692	12,200	0.2	3,938	+8,262

Tabela 135. Vlerësimi i nevojës për sipërfaqe të parcelave kadastrale për institucione publike shëndetësore sipas NTPH për vitin 2030

3.5.4. Institucionet e administratës publike

3.5.4.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të institucioneve të administratës publike

Normat minimale të parcelës së infrastrukturës së institucioneve administrative janë 0.62 m^2/banor.

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 0.62m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione të administratës publike për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 11,598m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione të administratës publike.

Komuna aktualisht ka vetëm 4,500m^2, kështu që Komuna **nuk plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione të administratës publike për së paku 7,098m^2.

	Banorë aktual	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	4,000	0.62	2,977	1,023
Zonë rurale	13,904	500	0.62	8,620	-8,120
Gjithsejtë	18,706	4,500	0.62	11,598	-7,098

Tabela 136. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të administratës publike sipas NTPH

3.5.4.2. Nevojat hapësinore për institucionet e administratës publike për 8 vitet e ardhme

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 4,500m^2 dhe numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezidentë, rezulton që për të përmbushur kërkesat minimale hapësinore sipas NTPH, komuna duhet të përcaktojë sipërfaqe të parcelave kadastrale prej së paku 7,709m^2 të destinuara për institucionet e administratës publike.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	4,000	0.62	3,236	764
Zonë rurale	14,473	500	0.62	8,973	-8,473
Gjithsejtë	19,692	4,500	0.62	12,209	-7,709

Tabela 137. Kërkesat hapësinore për institucionet e administratës publike sipas NTPH për vitin 2030

3.5.5. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

3.5.5.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mirëqenies sociale dhe komunitetit

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit janë: Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare prej 0.25 m^2/banor; dhe Ndërtesat e institucioneve të komunitetit prej 0.20 m^2/banor.

NTPH kanë përcaktuar 0.45m^2 sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezident. atëherë Komuna duhet të ketë së paku 8,418m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit.

Komuna aktualisht ka vetëm 2,300m^2, kështu që komuna **nuk plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit për së paku 6,118m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	2,000	0.45	2,161	-161
Zonë rurale	13,904	300	0.45	6,257	-5,957
Gjithsejtë	18,706	2,300	0.45	8,418	-6,118

Tabela 138. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit sipas NTPH

3.5.5.2. Nevojat hapësinore për institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit për 8 vitet e ardhme

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 4,500m^2 dhe numri e prognozuar të banorëve për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezident, rezulton që për të përmbushur kërkesat minimale hapësinore sipas NTPH, komuna duhet të përcaktojë sipërfaqe të parcelave kadastrale prej së paku 6,561m^2 të destinuara për institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	2,000	0.45	2,349	-349
Zonë rurale	14,473	300	0.45	6,513	-6,213
Gjithsejtë	19,692	2,300	0.45	8,861	-6,561

Tabela 139. Kërkesat hapësinore për institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit sipas NTPH për vitin 2030

3.5.6. Institucionet kulturore

3.5.6.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të institucioneve kulturore

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës të infrastrukturës së kulturës janë si në vijim: Ndërtesat e bibliotekave - 0.25 m^2/banor; Ndërtesat e teatrove -0.20 m^2/banor; dhe Ndërtesat e kinemave - 0.20 m^2/banor.

NTPH kanë përcaktuar destinimin minimal prej 0.25m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione kulturore - bibliotekë publike për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezident, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 8,418m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione kulturore - bibliotekë publike. Komuna është në proces e sipër të ndërtimit të Bibliotekës në qytet të Obiliqit dhe **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione kulturore dhe tejkalon atë për së paku 26,150m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	7,378	0.45	2,161	5,217
Zonë rurale	13,904	27,190	0.45	6,257	20,933
Gjithsejtë	18,706	34,568	0.45	8,418	26,150

Tabela 140. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione kulturore - bibliotekë publike sipas NTPH

3.5.6.2. Nevojat hapësinore për institucionet e institucioneve kulturore për 8 vitet e ardhme

Bazuar në numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2030 prej 19,692 banorë rezident, rezulton që për të përmbushur kërkesat minimale hapësinore sipas NTPH, Komuna nuk ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për institucione publike kulturore.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	7,378	0.45	2,349	+5,029
Zonë rurale	14,473	27,190	0.45	6,513	+20,677
Gjithsejtë	19,692	34,568	0.45	8,861	+25,707

Tabela 141. Kërkesat hapësinore për institucione kulturore sipas NTPH për vitin 2030

3.5.7. Institucionet sportive, rekreative

3.5.7.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të institucioneve sportive dhe fushave rekreative

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës se institucioneve sportive dhe fushave rekreative janë si në vijim:

1. Numri i banorëve në vendbanim:

1.1. ≤ 5000 banor: 2.50 m^2/banor;

1.2. ≥ 5001- 20,000 banor: 4.50 m^2/banor;

1.3. > 20,001 banor: 5.00 m^2/banor.

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, normat minimale për sipërfaqen e parcelës të NTPH dhe numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2030, Komuna do të ketë:

- 1 vendbanim me 5,001 – 20,000 banorë; dhe
- 19 vendbanime nën 5,000 banorë.


NTPH kanë përcaktuar destinimin minimal prej 2.50m^2 – 5.00m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione sportive dhe fushave rekreative publike për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 56,369m^2 sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për institucione sportive dhe fushave rekreative.

Komuna **nuk plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për institucione sportive dhe fushave rekreative për së paku 32,519m^2.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	4,802	21,050	4.5	21,609	-559
Zonë rurale	13,904	2,800	2.5	34,760	-31,960
Gjithsejtë	18,706	23,850	2.5 - 5.0	56,369	-32,519

Tabela 142. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione sportive dhe fushave rekreative publike sipas NTPH

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar distancën optimale shërbyese për institucionet sportive dhe fushave rekreative, respektivisht rrezen optimale shërbyese në vijë ajrore është 800 m.



Harta 53. Mbulueshmëria e territorit me institucione sportive dhe fushave rekreative sipas rezeve optimale të mbulueshmërisë të NTPH

Sa i përket vlerësimit të rrezes së mbulueshmërisë sportive dhe fushave rekreative vërehet një mungesë e lartë në pjesën veriore dhe jugore të zonës urbane, si dhe në shumicën e vendbanimeve rurale.

3.5.7.2. Nevojat hapësinore për institucionet sportive dhe fushave rekreative për 8 vitet e ardhme

Për Obiliqin, vendbanim me 5,001 – 20,000 banorë, komuna nevojitet të përcaktojë sipërfaqe shtesë për infrastrukturës se institucioneve sportive dhe fushave rekreative prej 2,436m^2, gjersa në vendbanimet me më pak se 5,000 banorë, komuna nevojitet të përcaktojë sipërfaqe shtesë për infrastrukturë të institucioneve sportive dhe fushave rekreative prej 33,383.

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
Zonë urbane	5,219	21,050	4.5	23,486	-2,436
Zonë rurale	14,473	2,800	2.5	36,183	-33,383
Gjithsejtë	19,692	23,850	2.5 - 5.0	59,668	-35,819

Tabela 143. Kërkesat hapësinore për infrastrukturës se institucioneve sportive dhe fushave rekreative sipas NTPH për vitin 2030

3.5.7.3. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të hapësira të hapura publike

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave te gjelbra janë si në vijim: Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor. Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 2.00m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18,706 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 37,412m² sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike. Komuna aktualisht ka 47,564m², kështu që Komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike.

	Numri i banorëve aktual rezident	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²)
Urbane	4,802	26,096	2.0	9,604	16,492
Rurale	13,904	21,468	2.0	27,808	-6,340
Gjithsejtë	18,706	47,564	2.0	37,412	10,152

Tabela 144. Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas kërkesave hapësinore për hapësira të hapura publike sipas NTPH

3.5.7.4. Nevojat hapësinore për hapësira të hapura publike për 8 vitet e ardhme

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 2.00m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike për kokë banori. Duke marrë parasysh që në vitin 2030, në Komunë parashihet të banojnë 19,692 banorë rezidentë, atëherë Komuna duhet të ketë së paku 39,384m² sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike. Komuna aktualisht ka vetëm 47,564m², kështu që Komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për hapësira të hapura publike, ndonëse në zonën

	Numri i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²)
Zonë urbane	5,219	26,096	2.0	10,438	15,658
Zonë rurale	14,473	21,468	2.0	28,946	-7,478
Gjithsejtë	19,692	47,564	2.0	39,384	8,180

Tabela 145. Kërkesat hapësinore për infrastrukturës së hapësirave të hapura publike sipas NTPH për vitin 2030

3.5.8. Varrezat

3.5.8.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të varrezave

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave për varreza janë si në vijim: Varreza: 1.50 m²/banor. NTPH kanë përcaktuar 1.50m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për varreza për kokë banori. Duke marrë parasysh që në Komunë aktualisht banojnë 18, 608 banorë atëherë Komuna duhet të ketë së paku 27, 912m² sipërfaqe për parcela kadastrale të destinuar për varreza. Komuna aktualisht ka 159,800m², kështu që Komuna **plotëson** kriterin minimal të përcaktuar për sipërfaqe të parcelave kadastrale të destinuar për varreza dhe tejkalon atë për së paku 126,418m².

3.5.9. Sfidave, gjetje kyçe, dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

3.5.9.1. Sfidat kryesore të infrastrukturës publike dhe sociale

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës sociale janë identifikuar sfidat vijuese:

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në zonat malore (turistike);
- Mirëmbajtja e standardit të shërbimeve në objektet shëndetësore;
- Shkalla e ulët e përfshirjes së fëmijëve ne edukimin parashkollor;
- Ndërlidhje jo e volitshme e Arsimit për Aftësimin Profesional me kërkesat e tregut të punës;
- Mungesa e kushteve për kryerjen e punës praktike nëpër shkolla (punëtoritë, laboratorët, rrjeti i teknologjisë informative);
- Buxheti i kufizuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore.
- Sigurimi i hapësirave / kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale;
- Grumbullimi i objekteve administrative ne një vend,
- Akomodimi i kërkesave për strehim për persona të riatdhesuar;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për asistencë sociale;

DRAFT

- Ofrimi i politikave lokale për programe të banimit social të integruar;
- Zbutja e varfërisë dhe papunësisë;
- Ndërtimi i objekteve të reja të kulturës, artit, sportit e rekreacionit dhe përmirësimi i qasjes në këto objekte për të gjithë banorët e komunës së Obiliqit;
- Mirëmbajtja adekuate e objekteve të artit, sportit, kulturës, rekreacionit, komunitetit në nën qendra;
- Sigurimi i hapësirave të reja publike për hapësirën urbane dhe hapësirat periferike urbane dhe standardizimi i mirëmbajtjes;
- Mirëmbajtja e objekteve fetare dhe objekteve përcjellëse;

3.5.10. Gjetje kyçe dhe supozime të pranuara

Sa përket zhvillimeve hapësinore dhe vlerësimit te tyre me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor duke u bazuar në numrin e prognozuar prej 19,692 banorëve rezident për vitin 2030, rezulton se Komuna aktualisht ka mungesë të sipërfaqeve për zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale si vijon:

- Ka sipërfaqe të mjaftueshme të destinuar për SHML;
- Ka sipërfaqe të mjaftueshme të destinuar për institucione te kujdesit parësor shëndetësor, ndonëse dy AMF nuk janë funksionale;
- Ka sipërfaqe të mjaftueshme të destinuar për varreza;
- Mungojnë 25,600 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e institucioneve parashkollore;
- Mungojnë 2,113 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e institucioneve SHFMU në zonë urbane;
- Mungojnë 6,561 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e institucioneve të mirëqenies sociale;
- Mungojnë 8,180 m^2 sipërfaqe të destinuara për hapësira të hapura publike;
- Mungojnë 35,819 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e hapësirave sportive dhe rekreative;
- Mungojnë 7,709 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e administratës publike komunale; dhe
- Mungojnë 25,707 m^2 sipërfaqe të destinuara për zhvillimin e hapësirave kulturore.

3.5.11. Identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

Sa i përket nevojave hapësinore të Komunës për ofrimin e infrastrukturës publike dhe sociale, bazuar në numrin e parashikuar të banorëve, janë identifikuar problemet dhe konstatimet kryesore vijuese:

- Ka mungesë të institucioneve parashkollore në pjesën veri-perëndimore, veri-lindore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të zonës urbane, si dhe në Mazgit dhe Milloshevë ku nuk ka asnjë institucion publik parashkollor;
- Ka mungesë Shkollave Fillore dhe të Mesme të Ulëta të në pjesën veri-lindore, jug-lindore, qendrore dhe jug-perëndimore të zonës urbane;
- Ka mungesë të Shkollave të Mesme të Larta në pjesën veriore, jugore të zonës urbane;
- Kujdesi parësor shëndetësor ka shtrirje të mirë në Komunë;
- Ka mungesë të administratës publike komunale në zonë rurale;
- Ka mungesë të bibliotekës publike;
- Ka mungesë të hapësirave sportive/rekreative, në pjesën veriore dhe jugore të zonës urbane, si dhe në shumicën e vendbanimeve rurale;
- Ka mungesë të konsiderueshme të sipërfaqes së destinuar për hapësirave të hapura publike në zonë rurale;

3.6. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

3.6.1. Mjedisi

Pasi që siç dihet se me Ligjin për Obiliqin nr. 05/L-044 në nenin 4, Komuna e Obiliqit shpallet si zonë me status të veçantë mjedisor në Republikën e Kosovës. Me këtë Ligj Komuna e Obiliqit cilësohet si zonë me rrezik të veçantë mjedisor, si pasojë e ndotjes së vazhdueshme të ajrit, tokës dhe ujit si dhe degradim të kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe shëndetit të njeriut. Po ashtu, me këtë ligj është caktuar një zonë e rrezikuar mjedisor e cila ka rreze 5000 metra nga pika mes dy termocentraleve. Bazuar nga të dhënat dhe nga analiza e bërë del se Komuna e Obiliqit është njëra ndër komunat me mjedis më të ndotur në Kosovë. Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" si dhe burimet e tjera si deponia e hirit, deponitë e mbeturinave në Mirash etj.

Nga analiza e gjendjes në komunën e Obiliqit të bërë nga grupet punuese sa i përket Mjedisit, u konstatua se mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm problematikë ekologjike ose teknologjike, por problematikë më e thellë dhe më e gjerë që shkon drejtë dimensionit social, e madje edhe politik. Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e

DRAFT

Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i imitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit.



Foto: Komuna e Obiliqit

3.6.2. Ndotja e Ajrit


Normativat e cilësisë se ajrit në Kosovë janë të rregulluara me Udhëzimin administrative për Vlerat Kufitare- Normat e cilësisë së Ajrit, Nr.02/2011 dhe Direktivën 2008/50/EC për Cilësinë e ajrit mjedisor dhe ajrit të pastër për Evropë. Bazuar në Ligjin për Obiliqin nr. 05/L-044 në nenin 4. Zonat me ndotje më të madhe të ajrit në komunë janë në rreze prej 5 km nga pika mes dy termocentraleve dhe përfshinë këto vendbanime: Kryshefc, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Shipitull Grabofc i Epërm, Cërkvena Vodicë, Dobrosellë dhe Lajthishtë. Procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga termoelektranat përcillet me emision të pluhurit dhe gazrave siç janë: SO_2, NOX, CO, CO_2, H_2S, bloza, thërrmijat ajrore sendimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj).

Ndotësi	2019	2020	2021	2022
PM 2.5 (µg/m3)	44.37	32.01	25.1	**21.43**
PM 10 (µg/m3)	51.21	43.17	35.3	**29.83**
CO (Monoksidi i Karbonit)	0.77	0.97	1.1	**1.55**
SO2 (Dyoksidi i Sulfurit)	31.95	63.82	10.3	**14.62**

Tabela 146. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Obiliq 2019 – 2022

Bazuar në matjet 4-vjeçare 2019 – 2022 të ndotëseve të ajrit në Obiliq vërehet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ajrit përmes rënies së pranisë së grimcave ndotësve prej -107.05% të PM 2.5 (µg/m3), -71.67% të PM 10 (µg/m3) dhe -118.54% të SO2 (Dyoksidi I Sulfurit).

E vetmja substancë ndotëse që ka shtim në matjet 4-vjeçare është CO (Monoksidi I Karbonit) që ka shënuar rritje prej 50.32%.




Grafiku 7 Trendi i pranisë së substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Obiliq 2017 – 2020

Ndotësi	2017	2018	2019	2020
PM 2.5 (µg/m3)	44.37	32.01	25.1	**21.43**
PM 10 (µg/m3)	51.21	43.17	35.3	**29.83**
CO (Monoksidi i Karbonit)	0.77	0.97	1.1	**1.55**
SO2 (Dyoksidi i Sulfurit)	31.95	63.82	10.3	**14.62**

Tabela 147. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Dardhishtë 2017 – 2020

Bazuar në matjet 4-vjeçare 2017 – 2020 të ndotëseve të ajrit në Dardhishtë vërehet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ajrit përmes rënies së pranisë së grimcave ndotësve prej -97.05% të PM 2.5 (µg/m3), -69.79% të PM 10 (µg/m3) -5.42% të SO2 (Dyoksidi I Sulfurit) dhe -5.42% të CO (Monoksidi I Karbonit).




Grafiku 8 Trendi i pranisë së substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Dardhishtë 2017 – 2020


Ndotësi	2017	2018	2019	2020
PM 2.5 (µg/m3)	44.37	32.01	25.1	**21.43**
PM 10 (µg/m3)	51.21	43.17	35.3	**29.83**
CO (Monoksidi i Karbonit)	0.77	0.97	1.1	**1.55**
SO2 (Dyoksidi i Sulfurit)	31.95	63.82	10.3	**14.62**

Tabela 148. Matjet e substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Palaj 2017 – 2020

Bazuar në matjet 4-vjeçare 2017 – 2020 të ndotëseve të ajrit në Dardhishtë vërehet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ajrit përmes rënies së pranisë së grimcave ndotësve prej -72.88% të PM 2.5 (µg/m3), -69.96% të PM 10 (µg/m3) -640% të SO2 (Dyoksidi I Sulfurit) dhe -96.62% të CO (Monoksidi I Karbonit).



Grafiku 9 Trendi i së pranisë substancave ndotëse të ajrit në njësitë matëse në Palaj 2017 – 2020



Janë deponuar në mënyrën më të lehtë dhe më të lirë, pa i kushtuar vëmendje në shqetësimet mjedisore. Vetëm kohëve të fundit hiri nga "Kosova B" është transportuar në mënyrë hidraulike në minierën pasive e shterur të Mirashit lindor. Siç u tha më herët, dy lokacionet e deponimit për zgjyrën dhe hirin fluturues janë përdorur jashtë normativave, pranë lokacionit të "Kosovës A dhe

B" ku grumbujt e formuar nga hiri krijojnë një element shumë irritues dominues në aspektin vizual në peizazh. Deponitë e hirit tejkalojnë vëllimin e synuar fillestar, duke përcaktuar edhe probleme të stabilitetit në të dy deponitë. Lartësia e dizajnuar maksimale e deponisë për TC B ishte 15 metra, por sot lartësia e deponisë është mbi 70 metra. Zonat e okupuara me deponi të hirit janë afro 240 hektarë për TC A (përfshirë djerrinën) dhe 74 ha për TC B.

Gjatë procesit të djegies së qymyrit përveç imitimit të ndotësve të njohur si pluhur fluturues, thërrmija të pluhurit, SO_2, NOx, blozë etj., ato emitojnë edhe grimca organike kancerogjene (hidrokarburet policiklike), grimca të metaleve të rënda (merkur, plumb, arsen etj.).

Burimet e ndotjes së ajrit në territorin e Komunës janë:

- Ndotja e ajrit nga aktivitetet minerare dhe minierat e qymyrit (linjitit);
- Ndotja e ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në TC-A dhe TC-B;
- Ndotja e ajrit nga deponimi i hirit dhe;
- Ndotja e ajrit nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse.




Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Obiliq

Problemet në aspektin e ndotjes së ajrit në Komunën e Obiliqit


- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO_2 dhe NOx, nga termocentralet ekzistuese, aktivitetet minerare dhe deponitë e hirit, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet mjedisore që dalin nga Direktiva e BE-së për impiante me djegie të mëdha (LCPD 2001/80/EC).
- Lirimi i gazrave serrë nga deponia rajonale e Prishtinës në Mirash.
- Të dhënat nga monitorimi i kualitetit të ajrit janë të kufizuara ,
- Cilësia e rrugëve dhe problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet.

Pika Matëse Grabofc	2017	2018	2019	2020
Vlera E pH (mg) l	-	8.1	7.89	**8.12**
Nitritet, (mg) l	-	0.003	0.007	**0.062**
Nitratet (mg) l	-	1.2	0.3	**1.6**
Hekuri (mg) l	-	45.8	0.02	**0.2**
Fenolet (mg) l	-	0.001	0.001	**0.002**

Tabela 149. Matjet e substancave ndotëse të lumit Drenica në njësinë matëse në Grabofc 2017 – 2020

Bazuar në matjet 4-vjeçare 2017 – 2020 të ndotëseve të lumit Drenica në Grabofc vërehet një përkeqësim i dukshëm i cilësisë së ujit përmes rritjes së pranisë ndotësve prej +89.35% Nitritet (mg) l, +28.57% Hekuri (mg) l dhe +78.57% Fenole (mg) l

I vetmi ndotës që shënon rënie të dukshme janë -1.88% Vlera E pH (mg) l, dhe -55.56% Nitrate (mg) l.




Grafiku 10 Trendi i pranisë së substancave ndotëse të limit Drenica në njësitë matëse në Grabofc2017 – 2020

Pika Matëse Obiliq	2017	2018	2019	2020
Vlera E pH (mg) l	7.91	8.66	7.88	**8.5**
Nitritet, (mg) l	0.4	0.098	0.112	**0.92**
Nitratet (mg) l	0.038	2.8	5.4	**1.8**
Hekuri (mg) l	-	0.1	0.06	**0.14**
Fenolet (mg) l	-	0.003	0.008	**0.014**

Tabela 150. Matjet e substancave ndotëse të lumit Sitnica në njësinë matëse në Obiliq 2017 – 2020

Bazuar në matjet 4-vjeçare 2017 – 2020 të ndotëseve të lumit Sitnica në njësinë Obiliq në vërehet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ujit përmes rritjes së pranisë ndotësve prej +0.25% Vlera E pH (mg)l, +95.16% Nitrite (mg)l, +25.00%% të Nitrate (mg)l, +50% të fenol.

I vetmi ndotës që shënon rënie të dukshme është Hekuri me -22800.00% (mg)l.



Grafiku 11 Trendi i pranisë së substancave ndotëse të lumit Drenica në njësinë matëse në Obiliq 2017 – 2020

Për minimizimin e ndotjes së ajrit si një nga komponentët kryesore të mjedisit duhet të merren këto masa në të ardhmen në komunën e Obiliqit:

Duke u bazuar në masat që dalin nga Ligji për zonën e rrezikuar mjedisore si dhe ligjet tjera të cilat e rregullojnë këtë fushë, masat do të jenë:

1. Zvogëlimin e emetimit të pluhurit dhe elementeve tjera ndotëse brenda standardeve të lejuara mjedisore;
2. Reduktimin në vazhdimësi të ndotjes së ajrit nga vetë djegia e thëngjillit nëpër minierat dhe grumbujt e thëngjillit;
3. Planifikimin dhe realizimin e mbylljes së gropave dhe të rikultivimit në mihjet sipërfaqësore;
4. Krijimi i rripit të sigurisë nga ana e operatorëve ndotës;
5. Trajtimi i grumbujve të hirit në përputhje të plotë me nevojat e eksploatimit të të njëjtëve, duke e balancuar edhe me interesin shoqëror, ashtu siç përcaktohet edhe me Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Republikës së Kosovës.

6. Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër (Mbjellja e bimëve drunore me kurorë të lartë të ndryshme), me kapacitete për absorbim të gazrave azotike, të sulfurit, gazrave karbonike, metaleve të rënda, dhe gazrat qe lëshohen nga Korporata Energjetike e Kosovës.

7. Rivitalizimin e parqeve ekzistuese mbjellja e drunjëve me kurorë të lartë dhe ngritja e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si të lira, dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve, po ashtu mbjellja e zonave të zhveshura me drunjë.

8. Në mënyrë të përkohshme mbjellja e deponive të hirit me bimë barishtore të cilat janë të përshtatshme dhe stabile për ato substrate, për eliminimin e erozionit nga erërat.

9. Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për absorbim të gazrave dhe aerosolëve të ndryshme.

10. Përcaktimin e kritereve për sipërfaqet e gjelbërta të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Obiliqit.

11. Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë.

12. Vendosja e filtrave për pengimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Termocentrali Kosova A dhe Kosova B dhe makinat lëvizëse, me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve të tjera në aspektin teknik.

13. Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit dhe energjia gjeotermale).


14. Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër termocentraleve, shiritave bartës, afër shkollave, etj.)

3.6.3. Ndotja e Ujit

Nga analiza e gjendjes në Komunë e Obiliqit e bërë nga të dhënat dhe grupet punuese, sa i përket cilësisë, resurseve dhe burimeve ujore, është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Territorin e Komunës së Obiliqit e përshkojnë ujërat e lumenjve Sitnica, Llapi dhe Drenica. Shkalla e ndotjes së lumenjve në komunën e Obiliqit është e lartë e sidomos e lumit Sitnica si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industrialë. Shkalla më e lartë e ndotjes së lumenjve të Kosovës është ajo e lumit Sitnica që tejkalon vlerat maksimale dhe bën pjesë në shkallën e IV të ndotjes. Nga proceset teknologjike lirohen: nitratet, nitritet, kloruret, amoniaku, vlera e lartë e PH, fenole etj. Shkallën e ndotjes e rritë edhe shkarkimi i ujërave të zeza që përcillen nga komunat tjera si e Prishtinës, Fushë Kosovës, Lipjanit, Drenasit, Obiliqit si dhe vendbanimeve rurale që shtrihen përgjatë shtratit të lumit Sitnica.

Ujërat e ndotura industriale paraqesin një prej ndotësve të mëdhenj të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimet kryesore të ndotjes janë: ujërat e kontaminuar nga minierat e thëngjillit. Ujërat e shkarkuara nga "T.C. Kosova (A dhe B)" përfshijnë drenazhimi i ujërave nga deponit e hirit. Ujërat e minierave të Bardhit dhe Mirashit kanë origjinë nëntokësore dhe sipërfaqësore meqë eksploatimi i linjitit bëhet nën nivelin e lumenjve "Drenica" dhe "Sitnica". Ujërat e shiut të grumbulluara në sistemet e drenazhit grumbullohen në miniera. Nuk ka pellgje për ujërat teknologjike nga minierat, por uji pompohet jashtë dhe shkarkohet në lumenjtë më të afërt. Komuna e Obiliqit ka nevojë për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave trajtimin e ujërave të zeza gjë që do të zvogëlonte shkallen e ndotjes në lumenjtë që kalojnë në Obiliq sepse ujërat e ndotura do të trajtoheshin në impiant dhe do të përmirësohej cilësia e ujit të lumenjve.

Sistemet e shkarkimit përfshijnë 22 pika shkarkimi në sistemin kryesor të kanalizimit dhe 3 pikat kryesore të shkarkimit në lumin "Sitnica".





Ndotja e lumenjve

Çdo banor shkarkon 16.46m³ ujëra të zeza. Shkarkimi i ujërave të zeza vetëm në qytezën e Obiliqit është 87238 m³/në vit ose rreth 3 l/s. Shumica e banorëve të qytezës së Kastriotit kanë qasje në kanalizimin e ujërave fekale.

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Përqindja %
Ndjeshmëri shumë e ulët e ujërave nëntokësorë	937.02	8.98%
Ndjeshmëri e ulët e ujërave nëntokësorë	128.14	1.23%
Ndjeshmëri e mesme e ujërave nëntokësore	6310.3	60.46%
Ndjeshmëri e lartë e ujërave nëntokësorë	208.28	2.00%
Ndjeshmëri shumë e lartë e ujërave nëntokësorë	2853.49	27.34%

Tabela 151. Ujërat nëntokësore sipas shkallës së ndjeshmërisë



Harta 54 Rreziku nga ndotja e ujërave nëntokësor

Duke marrë parasysh se PZHK-ja është dokument strategjik, është analizuar dhe është marrë për bazë Planin Hapësinor i Kosovës dhe pikat rajonale për trajtimin e ujërave të ndotura. Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturinat (të gjitha tipet e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara, dhe të cilat kanë marrë parasysh këtë faktor.


3.6.4. Ndotja e Tokës

Toka në këtë komunë është në shkallë të lartë të degradimit nga mihjet për eksploatimin e linjitit, nga deponitë e hirit dhe nga ndërtimet e "egra" në tokat më pjellore me komasacion. Deponive të hirit si problem kryesor në nxënie të tokës dhe degradim të saj kryesisht shtrihen në vendbanimet Kryshefc, kurse tjetra në Plemetin me sipërfaqe rreth 300 ha, mirëpo deponi të tilla gjenden edhe në: Hamidi, Mirash, Obiliq i Vjetër, Cërkvena Vodicë prandaj sipërfaqja e tërësishme e tokës së degraduar nga deponitë e hirit (termocentralet dhe mihjet sipërfaqësore) arrin rreth 500 ha. Nga mihja sipërfaqësore e Mirashit, ndotja e mjedisit vije kryesisht nga djegia e brendshme e thëngjillit, kështu që lirohen gazra kimikë të cilët kanë qenë në përbërje të thëngjillit.

Toka konsiderohet si një burim thelbësor dhe kryesisht jo i rinovueshëm, bazuar në analizën e grupeve punuese dhe gjerësinë e dijes dhe të kuptuarit e sistemeve të tokës dhe rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të kishte efekte shkatërruese në jetën tonë. Bujqësia dhe pylltaria dhe një varg aktivitetesh, janë të varura nga toka dhe këto do të kërcënoheshin, e deri te furnizimi me ujë dhe lëndë ushqyese për rritjen e bimëve dhe përkrahjen fizike të bimëve dhe të gjallesave tjera: një varg funksionesh e lidhjesh me ruajtjen e ekosistemeve. Për shkak të kësaj game të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenta e tokës nuk është konsideruar si e izoluar, andaj në fazën

e analizës iu është kushtuar rëndësi e veçantë. Për këtë arsye, parashihet: mbrojtje fizike dhe cilësore e tokës. Përpos mbrojtjes së ajrit dhe të ujit, parashohim edhe futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për të siguruar "Lidhjen e humbur" në mbrojtjen e mjedisit edhe në komunën Obiliqit.

Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqja	(%)
Zona me potenciale bujqësore	6852 ha	65.4
Zona me pyje	1153 ha	11
Zona e banimit/vendbanimet	833 ha	8
Prona ujore	96 ha	0.9
Prona rrugore	247 ha	2.4
Zona e minierave në shfrytëzim	838 ha	8
Deponitë e hirit nga "Kosova A dhe B"	272 ha	2.5
Zona industriale-"TC Kosova A dhe B"	191 ha	1.82
Gjithsejtë:	10482 ha	100



Harta 55 Ndjeshmëria mjedisore e tokës

Ekziston ndotje e dheut në zonën e ish-objekteve industriale energjetike, në lokacionin në afërsi të "TC Kosova A", depozitimi i mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike dhe blozës).

Komuna e Obiliqit deponinë e hirit të "TC Kosova A", si dhe punimeve të vjetra minerare nëntokësore. Këto kontaminime të hershme i janë nënshtruar një programi të gjerë të hulumtimit brenda Projektit të Pastrimit dhe Ri-Kultivimit të Tokës (CLRP/PPRT), i cili, mes tjerash, synon të identifikojë kontaminimet dhe të sigurojë kufizimin e rreziqeve të afërta dhe sanimin eventual të tyre. Burimet kryesore potenciale të identifikuara të kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësore janë:

- Derdhjet e substancave vajore dhe materieve tjera kimike, veçanërisht në lokacionet e stabilimenteve të mëhershme të gazifikimit, dhe azotikut;
- Shirat acidike, aerosolët dhe grimcat e suspenduara nga termocentralet, aktivitetet e mihjeve, si dhe deponitë e hirit (më parë ka pasur edhe depozitime të ndotësve nga impiantet e vjetra të gazifikimit dhe azotikut);

- Deponimi i mëparshëm dhe aktual i mbeturinave në deponi të hirit, në veçanti në deponinë e hirit të "Kosovës A" dhe në minierën e vjetër (deponia sanitare rajonale) dhe;
- Shkarkimet e ujërave industriale dhe të zeza të pa trajtuara.

Masat të cilat duhet të merren për mbrojtjen e tokës:

1. Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe të resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllimet jo bujqësore, me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar.

2. Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit parashikohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja e cila planifikohet të bëhet me këtë plan;

3. Planifikohet ujitje e tokës bujqësore dhe masa të tjera për të ngritur shkallën më të ultë të të përshtatshmërisë së tokës.

4. Masa më të rrepta për ruajtjen e tokës bujqësore dhe me bonitet më të lartë;

5 Planifikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave për tokat të cilat kanë bonitet të lartë, dhe masa të tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit;

6. Planifikohet mbrojtja nga erozionet nga shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimit të zonave të degraduara;

7 Planifikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë e mbeturinave dhe deponit e hirit

8 Planifikohet rivitalizim i zonave ku janë shfrytëzuar pasuritë e ndryshme sipërfaqësore dhe nëntokësore, siç janë në Obiliq, Kryshefc, Hamidi, Carravodicë

9 Në të ardhmen duhet të bëhet izolimi profesional i vendit ku hidhet hiri që mbetet nga prodhimi i energjisë elektrike nga qymyri.

3.6.5. Zhurma

Siç është shpjeguar në paragrafin e epërm të dhënat janë të pakta dhe zhurma mjedisore duhet konsideruar si problem që ka ndikim në mjedis që shkakton shqetësime serioze për shëndetin dhe mirëqenien (ngacmime dhe pengesa në gjumë) për banorët.

Indikacionet e pakta në dispozicion tregojnë mundësi të madhe të tejkalimit të standardeve të imitimit të zhurmës në zonat e banimit përreth kufirit të mihjeve nga një herë edhe në zonat banesore afër "Kosovës B".

Do duhej ndërmarrë monitorimi i zhurmës në mjedis për të përcaktuar masat e duhura për zbutjen e gjendjes.

Masat reduktuese të zhurmës duhet siguruar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së popullatës në afërsi.

Megjithatë, kushtet meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe shpejtësia e erës, absorbimi sipërfaqësor dhe atmosferik, dhe lagështia e ajrit mund të ndikojnë në nivelin dhe shpërndarjen e zhurmës; një fushatë monitorimi është e domosdoshme për të vlerësuar indikatorin "Emetimet e zhurmës" për lokacionet e centraleve dhe mihjeve.

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdorë pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë. Ndërtesat duhet të jenë të projektuara dhe e ndërtuara në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij intensiteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit.

Me rregulloren komunale duhet ndaluar kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera që me zhurmë pengojnë qetësinë dhe pushimin e njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga një orar i caktuar dhe veprimtari të caktuara.

Trashëgimia natyrore dhe biodiversiteti, humbja e llojeve organike

Nga analiza e bërë për këtë fushë në komunën e Obiliqit me rrethinë dhe dokumentet e aprovuara rezulton se në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë:

- Burim i ujit mineral në Grabofc të Epërm;
- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Palaj);
- Trung druri i vetëm bliri (Tilia spec.), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe;
- Grup trungjesh druri të bungut (3x Quercus spec., 1x Quercus cerris), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).

Në territorin e Komunës nuk ekzistojnë zona natyrore të mbrojtura me ligj, por ekziston një zonë e veçantë e mbrojtur me ligj siç janë, Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve. Në këtë zonë janë të ndaluara këto aktivitete:

- Ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi i mineraleve dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite nëpër zonat rurale dhe;
- Ndërtimet apo zhvillimet që qojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.[27]

Në aërsi të fshatrave mund të gjendet vegjetacion i cili është mjaft i degraduar nga faktori antropogjen. Ekzistojnë disa individume të fitocenozave natyrore në livadhet e ulëta dhe me lagështi kryesisht nga familja *Poaceae*, dhe individume të fitocenezave të llojet të ahut, dushkut, shkurreve etj., që gjinden në perëndim. Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kumria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjendën veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj. Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit etj. Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, thëllënza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.

Rekomandohet që komuna e Obiliqit ti marrë këto masa për mbrojtjen rivitalizimin dhe zhvillimin e disa nga ekosistemet e degraduara dhe ruajtjen e biodiversitetit aktual:

- Të bëhet një studim i mirëfilltë në nivel të Komunës për gjendjen e pyjeve ku do të identifikoheshin saktë problemet që i karakterizojnë pyjet dhe biodiversitetin në këto ekosisteme, dhe të propozoheshin zgjidhje për ato probleme.
- Ulja e shkallës së dëmtimit të pyjeve dhe mbrojtja e biodiversitetit.
- Hartimi i planit lokal për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.
- Kampanjë vetëdijesimi për mbrojtjen e biodiversitetit dhe pyjeve në veçanti
- Vendosja e tabelave me mbishkrime për vetëdijesim në të gjitha zonat me vlera të larta të biodiversitetit.

SWOT Analiza për mjedis

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Ka ligjin për zonën nën ndikim të ndotjes, i cili ofron edhe lehtësira për banorët dhe kufizon ndotjen në këtë zonë;** ▪ **Ka Planin e Veprimit Lokal në Mjedis;** ▪ **Komuna ka Drejtori për çështjet të mbrojtjes së Mjedisit e cila merret ekskluzivisht me mbrojtjen e Mjedisit dhe shëndetin e popullatës nga ndotja;** ▪ **Ka pozitë të mirë gjeografike pasi që shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe Rrjedhë se 75% e sipërfaqes së komunës është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku rreth 25% janë terrene malore;** ▪ **Parametrat e ajrit në mënyrë kontinuale monitorohen nga organizata të ndryshme në lokacione brenda territorit të Komunës;** ▪ **Ekzistenca e Instituti INKOS i cili bënë matjet dhe paraqet pasqyrën mbi gjendjen mjedisore në disa pika të për caktuara, gjegjësisht përqendrimin e emisioneve (ndotësve kryesor) në ajër, përfshirë SO_2, blozën, thërrmijat ajrore dhe pluhurin e depozituar (sendimentet), të cilat raportohen në KEK;** ▪ **Pasuri nëntokësore kryesisht të thëngjill (linjiti);** ▪ **Tokë pjellore nën komasacion dhe sistem ujitje dhe kushte të mira për bujqësi;** ▪ **Resurse të mjaftueshme ujore** ▪ **95% të vendbanimeve rurale dhe urbane gëzojnë qasje në rrjet të kanalizimit dhe të ujësjellësit**	▪ Komuna e Obiliqit është njëra ndër komunat me mjedis më të ndotur në Kosovë; ▪ Ndotja e ajrit vije nga TC A dhe B por edhe nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse banesore; ▪ Cilësia e rrugëve dhe problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet; ▪ Ujërat e kontaminuar nga minierat e thëngjillit; ▪ Nuk ka pellgje për ujërat teknologjike nga minierat, por uji pompohet jashtë dhe shkarkohet në lumenjtë më të afërt (lumenjtë "Drenica" dhe "Sitnica"); ▪ Ndotja e ujit nga shkarkimi i ujërave të zeza; ▪ Menaxhim i dobët i mbeturinave, si dhe mungesë trajtimi të tyre; ▪ Zonat me ndotje më të madhe të ajrit në komunë janë në zonat industriale dhe përfshijnë këto vendbanime: Kryshefc, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Cërkvena Vodicë dhe Lajthishtë; ▪ Ndotja e ajrit nga deponitë e hirit që vije nga erozioni nga erërat; ▪ Humbja e tokës bujqësore dhe uzurpimi i saj me ndërtime; ▪ Shkarkime të ujërave industriale të pa trajtuara; ▪ Prerja dhe dëmtimi i pyjeve ▪ vetëdija e ulët e opinionit publik dhe institucional lidhur me ngritjen e cilësisë së ajrit ▪ Deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milionë tonelata hi, duke uzurpuar kështu rreth 242 ha tokë punuese, deponia nga TC "Kosova-A" dhe 150 ha deponia

[27]PLVM, Obiliq, 2012-2017

▪ **Projekti për Obiliqin për futjen e sistemit të ngrohjes qendrore;**	TC "Kosova-B", si dhe gropat e hapura gjatë mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit. ▪ Shkatërrimet e mëdha të pyjeve kanë rezultuar me humbje biodiversiteti; ▪ Zvogëlimi i tokave pyjore:- nga prerja e pakontrolluar e drunjëve zjarri (kjo po ndikon edhe në rritjen e erozionit); ▪ Lirimi i gazrave serrë nga deponia rajonale e Prishtinës në Mirash; ▪ Mungon inventarizimi i biodiversitetit ▪ Ajri me cilësi të dobët duke pasur praninë e pluhurit dhe lirimi i gazrave siç janë: SO_2, NO_X, CO, CO_2, H_2S, bloza, thërrmijat ajrore sedimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj)
Mundësitë ▪ **Investimet në termocentralet Kosova A dhe Kosova B për vendosjen e filtrave për zvogëlimin e elementeve ndotës që lirohen nga këto dy termocentrale;** ▪ **Trajtimi i ujërave industriale nga TC-të;** ▪ **Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza nga kanalizimi i vendbanimeve;** ▪ **Përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe mbrojtja e shëndetit të popullatës përmes rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara;** ▪ **Projekte për menaxhim të mbeturinave komunale dhe atyre industriale;** ▪ **Rritja e buxhetit nga komuna por edhe niveli qendror sipas Ligjit për këtë komunë për fushën e mjedisit ;** ▪ **Të krijohet mundësia për shfrytëzimin e resurseve të ripërtërishme;** ▪ **Vendosja e matësve për cilësinë e ajrit në vendet ku ka ndotje te lartë (Plemetin. Obiliq, Hade, Mazgit, Kryshefc, Lajthishtë, Caravodicë, etj);** ▪ **Projekte për pyllëzim të hapësirave të zhveshura;** ▪ **Obiliqi duhet të ketë sistemin e ngrohjes qendrore sipas ligjit për këtë zonë i cili do të merret nga avulli nga TC-të.**	Rreziqet ▪ Humbje ireversibile e resursit tokësor me cilësi të lartë; ▪ Paraqitja e sëmundjeve kancerogjene dhe sëmundjeve tjera kardio-vaskulare; ▪ Humbje e interesit për të jetuar në këtë komunë dhe emigrim i popullatës; ▪ Dëmtim deri në rrezik zhdukje të ekosistemeve lumore dhe eutrofizim të plot të lumenjve; ▪ Zhdukja e llojeve organike nga ekosistemet e kësaj komune si rezultat i aktivitetit industrial; ▪ Rritja e ndotjes së ajrit, ujit, tokës nëse nuk merren masa të menjëhershme për parandalimin e ndotjes në komunën e Obiliqit;

3.6.6. Sipërfaqet me rrezikshmëri

3.6.6.1. Erozioni dhe sendimentimi

Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime. Rreth 6.000 km² ose 56 % e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga kjo dukuri natyrore që i takon shkallës së I, II, III të erozionit, (I erozion shumë i fortë, II erozion i fortë dhe III erozion i mesëm).


Vetëm në pellgun e Sitnicës nën ndikim të erozionit janë rreth 1.400 km² ose rreth 48 % e sipërfaqes së pellgut të lumit (kategoria I, II, III). Edhe në territorin e komunës së Obiliqit është prezent dukuria e erozionit që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonomitë familjare. Në bazë të analizave të paraqitura në hartë janë ndarë këto kategori të erozionit .

Në bazë të të dhënave, nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë erozive janë përfshirë rreth 535 ha ose 6% e sipërfaqes së territorit të komunës, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri.

Nr.	Përshkrimi	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja %

1	Pa erozion	4996.30	47.66%
2	Erozion shumë i dobët		
3	Erozion i dobët		
4	Erozion shumë i fortë	4951	47.23%
5	Erozion i fortë	381.76	3.64%
6	Erozion shumë i fortë	153.37	1.47%

Tabela 152. Sipërfaqet dhe përqindja e territorit e rrezikuar nga erozioni



Harta 56. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit

3.6.6.2. Sipërfaqet me ndotje të lartë (hot-spotet)

Kosova A dhe B - Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", Gjatë prodhimit të energjisë elektrike në termocentrale vjen deri te djegia e thëngjillit me ç 'rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe në formë të ujërave pas proceseve teknologjike.

Po ashtu si pik e nxehtë në Komunën e Obiliqit konsiderohet të jetë edhe deponia e mbeturinave në Mirash ku mbeturinat në këtë deponi sillen edhe nga disa komuna tjera dhe se këto mbeturina shkaktojnë ndotje.

Komuna e Obiliqit e mbulon me sistem të menaxhimit të mbeturinave tërë territorin e Obiliqit, numri i ekonomive familjare që janë të kyçura në sistem (numri i kontejnerëve është 2308).

Në ekonomitë familjare përdoren dy sisteme të grumbullimit të mbeturinave:

- sistemi i grumbullimit i ashtuquajtur "derë më derë", ky sistem aplikohet për amvisëritë me banim individual në qytezën e Obiliqi dhe fshatra
- sistemi i mbledhjes së mbeturinave me kontejner 1.1 m^3 dhe ky sistem aplikohet për ekonomitë familjare me banim kolektiv (ndërtesat shumëkatëshe). Kurse 7m^3 në ndërtesë kampi Plemetin

Në ekonomitë familjare ashtuquajtur "derë më derë", shërbimi kryhet një herë në javë.

Në ekonomitë familjare me banim kolektiv(të përbashkët) ndërtesat shumëkatëshe shërbimi kryhet çdo ditë.

Po ashtu, në komunën e Obiliqit ekzistojnë edhe mbeturina të rrezikshme, të cilat paraqiten më poshtë.

Lloji I Mbeturinave	Sasia/Njësia	Lokacioni	Komuna
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	49045m3	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	186ton	Kosova A	Obiliq
Burime radioaktive	34njësi	Kosova A	Obiliq

Tabela 153 Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit

3.6.6.3. Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e dëborës

Meqë shumica e territorit të komunë së Obiliqit është sipërfaqe e rrafshët dukuria e rrokullisjeve shkëmbore dhe ortekëve të dëborës nuk ka qenë fare e shprehur, apo më mirë të themi se ka qenë shumë pak e shprehur.

3.6.6.4. Erërat

Komuna e Obiliqit është Komunë me territor kryesisht të Rrafshët dhe është e atakuar erërat të cilat edhe në të kaluarën kanë sjell dëme materiale në këtë Komunë . Po ashtu, erërat në këtë Komunë kanë edhe në rol tjetër negativ pasi që ngritin materiet e rrezikshme nga deponia e hirit dhe bën ndotjen e ajrit.

3.6.6.5. Reliefi

Në Komunën e Obiliqit ka ekspozicion qendror si Komunë ku dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, perëndimin dhe pjesa qendrore e komunës është pjesë fushore që shtrihet rreth Lumit Sitnica. Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç në lindje dhe perëndim ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit Komunës së Obiliqit është i ndryshueshëm dhe i pa eksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dhe hedhja e mbeturinave rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore.

3.6.6.6. Përmbytjet

Historikisht, sikur edhe në vendet tjera në rajon, zvogëlimi i dëmeve si pasojë e përmbytjeve ka qenë i fokusuar më shumë në teknikat e mëparshme, që kishin të bënin me shmangien e vërshimeve duke ndërtuar struktura për kontrollimin e tyre siç janë ndërtimi i digave kontrolluese, brigjeve dhe modifikimi i kanaleve. Megjithatë masat e tilla të kontrollit nëpërmjet strukturave, kanë rezultuar si jo të suksesshme gjatë kohës. Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj : Sitnica, Drenica dhe Llapi.

Në komunën e Kastriotit (Obiliqit) janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jaze 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe këneta 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Kastrioti, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Plemetini dhe Hamidija.

Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap. Përveç faktorëve natyror edhe faktori njeri ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet. Sipas vlerësimit në këtë PZHK dhe sipas Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor janë identifikuar aktiviteteve negative si:

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve)
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë rritura pran brigjeve të lumenjve etj.
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.
- Vërshimet nuk mund të parandalohen, por dëmet në prona mund të menaxhohen nëpërmjet mos shfrytëzimit për ndërtim (kufizim zhvillimi) në zonat e prira për Vërshime.
- Meqë Vërshimet hyjnë në grupin e fatkeqësive të cilat mund të paralajmërohen, me anë të parashikimit të motit, kështu që zvogëlimi i dëmeve materiale të shkaktuara nga përmbytjet mund të bëhet duke marrë masat adekuate, siç janë: vendosja e thasëve me rërë përgjatë brigjeve të lumit, zhvendosja e të mirave materiale nga niveli i cili mund të përmbytet etj.

Në mënyrë që të mënjanohen dëmet nga Vërshimet në të ardhmen, Komuna duhet të:

- Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.
- Rregullimi i sistemit të drenazhimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.
- Përmirësimi i shtretërve të lumenjve Sitnica, Drenica, dhe Llapi.

DRAFT

3.6.6.7. Rrëshqitjet e tokës

Në komunë nuk janë shënuar raste të rrëshqitje të tokës.

3.6.6.8. Tërmetet

I tërë territori i komunës së Obiliqit është i rrezikuar nga ndikimi i tërmeteve me intensitet të ndryshëm. Hartat sizmike, të cilat janë pjesë e këtij dokumenti përcaktojnë nivelin e intensitetit të tërmetit për një periudhë të caktuar të kthimit. Për objektet banuese përdoren hartat me periudhë të kthimit 475 vite. Ndërsa, te objektet me rëndësi më të madhe siç janë pendët, përdoren hartat më periudhë të kthimit 1000 vite.

Shfrytëzimi i këtyre hartave gjatë fazës së projektimit dhe zgjidhjes së lokacionit, përdorimi i koeficienteve adekuat gjatë llogarisë së objektit dhe respektimi i rregullave bazë për objektet me rezistencë ndaj tërmeteve do të kishte kontribut të jashtëzakonshëm në zbutjen e ndikimit të tërmeteve në objektet kritike dhe objektet tjera.

Qëllimi kryesor është të respektohet kodi i ndërtimit që në rast të ndonjë tërmeti në të ardhmen të mos ketë humbje në njerëz si dhe dëmet materiale të jenë sa më të vogla dhe të riparueshme.

3.6.6.9. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Çdo objekt të cilit i jepet leja e ndërtimit duhet të posedojë edhe planin e evakuimit në rast të zjarrit. Ky aprovim jepet nga zyrtarë të profesionalizuar komunal. Nëse objekti nuk e ka këtë plan, atëherë leja e ndërtimit duhet t'ju pezullohet.

Banorët në ndërtesë duhen të jenë të vetëdijshëm për këtë plan dhe për vendndodhjen e hidrantëve në objektin ku ata jetojnë. Në zonën rurale ka nevojë për ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të parandaluar disa veprime, si zjarret në pyje, sidomos në stinën e verës. Këto duhet të bëhen me aktivitete për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve, përmes fletushkave, prezantimeve, edukimit të fëmijëve në shkolla, simulimeve të ndryshme etj.

Zjarret si shkak i djegies spontane të linjitit ndodhin në sistemin e tavaneve të mihjeve sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit dhe më rrallë në ballët e mihjes, dhe pirgjet e palosjes së linjitit. Tavanet e linjitit ndizen për shkak të oksidimit të sulfurit të djegshëm, i cili në kontakt me oksigjenin atmosferik prodhojnë energjinë e nxehtësisë së nevojshme për vetëndezje**.**

Zonat malore në fshatin Kozaricë, Breznicë, Shipitullë, Sibovc, Grabofc si dhe korporata e KEK-ut që paraqet rrezik permanent për shfaqjet e zjarrit.



Foto: Zjarret në komunën e Obiliqit

Përparësitë	Dobësitë

▪ **Shumica e territorit të komunës së Obiliqit është zonë fushore** ▪ **Obiliqi nuk ka qenë asnjëherë i goditur nga ndonjë termet apo ortek i përmasave shkatërruese** ▪ **Ka resurse të mjaftueshme ujore** ▪ **Ka planë për menaxhimin e mbeturinave** ▪ **Reliev i përshtatshëm për zgjerimin e rrjetit të drenazhimit**	▪ Shtretër të ngushtë të lumenjve gjë që sjell deri te vërshimet ne disa pjesë të Komunës si (: Kastrioti, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Plemetini dhe Hamidija.) ▪ Humbja e tokës Bujqësore si rezultat i erozionit të lumenjve dhe nga zgjerimi i deponive të hirit . ▪ Mungesa e rezervave të ujit në Kozaricë, Breznicë, Shipitullë, Sibovc, Grabofc dhe ne fshatra tjera të rrezikuara nga zjarret ▪ Rrugë të ngushta për intervenimin e zjarrfikësve në fshatrat Kozdaric ▪ Nuk ka analiza mikro sizmike për komunë por të dhënat për tërmetet i merr nga niveli qendrorë ▪ Mungesa e zbatimit të ligjeve ne fuqi ▪ Kufizimet financiare dhe teknike ▪ Shkalla e lartë e vdekshmërisë si rezultat i ndotjes së lartë të ajrit ▪ Kapaciteti i pamjaftueshëm dhe menaxhimi i dobët i deponive lokale
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Pastrimi dhe zgjerimi i lumenjve (Sitnica, Drenica dhe Llapi)** ▪ **Organizimi i trajnimeve, mbi vetëdijesimin e popullatës për rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë nga veprimtaria e erozionit, ortekut, rrëshqitjet e dheut zjarret etj.** ▪ **Kthimi i deponisë së hirtit në një tokë të punueshme** ▪ **Komuna të përkrah përdorimin e lëndëve djegëse më cilësore.** ▪ **Të pajisen dhe mbështeten zjarrfikësit me pajisje adekuate për menaxhim te zjarreve** ▪ **Sigurimi i brezave mbrojtës për largpërçuesit elektrik në fshatrat malore për zvogëlimin e mundësisë së zjarreve**	▪ Humbja e tokës bujqësore nga veprimtaria e erozionit, vërshimet. ▪ Shpenzime financiare në shuma të larta. ▪ Prerja e pyjeve. ▪ Zjarrvënia e qëllimshme nga faktori njeri. ▪ Rritja e zonave të vërshuara ▪ Rrezikimi i florës dhe faunës nga djegia e pyjeve ▪ Rritja e dëmeve materiale nga vërshimet në Obiliq dhe fshatrat në të cilët kalojnë lumenjtë ▪ Mungesa e rrjetit të drenazhimit ndikon në përmbytje në zona të caktuara

3.6.7. Identifikimi i sfidave

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në fushën e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri, janë identifikuar disa sfida të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

Sfidat e identifikuara në gjitha komponentët mjedisore janë:

- Sigurimi i fondeve për projektet mjedisore
- Menaxhimi i mbeturinave është ndër sfidat më të mëdha mjedisore në Komunën e Obiliqit
- Edukimi mjedisor
- Trajtimi i zonave ku depozitohet Hiri
- Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore nga ndërtimet dhe nga ndotja nga deponitë e hirit
- Trajtimi i ujërave të zeza
- Ruajtja e cilësisë së ujit në lumenjtë: Sitnica, Drenica, Llapi
- Parandalimi nga degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave
- Parandalimi i ndotjes nga zhurma
- Parandalimi i Erozionit
- Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen pyjeve nga zjarret.

DRAFT

3.6.8. Gjetjet kyçe

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri, janë identifikuar gjetjet kyçe të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

- Mospërputhja e dokumenteve zyrtare të komunës me dokumente të nivelit qendror
- Vështirësia deri te arritja e informacionit
- Ndotje enorme e Ajrit, Ujit dhe Tokës

3.6.9. Identifikimi i problemeve

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në fushën e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar problemet të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

3.6.9.1.1. Ndotja e Ajrit

- Ndotja e lartë e ajrit nga KEK-u
- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO_2 dhe NOx, nga termocentralet ekzistuese, aktivitetet minerare dhe deponitë e hirit, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet mjedisore që dalin nga Direktiva e BE-së për impiante me djegie të mëdha (LCPD 2001/80/EC).
- Ndotja e lart e ajrit në vendbanimet si; Kryshefc, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Shipitull Grabofc i Epërm Cërkvena Vodica, Dobrosellë dhe Lajthishtë
- Afërsia e Deponive të Hirit me qytetin të Obiliqit
- Monitorimi i kufizuar cilësisë së ajrit me stacione matëse
- Menaxhim i kufizuar i mbeturinave
- Ndotja enorme e ajrit, zhurma e lartë, antena të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në qytetin e Obiliqit.
- Një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës

3.6.9.1.2. Ndotja Ujit

- Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenj si ;Drenica, Sitnica dhe Llapi.
- Mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Deponitë e mbeturinave përgjatë shtratit të lumenjve
- Shkarkimi i ujërave industriale nga Korporata Energjetike e Kosovës në lumenjtë pa trajtim adekuat
- Qasja akoma e ulët në kanalizime publike
- Furnizimi me ujë të pijshëm, ujërat urbane, rurale e industriale pa trajtim adekuat

3.6.9.1.3. Ndotja e Tokës

- Humbja tokës bujqësore nga mihjet sipërfaqësore nga KEK-u, eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, deponitë e automjeteve, procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve, etj.
- Prania e deponive Hirit dhe deponitë e Mbeturinave
- Humbja e Tokës Bujqësore me bonitet të lartë nga ndërtimet
- Mos mbulesa e gjithë hapësirës ku ka tokë bujqësore me kanale të ujitjes

Ndotja nga zhurma

- Niveli i lartë i zhurmës nga automjetet, gurthyesit dhe veprimtaria industriale nga KEK-u
- Mungesa e dokumenteve për parandalimin e ndotjes nga zhurma

Biodiversiteti

- Humbja e sipërfaqeve pyjore në fshatrat Breznicë, Kozdaric, Grabofc
- Rrezikimi i specieve të rralla nga zhdukja
- Gjuetia e pa kontrolluar në malet e Grabofcit

Erozioni

- Humbja e tokës bujqësore
- Shtretër të ngushtë të lumenjve
- Rrezikimi nga erozioni i shtëpive që janë në afërsi të lumit Drenica, Sitnica dhe Llapi

Rrëshqitja e Tokës

- Shpyllëzimi i hapësirave
- Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit
- Rrëshqitjet e dheut
- Ndërtimet pa kriter dhe në mos përputhje me planet e komunës

Tërmetet

- Mungesa e Analizave Mikro-sizmike për Komunën Obiliqit
- Cilësi jo e duhur e ndërtimeve

Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e dëborës

- Mungesa e mureve mbrojtëse në vendet ku ka ortekë të dëborës, p.sh. në fshatrat Breznicë, Kozdaric, Grabofc i Epërm

Erërat

- Mungesa e një plani për gjelbërim mbrojtës dhe plan për peizazhe natyrore brenda qytetit
- Mos shfrytëzimi i erës për përfitimin e energjisë elektrike

Sipërfaqet me ndotje të lartë (HOT-SPOTET)

- Deponitë e hirit nga Korporata Energjetike e Kosovës
- Mungesa e lokacionit për mbeturinat e ngurta
- Mos riciklimi i mbeturinave
- Deponia e mbeturinave në Mirash

Sipërfaqet e Rrezikuara nga zjarri

- Mungesa e rezervave të ujit në Breznicë, Kozdaric, Grabofc i Epërm dhe në fshatra tjera të rrezikuara nga zjarret
- Rrugët e ngushta si në zonën urbane, po ashtu dhe në zonën rurale, në fshatrat Breznicë, Kozdaric, Grabofci i Epërm, Shipitullë dhe disa fshatra të tjera që janë të rrezikuara nga zjarri
- Zjarrvënia e qëllimshme nga faktori njeri
- Rrjeti dhe instalimet e vjetruara elektrike

Përmbytjet

- Shtretërit e ngushtë të lumenjve
- Mungesa e argjinaturave mbrojtëse në lumin Sitnica dhe Drenica

3.6.10. Konstatimet kryesore

Ndotja e Ajrit Konstatimet

- Vendosja e filtrave në Kosovë A dhe B
- Menaxhimi i rrjetit rrugor
- Promovimi i teknologjive të pastërta
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta
- Bizneset të cilat përdorin lënde djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të pajisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilësisë së lëndës djegëse).
- Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore të Obiliqit dhe përreth deponive të hirit dhe deponive të mbeturinave
- Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve
- Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave që e ndotin ajrin.
- Përcaktimin e kritereve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit me prioritet në qytetin e Obiliqit, hapësirat periferike urbane dhe vendbanimet e mëdha.
- Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve.
- Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale)
- Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në këmbë.
- Rikonstruktimi rrugëve (qarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet e mbeturinave etj.

Ndotja e Ujit Konstatimet

- Ndërtimi i kolektorëve dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza

DRAFT

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.
- Të merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike.
- Nevojat e popullsisë për ujë do të rriten vazhdimisht. Ne periudhën e ardhshme Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shendosh të pijes për popullsinë e Obiliqit do të jetë edhe në të ardhmen probleme seriozë. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth janë paraparë edhe në ketë dokument, për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Pos kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në ketë komunë është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.
- Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.)

Ndotja e Tokës Konstatimet

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikua me Plane nga Komuna e Obiliqit
- Planifikohet të bëhen në mënyra të vazhdueshme monitorimi dhe kontrolle e plleshmërisë së tokës bujqësore.
- Me këtë plan parashihet të bëhet edhe rivitalizimi i hapësirave te deponitë e hirit
- Parashikohen ujitje e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit te toka e cila ka bonitet më të ulët.
- Parashikohet në zonat të cilat janë destinime (përpos banimit) tjera të hartohen projekte rikultivimi të tokës bujqësore
- Parashikohet mbrojtja nga degradimi dhe ndikimi i njeriut.
- Parashikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes qarkullimit bimor në tokat bujqësore dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen serrishtat ose mbetjet bimore)
- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.
- Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh ketë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

Ndotja nga Zhurma Konstatimet

Andaj për zvogëlimin e zhurmës në Komunën e Obiliqit Parashikohet.

- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, në qendër etj.)
- Të hartohet Harta Strategjike e hurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

Biodiversiteti, Konstatimet

- Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'u lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur, sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.
- Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të kthehen përsëri
- Shumë lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere.
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër
- Biodiversiteti dhe llojllojshmëria biologjike e natyrës në pjesën perëndimore dhe veriore të Obiliqit paraqet një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi
- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike.
- Dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversiteti- shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.
- Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet .
- Parashikohet rivitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Obiliqit. Pra, duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve: fluturave, shpezëve mishngrënës etj.

Erozioni

- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë përgjatë lumenjve Sitnica Drenica dhe Llapi ,dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja.
- Parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpëlarja e elementeve përbërëse të tokës me anë të pyllëzimit dhe meliorimit të zonave të degraduara.

Rrëshqitja e Tokës

Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatrat (Breznicë, Kozdaricë, Grabofci Epërm, Shipitullë) që janë sado pak të rrezikuara nga kjo dukuri.

Tërmetet

- Analizat mikrozonike për qytetin e Obiliqit
- Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+4, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, e sidomos urave

Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në vendet ku ka ortekë të dëborës, p.sh. në Fshatrat Breznicë, Kozdaricë, Grabofci Epërm, dhe Shipitullë.

Erërat

- Komuna duhet pasur në konsideratë në procedurat e dhënies së kushteve të ndërtimit për objektet të etazhitetit të lartë si dhe objekteve të infrastrukturës teknike, të transportit dhe objekteve energjetike.
- Hartimi i Planit për gjelbërim mbrojtës

Sipërfaqet me ndotje të lartë (HOT-SPOTET)

- Caktimi i lokacionit për mbeturina të ngurta
- Riciklimin e mbeturinave
- Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave
- Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimit të vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj.), masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdoren, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar

Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

- Zgjerimi i rrugëve në qytet dhe fshatrat ku janë të rrezikuara nga zjarri
- Ndërrimi i rezervuarëve të ujit në zonat rurale për zjarrfikësit
- Trajnimi i faktorit njeri për rëndësinë e pyjeve

Përmbytjet

- Parashikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave te toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit.
- Zgjerimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave
- Ndërtimi i argjinaturave mbrojtëse.

3.7. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

3.7.1. Asetet e trashëgimisë natyrore

Përpos vlerave të larta të kulturës së trashëguar materiale e shpirtërore dhe trashëgimisë arkitektonike, komuna e Obiliqit karakterizohet me një trashëgimi natyrore shumë të pasur.

Në Komunë janë identifikuar gjithsejtë 9 asete vijuese të trashëgimisë natyrore:

Nga asetet e trashëgimisë natyrore të sipërpërmendura, vetëm trungjet e dushkut, të blirit dhe guri në Sibovc, janë të shpallura nën mbrojtje nga niveli qendror, gjersa Maja e Zezë –Grabofc i Epërm, Bota e kuqe dhe gurët e gjelbër në Grabofc të Epërm, Kroi i Mjekiqëve, Burimi i ujit mineral në Grabofc të Epërm, Çeshmja e katundit në Palaj, Bunari/Çeshmja e Mulla Jahës në lagjen e Hashanëve, Bunari i Pashës dhe Bunari i Dashnisë, janë të identifikuara nën mbrojtje nga komuna, mirëpo nuk janë të shpallura nën mbrojtje nga institucionet qeveritare të nivelit qendror.

Bazuar në Analizën Hapësinore të Komunës së Obiliqit nga Instituti i Planifikimit Hapësinor asetet natyrore si malet Rrënza e Çiçavicës dhe malet e Kozaricës, ofrojnë mundësi të zhvillimit të turizmit përmes gjuetisë dhe peshkatarisë.[28]

3.7.1.1. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Diversiteti i monumenteve natyrore (botanik, hidrologjik speologjik, gjeomorfologjik);** ▪ **Potencial i zhvillimit te turizmit në Shalë të Bajgorës;** ▪ **Gjendja në përgjithësi e mire e monumenteve natyrore;** ▪ **Zonë e pasur me ujë dhe lumenjtë** ▪ **Qasja e lehte për tu vizituar;** ▪ **Qytetar aktiv në shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore;** ▪ **Numri i madh i mjaftueshëm i ndërtesave hoteliere;** ▪ **Institucionet edukative të mjaftueshme dhe ato universitare;** ▪ **Nivel i mjaftueshëm i informimit;**	▪ Mungesa e një plani për mbrojtje dhe zhvillim të zonave ku ndodhen monumentet; ▪ Centralizimi i vendimmarrjes; ▪ Mungesa e definimit te zonës se mbrojtur; ▪ Mos hulumtimi i zonave; ▪ Vetëdija e ulët e popullatës; ▪ Mungesa e traditës për ruajtje të trashëgimisë natyrore ▪ Menaxhimi jo i mire i mbeturinave; ▪ Moszbatimi i PLVM; ▪ Mos implementimi i rregulloreve komunale; ▪ Buxhet i limituar;
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Shfrytëzimi i monumenteve te trashëgimisë natyrore për zhvillim te turizmit;** ▪ **Resurset njerëzore;** ▪ **Mundësia e promovimit dhe ngritjes se imazhit te Obiliqit;** ▪ **Shfrytëzimi i monumenteve te trashëgimisë natyrore për organizimin e ngjarjeve ekspeditave shkencore;** ▪ **Hartimi i politikave për zhvillim te qëndrueshëm;** ▪ **Zhvillimi i ofertës turistike dhe promovimi në nivel regjional/ndërkombëtar;**	▪ Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera: Vërshimet; Kanalet e hapura ne qytet; Erozioni; Djegia e pyjeve; ▪ Zhdukja e trashëgimisë në mënyrë të pa kthyeshme;

3.7.1.2. Sfidat e identifikuara

Si sfida të identifikuara në lëmin e aseteve të trashëgimisë natyrore janë:

- Konservimi i monumenteve të trashëgimisë natyrore
- Menaxhimi i zhvillimeve brenda dhe rreth *Perimetrit* dhe *Zonës Mbrojtëse*[29] të monumenteve të trashëgimisë natyrore;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i aseteve të trashëgimisë natyrore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave të të trashëgimisë natyrore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik.

3.7.1.3. Identifikimi i problemeve

- Nuk ka kufijtë të përcaktuar të zonave ku shtrihen asetet e trashëgimisë natyrore;
- Mungesa e politikave në nivel lokal për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore;
- Menaxhim efikas i trashëgimisë natyrore;
- Mungon infrastruktura për qasje në Asete të trashëgimisë natyrore (florës, faunës, etj.)
- Nuk ka një bazë të mirë të të dhënave për menaxhim më të lehtë
- Mungon edhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të qeverisë lokale dhe asaj qendrore.

[28] *Komuna e Obiliqit - Analiza hapësinore*, Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor, Kuvendi komunal – Obiliq,

Dhjetor, 2006, fq. 16

[29] Shprehja *Zonë Mbrojtëse* e përdorur në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, nënkupton *Zonën e Mbrojtjes* e përdorur në Ligjin Nr. 02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore

DRAFT

3.7.2. Asetet e trashëgimisë kulturore

Nën mbrojtje të përkohshme në komunën e Obiliqit janë përzgjedhur dhe përcaktuar: një aset të trashëgimisë kulturore arkeologjike, pesë asete të trashëgimisë kulturore arkitekturore dhe dy Zona të Veçanta të Mbrojtura.

Në të kaluarën, në territorin e Komunës së Obiliqit kanë qenë 8 asete vijuese të trashëgimisë arkeologjike – Monument/Ansambël nën mbrojtje të përkohshme. Mirëpo, në *Regjistrin e Trashëgimisë Kulturore të Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme 2020-2021*[30]*, Lokaliteti arkeologjik ''Lugu i Bucakut" i periudhës mesjetare-Hade, Lokalitet arkeologjik parahistorik Antik /Baimofc, Lokalitet arkeologjik të periudhës mesjetare "Çukishtë"-Bakshi, Lokalitet arkeologjik të periudhës parahistorik –Raskovë, Lokalitet arkeologjik të periudhës së antikitetit të vonë-mesjetë e hershme-"Markovac" Plemetin, Lokalitet arkeologjik i periudhës paleokristiane "Lugu i Kishës"-Grabofc i Epërm dhe Lokalitet arkeologjik "Lagjia e Qurilëve- Kisha – Sibovc,* janë larguar nga ky regjistër dhe nuk janë të mbrojtura me ligj. Vetëm *Lokaliteti arkeologjik parahistorik shumë shtresor -Dardhishtë (Krushec)* është nën mbrojtje të përkohshme.

Në të kaluarën, në territorin e Komunës së Obiliqit kanë qenë 7 asete vijuese të trashëgimisë arkitekturore – Monument/Ansambël nën mbrojtje të përkohshme: Tyrbja e Muratit, Selamllëku Shtëpia kulturore Promovuese Muze, RTK1 Radio Televizioni Valët e Mesme në Bakshi, Tyrbja e Bajraktarëve-Mazgit, Mulliri i Behramajve- Grabofc i Epërm, dhe Mulliri i Hysenajve - Grabofc i Epërm.

Mirëpo, në Regjistrin e Trashëgimisë Kulturore të Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme 2021-2022[31], Tyrbja e Bajraktarëve-Mazgit dhe Mulliri I Hysenajve - Grabofc i Epërm janë larguar nga ky regjistër dhe nuk janë të mbrojtura me ligj.

3.7.2.1. Trendët, nevojat, projeksionet dhe prognozat

Bazuar në trendët investimeve kapitale në të kaluarën, projeksionet dhe prognozat mbi investimet e ardhme në Komunë nuk është shumë premtuese.

Me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të aseteve të trashëgimisë kulturore, Komuna ka identifikuar nevojat vijuese:

- Zbatimi i politikave të lehtësirave fiskale që përcaktohet si masë ligjore e mbështetjes së financimit të trashëgimisë kulturore.
- Strategjia dhe politikat e rigjenerimit të aseteve të trashëgimisë kulturore si potencial për mirëqene të shoqërisë dhe zhvillim ekonomik, programi i zbatimit për vlerësimi, studim, konservim dhe adaptim të aseteve të trashëgimisë kulturore për përdorim bashkëkohor.
- Themelimi i Zyrës së Komunës për Menaxhimin e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore dhe trajnimi profesional i personelit.
- Ndërlidhja e planifikimit të Komunës së Obiliqit me Inventarin apo DB e Trashëgimisë Kulturore të MKRS.
- Krijimi i dokumentacionit relevant të aseteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë planet me konturat/kufijtë e Perimetrit të hapësirës së aseteve në mbrojtje me Zonat Mbrojtëse rreth tyre, përshkrimin e autenticitetit dhe mundësitë e zhvillimit.
- Vendosja e aseteve të trashëgimisë kulturore në planet kadastrale, Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, Hartën Zonale të Komunës, me qëllim përcaktimi të Sipërfaqeve të Mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta.
- Hartimi i listës së trashëgimisë kulturore në rrezik dhe programit për shpëtimin e tyre.
- Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore jo materiale/shpirtërore;
- Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore të luajtshme e ndërlidhur me territorin e Komunës së Obiliqit, paraqitja e vendit të ndodhjes së tyre përfshirë koleksionit publike dhe private.

3.7.2.2. Analiza SWOT

Tabela 154. Analiza SWOT për trashëgiminë natyrore, kulturore dhe turistike

Përparësitë	Dobësitë
▪ 5 asete të trashëgimisë arkitekturale ▪ 1 aset të trashëgimisë arkeologjike ▪ 2 Zona të Veçanta të Mbrojtura	▪ Mungesa e sipërfaqeve të *Perimetrit* dhe të *Zonës Mbrojtëse* të përcaktuara nga MKRS për asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje;

[30] Regjistri i Trashëgimisë Kulturore të Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme 2020-21, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Prishtinë, 2020

[31] Po aty,

	▪ Mungesa e *Sipërfaqeve të Mbrojtura* të përcaktuara nga MMPHI për asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje; ▪ Mungesa e shënjimeve orientuese drejtë aseteve të trashëgimisë kulturore; ▪ Masa jo adekuate për konservim; ▪ Infrastrukturë e dobët për qasje të kënaqshme nga publiku; ▪ Mungesa e një qasjeje të integruar drejt një menaxhimi dhe planifikimi të peizazhit në të gjitha fushat duke përfshirë vlerën e lartë të zonave të trashëgimisë natyrore; ▪ Infrastruktura e varfër për menaxhimin e përgjithshëm të trashëgimisë natyrore.
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ Përcaktimi i sipërfaqeve të *Perimetrit* dhe të *Zonës Mbrojtëse* për asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje; ▪ Përcaktimi i *Sipërfaqeve të Mbrojtura* për asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje; ▪ Përcaktimi i planit 10-vjeçar të investimeve në bashkëpunim me MRKS dhe QRTK të Obiliqit për asetet e trashëgimisë kulturore; ▪ Përcaktimi i zonave për zhvillimin e turizmit; ▪ Vendosja e shenjave orientuese drejtë aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore; ▪ Shfrytëzimi i objekteve te trashëgimisë kulturore për zhvillim te turizmit; ▪ Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore; ▪ Zhvillimi i ofertës turistike dhe promovimi në nivel regjional/ndërkombëtar;	▪ Mos mbrojtja e objekteve ekzistuese; ▪ Ndotja e lartë e ambientit; ▪ Mungesa e fondeve për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe mungesa e investitorëve. ▪ Shkatërrimi i aseteve të trashëgimisë kulturore; ▪ Tjetërsimi i aseteve të trashëgimisë kulturore; ▪ Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera: Vërshimet; Kanalet e hapura ne qytet; Erozioni; Djegia e pyjeve; ▪ Humbja e identitetit nga ndërtimet e pakontrolluar; ▪ Rrënimi i objekteve të trashëgimisë kulturore. ▪ Zhvillimet e pakontrolluara.

3.7.2.3. Detyrimet e mbrojtjes

Komuna e Obiliqit ruan pasuri të madhe të trashëgimisë kulturore të krijuar gjatë shekujve të kaluar, në variacione me tipologji të ndryshme të kulturës materiale dhe jo materiale. Prandaj, ruajtja e këtij potenciali me interes nacional për brezat pasardhës është detyrim i njerëzimit bashkëkohor. Megjithatë, përkundër bazës së mjaftueshme ligjore dhe të përpjekjeve institucionale me investime jo të vogla vendore dhe ndërkombëtare në dekadën e fundit, sfondi i aseteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Obiliqit paraqitet në situatë të pafavorshme, larg përkujdesjes së duhur profesionale, institucionale dhe ligjore. Si pasojë e mungesës së politikave dhe programeve relevante në relacion me përmbushjen e detyrimeve themelore ligjore, hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore të vendosur në listat zyrtare të mbrojtjes janë lënë në mëshirën e zhvillimeve të pakontrolluar bashkëkohore, duke përjetuar transformime të papërshtatshme të autenticitetit dhe integritetit fizik, historik, kulturor dhe hapësinor të tyre.

Sipas analizës së gjendjes aktuale, sfondi prej qindra asete të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore të vendosur në mbrojtje ligjore, kryesisht paraqitet në gjendje degradimi të lartë, të amortizuara, pa mirëmbajtje, me pamje restaurimi jocilësor dhe me hapësira të ngulfatur përreth nga zhvillimet dhe ndërtimet e papërshtatshme.

Gjendja e rrezikshmërisë së lartë të hapësirave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje dhe ato që duhet identifikuar, rrjedhë si pasojë e ngecjeve evidente të përmbushjes së detyrimeve kryesore institucionale të përcaktuar për masat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Në këtë kuptim, asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje nuk kanë të përcaktuar autenticitetin, kufirin e *Perimetrit* të bërthamës/hapësirës së asetit dhe as kufirin e *Zonës Mbrojtëse* rreth tij, as nevojat dhe limitet e mbrojtjes nga zhvillimet bashkëkohore. Si pasojë e këtyre mungesave, hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje nuk janë

përcaktuar *Sipërfaqet e Mbrojtura*[32] në Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës dhe Planin Zhvillimor të Komunës.[33]

Me qëllim përcaktimi të *Sipërfaqes së Mbrojtur* sipas kuptimit të definuar në nenin 6 (paragrafi 4 dhe 5) nenin 7 (paragrafi 19) të Ligji nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore dhe neni 3 (paragrafi 1.13, 1.19,) dhe neni 18 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor duhet të përcaktohen *Perimetri* dhe *Zona Mbrojtëse* rreth tij. Përmbushja e këtyre detyrave të përcaktimit të *Perimetrit* dhe *Zonës Mbrojtëse* është në kompetencën e MKRS dhe të institucioneve përgjegjëse për trashëgimi kulturore, gjersa përcaktimi i *Sipërfaqes së Mbrojtur* dhe në vartësi të MMPHI që duhet të përcaktojë ato në Hartën Zonale të Kosovës.

Por, këto të dhëna kryesore të mbrojtjes efektive ligjore mungojnë për mbi një dekade, meqenëse MKRS nuk i ka përcaktuar *Perimetrat* dhe *Zonat Mbrojtëse* rreth tyre dhe nuk ka vendosur në listën zyrtare të aseteve në mbrojtje. Si rrjedhojë e mungesave të këtyre dy kufijve, hapësirat e aseteve të mbrojtur të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore nuk janë përcaktuar si *Sipërfaqe të Mbrojtura* në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor (Plan Hapësinor të Kosovës, Hartë Zonale të Kosovës, pastaj rrjedhimisht në Plane Zhvillimore Komunale, Harte Zonale të Komunës) me vijëzim apo demarkim të truallit të shtrirjes së tyre në territor, duke specifikuar veçorit apo autenticitetin, rëndësinë, vlerat, gjendjen, nevojat dhe limitet ndaj zhvillimeve bashkëkohore.

3.7.2.4. Problematika

Përveç këtyre listave zyrtare, MKRS ka DB e trashëgimisë kulturore të RKS, e cila përmban të dhënat nga inventarizimi i potencialit të trashëgimisë kulturore të realizuar nga viti 2001. Ndërsa, në këtë DB mbase ka asete të cilat ende nuk janë përzgjedhur dhe propozuar për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme. Pra, potenciali i trashëgimisë kulturore të Komunës së Obiliqit, supozohet me qenë përtej aseteve të vendosur në dy listat e sipër cekur.[34] Sipas legjislacionit në fuqi, asetet me status të mbrojtjes së përkohshme mbahen vetëm për një vit. Nëse ky afat njëvjeçar tejkalohet, të gjitha humbjet financiare të pronarëve duhet t'i mbartë shteti.

Krahas mungesës së parametrave të elementeve kryesore të mbrojtjes nga zhvillimet bashkëkohore, aktivitetet e konservimit apo restaurimit kryesisht zhvillohen në kundërshtim me kritere ligjore, pa planifikim të bazuar në standarde profesionale dhe pa personel profesional të licencuar. Si rrjedhojë e anashkalimit të detyrimeve dhe kritereve ligjore të përcaktuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hapësirat e aseteve në mbrojtje janë duke u ngulfatur me ndërtime të reja në volume, forma dhe materializime të papërshtatshme. Ndërhyrjet restauruese dhe adaptuese të monumenteve dhe strukturave arkeologjike përfundojë me punime jocilësore, kryesisht me transformime negative të autenticitetit dhe pa kushte të përshtatshme për përdorim bashkëkohor.

Politikat për ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore përcaktohen dhe zhvillohen së bashku nga institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore (MKRS) dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor.[35] Institucionet përgjegjëse të trashëgimisë kulturore nuk kanë të publikuar politikat, programet apo ndonjë raport zyrtar për gjendjen dhe prioritetet të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Komunës Obiliqit. Njëherazi, nuk janë të publikuar ndonjë Listë zyrtare e Trashëgimisë Kulturore në Rrezik apo ndonjë plan për ndërmarrje të masave emergjentet të shpëtimit, ky detyrim i përcaktuar ligjor. Gjithashtu, mungon politika e lehtësirave fiskale që përcaktohet si masë ligjore e mbështetjes së financimit të trashëgimisë kulturore.[36]

3.7.2.5. Autoriteti i menaxhimit

Ministria e Kulturës dhe Departamenti i Trashëgimisë Kulturore si përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të trashëgimisë kulturore, ka krijuar inventarin interaktiv të trashëgimisë kulturore të ndërlidhur me Planin Hapësinor të Kosovës, hartat kadastrale dhe Planet Zhvillimore të Komunave.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Instituti Arkeologjik dhe Muzeu i Kosovës me Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Prishtinës, janë përgjegjës për inventarizim, dokumentim, vlerësim, përzgjedhje dhe propozimin e aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje. Aktivitetet e konservimit dhe restaurimit zhvillohen në përputhje me kritere dhe procedura të vendosur në legjislacionin e trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përcaktohet që, cilado ndërhyrje në asetet e

32 Sipërfaqja e Mbrojtur krijohet me qëllim kufizimi të ndërtimeve apo aktiviteteve të cilat mund të dëmtojnë veçoritë natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

33 Hulumtim Parlamentar - Zbatimi i Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qershor 2019

34 Data baza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës https://dtk.rks-gov.net

35 Ligji Nr.02/L-88 për trashëgimi kulturore. Neni 6.

36 Ligji Nr.02/L-88 për trashëgimi kulturore (Neni 5 dhe 6).

trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike bëhen në bazë të planit të miratuar dhe me leje formale nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Instituti Arkeologjik.

3.7.2.6. Mundësitë e rigjenerimit/ rikonstruimit/ rizhvillimit

Sipas analizës dhe vlerësimit të potencialit të trashëgimisë kulturore të Komunës së Obiliqit, peizazhi i sajë posedon pasuri kulturore tradicionale materiale dhe jo materiale të krijuar ndër breza e mileniume Në këtë kuadër përfshihen asete me vlera unike arkeologjike dhe arkitekturore, gjuha, ushqimi, traditat, ritualet, besimet, peizazhet, muzika tradicionale, lojërat, ngjarjet dhe performancat, folklori, artefaktet popullore, gojëdhënat dhe historia e vendit. Prandaj, ky kapital i çmuar me vlera dhe rëndësi shumëdimensionale, duhet ruajtur dhe zhvilluar përmes studimit, konservimit, mirëmbajtjes dhe adaptimit të mirëfilltë për zhvillim të turizmit kulturor vendor dhe ndërkombëtar.[37]

Trendët e reja të konservimit, padyshim ndihmojnë në progresin e zhvillimeve të qëndrueshëm afatgjatë të qytet, komunës dhe rajonit, kjo duke siguruar baraspeshe të ndjeshme ndërmjet nevojës njerëzore për të përmirësuar mënyrën e jetesës dhe mirëqenien, krahas ruajtjes të resurseve të trashëgimisë kulturore dhe të ekosistemit të territorit. Ndërsa, këto dy elemente janë baza themelore jetike për jetesën tonë dhe brezat pasardhës. [38]

Nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi krijojnë punësim dhe të hyra financiare të qëndrueshme kur ato janë të integruara si pjesë e një programi gjithëpërfshirës zhvillimor. Si rezultat i vlerësimit gjithëpërfshirës, elementet me vlera të përzgjedhur për ruajtje dhe mbrojtje, përfshihen në të gjitha planifikimet e zhvillimit hapësinor në zona urbane dhe rurale, kjo për ri-krijimin e identitetit urban dhe mjedisit jetësor të dinjitetshëm, me mundësi punësimi dhe të zhdukjes së varfërisë: si çështje me rëndësi thelbësore në vendin tonë dhe në Botë - qëllimi i Mileniumit. Përmes zhvillimit të aktiviteteve të rekomanduar, së bashku në partneritetit të vërtetë kolektiv, profesional dhe institucional, mund ta ruajmë dhe kultivojmë pasurinë tonë kulturore të trashëguar nga e kaluara, si një themel për jetesë të qëndrueshme, të dinjitetshme, të sigurt dhe paqësore.

3.7.3. Sfidave, gjetje kyçe, dhe supozime të pranuara, identifikimi I problemeve dhe konstatimet kryesore

3.7.3.1. Sfidat kryesore të aseteve të trashëgimisë kulturore

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës sociale janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e përcaktimit dhe menaxhimit të zhvillimeve brenda *Perimetrit* të *Zonës Mbrojtëse* të aseteve të trashëgimisë kulturore;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave të aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik;
- Mungesa e fondeve të mjaftueshme për restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore.

3.7.4. Gjetje kyçe dhe supozime të pranuara

Sa përket mbrojtjes ligjore, asetet e trashëgimisë kulturore nuk e kanë të përcaktuar:

- Kufirin e Perimetrit të monumenteve dhe Zonës Mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore nga MKRS; dhe
- Kufirin e Sipërfaqes së Mbrojtur nga MMPHI dhe kushtet zhvillimore brenda kësaj zone.

Sa përket mbrojtjes ligjore, asetet e trashëgimisë kulturore nuk e kanë të përcaktuar:

- Listën e aseteve të rrezikuara; dhe
- Plan afatgjatë të konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

3.7.5. Identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

Në planin hapësinor komunal të vitit 1988, çështjes së trashëgimisë kulturore i është dhënë një hapësirë e konsiderueshme. Në veçanti, vërehet një përpjekje për prezantimin korrekt të të gjitha kategorive të trashëgimisë kulturore, për të cilat me të drejtë ofrohen rekomandime dhe masa për trajtim adekuat të cilave fatkeqësisht u mungon realizimi.[39] Dhe së fundi, pas luftës së vitit 1999 autoritetet komunale fillojnë procesin e hartimit të dokumentit Plani Zhvillimor Komunal, i cili me pëlqim të MMPHI-së aprovohet në vitin 2009. Për nga aspekti i trajtimit të trashëgimisë kulturore, fatkeqësisht ky dokument paraqet një hap prapa. Në dokument nuk ka një prezantim të qartë të gjendjes momentale të TK dhe TN, nuk ka një synim të qartë dhe nuk ka as objektiva

[37] Convention on the Protection and Promotion of the Diversity of Cultural Expressions, UNESCO 2015.

[38] The Social and Economic Value of Cultural Heritage: literature review by Cornelia Dümcke and Mikhail Gnedovsky, EENC Paper, July 2013.

39Studimi_IPH_CHWB

të matshme që do të duhej të mbështeteshin nga masa, rekomandime, projekte ose edhe aktivitete specifike, në drejtim të ruajtjes së TK në komunë. Një konstatim i tillë pa dyshim se është rezultat i shumë faktorëve, nga të cilët më me ndikim mund të jenë:

- prioritizimi i çështjeve;
- vullneti i pamjaftueshëm politik;
- mungesa e të dhënave;
- mosnjohja e problematikës;
- buxheti i pamjaftueshëm;
- paqartësia në detyrimet vendimmarrësve e sektorëve të ndryshëm përgjegjës.

3.8. VENDBANIMET

Lashtësia, llojllojshmëria me tipologjinë gjenetike, fizionomike-morfologjike, funksionale dhe demografike e vendbanimeve, e bëjnë komunën e Obiliqit që të hyjë në radhën e hapësirave shumë interesante për hulumtim. Komuna e Obiliqit ka një spektër të gjerë tipash të vendbanimeve rurale. Ekzistimin e lokaliteteve të banuara e kanë kushtëzuar kushtet e përshtatshme natyrore (relievi, klima, hidrografia dhe kushtet tjera shoqërore), që kanë mundësuar dhe kanë lehtësuar komunikimet nëpërmjet popullsisë dhe civilizimeve. Kjo dëshmon për një vazhdimësi të një hapësire të banuar shekuj me radhë, si dhe ndërtim e zgjerim vendbanimesh të reja, me tipologji dhe cilësi që i përgjigjen kohës, kushteve dhe rrethanave të reja.

Si pasojë e shkatërrimeve nga luftërat, të cilat për pasojë patën rënien e numrit të popullsisë e si rrjedhojë të emigrimeve të herëpashershme, stagnime dhe rënie të numrit të popullsisë kanë pasur një numër i konsiderueshëm vendbanimesh. Duhet theksuar veçmas se ditë më ditë, disa nga vendbanimet, në aspektin fizionomik dhe morfologjik, janë duke u larguar nga tiparet e fshatit të dikurshëm patriarkal dhe duke marrë pamje që i përgjigjet kohës dhe kushteve të reja. Sot vërehen gërshetime ndërmjet asaj që ka trashëguar popullsia dhe së resë, që po e kërkon koha.

3.8.1. Vendbanimet sipas madhësisë dhe numrit të banorëve

Qyteti i Obiliqit ka një dendësi prej 548 banorëve/km2, ndërsa Raskova është në rendin e 656 banorëve/ km2, pasuar nga vendbanimet për-rreth qytetit.

Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit	Përshkrimi	Vendbanimet	Numri i vendbanimeve	% në raport me vendbanimet në tërësi
5,000-10,000 banorë	Vendbanim shumë i vogël urban	Obiliqi	1	5.56%
2,500 – 5,000 banorë	Vendbanim rural i madh	Mazgiti	1	5.56%
1,000-2,500 banorë	Vendbanim i mesëm i madh rural	Milloshevë, Breznicë, Kryshefc, Plemetin	4	22.22%
500-1,000 banorë	Vendbanim i mesëm rural	Sibovc, Leshkoshiq, Bakshi, Cërkvena Vodicë, Raskovë, Hade	6	33.33%
200-500 banorë	Vendbanim i vogël rural	Kozaricë, Baimofc, Shipitullë, Llazarevë	5	27.78%
<200 banorë	Vendbanim shumë i vogël rural	Hamidi	1	5.56%

Tabela 155. Klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë

Sa i përket dendësisë së banorëve për vendbanim vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë është në pjesën urbane, ku mesatarisht jetojnë rreth 548 banorë në një km², dhe në vendbanimin Raskovë, ku dendësia është rreth 656 banorë në një km².

Vendbanimet që në vitin 2011 kanë pasur më shumë se 500 banorë rezident renditen sipas tabelës:

Vendbanimi	Popullata 2011	Vendbanimi	Popullata 2022	Vendbanimi	Sipërfaqja (km2)	Vendbanimi	Dendësia(b/ha)
Obiliq	6864	Obiliq	4758	Breznicë	14.30	Raskovë	656
Mazgit	1886	Mazgit	3139	Obiliq	12.53	Obiliq	548
Breznicë	1871	Milloshevë	2082	Grabofci i Epërm	8.60	Mazgit	295
Milloshevë	1819	Plemetin	1268	Baimofc	8.02	Bakshi	295
Plemetin	1381	Breznicë	1230	Sibovc	7.49	Milloshevë	248

Kryshefc	1053	Sibovc	819	Milloshevë	7.33	Plemetin	241
Sibovc	963	Llazarevë	751	Carravodicë	7.11	Llazarevë	204
Carravodicë	733	Raskovë	687	Kryshefc	6.63	Leshkoshiq	191
Leshkoshiq	703	Bakshi	648	Mazgit	6.39	Kryshefc	159
Raskovë	640	Cërkvena Vodicë	646	Plemetin	5.73	Breznicë	131
Bakshi	602	Kryshefc	637	Hade	4.90	Sibovc	128
Hade	534	Leshkoshiq	597	Leshkoshiq	3.68	Hade	109

Tabela 156. Kategorizimi i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë 2011 dhe 2022, sipërfaqes totale dhe dendësisë së popullsisë

3.8.2. Vendbanimet sipas funksionalitetit dhe rrjetit ndërlidhës

Brenda përbrenda territorit të komunës ka ende fshatra, sidomos ato në veri të Obiliqit të cilat nuk kanë lidhje të mira me qendrën. Atje kemi të bëjmë kryesisht me rrugë të paasfaltuara.

Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban. Në këtë mënyrë banorët e qytetit janë të varur nga transporti individual. Një vështirësi shtesë këtu paraqet edhe rrjeti i rrugëve dhe shtigjeve të cilat nuk janë të përshtatshme për këmbësorë dhe çiklistë.

Në fshatra dhe regjion ekzistojnë disa vija autobusësh të cilat u ofrojnë shërbime transporti qytetarëve. Problem i theksuar në transportin e udhëtarëve është edhe operimi joformal i kombibusëve në linjat ndër-urbane.

3.8.3. Vendbanimet sipas llojit dhe lartësisë mbidetare

Zhvillimi i vendbanimeve në komunën e Obiliqit është i lidhur me karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit, ku vërehet se numri më i madh i vendbanimeve, 35.29% gjenden në zonën fushore me lartësi mbidetare 500-550.

Pjesa tjetër prej 35.29% shtrihen në zonën e mesme me lartësi mbidetare prej 550-600.

Ndërsa vendbanimet tjera, gjenden në zonën kodrinore-malore me lartësi mbidetare mbi 600-700, karakterizohen si vendbanime të shpërndara për shkak të konfiguracionit të terrenit, si dhe me zhvillim mjaft të ulët demografik, ekonomik e social.

Në pjesën e rrafshët, vendbanimet kryesisht janë të zhvilluara në mënyrë gjatësore përgjatë rrugëve lokale, por edhe magjistrale, duke formuar kështu korridore të dendura ndërtimesh.

3.8.4. Raporti në mes të sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara[40]

Raporti në mes të sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara brenda vendbanimeve të Komunës tregon pjesa dërmuese e tyre është shpërndarë dhe nuk janë kompakte. Nga të gjitha vendbanimet, përqindjen më të lartë të sipërfaqeve të ndërtuara në kuadër të vendbanimit e ka Raskova me 15.03%, pastaj Kryshefci me 12.23%, pasuar nga Baimofci me 8.90%.

Vendbanimi	Sipërfaqja e zonës kadastrale	Sipërfaqja e vendbanimit	Sipërfaqja e ndërtuar	% e sipërfaqes së ndërtuar
Raskovë	97.54	23.95	3.6	15.03%
Kryshefc	663.77	92.19	11.27	12.23%
Baimofc	802.79	92.50	8.23	8.90%
Carrovodicë	711.28	113.65	9.95	8.76%
Bakshi	204.41	42.30	3.25	7.68%
Obiliq	1,253.55	561.15	42.7	7.61%
Hade	491.05	43.69	3.25	7.44%
Llazarevë	210.69	52.14	3.81	7.31%
Mazgit	639.77	189.47	13.42	7.08%
Shipitullë	296.11	36.14	2.3	6.36%
Milloshevë	733.68	199.49	11.04	5.53%
Leshkoshiq	368.36	59.36	3.27	5.51%
Grabofc	860.36	33.50	1.77	5.28%
Plemetin	573.18	168.93	8.89	5.26%
Hamidi	173.52	20.42	0.83	4.07%
Sibovc	749.98	110.92	4.45	4.01%
Breznicë	1,431.05	246.23	7.25	2.94%

[40] Tabelat vijuese paraqesin raportin mes sipërfaqes së ndërtuar dhe të pa ndërtuar brenda Kufirit Ndërtimor.Këtu përjashtohet toka bujqësore.

Tabela 157. Raporti i sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pandërtuara në kuadër të vendbanimeve

3.8.5. Zona urbane

Qyteti i Obiliqit është krijuar si rezultat i zhvillimeve industriale në komunë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në zonën urbane. Qyteti për nga morfologjia është me zhvillim të tipit të shpërndarë dhe i përgjigjet karakteristikave të përgjithshme të vendbanimeve në Kosovë, jo kompakt dhe paksa linear, pasi kryesisht shtrihet përgjatë korridorit Prishtinë- Mitrovicë.

Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në komunë në periudhën e fundit, e kanë gjetur të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që ka sjell rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Një nga arsyet kryesore ka qenë lëvizja e lirë e njerëzve, e cila solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kritere urbanistike, duke krijuar kështu zona joformale. Në këto zona bëhet i vështirë disiplinimi i ndërtimeve dhe krijohen vështirësi të mëdha në lidhje me infrastrukturën teknike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefon, etj.). Kështu, nga një zhvillim i planifikuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme. Ndërtimet pa kritere të përcaktuara urbane e kanë rënduar dhe dëmtuar infrastrukturën dhe kanë zbehur mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen.

Zona urbane ka pasur një zgjerim të pakontrolluar, përgjatë korridoreve kryesore dhe segmenteve ndërmjet, duke krijuar në zonën urbane: hapësirën funksionale urbane dhe hapësirën periferike urbane. Hapësira funksionale edhe më tej vazhdon të ketë intensitet të ulët zhvillimor, kurse hapësirat periferike urbane zgjerim me intensitet të ulët. Fatkeqësisht, shkaku i shumë kufizimeve hapësinore ligjore mbi tërë hapësirën në komunë të Obiliqit, vetëm 40% e territorit të komunës është i lirë/ pa kufizime për të zhvilluar tutje. Pjesa tjetër janë në kontroll të zhvillimit, si mihjet, toka nën komasacion, etj.

3.8.5.1. Zhvillimi historik i zonës urbane ndër vite

Komuna e Obiliqit ka qenë territor i veçantë qysh gjatë kohës së sundimit turk. Diku nga viti 1873 njihet si qendër gjeostrategjike e Rrafshit të Kosovës. Me parë Kastrioti quhej Globoder. Në vitin 1912 emërohet Obiliq. Statusin e komunës e kishte gjithashtu pas Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore, deri në vitin 1962, kur përfshihet në kuadër të komunës së Prishtinës. Më 27 nëntor 1989 prapë konstituohet si Komunë. Më 1999, me vendim të Këshilli Komunal, është formuar Komisioni për Emërtimin e Vendbanimeve, me të cilin vendim qyteti i Obiliqit emërohet në Kastriot.[41]

3.8.5.2. Lagjet urbane

Në zonat për të cilat nuk ekzistojnë planet urbanistike, banimi po përcillet me probleme serioze. Raporti në mes të banimit në ndërtesat- shtëpi dhe atij në ndërtesat- banesa në komunën e Obiliqit është: rreth 70 % banim individual (në ndërtesat me një njësi) dhe 30 % banim kolektiv (në ndërtesat me shumë njësi). Një raport i tillë, që është për një nuancë më i favorshëm se mesatarja e Kosovës, po ndikon në mënyrë direkte në humbjen e tokës kualitative bujqësore. Mungesa e planeve dhe pamundësia e organeve komunale për tu përgjigjur në kërkesa të shumta për ndërtim po ndikon në shfrytëzimin e pa racionalizuar të tokës. Shpërndarja e banimit në distanca të mëdha në hapësirë pamundëson që qytetarët të kenë qasje të kënaqshme në shërbime publike (infrastrukturë, shkollë, ambulantë, etj).

3.8.6. Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia

Rrjeti i vendbanimeve rurale në komunën e Obiliqit paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në komunën e Obiliqit, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Territori i komunës së Obiliqit karakterizohet me numër të madh vendbanimesh për njësi sipërfaqesh. Ky numër vendbanimesh është i koncentruar në një sipërfaqe prej 106.77 km2, në të cilën gjenden 18 zona kadastrale, nga të cilat 17 janë rurale dhe një urban- Obiliqi. Madhësia mesatare e vendbanimeve në vitin 1981 ishte 6 km2 (ndaj 7,5 të mesatares së Kosovës) dhe me numër mesatar të popullsisë për një vendbanim prej 1478 banorë, që ishte me e madhe se mesatarja e Kosovës 1445. Për arsye të rritjes së numrit të popullatës (shkalla e lartë e natalitetit, migrimi), qytetit i nevojiteshin hapësira të reja banimi. Kjo kërkesë theksohet sidomos me shkatërrimet e bëra gjatë luftës. Si rrjedhojë, në vitet e fundit qyteti është zgjeruar (rritur) dhe rindërtuar shumë.

3.8.7. Trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat

Trendi i zhvillimeve dëshmon që e gjithë komuna e Obiliqit është zhvilluar në mënyrë të pa kontrolluar. Zona urbane ka pasur koncentrim më të madh të ndërtimeve, ndërkohë që në zonat rurale zhvillimi ka qenë i shpërndarë në të gjithë territorin dhe

[41] Kastrioti, Wikipedia. https://sq.wikipedia.org/wiki/Kastrioti

rrjedhimisht i pa balancuar. Intensitet më të madh zhvillimi dhe më të shpërqendruar kanë pësuar në veçanti vendbanimet përreth zonës urbane.

Zhvillimi i shpërqendruar ka ndodhë për shkak të presionit të madh për ndërtim në qytetin e Obiliqit, gjë që ka ndikuar që ndërtimet të kalojnë përtej kufirit aktual të zonës urbane në vendbanimet përreth. Në këtë mënyrë, vendbanimet Plemetin, Mazgit i Ulët dhe Dardhishte pothuajse janë bashkëngjitur me zonë urbane duke marr parasysh shkallën e zhvillimit.

Me rastin e hulumtimit të gjendjes ekzistuese gjatë hartimit të Profilit komunal janë evidentuar vendbanimet me potencial të zgjerimin dhe në hartimin e vizionit për zhvillimin e komunës është trajtuar edhe tema e zgjerimit të vendbanimeve. Vendbanimet ku nuk parashihet zgjerim të hapësirës banuese në shtrirjen e tyre territoriale sugjerohet që zhvillimet eventuale të orientohen drejt densifikimit, kompaktësimit të strukturës fizike.

Në mungesë të planeve rregulluese, nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative-sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike, etj.

Shumica e problemeve në menaxhimin dhe planifikimin e hapësirës territoriale manifestohet për shkak të:

- Mungesës së planeve rregulluese;
- Mungesa e standardeve urbane të avancuara;
- Menaxhim i dobët i hapësirës territoriale në komunë;
- Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakontrolluar i qytetit.

3.8.8. Depopullimi i vendbanimeve

Depopullimi është proces kompleks që po vazhdon në territorin e Kosovës, kryesisht në zonat kodrinore malore me lartësi të madhe mbidetare etj. Kjo dukuri është prezente edhe në komunën e Obiliqit e më e theksuar është në vendbanimet të cilat janë më larg nga qendra e qytetit. Kjo ndodh për shkak të kushteve të vështira që mbretërojnë në këto vendbanime, kushte që krijohen nga faktorët natyror, ekonomik, social, infrastruktura e pazhvilluar, niveli i ulët i shërbimeve, etj.

Depopullimi më i madh ka ndodhur në qytetin e Obiliqit, në Dardhishtë (Krushevc) dhe në Hade, pas vitit 1999. Arsye kryesore për depopullim është shpërngulja e popullsisë jo shqiptare posaçërisht popullsisë serbe pas vitit '99. Ndërsa sa i përket vetëm popullsisë shqiptare, depopullimi është shfaqur më shumë në këto vendbanime : Hade, Krushevc, Grabofc, Bakshi dhe Kozaricë.

Për shkak të koncentrimit më të madh të veprimtarive ekonomike, si atyre industriale dhe shumë veprimtarive tjera në Obiliq, të cilat janë më atraktive për numrin e madh të të papunësuarve në fshatra që në rrethanat e futjes së mekanizimit në bujqësi mbesin pa punë. Rrjedhimisht, rrethanat ekonomiko- sociale ndikuan në lëvizjen e popullsisë drejt qendrave urbane, duke u shndërruar nga migrues ditor e javor në migrues të përhershëm.

3.8.9. Zgjerimi i vendbanimeve

Me rastin e hulumtimit të gjendjes ekzistuese gjatë hartimit të Profilit komunal janë evidentuar vendbanimet me potencial të zgjerimit dhe në hartimin e vizionit për zhvillimin e komunës është trajtuar edhe tema e zgjerimit të vendbanimeve. Zgjerimi i vendbanimeve është përkufizuar në hartë. Vendbanimet ku nuk parashihet zgjerim të hapësirës banuese në shtrirjen e tyre territoriale sugjerohet që zhvillimet eventuale të orientohen drejt densifikimit, kompaktësimit të strukturës fizike.


Zgjerimi i vendbanimeve para së gjithash duhet të bazohet mbi parimet e densifikimit, shfrytëzimit racional të tokës dhe mbrojtjes së tokës bujqësore.

VENDBANIMI ku nevojitet zgjerimi	VENDBANIMI ku nevojitet kompaktësimi
Qyteti	Qyteti
Plemetin	Mazgit
Mazgit	Milloshevë
Milloshevë	Llazarevë
Kryshefc	
Hade e Re	


Tabela 158. Vendbanimet që parashihet të zgjerohen dhe ato që parashihet të kompaktësohen

Vendbanimet e përcaktuara për zgjerim janë vendbanime të cilat ky koncept I parasheh si vendbanime me potencial zhvillimi. Këtu hyn zona urbane, Qyteti, vendbanim I cili ka potencialin me të madh për rritje. Gjithashtu, të gjitha këto vendbanime tregojnë rritje të trendit të popullsisë në projeksionet e demografisë, çka çon në kërkesë për rritje edhe të kufijve ndërtimor. Për më shumë, këto vendbanime do të pranojnë banorët e zhvendosur nga zonat e mihjeve, që rritë kërkesën për banim dhe zhvillim të tyre.

Vendbanimet e përcaktuara për kompaktësim janë vendbanime të cilat ky koncept I parasheh si vendbanime që duhet të dendësohen dhe plotësohen edhe brenda kufijve të tyre ndërtimor në mënyrë që të arrihet kompaktësimi I tyre. Këto janë parë si vendbanime të shpërndara dhe me hapësira që kanë mundësi të plotësohen.



Harta 57 Vendbanimet qe i nënshtrohen zhvendosjes nga zgjerimi i minierave te linjitit



Harta 58 Zonat qe kufizojnë zhvillimet e ndërtimeve

3.8.10. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

3.8.10.1. Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e lidhjes së mire mes zonës urbane me vendbanimet më të largëta;
- Qasja e dobët nga hapësirat periferike urbane në hapësirën funksionale urbane;
- Mungesa e qasjes në infrastrukturë teknike-ujësjellës e kanalizim në një numër të madh të vendbanimeve;
- Mungesa e infrastrukturës përkatëse si dhe shpërndarja jo e balancuar e infrastrukturës publike dhe sociale;
- Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban;
- Numër i lartë i ndërtimeve pa leje, që duhet integruar dhe urbanizuar;
- Zhvillime të paplanifikuara me mungesën konsekuente të shërbimeve dhe hapësirave të gjelbër publike ;
- Morfologji dhe strukturë urbane jo konsistente në hapësirat periferike urbane;
- Mungesë e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në hapësirat periferike urbane;
- Zgjerime të mëdha me densitet të ulët të cilat konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar;

3.8.10.2. Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara

- Qyteti i Obiliqit paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për gjithë territorin e komunës.
- Qyteti i Obiliqit i takon tipit të shpërndarë të vendbanimeve, me sipërfaqe të ndërtuar prej 95.4 apo 32.45% nga e gjithë sipërfaqja e zonës urbane. Nëse e analizojmë madhësinë e parcelave në zonën urbane, atëherë del se kemi të bëjmë më një territor mjaft të fragmentuar ku shumica e parcelave, nuk janë më të mëdha se 3 ari.
- Shumica e vendbanimeve janë të tipit të shpërndarë (14) me dendësi të ulët të banimit, dhe mungesë të infrastrukturës, pastaj ato të tipit linear (2), që janë vendbanime të zhvilluara për-rreth rrugëve kryesore të komunës, dhe në fund në një

numër të vogël vendbanimet e koncentruar (2), e që tregon drejtë për drejtë mungesën e një planifikimi të mirëfilltë para zhvillimit të vendbanimeve.

- Kjo shpërndarje e banimit brenda vendbanimeve ka rezultuar edhe me një dendësi të ulët apo mesatare tek shumica e vendbanimeve, me përjashtim të zonës urbane dhe vendbanimeve rreth saj, që vjen si rezultat i kërkesave të shumta për banim për shkak të zbrazjeve të vendbanimeve rurale drejt zonës urbane.
- Obiliqi karakterizohet kryesisht si zone e rrafshe, duke u ndarë në atë fushore dhe malore, me lartësi mbidetare nga 500 deri në 750m.
- Edhe karakteri ekonomik në komunë mund të themi se në një masë dirigjohet nga relievi. Zona qendrore që përfshinë zonën urbane me vendbanimet për-rreth zhvillojnë aktivitete të ndryshme ekonomike industriale; një pjesë zhvillon bujqësi, kjo për shkak të tokës së kualitetit të lartë.
- Duke parë trendet e numrit të popullsisë sipas regjistrimeve të ASK-së deri na vitin 2011, por edhe projeksione të popullsisë, del se popullsia e Obiliqit është kryesisht në rënie me përjashtim të disa vendbanimeve ku ka rritje(shih tabelën).

Tabela më poshtë jep në detaje për secilin vendbanim karakteristikat kryesore të tyre, prej nga edhe bazohen gjetjet.

Vendbanimi	Kategori e rendit hapësinor[42]	Morfologjia hapësinore[43]	Dendësia ndërtimore[44]	Reliefi[45]	Identiteti ekonomik[46]	Klasifikimi i vendbanimit
Obiliq	Hapësirë Urbane	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 500-600	I përzier	Qendër e rendit të lartë
Baimofc	Hapësirë Rurale	Linear	Mesatare	I rrafshit- 530-600	Bujqësor	Qendër bazike
Bakshi	Hapësirë Rurale	Linear	Mesatare	I rrafshit- 500-550	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Breznicë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	I përzier- 600-750	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Cërkvena Vodicë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E lartë	I rrafshit- 550-600	Industrial	Qendër e rendit të ulët
Dobrosellë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 500-550	I përzier	Qendër bazike
Grabofci i Epërm	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I përzier- 550-800	I përzier	Qendër e rendit të mesëm
Hade e Re	Hapësirë Rurale	I koncentruar	Mesatare	I rrafshit	/	Qendër e rendit të mesëm
Hamidi	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E lartë	I rrafshit- 550-600	I përzier	Qendër bazike
Kryshefc	Hapësirë Rurale/ Hapësirë e zgjeruar urbane	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 530-570	I përzier	Qendër e rendit të ulët
Leshkoshiq	Hapësirë Rurale	I koncentruar	E ulët	I rrafshit- 550-600	Industrial	Qendër bazike
Llazarevë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 500-600	I përzier	Qendër bazike
Mazgit	Hapësirë Rurale/ Hapësirë e zgjeruar urbane	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 550-600	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Milloshevë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit- 500-550	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Plemetin	Hapësirë Rurale/ Hapësirë e zgjeruar urbane	I shpërndarë	Mesatare	I rrafshit- 500-550	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Raskovë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	I rrafshit- 500-550	Bujqësor	Qendër bazike
Shipitullë	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E lartë	I përzier - 650-700	Industrial	Qendër bazike
Sibovc	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	I përzier- 550-600	Industrial	Qendër e rendit të ulët

Tabela 159. Kategorizimet e vendbanimeve

3.8.11. Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet - Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Zonë kompakte urbane;**	▪ Vendbanime të zhvilluara në formë korridoresh;

[42]Hapësirë rurale, qendër e zhvillimit rural, hapësirë urbane dhe hapësirë e zgjeruar urbane, sipas 6.1.4. Kategori e rendit hapësinor nga Kodi Hierarkik i Rregullimit Plotësues.

[43]Linear, i koncentruar, i shpërndarë.

[44] E lartë, mesatare, e ulët (0-7%, 7-10%, >10%).

[45] Malor, i rrafshit, i përzier.

[46] Bujqësor, shërbime, përzier, tjera.

▪ **Infrastruktura teknike bazike relativisht e mirë e vendbanimeve në përgjithësi;** ▪ **Ndërlidhje e mirë e vendbanimeve me qendrën e Obiliqit;** ▪ **Qasja e mirë e vendbanimeve në shërbime komunale;** ▪ **95 % e banimit në pronë private, pa konteste pronësore;** ▪ **Programi 3 vjeçar i banimit;** ▪ **Banim relativisht i ri** ▪ **Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore**	▪ Zhvillime të shpërqendruara jashtë zonës urbane ▪ Humbja e tokës bujqësore për shkak të zgjerimit të vendbanimeve; ▪ Parcelimi i madh i pronave në zonën urbane dhe rurale; ▪ Inspektimi i ulët i ndërtimeve; ▪ Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore ▪ Krijimi i korridoreve të zonave ekonomike në mënyrë të pa kontrolluar ▪ Mungesa e politikave lokale për banim të përballueshëm; ▪ Mungesa e politikave lokale për banim social të integruar.
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ **Dendësimi i planifikuar i vendbanimeve ekzistuese në bazë të planeve hapësinore-veçanërisht në fshatra dhe në zonat sub-urbane;** ▪ **Hartimi i politikave nga niveli qendror për banim të përballueshëm;** ▪ **Potenciali i sektorit privat për banim.**	▪ Migrimi i popullsisë fshat – qytet. ▪ Mungesa e dokumentacionit kadastral. ▪ Marrëdhënie jo bashkëpunuese me komunën fqinje

Tabela 160. Analiza SWOT për vendbanimet

3.9. Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje

Në komunën e Obiliqit, sipas raportit të ministrisë, kanë qenë të identifikuara gjithsej tetë vendbanime joformale, prej të cilave gjashtë janë trajtuar deri më tani.

Vendbanimet e trajtuara janë:

Kampi i Plemetinit

Më nuk ekziston, janë ndërtuar dy objekte kolektive të destinuara për këta banorë. Janë vetëm tri baraka, të cilat gradualisht do t'iu bëhet zgjidhja përmes zyrës për minoritete me donacione të IOM dhe Ministrisë për Minoritete dhe Kthim.

Azotiku

Të dhënat në PZHUK 2009-2020 nuk qëndrojnë në këtë lagje për arsye se kanë largësi të konsiderueshme nga TC A, e po ashtu infrastruktura është e rregulluar në tërësi, tani nuk ekziston ky objekt, është rrënuar, do të ndërtohet park.

Janina Voda

Kjo pjesë tani nuk konsiderohet si vendbanime joformale, për arsye se çështja pronësore është e rregulluar dhe infrastruktura është e kompletuar, në këtë pjesë është ndërtuar edhe një park.

Fshati Plemetin

Në fshatin Plemetin prej një sipërfaqe prej 21 hektar ku kanë qenë të evidentuara 500 shtëpi, nuk qëndron më, janë vetëm 2 kontejner dhe dy familje në to.

Lagjja Obiliq i Ri

Nuk ekzistojnë më baraka dhe gjendja është e përmirësuar.

Lagjja në fshatin Baimofc

Kjo pjesë nuk hynë në vendbanimet joformale, për arsye se gjendja është e mirë e me infrastrukturë të kompletuar.

Tash në komunën e Obiliqit janë të identifikuara dy lokacione si vendbanime joformale. Vendbanimi joformal lagjja e Subotiqëve karakterizohet përmes çështjes së pazgjedhur pronësore, edhe me mungesën e një infrastrukture bazë dhe një pjesëmarrjeje të pamjaftueshme në vendim marrje, ndërsa Fshati Kryshefc është vendbanim afër zonës urbane, afër Termocentralit Kosova A, afër deponisë regjionale të Mirashit, si dhe ish deponive, të gjithë banorët e këtyre vendbanimeve gëzojnë qasja adekuate në shërbime elementare, pjesëmarrje adekuate në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi.

DRAFT

Nr.	VBIF	Sipërfaqja / ha	Nr. i shtëpive	Nr. i banorëve	Infrastruktura fizike	Infrastruktura sociale	Prona	Gjendja	Prioritetet
1	Lagjja e Subotiqëve	21	30	300	Jo	Jo	Shoqërore	Jo e mirë	Po
2	Fshati Kryshefc (Dardhishtë)	16	300	1500	Pjesërisht	Pjesërisht	Private	Jo e mirë	Po

Tabela 161. Vendbanimet aktuale joformale dhe karakteristikat e tyre

3.9.1.1. Shtrirja hapësinore




Figura 1. Vendbanimi joformal Lagja e Subotiqeve

Vendbanimi joformal Kryshec



Figura 13. Vendbanim joformal- Kryshefc

Prona e shenjuar me ngjyrë të verdhë/Lagjia e Subotiqëve është nën menaxhimin e AKP-së, p.sh.. KOMBINATI NDËRTIMOR "RAMIZ SADIKU". Komuna ka iniciuar procesin mes Kombinatit Ndërtimor dhe banorëve si shfrytëzues për zgjidhjen e çështjes së pronësisë.

3.9.1.2. Karakteristikat dhe Numri i banorëve

Këto vendbanime joformale karakterizohen me :

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë në Lagjen e Subotiqëve,
- Shërbimet joadekuate të infrastrukturës teknike dhe sociale, si dhe
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje.

Numri i banorëve :

- Lagja Subotiqëve : Në total ka 300 banorë.
- Lagja Kryshefc : Në total ka 1500 banorë.

3.9.1.3. Gjendja ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendbanimeve joformale të identifikuara

Komuna e Obiliqit ka identifikuar dy lokacione si vendbanime joformale, çështja pronësore në lagjen Kryshefc është e zgjidhur pra e gjitha është private vetëm në lagjen e Subotiqëve çështja pronësore mbetet e pazgjidhur pasi që ajo është pronë Shoqërore në pronësi të kombinatit "Ramiz Sadiku", mungesa e një infrastrukture bazë dhe një pjesëmarrjeje të pamjaftueshme në vendimmarrje, gjersa të gjithë banorët e këtyre vendbanimeve gëzojnë qasja adekuate në shërbime elementare, pjesëmarrje adekuate në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi.

Për të rregulluar çështjen pronësore të vendbanimit joformal në lagjen e Subotiqëve nevojitet koordinim në mes banorëve të VJF-së, autoriteteve dhe përfaqësuesve të pronës, bazuar në ligjet në fuqi deri në trajtimin përfundimtar dhe njohjen e pronësisë për banorët e VJF-së.

3.9.2. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore.

3.9.2.1. Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

- Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale që do të duhej të jete komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate të rregullimit të vendbanimeve joformale.
- Mungesa e detyrimeve ligjore për institucionet përgjegjëse te niveleve te ndryshme
- Mungesa e legjislacionit qe do te i obligonte banoret e vendbanimeve joformale qe te iniciojnë rregullimin e statusit pronësor të tyre.
- Mungesa e fondeve komunale për rregullimin e infrastrukturës teknike dhe sociale në vendbanimet joformale
- Shumë vendbanime joformale përcillen nga mungesa e dukshme në pjesëmarrje në qeveritë lokale dhe vendimmarrje.
- Mungesa e qasjes në infrastrukturë themelore si dhe mungesa e qasjes në shërbime sociale është gjithashtu tipar i njohur në shumë nga vendbanimet e identifikuara joformale, gjë që i lë banorët të jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme.

3.9.2.2. Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara


- Drejtoria e Urbanizmit të qytetit të Obiliqit ka vendosur që për hulumtimin e vendbanimeve joformale të marrë dy vendbanime karakteristike, për kah krijimi, përbërja etnike dhe gjendja fizike e tyre.
- Që të dy këto vendbanime joformale përfshijnë një sipërfaqe prej 37ha, një numër të shtëpive prej 330 si dhe numër të banorëve 1,800.
- Çështja e pronës në lagjen e Subotiqëve është Shoqërore në pronësi të kombinatit "Ramiz Sadiku".
- Që të dy vendbanimet karakterizohen përmes mungesës së një infrastrukture bazë dhe një pjesëmarrjeje të pamjaftueshme në vendimmarrje.
- Gjendja sociale – ekonomike paraqitet kritike, ku shkalla e varfërisë dhe papunësisë është e lartë.

Përparësitë	Dobësitë
▪ Identifikimi i VBJ ▪ Teren i përshtatshëm për ndërtim ▪ Identifikimi i ndërtimeve pa leje 2004-2018, posedimi i tyre në data-bazë ▪ Infrastruktura teknike bazike relativisht e mirë e vendbanimeve në përgjithësi; ▪ Qasja e mirë e vendbanimeve në shërbime komunale	▪ Çështja pronësore e pa zgjidhur për lagjen e Subotiqëve ▪ Mungesa e infrastrukturës rrugore ▪ Mungesa e infrastrukturës sociale ▪ Mungesë e transportit publik
Mundësitë	**Kërcënimet**
Rregullimi i çështjes së pronësisë Ofrimi i infrastrukturës rrugore Zgjidhja e transportit publik	Implikime pronësore Implikime buxhetore Tej zgjatja e procedurave ligjore në raport të ndërtimeve pa leje

Tabela 162. Analiza SWOT për vendbanimet joformale

3.9.3. Ndërtimet pa Leje

Numri më i madh i ndërtimeve pa leje të identifikuara shtrihen në zonat kadastrale Obiliq, Mazgit, Plemetin dhe Milloshevë.



Harta 59. Shpërndarja e ndërtimeve pa leje në komunën e Obiliqit

3.10. BANIMI

Bazuar në vlerësimin e Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) 2010-2020+, ekziston sipërfaqe banimi prej 18,65 m^2 për kokë banori ndërsa madhësia mesatare e familjes është 6.5 anëtare për familje. Plani raporton se 93,7% e sipërfaqes ekzistuese të banimit është i zënë me banim individual dhe 6,23% nga banimi kolektiv. Sigurimi i sipërfaqes së mjaftueshme të banimit është një nga sfidat kryesore të identifikuar nga PZHK-ja. Në Komunën e Obiliqit nga sipërfaqja ekzistuese për banim, gjejmë 11.44% banim kolektiv dhe 88.56% individual. Me një zgjerim shumë pasiv të fondit publik të banimit, fondi i banimit është duke u zgjeruar kryesisht nga sektori privat; dhe shpesh karakterizohet me parregullsi dhe mungesë të kritereve. Andaj, janë identifikuar problemet dhe potencialet në sektorin e banimit.

Zona Kadastrale	Kategoria e shfrytëzimit	Numri	Sipërfaqja (m^2)	Përqindja
Zona Urbane	Apartament	633	27954	28,71%
	Shtëpi	1572	140869	71,29%
Zona Rurale	Apartament	24	2619	0,60%
	Shtëpi	3982	364363	99,40%
Total		6211	535805	

Tabela 163 Të dhënat për numër dhe sipërfaqe të banimit[47]

[47] Burimi: Lista e tatimpagueseve te TP VITI 2019

3.10.1. Fondi i banimit

Për të analizuar sipërfaqen e shfrytëzuar për banim në kuadër të sipërfaqes së ndërtuar në komunën e Obiliqit, janë marrë për bazë vetëm objektet, pa infrastrukturën rrugore dhe kjo ka rezultuar se 82% e strukturave të ndërtuara në Obiliq janë të destinuara për banim.

Tabela 164.Numri i ndërtesave të banimit në zonë urbane dhe rurale

Tipi i vendbanimit	Gjithsejtë	Shtëpi e veçuar, e ndarë në vete	Shtëpi gjysmë e ndarë	Rresht apo varg shtëpish	Ndërtesë ose blloqe apartamentesh	Tjetër
Urban	945	845	50	16	33	1
Rural	2,427	2,377	21	25	1	3
Gjithsejtë	3,372	3,222	71	41	34	4

Tabela 165.Numri i ndërtesave të banimit në zonë urbane dhe rurale[48]

Në bazë të analizës së shfrytëzueshmërisë së tokës, por edhe të vetë ndërtimeve në komunën e Obiliqit, është evidente se banimi i ulët përbën pjesën më të madhe të të gjithë sektorit të banimit. Kjo tendence është në rënie viteve të fundit, ku kërkesa për banim është më shumë e orientuar në banim të lartë. Mirëpo sa i përket numrit të njësive të banimit, profili komunal i referohet regjistrimit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011, dhe listës së tatim paguesve të vitit 2019. Bazuar në të dhënat e ASK-së[49], del se komuna e Obiliqit në vitin 2011 ka 21,549 banorë të cilët jetojnë në 3,915ekonomi familjare, 1,272 prej të cilave janë në zonën urbane ndërsa 2,645 në zonën rurale.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të popullsisë nga po ky burim, ASK vlerëson së Obiliqi në vitin 2019 ka 17,889 banorë.

Sipas ASK 2013 "*Banesat dhe Ndërtesat Sipas Komunave*" numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Kosovë është 412.884, prej të cilave 175.942 (43%) janë në zonën urbane, ndërsa 236.942 (57%) në zonë rurale. Në komunën e Obiliqit, sipas ASK 2013, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 5457që përbën rreth 1% të numrit të përgjithshëm të njësive të banimit në Kosovë. Ndërsa, sipas listës së tatim paguesve 2019, në komunën e Obiliqit kemi 6211 njësi banimi, nga të cilat 2205 në zonën urbane dhe 4006 në zonën rurale. Njësitë e banimit janë të ndara rreth 35% në zonë urbane dhe rreth 65% asaj rurale.

Numri i banorëve		Ekonomitë familjare	Njësitë e banimit	Ndërtesat e banimit		
	Nr.	Nr.	Nr.	Tipologjia	Nr.	%
Komuna e Obiliqit	21,549	3,915	5457 (100%)	ndërtesa banimi me një njësi	4801	87.98%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	656	12.02%
Zona urbane	6,864	1,272	1831 (33.55%)	ndërtesa banimi me një njësi	510	27.85%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	1321	72.15%
Zona rurale	14,685	2,645	3644 (66.77%)	ndërtesa banimi me një njësi	21	0.58%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	3623	99.42%

Tabela 166. Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kapitulli për demografi- trendet dhe prognozat demografike), deri në vitin 2030, në krahasim me vlerësimet dhe projeksionet për vitit 2022, parashikohet të kemi rritje të popullsisë në zonën urbane nga 4,802 në 5,171 banorë, pra diferenca 369 banorë; si dhe në zonën rurale nga 13,904 në 14,408 banorë, me diference prej 504 banorë.

3.10.2. Nevojat për banim

Varësisht prej skenarëve potencialë për zhvillimin e Obiliqit jepen edhe projeksionet e mundshme të fondit të nevojshëm për banim të popullsisë së Obiliqit.

Projeksionet e duhura për banim, janë ndërtuar mbi skenarin më realist që është edhe skenari më i mundshëm për të ndodhur. Sipas kësaj Obiliqi në vitin 2030 supozohet të shkojë në një popullsi rreth 19,578 banorë, ndërkohë që zona urbane në 5,171 banorë.

Presupozohet që rreth 70% e sipërfaqeve ndërtimore të jetë banim me një njësi, ku sipërfaqja e banimit për banor është tendencialisht më e madhe sesa sipërfaqja ndërtimore në një banim me shumë njësi, i cili supozohet të përbëjë rreth 30% e fondit ndërtimor. Bazuar në këtë arsyetim është simuluar shpërndarja e sipërfaqeve ndërtimore aktualisht në Komunën e Obiliqit, sipas të cilës mesatarja e banimit për frymë (bruto) vendoset diku mes 45-50 m^2.

[48] Burimi: Banesat dhe ndërtesat sipas komunave, ASK 2013

[49] ASK, vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2020

	Popullsia (banorë)	Banim me një njësi (m^2)	Banim me shumë njësi (m^2)	TOTAL
Urbane	4 802	70589,4	30252,6	100842
Rurale	13 904	347 600		347 600
TOTAL	18 705	418 189	30 253	448 442

Tabela 167 Simulimi dhe shpërndarja e sipërfaqeve të banimit ekzistues

Bazuar në skenarin realist projektohet që Obiliqi të ketë nevojë rreth 20,350 m^2 në 10 vitet që vijnë për të akomoduar nevojën e projektuar për banim.

3.10.3. Kushtet e banimit

Ndërtesat e banimit më shumë njësi thuaja se që nga ndërtimi i tyre nuk janë mirëmbajtur fare. Posaçërisht fasadat janë në një gjendje të keqe. Në vende ku ka rënë suvaja krijohen vrima në mbështjellësin e ndërtesës dhe krijojnë dëme në strukturën e objektit. Pos kësaj duhet që instalimet elektrike dhe të ngrohjes, ashensorët, etj. të rinovohen.

Rrethina e këtyre blloqeve të banimit ofron shumë pak kualitete pushimi, veçanërisht vendet për lojëra të fëmijëve mungojnë. Në mënyrë që të gjitha këto të mund të bihen në nivelin e kënaqshëm, përgjegjësia nuk do të duhej të mbetej vetëm te qeveria. Pikërisht banorët, që edhe posedojnë këto banesa, duhet të luajnë një rol qendrorë në procesin e rinovimit të tyre.

Nëse analizohet vjetërsia e ndërtesave të banimit në komunën e Obiliqit, atëherë del se fondi i banimit në Obiliq është relativisht i ri. Rreth 40 % prej tyre janë ndërtuar pas luftës së fundit në Kosovë dhe vetëm 25% e të gjitha ndërtesave të banimit të Obiliqit janë ndërtuar para vitit 1999.

Mirëpo, duke marrë parasysh që shumica e ndërtesave më shumë njësi të cilat janë ndërtuar para vitit 1991 nuk kanë pësuar ndonjë renovim dhe disa prej tyre paraqesin rrezik për kalimtarët e rastit, komuna duhet të ndërmerr masa për renovimin e këtyre ndërtesave. Po ashtu shumica e njësive të banimit brenda ndërtesave të banimit që janë ndërtuar para vitit 1999 janë ende pronë shoqërore. Gjithsesi, komuna duhet të ketë një qasje proaktive sa i përket trajtimit të ndërtesave të vjetra të banimit marrë parasysh nevojën e për masa shtesë të sigurisë, pajtueshmërinë me kërkesat e kodit të ndërtimit apo edhe përmes regjenerimit urban të këtyre zonave.

Rreth 90% të ndërtesave banimi kanë qasje në infrastrukturë. Vetëm në 30% të ndërtesave janë aplikuar masa termo-izoluese, që dëshmon që shumica e ndërtimeve nuk plotësojnë kërkesat ligjore-mjedisore.

15.90% të ndërtesave banimi janë pa leje ndërtimit, nga të cilat 61.11% ndërtime janë në pronë shoqërore, gjersa mbindërtime nuk ka.

Në mungesë të legjislacionit përkatës, objektet e banimit rrallë here janë të ndërtuara duke u bazuar në parimin e energjisë efiçiente. Ndërtesat nuk kanë izolime të duhura që ta ruajnë energjinë, si dhe nuk përdorin elemente shtesë për prodhim të energjisë si panele solare apo të ngjashme.

3.10.4. Shfrytëzimi i fondit të banimit

Analiza e fondit të njësive të banimit në dispozicion, tregon se vetëm 71.77 % prej tyre në komunë të Obiliqit janë të shfrytëzuara, përderisa 28.23% % mbesin të pa-shfrytëzuara. Ndërsa, në bazë të analizës demografike ndër vite dhe trendëve të përgjithshme në Kosovë, del se ekonomitë familjare në komunën e Obiliqit janë duke u zvogëluar sa i përket numrit të anëtarëve. Ndërsa, nga totali i ekonomive familjare, rreth 20% banojnë në zonën urbane. E gjithë kjo jep indikacion që planifikimi i njësive të reja të banimit në Komunën e Obiliqit në të ardhmen duhet të bëhet me kujdes duke u bazuar në parashikimet demografike por duke e përcjellë trendin e ekonomive familjare. Në veçanti me rëndësi për zonën urbane duhet që, në të ardhmen të planifikojë njësi të reja të banimit në bazë të parashikimeve demografike, mirëpo edhe duke përcjellë trendin e ekonomive familjare.

	Gjithsej njësi të banimit nga viti 2011			Të pabanuara	Gjithsej të pabanuara
Kosova	412.884	Zona urbane	175.942	42.340 (42%)	99.808 (24%)
		Zona rurale	236.942	57.468 (58%)	
Komuna e Obiliqit	5457	Zona urbane	1.813	507 (27.96%)	1.541 (28.23%)
		Zona rurale	3.644	1.034 (28.38%)	

Tabela 168 Shfrytëzueshmëria e fondit të banimit

Megjithëse ka një numër të konsiderueshëm të banesave të pabanuara, këto banesa mund të jenë në shfrytëzim për banim me qira apo shitje, sipas kategorizimit të burimit të këtyre të dhënave. Pas parasysh parregullsitë në fushën e qiradhënies dhe mos deklarimin e banesës së lëshuar me qira në gjithë Kosovë, nuk mund të dilet në përfundim se këto banesa janë apo jo të banuara. Kjo na pamundëson të marrim si fond të zbrazët fondin e banesa të pabanuara në llogaritjet e nevojave të reja për banim. Gjithashtu, në llogaritjen dhe planifikimin e përdorjes së fondit të banimit të pabanuar për planifikime të reja, duhet pasur parasysh edhe vjetërsinë e banesave të pashfrytëzuara, dhe se a mund te inkuadrohen ato në këtë planifikim.

Sa i përket tipologjisë së ndërtimeve të njësive të banimit me një njësi, përqindja më e madhe prej 60.04% janë ndërtuar para vitin 1999, gjersa gjatë 30 viteve të fundit janë ndërtuar 39.96% njësi të banimit individual.

Numri i objekteve para 1999	3050
Numri i objekteve pas 1999	2030
Etazhiteti mesatar	P+1

Tabela 169 Numri i njësive të banimit me një njësi para dhe pas vitit 1999

Sa i përket tipologjisë së ndërtimeve të njësive të banimit me shumë njësi, përqindja më e madhe e ndërtesave prej 57.89% janë ndërtuar para vitin 1999, gjersa gjatë 30 viteve të fundit janë ndërtuar 42.11% ndërtesa banimi me shumë njësi.

	Numri I ndërtesave	**Numri I njësive të banimit**
Të ndërtuara para 1999	11	170
Të ndërtuara pas 1999	8	120

Tabela 170 Numri i ndërtesave dhe njësive të banimit me shumë njësi para dhe pas vitit 1999

Duke marrë parasysh që shumica e ndërtesave më shumë njësi të cilat janë ndërtuar para vitit 1991 nuk kanë pësuar ndonjë renovim dhe disa prej tyre paraqesin rrezik për kalimtarët e rastit, Komuna duhet të ndërmerr masa për renovimin e këtyre ndërtesave.

3.10.5. Trendet e ndërtimit të ndërtesave për banim dhe çmimet mesatare të ndërtesave për banim

Pavarësisht ndryshimeve në numër të popullsisë në Obiliq, kërkesa për banim është relativisht e lartë, sidomos në zonën urbane dhe rreth saj. Rritja modeste e popullsisë nuk është faktori kryesor që ndikon në kërkesën për njësi të reja banimi. Migrimi i brendshëm (fshat – qytet), ndryshimi i numrit të anëtarëve të familjes i cili është në zvogëlim, krijimi i çifteve të reja dhe diaspora janë faktorët tjerë kryesor që ndikojnë në rritjen e kërkesës për njësi të reja të banimit.

Numri I lejeve ndërtimore të dhëna që nga viti 2009 deri në vitin 2018, për ndërtim të objekteve banimi (shtëpi dhe me shumë njësi) dhe afariste- banimi janë 150 leje. Në krahasim me komunat tjera, ky numër është I ulët. Kurse, leje ndërtimore për ndërtesa banimi me shumë njësi, prej vitit 2009 deri në vitin 2018, janë dhënë 64 leje ndërtimore.

Çmimet mesatare të një njësie banimi në objektet kolektive rezulton të jetë nga 400€ deri në 600€ për m². Sigurisht që çmimet ndryshojnë varësisht nga lokacioni i njësive të banimit. Qendra e qytetit është pjesa më e kërkuar për banim, dhe rrjedhimisht çmimet janë më të larta.

3.10.6. Identifikimin e tokës së mjaftueshme për banim

Banimi për kategoritë e veçanta

Nevojat për banim janë më tepër se sa të rasteve sociale, duke marrë parasysh se çmimi mesatar i një njësie banimi është **500€/m²**. Ngase edhe shumë familje të cilat kanë ndonjë anëtar të punësuar, janë në pamundësi që të ndërtojnë shtëpi apo të blejnë banesë dhe kanë nevojë për një mundësi më të përballueshme të sigurimit të banesës me një qira të përballueshme.

Banimi Social

Sipas kërkesave zyrtare në Komunën e Obiliqit, numri i familjeve të cilat kërkojnë strehim, meremetim dhe ndërtim të shtëpisë deri më tani është 200.

Komuna planifikon qe ndërtesat e Hades së vjetër ti ndahen veteranëve, invalidëve të luftës, dhe për rastet sociale. Ky projekt do të zvogëlonte numrin e përgjithshëm të rasteve të pastrehë, mirëpo, duke parë trendet dhe kërkesat për banim, komuna duhet patjetër të planifikoj edhe hapësira të tjera për strehim të këtyre familjeve.

3.10.6.1. Banimi i përballueshëm:

Në identifikim e tokës së mjaftueshme për banim duhet të futen së paku edhe kategoritë e më poshtme të banimit të përballueshëm:

- Banimin për familjet me të ardhura të ulëta
- Të moshuarit
- Personat me aftësi të kufizuara
- Çifte të reja

3.10.7. Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore.

3.10.7.1. Sfidat, identifikimi I problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

Sfidat:

- Kontrollimi i zhvillimit jashtë zonës urbane, në zonat rurale;
- Zhvillimi i pa balancuar i vendbanimeve;
- Ruajtja e zonave të banimit brenda vendbanimeve përkitazi me planet hapësinore;
- Koncentrimi i kontrollit të zhvillimeve për industri në zonën industriale ekzistuese ;
- Mungesa e politikave lokale fiskale për rregullimin e banimit të përballueshëm;
- Mos balancimi i kërkesës për banim me ndërtimet e reja në dispozicion (fondi aktual banesor);
- Menaxhimi i presionit në zona të caktuara për ri-zhvillim - Kërkesat e mëdha të qytetarëve dhe ndërtuesve/investitorëve për objekte shumë banesore në zonën urbane;
- Mos zbatimi i politikave dhe strategjive për banim në nivel qendror dhe lokal;
- Mungesa e harmonizimit të nevojave për banim në raport me kërkesën;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e dobët e ndërtesave të banimit në bashkëpronësi;
- Nevoja për formimin e Divizionit për Banim, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm;
- Sigurimi i banimit të përshtatshëm (social dhe i përballueshëm) për familjet me të ardhura të ulëta dhe familjet tjera;
- Mungesa e Fondit të Banimit në nivel qendror;
- Vendbanimi joformale, brenda dhe jashtë zonave urbane;
- Rritja e banimit përgjatë rrugëve; shfrytëzimi jo racional i hapësirës;
- Lidhja ndërmjet banimit individual dhe kolektiv në zonat urbane;

Potencialet:

- Hartimi i Ligjit për Banim;
- Politikat për banim dhe zhvillim urban;
- Rritja e banimit për t'i përmbushur kërkesat;
- Interesi i sektorit privat për investime;
- Krijimi dhe menaxhimi i politikave të qerasë për banesa, lokale dhe tokë ndërtimore (prona komunale);

3.10.7.2. Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara

Sa i përket banimit, duke ju referuar të dhënave për strukturat e ndërtuara, 76.6% janë të destinuara për banim, të cilat janë të ndara në Banim me një njësi dhe banim me shumë njësi. Ndërsa në aspektin e shfrytëzimit të tokës është evidente se banimi i ulët përbën rreth 88 % e të gjithë sektorit të banimit. Sa i përket njësive të banimit në dispozicion, del se 20% e tyre janë të pa-shfrytëzuara, prandaj është e domosdoshme që në të ardhmen planifikimi i njësive të reja të banimit të bëhet në bazë të parashikimeve demografike, por edhe duke përcjellë trendin e zvogëlimit të ekonomive familjare.

Në Komunën e Obiliqit, në aspektin e banimit social, përveç faktit që kemi 200 kërkesa për strehim, situata është relativisht e mirë. Komuna planifikon qe ndërtesat e Hades së vjetër ti ndahen veteranëve, invalidëve të luftës, dhe për rastet sociale. Ky projekt do të zvogëlonte numrin e përgjithshëm të rasteve të pastrehë, mirëpo, duke parë trendet dhe kërkesat për banim, komuna duhet patjetër të planifikoj edhe hapësira të tjera për strehim të këtyre familjeve.

Sa i përket dendësisë së banorëve për vendbanim vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë është në Raskovë ku mesatarisht jetojnë rreth656 banorë në një km² dhe pas saj në qytetin e Obiliqit me 548 banorë për km² . Kjo ka bërë që ndikimi i zonës urbane të jetë më së shumti në vendbanimet Mazgit, Milloshevë Plemetin, që janë ndër vendbanimet me më së shumti banorë pas Obiliqit.

3.10.7.3. Vlerësimi i përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve – Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Ekzistimi i dokumenteve planore (ne proces të finalizimit)** ▪ **Përkushtimi i fuqishëm nga administrata për zgjidhjen e çështjeve të banimit** ▪ **Iniciativat për investim në banim përmes PPP-ve, fond i konsiderueshëm i njësive të banimit, të mundësuara/ofruara nga sektori privat**	▪ Një numër i njësive të banimit nuk i plotësojnë standardet hapësinore të banimit ▪ Në lidhje me kombësitë e tjera në rajon, ofrimi i standardit të banimit ende është i ulët. ▪ Shkalla e madhe e ndërtimeve pa leje ▪ Mospërputhje e konsiderueshme e llojeve të pronësisë ▪ Niveli i ulët i regjistrimit të pronës ▪ Sektori i banimit me qira i pazhvilluar

DRAFT

▪ **Fond me banesa relativisht të reja dhe të ndërtuara duke përdorur material të cilësisë së mirë** ▪ **95% e banimit në pronë private, pa konteste pronësore;** ▪ **Programi 3 vjeçar i banimit;** ▪ **Banim relativisht i ri - vetëm 20% të njësive të banimit më të vjetra se 40 vjet** ▪ **Trendi i remitencave për fushën e banimit;** ▪ **Numri i kërkesave të përcaktuara** ▪ **Infrastruktura ne zonat urbane dhe rurale** ▪ **Ekzistimi i zonave rezervë te planifikuara për banim**	▪ Mungesa e themelimit të Shoqatave të Pronarëve për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi ▪ Mungesa e sektorit të Banimit ▪ Mjetet e pa mjaftueshme buxhetore për ndarjen e banimit social ▪ Prona e kufizuar komunale për banim social ▪ Mungesa e dokumenteve të mëhershme të banimit ▪ Mos përkrahja e donatoreve për ndërtimin e objekteve për banim social ▪ Parcela të vogla ▪ Mungesa e hapësirave për shërbime ▪ Oferta dhe kërkesa jo te harmonizuara ▪ Masa jo te mjaftueshme qe ndërmerren për kategoritë e caktuara
Mundësitë	**Kërcënimet**
▪ **Planifikimi kompakt i zonave të banimit** ▪ **Dëshirë e madhe për pronësinë e shtëpisë, pothuajse 95% në pronësi.** ▪ **Rritja e kërkesës për banim, përfshirë numrin në rritje të personave të ri-atdhesuar dhe ekonomive të shumë-familjare që janë në ndarje.** ▪ **Hartimi i politikave nga niveli qendror për banim të përballueshëm;** ▪ **Potenciali i sektorit privat për banim;** ▪ **Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale nga niveli qendror** ▪ **Mundësia e aplikimit të PPP-së me qëllim të rritjes së numrit të banesave sociale** ▪ **Shkëmbimi i përvojave me komunat dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor** ▪ **Ligjet dhe Programet shtetërore për banim** ▪ **Strategjitë komunale dhe qendrore** ▪ **Formimi i Agjensionit apo sektorit për banim** ▪ **Stimulimet për grupet e caktuara,** ▪ **Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e banimit.**	▪ Supozohet se modelet tradicionale të banimit, me shumë gjenerata- familje të mëdha, do zvogëlohen e me këtë do të rriten kërkesat shtesë për vendbanim individual. ▪ Tendenca për ndërtimin e banimit pa planifikim përkatës dhe pa leje ndërtimore ▪ Kërkesat e mëdha për depozitë dhe shkalla e lartë e interesit nga bankat për kreditë e banimit ▪ Përqindje e madhe e kërkesave të hipotekës janë refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit ▪ Vlerësimi jo real i pronës nga ana e bankës ▪ Migrimi i popullsisë fshat – qytet; ▪ Mos respektimi i legjislacionit ▪ Rritja e vazhdueshme numrit të kërkesave ▪ Krijimi i Getove të banimit social

Tabela 171. Analiza SWOT për banim

3.11. SHFRYTËZIMI AKTUAL I TOKËS

Komuna e Obiliqit, është komuna më e ndikuar nga gjenerimi i energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponimeve të hirit dhe të djerrinës si dhe zhvendosjes së vendbanimeve, ka nën shfrytëzim dhe pronësi private 54 % (ose me 5.683 ha) të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.809 ha (ose 46 %), nga e cila KEK-u posedon 15 %.

Nga kjo analizë kuptohet që territori prej 24km2 në periudhën 20 vjeçare ka pasur këtë zhvillim, i cili zhvillim pra është bërë i tëri në kurriz të tokës bujqësore.

Nga e gjithë kjo kuptohet, që ndër shumë sfida të mëdha që ka kjo komunë, ka edhe humbjen e madhe të tokës bujqësore.

Në mungesë të informacioneve për shfrytëzim të tokës nga PZHK 2009 – 2020+ jemi detyruar të marrim për bazë shfrytëzimin ekzistues të tokës i nxjerrë nga digjitalizimi në sistemin gjeografik të informimit GIS dhe shfrytëzimi i tokës sipas Planit të Veprimit në mjedis 2012-2019 dhe Urban Atlas Copernicus 2012(Sipërfaqja e shfrytëzuar për infrastrukturë të transportit).

Sipërfaqet për të dy shfrytëzimet ekzistuese sikur tek plani i veprimit ne mjedis i cili është hartuar në vitin 2012 edhe tek shfrytëzimi aktual janë marrë për bazë për të bërë krahasimin dhe për të nxjerrë diferencat apo trendët e zhvillimeve që kanë ndodhur në periudhën kohore nga 2012 deri 2022.

Shfrytëzimi tokës Sipërfaqja ha	(%)
Zona me potenciale bujqësore 6852ha	65.4%
Zona me pyje 1153ha	11%
Zona e banimit/vendbanimet 833ha	8%
Prona ujore 96ha	0.9%
Infrastruktura e transportit 155.61ha	2.4%
Zona e minierave në shfrytëzim 838ha	8%
Deponitë e hirit nga "Kosova A dhe B" 272ha	2.5%
Zona industriale - "TC Kosova A dhe B" 191ha	1.82%

Tabela 172 Shfrytëzimi i Tokës sipas Planit të Veprimit në mjedis 2012-2019 dhe Urban Atlas Copernicus (Infrastruktura e transportit)

Shfrytëzimi tokës Sipërfaqja ha	(%)
Banim / Banim i përhershëm 920.72ha	8.78%
Shfrytëzim Tjetër / Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik / Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik 38.17ha.	0.36%
Prodhim Parësor / Bujqësi 6471.6ha	61.7%
Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit 83.76ha	0.80%
Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile 276.67ha	2.64%
Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar 74.85ha	0.71%
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit 172.56 ha	1.65%
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor 21.41 ha	0.20%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë 1168.04ha	11.14%
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative 26.09ha	0.25%
Prodhim Parësor / Minierë dhe Gurore / Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë 1220.22ha	11.63%

Tabela 173 Shfrytëzimi aktual i Tokës 2022

Kategoria e shfrytëzimit	Sipas Planit të Veprimit në Mjedis sip/ha dhe *Urban Atlas Copernicus*	Sipas Shfrytëzimit Aktual sip/ha	Diferenca në ha	Diferenca në %
Banim / Banim i përhershëm	833 ha	920.72ha	87.72	9.53%
Prodhim Parësor / Bujqësi	6852 ha	6471.6ha	-380.4	-5.55%
Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile.	191 ha	276.67ha	85.67	30.96%
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit	155.61ha	172.56ha	16.95	10.89%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	1153 ha	1168.04ha	15.04	1.29%
Prodhim Parësor / Minierë dhe Gurore / Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë	838 ha	1220.22ha	382.22	31.32%

Tabela 174 Diferenca në mes të shfrytëzimit aktual të tokës sipas Planit të Veprimit në Mjedis 2012, Urban Atlas Copernicus (Infrastruktura e transportit) dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2022.

Nga analiza krahasuese në mes sipërfaqeve të shfrytëzimeve të tokës nga viti 2012 deri në vitin 2022, vërejmë që për këtë periudhë kohore prej tetë vitesh kemi lëvizje të konsiderueshme në sipërfaqe.

Nëse shohim sipërfaqen e cila është e ndërtuar me ndërtesa banimi, vërejmë që kemi një rritje prej 87.72 ha apo 9.53%.

Sipërfaqja e tokës bujqësore për periudhën tetë vjeçare kemi pasur një humbje të tokës prej -380.4ha apo -5.55%

Tek zonat industriale vërejmë një rritje të sipërfaqes, ku në periudhën tetë vjeçare kemi një rritje prej 85.67 ha apo 30.96%.


Tek zonat e komunikacionit dhe transportit kemi marrë për bazë sipërfaqet e kalkuluara nga Urban Atlas Copernicus tek të cilat vërejmë rritje të sipërfaqes për 16.95 ha apo 10.89%.

Zona pyjore për periudhën tetë vjeçare kemi pasur një rritje të sipërfaqes prej 15.04 ha apo 1.29%.

Zona minierë sipërfaqësore për periudhën tetë vjeçare kemi pasur një rritje të sipërfaqes prej 382.22 ha apo 31.32%.

3.11.1. Banim / Banim i përhershëm

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e banimit në përqindje, ku vërehet qe në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të sipërfaqes. Kryesisht janë vendbanimet të cilat janë më afër zonës urbane si dhe zona urbane.




Grafiku 12 Shfrytëzimi i Tokës për banim i shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.2. Banimi Social

Në kuadër të banimit kemi edhe banimin social ku në komunën e Obiliqit këtë lloj të banimit e gjejmë vetëm tek vendbanimi me emër Plemetin i cili ka 0.84 ha sipërfaqe për banim social.

3.11.2.1. Trendet

Nëse e shohim trendin e rritjes së sipërfaqeve të banimit nga 2012 deri 2020 për tetë vite kemi arritur të kemi 87.72 ha, që i bie nga 10.96 ha në vit.



Grafiku 13 Trendi i rritjes së sipërfaqes për banim në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.2.2. Prognozat

Bazuar në trendin e rritjes së sipërfaqes së banimit prognozojmë që nëse vazhdohet ky trend i rritjes edhe për tetë vite të ardhshme, komuna e Obiliqit do të ketë plus 87.72 ha për banim dhe njëkohësisht kaq humbje në kuadër të tokës bujqësore.

Në bazë të shtrirjes së vendbanimeve në terren si dhe në hartën e shtrirjes së vendbanimeve vërejmë rritje të kufijve ndërtimor ku në të kundërtën vërejmë humbje të tokës bujqësore, si dhe një shtrirje të shpërndarë tek disa nga vendbanimet.


3.11.2.3. Nevojat

- Duke analizuar trendët dhe prognozat vlerësojmë që në komunën e Obiliqit duhet të merren masa në fushën e banimit, ku në vendbanimet e përmendura më lart duhet të tentohet të konceptohen në atë mënyrë që territori për banim të jetë sa ma kompakt dhe me densifikim më të madh të territorit të sipërfaqes së banimit.
- Nevoja për banim më cilësor dhe të qëndrueshëm.
- Nevoja për banim më cilësor në aspektin e efiqiencës energjetike, promovimi i ndërtesave të gjelbërta.
- Nevoja e banimit në zona urbane për gjelbërim, hapësira të lira dhe terrene sportive e të rekreimit.
- Nevoja për trajtimin e ndërtesave të banimit në tokat bujqësore nën komasacion.

3.11.3. Prodhim Parësor / Bujqësi


Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e tokave bujqësore e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës ndërtimore dhe zvogëlim të asaj bujqësore.

Kryesisht janë vendbanimet të cilat janë më afër zonës urbane si dhe zona urbane ku më saktësisht mund ti shohim edhe në grafikonin e sipërfaqes së tokës të punueshme bujqësore.



Grafiku 14 Shfrytëzimi i tokës të punueshme bujqësore i shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.


Në grafikonin në të cilin janë të paraqitura sipërfaqet e shprehura në përqindje sipërfaqet me kullosa në kuadër të vendbanimeve vërejmë që vendbanimet si : Breznicë, Sibovc, Raskovë dhe Grabofci Epërm, janë vendbanime me më shumë sipërfaqe.



Grafiku 15 Shfrytëzimi i tokës bujqësore - kullosa i shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.3.1. Trendet

Bazuar në trendin e tokës bujqësore, vërejmë që në kuadër të tokës bujqësore kemi një humbje të konsiderueshme ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi -380.4ha ku i bie që për tetë vite kemi nga 47.55 ha të humbur në vit.



Grafiku 16 Trendi i humbjes së sipërfaqes për tokë bujqësore në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.3.2. Prognozat

- Bazuar në trendin e tokës bujqësore, prognozojmë që nëse vazhdohet me një trend të tillë edhe për dhjetë vite të ardhshme komuna e Obiliqit do të ketë -380.4ha, të humbura nga toka bujqësore dhe kështu do të rritet degradimi i bujqësisë në vend si një ndër fushat e rëndësishme të ekonomisë.
- Bazuar në sipërfaqet e vendbanimeve, trendët e zhvillimit të ndërtimit, vërehet që në fshatrat me humbje më të madhe të tokës bujqësore dhe shtrirje më të madhe të ndërtimit në toka bujqësore, nuk janë kontrolluar ndërtimet dhe kufiri ndërtimor.
- Dëmtimi i tokave të cilat janë nën sistemin e ujitjes dhe nën komasacion, janë të ndërtuara në një sipërfaqe shqetësuese dhe kjo rrjedhë si rezultat i një zhvillimi i pa kontrolluar të territorit.


3.11.3.3. Nevojat

- Mbrojtja e tokës bujqësore e cila është ende e lirë dhe mundë të shfrytëzohet për kultivim të kulturave bujqësore.
- Mbrojtja e tokave nën sistemin e ujitjes dhe nën komasacion.
- Komasacioni i tokave bujqësore, si mënyrë më efikase për shfrytëzimin e tyre.

3.11.4. Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e tokave pyjore e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës së tokës pyjore në kuadër të territorit të komunës.


Vendbanimet të cilat kanë më shumë sipërfaqe të tokës pyjore janë si në vijim : Grabofci i Epërm, Breznica, Shipitulla dhe Sibovci.



Grafiku 17 Sipërfaqja e zonave të shërbimeve e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.4.1. Trendet

Bazuar në trendin e zhvillimit të tokës pyjore, vërejmë që në kuadër të tokës pyjore kemi një rritje të konsiderueshme ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi rritje për 15.04ha.



Grafiku 18 Trendi i rritjes së sipërfaqes për tokë pyjore në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.4.2. Prognozat

- Bazuar në trendin e zhvillimit të tokave pyjore, prognozojmë që nëse vazhdohet me një trend të tillë edhe për tetë vite të ardhshme, komuna e Obiliqit do te ketë sipërfaqe prej 1183.08 ha tokë pyjore.
- Është i pranueshëm fakti që komuna e Obiliqit ka rritje në sipërfaqen e tokës pyjore, por duke marrë për bazë termoelektranat dhe ndotjen e ajrit që ka në këtë komunë, ne prognozojmë që duhet të shtohet sipërfaqja me tokë pyjore dhe kjo arrihet duke siguruar hapësira të reja për ripyllëzim.


3.11.4.3. Nevojat

- Mbrojtja e sipërfaqes ekzistuese pyjore nga prerja ilegale.
- Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore nga zjarret masive.
- Ripyllëzimi dhe rigjenerimi i tokave pyjore të dëmtuara dhe propozimi i tokave të reja për ripyllëzim.

3.11.5. Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit

Bazuar në të dhënat e profilit të komunës së Obiliqit vërejmë që zonat kadastrale me më së shumti zona të shërbimeve janë : Obiliq, Carravodicë, Mazgit dhe Baimofc. Këto zona përbëjnë numrin më të madh të zonave të shërbimeve, në diagramin më poshtë i kemi të paraqitura në grafikon këto zona dhe sipërfaqet e tyre.

DRAFT



Grafiku 19 Sipërfaqja e zonave të shërbimeve e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.5.1. Prognozat

Bazuar në të dhënat e profilit, vërejmë që zonat e shërbimeve janë të koncentruara në zonën urbane dhe vendbanimet pran zonave urbane. Nga kjo prognozojmë që zhvillimi i qytetit vitet e kaluara ka qenë i koncentruar më shumë në zonën urbane dhe nëse vazhdojmë në këtë mënyre të koncentrimit të shërbimeve vetëm në zonën urbane, do të kemi qytet monocentrik ku shumica e zonave kadastrale duhet të kryejnë shërbimet në zonë urbane, zhvillim ky i cili do të ndikoj në rritjen e trendit të migrimit të qytetarëve nga zonat rurale për në zonën urbane, ku një ndër faktorët kryesor janë shërbimet.


3.11.5.2. Nevojat

- Shtrirja e shërbimeve në zonat rurale në të cilat kemi migrim më të madh të popullsisë për në zonën urbane dhe zona tjera.
- Orientimi i zhvillimit të komunës në formë policentrike, pra formimi i disa zonave kadastrale si nën qendra komunale, të cilat do të ofrojnë shërbimet për qytetarët në zona kadastrale më larg zonës urbane.

3.11.6. Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor

Bazuar në të dhënat e profilit në komunën e Obiliqit kemi një sipërfaqe prej 21.41 ha e cila është nën mbrojtje.

Në vijim do të paraqesim një grafikon i cili na tregon saktësisht vendbanimeve që kemi më shumë sipërfaqe të shtrirë.




Grafiku 20 Sipërfaqja e zonave të mbrojtura arkeologjike - historike e shprehur në hektar sipas vendbanimeve.

3.11.6.1. Nevojat

- Promovimi zonave arkeologjike dhe ruajtja e sipërfaqeve ekzistuese të komunës së Obiliqit.
- Hulumtimi i vazhdueshëm për zona të reja me kapacitete arkeologjike.
- Përcaktimi i zonave për hulumtime të reja arkeologjike.

3.11.7. Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e zonave komerciale e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës së zonave komerciale në kuadër të territorit të Komunës. Vendbanimet të cilat kanë më shumë sipërfaqe të zonave komerciale janë : Obiliq, Baimofc, Milloshevë, Mazgit, Bërnicë e Poshtme, Plemetin, Grabofc i Epërm, Carravodicë, Bakshi.



Grafiku 21 Sipërfaqja e zonave komerciale e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.7.1. Prognozat

- Duke u bazuar në të dhënat nga profili vijmë në përfundim që zonat komerciale janë të shtrira në formë të korridoreve përgjatë qendrës së qytetit të Obiliqit, nga kjo prognozojmë që këto zona duhet të ruhen dhe këto korridoret të përcaktohen që te sigurohet sipërfaqe e mjaftueshme e zonave komerciale përgjatë këtyre korridoreve zhvillimore.
- Përcaktimi i zonave të reja për shfrytëzim komercial, në formë të korridoreve për zhvillim ekonomik, përgjatë rrugëve nacionale.
- Përkrahje e bizneseve në komunën e Obiliqit për një zhvillim më të qëndrueshëm të zonave komerciale.


3.11.7.2. Nevojat

1. Përcaktimi i zonave të reja për shfrytëzim komercial, në formë të korridoreve për zhvillim ekonomik.
2. Përkrahje e bizneseve në komunën e Obiliqit për një zhvillim më të qëndrueshëm të zonave komerciale.

3.11.8. Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e zonave industriale e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës së zonave industriale në kuadër të territorit të komunës. Vendbanimet të cilat kanë më shumë sipërfaqe të zonave industriale janë Obiliq, Kryshefc, Leshkoshiq, Carravodicë dhe Llazarevë.

DRAFT




Grafiku 22 Sipërfaqja e zonave industriale e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

Karakteristike tek zonat industriale në komunën e Obiliqit por edhe për gjithë Republikën e Kosovës janë termoelektranat Kosova A dhe Kosova B, ku të dyja shtrihen në territorin e komunës së Obiliqit. Kosova B e cila shtrihet në territorin e zonës kadastrale Leshkoshiq me sipërfaqe 16.44 ha, Obiliq 45.7ha dhe Plemetin 0.87 ha. Termoelektrana Kosova A shtrihet në dy vendbanime, në Obiliq me sipërfaqe prej 83.87 ha dhe në Kryshefcv me sipërfaqe prej 78.55.

3.11.8.1. Trendet

Duke u bazuar në planin e veprimit në mjedis 2012 - 2020 tek sipërfaqet me shfrytëzim zona industriale kemi një sipërfaqe prej 191 ha, ndërsa nga shfrytëzimi aktual i tokës kemi 276.67 ha. Nga ky trend i zhvillimit vërejmë që në kuadër të zonave industriale kemi një rritje të territorit ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi 85.67 ha rritje, ku i bie që për tetë vite kemi nga 10.70ha në vit.



Grafiku 23 Trendi i rritjes së sipërfaqes së zonave industriale në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.8.2. Prognozat

- Bazuar në trendin e zhvillimit t sipërfaqeve të zonave industriale vijmë në përfundim qe për tetë vite kemi një rritje prej 85.67ha, ku i bie që për tetë vite kemi nga 10.70ha në vit.
- Bazuar në këto trende të zhvillimit prognozojmë që zhvillimi i zonave industriale në Obiliq është njëra ndër sipërfaqet me rritje më të madhe në territorin e komunës së Obiliqit.


3.11.8.3. Nevojat

- Rivitalizimi i termocentralit Kosova A si faktorë i rëndësishëm në industrinë e komunës së Obiliqit por edhe të Republikës së Kosovës.

- Sigurimi dhe alokimi i sipërfaqes për ndërtimin e termoelektranës Kosova e Re.

3.11.9. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e zonave të transportit e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës të zonave të transportit në kuadër të territorit të komunës. Vendbanimet të cilat kanë më shumë sipërfaqe të zonave të transportit janë : Obiliq, Mazgit dhe Breznicë.




Grafiku 24 Sipërfaqja e zonave transportit dhe komunikacionit e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.9.1. Trendet

Bazuar në shfrytëzimin e tokës nga Urban Atlas - Copernicus 2012 dhe në shfrytëzimin aktual të tokës vërejmë që kemi një diferencë në mes sipërfaqeve, ku rezulton që kemi 16.95ha më shumë në shfrytëzimin aktual të tokës.

Nga ky trend i zhvillimit vërejmë që në kuadër të zonave të komunikacionit dhe transportit kemi një rritje të territorit ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi 16.95ha rritje, ku i bie që për tetë vite kemi nga 2.11 ha në vit.



Grafiku 25 Trendi i rritjes së sipërfaqes së zonave të komunikacionit dhe transportit në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.9.2. Prognozat


Bazuar në trendin e zhvillimit të infrastrukturës së komunikacionit dhe transportit si në sipërfaqet : Obiliq, Mazgit dhe Breznicë, arrijmë në një prognozë që ndikimi në këto zhvillime ka qenë zona urbane, ku edhe nëse i shikojmë në aspektin hapësinorë këto vendbanime janë më afër zonës urbane edhe ndërtimi ka pasur një fluks më të madh. Me zhvillimin e ndërtimit të lartë, sidomos në fshatrat e shpërndara, automatikisht është paraqitur edhe nevoja për infrastrukturën rrugore për këto ndërtesa.

3.11.9.3. Nevojat

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në fshatrat me zhvillim më të vogël si : Bakshi, Hamidi, Rashkovë.
- Përmirësim i infrastrukturës rrugore edhe në zona urbane dhe suburbane.
- Zhvillim i transportit të qëndrueshëm.

3.11.10. Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile

Bazuar në të dhënat e profilit në komunën e Obiliqit kemi një sipërfaqe prej 1220.22ha minierë sipërfaqësore, ku nga kjo 1211.19 janë deponi të hirit dhe 9.03ha janë gurthyes. Në vijim do të paraqesim një grafikon i cili na tregon saktësisht sipas përqindjes se në cilat vendbanime kemi më shumë sipërfaqe të shtrirë.




Grafiku 26 Sipërfaqja totale e zonave minierë sipërfaqësore e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.10.1. Trendet

Bazuar në shfrytëzimin e tokës nga Plani i veprimit në mjedis 2012- 2020 dhe në shfrytëzimin aktual të tokës vërejmë që kemi një diferencë në mes sipërfaqeve, ku rezulton që kemi 382.22ha më shumë në shfrytëzimin aktual të tokës.

Nga ky trend i zhvillimit vërejmë që në kuadër të infrastrukturës rrugore kemi një rritje të territorit ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi 382.22ha rritje, ku i bie që për tetë vite kemi nga 47.77 ha në vit.



Grafiku 27 Trendi i rritjes së sipërfaqes së zonave minierë sipërfaqësore në kuadër të komunës i shprehur në hektar nga viti 2012 deri 2020.

3.11.10.2. Prognozat

Bazuar në trendin e zhvillimit zonave minierë sipërfaqësore vërejmë që kemi një rritje të madhe të deponive të hirit në Vendbanimet si : Obiliq, Hade, Shipitullë, Sibovc, Plemetin, Leshkoshiq, Kryshefc, Hamidi, Dobrosellë dhe Carravodicë, nga kjo vijmë në përfundim që duhet të planifikohet largimi dhe në sipërfaqet e tyre të bëhen planifikim për zgjerim të zonave ekzistuese industriale apo gjelbërimit dhe funksione të tjera.

3.11.10.3. Nevojat

- Largimi apo eliminimi i deponisë së hirit në Obiliq tek Kosova B dhe alokimi i sipërfaqes së lirë për ndërtimin e termocentralit të ri Kosova e Re.
- Largimi i sipërfaqeve me deponi hiri dhe sigurimi i sipërfaqes për zona për gjelbërim.

3.11.11. Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative

Në vazhdim është paraqitur sipërfaqja e zonave të rekreative-turistike e shprehur në përqindje, ku vërehet se në disa vendbanime kemi përqindje më të madhe të hapësirës të zonave rekreative-turistike në kuadër të territorit të komunës. Vendbanimet të cilat kanë më shumë sipërfaqe të zonave rekreative-turistike janë : Obiliq, Baimofc, Milloshevë, Plemetin, Llazarevë, Raskovë, Kryshefc, Mazgit.




Tabela 175 Sipërfaqja totale e zonave rekreativo - turistike e shprehur në përqindje sipas vendbanimeve.

3.11.11.1. Prognozat

Duke pasur parasysh të dhënat e profilit vërejmë që sipërfaqe më të madhe të hapësirave rekreativo – turistike kemi në zonën urbane dhe sub urbane.

Nga kjo prognozojmë që dendësia më e madhe e popullatës në këto zona dhe nevoja për hapësira rekreativo - turistike ka ndikuar edhe në krijimin e këtyre zonave.

3.11.11.2. Nevojat

- Sigurimi i hapësirave të reja për zhvillimin e zonave të reja rekreative - turistike
- Promovimi i zonave rekreativo-turistike ekzistuese në nivelin kombëtar e ndërkombëtar
- Zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm në komunën e Obiliqit
- Promovimi dhe zhvillimi i sipërfaqeve për zhvillim të turizëm malor.

3.11.12. Modelet e shfrytëzimit

Modeli i shfrytëzimit të banimit në komunën e Obiliqit.

Sa i përket numrit të strukturave të ndërtuara, në Komunë pjesa më e madhe e ndërtimeve prej 88.56% janë ndërtesa banimi me një njësi dhe banimi me shumë njësi prej 11.44%. Karakteristikë e ndërtimeve në komunë është shtrirja e tyre përgjatë rrugëve kryesore, ku vendbanimet marrin një formë lineare dhe shtrirja e shpërndarë e ndërtesave të banimit.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve ujore :

Territorin e Komunës së Obiliqit e përshkojnë ujërat e lumenjve Sitnica, Llapi dhe Drenica. Shkalla e ndotjes së lumenjve në komunën e Obiliqit është e lartë e sidomos e lumit Sitnica si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industrial. Shkalla më e lartë e ndotjes së lumenjve të Kosovës është ajo e lumit Sitnica që tejkalon vlerat maksimale dhe bën pjesë në shkallën e IV të ndotjes.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve bujqësore :

Rreth 48% e territorit komunal është në shfrytëzim për nevoja të bujqësisë që d.m.th. gati gjysma e territorit të komunës së Obiliqit. Prej tyre 6.677 ha janë pronë private dhe 3.854ha janë pronë shoqërore.

Si biznese, aktivitetet bujqësore në sektorin e bujqësisë, nuk figurojnë të regjistruara, mirëpo është evidente se ato janë ndër aktivitetet primare familjare. Në Komunë, bujqësia është zhvilluar tradicionalisht nga familjet e mëdha dhe ka qenë aktiviteti kryesor ekonomik jashtë sektorit të energjisë dhe minierave. Përafërsisht 60 % e popullatës që jetojnë në këtë rajon janë bujq që kultivojnë kryesisht grurin dhe misrin. Korrja dhe bluarja e drithërave kryesisht është e rregulluar në formë kooperative dhe në formë individuale. Nuk ka ndonjë fermë të madhe blegtorale, mirëpo kryesisht ka ferma të vogla dhe të mesme.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore :

Toka pyjore në komunën e Obiliqit është në pyje të ulëta që mbulohet nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardhi – Querrcus Frainetto, Qarri – Qurqus Cerris, Shkoza e zezë - Carpinus Orientalis, Ahu – Fagus Moesiaca. Ndërsa, pjesa jug - perëndimore e zonës mbulohet dhe karakterizohet me një sipërfaqe të pyjeve të ngritura me anë të pyllëzimeve, kryesisht me Hartina– Pinus Silvestris dhe pisha e zezë – Pinus Negra. Kryesisht janë pyje të ulëta të degraduara.

Zonat Pyjore shtrihen në një të sipërfaqe të përgjithshme prej 1168.04 ha.

3.11.13. Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet / Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ **Struktura urbane është kompakte,** ▪ **Qendra e qytetit është e fuqishme,** ▪ **Zonat për zhvillim në lokacione atraktive** ▪ **Përcaktimi i zonave urbane të reja** ▪ **Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore** ▪ **Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore** ▪ **Përcaktimi i tokës ndërtimore.** ▪ **Rritje të zonave industriale me sipërfaqe prej 382.22ha brenda periudhës kohore 2012 – 2022.** ▪ **Rritja e zonave te komunikacionit dhe transportit me sipërfaqe prej 16.95ha 2012 – 2022.**	▪ Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi joefikas në periferi ▪ Buxheti i ulët për shpronësime, duke marrë parasysh rritjen vlerës së tokës. ▪ Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore ▪ Fragmentimi i tokës bujqësore në parcela të vogla ▪ Mungesa e konsolidimit të tokës (komasacionit) ▪ Vendbanime me shtrirje të shpërndarë ▪ Krijimi i korridoreve të zonave ekonomike në mënyrë të pa kontrolluar ▪ Mungesa e sistemit të ujitjes dhe infrastrukturës rrugore për tokën bujqësore ▪ Mungesa e sipërfaqeve ujore (akumulimeve) ▪ Humbje e tokës bujqësore me sipërfaqe -380.4ha brenda tetë viteve 2012– 2022 ▪ Pronësia e paqartë mund të pengojë zhvillimin e duhur.
Mundësitë	Rreziqet
▪ **Hartimi Ligjit për Rregullim të tokës urbane (ku lehtëson miratimin dhe zhvillimin e planifikimit urban në kadastër).** ▪ **Largimi I sipërfaqeve të deponive të hirit dhe zhvillimi i këtyre sipërfaqeve.** ▪ **Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore** ▪ **Përcaktimi i zonave urbane dhe për ndërtim të reja në sipërfaqe të përshtatshme për urbanizim** ▪ **Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore Përcaktimi i zonave për ndërtim të pendëve dhe akumulim të ujit** ▪ **Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore** ▪ **Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore** ▪ **Caktimi i zonave të reja ekonomike** ▪ **Caktimi i zonave turistike verore dhe dimërore** ▪ **Zhvillimi i industrisë së prodhimit të energjisë së ripërtritshme me erë.**	▪ Ndotje e mjedisit nga minierat sipërfaqësore – deponitë e hirit ▪ Humbja e tokës bujqësore ▪ Krijimi i vendbanimeve të shpërndara ▪ Vështirësim deri në pamundësim të aplikimit të masave komasative në tokën bujqësore ▪ Rreziku nga vërshimi i tokave bujqësorë ▪ Rreziqe ndaj tërmeteve. ▪ Rreziku i zjarreve masive në zona pyjore ▪ Rritje e pakënaqësisë qytetare

DRAFT

3.11.14. Gjetjet kyçe

Gjatë analizës së profilit për komunën e Obiliqit kemi disa gjetje kyçe në të gjitha fushat e shfrytëzimit të Tokës.

Në tabelën më poshtë kemi të përshkruara së cilën gjetje për secilën fushë të shfrytëzimit të tokës.

Tabela 176 Gjetjet kyçe gjatë vlerësimit të profilit të shfrytëzimit të tokës

NR	Përshkrimi
1	Shfrytëzimi i Tokës : Banim / Banim i përhershëm Duke analizuar trendin e rritjes së sipërfaqeve të banimit nga 2012 deri 2022, kemi 87.72 ha, që i bie nga 10.96 ha në vit.
2	Shfrytëzimi i Tokës : Prodhim Parësor / Bujqësi Në komunën e Obiliqit kemi një humbje të konsiderueshme ku nga viti 2012 e deri në vitin 2022 kemi -380.4ha ku i bie që për tetë vite kemi nga 47.55 ha të humbur në vit.
3	Shfrytëzimi i Tokës : Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë. Në komunën e Obiliqit kemi një rritje të konsiderueshme ku nga viti 2012 e deri në vitin 2022 kemi rritje për 15.04ha.
4	Shfrytëzimi i Tokës : Prodhim Dytësor / Prodhim i Energjisë / Prodhim i energjisë së bazuar në fosile Në komunën e Obiliqit kemi një rritje të territorit ku nga viti 2012 e deri në vitin 2022 kemi 85.67 ha rritje, ku i bie që për tetë vite kemi nga 10.70 ha në vit.

DRAFT

4. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE TË KOMUNËS

4.1. Kapacitetet njerëzore

Në administratë publike të Komunës aktualisht janë të punësuar gjithsejtë 112 punonjës. Pjesa më e madhe prej 27 punëtorëve punojnë në drejtorinë e Administratës së përgjithshme, gjersa me 3 punëtorë numri më i vogël i të punësuarve është në drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Kabineti I kryetarit	Administrata e përgjithshme	Financave	Mbrojtje të mjedisit	Inspekcion	Infrastruktura publike	Arsimit	Kulturës, Rinise dhe Sportit	Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Pronës, Kadastër dhe Gjeodezisë	Bujqësisë dhe Pylltarisë	Planifikim Urban	Zyra e Komuniteteve	Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Gjithsej:
10	27	14	4	8	5	6	10	14	6	3	6	9	11	112

Tabela 177. Numri i të punësuarve sipas drejtorive komunale

Në administratë publike të Komunës pjesa më e madhe e të punësuarve, 40 punonjës kanë 21 – 41 përvojë pune, gjersa pjesa më e vogël, 21 punonjës kanë 0 – 5 vjet përvojë pune.

	Kabineti I kryetarit	Administrata e përgjithshme	Financave	Mbrojtje të mjedisit	Inspekcion	Infrastruktura publike	Arsimit	Kulturës, Rinise dhe Sportit	Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Pronës, Kadastër dhe Gjeodezisë	Bujqësisë dhe Pylltarisë	Planifikim Urban	Zyra e Komuniteteve	Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Gjithsej:
0-5	3	2	1		3	3	1	3	1		1			3	21
6-10	3	6	1	1	1	2		1	1		1		2	2	21
11-15	2	6	1	2				2	5	1		2	2	4	27
16-20	2	2	8		1		1	1	3	1		3	2		24
21-41	0	11	3	1	3		4	3	4	4	1	1	3	2	40
Gjithsejtë	10	27	14	4	8	5	6	10	14	6	3	6	9	11	112

Tabela 178. Numri i të punësuarve sipas përvojës së punës dhe drejtorive komunale

Me 79 të punësuar, pjesa më e madhe e të punësuarve janë me kualifikime SNKA 5/6 - Niveli 1, pastaj me 54 të punësuar janë individë me kualifikime SNKA 2 dhe vetëm 2 të punësuar me kualifikime SNKA 3

	Kabineti I kryetarit	Prokurimi	Administrata e përgjithshme	Financave	Urbanizmit dhe Mjedisit	Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Infrastruktura Publike	Arsimit	Kulturës, Rinise dhe Sportit	Mirëqenies Sociale	Qendra Rezidenciale	Pronës, Kadastër dhe Gjeodezisë	Bujqësisë dhe Pylltarisë	Zyra e Komuniteteve	Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Inspekcionit	Shëndetësi	Planifikim mjedisor inspekcion	planifikim urban inspekcion	Auditor i Brendshëm	Gjithsej:
SNKA 2	1		14	4				2	2	5		5	2	7	7	1		2	2		54
SNKA 3														1		1					2
SNKA 5/6 Niveli 1	8	2	11	10			5	4	8	6		1	3	1	4	6	3	2	4	1	79

Tabela 179. Numri i të punësuarve sipas përvojës së punës dhe drejtorive komunale

4.2. Performanca financiare në të kaluarën

Buxheti i shpenzuar nëpër vite:

Kategoria ekonomike:	2019	2020	2021	2022
Rroga dhe paga:	3,664,936.00	3,875,959.30	4,078,258.96	4,438, 341.00
Mallëra dhe shërbime:	367,452.00	489,929.00	666,725.50	823,930.00
Shpenzime komunale:	123,000.00	123,000.40	276,675.00	316,675.00
Subvencione dhe transfere:	138,799.00	138,799.40	832,800.00	762,800.00
Shpenzime kapitale:	1,766,892.00	2,158,803.00	6,253,396.00	4,912,981.00
Gjithsej:	6,061,079.00	6,786,491.10	12,107,855.46	11,254,727.00

Tabela 180. Buxheti i shpenzuar nëpër vite

Siç mund të shihet nga të dhënat, gjatë viteve 2017-2019 ka pasur një ngritje të buxhetit nëpër vite +9.37% (2020) dhe +69.87% (2021). Ka një rënie të vlerës së investimeve kapitale në vitin 2022, por kjo ka ndodhur në të gjitha komunat në Kosovë, ku disa nga projektet kapitale janë anuluar apo zëvendësuar me projekte për mbështetje ekonomike për bizneset dhe popullsinë kundrejt humbjeve financiare gjatë pandemisë së COVID- 19.

Gjatë analizimit të trendeve në të kaluarën të të hyrave vetanake në komunën e Obiliqit, mund të vërejmë si në vijim grupet kryesore të të hyrave vetanake. Komuna e Obiliqit ka shënuar rritje prej +2.5% të të hyrave vetanake në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, dhe një rritje prej +6.03% të hyrat vetanake të gjeneruara në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Të hyrat vetanake	2019	2020	2021	2022
Tatimi në tokë			113,324.00	113,323.00
Tatimi në pronë	366,984.00	368,958.70	446,000.00	463,000.10
Taksat Komunale	449,345.00	336,005.70	313,443.00	332,926.00
Licencat dhe lejet	136,600.00	83,068.20	112,000.00	113,457.00
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	28,428.00	24,354.80	30,000.00	35,191.00
Taksat e pajisjeve motorike	46,562.00	38,076.90	43,000.00	49,584.00
Lejet për ndërtesa	95,321.00	63,428.50	70,000.00	75,474.00
Taksat tjera komunale	142,434.00	127,077.30	58,443.00	59,220.00
Ngarkesat Komunale	103,671.00	77,050.70	84,859.00	109,639.00
Ngarkesat rregullatore	6,682.00	4,899.80	6,054.00	8,246.00
Të hyrat nga qiraja	15,756.00	11,269.70	15,000.00	19,025.00
Bashke-pagesat për arsim	30,018.00	22,996.60	24,724.00	31,504.00
Bashke-pagesat për shëndetësi	33,955.00	28,061.90	28,948.00	39,864.00
Ngarkesat tjera komunale	17,260.00	9,822.70	10,133.00	11,000.00
Të hyrat tjera	124,713.00	94,713.00	77,937.00	52,383.00
Gjithsej	1,597,729.00	1,289,784.50	1,433,865.00	1,513,836.10

Tabela 181. Komuna e Obiliqit –Mbledhja e të hyrave vetanake në të kaluarën 2019-2022

Krahasuar me buxhetin e përgjithshëm vjetor, të hyrat vetanake të gjeneruara gjatë vitit financiar 2019 ishin 15%, në vitin 2020 ishin 15% dhe në vitin 2021 ishin 9%. Siç mund të shihet nga të dhënat, të hyrat vetanake janë pjese se buxhetit të Komunës së Obiliqit.




Figura 14. Të hyrat vetanake në raport me buxhetin komunal për vitet 2019- 2022

Në figurat me poshtë, shihet pjesëmarrja e kategorive dominante të të hyrave vetanake të gjeneruara sipas viteve, pra nga viti 2019 deri në vitin 2022. Gjatë analizimit të këtyre kategorive specifike të të hyrave vetanake, në përgjithësi se ka pasur një rritje

për +2.85% të të hyrave vetanake ne vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, dhe një rritje prej +6.03% ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.Mund te thuhet se në përgjithësi ka pasur një graduale, apo një trend stabil të rritjes gjatë viteve.

Kategoria më e madhe e gjenerimit të të hyrave vetanake komunale është tatimi në pronë e cila (rreth 44.77% pjesëmarrje mesatare gjate viteve), pastaj taksa për ushtrimin e veprimtarisë (rreth 11.16% pjesëmarrje mesatare gjate viteve) dhe taksa për regjistrimin e trashëgimisë – ndërrimi i pronarit (rreth 9.46% pjesëmarrje mesatare gjate viteve). Kategoria taksa për ndërrim të destinimit të tokës ishte kategori që ka siguruar të hyra të konsiderueshme në vitin 2017, por në vitet në vijim, kjo kategori ka kontribuuar minimalisht. Në përgjithësi ka pasur një trend pozitiv, në rritje, të të gjitha kategorive dominuese tjera.

4.3. Supozimet parashikuese

Këshilluesi ka marr supozimet në vijim kur ka llogaritur të hyrat vetanake për periudhën 2022-2030:

Tatimi në pronë

Përmirësimet në gjenerimit vjetor të të hyrave supozohen të jenë në rritje prej +2.24%. Tarifat e rritjes së natyrshme për pronat e reja të tatueshme janë vlerësuar bazuar në informatat e zyrtarëve komunalë për trendët e pronave të reja të regjistruara çdo vit dhe rritja e natyrshme ishte supozuar të jetë 1.21% çdo vit.

Kështu që supozimi i gjenerimit vjetor të të hyrave nga tatimi në pronë do të jetë +2.24% nga pronat ekzistuese dhe 1.21% nga ndërtimet e reja që parashihen të gjenerohen për secilin vit të 8 viteve të ardhme.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
579,702	594,632	609,562	624,492	639,422	654,352	669,282	684,212	699,142

Tabela 182. Parashikimi i të hyrave vetanake nga tatimi në pronë për vitet e ardhme

Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve

Supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +7.32% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +4.60%. nga viti 2020. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej +5.96%, e ndjekur nga një rritje prej +2% çdo vjet ne vijim nga viti 2025 dhe 2025, e ndjekur nga një rritje prej +3% çdo vjet ne vijim nga viti 2026 deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
52,196	53,240	54,838	56,483	58,177	59,922	61,720	63,483	65,254

Tabela 183. Parashikimi i të hyrave vetanake nga regjistrimi i automjeteve për vitet në vijim

Të hyrat nga lejet e ndërtimit

Supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +9.92% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +6.46%. nga viti 2020. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej 8.19%, e ndjekur nga një rritje prej +2% çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
319,626	322,822	326,051	332,572	339,223	346,007	352,928	359,849	366,770

Tabela 184. Parashikimi i të hyrave vetanake nga lejet ndërtimore për vitet në vijim

Të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë

Ka pasur lëvizje të mëdha gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +91.09 % ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rrënje prej -53%.09%. nga viti 2020.Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej +2%, e ndjekur nga një rritje prej +3% çdo vjet ne vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
64,108	65,391	67,352	69,373	71,454	73,598	75,806	77,224	79,109

Tabela 185. Parashikimi i të hyrave vetanake nga regjistrimi i trashëgimisë

Të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës

Supozimet parashikuese nuk mund te bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, sepse Komuna nuk ka pasur të hyra për vitin 2020, kështu që parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +3%, e ndjekur nga një rritje prej +4% në vitin 2024 deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
10,689	11,116	11,116	11,116	11,116	11,116	11,116	11,362	11,449

Tabela 186. Parashikimi i të hyrave vetanake nga ndërrimi i destinimit të tokës për vitet në vijim

Të hyrat nga ngarkesa tjera administrative

Supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +19.29% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +0.69%. nga viti 2020. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej 9.99%.67%, e ndjekur nga një rritje prej +2% ne vitin 2024, dhe 3% ne vitin 2026 duke vazhduar e tille deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
26,266	26,791	29,467	30,351	33,383	36,717	40,384	44,051	47,718

Tabela 187. Parashikimi i të hyrave vetanake nga ngarkesat tjera administrative

Tatimet për ushtrimin e veprimtarisë:

Supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rrënje prej -2.% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +33.96%. nga viti 2020.

Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 16.66% ne vitin 2022 dhe pastaj një rritje mesatare prej +3% në vitin 2024, e ndjekur nga një rritje prej +2% çdo vjet në vijim nga viti 2026 deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
167,069	168,739	170,427	173,835	177,312	180,858	184,475	188,092	191,709

Tabela 188. Parashikimi i të hyrave vetanake nga tatimet për ushtrimin e veprimtarive

Të hyrat nga participimet ne Arsim dhe Shëndetësi:

Për arsim, Supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +17.77% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +15.55%. nga viti 2020.

Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej 16.66%, e ndjekur nga një rritje prej +2% ne vitin 2024, dhe 3% ne vitin 2026 duke vazhduar e tille deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
44,206	45,090	45,992	47,372	48,793	50,257	51,765	53,273	54,781

Tabela 189. Parashikimi i të hyrave vetanake nga participimi në arsim

Për shëndetësi, supozimet parashikuese bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në 2020 ka një rritje prej +4.56% ndryshim nga viti 2019, dhe në vitin 2021 ka një rritje prej +28.91%. nga viti 2020.

Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje ne 2022 prej 16.74%, e ndjekur nga një rritje prej +2% ne vitin 2024, dhe 3% ne vitin 2026 duke vazhduar e tille deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
38,164	38,927	39,706	40,897	42,124	43,388	44,689	45,990	47,291

Tabela 190. Parashikimi i të hyrave vetanake nga participimi në shëndetësi

DRAFT

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
TATIMI NË PRONË	519,701.98	537,631.70	556,179.99	575,368.20	595,218.40	615,753.44	636,996.93	677,269.98	702,430.02
TAKSA - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	52,196.40	53,240.33	54,837.54	56,482.66	58,177.14	59,922.46	61,720.13	63,644.17	65,384.36
TAKSA PËR LEJE NDËRTIMI	97,685.01	99,638.71	101,631.49	103,664.12	105,737.40	107,852.15	110,009.19	117,727.08	121,444.35
TAKSA PËR REGJISTRIMIN E TRASHËGIMISË - NDËRRIMI I PRONARIT	64,108.41	65,390.58	67,352.29	69,372.86	71,454.05	73,597.67	75,805.60	65,605.90	64,242.20
TAKSA PËR NDËRRIMI I DESTINIMIT TË TOKËS	10,688.57	11,116.11	11,560.75	12,023.18	12,504.11	13,004.28	13,524.45	12,494.53	18,597.53
TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE	26,265.91	26,791.23	27,327.06	28,146.87	28,991.27	29,861.01	30,756.84	32,744.09	33,907.89
TAKSA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË	167,068.54	172,080.59	177,243.01	180,787.87	184,403.63	188,091.70	191,853.54	217,841.13	228,130.74
PARTICIPIMET ARSIM	44,206.20	45,090.32	45,992.13	47,371.89	48,793.05	50,256.84	51,764.55	57,680.82	60,387.97
PARTICIPIMET SHENDETËSI	38,163.90	38,927.18	39,705.72	40,896.89	42,123.80	43,387.51	44,689.14	50,091.15	52,513.99
Tjera Kategori jodominante - totali:	80,246.75	81,851.68	83,488.72	85,993.38	88,573.18	91,230.38	93,967.29	98,705.75	101,751.29
Gjithsej:	1,100,331.67	1,131,758.43	1,165,318.70	1,200,107.93	1,235,976.04	1,272,957.43	1,311,087.65	1,368,815.5	1,411,595.2

Siç mund të shihet nga tabela e parashikimit të të hyrave vetanake, THV për komunën e Obiliqit mund të rriten deri në ~1.4M Euro në fund të vitit 2030. Kur të shikojmë të hyrat e përgjithshme vetanake, mund të shihet një trend pozitiv. Kjo rritje mund më mirë të shihet në tabelën e ardhshme.

DRAFT

Komuna e Obiliqit – THV në të kaluarën dhe të parashikuara nga viti në vit me ndryshimin e përqindjes

Siç mund të shihet nga grafiku, lëvizësit kryesorë të THV gjatë periudhës në vijim mbeten të jenë tatimi në pronë, taksa për regjistrimin e trashëgimisë dhe lejet e ndërtimit. Këto janë fushat ku komuna duhet të përpiqet të arrijë ngritje sa i përket të hyrave vetanake nëpërmjet efikasitetit të shtuar në menaxhimin e tyre financiar dhe zbatimin. Rritja e secilës kategori të të hyrave vetanake të parashikuara është siç është paraqitur në grafikun më poshtë:

Të hyrat nga tatimi në pronë vazhdojnë të rriten gradualisht për shkak të regjistrimit të përmirësuar, menaxhimit të bazës së të dhënave, faturimit të përmirësuar dhe zbatimit më të mirë. Të hyrat nga ky tatim gjithashtu do të ngritën për shkak të rritjes së natyrshme të komunës si dhe rritjes së ekonomisë. Më në fund, gjithashtu mund të llogaritet në mbledhjen e të hyrave të detyrimeve tatimore nga vitet e kaluara, e cila duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave.

Komuna duhet të përkrahë ndërmarrjet që zhvillojnë afarizëm në komunën e Obiliqit. Grumbullimi i shtuar i tatimit gjithashtu mund të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë me komunat dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (njësia e regjistrimit të biznesit). Më në fund, prania e përmirësuar e zyrtarëve komunalë brenda komunitetit të biznesit dhe zbatimi më i mirë i rregulloreve komunale mund të ndihmojë në përmirësimin e të hyrave nga bizneset. Të hyrat nga taksa për regjistrimin e automjeteve vazhdojnë të rriten për shkak të rritjes graduale të standardit të jetesës dhe kërkesës për drejtimit të automjeteve private në këtë komunë.

Të hyrat nga lejet e ndërtimit komunës janë dhe vazhdojnë të jenë kontribuues të mëdhenj të të hyrave vetanake komunale. Komuna duhet të përpiqet të zhvilloj komunën sipas vizionit te saj afatgjate duke rritur kontributin në këtë kategori dhe nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve komunale të inspektimit ne ketë fushe.

Donacionet

Ka pasur lëvizje të mëdha gjatë tri viteve të kaluara 2019 – 2022, ku në vitin 2019 ka pasur donacione të mëdha, kurse në 2020 ka një rrënje prej -28.58 % ndryshim nga viti 2017, dhe në vitin 2021 ka një rrënje prej -91.82%. nga viti 2020. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të ketë të hyra prej 10,000 Euro në 2022, pastaj një rritje në vitin 2023 prej +1%, e ndjekur nga një rritje prej +2% në 2026 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
10,100	10,201	10,303	10,509	10,719	10,934	11,152	11,279	11,459

Parashikimi i të hyrave nga donacioneve

4.3.1. FUSHAT POTENCIALE PËR INTERVENIM DHE PËRKRAHJE

Fushat për Komunën e Obiliqit në rritjen e nivelit të të hyrave vetanake te gjeneruara duhet të fokusohen në kategoritë e THV që mund të ndikohen nga veprimet e autoriteteve komunale dhe ku mund të ketë përfitime të qarta në përmirësimin e performancës komunale.

Tatimi në pronë, duke qenë njëri nga kontribuuesit më të mëdhenj, është një fushë që duhet të përkrahet. Kjo do t'i mundësojë komunës që të kenë një pasqyrë më të qartë të bazës së tatimit të tatueshëm dhe përmirësimit të politikave të tatimit që ata aplikojnë, si dhe përmirësimin e efikasitetit në zbatim dhe reagimin e komunës në dërgimin e projekteve të investimeve kapitale në zona kadastrale përkatëse që paguajnë tatimin në pronë dhe të promovojë efektin e grumbullimit të përmirësuar në jetën e përditshme të qytetarëve të zonave përkatëse.

Komuna gjithashtu mund të përkrahet në gjenerimin e të hyrave nga bizneset. Kjo mund të bëhet në dy drejtime. Njëra është që ti ndihmojë ata në përmirësimin e regjistrimit të bizneseve dhe klasifikimin dhe si rezultat të prodhojë politika më të mira tatueshme për bizneset. Gjithashtu, Komuna duhet të përpiqet që të përmirësojë lidhjet në mes të komunave dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në shkëmbimin e informatave për bizneset e regjistruara dhe funksionimin e tyre aktual. Një bazë e të dhënave të tatimeve të pa grumbulluara mund të krijohet në komunë dhe të freskohet në baza vjetore, kështu që mund të eliminohen bizneset që janë mbyllur, bankrotuar apo që nuk janë aktive, gjersa në të njëjtën kohë mundëson shënjestrim më të mirë të bizneseve ekzistuese, funksionale dhe të suksesshme. Duhet të përdoren politika për kushtëzimin e shërbimeve komunale për bizneset që kanë taksa dhe tatime të pakryera.

Një rekomandim është që komuna të fillojë të vendosë tarifa në rregulloren komunale dhe t'i zbatojë ato në baza të barabarta për të gjitha bizneset dhe ofruesit e hapësirave për reklamim. Grumbullimi i tarifave për shfrytëzimin e pyjeve dhe zbatimi i përmirësuar i këtyre tarifave, i përkrahur nga nivelet më të larta politike për lobim në mënyrë që komuna të menaxhojë tarifat dhe tatimet që vijnë nga shfrytëzimi i pyjeve, mund të rezultojë në një burim të mirë të të hyrave për komunën.

Dhënia me qira e tokës komunale, ndërtesave dhe hapësirave është një burim tjetër i mirë i të hyrave nëse menaxhohet si duhet. Komuna aktualisht ka të hyra të paqëndrueshme nga kjo kategori kryesisht për shkak të menaxhimit joadekuat. Shfrytëzimi i aseteve komunale mund të bëhet më atraktiv nëpërmjet investimeve strategjike, vendimeve dhe politikave stimuluese.

Kompletimi i dokumentacionit të planifikimit hapësinorë, duke përfshirë Hartën Zonale të Komunës, do t'i lejojë komunës që të inkurajoj zhvillimin, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë. Kjo do të ndihmonte komunën të rriste të hyrat nga lejet për ndërtim, si dhe shërbimet tjera, duke stimuluar aktivitetin e ndërtimit të ri dhe legalizimin e pronave të paregjistruara dhe pa leje.

Komuna po ashtu duhet të identifikojë donatorët potencial dhe fushave që mund të përfitojnë nga grantet dhe format e tjera të përkrahjes nga donatorët. Kjo përkrahje më tutje mund të përfshijë asistencë dhe aftësim në planifikimin e projekteve, shkrimin e propozimeve, ngritjen e fondeve dhe teknikat për monitorim dhe vlerësim. Kjo do t'i mundësonte komunës të trokiste në grande potenciale dhe në dispozicion dhe kështu të ndihmohej në rritjen e të hyrave vetanake në dispozicion.

Ky raport është përgatitur me informatat që mbulojnë performancën financiare deri në vitin financiar 2019 dhe kjo analizë të freskohet në baza të rregullta dhe të akordohen kur informatat e reja dhe më të detajuara të jenë në dispozicion.

4.3.1.1. Kapacitetet format e financimit

Ne përgjithësi, K. Obiliq, nga mungesa e fondeve pamundësohet realizimi i investimeve kapitale për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve tjera për qytetarët e komunës së Obiliqit. Një pjesë e madhe e fondeve pritet të sigurohen nga grantet qeveritare. Opsionet e financimit të investimeve kapitele për komunën e Obiliqit janë:

- **Huamarrje/ borxh nga tregu kombëtar i kapitalit** – Komuna e Obiliqit mund ta përdorë këtë metodë financimi. Huamarrja për komuna rregullohet me ligjin Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, më saktësisht neni 30.
- **Partneritet Publiko-Privat** – model investimeve kapitale ku shërbimi për qytetaret në mënyrë të kontratës koncesionare kalon tek sektori privat për një periudhë afatmesme apo afatgjatë. Sektori ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimit publik për të cilën shfrytëzuesit paguajnë. Nëse komuna e Obiliqit dëshiron ta ndjek këtë zgjedhje, ka nevojë që të shikojë te cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejojë t'i sigurojë sektori privat. Për këtë duhet të ndiqen hapat e nevojshëm sipas ligjit nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Private, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.
- **Incentiva Private e Financimit** – lloj i Partneritetit Publiko-Privat, ku sektori privat ka eksperiencë dhe ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimi publik, por nuk mund të kërkojnë pagesë tek shfrytëzuesit e shërbimit, kështu që komuna paguan për atë shërbim në formë të pagesave vjetore tek sektori privat. Nëse komuna e Obiliqit dëshiron ta ndjek këtë zgjedhje, ka nevojë që të shikojë te cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejojë t'i sigurojë sektori privat. Për këtë duhet të ndiqen hapat e nevojshëm sipas ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.
- **Donatorët.** Mbajtja dhe kultivimi i komunikimit të mirëfilltë me donatorët. Kjo do të thotë një seri aktivitetesh, përmes së cilave donatorët mund të shohin përmirësim të dukshëm lidhur me ndihmat të cilat dëshirojnë t'i shpërndajnë. Një komunikim i tillë dhe fleksibilitet në punë ndihmon në sigurimin e mjeteve për investime kapitale. Sa më shumë investime kapitale të suksesshme, ndihmon në zgjerimin e rrjetit të donatorëve, me të cilët komuna e Obiliqit do mund të bashkëpunojë. Sidoqoftë, nevojitet koha për sigurimin e fondeve të tilla dhe komuna duhet të jetë e angazhuar vazhdimisht në këto lloj përpjekjesh.

DRAFT

5. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

PZHK- ja është dokument politik hapësinor që përcakton sfidat dhe mundësitë kryesore në komunë, përcakton vizionin hapësinor të ardhshëm dhe përshkruan një seri strategjish për të arritur atë vizion.

Korniza e zhvillimit hapësinor është pjesa kryesore e PZHK-së. Korniza e zhvillimit hapësinor paraqet zhvillimin hapësinor për tërë territorin e komunës së Obiliqit për periudhën **8** (për tetë vite), gjegjësisht formulon strukturën dhe organizimin hapësinor për zhvillim të ardhshëm.

Gjatë hartimit të PZHK-së është bërë një mobilizim i të gjitha resurseve njerëzore dhe intelektuale nga komuna dhe jashtë saj, si konsultime me ekipin bazë dhe ekipin komunal të planifikimit për hartim të PZHK-së dhe duke organizuar aktivitete të pandërprera të grupeve punuese, institucioneve, sektorëve dhe të gjithë qytetarëve me qëllim të hulumtimit, analizimit dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme në mënyrë gjithëpërfshirëse.

5.1. VIZIONI

Vizioni është faza e parë në zhvillim, ku akterët bien dakord për konceptin e përgjithshëm, të gjerë dhe të përbashkët të vizionit të komunës. Qëllimi i vizionit është të formulojë imazhin e së ardhmes dhe një model që komuna e Obiliqit duhet të arrijë gjatë viteve të ardhshme. Imazhi përmban çështjen kryesore dhe qëllimet e zhvillimit të pa ndikuar nga faktorët e jashtëm.

Komuna e Obiliqit është një qendër e vogël ekonomike, por me një barrë shumë të madhe industriale, atë të prodhimit të 97% të rrymës elektrike të Kosovës. Andaj, Obiliqi nuk është vetëm një komunë, në rrethinë të Prishtinës, por një qendër rajonale industriale, ku gjithashtu shtrihen mihjet e qymyrit që janë një vlerë e jashtëzakonshme për ekonominë dhe sektorin e energjisë në Kosovë.

Marr parasysh këtë, territori i komunës së Obiliqit në 10 vitet e fundit është zhvilluar dhe duhet të zhvillohet duke u bazuar në vizionin e dhënë për këtë regjion sipas Planit Hapësinor të Kosovës (PHK), që identifikon regjionin, si:


"Porti i Kosovës"- Hapësira e kaltër- administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina si qendër kryesore dhe kryeqendër e Kosovës, Obiliqi, Podujeva, Fushë Kosova, Lipjani, Drenasi dhe Shtime që gravitojnë në qytetin e Prishtinës.

Të gjitha analizat, vlerësimet, trendet, projeksionet, prognozat dhe konkludimet rezultuan se Obiliqi duhet të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duke planifikuar zhvillim të zonave të banimit, industriale, rekreative turistike që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe mirëqenien e popullsisë, sot dhe në të ardhmen. PZHK duhet të sigurojë zhvillim të balancuar ashtu që zhvillimet ekonomike të mos jenë në konflikt (kanë efekte negative por më së paku efekt minimal) me fushat tjera, siç janë: mjedisi, shëndeti, dhe siguria e popullatës.

Gjithashtu, duke marrë parasysh kontekstin e ndërlikuar politik dhe rrethanat e kushtet e përgjithshme që janë në lidhshmëri me njëra tjetrën (mundësia për ri-funksionalizimin e prodhimtarisë së xehes dhe përpunimin e metaleve, potenciali për zhvillimin e turizmit), shanset për një zhvillim vlerësohet të jenë në potencialin e një qendre multi-funksionale e lidhur me opsionet e qytetit të arsimit të lartë si dhe në lëminë e tregtisë dhe bujqësisë.

DRAFT

Obiliqi- Fabrika e rrymës elektrike të Kosovës



Obiliqi ka edhe shumë shtylla tjera ku mundet të mbështetet deklarata e vizioni të komunës, i cili në mënyrë skematike mundet të paraqitet në ketë format:

Ndërsa në formë të deklaratës:




Figura 2. Ilustrimi i konceptit të kornizës së zhvillimit hapësinor

5.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTA

Qëllimet e veçanta të cilat do prezantohen në fushat tematike të PZHK-së, të mbështetura në hulumtimin e gjerë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, paraqesin sintetizim të qëllimeve të prezantuara nga drejtoritë komunale, institucionet tjera publike lokale dhe qendrore, shoqërisë civile, si dhe "16 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030".

Objektivat e propozuara janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të lidhura për afatet kohore që synohet për tu arritur brenda një periudhë kohore specifike.



Figura 15. Zbërthimi i Objektivave sipas konceptit SMART

DRAFT

1. Jo Varfërisë	•Elimino varfërinë në të gjitha format e tij kudo.
2. Elimino Urinë	•Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore, përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.
3. Shëndet i mirë	•Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerëzve të gjitha moshave.
4. Arsim cilësor	•Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës, të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë
5. Barazi Gjinore	•Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.
6. Ujë i pastër	•Sigurimi i qasjes dhe administrimit të qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë.
7. Energji e përballueshme	•Sigurimi i energjisë së qëndrueshme, moderne, të sigurtë dhe me çmim të përballueshëm.
8. Zhvillim ekonomik	•Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja, për të gjithë.
9. Industrisë, Inovacionit dhe Infrastrukturës	•Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe e inovacionit.
10. Redukto pabarazitë	•Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet të Qytetit dhe zonave rurale, si dhe në mes të zonave rurale.
11. Qytete të qëndrueshme	•Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirës, të sigurta, rezistuese ndaj rreziqeve dhe vështirësive, dhe të qëndrueshëm.
12. Konsumim i përgjegjshëm	•Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
13. Ndryshimi klimatik	•Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj.
14. Jeta nën Ujë	•Konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për një zhvillim të qëndrueshëm.
15. Jeta në Tokë	•Shfrytëzim i qëndrueshëm i pyjeve dhe ndalimi i degradimit të tokës dhe humbja e biodiversitetit.
16. Institucione efektive	•Zhvillim gjithëpërfshirës, qasje në drejtësi për të gjithë dhe institucione efektive dhe të përgjegjshme.
17. Partneritet për Qëllimet	•Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm

Figura 16. Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshinë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

5.2.1. Zhvillimi ekonomik

Q. 1. Krijimi i kushteve për konkurrencë në tregun rajonal të veprimtarive të industrisë prodhuese dhe përpunuese si dhe veprimtarive komerciale.

O. 1.1. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillim industrial i qëndrueshëm në zonën industriale në Llazarevë deri në vitin 2023.

O. 1.2. Sigurimi I infrastrukturës përcjellëse për integrimin e korridorit ekonomik përgjatë N2 deri në vitin 2024.

O. 1.3. Krijimi i zonës për zhvillim industrial/ komercial përgjatë rrugës Obiliq- Caravodicë (Palaj) deri në vitin 2023.

O.1.4. Krijimi i një zone ekonomike me qasje në rrugën Obiliq- Prishtinë deri në vitin 2023.

O.1.5. Ofrimi i infrastrukturës dhe funksioneve përcjellëse për terminalin e ri në Obiliq deri në vitin 2025.

O.1.6. Ri-zhvillimi i pjesëve të dekomisionuara të hapësirave të KEK- ut në hapësira ekonomike/industriale deri në vitin 2029.

Q. 2. Ekonomizimi – valorizimi ekonomik i resurseve natyrore dhe kulturore për zhvillim të turizmit.

O.2.1. Ngritja e kapaciteteve turistike sipas analizave ekonomike, sociale-kulturore, mjedisore në Grabofc të Epërm, Shipitullë, Breznicë dhe Kozaricë deri në vitin 2026.

O.2.2. Nxitja e zhvillimit të turizmit të gjuetisë dhe peshkatarisë në vendgjuetinë Qyqavica, deri në vitin 2029.

O.2.3. Shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore me theks të veçantë në dy zonat e mbrojtura (Tyrbja dhe Gazimestani) në Obiliq për zhvillim të qëndrueshëm turistik, në vazhdimësi.

O.2.4. Zhvillimi i aseteve turistike, me theks të veçantë Obeliskut të Skënderbeut në Llazarevë dhe Përmendoren për Gruan, në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor deri në vitin 2024.

O.2.5. Vazhdimi i hulumtimeve arkeologjike në disa lokacione në komunë si dhe ndërtimi i Muzeut Etnologjiko-Arkeologjik për nxitje të zhvillimit historik, deri në vitin 2026.

O.2.6. Krijimi i një zone rekreativo- sportive në hapësirën e ish- deponisë së TC- A, deri në vitin 2026.

Q. 3. Modernizimi, rritja e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore në Komunën e Obiliqit

O.3.1. Mbrojtja në vazhdimësi e tokës bujqësore nga tjetërsimi 2022 – 2030.

O.3.2. Re-vitalizimi i sistemit ekzistues të ujitjes të Ibër Lepencit në Baimofc dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në Breznicë- Kozaricë dhe Grabofc të Epërm deri në vitin 2029.

O.3.2. Pastrimi i sistemit të ujitjes në Sibovc dhe Hamidi deri në vitin 2022.

O.3.3. Rritja e fondit dhe përmirësimi racor blegtoral për 10% për çdo vite dhe zgjerimi i kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të qumështit, deri në vitin 2029.

O.3.4. Rritja e sipërfaqeve të kultivuara me drithëra, perime dhe peme, së paku 5% në vit, deri në vitin 2029.

O.3.5. Rritja e kapaciteteve grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve, deri në vitin 2029.

O.3.6. Rritja e vazhdueshme e numrit të shoqërive të bletëve, deri në vitin 2029.

O.3.7. Ndërtimi i një ekonomie të qëndrueshme të pyjeve (ripyllëzimi, mbrojtja e pyllit, ruajtja), deri në vitin 2029.

Q.4. Mbështetja e furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike.

O. 4.1. Mbështetja e ndërtimit të TC Kosova e Re me infrastrukturë përcjellëse, deri në vitin 2029.

O. 4.2. Sigurimi i fuqisë punëtore lokale nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve profesionale në Obiliq deri në vitin 2026.

O. 4.3. Integrimi i zgjatjes së procesit të dekomisionimit të TC Kosova A në zhvillimin e komunës deri në funksionalizimin e të TC Kosova e Re, deri në vitin 2029.

O. 4.4. Avancimi i teknologjisë prodhuese të TC Kosova B deri në vitin 2023.

O. 4.5. Ofrimi i rrjetit sekondar dhe terciar sipas nevojës për një sistem stabil të energjisë elektrike, në vazhdimësi.

O. 4.6. Studimi i potencialeve për gjenerim të energjisë elektrike nga BRE në Komunën e Obiliqit deri në vitin 2023.

5.2.2. Infrastruktura teknike

Q.1. Menaxhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm i ujësjellësit, në të mirë të jetës së shëndetshme dhe mirëqenies më të mirë

O.1.1. Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në të gjithë komunën, deri në vitin 2029.

O.1.2. Përfundimi i projekteve të ujësjellësit në fshatrat pa ujësjellës, për një shërbim më cilësor të qytetareve të asaj zone deri në vitin 2025.

O.1.3. Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 5% çdo vit, deri në vitin 2029.

O.1.4. Mbulimi me furnizim dhe modernizimi i infrastrukturës së ujësjellësit në zonën rurale për 5% çdo vit sipas prioriteteve, deri në vitin 2025.

O.1.5. Zgjerimi i sistemit të ujitjes Ibër-Lepenc

Q.2. Menaxhimi dhe qasje e qëndrueshme në infrastrukturë të ujërave të zeza

O.2.1. Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e zeza deri në vitin 2024

O.2.2. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit, deri në vitin 2025.

O.2.3. Zgjerimi i rrjetit të infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit në zona urbane dhe rurale, deri në vitin 2028.

O.2.4. Ndërtimi dhe integrimi i kolektorëve nga pikat shkarkuese deri te kolektori kryesor për impiant, deri në vitin 2023.

Q.3. Furnizimi stabil dhe i qëndrueshëm me energji elektrike

O.3.1. Sigurimi i furnizimit me energji të pandërprerë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve dhe sigurimin e cilësisë në furnizimin me energji elektrike, deri në vitin 2028.

O.3.2. Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve të reja transformuese dhe bartëse, deri në vitin 2028.

O.3.3. Përmirësimi i gjendjes në infrastrukturën e rrjetit të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë në vendbanimet me të rrezikuara, në vazhdimësi.

O.3.4. Kalimi nga rrjeti ajror në nëntokësor, në vazhdimësi.

O.3.5. Vlerësimi i potenciale për gjenerim të energjisë së ripërtritshme në Obiliq, deri në vitin 2023.

O.3.5. Zhvillimi i Parkut Solar në Veri-Lindje të Komunës.

Q.4. Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes kolektive përmes sistemit të kogjenerimit

O.4.1. Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 1, deri në vitin 2025.

O.4.2. Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 2, deri në vitin 2027.

O.4.3. Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 3, deri në vitin 2029.

Q.5. Ofrimi i shërbimeve moderne të telekomunikimit

O.5.1. Mbulueshmëria e 100% të zonave me interes komunal me rrjet të telekomunikimit, deri më 2025.

O.5.2. Shtrirja e kabllove optike apo vendosja e rrjetit në gypa nëntokësor, deri në vitin 2029.

O.5.3. Vendosja dhe organizimi i antenave për transmetim të valëve sipas kritereve të aplikueshme, deri në vitin 2029.

Q.6. Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave dhe infrastrukturës përkatëse

O.6.1. Funksionalizimi i deponisë dhe trajtimi i mbeturinave inerte dhe shtazore sipas standardeve të aplikueshme, deri në vitin 2025.

O.6.2. Ulja e sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi nëpërmjet trajtimit, ripërdorimit dhe përgatitjes për riciklim të mbeturinave, me përfitime mjedisore dhe financiare për komunitetin dhe biznesin, deri në vitin 2029.

O.6.3. Ndërtimi i një deponie për mbeturina inerte, deri në vitin 2026.

O.6.4. Përmirësimi i infrastrukturës së deponisë së mbeturinave në Mirash dhe regjenerimi i zonave për-rreth saj, deri në vitin 2029.

5.2.3. Infrastruktura e transportit

Q.1. Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës së transportit

O.1.1. Sigurimi i rrugëve të sigurta për të bashkëlidhur fshatrat me qytetin, deri në vitin 2024.

O.1.2. Zhvillimi i qarkores në zonën urbane, deri në vitin 2023.

O.1.3. Sinjalizimi vertikal dhe horizontal në gjithë rrjetin e transportit rrugor, në vazhdimësi.

Q.2. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të transportit publik.

O.2.1. Ndërtimi i stacionit të autobusëve në zonën urbane, deri në vitin 2024.

O.2.2. Ndërtimi i terminusit në afërsi të stacionit hekurudhor, deri në vitin 2024.

Q.3. Sigurimin e infrastrukturës bashkëkohore të transportit hekurudhor

O.3.1. Ndërtimi i stacionit të ri hekurudhor, deri në vitin 2025.

O.3.2. Modernizimi i linjës hekurudhore Prishtinë-Obiliq-Mitrovicë, në vazhdimësi.

5.2.4. Infrastruktura publike dhe sociale

Q.1. Hapësira adekuate për arsimim, kujdes të fëmijëve dhe infrastrukturë për zhvillim të edukatës fizike në kuadër të arsimit

O.1.1. Ndërtimi i 2 shkollave fillore të mesme të ulëta, në Obiliq dhe Baimofc, deri në vitin 2023.

O.1.2. Ndërtimi i 5 institucioneve parashkollore në Mazgit, Milloshevë, Hade e Re, Lajthishtë dhe Krushefc, deri në vitin 2026.

O.1.3. Ndërtimi i 3 sallave të edukatës fizike në SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë, SHFMU" Migjeni" në Sibovc, SHFMU "Abdurrahmon Gërguri" në Kryshefc, deri në vitin 2024.

Q.2. Shërbime mjekësore dhe të përkujdesjes sociale me cilësi të lartë dhe të decentralizuara.

O.2.1. Ndërtimi i Qendrës së re Kryesore të Mjekësore Familjare në qytetin e Obiliqit, deri në vitin 2025.

O.2.2. Sanimi i AMF- ve në vendbanimet, deri në vitin 2028.

Q.3. Përmirësimi i infrastrukturës së mirëqenies sociale dhe komunitetit

O.3.1. Ndërtimi i ndërtesës për banim me shumë njësi me 50 njësi për rastet sociale, deri në vitin 2025.

O.3.2. Ndërtimi i 50 shtëpive për rastet sociale, deri në vitin 2024.

O.3.3. Ndërtimi i qendrës për strehim të përkohshëm për se paku 20 familje, deri në vitin 2026.

O.3.4. Ndërtimi i qendrës për strehim për persona të moshuar, deri në vitin 2026.

Q.4. Përmirësimi i infrastrukturës kulturore

O.4.1. Ndërtimi i Bibliotekës Komunale, deri në vitin 2023.

Q.5. Përmirësimi i infrastrukturës së hapësirave sportive dhe të gjelbra-rekreative

O.5.1. Revitalizimi i stadiumit të qytetit "Agron Rama", deri në vitin 2025.

O.5.2. Rregullimi i fushave sportive në shkolla në Raskovë, Kozaricë, Sibovc, Plemetin dhe Palaj, deri në vitin 2025.

Q.6. Përmirësimi i infrastrukturës së hapësirave të hapura publike

O.6.1. Krijimi i brezave të gjelbër përreth termocentraleve, deri në vitin 2025.

O.6.2. Ndërtimi i sheshit të qytetit "Adem Preniqi", deri në vitin 2023.

O.6.3. Krijimi i parqeve të reja, deri në vitin 2028.

Q.7. Përmirësimi i infrastrukturës së varrezave

O.7.1. Rregullimi dhe zgjerimi i varrezave në Milloshevë, Sibovc, Mazgit dhe Baimofc, deri në vitin 2029.

5.2.5. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Q.1. Parandalimi i ndotjes së komponentëve mjedisore

O.1.1. Vendosja e sistemit (senzorëve) për monitorimin e ajrit në disa lokacione-pika monitoruese, duke u dhënë përparësi ndotësve të mëdhenj industrial dhe "pikave të nxehta", deri në vitin 2023.

O.1.2. Pyllëzimi i brezave gjelbërues: Rreth minierave ekzistuese dhe të reja të mihjes, deponive të hirit dhe me theks të veçantë përreth TC-ve ekzistuese, deri në vitin 2022.

O.1.3. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve ujore, në veçanti lumit Sitnica, në vazhdimësi.

O.1.4. Trajtimi i ujërave të ndotura nga amvisëria, deri në vitin 2029.

O.1.5. Parandalimi i ndotjes së tokës duke menaxhuar të gjitha llojet e mbeturinave, në vazhdimësi.

O.1.6. Hartimi i një plani për ripyllëzim me theks të veçantë në zonën e Mihjeve dhe te deponia e mbeturinave në Mirash, në përputhje me mbrojtjen e mjedisit, deri në vitin 2022.

O.1.7. Ruajtja nga dëmtimi i llojit bimor të rrallë dhe karakteristik Alium pendulinum- triquetrum dhe habitatit të ekosistemit pyjor në fshatin Grabofc të Epërm, deri në vitin 2029.

O.1.8. Përmirësim i cilësisë së ajrit duke vendosur filtra të ajrit në TC B, deri në vitin 2023.

O.1.9. Trajtimi i ujërave të ndotura nga Korporata Energjetike e Kosovës, deri në vitin 2026.

Q.2. Programet remediate në hapësirat publike dhe private (Deponia e hirit, hapësirat publike, shkollat, institucionet dhe tokat bujqësore)

O.2.1. Rregullimi i kanaleve drenazhuese të ujërave te deponia i hirit, deri në vitin 2023.

O.2.2. Zhdukja e menjëhershme e hirit pas eksploatimit, në vazhdimësi.

O.2.3. Rinatyrimin e zonave të mihjeve të ekzistuese të TC A dhe TC B, deri në vitin 2029.

O.2.4. Menaxhimi i integruar i sistemit të mbeturinave, deri në vitin 2023.

O.2.5. Trajtimi i qenve endacak, deri në vitin 2023.

Q.3. Mbrojtja dhe menaxhimi i situatave që mund të ndodhin nga Fatkeqësitë Natyrore

O.3.1. Rregullimi i segmenteve lumore për mbrojtje nga vërshimet si muret mbrojtëse, gabionet, argjinaturat, ngritje të terrenit me mbushje për Lumin Sitnica, Drenica, Llapi, deri në vitin 2029.

O.3.2. Zhvillimi i një studimi- analizë për ndikimin e zhurmës tek receptorët e mundshëm në Obiliq, deri në vitin 2024.

O.3.3. Zhvillimi i kanaleve të drenazhimit, mbushje, injektime për mbrojtje nga thatësira dhe zjarri në pyje, deri në vitin 2029.

O.3.4. Përcaktimi dhe monitorimi i zonave të zhurmës në zonat e banimit dhe zonën përreth termocentraleve dhe mihjeve, deri në vitin 2023.

O.3.5. Mbrojtja e biodiversitetit dhe llojeve organike me rendësi 2023.

O.3.6. Pyllëzimi i sipërfaqeve të tokës që është në dispozicion dhe e përshtatshme për mbjelljen e pyjeve, që zvogëlon erozionin për rreth lumenjve Drenica, Sitnica dhe Llapi gjë që zvogëlon shkallën e erozionit, deri në vitin 2024.

O.3.7. Sigurimi i qasjes në ujë për zjarrfikësit në fshatrat Kozaricë, Breznicë, Grabofc dhe në fshatrat tjerë në rrezik nga zjarret, deri në vitin 2027.

DRAFT

5.2.6. Trashëgimia natyrore dhe kulturore

Q.1. Përcaktimi i masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore

O.1.1. Përcaktimi e kufijve të zonave dhe masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore, deri në vitin 2023.

O.1.2. Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore nga MKRS në bashkëpunim me komunën, deri në vitin 2023.

Q.2. Përcaktimi i masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore

O.2.1. Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore nga MKRS në bashkëpunim me komunën, deri në vitin 2023.

5.2.7. Vendbanimet

Q.1. Planifikimi efektiv për vendbanimet e destinuara për mihje

O.2.1. Zhvillimi i planeve sociale për fshatra që duhet të rivendosen, deri në vitin 2025.

O.2.2. Përcaktimi i destinimit të përshtatshëm për zonat që nuk nevojitën më tutje për mihje, deri në vitin 2023.

Q.2. Zhvillimi i një planifikimi hapësinor kompakt dhe të qëndrueshëm

O.1.1. Kompaktësimi i qëndrueshëm i zonës urbane të Obiliqit, në vazhdimësi, deri në vitin 2029.

O.1.2. Zhvillimi i ekuilibruar i vendbanimeve rurale, deri ne vitin 2029.

Q.3. Krijimi i vendbanimeve të zhvilluara qëndrueshëm që ofrojnë kualitetit më të lartë të mundshëm për jetesë

O.3.1. Krijimi i hapësirave të mirëfillta për banim, me të gjitha elementet e nevojshme përcjellëse, deri në vitin 2029.

O.3.2. Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe rekreative në funksion të të gjitha vendbanimeve dhe krijimi i qasjes në to, deri në vitin 2025.

O.3.3. Krijimi dhe rregullimi i një zone rekreative-sportive në periferi të qytetit, deri në vitin 2023.

O.3.4. Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese në zonën urbane të qytezës, në vazhdimësi.

O.3.5. Ofrimi i qasjes së barabartë në shërbime për të gjithë banorët e komunës, ne vazhdimësi.

5.2.8. Vendbanimet jo- formale

Q.1. Trajtimi i vendbanimeve joformale ekzistuese dhe parandalimi i paraqitjes së vendbanimeve joformale

O.1.1. Formalizmi i të dy vendbanimeve joformale, deri në vitin 2024.

Q.2. Mbështetja për trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje

O.2.1. Mbështetje procesit të legalizimi i të gjitha ndërtimeve pa leje dhe integrimi i tyre në zona të urbanizuara, në vazhdimësi.

5.2.9. Banimi

Q.1. Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e tanishme dhe në të ardhmen

O.1.1. Rritja e fondit banesor dhe dendësimi i ndërtimit në zonën urbane dhe zonën rurale, deri në vitin 2028.

O.1.2. Sigurimi i banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës, në vazhdimësi.

DRAFT

5.2.10. Shfrytëzimi i tokës

Q.1. Alokimi i sipërfaqeve në shfrytëzimin e planifikuar të tokës bazuar në interesat kombëtare

O.1.1. Trajtimi i të gjitha hapësirave (sipërfaqësore dhe nëntokësorë) dhe përmbajtjeve tjera për TC A dhe TC B prej vitit 2020 deri në vitin 2028 edhe në vazhdimësi.

O.1.2. Trajtimi i të gjitha hapësirave (sipërfaqësore dhe nëntokësorë) dhe përmbajtjeve tjera për TC Re deri në vitin 2028 edhe në vazhdimësi.

O.1.3. Sigurimi dhe trajtimi i planifikuar i të gjitha hapësirave për ndërtimin dhe zgjerimin e të gjitha rrugëve të reja nacionale.

O.1.4. Sigurimi i sipërfaqeve të planifikuar për shfrytëzim të energjisë solare për prodhim të energjisë elektrike.

O.1.5. Zhvillimi i shfrytëzimeve të përkohshme në harmoni me PHZVE Mihja e Re, si në vendbanim dhe në zonën bujqësore.

Q.2. Sigurimi i planifikuar i shfrytëzimit të tokës duke marr në konsideratë funksionin rajonal që luan komuna e Obiliqit

O.1.1. Sigurimi i sipërfaqeve të planifikuar për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugëve regjionale, në vazhdimësi.

O.1.2. Sigurimi i sipërfaqeve të planifikuara për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në komunën e Obiliqit, deri në vitin 2028.

Q.3. Shfrytëzimi efikas i tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor

O.3.1. Ruajtja e harmoninë mes shfrytëzimit të tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe institucioneve, në vazhdimësi.

O.3.2. Zhvillimi i planifikuar i shfrytëzimit të tokës, në vazhdimësi.

Q.4. Obiliqi komunë me vendbanime kompakte

O.4.1. Mbajtja nën kontroll e zhvillimeve në vendbanime, me theks në ato lineare si në Baimofc, Bakshi, në vazhdimësi.

O.4.2. Mbajtja nën kontroll e zhvillimeve të ndërtimit në vendbanimet e shpërndara me theks të veçantë në Breznicë, Cërkvena Vodicë, Dobrosellë, Grabofci i Epërm, Hamidi, Kryshefc, Llazarevë, Mazgit, Milloshevë, Plemetin, Raskovë, Shipitullë, Sibovc, në vazhdimësi.

Q.5. Zhvillimi i banimit të qëndrueshëm në komunën e Obiliqit.

O.5.1. Banim i qëndrueshëm dhe zhvillim kompakt i banimit.

O.5.2. Promovimi i ndërtesave të qëndrueshme për banim.

O.5.3. Trajtimi i zonave të banimit të ndërtuara në sipërfaqet bujqësore nën komasacion, deri në vitin 2023.

Q.6. Promovimi i hapësirave të gjelbra në qytetin e Obiliqit

O.6.1. Të sigurohen hapësira të hapura dhe të gjelbërta, sidomos në zonat e caktuara për banim të dendur dhe komercial në zonën urbane, deri në vitin 2025.

O.6.2. Ruajtja dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta ekzistuese në komunën e Obiliqit.

Q.7. Qasje e integruar në mbrojtje të mjedisit dhe të sipërfaqeve me rrezikshmëri.

O.7.1. Mbrojtje e vazhdueshme e mjedisit dhe sipërfaqeve të ndotura, në vazhdimësi.

Q.8. Qasja e integruar në mbrojtje të sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore në kuadër të shfrytëzimit të tokës drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

DRAFT

O.8.1. Konservimi dhe fuqizimi i sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore, në vazhdimësi.

Q.9. Qasje e integruar në mbrojtje të zonave të mbrojtura arkeologjike dhe historike.

O.9.1. Ruajtja e zonave ekzistuese të mbrojtura, në vazhdimësi.

O.9.2. Definimi dhe përcaktimi i zonave për hulumtime të reja arkeologjike në komunën e Obiliqit, deri në vitin 2029.

Q.10. Qasja e integruar në mbrojtje të sipërfaqeve për trashëgimi natyrore drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

O.10.1. Menaxhimi dhe ruajtja e sipërfaqeve të trashëgimisë natyrore, në vazhdimësi.

Q.11. Qasje e integruar dhe mbrojtje e sipërfaqeve të tokës bujqësore.

O.11.1. Formësimi dhe bashkimi i parcelave të fragmentuara me proces të komasacionit, deri në vitin 2028.

O.11.2. Integrimi i sistemeve të avancuara për bujqësi, në shërbim të menaxhimit të sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore.

O.11.3. Ruajtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore ekzistuese, në vazhdimësi.

O.11.4. Promovimi dhe zhvillimi i hapësirave për bujqësi dhe blegtori, në vazhdimësi.

O.11.5. Promovimi dhe zhvillimi i tokës bujqësore për bletari, në vazhdimësi.

Q.12. Qasje e integruar dhe mbrojtje e sipërfaqeve të tokës pyjore.

O.12.1. Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese të tokës pyjore, në vazhdimësi.

O.12.2. Ripyllëzimi i sipërfaqeve të reja dhe atyre të dëmtuara të tokës pyjore, në vazhdimësi.

Q.13. Zhvillim i sipërfaqeve të reja për zona komerciale dhe krijimi i kushteve për hapësira të qëndrueshme komerciale.

O.13.1. Zhvillimi i sipërfaqeve për korridore zhvillimore përgjatë rrugëve nacionale, në vazhdimësi.

O.13.2. Ruajtja dhe mirëmbajtja e zonave ekzistuese ekonomike e komerciale, në vazhdimësi.

Q.14. Zhvillim i sipërfaqeve të reja për zona industriale dhe krijimi i kushteve për hapësira të qëndrueshme industriale.

O.14.1. Zhvillimi i sipërfaqeve për zona të reja industriale, deri në vitin 2029.

O.14.2. Ruajtja dhe mirëmbajtja e zonave ekzistuese industriale, deri në vitin 2029.

Q.15. Zhvillim i qëndrueshëm i bujqësisë dhe sipërfaqeve bujqësore në kuadër të zhvillimit ekonomik

O.15.1. Zhvillim i sipërfaqeve të tokës bujqësore për prodhimin e produkteve bujqësore nga kulturat e lavërtarisë.

O.15.2. Zhvillimi i bujqësisë në kuadër të shfrytëzimit të sipërfaqeve për prodhime të produkteve nga blegtoria.

O.15.3. Zhvillimi i bujqësisë në kuadër të shfrytëzimit të sipërfaqeve për prodhime të produkteve nga bletaria.

O.15.4. Ruajtja e tokës bujqësore përmes kompaktësimit të vendbanimeve.

Q.16. Turizëm i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit ekonomik

O.16.1. Qasje e integruar dhe e qëndrueshme në funksion të zhvillimit të territoreve me potencial për zhvillim të turizmit malor, deri në vitin 2029.

O.16.2. Zhvillim i sipërfaqeve me potenciale për turizëm kulturor, deri në vitin 2028

DRAFT

Q.17. Krijimi i hapësirave për zgjerim dhe fuqizim të infrastrukturës së rrugore

O.17.1. Krijimi i sipërfaqeve për rrugë të planifikuara në shërbim të një infrastrukture rrugore të qëndrueshme, deri në vitin 2025.

O.17.2. Alokimi i korridoreve për rruge bujqësore dhe pyjore, deri në vitin 2023.

O.17.3. Ruajtja dhe mirëmbajtja korridoreve të rrugëve ekzistuese bujqësore dhe pyjore, në vazhdimësi.

5.3. SKENARËT E PROPOZUAR HAPËSINOR

Përgatitja e skenarëve hapësinor është një metodë e planifikimit strategjik, me qëllim të analizimit të zhvillimeve të mundshme në të ardhmen, duke analizuar situata alternative për të ardhmen dhe duke integruar elemente që mund të ndihmojnë në realizim. Skenarët bazohen në veprime hipotetike nën supozimin e një mjedisi me zhvillim stabil, duke marr parasysh aspektet pozitive dhe negative zhvillimore. Prandaj, duhet të analizohen faktorët relevantë, të cilët kanë ndikim kryesor në zhvillim.

Përveç se paraqiten mundësitë e shfaqjes së një situatë hipotetike në të ardhmen, janë paraqitur edhe variacione dhe alternativa. Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit e kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor konceptin e PZHK-së përmes tre koncepteve/skenarëve, si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinor të vendbanimeve. Sa i përket koncepteve të mundshme të zhvillimit si bazë për të zhvendosur barrën e zhvillimit jo të qëndrueshëm të Obiliqit, koncepti kompakt lind natyrshëm dhe veçanërisht i zbatueshëm për komunat si Obiliqi, duke sjellë një shpërndarje të përshtatshme, të ekuilibruar hapësinore përpos kufizimeve natyrore, vështirësia e trafikut dhe çrregullimeve ekologjike dhe krijon mundësi për lidhje të forta shumëdimensionale të nyejve dhe vendbanimeve tjera.

Gjithashtu, policentrizmi, nënkupton një strukturë të ndërlidhur të rrjetit komunal të përbërë nga nën-qendra të shumta urbane apo rurale, që karakterizohen me disa qendra të shpërndara, me hierarki të ndryshme në aspektin e madhësisë, morfologjisë, rendit hapësinor, funksionit, me sferat e ndikimit drejt vendbanimeve më të afërta. Komuna e Obiliqit duke ndërthurur në vete shumë kufizime për zhvillime të reja, si tokat nën komasacion dhe sistem të ujitjes, tokat nën mihjet ekzistuese dhe të planifikuara; ka nevojë për zhvillim të ardhshëm policentrit duke krijuar ndërlidhje ndërmjet zonës urbane dhe rurale edhe përpos kufizimeve hapësinore. Andaj, që të tre skenarët e propozuar për koncept të zhvillimit hapësinor të Obiliqit janë në vete koncepte me kornizë zhvillimore policentrite, që kombinojnë përparësitë e modeleve kompakte dhe të shpërndara të zhvillimit të vendbanimeve, ku disa nën qendra janë të lidhura në një rrjet hapësinor dhe zhvillimor dhe plotësojnë njëri-tjetrin funksionalisht, duke gjeneruar një masë urbane si qendër kryesore, zonën urbane.

Urbanizimi nxit rritjen si rezultat ndaj forcave ekonomike, shoqërore dhe politike me implikim hapësinor, financiar dhe mjedisor. Disa nga shkaqet e shtrirjes urbane janë: rritja e popullsisë, ekonomia, zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe sigurimi i infrastrukturës me investime publike që inkurajojnë zhvillimin.

Rrjedhimisht, të tre skenarët e propozuar zhvillimor bazohen në rritjen e popullsisë së Komunës së Obiliqit nga 21,549 në 28,307 mijë banorë deri në vitin 2028.

Skenarët është propozuar duke marr parasysh zhvillimin e Obiliqit ndër vite, duke integruar interesat kombëtar që shtrihen në Obiliq si dhe duke tentuar përgjigje ndaj nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Të tre skenarët e propozuar janë analizuar në rrafshin hapësinor, politik dhe social dhe është diskutuar me shoqërinë civile, dhe duke marr parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në territorin e komunës së Obiliqit si dhe të gjitha implikimeve hapësinore që reflektojnë gjendjen në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor.

Për zhvillimin potencial, çështjet kyçe në vijim janë marr parasysh si çështje me ndikim kryesor:

- Zhvillimi i shfrytëzimit të tokës në përgjithësi.
- Zhvillimi i aktiviteteve në vendbanime.
- Niveli teknik dhe efikasiteti i infrastrukturës teknike.
- Niveli i shërbimeve publike dhe sociale.

5.3.1. SKENARI 1 - SKENARI KRYESOR NGA PZHK E KALUAR

Skenari I i propozuar është replikim i konceptit të përvetësuar të PZHK- së 2010. Integrimin e konceptit të PZHK-së 2010- 2020+ përmes Skenarit të 1-rë, është pikënisje e mundshme e zhvillimit hapësinor të komunës, si vazhdimësi e zhvillimit të deri tanishëm.

Skenari I shkurtimisht përshkruhet si zona urbane e ndërlidhur me tri zona zhvillimore tjera. Dy zona zhvillimore shtrihet në pjesët malore, në Breznicë dhe Grabofc të Epërm, kurse zona e tretë zhvillimore integron zonën përgjatë M- 2, si korridori kryesor në

komunë. Zona përgjatë M- 2, si arterie ndërlidhëse, ka luajtur dhe do të luaj rolin e ndërmjetësuesit dhe furnizuesit për zonën urbane dhe zonën zhvillimore në Breznicë.

Skenari I parasheh zhvillimin e katër zona zhvillimore, ku njëra është qendra urbane dhe komunale Obiliqin dhe tre qendra sekondare si Millosheva, Breznica dhe Grabofci i Epërm. Në anën tjetër, Obiliqi, në të mire dhe në të keqe të qytetarëve të Obiliqit vazhdon të jetë qendër e prodhimit të energjisë për gjithë Kosovën. Fatkeqësisht, deri më tani energjia elektrike është prodhuar prej qymyrit. PZHK e kaluar si dhe ky skenar, edhe pse I planifikuar për 20 vitet e fundit ende i parealizuar, është bazuar mbi zhvillimin e një termocentrali të ri, TC Kosova e Re.

Ky skenar shfrytëzon afërsinë e Obiliqit me qendrën e Kosovës, Prishtinën. Andaj, tenton të zgjasë zhvillimet industriale dhe të tjera në drejtim të Prishtinës, nëpërmjet M-2 si dhe nëpërmjet arteries kryesore të qytetit, rrugës Vushtrri-Prishtinë.

Zhvillimi ekonomik i këtij skenari bazohet në disa zhvillime të nivelit kombëtar veç më të planifikuara si TC Kosova e Re dhe mihjet e planifikuara. Këto dy zhvillime të planifikuara nga niveli qendror orientojnë dukshëm zhvillimin e ardhshëm. TC Kosova e Re, sipas planifikimeve shtrihet në zonën urbane. Gjithashtu me zgjerimin e mihjes së Re parashihet edhe zhvendosja e fshatrave si Hade, Shipitullë, Lajthishtë dhe Sibovc. Rivendosja e këtyre vendbanimeve nuk është trajtuar mjaftueshëm, por duket sikur jepet mundësia e rivendosjes nëpër zonat e zhvillimit, e në veçanti në vendbanimin e ri Shkabaj/ Hade e Re.

Fatkeqësisht, skenari i nuk i ka analizuar mjaftueshëm mihjet ekzistuese dhe të ardhshme, si dhe implikimet e mundshme. Edhe pse, është planifikuar zhvendosja e vendbanimeve, nuk është përcaktuar saktë një plan strategjik i zhvendosjes, si dhe implikimi ekonomik dhe social i zhvendosjes.

Komuna zhvillon veprimtaritë e veta ekonomike në kuadër të tri korridoreve të zhvillimit, ku përgjatë tyre planifikon zgjerimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të cilat shtrihet përgjatë rrugëve magjistrale dhe lokale. Një nga zonat zhvillimore shtrihen në rrugën nacionale M-2 dhe dy tjerat në rrugët regjionale R120 dhe R220.

Zona përgjatë M-2 është premtuese sa i përket zhvillimi, ku edhe është i koncentruar zhvillimi kryesor. Zhvillimi në formatin e korridorit, ndonëse jo i dëshiruar në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm, nga perspektiva e zhvillimit të komunës së Obiliqit është një rrugëdalje e mundshme. Kjo si rrjedhoje e shume kufizimeve hapësinore që bart komuna e Obiliqit. Analizat kanë përfunduar se përafërsisht 65% e territorit të komunës është ose nën zhvillim ekzistues ose nën ndonjë kufizim të nivelit qendror apo lokal. Ky korridor do të vazhdohet të analizohet edhe në dy skenarët tjerë. Skenari I nuk ka të përcaktuara modelet e banimit, e as prognozat e banimit dhe fondin e alokuar të tokës ndërtimore për banim.

Si zhvillim hipotetik por i planifikuar është rehabilitimi i plotë rrjetit hekurudhor Fushë Kosovë- Mitrovicë dhe Fushë Kosovë- Pejë me disa nënstacione. Transporti sipas këtij skenari zhvillohet ashtu siç është momentalisht dhe nuk parashihet zhvillimi i koncepteve tjera të transportit. Po ashtu, traseja e ndryshuar e autoudhës "Ibrahim Rugova" ndikon dukshëm në vlerësim të zhvillimit të këtij skenari, andaj i njëjti do të përpunohet.

Skenari I trajton në nivel jo të kënaqshëm ndotjen e ajrit. Trajton zonën e rrezikshme nga vërshimet pranë lumit Sitnica, mirëpo mungojnë të përcaktuara veprime konkrete. Kërcënimet serioze të mjedisit dhe jetës e shëndetit publik janë pjesë e vlerësimit të skenarit, por mungojnë masa konkrete për zvogëlimin dhe parandalimin e rreziqeve të lartpërmendura.


Thuhet që duhet parashikuar masa mjedisore për parandalimin e degradimit të mjedisit, peizazhit dhe mundësitë e zvogëlimit të ndotjes në burim nga TC- të, mirëpo veprimet konkrete nuk janë të përcaktuara. Ndërsa, deponitë e hirit, pjesë e këtij skenari janë eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore.

Skenari i I parasheh që infrastruktura publike të zhvillohet sipas regjimit aktual të zhvillimi, ndërsa nuk trajton fare infrastrukturën teknike.

Skenari I vlerësohet që ka pasur disa probleme serioze si dhe nuk përshtat në plotni me zhvillimet e tashme. Marr në konsideratë që edhe zhvillimet hapësinore aktuale apo të deri tashmë janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga skenari në fjalë, dhe në përgjithësi duke mos respektuar asnjë nga dokumentet e planifikimit hapësinor lokal, mund të konkludohet se ky skenar është tërësisht pa efekt në zhvillimin hapësinor në komunën e Obiliqit.

Më poshtë gjeni një Tabele krahasuese, ku ky skenar është vlerësuar për impaktin e mundshëm sipas gjithë tematikave zhvillimore.

DRAFT



Harta 60. Skenari sipas PZHK- së në fuqi

5.3.2. SKENARI 2

Skenari II, bazuar në dy konceptet kryesore të përzgjedhura, atë të zhvillimit kompakt dhe policentrit zhvillohet në disa drejtime. Përkrah zonës urbane si qendër e rendit të lartë, krijon dy qendra sekondare atë të Milloshevës dhe Hades së Re, si dhe disa qendra të rendit të ulët.

Zona urbane integron dhe funksionon në plotni me hapësirat e zgjeruara urbane si pjesë të Plemetinit, dhe Mazgitit të ultë dhe Dardhishtës, ndërsa si qendra të rendit të mesëm mbesin Hadja e Re dhe Millosheva. Në Skenarin II të gjitha vendbanimet në perëndim të Obiliqit në dimension funksional janë të lidhura direkt me zonën urbane/ qendra të rendit të lartë, ndërsa vendbanimet e tjera do të gravitojnë drejt dy qendrave të rendit të mesëm (Hadja e Re dhe Millosheva).

Si rrjedhojë e planifikimeve kombëtare për gjenerim të energjisë si dhe eksploatimit të linjitit, Skenari II parasheh zhvendosjen e tërësishme të vendbanimeve si Hade, Shipitullë, Lajthishtë (Leshkoshiq) dhe Sibovc si dhe rivendosja e tyre të bëhet në zonën urbane, si dhe në Hade të Re.

Ky skenar parasheh që zhvillimet në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve të ngrihen dhe të mos zgjerohen më tutje. Sa i përket zhvillimeve në zonën bujqësore me komasacion dhe sistem të ujitjes parasheh rregullimin dhe kufizimin e këtyre zonave në kuadër të kufijve ekzistues, por duke i integruar zhvillimet e deritanishme si dhe duke zhvilluar aktivitetet përkatëse dhe duke ndaluar zgjerimin e pakontrolluar të mëtejmë të tyre.

Edhe në skenarin e II baza e energjisë nacionale zhvillohet përmes tre termocentraleve, siç janë TC-B dhe parashihet ndërtimi i TC-K Re, dhe planifikimit të mihjeve. Pasi dekomisionimi i TC A nuk ka ndodhur ende, si dhe nuk ka datë të saktë të përcaktuar për dekomisionim, TC A është po ashtu pjesë e Skenarit II.

TC-K Re ndonëse në pjesën urbane, planifikohet të ketë prodhim efektiv dhe të pastër, në harmonizim të plotë me direktivave evropiane.

Komuna zhvillon veprimtaritë ekonomike në dy zona kryesore, njëra përgjatë korridorit nacionale M-2 me shfrytëzim të përzier por të kufizuar, dhe e dyta është zona industriale/ ekonomike në Shkabaj e cila ka lidhje të menjëhershme në autoudhën "Ibrahim Rugova" si dhe është në afërsi të kryeqytetit.

Toka bujqësore e cila është nën sistem të ujitjes dhe e rregulluar me komasacion është e dedikuar tërësisht në zhvillim të prodhimtarisë bujqësore duke vendosur masa mbrojtëse. Autoudha "Ibrahim Rugova" si dhe zhvillimet përgjatë M-2 janë pjesë integruese e Skenarit II si një potencial i rëndësishëm zhvillimor për komunën.

Skenari II banimin e sheh të zhvilluar në kuadër të tri zonave kryesore të cilat paraqesin edhe tipat kryesore të banimit në komunë, që dallojnë në mes për nga dendësia banimore. Tipat e planifikuara janë:

- Tipi i banimit me dendësi të lartë banimi zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku pretendohet banimi i qëndrueshëm duke alokuar tokë të mjaftueshme për hapësira të lira, rekreative dhe nevojave të tjera përcjellëse të banimit.
- Tipi i dytë i banimit me dendësi të mesme banimi do të zhvillohet në pjesët jo qendrore të zonës urbane dhe në vendbanimet e mëdha.
- Tipi i tretë i banimit me dendësi të mesme banimi në zonat rurale, i cili është më fleksibil dhe në varësi të kushteve dhe rrethanave e nevojave mund të zhvillohet sipas nevojës.

Sa i përket zhvillimit të infrastrukturës teknike, një zhvillim i rëndësishëm është trajtimi i ujërave të zeza, problem i kahmotshëm për komunën e Obiliqit. Komuna e Obiliqit planifikohet të ketë impiant për trajtimin e ujërave të zeza, njëri që do duhej vendosur në rrjedhën e poshtme të lumit Sitnica për trajtim të ujërave të ndotura të amvisërisë dhe bizneseve, dhe i dyti industrial do trajtoj kryesisht ujërat e ndotura dhe mbetjet tjera industriale që vijnë nga energjetika dhe minierat.

Rrjeti nacional energjetik zhvillohet ashtu siç është aktualisht, ndërsa linjat shpërndarëse të TC "Kosova e Re" lidhen me rrjetin e TC "Kosova B". Linjat komunikuese të largpërçuesve nga TC- K Re dhe TC B me stacionin kryesor shpërndarës (trafon) do të zhvillohen nën tokë, pra do të jenë linja nëntokësore.

Ky skenar parasheh edhe shtrirjen e rrjetit të ko-gjenerimit në 50% të territorit të komunës. Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, ky skenar parasheh mbrojtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve nën ujitje dhe komasacion.

Një tjetër element që trajton Skenari II janë edhe deponitë e hirit, ku sipas këtij skenari ato duhet eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore, ndërsa në këto zona do të krijohen zona rekreative dhe mundësi të zhvillimit ekonomik të komunës përmes zgjerimit të zonave ekonomike dhe banimit. Pikë e fortë e këtij skenari është edhe ruajtja dhe rehabilitimi i peizazhit përmes ruajtjes së çdo trungu, mbjelljes së trungjeve të reja dhe zhvillimit të brezave mbrojtës.

Sipas Skenarit II, infrastruktura rrugore dhe transporti në komunën e Obiliqit formësohen nga rrejti hekurudhor Fushë Kosovë-Mitrovicë dhe Fushë Kosovë-Pejë me disa nënstacione, pastaj janë autoudha "Ibrahim Rugova" me qasjen në Shkabaj, rruga nacionale Prishtinë-Mitrovicë (M2), disa rrugë regjionale dhe lokale.

Transporti sipas këtij skenari zhvillohet në mënyrë të integruar dhe në disa mode. Lidhjet mes tipave të transportit por edhe të rrugëve janë plotësisht të integruara, ku qasja e shpejt dhe integruese e shoqëruara me masa mjedisore është bazë për funksionin e transportit në komunë dhe regjionin më të gjerë.

Skenari II parasheh një integrim të infrastrukturës publike dhe sociale me mjedisin e ndërtuar, përkatësisht me zonat e banimit dhe hapësirat që kanë nevojë për shërbime. Sipas këtij skenari kemi rritje të hapësirave për sport dhe rekreacion kryesisht përgjatë lumit Sitnica dhe në zonën urbane. Por jo vetëm kaq, këto shërbime janë të shpërndara edhe në të gjitha zonat tjera urbane apo vendbanimet e mëdha. Gjithashtu, sipas Skenarit II parashihet ndërtimi i liqenit i cili do te ketë kryesisht karakter rekreativo-sportiv ku do mund të zhvillohen edhe forma tjera të hapësirave me karakter natyror.

Skenari II trajton në përgjithësi të gjitha rreziqet dhe kërcënimet në komunën e Obiliqit dhe zonën e afektuar nga zhvillimet në komunë. Fillimisht, parasheh që TC "Kosova e Re" të ndërtohen në principet e prodhimit të gjelbër me ndotje minimale të mundshme, duke rehabilituar edhe dy termocentralet ekzistuese (TC KA dhe TC KB). Në këtë mënyrë parashihet ulja e sasisë së emetimit të gazrave dhe pluhurit nga TC gjatë djegies së linjitit.

Masa tjera janë edhe brezat e gjelbër në gjerësi 100m deri 250m të cilët do të zbusin efektin e ndotjes pas shkarkimit por edhe si rregullator të peizazhit, si për TC ashtu edhe për zonën e mihjes së Re.

Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica, Llap dhe Drenica do të eliminoj problemin e përmbytjeve, sidomos përgjatë lumit Sitnica dhe me ç' rast do të krijojë mundësi për zhvillimin e këtyre zonave në rrafsh të ofrimit të shërbimeve rekreative dhe sportive.

Sipas Skenarit II nuk ka vendbanime jo formale, por ka zhvillime jo konforme me kërkesat ligjore, dhe të njëjtat ose integrohen në planifikimet e ardhshme apo ngrihet zhvillimi i ardhshëm i tyre, varësisht kërkesave të normave të planifikimit hapësinore dhe ligjeve përkatëse për karakterin e zonës, si p.sh. zonat e mbrojtura, zonat nën komasacion dhe sistem të ujitjes, etj.

Skenari II parasheh balancim të zhvillimeve duke i dhënë rol të rëndësishëm shfrytëzimit të tokës përmes funksioneve zhvillimore dhe statuseve që ka çdo tip i shfrytëzimit të tokës në këtë zonë të ndjeshme me karakter edhe nacional.


Koncepti parasheh zgjerimin e tokës ndërtimore në drejtim të tokës që aktualisht është pa funksion ekonomik, kontrollon zhvillimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes duke kufizuar zhvillimet lineare përgjatë korridoreve në një distancë nga 50m deri në 100m si dhe duke vendosur masa mbrojtëse të rrepta në këto zona. Sipas këtij skenari parashihet edhe zgjerimi i sipërfaqeve nën sistem të ujitjes që shtrihen në pjesën veriore të lumit Llap.

Ky skenar krijon mundësinë për zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha kategorive kryesore të shfrytëzimit të tokës të njoftuara me këtë skenar dhe mundëson zhvillim të balancuar dhe integruar në Komunë.

Sipas Skenarit II, kërkohet shpronësime të tokës edhe jashtë zonës së mihjes së re.

Më poshtë gjeni një Tabele krahasuese, ku ky skenar është vlerësuar për impaktin e mundshëm sipas gjithë tematikave zhvillimore.

DRAFT



Harta 61. Skenari i dytë[50]

[50] Hade e Re nënkupton vendbanimin e ri në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq

5.3.3. SKENARI 3

Edhe Skenari III, është i bazuar në dy konceptet kryesore të përzgjedhura, atë të zhvillimit kompakt dhe policentrit zhvillohet në disa drejtime. Përkrah zonës urbane si qendër e rendit të lartë, krijon dy qendra të rendit të mesëm, atë të Milloshevës dhe Hades së Re, qendrën e rendit të ulët Carravodicën si dhe përcakton rritje të zhvillimit në zona tjera.

Në Skenarin III parasheh që komuna të zhvillohet në disa drejtime. Zona urbane përfshirjen si hapësira periferike urbane pjesë të Plemetinit, Mazgitit të ultë dhe Dardhishtes, duke krijuar një zonë urbane të integruar duke të ndërlidhur me funksione dhe vendbanimet përreth.

Të gjitha vendbanimet në perëndim të Obiliqit në dimension funksional janë të lidhura direkt me zonën urbane, ndërsa vendbanimet e tjera me dy qendrat tjera të rendit të mesëm. Ky skenar parasheh që të zhvendosen tërësisht vendbanimet si Hade, Shipitullë, Lajthishtë (Leshkoshiq) dhe Sibovc si dhe rivendosja e tyre të bëhet në zonën urbane, përkatësisht në zonat ku preferojnë të zhvendosurit brenda dhe jashtë zonës urbane.

Ky skenar parasheh që zhvillimet në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve të ngrihen dhe të mos zgjerohen më tutje. Në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të eksploatimit të mihjeve (p.sh. Sibovci planifikohet të fillojë eksploatimi tek në vitet 2030) do të lejohen vetëm shfrytëzime të përkohshme, në përputhshmëri me planifikimin në kuadër të planit zhvillimor të KEK-ut për eksploatim të mihjeve. Kjo e tëra duke marr parasysh dhe afatgjatësinë e PZHK- së, që është 8 vite, që nënkupton më shkurtë sesa planifikimi i eksploatimit të mihjeve.

Sa i përket zhvillimeve në zonën bujqësore me komasacion dhe sistem të ujitjes parasheh rregullimin dhe kufizimin e këtyre zonave në kuadër të kufijve aktual, por duke i zhvilluar me aktivitetet përkatëse dhe duke ndaluar zgjerimin e mëtejmë të tyre.

Ndërsa, Skenari III banimin e sheh të zhvilluar në kuadër të disa zonave kryesore të cilat paraqesin edhe katër tipet kryesore të banimit në komunë. Tipet e banimit janë:

- Tipi i banimit me dendësi të lartë banimi zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku pretendohet banimi i qëndrueshëm duke alokuar tokë të mjaftueshme për hapësira të lira, rekreative dhe nevojave të tjera përcjellëse të banimit.
- Tipi i dytë i banimit me dendësi të mesme banimi do të zhvillohet në pjesët jo qendrore të zonës urbane dhe në vendbanimet e mëdha.
- Tipi i tretë i banimit është banimi që do të zhvillohet në zonat rurale të identifikuara si zona me jo konformitet, ku dendësia e banimit mund të zhvillohen sipas rrethanave, por që mund të lejohet dendësi më e lartë dhe përzierje me aktivitete tjera përcjellëse.
- Kurse tipi i katërt paraqet banimin rural që parashihet të zhvillohet në vendbanime me karakter jo urban dhe i cili është më fleksibil dhe në varësi të kushteve dhe rrethanave e nevojave mund të zhvillohet sipas nevojës.

Një tjetër element i Skenarit III janë edhe deponitë e hirit, ku sipas këtij skenari ato duhet eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore, ndërsa në këto zona do të krijohen zona rekreative dhe mundësi e zhvillimit ekonomik të komunës përmes zgjerimit të zonave ekonomike dhe banimit.

Pikë e fortë e këtij skenari është edhe ruajtja dhe rehabilitimi i peizazhit, mbjelljes së trungjeve të reja dhe zhvillimit të brezave mbrojtës. Për më tepër parashihet të pyllëzohet e gjithë zona nga lumi Sitnica deri në zonën e mihjes së Re.

Aspekti i gjenerimit të energjisë përqendrohet në zhvillimin e dy termocentraleve, në rritjen e efikasitetit prodhues të TC- A dhe TC- B dhe parashihet ndërtimi i TC-K Re, dhe planifikimit të mihjeve. Pasi planifikohet TC-K Re planifikohet të ketë prodhim efektiv dhe të pastër, në harmoni të plotë me direktivat evropiane.

Rrjeti nacional energjetik zhvillohet dhe avancohet, ndërsa të gjitha linjat e tensionit të lartë të TC "Kosova A" eliminohen, ndërsa linjat shpërndarëse të TC "Kosova e Re" lidhen me rrjetin e TC "Kosova B". Linjat komunikuese të largpërçuesve nga TC- K Re dhe TC B me stacionin kryesor shpërndarës (trafon) do të zhvillohen nën tokë, pra do të jenë linja nëntokësore. Ky skenar parasheh edhe shtrirjen e rrjetit të ko-gjenerimit në 100% të territorit të komunës. Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, ky skenar parasheh mbrojtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve nën ujitje dhe komasacion.

Komuna zhvillon veprimtaritë ekonomike në dy zona kryesore të zhvillimit ekonomik, njëra përgjatë korridorit nacionale M-2 me shfrytëzim të përzier por të kufizuar, dhe e dyta është zona industriale/ ekonomike në Shkabaj, e cila ka lidhje të menjëhershme në autoudhën "Ibrahim Rugova".

Toka bujqësore e cila është nën sistem të ujitjes dhe e rregulluar me komasacion është e dedikuar tërësisht në zhvillim të prodhimtarisë bujqësore duke vendosur masa mbrojtëse. Autoudha "Ibrahim Rugova" është integruar në skenar si një potencial i rëndësishëm zhvillimor për komunën. Planifikohet impiant për trajtimin e ujërave të zeza, njëri që do duhej vendosur në rrjedhën

e poshtme të lumit Sitnica për trajtim të ujërave të ndotura të amvisërisë dhe bizneseve, dhe i dyti industrial do trajtoj kryesisht ujërat e ndotura dhe mbetjet tjera industriale që vijnë nga energjetika dhe minierat.

Sipas Skenarit III infrastruktura rrugore dhe transporti në komunën e Obiliqit formësohen nga rrejti hekurudhor Fushë Kosovë-Mitrovicë dhe Fushë Kosovë-Pejë me disa nënstacione, pastaj janë autoudha "Ibrahim Rugova" me qasjen në Shkabaj, rruga nacionale Prishtinë-Mitrovicë (M2), disa rrugë regjionale dhe lokale. Transporti sipas këtij skenari zhvillohet në mënyrë të integruar dhe në disa mode. Lidhjet mes tipave të transportit por edhe të rrugëve janë plotësisht të integruara, ku qasja e shpejt dhe integruese e shoqëruara me masa mjedisore është bazë për funksionin e transportit në komunë dhe regjionin më të gjerë.

Skenari III parasheh një integrim të infrastrukturës publike dhe sociale me mjedisin e ndërtuar, përkatësisht me zonat e banimit dhe hapësirat që kanë nevojë për shërbime. Sipas këtij skenari kemi rritje të hapësirave për sport dhe rekreacion kryesisht nga zona urbane, lumi Sitnica dhe deri te brezi mbrojtës apo rregullues i mihjes së Re. Pra, kemi një zonë me karakter dhe plot shërbime të karakterit rekreativ, turistik dhe sportiv që shtrihet në të dy anët e lumit Sitnica. Por jo vetëm kaq, këto shërbime janë të shpërndara edhe në të gjitha zonat tjera urbane apo vendbanimet e mëdha. Gjithashtu, sipas Skenarit III parashihet ndërtimi i liqenit i cili do të ketë kryesisht karakter rekreativo-sportiv, ku do mund të zhvillohen edhe forma tjera të hapësirave me karakter natyror. Skenari III trajton në përgjithësi të gjitha rreziqet dhe kërcënimet në komunën e Obiliqit dhe zonën e afektuar nga zhvillimet në komunë.

Skenari III parasheh balancim të zhvillimeve duke i dhënë rrol të rëndësishëm shfrytëzimit të tokës përmes funksioneve zhvillimore she statuseve që ka çdo tip i shfrytëzimi të tokës në këtë zonë të ndjeshme me karakter edhe nacional.


Koncepti parasheh zgjerimin e tokës ndërtimore në drejtim të tokës që aktualisht është pa funksion ekonomik, kontrollon zhvillimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes duke kufizuar zhvillimet lineare përgjatë korridoreve në një distancë nga 100m deri në 250m si dhe duke vendosur masa mbrojtëse të rrepta në këto zona.

Ky skenar krijon mundësinë për zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha kategorive kryesore të shfrytëzimit të tokës të njoftuara me këtë skenar dhe mundëson zhvillim të balancuar dhe integruar në Komunë.

Sipas Skenarit III, nevojat për shpronësimin e tokës janë më të mëdha sepse, përveç shpronësimeve në zonën e mihjes së re, kërkohen edhe shpronësime në zonën e pyllëzuar në perëndim të lumit Sitnica.

Më poshtë gjeni një tabelë krahasuese, ku ky skenar është vlerësuar për impaktin e mundshëm sipas gjithë tematikave zhvillimore.

DRAFT



Harta 62 Skenari i tretë[51]

[51] Hade e Re nënkupton vendbanimin e ri në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq

Tabela krahasuese e skenarëve të propozuar, ku secili skenar vlerësohet sipas qëllimeve dhe objektivave dhe masave të propozuara në kuadër të fushave tematike.

Fusha tematike	SKENARI I	SKENARI II	SKENARI III	Vlerësimi		
				S-I	S-II	S-III
Ekonomia	Baza ekonomike e skenarit të I në nivel nacional është energjetika e cila funksionon me tre Termocentrale, siç janë TC-A, TC-B dhe parashihet ndërtimi i TC-C. Në kuadër të skenarit janë të integruara edhe mihjet ekzistuese dhe të ardhshme, mirëpo nuk janë analizuar mjaftueshëm. Ndërsa në rrafshin lokal komuna ka tri zona zhvillimore apo tri korridore të zhvillimit, ku përgjatë tyre planifikon zgjerimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të cilat shtrihet përgjatë rrugëve magjistrale dhe lokale. Një nga zonat zhvillimore shtrihen në rrugën nacionale M2 dhe dy tjerat në rrugët regjionale R120 dhe R220. Skenari parasheh një zonë zhvillimore edhe në veri të komunës, në Kozaricë. Vetëm zona që shtrihet përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë është premtuese sa i përket zhvillimit. Edhe pse autoudha "Ibrahim Rugova" është pjesë e skenarit, nuk vlerësohet mjaftueshëm ose fare si potencial zhvillimi për komunën. Traseja e ndryshuar e autoudhës po ashtu ndikon dukshëm në vlerësim të zhvillimit të këtij skenari.	Edhe në skenarin e II baza e energjisë nacionale zhvillohet përmes tre termocentraleve, siç janë TC-A, TC-B dhe parashihet ndërtimi i TC-K Re, dhe planifikimit të mihjeve. TC-K Re planifikohet të ketë prodhim efektiv dhe të pastër. Ndërsa në rrafshin lokal komuna ka dy zona kryesore të zhvillimit ekonomik, njëra përgjatë korridorit nacionale M2 me shfrytëzim të përzier por të kufizuar, dhe e dyta është zona industriale/ ekonomike në Shkabaj e cila ka lidhje të menjëhershme në autoudhën "Ibrahim Rugova". Gjithashtu edhe turizmi kulturor është identifikuar si një potencial zhvillimi i komunës duke pasur në konsideratë monumentin e kulturës "Tyrbja e Sulltan Muratit" dhe monumenti i "Gazimestanit". Toka bujqësore e cila është nën sistem të ujitjes dhe e rregulluar me komasacion është e dedikuar tërësisht në zhvillim të prodhimtarisë bujqësore duke vendosur masa mbrojtëse. Autoudha "Ibrahim Rugova" është integruar në skenar si një potencial i rëndësishëm zhvillimor për komunën.	Në skenarin e III baza e energjisë nacionale përqendrohet në zhvillimin e dy termocentraleve, në rritjen e efikasitetit prodhues të TC- A dhe TC- B dhe parashihet ndërtimi i TC-K Re, dhe planifikimit të mihjeve. TC-K Re planifikohet të ketë prodhim efektiv dhe të pastër. Ndërsa në rrafshin lokal komuna ka dy zona kryesore të zhvillimit ekonomik, njëra përgjatë korridorit nacionale M2 me shfrytëzim të përzier por të kufizuar, dhe e dyta është zona industriale/ ekonomike në Shkabaj e cila ka lidhje të menjëhershme në autoudhën "Ibrahim Rugova". Gjithashtu edhe turizmi kulturor është identifikuar si një potencial zhvillimi i komunës duke pasur në konsideratë monumentin e kulturës "Tyrbja e Sulltan Muratit" dhe monumenti i "Gazimestanit". Toka bujqësore e cila është nën sistem të ujitjes dhe e rregulluar me komasacion është e dedikuar tërësisht në zhvillim të prodhimtarisë bujqësore duke vendosur masa mbrojtëse. Autoudha "Ibrahim Rugova" është integruar në skenar si një potencial i rëndësishëm zhvillimor për komunën.	2	2	3
Infrastruktura teknike	Skenari i parë nuk trajton fare infrastrukturën teknike.	Komuna e Obiliqit planifikohet të ketë impiant për trajtimin e ujërave të zeza, njëri që do duhej vendosur në rrjedhën e poshtme të lumit Sitnica për trajtim të ujërave të ndotura të amvisërisë dhe bizneseve, dhe i dyti industrial do trajtoj kryesisht ujërat e ndotura dhe mbetjet tjera industriale që	Komuna e Obiliqit planifikohet të ketë impiant për trajtimin e ujërave të zeza, njëri që do duhej vendosur në rrjedhën e poshtme të lumit Sitnica për trajtim të ujërave të ndotura të amvisërisë dhe bizneseve, dhe i dyti industrial do trajtoj kryesisht ujërat e ndotura dhe mbetjet tjera industriale që	0	3	3

DRAFT

		vijnë nga energjetika dhe minierat. Rrjeti nacional energjetik zhvillohet ashtu siç është aktualisht, ndërsa linjat shpërndarëse të TC "Kosova e Re" lidhen me rrjetin e TC "Kosova B". Linjat komunikuese të largpërçuesve nga TC- K Re dhe TC B me stacionin kryesor shpërndarës (trafon) do të zhvillohen nën tokë, pra do të jenë linja nëntokësore. Ky skenar parasheh edhe shtrirjen e rrjetit të ko-gjenerimit në 50% të territorit të komunës. Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, ky skenar parasheh mbrojtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve nën ujitje dhe komasacion.	vijnë nga energjetika dhe minierat. Rrjeti nacional energjetik zhvillohet dhe avancohet, ndërsa të gjitha linjat e tensionit të lartë të TC "Kosova A" kabllohen, ndërsa linjat shpërndarëse të TC "Kosova e Re" lidhen me rrjetin e TC "Kosova B". Linjat komunikuese të largpërçuesve nga TC- K Re dhe TC B me stacionin kryesor shpërndarës (trafon) do të zhvillohen nën tokë, pra do të jenë linja nëntokësore. Ky skenar parasheh edhe shtrirjen e rrjetit të ko-gjenerimit në 100% të territorit të komunës. Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, ky skenar parasheh mbrojtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve nën ujitje dhe komasacion.			
Infrastruktura e transportit dhe transporti	Shtyllë e infrastrukturës rrugore dhe të transportit në komunën e Obiliqit sipas skenarit të parë janë: rrjeti hekurudhor Fushë Kosovë- Mitrovicë dhe Fushë Kosovë- Pejë me disa nënstacione, pastaj autoudha "Ibrahim Rugova", rruga magjistrale Prishtinë-Mitrovicë (M2), disa rrugë regjionale dhe lokale. Transporti sipas këtij skenari zhvillohet ashtu siç është momentalisht dhe nuk parashihet zhvillimi i koncepteve tjera të transportit. Traseja e ndryshuar e autoudhës po ashtu ndikon dukshëm në vlerësim të zhvillimit të këtij skenari.	Sipas Skenarit II infrastruktura rrugore dhe transporti në komunën e Obiliqit formësohen nga rrejti hekurudhor Fushë Kosovë-Mitrovicë dhe Fushë Kosovë-Pejë me disa nënstacione, pastaj janë autoudha "Ibrahim Rugova" me qasjen në Shkabaj, rruga nacionale Prishtinë-Mitrovicë (M2), disa rrugë regjionale dhe lokale. Transporti sipas këtij skenari zhvillohet në mënyrë të integruar dhe në disa mode. Lidhjet mes tipave të transportit por edhe të rrugëve janë plotësisht të integruara, ku qasja e shpejt dhe integruese e shoqëruara me masa mjedisore është bazë për funksionin e transportit në komunë dhe regjionin më të gjerë.	Sipas Skenarit III infrastruktura rrugore dhe transporti në komunën e Obiliqit formësohen nga rrejti hekurudhor Fushë Kosovë-Mitrovicë dhe Fushë Kosovë-Pejë me disa nënstacione, pastaj janë autoudha "Ibrahim Rugova" me qasjen në Shkabaj, rruga nacionale Prishtinë-Mitrovicë (M2), disa rrugë regjionale dhe lokale. Transporti sipas këtij skenari zhvillohet në mënyrë të integruar dhe në disa mode. Lidhjet mes tipave të transportit por edhe të rrugëve janë plotësisht të integruara, ku qasja e shpejt dhe integruese e shoqëruara me masa mjedisore është bazë për funksionin e transportit në komunë dhe regjionin më të gjerë.	2	3	3
Infrastruktura publike dhe sociale	Skenari I parasheh që infrastruktura publike të zhvillohet sipas regjimit aktual të zhvillimit.	Skenari II parasheh një integrim të infrastrukturës publike dhe sociale me mjedisin e ndërtuar, përkatësisht me zonat e banimit dhe hapësirat që kanë nevojë për shërbime. Sipas këtij skenari kemi rritje të hapësirave për sport dhe rekreacion kryesisht përgjatë lumit Sitnica dhe në zonën	Skenari III parasheh një integrim të infrastrukturës publike dhe sociale me mjedisin e ndërtuar, përkatësisht me zonat e banimit dhe hapësirat që kanë nevojë për shërbime. Sipas këtij skenari kemi rritje të hapësirave për sport dhe rekreacion kryesisht nga zona urbane, lumi Sitnica dhe deri te	1	2	3

		urbane. Por jo vetëm kaq, këto shërbime janë të shpërndara edhe në të gjitha zonat tjera urbane apo vendbanimet e mëdha. Gjithashtu, sipas Skenarit II parashihet ndërtimi i liqenit i cili do te ketë kryesisht karakter rekreativo-sportiv ku do mund të zhvillohen edhe forma tjera të hapësirave me karakter natyror. Skenari parashihet edhe ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët në Obiliq dhe tre kopshteve për fëmijë (Mazgit, Milloshevë dhe Hade e Re).	brezi mbrojtës apo rregullues i mihjes së Re. Pra, kemi një zonë me karakter dhe plot shërbime të karakterit rekreativ, turistik dhe sportiv që shtrihet në të dy anët e lumit Sitnica. Por jo vetëm kaq, këto shërbime janë të shpërndara edhe në të gjitha zonat tjera urbane apo vendbanimet e mëdha. Gjithashtu, sipas Skenarit II parashihet ndërtimi i liqenit i cili do te ketë kryesisht karakter rekreativo-sportiv ku do mund të zhvillohen edhe forma tjera të hapësirave me karakter natyror.			
Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri	Skenari I trajton kryesisht ndotjen e ajrit dhe zonën e rrezikshme nga vërshimet pranë lumit Sitnica si dy kërcënime serioze të mjedisit dhe jetës e shëndetit publik në përgjithësi, por nuk ofron masa të domosdoshme për zvogëlimin dhe parandalimin e rreziqeve të lartpërmendura. Tjetër element që nuk trajton ky skenar është edhe elementi i ruajtjes së peizazhit dhe parashikimin e masave mjedisore për parandalimin e degradimit të mjedisit, peizazhit dhe mundësitë e zvogëlimit të ndotjes në burim nga TC- të, por edhe pasi të jetë shkarkuar ajo përmes brezave dhe sipërfaqeve gjelbëruese.	Skenari II trajton në përgjithësi të gjitha rreziqet dhe kërcënimet në komunën e Obiliqit dhe zonën e afektuar nga zhvillimet në komunë. Fillimisht, parasheh që TC "Kosova e Re" të ndërtohen në principet e prodhimit të gjelbër me ndotje minimale të mundshme, duke rehabilituar edhe dy termocentralet ekzistuese (TC KA dhe TC KB). Në këtë mënyrë parashihet ulja e sasisë së emetimit të gazrave dhe pluhurit nga TC gjatë djegies së linjitit. Masa tjera janë edhe brezat e gjelbër në gjerësi 50m deri 100m të cilët do të zbusin efektin e ndotjes pas shkarkimit por edhe si rregullator të peizazhit, si për TC ashtu edhe për zonën e mihjes së Re. Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica, Llap dhe Drenica do të eliminoj problemin e përmbytjeve, sidomos përgjatë lumit Sitnica dhe me ç'rast do të krijoj mundësi për zhvillimin e këtyre zonave në rrafsh të ofrimit të shërbimeve rekreative dhe sportive.	Skenari III trajton në përgjithësi të gjitha rreziqet dhe kërcënimet në komunën e Obiliqit dhe zonën e afektuar nga zhvillimet në komunë. Fillimisht, parasheh që TC "Kosova e Re" të ndërtohen në principet e prodhimit të gjelbër me ndotje minimale të mundshme, duke rehabilituar maksimalisht TC-B dhe TC-A. Në këtë mënyrë parashihet ulja maksimale e sasisë së emetimit të gazrave dhe pluhurit në emision. Masa tjera janë edhe brezat e gjelbër në gjerësi 50m deri 100m të cilët do të zbusin efektin e ndotjes pas shkarkimit por edhe si rregullator të peizazhit, si për TC ashtu edhe për zonën e mihjes së Re. Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica, Llap dhe Drenica do të eliminoj problemin e përmbytjeve, sidomos përgjatë lumit Sitnica dhe me ç'rast do të krijoj mundësi për zhvillimin e këtyre zonave duke ofruar shërbime rekreative dhe sportive, si dhe masa për rehabilitimin e ndotjes së ajrit dhe peizazhit.	1	3	3
Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore	Një tjetër element që trajton Skenari I janë edhe deponitë e hirit, ku sipas këtij skenari ato duhet eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore.	Një tjetër element që trajton Skenari II janë edhe deponitë e hirit, ku sipas këtij skenari ato duhet eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore, ndërsa në këto zona do të	Një tjetër element i Skenarit III janë edhe deponitë e hirit, ku sipas këtij skenari ato duhet eliminuar dhe zhvendosur në zonën aktive të minierës sipërfaqësore, ndërsa në këto zona do të krijohen	2	3	3

DRAFT

dhe turistike		krijohen zona rekreative dhe mundësi të zhvillimit ekonomik të komunës përmes zgjerimit të zonave ekonomike dhe banimit. Pikë e fortë e këtij skenari është edhe ruajtja dhe rehabilitimi i peizazhit përmes ruajtjes së çdo trungu, mbjelljes së trungjeve të reja dhe zhvillimit të brezave mbrojtës. Dy asetet nacionale dhe lokale të trashëgimisë kulturore të Obiliqit (Tyrbja e Sulltan Muratit dhe Monumenti i Gazimestanit) janë pjesë përbërëse e skenarit si potencial i zhvillimit të turizmit kulturorë në komunën e Obiliqit.	zona rekreative dhe mundësi e zhvillimit ekonomik të komunës përmes zgjerimit të zonave ekonomike dhe banimit. Pikë e fortë e këtij skenari është edhe ruajtja dhe rehabilitimi i peizazhit përmes ruajtjes së çdo trungu, mbjelljes së trungjeve të reja dhe zhvillimit të brezave mbrojtës. Për më tepër parashihet të pyllëzohet e gjithë zona nga lumi Sitnica deri në zonën e mihjes së Re. Dy asetet nacionale dhe lokale të trashëgimisë kulturore të Obiliqit (Tyrbja e Sulltan Muratit dhe Monumenti i Gazimestanit) janë pjesë përbërëse e skenarit si potencial i zhvillimit të turizmit kulturorë në komunën e Obiliqit.			
Vendbanimet	Skenari I parasheh zhvillimin e komunës në katër zona zhvillimore, ku njëra është qendra urbane dhe komunale Obiliqin dhe tre qendra sekondare si Millosheva, Breznica dhe Grabofci i Epërm. Gjithashtu me zgjerimin e mihjes së Re parashihet edhe zhvendosja e fshatrave si Hade, Shipitullë, Lajthishtë dhe Sibovc. Rivendosja e këtyre vendbanimeve nuk është trajtuar mjaftueshëm, por duket sikur jepet mundësia e rivendosjes nëpër zonat e zhvillimit, e në veçanti në vendbanimin e ri Shkabaj/ Hade e Re. Ky skenar nuk trajton fare masat e parandalimit të zhvillimeve në zonat me rëndësi siç janë në zonën e zhvendosjes dhe mihjes së re, zonat nën komasacion dhe sistem të ujitjes, etj.	Në Skenarin II komuna zhvillohet në disa drejtime, ku zona urbane zgjerohet dhe integron pjesë të Plemetinit, dhe Mazgitit të ultë dhe Dardhishtës si hapësira periferike urbane, ndërsa si qendra të rendit të mesëm mbesin Hadja e Re dhe Millosheva. Të gjitha vendbanimet në perëndim të Obiliqit në dimension funksional janë të lidhura direkt me hapësirën funksionale urbane, ndërsa vendbanimet e tjera me dy qendrat e rendit të mesëm. Ky skenar parasheh që të zhvendosen tërësisht vendbanimet si Hade, Shipitullë, Lajthishtë (Leshkoshiq) dhe Sibovc si dhe rivendosja e tyre të bëhet në zonën urbane, përkatësisht në zonat me dendësi të mesme dhe të lartë, dhe në Hade të Re. Ky skenar parasheh që zhvillimet në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve të ngrihen dhe të mos zgjerohen më tutje. Sa i përket zhvillimeve në zonën bujqësore me komasacion dhe sistem të ujitjes parasheh rregullimin dhe kufizimin e këtyre zonave në kuadër	Në Skenarin III komuna zhvillohet në disa drejtime, ku zona urbane zgjerohet ku përfshihen përveç qytetit edhe Plemetini, Mazgiti i ultë dhe Dardhishtja si hapësira periferike urbane, duke krijuar një zonë urbane të integruar, pa fragmentime dhe pothuajse të ndërlidhur me vendbanimet përreth, ndërsa si qendra të rendit të mesëm mbesin Hadja e Re dhe Millosheva. Të gjitha vendbanimet në perëndim të Obiliqit në dimension funksional janë të lidhura direkt me zonën urbane, ndërsa vendbanimet e tjera me dy qendrat e rendit të mesëm. Ky skenar parasheh që të zhvendosen tërësisht vendbanimet si Hade, Shipitullë, Lajthishtë (Leshkoshiq) dhe Sibovc si dhe rivendosja e tyre të bëhet në zonën urbane, përkatësisht në zonat ku preferojnë të zhvendosurit brenda dhe jashtë zonës urbane. Ky skenar parasheh që zhvillimet në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve të ngrihen dhe të mos zgjerohen më tutje. Në kuadër të zonës së	1	2	3

		të kufijve aktual, por duke i zhvilluar me aktivitetet përkatëse dhe duke ndaluar zgjerimin e mëtejmë të tyre.	zhvendosjes dhe të mihjeve do të lejohen vetëm shfrytëzime të përkohshme, varësisht nga planifikimi i eksploatimit të mihjeve. Sa i përket zhvillimeve në zonën bujqësore me komasacion dhe sistem të ujitjes parasheh rregullimin dhe kufizimin e këtyre zonave në kuadër të kufijve aktual, por duke i zhvilluar me aktivitetet përkatëse dhe duke ndaluar zgjerimin e mëtejmë të tyre.			
Banimi	Skenari I nuk i trajton fare modelet e banimit, e as prognozat e banimit dhe fondin e alokuar të tokës ndërtimore për banim.	Ndërsa, Skenari II banimin e sheh të zhvilluar në kuadër të tri zonave kryesore të cilat paraqesin edhe tipet kryesore të banimit në Komunë, që dallojnë në mes për nga dendësia banimore. Tipi i banimit me dendësi të lartë banimi zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku pretendohet banimi i qëndrueshëm duke alokuar tokë të mjaftueshme për hapësira të lira, rekreative dhe nevojave të tjera përcjellëse të banimit. Tipi i dytë i banimit me dendësi të mesme banimi do të zhvillohet në pjesët jo qendrore të zonës urbane dhe në vendbanimet e mëdha. Tipi i tretë i banimit me dendësi të mesme banimi në zonat rurale, i cili është më fleksibil dhe në varësi të kushteve dhe rrethanave e nevojave mund të zhvillohet sipas nevojës.	Ndërsa, Skenari III banimin e sheh të zhvilluar në kuadër të disa zonave kryesore të cilat paraqesin edhe katër tipet kryesore të banimit në Komunë. Tipi i banimit me dendësi të lartë banimi zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku pretendohet banimi i qëndrueshëm duke alokuar tokë të mjaftueshme për hapësira të lira, rekreative dhe nevojave të tjera përcjellëse të banimit. Tipi i dytë i banimit me dendësi të mesme banimi do të zhvillohet në pjesët jo qendrore të zonës urbane dhe në vendbanimet e mëdha. Tipi i tretë i banimit është banimi që do të zhvillohet në zonat rurale të identifikuara si zona me jokonformitet ku dendësia e banimit mund të zhvillohen sipas rrethanave, por që mund të lejohet dendësi më e lartë dhe përzierje me aktivitete tjera përcjellëse. Kurse tipi i katërt paraqet banimin rural që parashihet të zhvillohet në vendbanime me karakter jo urban dhe i cili është më fleksibil dhe në varësi të kushteve dhe rrethanave e nevojave mund të zhvillohet sipas nevojës.	0	2	3
Vendbanimet Joformale	Skenarit I nuk i trajton fare vendbanimet jo formale.	Sipas Skenarit II nuk ka vendbanime jo formale, por ka zhvillime jokonforme me kërkesat ligjore, dhe të njëjtat ose integrohen në planifikimet e ardhshme	Sipas Skenarit III nuk ka vendbanime jo formale, por ka zhvillime jokonforme me kërkesat ligjore, dhe të njëjtat ose integrohen në planifikimet e ardhshme	0	1	1

DRAFT

		apo ngrihet zhvillimi i ardhshëm i tyre, varësisht kërkesave të normave të planifikimit hapësinore dhe ligjeve përkatëse për karakterin e zonës, si p.sh. zonat e mbrojtura, zonat nën komasacion dhe sistem të ujitjes, etj.	apo ngrihet zhvillimi i ardhshëm i tyre, varësisht kërkesave të normave të planifikimit hapësinore dhe ligjeve përkatëse për karakterin e zonës, si p.sh. zonat e mbrojtura, zonat nën komasacion dhe sistem të ujitjes, etj.			
Shfrytëzimi i tokës	Skenari I i cili është edhe skenar i PZHK-së në fuqi, duket që ka pasur disa probleme serioze duke mos njohur. Marr në konsideratë që edhe zhvillimet hapësinore aktuale apo të deri tashmë janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga skenari në fjalë, dhe në përgjithësi duke mos respektuar asnjë nga dokumentet e planifikimit hapësinor lokal, mund të konkludohet se ky skenar është tërësisht pa efekt në zhvillimin hapësinor në komunën e Obiliqit.	Skenari II parasheh balancim të zhvillimeve duke i dhënë rol të rëndësishëm shfrytëzimit të tokës përmes funksioneve zhvillimore dhe statuseve që ka çdo tip i shfrytëzimit të tokës në këtë zonë të ndjeshme me karakter edhe nacional. Koncepti parasheh zgjerimin e tokës ndërtimore në drejtim të tokës që aktualisht është pa funksion ekonomik, kontrollon zhvillimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes duke kufizuar zhvillimet lineare përgjatë korridoreve në një distancë nga 50m deri në 100m si dhe duke vendosur masa mbrojtëse të rrepta në këto zona. Sipas këtij skenari parashihet edhe zgjerimi i sipërfaqeve nën sistem të ujitjes që shtrihen në pjesën veriore të lumit Llap. Ky skenar krijon mundësinë për zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha kategorive kryesore të shfrytëzimit të tokës të njoftuara me këtë skenar dhe mundëson zhvillim të balancuar dhe integruar në Komunë. Sipas Skenarit II, kërkohet shpronësime të tokës edhe jashtë zonës së mihjes së re.	Skenari III parasheh balancim të zhvillimeve duke i dhënë rrol të rëndësishëm shfrytëzimit të tokës përmes funksioneve zhvillimore she statuseve që ka çdo tip i shfrytëzimi të tokës në këtë zonë të ndjeshme me karakter edhe nacional. Koncepti parasheh zgjerimin e tokës ndërtimore në drejtim të tokës që aktualisht është pa funksion ekonomik, kontrollon zhvillimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes duke kufizuar zhvillimet lineare përgjatë korridoreve në një distancë nga 50m deri në 100m si dhe duke vendosur masa mbrojtëse të rrepta në këto zona. Ky skenar krijon mundësinë për zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha kategorive kryesore të shfrytëzimit të tokës të njoftuara me këtë skenar dhe mundëson zhvillim të balancuar dhe integruar në Komunë. Sipas Skenarit III nevojat për shpronësimin e tokës janë më të mëdha sepse përveç shpronësimeve në zonën e mihjes së re, kërkohen edhe shpronësime në zonën e pyllëzuar në perëndim të lumit Sitnica.	1	2	3
Vlerësimi i skenarëve: 1-3 (min. = 1, max.=3 & 0=pa vlerësim)				10	22	27

Rrjedhimisht, shkaku i vlerësimeve pozitive në shkallët më të lartë për Skenarit III, përzgjidhet për përvetësim të mëtutjeshëm.

DRAFT

5.3.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor krijon bazën zhvillimore, rrjetet funksionale urbane dhe rurale dhe atë të shfrytëzimit të tokës, që përdoret gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit. PZhK duhet të siguroj zhvillim të qëndrueshëm dhe kapacitet hapësinor të balancuar, gjegjësisht të përcaktojë shkallën e rritjes/ shtimit/ dhe të zvogëlimit/ heqjes së funksioneve dhe elementeve hapësinore, pa e prishur drejtpeshimin zhvillimor.

Duke krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm, që zbërthehet në:

- Administratë efikase dhe e decentralizuar
- Mbrojtje efikase e tokës bujqësore dhe zhvillim i bujqësisë
- Rritja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve dhe kullosave
- Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë
- Vendbanime kompakte dhe planifikimi për vendbanimet që do të zhvendosen
- Ekonomi të zhvilluar dhe të balancuar dhe
- Mjedis të pastër dhe atraktiv.

Strukturimi i konceptit kryesor të Zhvillimit Hapësinor është bazuar në reflektimin e gjendjes aktuale dhe integrimit të zhvillimeve të planifikuara. Logjika hapësinore dhe integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor rrjedhin drejtpërsëdrejti nga vizioni i komunës së Obiliqit, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara, të prezantuara në mënyrë të përgjithshme përmes përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet zhvillimore për komunën e Obiliqit.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përcakton bazën kryesore të zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës të paraqitur në hartat tematike të PZHK-së, kushteve dhe masave të HZK-së. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara gjatë analizës së skenarëve dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë nyejt; korridoret; plotësimi dhe dendësimi; mbajtja nën kontroll; mbrojtja; zonat e rritjes të cilat përpos aspektit hapësinor gjatë strukturimit të skenarëve është trajtuar implikimi financiar i zbatimit të secilit element.

Nyjet paraqesin qendra të rendit të mesëm dhe të ulët, ndërsa korridoret që shërbejnë për ndërlidhje paraqesin korridori M-2, korridori i zonës urbane Vushtrri- Prishtinë dhe korridoret që lidhin qytetin me M-". Mbajtja nën kontroll dhe mbrojtja janë vënë në përdorim gjatë planifikimit të mbajtjes nën kontroll të zonave përreth tokës bujqësore, si dhe mbrojtja e tokave nën mihje. Zonat e rritjes, edhe përskaj kufizimeve, paraqesin zona urbane, përreth zonës urbane duke integruar zonat peri- urbane dhe zonat e rritjes në vendbanime.

Koncepti i zhvillimit hapësinor bazohet në planifikimin e shpërndarjeve hapësinore të zhvillimeve dhe funksioneve për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara për arritjen e vizionit, përmes një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm hapësinor të komunës, duke i vënë në funksion të zhvillimit potencialet e saj konkurruese.

Potenciale konkurruese të komunës së Obiliqit pa dyshim janë: gjenerimi I energjisë elektrike për gjithë Kosovën, sigurimi I lëndës së parë- linjitit dhe toka bujqësorë kualitative, me bujqësi si veprimtari tradicionale e popullatës si dhe kapacitetet ekzistuese agroindustriale. Koncepti parasheh, integrimin e zonës industriale ekzistuese në Llazarevë, si dhe përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse.

Theksi në zhvillimin ekonomik në degët tradicionale industriale dhe bujqësisë. Mirëpo, duke u nisur nga zhvillimet ekzistuese, ndërlidhja me Prishtinën, Vushtrrinë, si dhe M-2, është paraparë rritje të zonave për zhvillim komercial dhe shfrytëzim të përzier. Komuna do të zhvillojë veprimtaritë ekonomike në dy zona kryesore të zhvillimit ekonomik, njëra përgjatë korridorit nacionale M-2 me shfrytëzim të përzier por të kufizuar, dhe e dyta është zona industriale/ ekonomike në Shkabaj e cila ka lidhje të menjëhershme në autoudhën "Ibrahim Rugova".

Zhvillimi i bujqësisë intensive, në veçanti pemëtarisë, perimtarisë, bimëve mjekuese dhe blegtorisë, do të jenë nxitëse të themelimit të kapaciteteve të ndryshme përpunuese. Ndërsa I përdorimit jo efektiv të dheut te vlefshëm bujqësor përgjatë M2-shit, do të vihet nën kontroll, duke lejuar zhvillime vetëm përgjatë korridoreve. Për të integruar zhvillimet ekzistuese, si dhe shfrytëzimit të potencialit zhvillimor.

Në komunën e Obiliqit duke nxitur dhe mbështetur zhvillimin e NVM-ve si një sektor I rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, duke u siguruar hapësirat e nevojshme për zhvillim në kuadër të zonave ekzistuese dhe zonave të reja të planifikuara për këtë qellim, dhe duke i mbështetur me infrastrukturën përcjellëse këto zona.

Vendbanimet do të zhvillohen në modelin policentrik, ku vendbanimet Hade e re (në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq), Milloshevë dhe Palaj marrin primatin e qendrave sekondare krahas qytetit, si qendër kryesore. Në këto vendbanime duhet të intensifikohet dhe të diversifikohet zhvillimi I shërbimeve dhe shtrirja e infrastrukturës teknike adekuate në përputhje me funksionet e qendrave të caktuara në rrjetin e vendbanimeve. Shërbimet dhe infrastruktura e shpërndarë në mënyrë të

baraspeshuar do të ndikon në zvogëlimin e migrimit të popullatës nga zonat rurale. Kjo krijon një shpërndarje më të balancuar të popullsisë në territorin e komunës dhe përmirëson lidhjet funksionale ndërmjet qendrës komunale dhe nën-qendrave.

Ndërtimi i sistemeve dhe objekteve të infrastrukturës teknike dhe transportit dhe përmirësimi i asaj ekzistuese është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës. Kjo nënkupton zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor dhe shërbimeve të transportit; riaktivizimin e hekurudhës për bartjen e mallrave; zgjerimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe për kullimin e ujërave atmosferikë përfshirë impiantin për trajtim të ujërave të zeza; rindërtimin e rrjeteve ekzistuese të energjisë elektrike të vendbanimeve; menaxhim efikas të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e deponisë rajonale të mbeturinave komunale; rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes.


Një nga përcaktimet themelore të PZHK-së është shfrytëzimi racional i tokës ndërtimore. Dendësimi dhe zhvillimi i tokës së lirë ndërtimore brenda hapësirës ekzistuese të zonës urbane dhe vendbanimeve rurale do të ketë prioritet para shfrytëzimit të zonave të parapara për zgjerim.

Parandalimi dhe përmirësimi I ndotjes së mjedisit, zë vend të rëndësishëm në koncept të zhvillimit hapësinor, ku janë integruar projekte kapitale si Instalimi I filtrave në TC- B, dekomisionimi i pjesëve jo- funksionale të TC- A, rehabilitimi i ish deponive të Kek-ut në hapësira të gjelbëruara, rregullim të shtretërve, instalimi I sistemit të trajtimit të ujërave të zeza rezidenciale dhe industrial, etj.


Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor mbështet policentrizmin, ku nyejt ndërlidhen nëpërmjet korridoreve zhvillimore. Korridoret ekzistuese janë analizuar nga aspekti social, ekonomik dhe financiar, dhe është konstatuar se implikimet sociale dhe financiare të mos integrimit të korridoreve ekzistues janë të mëdha, andaj duhet pranuar dhe integruar korridoret ekzistuese, dhe duhet trajtuar tutje si pjesë të konceptit hapësinor (rregullimi dhe funksionalizimi i tyre).

Për këtë arsye, bazuar në zhvillimet e mëhershme dhe ato aktuale është planifikuar edhe zhvillimi i korridorit ekonomik përgjatë rrugës nacionale Prishtinë – Obiliq – Mitrovicë, përgjatë të cilës ndërveprojnë shumë operatorë ekonomik.

Koncepti në nivelin e hapësirave mbështet modelin e zhvillimit **kompakt dhe të baraspeshuar zhvillimor** duke promovuar intensitet të lartë zhvillimor dhe të shfrytëzimit të tokës, duke kontrolluar zgjerimet dhe rritjet e mëtutjeshme përmes përcaktimit të zgjerimeve të Zonës Urbane dhe kufijve ndërtimor të Zonës Rurale.



Harta 63 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Obiliqit



Harta 64 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të zonës urbane

Më saktësisht, në nivel të zonës urbane mbështet modelin e zhvillimit hapësinor-funksional policentrit dhe modelin hapësinor-zhvillimor kompakt dhe të baraspeshuar, si dhe në nivelin e zonave rurale mbështet modelin hapësinor- zhvillimor kompakt në përputhshmëri me qendrat e rendit të ulët dhe vendbanimet tjera, kurse në aspektin funksional qendrat e rendit të mesëm (Milloshevë, Hade e re (në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq), dhe Carravodicë) trajtohen si nyje shërbyese të shërbimeve publike dhe sociale ku gravitojnë banorët e vendbanimeve përreth. Sistemimi hierarkik dhe trajtimi i morfologjisë hapësinore të vendbanimeve zhvillohet me fuqizimin e qytetit të Obiliqit si qendër e rendit të lartë, duke ndërlidhur hapësirën funksionale urbane me hapësirat periferike urbane.

Përderisa ky koncept parasheh densifikimin e zonës urbane, për shkak të nevojës të zhvendosjes të banorëve që jetojnë në territorin "Fusha e Mihjes së Re" në të cilin nuk do të lejohen zhvillime të reja ndërtimore të përherëshme, i përkasin vendbanimeve rurale, është paraparë edhe një zgjerim minimal i vendbanimeve aktuale kompakte rurale, për të siguruar veprimtaritë e tyre bujqësore të cilat tani ushtrojnë.

Infrastruktura e transportit hekurudhor definohet nëpërmjet sigurimit të trasesë hekurudhore, si përmbajtje që reflekton projektin e planifikuar në kuadër të vizionit për rajonin e Obiliqit me zbatimin e të cilës do të mundësohej zhvillim ekonomik industrial rajonal.

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, gjegjësisht ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësor, dhe trupave ujor, etj., të domosdoshëm janë trajtimi i shtretërve të lumenjve dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura.

5.3.2. ZHVILLIMET E PLANIFIKUARA SIPAS FUSHAVE

Zhvillimi i mëtutjeshëm duhet të sigurojë jetesë të mirë në mbarë Komunën e Obiliqit, duke e trajtuar skenarin e përzgjedhur (skenari i 3-të) për zhvillimin hapësinor. Kushtet e barabarta të jetesës dhe punës duhet të arrihen dhe të ruhen në çdo pjesë të komunës së Obiliqit. Ruajtja dhe arritja e efikasitetit në gjithë territorin, sigurimi i aktivizimit dhe promovimit të zhvillimit të vazhdueshëm të potencialit ekzistues endogjen është thelbësor. Prandaj një menaxhim efikas i hapësirës është i duhur për vëzhgimin dhe rritjen e sigurisë së hapësirave të ndryshme të strukturuara.

5.3.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK

Funksionet në shërbim të zhvillimit ekonomik në Obiliq

Duke konsideruar potencialet dhe përparësitë për zhvillim ekonomik komuna e Obiliqit do të fokusohet në zhvillimin e sektorëve konkurrente dhe një infrastrukture ekonomike efikase. Përpos gjenerimit të energjisë elektrike dhe sigurimit te lendes se pare-linjitit për gjenerimin e energjisë elektrike, Komuna e Obiliqit duhet të zhvillojë dhe shtojë sektorët tjerë ekonomik, p.sh. industrinë prodhuese dhe përpunuese, turizmin, ndërtimtarinë, prodhimtarinë, tregtinë, akomodimin, etj.

Potenciali ekonomik, përfshin para së gjithash këto fusha:

- Gjenerimi i energjisë elektrike nga BRE
- Zhvillimi i turizmit rural dhe industrial
- Krijimi i hapësirave të reja për veprimtari komerciale dhe industriale
- Rekreacionin, kohën e lirë, malet: regjioni i Kozarices dhe Grabofcit
- Integrimi i mihjeve dhe ndërtimi TC Kosova e Re


Koncept i zhvillimit hapësinor promovon zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, duke mbështetur ekonominë lokale si bizneset e vogla dhe të mesme, ekonomitë familjare dhe vetë- punësimin, në të gjithë sektorët ekonomik:

Industria. Bazuar në interesat e nivelit qendror është ruajtur/ destinuar hapësirë për zhvillim dhe fuqizim të industrisë së gjenerimit të energjisë elektrike, gjegjësisht për fuqizim të kapaciteteve të plota industriale të KEK- ut. KEK-u është aset shumë i vlefshëm, e cila duhet të vlerësohet në pajtim të plotë me strategjitë kombëtare të Kosovës.

Si impuls kryesor për zhvillimin ekonomik industrial është ndërtimi i TC- Kosova e Re, ku në këtë PZHK nëpërmjet kornizës zhvillimore dhe planifikimit të shfrytëzimit të tokës, mbështetet mundësia për ndërtimin TC- Kosova e re në zonën urbane. Koncepti, nxit hulumtim për rezervat minerale në përputhje me standardet botërore, dhe promovon investime për shfrytëzimin racional të burimeve minerale duke pasur çdoherë parasysh ndikimet në mjedis, gjegjësisht riaktivizimi sipas praktikave mjedisore më të mira evropiane, përmes aplikimit të teknologjive më të përparuara, dhe të gjelbra (me ndotje të ulët).

PZHK po ashtu ka paraparë, sigurim të fuqisë punëtore profesionale në koordinim me teknologjinë e re që do të zhvillohet në TC-Kosova e re. Komuna, në koordinim me KEK do të punojë në harmonizim të kurikulave mësimore sipas nevojave të industrisë së gjenerimit të energjisë elektrike. Plani strategjik zhvillimor sipas viteve i KEK- ut për eksploatimit të mihjeve është gjithashtu i integruar në konceptin e zhvillimit hapësinor, si dhe konceptin e zhvillimit ekonomik. Koncepti i zhvillimit hapësinor me theks të veçantë zhvillimi ekonomik është harmonizuar me Plani strategjik zhvillimor sipas viteve: deri 2019; 2019- 2024; 2024- 2030; 2030-2035; 2035- 2040; 2040- 2045; 2045- 2050; 2050-2055, dhe 2055- 2060; ku gjithashtu është analizuar lejimi i zhvillimeve të përkohshme të pjesëve nën kufirin e zonës së mihjeve, ku zhvillimet e përkohshme si shfrytëzime të përkohshme do të harmonizoheshin me eksploatimin e mihjeve sipas viteve. PZHK ka afat gjatësi prej vetëm 8 viteve, ndërsa plani I eksploatimit të mihjeve është me afat gjatësi prej 40 vitesh, andaj lejimi I zhvillimeve të përkohshme në pjesët e vendbanimeve të cilat janë planifikuar të eksploatohen pas afat gjatësisë së kësaj PZHK- je, gjegjësisht pas vitit 2030, do të hapte rrugën për zhvillim të këtyre vendbanimeve, ku zhvillimi është stagnuar përafërsisht 30 vitet e fundi, dhe do të shërbente edhe në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale të banorëve.

PZHK nëpërmjet kornizës zhvillimore dhe planifikimit të shfrytëzimit të tokës, mbështet ri-vitalizimin e ish deponive të Kek- ut. Koncepti nxit eksploatim për rezervat e linjitit në përputhje me standardet botërore duke pasur çdoherë parasysh ndikimet në mjedis, gjegjësisht riaktivizimi sipas praktikave mjedisore më të mira evropiane, përmes aplikimit të teknologjive më të përparuara, dhe të gjelbra (me ndotje të ulët). Revitalizimi I TC- B dhe eliminimi i ndotjes me instalimin e filtrave sipas standardeve Evropiane dhe praktikave më të mira për të mundësuar riaktivizimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të tij nëpërmjet investimeve kryesisht private.



Harta 65 Koncepti i zhvillimit ekonomik të komunës së Obiliqit

Koncepti nxit në masë të theksuar zhvillimin e industrisë prodhuese dhe përpunuese të sektorit privat duke rritur hapësirat për zhvillim industrial dhe tregtar në kuadër të territorit Zonat ekonomike. PZHK jo detyrimisht nuk krijon zona ekonomike, por rrit zonat për lejim të veprimtarive industriale, të rëndë dhe të lehtë, tregtare dhe atyre për shfrytëzim të përzier.

PZHK ka të integruar, zonën industriale në Llazarevë[52], ku parashihet sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillim industrial të qëndrueshëm. Zhvillimi i infrastrukturës planifikohet të përfundohet në vitin 2023, duke ju ofruar investitorëve lokal zhvillim si dhe krijimin e potencialit të tërheqjes së investitorëve të huaj. Në kuadër të nxitjes së veprimtarive ekonomike hyn edhe zona për zhvillim industrial/ komercial përgjatë rrugës Obiliq- Caravodicë (Palaj). Kjo zonë, ish- pronë e KEK-ut, ish deponi e mihjeve, por e revitalizuar, do të sigurohet me infrastrukturë përcjellëse deri në vitin 2023.

Ashtu siç u përshkrua në skenarin III dhe në konceptin hapësinor, korridori përgjatë M-2 luan rol të rëndësishëm ekonomik për komunën e Obiliqit. Korridori ekonomik përgjatë M-2 plotëson zhvillimin e komunës, në aspektin ekonomiko- tregtar dhe ofron mundësi ndërlidhjen e zonës urbane me vendbanimet përgjatë M-2 (Milloshevë, Llazarevë, Mazgit, Baimofc). PZHK ka paraparë po ashtu zhvillimin e infrastrukturës përcjellëse për integrimin e korridorit ekonomik përgjatë M2 deri në vitin 2024.

Krijimi i një hapësirave përgjatë korridorit Vushtrri- Prishtinë, në pjesën jugore të Obiliqit, krijon ndërlidhej direkte me zonat industriale- tregtare veç më të zhvilluara përgjatë të njëjtit korridor, por në komunë të Prishtinës.

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës së Obiliqit për periudhën 2009- 2020+ të miratuar me vendimin e Kuvendit Komunal Nr.01-166/10 të datës 26.07.2010, Komuna e Obiliqit ka planifikuar zhvillimin e zonës industriale në Llazarevë. Në kuadër të zonës kadastrale Llazarevë, kjo zonë ka një statut të veçantë ekonomik të krijuar përmes një vendimi të Kuvendit Komunal me nr XXXX. Momentalisht, në zonën industriale janë të vendosur 4 biznese. Ndonëse Zona Industriale në Llazarevë ka kushte ideale për të krijuar ekonomi të qëndrueshme për zhvillim të bizneseve, nevojitet investim për rregullimin e infrastrukturës përcjellëse. Një pjesë e kësaj zone shtrihet në toka në sistem të ujitjes, mirëpo që ky sistem nuk ka qenë funksional për shumë vite

[52] Komuna me vendim të Kuvendit Komunal, në vitin 2017, merr vendim për krijim të zonës industriale në Llazarevë.

dhe ende mbetet në gjendje të tillë, ku tokat bujqësore nuk kanë qasje në sistem të ujitjes, e cila dëshmohet edhe nga letra zyrtare nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh. a.

Bazuar në vlerësimin mbi nevojat për zhvillim ekonomik në Komunën e Obiliqit të gjendjes ekzistuese të krijuar, mosfunksionilizimin e rrjetit të ujitjes, si dhe planifikimet e parapara me dokumentet PZHK të Obiliqit në fuqi dhe PHZIVE-FMR, vërehet një pasqyrë e qartë për nevojat dhe trendët e zhvillimit ekonomik të Komunës së Obiliqit. Si rezultat i gjendjes së krijuar, Komuna ka planifikuar zhvillimet e reja ekonomike duke u bazuar në dokumente ligjore, trendët reale të zhvillimit dhe nevojave reale për akomodim të bizneseve dhe rrjedhimisht të tokës ndërtimore.

Korniza e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor në Obiliq

Prodhimi i qëndrueshëm bujqësor është shfaqur si një nevojë për të gjetur mënyra të prodhimit bujqësor që nuk degradojnë resurset natyrore dhe që në të njëjtën kohë sjellin prodhime bujqësore dhe të ardhura të larta.

Meqenëse bujqësia varet kryesisht nga shërbimet e ofruara nga ekosistemet, bujqësia e qëndrueshme synon të zvogëlojë ndikimet negative mjedisore antropogjene përmes përdorimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së burimeve natyrore.

Burimet natyrore të ruajtura dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit në sistemet e prodhimit të qëndrueshëm janë në shërbim jo vetëm për gjeneratat e pranishme, por edhe për gjeneratat e ardhshme.

Prodhimi bujqësor i qëndrueshëm do të thotë se fermerët janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjes dhe kanë përfitime specifike nga zhvillimi ekonomik, kushtet e mira të punës dhe çmimet e mira për prodhimet e tyre bujqësore.

Koncepti i bujqësisë së qëndrueshme mund të përkufizohet si një sistem i integruar i praktikave të prodhimit të bimëve dhe kafshëve që në një afat të gjatë të plotësojnë nevojat e njerëzve për ushqim, të ruajnë cilësinë e mjedisit dhe burimeve natyrore, të kenë vlerë të lartë ekonomike dhe të përmirësojnë cilësinë e jeta e fermerëve, bashkësia lokale dhe shoqëria në tërësi.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonominë të Obiliqit, e cila do mbështetet edhe më tej me ketë koncept, me kushtet e planifikuara do ofroj një kontribut të konsiderueshëm në ekonomi dhe stabilitetin social.

Ekonomia bujqësore si një segment i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik në Obiliq arrin të absorbojë një numër të konsiderueshëm të fuqisë punëtore në tërësi, e posaçërisht të fuqisë punëtore në zonat rurale. Sipas vlerësimeve të bëra në Kosovë bujqësia kontribuon rreth 20 % në GDP-në e përgjithshme. Megjithatë, kjo rritje e pjesëmarrjes së bujqësisë në produktin e përgjithshëm gjatë viteve të fundit ka ardhur si rezultat i ngushtimit dhe rënies së aktivitetit ekonomik në degët tjera të ekonomisë.

Në komunën e Obiliqit janë përcaktuar dy zona të ndryshme bujqësore, Zona kodrinore e Shalës (përshtatshme për blegtori, bletari dhe turizëm rural) dhe Zona e bujqësisë intensive (përshtatshme për drithëra dhe lavërtari).

Prodhimtaria bujqësor intensive (drithërat, produkte lavërtare dhe pemëtari)

Bujqësia intensive, me prodhim të lartë mund të jetë mënyra më e mirë për të plotësuar kërkesën në rritje për ushqim duke ruajtur biodiversitetin. Në anën tjetër, tokat bujqësore në pjesën lindore të komunës si fshatrat Milloshevë, Mazgit, Llazarevë, Bakshi, Baimofc janë fshatra me kualitet të lartë të tokës bujqësore shumë të përshtatshme për kultivimin e drithërave, perimeve, mirëpo për arsye klimatike janë të varura nga ujitja e tyre edhe pse një pjesë e konsiderushme e këtyre tokave janë nën sistem të ujitjes. Aktivizimi i sistemeve të ujitjes si dhe zgjerimi i tyre do të paraqet një sfidë për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë për këto anë.

Sipërfaqet e tërësishme për prodhimtarinë e drithërave dhe perimeve janë rreth 2,350 ha. Prej rreth 6524 ha të tokës punuese, 46.80 ha çdo vite 'humben' duke i përdorë si tokë ndërtimore apo shfrytëzime tjera jo bujqësore.

Sipërfaqja e mbetur është e ndarë në parcela me sipërfaqe jashtëzakonisht të vogla të cilat gjenden pothuajse të tërat në pronësi private. Brenda tokave bujqësore parashihet edhe mbrojtja e tokave bujqësore si resurs nacional, dhe si aset ekonomik e mjedisor, planifikohet të mbrohet nga degradimi, nga erozioni, fragmentimi dhe ndërtimet, për çka kemi definuar kufijtë ndërtimor dhe kufijtë e tokave bujqësore që planifikohet të mbrohen dhe zhvillohen. Pra, siç e potencuam më larte fshatrat me tokë të kualitet të lartë të tokës bujqësore dhe si e tillë duhet të ruhen nga tjetërsimi dhe të zhvillohet më tutje në aspektin e zhvillimit të bujqësisë.

Kjo zonë e zhvillimit bujqësor për arsye të llojllojshmërisë së tokës mund të zhvillohen disa kultura bujqësore duke filluar nga ato lavërtarë deri të ato pemëtarë. Duke pasur parasysh llojet e ndryshme të tokave në këto zonë bujqësore, para që të fillojmë zhvillimin e kulturave duhet të analizohen dhe të merren parasysh përshtatshmëria e tokave bujqësore si dhe kushtet agro-teknike të tokës.

Qëllimi i zhvillimit të konceptit hapësinorë i zhvillimit të bujqësisë dhe ndarja e zonave zhvillimore është që të mundësoje komunës përkatësisht DBZHR si dhe fermerëve që të kenë një vizion në aspektin e shtrirjes së investimeve në fusha të caktuara bujqësore në komunën e tyre.

Koncepti i zhvillimit të kulturave bujqësore në këtë zonë komuna ka analizuar rendësin e pemëtarisë dhe si rezultat i saj ka paraparë disa objektiva dhe projekte në zhvillimin e këtij sektori bujqësor.

Pemëtaria - Pemëtaria, është një nga veprimtaritë bujqësore më fitimprurëse dhe më e rëndësishme në vendin tonë. Të ardhurat nga pemëtaria, janë mjaft të larta krahasuar me shumë kultura të tjera bujqësore. Për këtë arsye kultivimi i pemëve konsiderohet pasuri e madhe jo vetëm për fermerin, por për gjithë zonën dhe vendin ku ato kultivohen.

Obiliqi ka një traditë të lashtë në kultivimin e kulturave pemëtarë si molla, dardha, kumbulla, qershia, vishnja, lajthia, dredhëza, mjedra, manaferra etj. Në periudhën e kaluar, prodhimtaria pemëtarë në Obiliq u karakterizua nga shumëllojshmëria e kultivarëve të vjetërsuar dhe jo shumë produktiv, mbjelljeve të pemishteve ekstensive e gjysmë-intensive me material fidanor jo kualitativ, niveli i ulët i aplikimit të masave agro-teknike, praktika jo adekuate të menaxhimit shkencor bujqësor dhe mungesa e objekteve adekuate për ruajtjen e frutave.

Edhe pse pemëtaria si veprimtari bujqësore mjaft fitimprurëse në komunën e Obiliqit nuk ka një shtrirje shumë të madhe por ka një trend të rritjes çdo vite duke ditur rendësin e kësaj veprimtarie në zhvillimin e bujqësisë dhe gjenerimin e të ardhurave për ekonomi familjare.

Objektivat dhe projektet për zhvillimin e pemëtarisë:

Mbrojtja e zonave bujqësore të definuara me PZHK, Investimet në infrastrukturën bujqësore (rrugë bujqësore, kanale drenazhimi) në të mirë të mbrojtjes së tokës bujqësore; Ri-vitalizimi i rrjetit ekzistues të ujitjes të Ibër Lepencit dhe mundësia për zgjerim.

Blegtoria - komunën e Obiliqit veprojnë një numër i fermave të cilat merren me mbarështimin e kafshëve si atyre të mëdha dhe kafshëve të imta. Por sa i përket potencialeve të cilat ka kjo zonë numri i fermerëve dhe fondit blegtoral është i vogël, si rezultat i saj drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural ka paraparë disa projekte në zhvillimin dhe përkrahjen e fermerëve në këtë zonë me potenciale të larta për zhvillimin e blegtorisë. Në aspektin e zhvillimit blegtoral është hartuar një koncept e hapësinor i përcaktimit të zonave më të përshtatshme për mbarështimin e kafshëve.

Sektori i qumështit një nga sektorët më të rëndësishëm organizohet në disa ndërmarrje prodhuese dhe tregtare të cilat merren me përpunimin dhe grumbullimin e qumështit nga fermerët nëpër shumë pika grumbulluese. Produktet kryesore janë: qumështi i pasterizuar, kosi me kajmak, jogurti, djathi , speca me ajkë, kajmak i freskët shtëpiak, dhe gjiza. Shitja e prodhimeve bëhet kryesisht në tregun e brendshëm.

Përveç konceptit hapësinor Komuna (DBZHR) ka paraparë disa objektiva dhe projekte në aspektin e zhvillimit të blegtorisë.

Bletaria - Në Komunën e Obiliqit viteve të fundit ka një trend të zhvillimit duke ju falënderuar kushteve hapësinore të cilat i ka kjo komunë. Kushtet natyrore për zhvillimin e bletarisë janë shumë të mira asistenca në këtë drejtim nuk mungon Ministra, kuvendi i komunës, është një mundësi e përkrahjes së bletareve. Si rezultat i saj komuna (DBZHR) në kuadër të planit zhvillimor komunal ka hartuar një koncept i cili do ti ndihmonte dhe orientonte fermerët në aspektin e potencialeve hapësinore ku do të ishte e përshtatshme kultivimi i bletës. Përveç, konceptit hapësinor DBZHR për gjatë viteve në vazhdim do të përkrah bletaret me impute të nevojshme për kultivimin sa më adekuat të bletës.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie në atë zonë do të krijonte një impakt të lartë të qytetare dhe fermerët e asaj zonë, përmes zhvillimit të bletarisë fermerët do të gjeneronin të ardhura ku do të krijofshin një stabilitet ekonomik të qëndrueshëm, migrimi i popullsisë nga këto zona do të parandalohet me investime konkrete dhe ofrim të kushteve do të rritej interesi i kthimit të fermerëve në ato pjesë që të zhvillonin këtë veprimtari. Për realizimin e këtyre zhvillimeve komuna (DBZHR) ka përcaktuar objektiva dhe projekte për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Turizmi rural në Komunën e Obiliqit është një potencial i lartë, një pjesë e territorit është zonë malore e pasur më druje të llojeve të ndryshëm, kullosa, lumeje dhe resurse tjera natyrore të përshtatshme për zhvillimin e turizmit rural.

Duke zhvilluar këtë fushe, impakti të cilin do të krijonte në atë pjesë të territorit të komunës do të jetë i lartë si: ndikon drejtpërdrejt tek niveli kulturor për banorët vendas, përballë fluksit të madh të vizitorëve nga vende të ndryshme të botës, kulturave dhe traditave të ndryshme, ka ndikim sidomos tek gjeneratat e reja, tek fëmijët dhe të rinjtë, të cilët motivohen më shumë për t'u arsimuar, sidomos në përvetësimin e gjuhëve të huaja, rriten dhe të ardhurat ekonomike të banorëve, nxitja e prodhimit të vogël bujqësor në këto zona, etj. Ndërsa sa i përket zhvillimit të turizmit në konceptin e zhvillimit hapësinor të komunës së Obiliqit parasheh zhvillimin e turizmit natyror- rekreativ dhe kulturor, duke mbrojtur dhe rehabilituar mjedisin, natyrën dhe asete të shumta të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Obiliq. Për më tepër, rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në korridor rekreativo-turistik, integrimi i dy asetet nacionale dhe lokale të trashëgimisë kulturore të Obiliqit (Tyrbja e Sulltan Muratit dhe Monumenti i Gazimestanit) janë pjesë përbërëse e konceptit të zhvillimit të turizmit kulturor në komunën e Obiliqit.

Një projekt madhor i rehabilitimit të mjedisit të degjeneruar është integrimi I projektit të parkut multinacional në Obiliq, ku parashihet shndërrimi i tokave të kontaminuara në hapësira gjelbëruese dhe përfshin një sipërfaqe prej 100 hektarësh të KEK-ut.

Peshkataria dhe akuakultura: Obiliqi është një vend i pasur me burime ujore, të cilat përbëhen nga lumi Sitnica Llapi dhe Drenica. Sektori i peshkimit në Obiliq është relativisht i vogël, por është i rëndësishëm për nga pikëpamja social-ekonomike, sepse është një burim i rëndësishëm i vendeve të punës në zonat dhe periudhat e caktuara kohore gjatë vitit.

Akuakulturë aktualisht është një aktivitet i rëndësishëm dhe ka një potencial të madh për zhvillim në të ardhmen, duke ndërthurur aspektet sociale, ekonomike, biologjike, ekologjike dhe mjedisore. Kultivuesit e peshku përdorin teknika të ndryshme kultivimi, intensive, gjysmë intensive, dhe të gjera për të rritur kryesisht troftë, molusqe dhe krap. Këto specie rriten në rezervuarë, liqene artificiale dhe natyrore. Akuakulturara apo rritja e peshkut në formë të organizuar ka filluar të zhvillohet posaçërisht restorante të cilat kanë ndërtuar basene artificiale për rritjen e peshkut i cili përdoret për nevojat e tyre.

Agrobiznesi: Agrobiznesi është sektorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit. Globalisht, bujqësia dhe agrobiznesi po zhvillohen me shpejtësi. Tregjet ndërkombëtare po liberalizohen, sjellja e konsumatorëve po ndryshon dhe tregjet e reja si bioenergjia dhe biokarburantet po evoluojnë. Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, si dhe dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet aktuale vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Megjithatë, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që mund të kenë perspektivë edhe më tutje: grumbullimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore (me theks të veçan pemët), përpunimi i drurit që kohëve të fundit po zhvillohet mjaft shumë, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave të tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese, prodhimi dhe përpunimi i mishit, një mundësi tjetër ka të bëjë me turizmin fshatar, i cili është fare pak prezent. Zhvillimi i sektorit bujqësor në zonat rurale mund të ndikojë dukshëm në ngritjen e nivelit të të ardhurave dhe në uljen e papunësisë, pasi që efekti i bujqësisë është i madh në këtë aspekt. Për të nxitur zhvillimin e bizneseve rurale, qeveria qendrore, komunale dhe agjencionet kosovare e ndërkombëtare që mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme do të duhej të fokusohen gjithashtu në krijimin e kushteve për zhvillimin e bizneseve familjare, që do të krijonte një ambient të favorshëm për biznesin rural.

Koncepti për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës teknike mbështet në plotësimin e nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë teknike cilësore dhe me kapacitetet e planifikuara sipas normave teknike të planifikimit. Infrastruktura e planifikuar do jetë në funksion të plotësimit të nevojave për nivelin qendror, rajonal dhe lokal duke planifikuar shtrirjen, lokacionet dhe kapacitetet e kësaj infrastrukture, dhe identifikimin e hapësirave zhvillimore që kanë nevojë për infrastrukturë të zgjeruar dhe të re. Infrastruktura teknike përfshin pjesën vitale të jetës së qytetareve për mirëqeni më të mirë duke ofruar shërbime si ujë, largim të ujërave të zeza, energji elektrike, ngrohje, telekomunikim dhe menaxhim të mbeturinave. prandaj, është shumë e nevojshme dhe domosdoshme përmirësimi dhe zhvillimi i kësaj infrastrukture në të mirën e një jete më të mirë dhe sigurt.

Qëllimi i konceptit që të siguroj që investimet dhe veprimet komunale mbi infrastrukturën teknike të jenë efikase dhe të qëndrueshme për të ndihmuar qytetarët në zhvillimin e lagjeve në kushte sa më të përballueshme. Koncepti i infrastrukturës teknike thekson nevojat për projekte për zhvillim të infrastrukturës të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse me përputhje me burimet dhe kërkesat e qytetarëve.

Koncepti do të zhvillojë sisteme të qëndrueshme me praktika efikase, teknika dhe administrative për nevojat afatgjata. Planifikimi efektiv është thelbësor për të siguruar qytetarëve shërbime efikase dhe të vazhdueshme që siguron kosto efikase dhe përballueshme për komunën. Nevojat për infrastrukturë teknike janë të vazhdueshme dhe si të tilla nevojitet plani financiar është i domosdoshëm që shpenzimet të jenë të përballueshme për komunën.

5.3.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

UJËSJELLËSI - Për të përmirësuar gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Obiliqit, viteve në vijim duhet të investohet në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shërbimeve teknike për gjithë territorin e komunës. Vendbanimet (fshatrat) që nuk kanë rrjet të ujësjellësit funksional janë Grabofc i Epërm dhe Leshkoshiq. Përveç vendbanimeve (fshatrave) të cilët nuk posedojnë fare rrjet të ujësjellësit, disa vendbanime posedojnë rrjetin e ujësjellësit por furnizimi me ujë në kuadër të këtyre vendbanimeve përcjellët me vështirësi të shumta teknike dhe me infrastrukturë përcjellëse te dobët . Nga vendbanimet (fshatrat) të cilat janë më të mëdhenj dhe kanë një numër të konsiderueshëm të banorëve dhe nuk posedon rrjet të ujësjellësit është Grabofc i Epërm. Në sajë të gjendjes aktuale dhe në perspektivë rrjeti i ujësjellësit në komunën e Obiliqit do të përmirësohet duke i ndërmarrë këto veprime:

- Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina" sh.a. (përfshire pusetat).
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Grabofc i Epërm;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Shipitullë;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Baimofc dhe Milloshevë;
- Riparimi i rrjetit të ujësjellësit në disa lagje të qytetit të Obiliqit;
- Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina;

KANALIZIMI - Për të përmirësuar mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit fekal në Komunën e Obiliqit, komuna në bashkëpunim me K.R.U Prishtina kanë paraparë disa projekte në aspektin e rivitalizimit të rrjeteve ekzistuese dhe shtrirjen e rrjeteve të reja në vendbanimet të cilat nuk kanë shërbime mbi grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Komuna e Obiliqit nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza si dhe kolektor në drejtim të impiantit dhe si e tillë të gjitha shkarkimet ndodhin në trupa ujorë si lumin Sitnicë, Llap dhe Drenica. Pra, duke parë problemet të cilat sjellin aspekti i shkarkimeve të tilla dhe vështirësitë e menaxhimit të rrjeteve ekzistuese, komuna e Obiliq dhe komunat tjera përreth kanë nënshkruar marrëveshje me BEZH për përkrahje në ndërtimin e impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në kuadër të Komunës së Obiliqit i cili impiant do të mundësonte mbledhjen e të gjitha ujërat e zeza dhe trajtimi e tyre. Pra, për përmirësimin e gjendjes në komunë në aspektin e menaxhimit dhe rivitalizimit e rrjetit të ujërave të zeza ka ndërmarr këto veprime:

- Ndërtimi i kolektorëve kryesor dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në zonën e Obiliqit;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Grabofc i Epërm;
- Riparimi i rrjetit të kanalizimit disa lagje ne qytetit e Obiliqit;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Baimofc dhe Mullosheve;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Breznicë dhe Kozaricë;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;


Gjithashtu për përmirësimin e gjendjes në komunë në aspektin e menaxhimit dhe rivitalizimit e rrjetit të ujërave të atmosferike ka ndërmarr këto veprime:

- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferik;
- Ndarjen e ujerave te atmosferike nga ato te zeza;
- Trajtimin mekanik të tyre dhe shfrytëzimin e këtyre ujerave për nevoja të caktuara.

ENERGJIA ELEKTRIKE DHE TELEKOMUNIKIMI - Nga analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit të elektro- energjetik rezulton se rrjeti shpërndarës është i vjetruar dhe se është shkaktari kryesor i problemeve me furnizim me energji elektrike në komunë.

Prandaj e nevojshme të planifikohet përmirësimi i rrjetit ekzistues për të rritur cilësinë dhe sigurinë e furnizimit, si dhe për të reduktuar humbjet teknike në zona të caktuara të komunës, si dhe në fshatrat ku këto humbje janë me te theksuara. Kjo nënkupton kalimin nga rrjeti shpërndarës ajror 10kV në rrjetin shpërndarës kabllovik 20kV si dhe zëvendësimin e linjave ajrore 230/400 me kabllo gërshetë apo edhe kabllo nëntokësore domosdoshmërish ne qytet por edhe ne lokacionet me numër të konsiderueshëm të konsumatorëve.

Ne rrjetin e fshatrave më periferike gjithashtu duhet rrjeti të përmirësohet duke vendosur shtylla nga betoni, si dhe zëvendësimi i përçuesve të stërvjetruar me kabllo bistek.



Harta 66 Koncepti i zhvillimit të Infrastrukturës Teknike

Në kuadër të këtij plani edhe infrastruktura dhe objektet e rrjetit elektro-energjetike vjetruara, duhet të zëvendësohet, andaj parashihet eliminimi gradual i trafostacioneve të nivelit 35/10 kV dhe kalimi në ato me tension TS 110/20kV, dhe zëvendësimi i nënstacioneve me kapacitet NS 10/0.4 kV në ato me kapacitet 20/0.4 kV.

Rregullimi i ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale ku në pjesën më të madhe të vendbanimeve dhe lagjeve ekziston por kemi disa vendbanime sidomos ato rurale që nuk ka ndriçim publik dhe për këtë arsye komuna ka paraparë disa projekte në avancimin dhe mbulueshmërinë e territorit të komunës me ndriçim publik, me prioritet të veçantë në qytet dhe në vendbanimet të cilat nuk posedojnë ndriçim publik.

- Zëvendësimin e transformatorëve nga 10/0.4kV në 20(10)/0.4kV;
- Ndërtimin e blloqeve të TM në nivel 20(10)/0.4kV;
- Zëvendësimin i linjave kabllore nga 10 kV të vjetërsuara dhe të mbingarkuara në 20kV ;
- Zëvendësimin i shtyllave të drurit me shtylla betoni me pajisje tjera përcjellëse;
- Zëvendësimin i kabllove të vjetërsuara të 10kV me ato 20kV
- Ndërtimi i NS 10(20)/0.4kV në rrjetet e ngarkuara të tensionit të ulët.
- Ndërtimi i NS 35/10kV në 110/10(20)kV.

Në rrjetin e **telekomunikacionit** në komunën e Obiliqit bëhen investime të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të performancës së tij. Në këtë aspekt është shtrirja e kabllos optike (KO) në fshatrat. Në zonën urbane në disa lagje është shtrirë KO ndërsa planifikohet të shtrihet edhe për lagjen tjera. Gjithashtu planifikohet që në fshatra në të cilët KO nuk përmbush kapacitetin e duhur parashihet rritja e tij.

Propozimet për zgjerimin e infrastrukturës së telekomunikacionit janë planifikuar si në vijim:

- Propozimet për rrjet optik me qëllim të shtimit të kapacitetit të konsumatorëve të rinj.
- Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit (TEL+DATA+VIDEO) dhe 4G, LTE dhe 5G.
- Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore dhe shtrirje e rrjetit të ri GPON.
- Ndërtimi i infrastrukturës për një rrjet të përbashkët për shërbime të telekomunikimit.
- Vendosja e antenave për transmetim të valëve sipas kërkesave të përcaktuara me ligj.

GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE - Obiliqi në aspektin e ofrimit të shërbimeve në menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave. Ofrimi i këtij shërbimi do të vazhdojë të realizohet bazuar në "Planin lokal për veprim në mjedis" me synim të mbulimit të vendbanimeve të cilat janë jashtë sistemit të grumbullimit të mbeturinave. Përveç kësaj, planifikohet eliminimi e të gjitha deponive ilegale dhe trajtim i deponisë ekzistuese rajonale në Mirash me qëllim edhe të shtimit të kapaciteteve dhe eliminimit të ndotjeve të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në dhe përreth deponisë rajonale, nëpërmjet shtrirjes së shtresës mbrojtëse - gjeomembranë adekuate.

Sa i përket mbeturinave ndërtimore, parashihet të zhvillohen deponia për grumbullimin e mbeturinave ndërtimore për të gjitha vendbanimet planifikohet të realizohet deri në vitin 2025. Skema e grumbullimit të mbeturinave në komunë do t'i nënshtrohet ri-modelimit gjatë së cilit do të caktohen disa zona me orar përkatës të grumbullimit, dhe do të promovohet seleksionimi dhe riciklimi i mbeturinave.

- Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit nga mbeturinat
- Trajtimi i mbeturinave
- Trajtimi mbetjeve të ngurta dhe mbetjeve urbane.
- Mënjanimi i mbeturinave industriale dhe rivitalizimi i zonave të afektuara.
- Identifikim, largim dhe mirëmbajtja e deponive ilegale dhe mbeturina që përmbajnë azbest.

5.3.2.3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

Aktualisht, transporti është një nga komponentët më të rëndësishëm të ekonomisë shtetërore, si në zhvillim ashtu edhe me një bazë shumë të zhvilluar ekonomike dhe sociale. Transporti siguron funksionimin normal të ekonomisë, rritjen e efikasitetit të prodhimit shoqëror, krijon kushte për shpërndarjen racionale të forcave të prodhimit në të gjithë vendin, duke marrë parasysh përafrimin më të përshtatshëm të ndërmarrjeve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë me burimet e lëndëve të para dhe zonat e konsumit të produkteve, specializimin dhe bashkëpunimin e prodhimit, si deh lejon zhvillimin e industrive të tilla si tregtia, bujqësia dhe veprimtarive tjera.

Në Komunën e Obiliqit, modeli aktual i sistemit të transportit është një prej shkaqeve kryesore të trendit të paqëndrueshëm: rritja e ndotjes nga mjetet motorike, varësia e vazhdueshme nga nafta dhe rritja e mbipopullimit. Për këtë arsye, në dekadat e fundit, qasja ndaj transportit ka ndërruar fokusin nga planifikimi i rrugëve për automjete, në atë të transportit të pa-motorizuar, këmbësorë dhe biçikleta, si dhe transportit publik.

Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e rrjetit rrugor

Territori i Komunës së Obiliqit është i mbuluar mirë me rrjet rrugor, sipas kërkesave për lëvizje, infrastruktura rrugore në përgjithësi është përmirësuar ne aspektin e përmbushjes se kritereve teknike dhe ofron kushte të kënaqshme për lëvizjen e mjeteve. Përveç mbulueshmërisë me infrastrukture rrugore, Komuna e Obiliqit ka mbulueshmëri edhe me infrastrukture hekurudhore, funksionalizimi dhe modernizimi i se cilës është pjese e strategjisë dhe zhvillimit nga niveli qendror.

Në territorin e komunës së Obiliqit kalon autoudha R7 ("Ibrahim Rugova"). Kjo autoudhë e tangjenton komunën e Obiliqit në pjesën veri-lindore. Në këtë pjesë gjendet edhe nyja e autoudhës që mundëson kyçjen me rrugën nacionale N2 e pastaj edhe me rrugën rajonale R220. Komuna e Obiliqit, në kuadër të rrjetit rrugor ekzistues përmban rrugën nacionale M-2 që lidhë Prishtinën me qytetin e Mitrovicës. Përmes kësaj nyje, qyteti i Obiliqit krijon qasje në rrugët e karakterit më të lartë.

Gjithashtu, rruga nacionale M-2, Obiliqit i siguron qasje në rrugët me rëndësi kombëtare siç janë autoudha "Ibrahim Rugova" dhe "Arbër Xhaferi" përmes të cilave mund të lidhet edhe me rrugët e karakterit ndërkombëtar (korridoret pan evropiane).

Përmirësimi i mëtutjeshëm i rrjetit rrugor është i nevojshëm për të lidhur qytetin e Obiliqit në tërësi dhe të fshatrave të tij. Kjo do të përmirësoj jetesën, do të mbështesë ekonominë vendore duke ofruar qasje më të mirë në tregje dhe do të promovojë turizmin**.** Komuna e Obiliqit është e lidhur mirë me komunat përreth, siç janë Fushë Kosova, Drenasi, Vushtrria dhe Prishtina.

Parametrat teknik të rrugës nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte te mira për qarkullim të mjeteve motorike. Hyrja dhe dalja nga qyteti i Obiliqit në autoudhën "Ibrahim Rugova" -R7 realizohen përmes nyjes që gjendet në territorin e qytetit. Ne kuadër te rrjetit rrugor rajonal, Komuna e Obiliqit përfshinë rrugët R220, dhe R120. Në përgjithësi, rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike.

Problematika paraqitet në pjesën e rrugës R220 që shërben për lidhje më autoudhën dhe pjesën e territorit të komunës deri në qytetin e Mitrovicës. Pothuajse në tërë gjatësinë e saj (përveç në pjesën që kalon në qytet), kjo rrugë nuk përmban pjesën e infrastrukturës për akomodim të këmbësorëve dhe biçiklistëve. Në aspektin e sigurisë së trafikut, sfidë kryesore mbeten kryqëzimet me rrugët tjera që të gjitha janë në nivel të njëjtë dhe të pasinjalizuara sipas standardeve (kryqëzimi R220 me R120). Përmes rrugës rajonale R120 nga qyteti i Obiliqit realizohet kyçja në rrugën nacionale N-2, e rregulluar me mbikalim (fshati Muzakaj).

Zhvillimi i rrjetit të infrastrukturës për lëvizje aktive / ecje dhe çiklizëm

Ecja dhe çiklizmi njihen dhe promovohen si mënyra të qëndrueshme të transportit, me pasoja pozitive në shëndet, mjedis dhe në cilësinë e përgjithshme të jetës së qytetit, duke ndihmuar në reduktimin e zhurmës dhe kërkesës për mënyra ndotëse, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe ndotjen akustike, duke implementuar politika të adresuara për ripërdorimin e hapësirave urbane dhe krijimin e një mjedisi urban më miqësor për njerëzit.

Megjithatë, në mënyrë që ecja dhe çiklizmi të pranohet nga qytetarët dhe të mbështetet nga autoritetet komunale dhe institucionet tjera vendore, infrastruktura duhet të sigurojë një mjedis të sigurt dhe efektiv për këmbësorët dhe çiklistët.

Rrugët urbane brenda qytetit, në aspektin e funksionalitetit përgjithësisht ofrojnë qasje të mirë për qarkullim të automjeteve motorike, por jo edhe për lëvizje të këmbësoreve dhe çiklisteve.

Kërkesave për lëvizje nga ana e këmbësorëve dhe çiklisteve, ne qytetin e Obiliqit nuk u ofrohet hapësirë komode. Po ashtu dhe ne kuadër te rrjetit rrugor periferik, këmbësoret dhe çiklistet nuk kane qasje te lehte dhe kushte te mira për lëvizje te sigurt.

Qëllimi kryesor i zhvillimit të infrastrukturës për këmbësorë është përmirësimin e cilësisë së lëvizjes dhe largimin e barrierave nga trotuaret, si dhe në qasjen pa pengesa në ndërtesa administrative publike dhe shtetërore, shërbime shëndetësore dhe sociale, shkolla, dyqane, objekte kulturore dhe ndërtesa tjera.

Ekzistojnë një sërë propozimesh për përmirësimin e kushteve për këmbësorë në Obiliq, duke përfshirë:

- Zhvillimin e infrastrukturës adekuate për këmbësorë dhe çiklist – me standarde adekuate të projektimit dhe hapësira përcjellëse për lloje të ndryshme të rrugëve për këmbësorë dhe çiklist në të gjithë qytetin.
- Skemën e zgjeruar për këmbësorë dhe çiklist në qendër të qytetit, zgjerimin e zonës për të përfshirë rrugët e afërta dhe për të siguruar një zonë më të gjerë për këmbësorët. Kjo do të përfshijë udhëtimet në qendër të qytetit, në zonat në afërsi të shkollave si dhe pjesët tjera rekreative të qytetit.
- Masat për të ndihmuar personat me vështirësi në lëvizje – futja e masave tjera për të ndihmuar personat e verbër/me shikim të vështirësuar (p.sh. përdorimi i sipërfaqeve speciale-të dallueshme në afërsi të vendkalimeve për këmbësorë).
- Përdorimin e sinjalizimit adekuat të trafikut për lëvizje të pamotorizuar.
- Lidhjen e mirë të këmbësorëve/çiklistëve me transportin publik, parkingjet e automjeteve, taksitë dhe vendparkimet e biçikletave.
- Përmirësimi i kushteve në qytet për këmbësorë. Sipas nevojës, kjo përfshin riprojektimin e rrugëve për të siguruar lidhje më të mirë dhe qasshmëri për përdoruesit.
- Duhet të hiqen të gjitha pengesat për lëvizjen e këmbësorëve në tërë qytetin dhe synohet që të merren parasysh zgjerimet e zonave ekzistuese të këmbësorëve.

Ndërtimi dhe funksionalizimi i rrugës qarkore – By Pass në pjesën jug-perëndimore të qytetit prej nga vitit 2020 është funksional dhe përbën infrastrukturë lehtësuese për qytetit.

Përmirësimi i infrastrukturës për zhvillimin e transportit rajonal

Një nga objektivat kryesore të sistemit të transportit publik në Komunën e Obiliqit është **përmirësimi dhe** zhvillimi i infrastrukturës rrugore. Krijimi i një rrjeti të transportit regjional për njerëz dhe për mallra, përpos përmbushjes së kërkesave për lëvizje do të ketë ndikim edhe në zhvillimin ekonomik duke nxitur investimet në zhvillimin e infrastrukturës rrugore në nivel regjional. Objektivi për përmirësimin e infrastrukturës rrugore për zhvillimin e transportit publik, mund të arrihet duke realizuar aktivitetet si në vijim:

- Ndërtimi i stacionit të autobusëve në zonën urbane;
- Vendosja e shërbimeve e reja të transportit publik me autobusëve, të propozuara në kuadër të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) për qytetin e Prishtinës[53], ku është planifikuar rrjeti dytësor i transportit publik urban (si pjesë plotësuese e transportit kryesor urban) që do të lidhnin qendrën kryesore urbane me zonat periferike (të banimit), si dhe më gjerë. Në kuadër të këtyre shërbimeve dytësore është përfshirë edhe qyteti i Obiliqit, dhe kjo linjë mundëson lidhjen me më shumë zona rurale dhe zona periferike të qytetit me qytetin e Prishtinës. Në përgjithësi, rrjeti i ri do të ofrojë një nivel të përmirësuar të shërbimit në të gjithë qytetin në krahasim me kushtet ekzistuese.
- Mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve.

Rivitalizimi i transportit hekurudhor

Infrastruktura hekurudhore në Komunën e Obiliqit, aktualisht është e vjetruar dhe nuk është në gjendje t'i përmbushë nevojat e udhëtarëve dhe transportuesve të mallrave. Ajo nuk ofron lidhje adekuate me shtetet fqinje dhe portet e tyre. Për këtë arsye ka nevojë urgjente për **modernizim dhe zhvillim në mënyrë që t' i plotësojë nevojat dhe të ofrojë shërbime të qëndrueshme të transportit.**

[53]Mott McDonald - Matjet e realizuara nga PMQU për qytetin e Prishtinës, 2017.

Me qëllim të rivitalizimit të transportit hekurudhor në relacioni Prishtinë-Mitrovicë, është e nevojshme:

- Ndërtimi i terminusit në afërsi të stacionit hekurudhor në Obiliq, ku do të përfshihen ambiente për vagonët e mallrave dhe magazinën kryesore hekurudhore.
- Autoritet qendrore në Kosovë janë në përgatitje të procedurave për fillimin e rikonstruktimit të linjave hekurudhore, projekt ky i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe nga Qeveria e Kosovës. Faza e parë e rikonstruktimit të rrjetit hekurudhor do të fillon në linjën Prishtinë - Hani i Elezit në kufi me Maqedoninë, kurse faza e dytë, e cila kalon nëpër territorin e Obiliqit, përfshin rrjetin hekurudhor Prishtinë - Leshak, në kufirin me Serbinë. Prandaj, është e nevojshme të zbatohen gradualisht rekomandimet e nxjerra në bazë të studimit të fizibilitetit të Linjës 10 (kryer nga Konsulenca e angazhuar dhe mbështetur nga BERZH) për të pasur, së paku, këtë linjë në gjendje të mirë për operim. Pjesa jugore e linjës 10 duhet të konsiderohet si prioritare si dhe ne një ardhme të afërt duhet rishikuar mundësit e funksionalizimit të pjesës veriore të linjës X. Në bazë të studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës X[54].

5.3.2.4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Zhvillimi i sistemit të infrastrukturës publike i referohet përmirësimit të cilësisë jetës së qytetarëve përmes ngritjes së nivelit të shërbimeve dhe qasjes më të lehtë në objekte. Shpërndarja hapësinore e shërbimeve publike bazohet në rrjetin aktual të ndërtesave dhe hapësirave dhe identifikimin e nevojave të popullatës në të ardhmen. Në këtë aspekt, parimet themelore të zhvillimit të ardhshëm të këtij sektori janë:

- Përmirësimi i shërbimeve në të gjitha vendbanimet përmes rehabilitimit të objekteve ekzistuese apo ndërtimit të objekteve të reja;
- Shtrirja e balancuar e shërbimeve në tërë territorin e komunës;
- Nxitja e përfshirjes së iniciativave private në këtë sektor, në veçanti në fushën e përkujdesjes së fëmijëve dhe të moshuarve.


Bazuar në zhvillimin hapësinor dhe demografik për secilin vendbanim dhe strukturës së moshës së popullatës, dhe në përputhje me këtë dhe funksionet e tyre themelore, do të sigurohen shërbimet e nevojshme publike.

Institucionet arsimore. Në përgjithësi, qasja në arsim fillor dhe të mesëm në komunën e Obiliqit është relativisht e kënaqshme. Me zhvillimin e ardhshëm të infrastrukturës arsimore synohet sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor në tërë territorin e komunës.

Sigurimi i objekteve të nevojshme të edukimit parashkollor me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel të arsimimit do të bëhet përmes ndërtimit të institucioneve parashkollore-çerdheve në:

- Mazgit;
- Milloshevë;
- Hade e Re (në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq),;
- Lajthishtë; dhe
- Krushefc

[54]Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015- 2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeqar, 2015.



Harta 67 Koncepti i zhvillimit të Infrastrukturës Publike dhe Sociale

Gjithashtu, në aspektin afatgjatë, planifikohet edhe mbulueshmëria me shërbime çerdhe apo kopsht në zonën rurale, në fshatrat ku numri i popullsisë kalon shifrën 3,000 banorë, më saktësisht shtrirjen e tyre në të gjitha qendrat e rendit të mesëm të definuara me këtë koncept, si Caravodicë. Organizimi i arsimit para- fillor do të bëhet përmes sigurimit të hapësirave për këtë qëllim në kuadër të rrjetit ekzistues të SHFMU-ve, në mënyre të balancuar në tërë territorin e komunës. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët për periudhën e ardhme tetë-vjeçare janë planifikuar ndërtimi i institucione të reja në:

- Obiliq;
- Baimofc.

Koncepti parasheh edhe pajisjen me salla të edukatës fizike në:

- SHFMU ”Naim Frashëri“ në Breznicë,
- SHFMU” Migjeni“ në Sibovc.
- SHFMU ”Abdurrahmon Gërguri“ në Kryshefc.

Nivelin e arsimit të mesëm të lartë nuk janë planifikuar institucione të reja. Investimet kapitale do të përqendrohen në kompletimin e infrastrukturës ekzistuese me hapësirat e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të edukatës fizike.

Institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale. Zhvillimi i kujdesit shëndetësor do të bazohet në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor parësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat Shëndetësore në zonat rurale. Ofrimi i shërbimeve cilësore do të sigurohet përmes rritjes së numrit të personelit shëndetësor, në veçanti të mjekëve familjarë. Gjithashtu përmirësimi i kujdesit shëndetësor do të mundësohet duke pajisur të gjitha institucionet shëndetësore me pajisje të reja dhe moderne mjekësore dhe furnizim të rregullt me inventar.

Në një periudhë afatgjatë, janë planifikuar edhe ndërtimet e objekteve e reja të mjekësisë familjare në QKMF-së në Obiliqit në mënyrë që të sigurohet kapacitet i mjaftueshëm për shërbime cilësore dhe qasje më e lehtë e shfrytëzueseve.

Ndërtimi i objekteve të reja të të përkujdesjes shëndetësore janë planifikuar si vijon:

- Ndërtimi i Qendrës së re Kryesore Mjekësore Familjare në qytetin e Obiliqit.

Ndërtimi i objekteve të reja të të përkujdesjes sociale janë planifikuar si vijon:

- Ndërtimi i banimit kolektiv me 50 njësi për rastet sociale;
- Ndërtimi i 50 shtëpive për rastet sociale ne komunën e Obiliqit;
- Ndërtimi i qendrës për strehim te përkohshme për se paku 20 familje.
- Ndërtimi i qendrës për strehim për persona te moshuar.

Administrata publike. Për funksionim më efecient të administratës komunale tashmë Komuna ka ndërtesë të re dhe nuk ka planifikuar hapësira të reja gjatë tetë viteve të ardhme. Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet avancimi i sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Hapësirat kulturore. Objektiv tjetër është krijimi i kushteve më të mira për aktivitete kulturore. Ky objektiv planifikohet të arrihet përmes ndërtimit të:

- Bibliotekës Komunale.

Hapësirat sportive dhe të gjelbra. Objektiv tjetër është krijimi i kushteve më të mira për aktivitete rekreative për sportistë. Ky objektiv planifikohet të arrihet përmes dy projekteve. Komuna nuk ka mundësi financiare të investojë dhe t'u përshtatet standardeve të cilat kërkohen në lojërat ndërkombëtare dhe kjo do të mundësonte një zhvillim të biznesit privat duke ofruar një përvojë të mirë dhe duke hapur gjithashtu vende të reja të punës. Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet:

- Revitalizimi i stadiumit te qytetit "Agron Rama" nga ana e Federatës se Futbollit te KS.

Po ashtu ky Plan Zhvillimor Komunal parasheh edhe krijimin e fushave të reja sportive në kuadër të Shkollave Fillore dhe të Mesme te Ulëta në:

- Raskovë;
- Kozaricë;
- Sibovc;
- Plemetin; dhe
- Palaj

Përreth termocentraleve parashihet:

- Krijimi i brezave të gjelbër.

Hapësirat e hapura publike. Objektiv tjetër është krijimi i kushteve më të mira për hapësira të lira publike. Ky objektiv planifikohet të arrihet përmes dy projekteve. Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet ndërtimi i:

- Ndërtimi i sheshit te qytetit "Adem Preniqi";
- Krijimi i parqeve të reja.

Hapësirat e varrezave Objektiv tjetër është krijimi i kushteve më të mira për hapësira të destinuara për varreza. Ky objektiv planifikohet të arrihet përmes mirëmbajtjes së varrezave ekzistuese si dhe zgjerimit dhe rregullimit të varrezave ekzistuese në:

- Milloshevë;
- Sibovc;
- Mazgit; dhe
- Baimofc.

5.3.2.5. MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Obiliqit është mision i veçantë marrë parasysh vlerat e tyre, paraqet një potencial për zhvillim ekonomik përmes turizmit. Territori i komunës së Obiliqit , vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale.

Sa i përket strategjisë së mbrojtjes së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, Plani Zhvillimor Komunal parasheh:

- Hulumtimin dhe studimi shkencor të zhvillimit historik të qytetit dhe vendbanimeve rurale;
- Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për asetet e trashëgimisë kulturore dhe kushteve të veçanta ndërtimore në hartën zonale;
- Definimi i bërthamës së vjetër të qytetit mbi bazën e hulumtimit historik dhe hartëzimit të sipërfaqeve të mbrojtura;
- Hartimi i planeve të konservimit si plane rregulluese të hollësishme sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, si dhe komplementimi me metodologjitë e konservimit të integruar që promovojnë nxitjen e zhvillimit ekonomik përmes turizmit;

5.3.2.6. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Mbrojtja e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri


Mbrojtja e mjedisit në komunën e Obiliqit është mision i veçantë marrë parasysh vlerat e saja natyrore siç janë ato pyjore, ujore dhe tokën bujqësore. E gjithë kjo krijon një natyrë që është potencial për zhvillim të turizmit. Për të luajtur rolin që i përshkruhet duhet të mbrohet ajri, uji dhe toka. Territori i komunës së Obiliqit , vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale.

Komuna ka paraparë si të domosdoshme ndërtimin e impiantit kryesor për ujërat e zeza dhe impiante tjera në fshatrat të cilat për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të lidhen me atë kryesor. Për më tepër edhe çdo operator industrial si Korporata energjetike e Kosovës (KEK) duhet të parasheh masa për trajtimin e ujërave të zeza (ndërtimin e sistemeve të brendshme të filtrimit të ujërave industrial - impianteve vetanake), e gjithë kjo me qëllim të mbrojtjes së lumenjve dhe tokës nga degradimi që mund të shkaktojnë mbetjet industriale. Zgjerimi i kapaciteteve të deponisë rajonale dhe eliminimi i deponive ilegale është hapi tjetër në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

Mbrojtja e ujit dhe ajrit dhe tokës

Mbrojtja e ujit. Në Komunën e Obiliqit , lumenjtë dhe derdhjet e tyre që kalojnë përgjatë qytetit dhe disa fshatra janë të ndotura në shkallë të madhe. Komuna duhet të ndërmerr masa për mbrojtjen e zonave ujore, burimeve të ujërave nëntokësor, ujërat sipërfaqësorë dhe ujë rrjedhat e hapura, të bëjë mirëmbajtjen e ujërave, kontrollimin e zhvillimeve dhe ndërtimeve etj. Përveç masave të cekura më lartë, për mbrojtjen e ujërave bëhet eliminimi i deponive ilegale dhe menaxhimi efektiv i mbeturinave, si dhe trajtimi i problemit të derdhjes së ujërave të ndotura të cilat derdhet te pa trajtuara në përroje, dhe në lumenjtë si Sitnica, Drenica dhe Llapi. Një kërcënim tjetër i kualitet të ujit është vendosja e zonës industriale afër lumenjve. Rreziku qëndron nga vajrat dhe substancat tjera kontaminuese, që depërtojnë përmes ujit.

Për të mbrojtur trupat ujor, koncepti planifikon ndarjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura nga kanalizimi i ujërave atmosferike, dhe ndërtimin e fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Obiliq , që do të parandalonte derdhjen e ujërave të zeza në lumenj dhe përroska të Obiliqit . Përgjatë rrugëve dhe brigjeve të lumenjve duhet të mbillen pemë për të krijuar breza të gjelbërimit dhe amortizuar ndotjen nga pluhuri, gazrat dhe zhurma. Po ashtu do të ndërmerren masa në lidhje me trajtimin e mbeturinave dhe përdorimin e energjisë që lirohet nga trajtimi i mbeturinave. Për më tepër edhe masat e buta si fushata vetëdijësuese, trajnimeve dhe ligjërata mbi rëndësinë dhe ruajtjen e trupave ujor duhen të ndermirën.



Harta 68 Koncepti i Mbrojtjes se Mjedisit dhe sipërfaqeve në rrezikshmëri

Mbrojtja e ajrit

Sipas Vlerësimit, ndotja e ajrit kryesisht shkaktohet nga: emetimet e gazrave nga trafiku, dhe nga Korporata Energjetike e Kosovës. Gjithashtu, në mungesë të rrjetit të ngrohjes qendrore, ndotje shtesë paraqesin të gjitha njësitë e banimit që ngrohen përmes burimeve alternative me dru, pelet, dhe thëngjill.

Mirëpo, bazuar në ligjin mbi mbrojtjen e ajrit, komuna në bashkëpunim me MMPHI duhet të bëjë kontrollimin e vazhdueshëm të emetimeve të pluhurit dhe tymit përmes matësve të cilësisë së ajrit. Obiliqi ka 3 stacione për matjen e parametrave të ajrit që monitorohen nga instituti hidrometrologjik i Kosovës, po ashtu edhe instituti INKOS bënë monitorime në disa pika për parametra si PM10, PM2.5, SO2, NOx, O3, CO. Sipas raportit të AMMK 2018 për gjitha këto parametra kemi vlera në rritje.

Në mënyrë që të zvogëlohen pasojat nga ndotësit e ajrit, komuna duhet të hartojë **Plan Lokal të Veprimit të Cilësisë së Ajrit**, ku do të përcaktohen masat për veprime 8 vjeçare për menaxhimin e cilësisë së ajrit për tërë territorin e komunës në pajtim me strategjinë e cilësisë së Ajrit.

Sa i përket zvogëlimit të ndotjes së ajrit nga përdorimi i drurit, peletit dhe thëngjillit për ngrohje, koncepti propozon të bëhet studim i mundësive për ndërtim të sistemit të ngrohjes qendrore, ku si hap i parë parashihet studim i fizibilitetit të cilin Komuna e Obiliqit e ka përfunduar për ngrohje të ndërtesave të institucioneve publike në Komunë. Ndërsa në proces të planifikimit përmes përcaktimit të shfrytëzimit të tokës plani parasheh një zhvillim më kompakt dhe përdorim më të vogël të automjeteve me qëllim të zvogëlimit të dyoksidit të karbonit.

Mbrojtja e tokave bujqësore Komuna e Obiliqit nga sipërfaqja e tërësishme ka rreth 6524.43haose 62.08% e territorit të Komunës është Tokë bujqësore, si aset nacional, ekonomik dhe mjedisor duhet të mbrohet parimisht nga degradimi dhe ndërtimi i shpërqendruar, bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit Përveç kësaj, koncepti parasheh mbrojtjen e tokës bujqësore nga:

- Gazrat e shkarkuara, pesticidet dhe plehrat kimikë apo përdorimi i tepruar i tyre në bujqësi;
- Grumbullimi në tokë i Plumbit dhe metaleve të rënda, gazrat dhe mbetjet e tjera;
- Përzierja me tokën nëpërmjet reshjeve të gazrave të dëmshme që ndotin ajrin;
- Erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve;
- Ndërtimet e shpërndara;
- Fragmentimet e shpeshta dhe të paplanifikuara të tokës bujqësore.

Për secilin tyre aplikohen masa të veçanta për mbrojtje. Sa i përket ndjeshmërisë së tokës në komunën e Obiliqit në hartën e ndjeshmërisë së tokës vërehet se toka përgjatë rrjedhave të lumenjve dhe me bonitet më të lartë ka një sensitivitet më të lartë. Në komunën e Obiliqit, ruajtja e shtretërve të lumenjve nga erozioni dhe nga hedhja e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme, mbron tokën bujqësore dhe bonitetin e lartë përreth trupave ujor.

Sa i përket mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara, përcaktimi i kufijve ndërtimor, veçanërisht në vendbanimet rurale është masë mbrojtëse e drejtpërdrejt ndaj ndërtimeve. Në kuadër të këtyre masave përfshihen edhe monitorimi dhe kufizimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave në masë që të mos e dëmtojnë tokën bujqësore dhe kontrolli i lëshimit të ujërave industrial në afërsi të tokave bujqësore me bonitet të lartë. Përmes planifikimit, përcaktimi i zonave bujqësore, është masë mbrojtëse e drejtpërdrejt ndaj fragmentimit të tokës bujqësore, kurse mbrojtja nga erozioni do të bëhet përmes përcaktimit të zonave pyjore dhe pyllëzimit.

Mbrojtja e pyjeve. Komuna e Obiliqit nga sipërfaqja e tërësishme ka rreth 1168.04ha ose 11.11 % vetëm tokë pyjore. Pylltaria gjithashtu vlerësohet të jetë njëri ndër sektorët me potencial për zhvillim ekonomik. Erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve sidomos në fshatrat si Breznicë, Grabofc i Epërm etj.

Mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve do të ketë ndikim pozitiv edhe në parandalimin e erozionit. Toka pyjore mbrohet duke ndërmarrë masa për parandalimin e shpyllëzimit, mbrojtjes dhe rregullimit përmes pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Pyllëzimi duhet të bëhet përmes mbjelljeve të bimëve apo farës. Gjithashtu edhe për mbrojtje të biodiversitetit duhen të ndermirën masa të veçanta sidomos për speciet endemike të florës dhe faunës si dhe mbrojtjes së peizazhit.

Parandalimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Bazuar në Ligjin Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera" Komuna e Obiliqit , përkatësisht sektori për Mbrojtje të Mjedisit duhet të ketë "Planin për Reagim Emergjent Komunal", i cili përcakton procedurat, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave komunale dhe tjera në ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore, bën evidentimi i mjeteve për reagim emergjent në komunë dhe vlerëson nevojën për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore. Për më tepër komuna për të parandaluar rreziqet dhe fatkeqësitë natyrore duhet të krijojë dhe funksionalizojë Qendrën Operative Emergjente Komunale (QOEK).

Analiza e rreziqeve paraqet dukuritë kryesore që ndodhin në Qytet/Komunë që janë vërshimet, zjarret, erërat e forta, erozionet dhe incidentet me materie të rrezikshme, etj.

Mbrojtja nga erozioni Komuna e Obiliqit nuk karakterizohet me shkallë të lartë të erozionit. Në komunën e Obiliqit janë identifikuar me shkallë të lartë të erozionit gjendet qendrore të territorit të evidentuara disa zona erozive të intensitetit të lartë të paraqitura në hartën e erozionit. Territori i. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Obiliqit, shpyllëzimi dhe shtrirja urbane kanë ndikuar në ngritjen e shkalles së erozionit. Koncepti me përcaktim të shfrytëzimit të tokës për tërë territorin e komunës, shtrirjen e pakontrolluar të vendbanimeve me ndërtime, me veprime për pyllëzim promovon praktika të qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës, që ndikon në parandalim të erozionit.

Zonat në të cilat erozioni është me intensitet më të madh sipas Ligjit të ujërave duhen të shpallen "zona erozive". Në komunën e Obiliqit janë të evidentuara disa zona erozive të intensitetit të lartë të paraqitura në hartën e erozionit.. Për të parandaluar aktivitetin eroziv në këto zona duhen të ndërmerren veprime antierozive si hidroteknike, bujqësore, si dhe biologjike varësisht nga rasti. Shpesh këto masa duhet të kombinohen për të arritur rezultate më të mira antierozive.

Masat bujqësore:

- Mirëmbajtja e tokave bujqësore me mekanizma modern.
- Zhvillimi i një sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Masat biologjike:

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri;
- Mbjelljen e drunjëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi për të kufizuar erozionin në lumenjtë kryesor;
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara;
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.

Të gjitha veprimet dhe masat antierozive duhet ti nënshtrohen Udhëzimit Administrativ mbi Normat teknike të Planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli 2 paragrafi 2 dhe 1.2.1.).

Mbrojtja nga vërshimet. Vërshimet janë një ndër fenomenet të cilët më së shpeshti e atakojnë komunën, që ndodhin në përmasa të ndryshme varësisht nga të reshurat atmosferike. Duke marr parasysh katërvjeçarin e fundit, mund të konstatojmë se përkundër të reshurave të shumta, dëmet në territorin e komunës janë më të vogla. Marrë në tërësi, duke u bazuar në vlerësime të dëmeve pas ndodhjes së vërshimeve, këto trendë, janë në rënie, si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës përkatëse.

Në Obiliq janë identifikuar zonat me rrezikshmëri të lartë nga vërshimet, dhe koncepti parasheh masa mbrojtëse nga vërshimet:

- Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave duke ndërtuar argjinatura (rregullim i bankinave) në disa pjesë të Lumit Sitnica, Drenica, dhe Llapi
- Përcaktimi i brezave mbrojtës për lumenjtë, ku ndalohen ndërtimet sipas ligjit.

Masat për mbrojtje nga zjarri. Bazuar në Ligjin Për Mbrojtje nga Zjarri" komuna është përgjegjëse për hartimin e Planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal ne bazë të vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe praktikave të deritashme si dhe në pajtim me Planin shtetëror për mbrojtje nga zjarri. Komuna e Obiliqit nuk e ka të hartuar këtë plan që ka të përcaktuara përgjegjësitë për fatkeqësi përkatëse si dhe mjetet teknike për ballafaqim me fatkeqësitë në këtë rast njësinë e zjarrfikësve dhe automjetet.

Në Obiliq janë prezentë zjarret të shkaktuara kryesisht nga temperaturat e larta, nga largpërçuesit të vjetër elektrik zjarr vëniet dhe veprimtaritë e pakujdesshme njerëzore. Gjithashtu janë evidentuar Vatrat e zjarreve në pyje, siç janë pyjet në afërsi të vendbanimeve Kozdaricë, Breznicë, Obiliq dhe në disa vendbanime tjera. Në këtë aspekt duhet të ndërmerren masa për parandalimin e përhapjes së zjarreve eventuale.

Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale bazuar në Planin emergjent formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve. Në këtë kontekst masat që duhet ndërmarrë janë:

- Inspektimi për parandalim të zjarrvënëseve të qëllimshme në zonat pyjore dhe tokat bujqësore;
- Respektimi I kushteve të ndërtimit të përcaktuara me kornizën ligjore për mbrojtje nga zjarri;
- Sigurimi i elaborateve për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për të gjitha projektet e ndërtimit për të gjitha kategoritë konform ligjeve përkatëse.
- Planifikimi I tampon zonave në mes të zonave pyjore dhe të tjera të cilat janë të ndjeshme nga zjarri si dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar përçimin eventual të zjarrit.
- Vendosjen e hidrantët në vende të caktuara në qytet dhe vendbanime në komunë.
- Sigurim i qasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri të çdo njësi banimi në Komunë .

Masat për mbrojtje nga vërshimet. Në kuadër të veprimeve për mbrojtje të mjedisit dhe parandalimit të fatkeqësive natyrore komuna duhet të ndërmerr masa për mbrojtje nga vërshimet dhe atë:

- Mirëmbajtjen e shtretërve të rrjedhave ujore, përmirësimin e argjinaturave mbrojtëse.
- Pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe të kanalizimit atmosferik të cilat bëhen pengesë e rrjedhjes së ujërave në rastet e reshjeve më të mëdha.
- Hapjen dhe rregullimin e shtretërve të, Sitnicës, Drenicës dhe Llapi për të evituar vërshimet në rast të reshjeve të mëdha dhe shkrirjes së borës.
- Ndërtimin e pendave për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjtë nga malet.

Masat për mbrojtje nga stuhitë e erës. Komuna duhet t'i ketë të identifikuara lokacionet të cilat mund t'i nënshtrohen erërave të forta për të paraparë masa mbrojtëse kundër stuhive eventuale.

Këtë duhet pasur në konsiderate në procedurat e dhënies së kushteve të ndërtimit të etazhitetit të lartë si dhe objekteve të infrastrukturës teknike, të transportit dhe energjetike.

Mbrojtja nga tërmetet. Komuna e Obiliqit shtrihet në zonën me magnitudë maksimale 4.5deri në 6.0. Sipërfaqja e Obiliqit i është ekspozuar aktivitetit sizmik nga burime të ndryshme sizmike (lokale dhe telesizmike), prandaj potenciali i rrezikut sizmik është mjaft i shprehur. Në kuadër të vlerësimit janë identifikuar zona me rrezikshmëri sizmike të shkallës 4.5 Rihter dhe zona me rrezikshmëri sizmike të shkallës 6 Rihter, ku për secilën zonë do të ndermirën masa adekuate. Në tërë komunën e Obiliqit duhet aplikuar Eurokodin 8 në ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit për t'i përballuar intensitetit të dridhjeve dhe për minimizimin e pasojave në raste rreziku. Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+4, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, e sidomos urave.

Për të gjitha masat që ndërmerren duhet të vlerësohet ndikimit i tyre në mjedis, në mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit gjithnjë duke pasur parasysh udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli 1).

5.3.2.7. VENDBANIMET

Përherë të parë ligjërisht dhe profesionalisht gjatë hartimit të planit trajtohen të gjitha vendbanimet në komunë, duke u kushtuar rënësi të njëjtë si zonës urbane ashtu edhe vendbanimeve rurale. Gjatë analizave të mëhershme, janë shqyrtuar dhe vlerësuar gjendja ekzistuese dhe shtrirja hapësinore e të gjitha vendbanimeve dhe është bërë klasifikimi i vendbanimeve, dhe ky klasifikim është pjesë përmbajtjesore e PZHK-së dhe e konceptit. Është bërë klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë, sipas kërkesës së UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor (shih hartën).

Funksioni dhe madhësia. Intensitet më i madh i zhvillimit përveç Obiliqit dhe Plemetinit ndodh edhe në vendbanimet Mazgit i Ulët dhe Dardhishte, të cilat vazhdimisht kanë trende pozitive të zhvillimit. Këto së bashku krijojnë një zonë zonën urbane të integruar, pa fragmentime dhe pothuajse të ndërlidhur me vendbanimet përreth. Si qendra sekondare mbesin Hadja e Re dhe Millosheva.

Të gjitha vendbanimet në perëndim të Obiliqit në dimension funksional janë të lidhura direkt me zonën urbane/ qendër e rendit të lartë, ndërsa vendbanimet e tjera me dy qendrat tjera të rendit të mesëm. Koncepti parasheh që të zhvendosen tërësisht vendbanimet si Hade, Shipitullë, Lajthishtë (Leshkoshiq) dhe Sibovc si dhe rivendosja e tyre të bëhet në zonën urbane, përkatësisht në zonat ku preferojnë të zhvendosurit brenda dhe jashtë zonës urbane.

Koncepti parasheh që zhvillimet në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve të ngrihen dhe të mos zgjerohen më tutje. Në kuadër të zonës së zhvendosjes dhe të mihjeve do të lejohen vetëm shfrytëzime të përkohshme, sipas UA MMPH-NR 24/2015, neni 12, paragrafi 3.4. Këto shfrytëzime përcaktojnë funksione dhe aktivitete që janë të lejuara për një periudhe specifike kohore, para së cilës largohen plotësisht. Përcaktimi i jetëgjatësisë së zhvillimeve të përkohshme do të bëhet në bazë të një Plani të Hollësishëm Dinamik për Zhvendosje të Organizuar të Komunitetit, sipas kërkesës së Planit Hapësinor 2010-2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", 2011 Synimi 2, Objektiva 5. Ky plan do të ketë parasysh procesin e zhvillimit të minierave, dhe *"avancimi dhe kronologjia e zhvillimit të procesit të zhvendosjes së vendbanimeve nga fusha e re minerare, duhet të realizohet konform zhvillimit të procesit të zhvillimit minerar"*.[55]

Në të njëjtën kohë, për rregullim të çështjeve të pasurisë së paluajtshme dhe detyrimeve të shpronësimit , "në vendbanimet që duhet të zhvendosen, sipas avancimit të zhvillimeve bazuar në Planin Kryesor Minerar, autoritetet komunale marrin vendim mbi ndalimin e ndërtimeve të reja pas inventarizimit të pasurisë së paluajtshme."[56]


[55] Plani Hapësinor 2010-2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", MMPH, Instituti për planifikim hapësinor, 2011, fq 147, 5.3, pika 4.

[56] Plani Hapësinor 2010-2020+ për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", MMPH, Instituti për planifikim hapësinor, 2011, fq 146, 5.1.6, pika 4.

Sa i përket zhvillimeve në zonën bujqësore me komasacion dhe sistem të ujitjes, parashihen rregullimi dhe kufizimi i këtyre zonave në kuadër të kufijve aktual, por duke i zhvillimi me aktivitete përkatëse dhe duke ndaluar zgjerimin e mëtejmë të tyre.

Koncepti i zhvillimit hapësinor përveç konceptit policentrit vetembështet dhe konceptin e shpërndarjes hapësinore të funksioneve të vendbanimeve, nëpërmjet strukturimit të vendbanimeve në nivele të ndryshme hierarkike. Varësisht nga niveli i tyre hierarkik, vendet qendrore bartin lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve publike. Çdo vendbanim do të zhvillohet bazuar në potencialet për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofrojë.

Komuna e Obiliqit ka zhvillim kryesisht të shpërqendruar në gjithë territorin e saj, sidomos në vendbanimet përreth zonës urbane. Mungesa e kontrollit të zhvillimit, sidomos në zonat rurale, ka ndikuar që të ketë zhvillim të shpërqendruar. Koncepti adreson këtë çështje duke rekomanduar zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke filluar nga zona urbane e deri tek vendbanimet në zonën rurale. Në këtë kontekst rritja e popullsisë dhe investimet publike për të ofruar shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi janë elemente shumë me rëndësi. Të gjitha vendbanimet/ fshatrat tjera do të ofrojnë vetëm hapësirë për banim dhe bujqësi me intensitet të ulët.



Harta 69 Koncepti i zhvillimit hapësinor të vendbanimeve

Qyteti është qendra komunale e cila bart të gjithë barrën e zhvillimit të komunës me funksionet e saja përcjellëse, që vepron si bazë ekonomike, turistike, kulturore, edukative dhe shëndetësore dhe shërben tërë komunës dhe rajonin. Tërësia urbane e Obiliqit dhe Plemetinit dhe zona sub-urbane komplimentojnë njëra tjetrën dhe i dhurojnë pronat e tyre specifike hapësinore zhvillimit të vazhdueshëm. Fitimi dhe humbja e hapësirës duhet të balancohet në zhvillimin hapësinor të komunës. Prandaj krijohen qendrat e rendit të mesëm të cilat veprojnë si gjeneratorë shtytës për zonat rurale, të cilat ofrojnë edhe autonomi dhe kushte të krahasueshme jetese dhe pune.

Zona urbane si **qendër rendit të lartë** e përcaktuar në konceptin e zhvillimit hapësinor planifikohet të ofrojë këto funksione:

- Qendër administrative duke ofruar shërbime administrative për rajonin, qytetin, qendrat e rendit të mesëm, qendrat e rendit të ulët dhe gjithë fshatrat në territor të komunës së Obiliqit.
- Të siguroj infrastrukturë para universitare, trajnime profesionale dhe tërë-jetësore për meshkuj dhe femra.
- Të siguroj që qendra kryesore e mjekësisë familjare të ofrojë shërbimet më të larta mjekësore në komunë.

- Shfrytëzime komerciale (p.sh. veshmbathje, pajisje mekanike, elektroteknikë) që kënaqin "kërkesat periodike" duhet të koncentrohen në qytetin e Obiliqit
- Shfrytëzimet e reja industriale duhet të vendosen në zonat ekonomike të qytetit të Obiliqit
- Planifikohet zgjerimi urban i blloqeve banimore dhe intensifikimi i densitetit banimor në qytet.
- Mbushja dhe zgjerimi urban i qytetit të Obiliqit dhe Plemetinit do të bëjë që vendbanimet Mazgit I Ulët dhe Dardhishte të bëhen qendra sub- urbane.
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike në një nivel më të lartë.
- Përmirësimi i transportit publik drejt qyteteve tjera dhe drejt nën- qendrave.

Qendrat e rendit të mesëm do të ofrojnë shërbime bazë për vendbanimet përreth duke mundësuar mbulim të përgjithshëm të komunës dhe rrjedhimisht të ofrojnë zhvillim të balancuar. Të gjitha vendbanimet tjera do të ofrojnë vetëm hapësirë për banim dhe bujqësi me intensitet të ulët. Duke marrë parasysh parashikimet për rritje të popullsisë, vendbanimet në vijim do të zhvillohen sipas këtyre funksioneve si qendra sekondare do të zhvillohen Hadja e Re dhe Millosheva.

Zgjedhja e vendbanimeve që të veprojnë si qendra sekondare është bazuar në strukturën, funksionin, densitetin dhe morfologjinë urbane ekzistuese të vendbanimeve dhe në parakushtet për zhvillim të mundshëm në të ardhmen. Indikatorët për përzgjedhjen e nën- qendrave janë popullata dhe numri i shtëpive, si dhe një infrastrukturë e mirë shoqërore dhe teknike. Qendrat e rendit të mesëm janë të pajisura me shkolla kryesore, qendra të mjekësisë familjare, kanë qasje të mirë rrugore dhe të cilat tanimë janë nën- qendra ekonomike ose kanë një numër më të lartë të biznese ekzistuese. Një tjetër aspekt i rëndësishëm për përzgjedhjen e qendrave të rendit të mesëm, bazuar në parimin e balancimit hapësinor (gjithëpërfshirës në hapësirë dhe ofrim të shërbimeve tërësore publike në distancë të arsyeshme), është vendndodhja e tyre në territorin e Obiliqit.

Funksionet e qendrave të rendit të mesëm:

- Të ofrojnë infrastrukture të institucioneve të arsimit para-universitar (shkolla të mesme të ulëta dhe të mesme të larta);
- Të ofrojnë infrastrukturë shëndetësore të nivelit dytësor- qendra të mjekësisë familjare, duke siguruar shërbime bazike mjekësore dhe disa specialistë;
- Dyqanet ofrojnë të mira të nevojshme (gjëra ushqimore, gazeta) të cilat kënaqin "kërkesat ditore"
- Ndërmarrjet vendosen në zonat e reja komerciale dhe industriale në qendra sekondare
- Planifikim për zgjerim të balancuar me intensitet të ulët e të mesëm, posaçërisht për shfrytëzime të banimit
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike dhe publike& sociale dhe qasjes në shërbime publike
- Lidhje të mira me rrjetin e rrugëve kryesore
- Sigurim të transport urbano- ruralo publik drejt qytetit të Obiliqit.

Qendrat e rendit të ulët janë vendbanime/ fshatra që ofrojnë kushte të mira të jetesës, të furnizuara nga qendra e rendit të lartë dhe qendrat e rendit të mesëm. Fshatrat do të zhvillohen në një mënyrë origjinale, të ruajnë karakterin e tyre tradicional gjersa të adaptohen me nevojat e jetës së sotme. Për sa i përket infrastrukturës sociale dhe zhvillimit ekonomik ato përfitojnë nga ndërlidhja e afërt me qendrat e rendit të mesëm dhe lidhjen me qytetin e Obiliqit si qendër e rendit të lartë.

Funksionet e qendrave të rendit të ulët janë:

- Të ofrojnë infrastrukture të institucioneve të arsimit para-universitar (shkolla fillore).
- Të ofrojnë shërbime themelore mjekësore (ambulanca të mjekësisë familjare) duke siguruar shërbime bazike mjekësore në fshat ose në fshatrat e afërt.
- Promovim dhe mbështetje të zhvillimit me intensitet të ulët ekonomik, kryesisht zhvillim bujqësor.
- Përmirësim të infrastrukturës teknike dhe qasjes në shërbime publike, zbatim me prioritet të mesëm.
- Planifikim për zgjerim të kontrolluar me intensitet të ulët, posaçërisht për shfrytëzime të banimit.

Fshatrat shumë të vogla, qëllimi është në përkrahjen e njerëzve, jo vendit.

Disa fshatra në komunën e Obiliqit karakterizohen me një numër të vogël të banorëve dhe një numër të vogël të shtëpive me tendenca të zvogëlimit dhe numër të vogël të nxënësve dhe bizneseve të vogla. Komuna duhet të garantojë kushte të mira të jetesës për banorët e fshatrave të largëta duke ofruar shërbime publike sa më larg që është e mundur në vetë fshatrat ose, nëse është e nevojshme, duke aranzhuar transport të sigurt deri te infrastruktura e shërbimeve publike në fshatrat tjera.

Funksionet e fshatrave të largëta:

- Të ofrojnë infrastrukture të institucioneve të arsimit para-universitar (shkolla të fillore) në fshat ose në fshatrat e afërt (duke përfshirë edhe sigurimin e transportit).
- Ofrimi i shërbimeve themelore mjekësore (ambulanca të mjekësisë familjare) në fshatrat e afërta ose me ambulanca lëvizëse.
- Promovim dhe mbështetje të zhvillimit me intensitet të ulët ekonomik, kryesisht zhvillim bujqësor dhe i turizmit rekreativ.

- Përmirësimi i infrastrukturës themelore teknike dhe e transportit, zbatim me prioritet më të ulët .
- Planifikim për zgjerime të rralla për shfrytëzime të banimit apo tjera.

Zhvillimi i vendbanimeve:

	Sipërfaqja (ha)		Sipërfaqja shtesë		Nr. banorëve 2029	Dendësia e banorëve	Intensiteti
	planifikuar	ekzistuese	(ha)	(%)	I prognozuar	(b/ha)	
Baimofc	164.94	73.14	91.80	56%	321	1.95	I ultë
Bakshi	53.72	28.39	25.33	47%	661	12.31	I ultë
Breznicë	117.69	82.13	35.55	30%	1,254	10.66	I ultë
Bërnicë Poshtme	92.35	66.09	26.25	28%	659	7.14	I ultë
Carravodicë	296.47	296.47	0.00	0%	0	0.00	I ultë
Dobrosellë	231.65	231.65	0.00	0%	319	1.38	I mesëm
Grabofci Epërm	52.34	27.38	24.96	48%	383	7.32	I ultë
Hade	22.38	301.76	-279.38	-1248%	140	6.26	I ultë
Hamidi	11.84	9.03	2.81	24%	650	54.89	I lartë
Kryshefc	469.29	469.29	0.00	0%	609	1.30	I ultë
Leshkoshiq	82.67	82.67	0.00	0%	766	7.86	I ultë
Mazgit	189.17	146.40	42.76	23%	3,387	17.90	I ultë
Milloshevë	238.96	146.46	92.49	39%	2123	8.88	I ultë
Obiliq	701.64	522.32	179.32	26%	5,171	7.37	I ultë
Plemetin	244.91	172.33	72.58	30%	1,368	5.59	I ultë
Raskovë	48.16	30.59	17.57	36%	701	14.55	I ultë
Shipitullë	26.55	63.68	-37.13	-140%	835	31.45	I mesëm
Sibovc	50.89	50.89	0.00	0%	232	3.19	I ultë

Tabela 191. Sipërfaqet e tokës ndërtimore, të planifikuar dhe ekzistuese dhe intensiteti i planifikuar

Në Tabelën më lartë janë dhënë toka ndërtimore e planifikuar, banorë të planifikuar dhe dendësi (dendësia banimore është bruto, ku gjatë Hartës Zonale të Komunës definohet dendësia banimore neto, duke kalkuluar infrastrukturën publike dhe sociale, rrugët publike) sipas vendbanimeve në komunën e Obiliqit.

Ndërtimet pa Leje

Ndërtimet pa leje të identifikuar me Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje, janë vlerësuar të gjitha në mënyrë që përfshirja e ndërtimeve të legalizuara në dokumentet e planifikimit hapësinor të jetë në harmoni me Ligjin për Ndërtime pa Leje[57]. Nga hyrja në fuqi e Ligjit dhe udhëzimeve administrative për Trajtim të Ndërtimeve pa Leje, Komuna e Obiliqit vepron konform kësaj baze ligjore drejt legalizimit të ndërtimeve pa leje.

5.3.2.8. BANIMI

Duke e kuptuar rëndësinë e banimit, kësaj fushe i është kushtuar një rëndësi e veçantë brenda PZHK-së dhe konceptit kryesor, si dhe është shqyrtuar dhe vlerësuar gjendja ekzistuese e banimit dhe modeleve të banimit në komunë dhe nevojat në të ardhmen.

PZhK duhet të plotësoj të gjitha nevojat për banim, andaj numri i njësive të banimit të nevojshme për të ardhmen është planifikuar sipas rritjes së parashikuar demografike, strukturës së popullsisë por dhe kërkesave të tregut. Gjithashtu, pas analizës së kushteve të banimit, përfshirë rekomandimet për zhvillimin e banimit planifikohet përmirësimi i kushteve të banimit duke ofruar qasje në infrastrukturë adekuate, hapësira adekuate si dhe standard dhe efiçiencë energjetike.

Zona urbane e qytetit të Obiliqit karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 548 banorë në një km². Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane, ku shtrihen kryesisht njësi të banimit. Sa përket numrit të strukturave të ndërtuara, në nivel komune numri më i madh i ndërtesave i përkasin shtëpive të banimit më 88.56% ,pasuar me banim me shumë njësi 11.44%. Viteve të fundit, për shkak të presionit për zhvillim ka kërkesë më të madhe për objekte të banimit me shumë njësi.

[57] Paragrafi 3, Neni 4 I Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje

Pas një analizë të ndërtesave të banim të zbrazëta, përfshirë dhe mundësitë për ri-përdorimin e tyre, janë identifikuar ndërtesat që potencialisht mund të ri-përdoren si dhe është konstatuar se shumica e banesave të cilat konsiderohen të zbrazëta në komunën e Obiliqit, nga regjistrimi i vitit 2011, në fakt janë pronë dhe shfrytëzohet nga banorët që konsiderohen jo rezident.

Po ashtu, konstatohet se ka pas një trend më të lartë të ndërtimit të ndërtesave për banim viteve të fundit i cili planifikohet të vazhdoj edhe për sa kohë do ketë kërkesa dhe çmime mesatare të ndërtesave për banim. Duke marrë parasysh rritjen natyrore të popullsisë si dhe kërkesat e tregut, zona urbane do të vazhdojë të jetë në presion për njësi të reja banimi, në tipologji banim me shumë njësi, sidomos në pjesën qendrore të qytetit, andaj edhe ky koncept promovon dendësim dhe plotësim. Sa i përket tipologjisë së banimit, koncepti promovon katër tipet kryesore të banimit në Komunë. Tipologjia banimore mund të përshkruhet si:

- Tipi i banimit me dendësi të lartë banimi zhvillohet vetëm në zonën urbane, ku pretendohet banimi i qëndrueshëm duke alokuar tokë të mjaftueshme për hapësira të lira, rekreative dhe nevojave të tjera përcjellëse të banimit.
- Tipi i dytë i banimit me dendësi të mesme banimi do të zhvillohet në pjesët jo qendrore të zonës urbane dhe në vendbanimet e mëdha.
- Tipi i tretë i banimit është banimi që do të zhvillohet në zonat rurale të identifikuara si zona me jokonformitet ku dendësia e banimit mund të zhvillohen sipas rrethanave, por që mund të lejohet dendësi më e lartë dhe përzierje me aktivitete tjera përcjellëse.
- Kurse tipi i katërt paraqet banimin rural që parashihet të zhvillohet në vendbanime me karakter jo urban dhe i cili është më fleksibil dhe në varësi të kushteve dhe rrethanave e nevojave mund të zhvillohet sipas nevojës.

Duke ofruar njësi të reja banimi sipas kërkesës komuna siguron që është duke e kontrolluar dhe udhëzuar zhvillimin në hapësirë dhe kohë. Kjo nënkupton që komuna do të vendosë në faza për rritje të mëtutjeshme të fondit të banimit duke u bazuar në rritje natyrore, kërkesat, dhe zonat për rritje dhe plotësim.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë së tij natyrore. Zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve. Ngritjen e kushteve për banim të shëndetshme dhe atraktive në zonat urbane dhe zonat rurale. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga tërmetet, vërshimet, erozionet etj. dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit.

Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat për Efiçencë të Energjisë sipas kërkesave nga është rregullorja për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MMPH Nr. 04/18). Të gjitha këto veprime do të mundësojnë që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit në komunë, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit.

Banimi social

Edhe pse shumë bazike dhe e qartë si parim, zgjidhja e vetme për mungesë të banimit është banimi I përballueshëm. Mirëpo, përpilimi I politikave të mirëfillta për banim e sidomos atij me çmim të përballueshëm dhe banimit për familje me asistencë sociale është një nga problemet kryesore të planifikimit në Kosovë, po edhe më gjerë.

Komuna duket të ofroj banim për të gjitha kategoritë. Në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për rastet sociale, është planifikuar sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ndërtimi i objekteve për strehim të këtyre familjeve. Kjo do të arrihet duke siguruar që çdo 5 – 10% nga numri i përgjithshëm i njësive të reja të banimit për vit të jenë me çmim të përballueshëm. Ky veprim do të mundësojë që familjet e reja të kenë qasje në njësi banimi me çmim të përballueshëm, duke adresuar kërkesat për banim në mënyrë të kontrolluar. Këtij veprimi do t'i paraprijë hartimi i një strategjie lokale për banim të përballueshëm dhe për banim social si dhe rregullore komunale. Rregullorja komunale do të përcaktojë kriteret që duhet të përmbushen nga çdo investitor për të arrit kuotën e caktuar vjetore për njësi banimi me çmim të përballueshëm dhe atë social.

Komuna e Obiliqit planifikon të ndërtoj 2 ndërtesa me nga 50 banesa, me të cilat do të arrij të zbut numrin e madh të familjeve të pa strehë. Një formë tjetër me të cilën komuna e Obiliqit planifikon të ndihmojë familjet në nevojë për banim social është përmes banesave ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit.

5.3.2.9. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Duke e kuptuar rëndësinë e madhe të Shfrytëzimit të tokës, kësaj fushe I është kushtuar një rëndësi e veçantë Brenda PZHK-së dhe konceptit kryesor, dhe është shqyrtuar dhe vlerësuar gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës si dhe modele të shfrytëzimit të tokës Brenda territorit të komunës dhe gjithashtu janë vlerësuar projeksionet për shfrytëzimin e tokës në PZHK-të e mëparshme dhe deri në çfarë mase këto projeksionet janë realizuar.

Sa i përket shfrytëzimit të tokës, me 11.14% ka tokë pyjore, gjersa me 61.70%, toka bujqësore.

Harta e shfrytëzimit të tokës përcakton llojin e shfrytëzimit të tokës bazuar në vizion, qëllime dhe objektiva.

Shfrytëzimi I planifikuar I tokës në mënyrë direkte rrjedh nga koncepti I zhvillimit.

Sa I përket shfrytëzimit të tokës propozohet një shfrytëzim racional I tokës me qëllim që të ofroj një organizim të qëndrueshëm të vendbanimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në pjesët rurale dhe urbane.

Parimi I përgjithshëm përveç rrjetit hierarkik të vendbanimeve, gjithashtu merret me menaxhimin e shfrytëzimit të tokës duke u kujdesur për faktorët e mjedisit.

Mbrojtja e mjedisit në nivele të caktuara që kanë të bëjnë me pasuritë natyrore siguron zhvillim të vazhdueshëm dhe efikas.

Në shfrytëzimin e tokës planifikohet sigurimi i sipërfaqeve për projektet të nivelit nacional dhe atyre rajonal.

Shfrytëzimi i tokës- Bujqësi është hapësirë e cila do të zhvillohet vetëm për bujqësi dhe infrastrukture përcjellëse në dobitë zhvillimit të bujqësisë, pra shfrytëzime të lejuara në kuadër të zhvillimit të bujqësisë janë: Kultivimi I drithërave (përveç orizit), I bimëve bishtajore dhe I farërave vajore, Kultivimi I perimeve, Pjepra dhe Shalqinj, Bimë rrënjore, Tuberoze, Kultivimi I hardhive, Kultivimi në serë, Kultivimi I frutave me bërthamë dhe frutave me farë, Kultivimi I frutave të tjera pemore, Arra dhe Lajthi, Shumimi I bimëve, Kultivimi I bimëve të tjera një vjeçare, Kultivimi I bimëve të tjera shumë vjeçare, Bletaria, si dhe shfrytëzimet ndihmëse për zhvillimin e bujqësisë Infrastruktura bujqësore, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesat për ruajtje dhe konservim të mishit.

Zona urbane është zonë e cila në mënyrë të vazhdueshme është në presion të zhvillimit dhe si e tillë do të akomodojë zhvillim kompakt dhe të balancuar. Kjo do të arrihet nëpër mes zonave për ri-zhvillim, plotësim dhe dendësim. Shfrytëzimet e tokës në vijim janë të lejuara në këtë zonë: banim; shfrytëzim i përzier; shërbim publik; shërbim tregtar; shërbim profesional financiar dhe I informacionit; shërbim I komunitetit; shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ; bujqësi urbane; industri e lëndës së parë, industri e prodhimeve të rënda dhe të lehta. Parimisht, zona urbane do të përmbajë të gjitha shfrytëzimet e tokës të nevojshme për të udhëheqë zhvillimin bazuar në vizionin e planit.




Figura 3 Përqindjet e shfrytëzimit të planifikuar të tokës

Zona rurale do të trajtohet me kujdes të veçantë ngaqë zhvillimet e tokave bujqësore janë të shtrira në zonën rurale, do të përcaktohen kufijtë ndërtimorë sipas dendësisë së popullsisë së planifikuar për tetë vitet e ardhshme, në mënyrë që të ruajmë tokën bujqësore dhe të kemi një zhvillim më kompakt në këto zona.

Në vendbanimet të cilët janë të shtrira në formë lineare, përgjatë rrugore dhe vendbanimet e shpërndara do të tentohet përcaktimi i kufijve ndërtimorë në atë mënyrë që këto vendbanime të kenë një zhvillim në formë kompakte.

Në zonën rurale do ti jepet prioritet zhvillimeve bujqësore, ku në komunën e Obiliqit kemi disa fshatra që kanë kapacitete të mira agrare si dhe turistike në të njëjtën kohë për shkak konfiguracionit të terrenit të tyre.

5.4. PRIORITETET E ZHVILLIMIT STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT

Në bazë të përcaktimeve sa i përket qëllimeve, objektivave, koncepteve hapësinore nëpërmjet elementeve hapësinore dhe projekteve konkretet, të gjitha në shërbim të zbatimit të kornizës së zhvillimit hapësinor, Komuna e Obiliqit ka përcaktuar disa prioritetet strategjike. Prioritetet strategjike, të shtjelluara në veprime konkrete, në kosto financiare dhe në kohëzgjatje, strukturojnë Planin e Veprimit. Mbi Planin e Veprimit, Komuna ka strukturuar Planin e Monitorimit.

Prioritetet e zhvillimit hapësinor për komunën e Obiliqit, të ndara sipas tematikave zhvillimore janë:

Prioritetet strategjike për zhvillimin ekonomik:

- Sigurimi i infrastrukturës për veprimtaritë e industrisë prodhuese dhe përpunuese si dhe veprimtarive komerciale.
- Valorizimi ekonomik i resurseve natyrore dhe kulturore për zhvillim të turizmit.
- Modernizimi, rritja e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore
- Përkrahja e sinergjive me forma tjera te aktiviteteve afariste.

Prioritetet strategjike për infrastrukturë teknike

- Menaxhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm i ujësjellësit
- Menaxhimi dhe qasje e qëndrueshme në infrastrukturë të ujërave të zeza
- Furnizimi stabil dhe i qëndrueshëm me energji elektrike
- Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes kolektive përmes sistemit të ko- gjenerimit
- Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave dhe infrastrukturës përkatëse

Prioritetet strategjike për infrastrukturë të transportit

- Ndërtimi i rrugëve në lagjen Hade e Re.
- Mirëmbajtja e rrugëve në zonën urbane dhe rurale.

Prioritetet strategjike për arsim

- Ndërtimi i shkollave fillore të mesme të ulëta në Obiliq dhe Baimofc
- Ndërtimi i institucioneve parashkollore në Mazgit, Milloshevë, Hade e Re, Lajthishtë dhe Krushefc
- Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU ”Naim Frashëri“ në Breznicë, SHFMU” Migjeni“ në Sibovc, SHFMU ”Abdurrahmon Gërguri“ në Kryshefc.

Prioritetet strategjike për shëndetësi

- Mbulueshmëria e të gjitha vendbanimeve me mbi 2,000 banorë me institucione të kujdesit parësor shëndetësor.
- Ofrimi efiçient të shërbimeve komunale shëndetësore.
- Ndërtimi i Qendrës së re Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Obiliqit.

Prioritetet strategjike për mirëqenie sociale dhe komunitet

- Krijimi i banimit social për të gjithë banorët të pastrehuar të Komunës.
- Ndërtimi i banimit kolektiv me 50 njësi për rastet sociale dhe i 50 shtëpive për rastet sociale ne komunën e Obiliqit.

Prioritetet strategjike për hapësirat kulturore

- Krijimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.
- Ndërtimi i Bibliotekës Komunale.

Prioritetet strategjike për hapësira sportive dhe të gjelbra

- Revitalizimi i stadiumit të qytetit Agron Rama dhe krijimi i brezave të gjelbër.
- Rregullimi i fushave sportive në shkolla në Raskovë, Kozaricë, Sibovc, Plemetin dhe Palaj.

Prioritetet strategjike për hapësira të hapura publike

- Ndërtimi i sheshit të qytetit dhe ndërtimi i parqeve të reja.

Prioritetet strategjike për varreza

- Sigurimi i sipërfaqeve të mjaftueshme për varreza në të gjitha vendbanimet.

Prioritetet strategjike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

- Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore.
- Përcaktimi i kufijve të sipërfaqes së mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe kushteve zhvillimore.
- Promovimi i trashëgimisë kulturore si dhe aftësimi, ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë. kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit.
- Masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore.

Prioritetet strategjike për vendbanimet

- Kompaktësimin e qëndrueshëm i zonës urbane.
- Zhvillimin e ekuilibruar i vendbanimeve rurale.
- Krijimin e hapësirave të mirëfillta për banim, me të gjitha elementet e nevojshme përcjellëse.
- Krijimin e hapësirave të gjelbra dhe rekreative në funksion të të gjitha vendbanimeve.

Prioritetet strategjike për ofrimin e qasjes së barabartë në shërbime për të gjithë banorët e komunës

- Nxitja e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Prioritetet strategjike për banim

- Rritjen e fondit banesor në zonën urbane dhe zonën rurale.
- Sigurimin e banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës.

5.5. PLANI I VEPRIMIT

5.5.1. Prioritetet strategjike për zhvillimin ekonomik

5.5.1.1. Sigurimi i infrastrukturës për veprimtaritë e industrisë prodhuese dhe përpunuese si dhe veprimtarive komerciale.

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Hartimi i projektit kryesor për zhvillim të infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për Zonën Industriale në Llazarevë	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€15,000	DEFZH DPUKP MMPHI Komuna
2	Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për Zonën Industriale në Llazarevë	I lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€1,500,000	DEFZH MMPHI Komuna
3	Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse (rrugë dytësore, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për integrimin e korridorit ekonomik përgjatë rrugës N2 në harmoni me Planin Rregullues të Hollësishëm për korridorin N2	I lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2025	€1,200,000	DEFZH MMPHI MF Komuna
4	Hartimi i projektit kryesor për zhvillim të infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për zonën Industriale-Komerciale përgjatë rrugës Obiliq-Carravodicë (Palaj)	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€20,000	DEFZH DPUKP MMPHI Komuna
5	Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për zonën Industriale-Komerciale përgjatë rrugës Obiliq-Carravodicë (Palaj)	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€1,200,000	DEFZH MMPHI Komuna
6	Hartimi i projektit kryesor për zhvillim të infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për zonën komerciale përgjatë rrugës Obiliq-Prishtinë në harmoni me Planin Rregullues të Hollësishëm për zonën komerciale Obiliq-Prishtinë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€15,000.00	DEFZH DPUKP MMPHI BERZH Komuna

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
7	Zhvillimi i projektit kryesor për zhvillim të infrastrukturës përcjellëse (rrugë qaseshe në zonë, qasje në rrymë elektrike, ujë industrial, trajtim të ujërave industrial dhe të mbeturinave) për zonën komerciale përgjatë rrugës Obiliq-Prishtinë në harmoni me Planin Rregullues të Hollësishëm për zonën komerciale Obiliq-Prishtinë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2026	€300,000.00	DEFZH MTI KOMUNITETI I BIZNESIT KOMUNA
8	Ofrimi i infrastrukturës hekurudhore dhe funksionimi përcjellës për terminalin e ri në Obiliq	I lartë	Afatgjatë	I lartë	2023-2025	€5,000,000	MTI, MMPHI, INFRAKOS, KOMUNA BE
9	Ri-zhvillimi i pjesëve/ hapësirave jashtë funksionit të termocentralit Kosova A	I lartë	Afatgjatë	I lartë	2023-2028	€35,000,000.00	KE MAA MTI KOMUNA
10	Ndërtimi i Termoelektranës Kosova e Re	I lartë	Afatgjatë	I lartë	2023-2028	€1,000,000,000	KE MAA MTI KOMUNA

5.5.1.2. Valorizimi ekonomik i resurseve natyrore dhe kulturore për zhvillim të turizmit.

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Hartimi i një Strategjie të zhvillimit të turizmit në Obiliq	I ulët	Afatmesëm	I ulët	2023-2024	€20,000	DEFZH DPUKP MMPHI Komuna
2	Hartimi i Studimit të fizibilitetit për arsyeshmërinë ekonomike, financiare dhe mjedisore të Projektit Revitalizimi i liqenit/ hapësirës përreth të mihjeve në hapësirë për rekreacion	I lartë	Afatgjatë	I Ulët	2023-2024	€50,000	MAA KEK KOMUNA DONACIONET
3	Zhvillimi i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm dhe sinjalizim në Grabofc të Epërm, Shipitullë, Breznicë dhe Kozaricë	I mesëm	Afatgjatë	I lartë	2023-2026	€70,000	KOMUNA MKRS DONACIONET
5	Përcaktimi i zonave të përshtatshme dhe sinjalizimi për zhvillim të gjuetisë dhe peshkatarisë në vend-gjuetinë Qyqavica në harmoni me Strategjinë për zhvillim të turizmit në Obiliq	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	NA	KOMUNA DONACIONET MMPHI SHOQATAT
6	Popullimi me shtazë të egra i në vend-gjuetisë Qyqavica në harmoni me Strategjinë për zhvillim të turizmit në Obiliq	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	2023-2025	€5,000	DBP Komuna
7	Hartimi, zhvillimin dhe zbatimi i pakove turistike për Tyrben dhe Gazimestanin që	I ulët	Afatgjatë	I ulët	2023-2026	NA	KOMUNA MKRS

	dalin nga Strategjia e zhvillimit të turizmit në Obiliq						SHOQATAT
8	Zhvillimi i Obeliskut të Skënderbeut në Llazarevë dhe Përmendoren për gruan	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€200,000	DKRS KOMUNA MKRS
9	Zhvillimi i Përmendores për gruan në Obiliq	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€100,000	DKRS KOMUNA MKRS
10	Vazhdimi I hulumtimeve arkeologjike në disa lokacione në Obiliq	I mesëm	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€1,150,000	DKRS KOMUNA MKRS MMPHI
11	Hartimi i Projektit kryesor për ndërtim të Muzeut Etnologjik në Obiliq	I mesëm	Afatmesëm	I lartë	2024-2025	€30,000	DKRS KOMUNA MKRS MMPHI
12	Ndërtimi i Muzeut Etnologjik në Obiliq	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2025-2027	€320,000	DKRS KOMUNA MKRS MMPHI
13	Hartimi i projektit kryesor për zonën rekreativo- sportive në hapësirën e ish-deponisë së TC- A.	I lartë	Afatgjatë	I mesëm	2023-2024	€20,000	MMPHI MTI KOMUNA KEK-U BB
14	Zhvillimi i zonës rekreativo- sportive në hapësirën e ish- deponisë së TC- A.	I lartë	Afatgjatë	I mesëm	2023-2028	€35,000,000	Banka Botërore MMPHI MTI KOMUNA KEK-U

5.5.1.3. Modernizimi, rritja e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zhvillimi i projektit "Zgjerim i tokave bujqësore nën komasacion bujqësor"- për organizim të prodhimtarisë intensive.	I lartë	Afatgjatë	I Lartë	I lartë	€3,000,000	Qeveria dhe Donatorë
2	Zhvillimi i projektit "Revitalizimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ujitjes të Ibër Lepencit"	I lartë	Afatgjatë	I Lartë	2023-2028	€500,000	DBZHR Qeveria dhe Donatorë
3	Furnizimi i 400 fermerëve me mekanizëm përcjellës në bujqësi	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€120,000	DBP Komuna
4	Furnizimi i 200 prodhuesve të perimeve me sera të zinkuara nga 50-100m2	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€100,000	DBP Komuna
5	Subvencionimi i qumështit dhe furnizimi i 20 fermave të qumështit me tanke ftohës	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2028	€100,000	DBP Komuna
6	Përkrahja e fermerëve me krerë të gjedheve deleve dhe dhive me potencial të lartë të prodhimit të	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2028	€288,000	DBZHR Komuna Donatorë

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
	qumështit						
7	Përkrahja e fermerëve me mekanizëm (makina mjelëse, bidonë të qumështit dhe laktofriz)	I mesëm	Afatmesëm	I Ulët	2023-2028	€140,000	DBZHR Komuna Donatorë
8	Furnizimi i 60 fermave të lopëve qumështore me makina mjelëse	I mesëm	Afatmesëm	I Ulët	2023-2025	€15,000	DBP Komuna
9	Zhvillimi i 20 ha me arrë (sigurimi i fidanëve).	I mesëm	Afatmesëm	I Ulët	2023-2025	€25,000	DBP Komuna
10	Zhvillimi i 10 ha me pemë të imëta (sigurimi i fidanëve).	I mesëm	Afatmesëm	I Ulët	2023-2025	€40,000	DBP Komuna
11	Furnizim i 60 bletareve me bletë, ushqim (pogaçe) dhe pajisje për zhvillim të bletëve	I mesëm	Afatmesëm	I Ulët	2023-2025	€80,000	DBP Komuna
12	Përkrahja e fermerëve me serra 200 - 500 m^2	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€280,000	DBZHR
13	Furnizimi i bletareve me shoqëri bletësh, dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e bletarisë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€196,000	DBZHR MBPZHR
14	Ripyllëzimin e pyjeve në zonat e dëmtuara, të cilat janë definuar me PZHK	I Ulët	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€100,000	DBZHR DM
15	Investimet në infrastrukturën bujqësore (rrugë bujqësore, kanale drenazhimi) në të mirë të mbrojtjes së tokës bujqësore	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€300,000	DBZHR DSHPI
16	Pyllëzimi i përafërsisht 5 ha sipërfaqe djerrina të KEK-ut	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€100,000	DBZHR DM

5.5.1.4. Përkrahja e sinergjive me forma tjera te aktiviteteve afariste

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Pastrimi i pyjeve dhe përdorimi i mbetjeve për përpunimin e peletit dhe briketit	I mesëm	Afatgjatë	I ulët	2023-2028	€100,000	Komuna-DBP APK, Enti për Punësim
2	Hartimi i Studimit të fizibilitetit të performancës gjeneruese dhe ekonomike të mullinjve të erës në Obiliq.	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€30,000	DEFZH DPUKP MMPHI MTI

5.5.2. Prioritetet strategjike për infrastrukturë teknike

5.5.2.1. Menaxhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm i ujësjellësit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Grabofc i Epërm.	I Lartë	Afatshkurtër	I vogël	2023-2024	€150.000	DSHP KRUP
2	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€120.000	DSHP

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
	Shipitullë.						KRUP
3	Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Baimofc	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€120.000	DSHP KRUP
4	Riparimi i rrjetit të ujësjellësit në disa lagje në qytetit e Obiliqit	I Lartë	Afatmesëm	I Lartë	2023-2025	€200.000	DSHP KRUP
5	Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina".	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€120.000	DSHP KRUP

5.5.2.2. Menaxhimi dhe qasje e qëndrueshme në infrastrukturë të ujërave të zeza

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza Prishtinë, Obiliq dhe Fushë Kosovë.	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€66.000.000	DSHP, Komunat e Prishtinës dhe Fushe Kosovës, Qeveria franceze
2	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Grabofc i Epërm;	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€150.000	DSHP
3	Riparimi i rrjetit të kanalizimit disa lagje të qytetit e Obiliqit;	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€200.000	DSHP
4	Revitalizimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Baimofc, Milloshevë dhe Llazarevë.	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€350.000	DSHP
5	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në disa lagje në fshatrat Breznicë dhe Kozaricë;	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€50.000	DDSHP

5.5.2.3. Furnizimi stabil dhe i qëndrueshëm me energji elektrike

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zëvendësimin e transformatorëve nga 10/0.4kV në 20(10)/0.4kV	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€400,000	DSHP KEDS
2	Ndërtimin e blloqeve të TM në nivel 20(10)/0.4kV;	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€200,000	DSHP KEDS
3	Zëvendësimin i linjave ajrore nga 10 kV të vjetërsuara dhe të mbingarkuara në 20kV	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€400,000	DSHP KEDS
4	Zëvendësimin i shtyllave të drurit me shtylla betoni me pajisje tjera përcjellëse;	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€700,000	DSHP KEDS
5	Zëvendësimin i kabllove nëntokësore të vjetërsuara të 10kV me ato 20kV	I Mesëm	Afatmesëm	I Lartë	2023-2024	€500,000	DSHP KEDS
6	Ndërtimi i NS 10(20)/0.4kV në rrjetet e ngarkuara të tensionit të ulët	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€300,000	DSHP KEDS
7	Ndërtimi i NS 35/10kV në 110/10(20)kV. në Mazgit	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2023-2024	€950,000	DSHP KOSTT
8	Hartimi i Studimit të Fizibilitetit për Arsyeshmërinë ekonomike, financiare dhe mjedisore të Projektit Gjenerimi i	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€50,000	DSHP Ministritë Donatorë

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
	energjisë elektrike nga era në rajonin e Breznicë- Kozaricë.						Komuna

5.5.2.4. Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes kolektive përmes sistemit të ko- gjenerimit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i Stacionit për Pranimin e Energjisë HES (Heat Extraction Station) në lokacionin sipas Studimit të Fizibilitetit	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2023-2024	€3,500,000	DSHP/ Komuna Ministritë Donatorë
2	Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 1 sipas Studimit të Fizibilitetit	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2023- 2025	€582,818	DSHP/ Komuna Ministritë Donatorë
3	Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 2 sipas Studimit të Fizibilitetit	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2024- 2025	€427,544	DSHP/ Komuna Ministritë Donatorë
4	Shtrirja e rrjetit primar dhe sekondar si dhe kyçja e ekonomive shtëpiake në zonën 3 sipas Studimit të Fizibilitetit	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2024- 2025	€404,326	DSHP/ Komuna Ministritë Donatorë

5.5.2.5. Ofrimi i shërbimeve moderne të telekomunikimit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zgjerimi i rrjetit të instalimeve kabllore nëntokësore në zonën urbane	I Lartë	Afatshkurtër	I Mesëm	NA	NA	Kompanitë Komuna
2	Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit (TEL+DATA+VIDEO) dhe 4G, LTE dhe 5G.	I Lartë	Afatshkurtër	I Mesëm	NA	NA	Kompanitë Komuna
3	Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore dhe shtrirje e rrjetit të ri GPON.	I mesëm	Afatmesëm	I Mesëm	NA	NA	Kompanitë Komuna
4	Ndërtimi i infrastrukturës për një rrjet të përbashkët për shërbime të telekomunikimit.	I mesëm	Afatmesëm	I Mesëm	NA	NA	Kompanitë Komuna
5	Vendosja e antenave për transmetim të valëve sipas kërkesave të përcaktuara me ligj.	I mesëm	Afatmesëm	I Mesëm	NA	NA	Kompanitë Komuna

5.5.2.6. Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave dhe infrastrukturës përkatëse

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Sigurimi i kontejnerëve, kamionëve shkarkues, etj. për bartje të mbeturinave deri në Mirash.	I Lartë	Afatshkurtër	I Lartë	2023-2024	€500,000	DSHP Komuna

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
2	Sigurimi i kontejnerëve rezidencial për çdo vit nga 500 copa (1 copë, 120l- 20 EUR; 1 copë 1.1 t 300 EUR).	I Lartë	Afatshkurtër	I Mesëm	2024-2023	€150,000	DSHP Komuna
3	Ajrosja, filtrimi, drenazhimi, ndërrimi I gjeo-tekstilit dhe rehabilitimi i infrastrukturës rrugore brenda deponisë Mirash	I Lartë	Afatshkurtër	I Mesëm	2023-2024	€150,000	DSHP Komuna
4	Zhvillimi i projektit "Klasifikimi I mbeturinave ne burim te mbeturinave rezidenciale"	I Lartë	Afatshkurtër	I Mesëm	2023-2024	€20,000	DSHP Komuna
5	Ndërtimi i deponisë për mbetje inerte dhe të vëllimshme dhe trajtimi mbetjeve inerte dhe të vëllimshme	I Mesëm	Afatmesëm	I Mesëm	2023-2024	€150,000	DSHP Komuna
6	Zhvillimi i pilot projektit "Sigurimi I kontejnerëve për kompostim të kapacitetit rezidencial me kapacitet 280 l në fshatin Milloshevë. (280l 1 cope= 50 euro).	I Mesëm	Afatmesëm	I Mesëm	2023-2024	€20,000	DSHP Komuna
5	Identifikimi, largimi dhe eliminimi i deponive ilegale.	I Lartë	Afatgjatë	I Ulët	2022- 2030	€50,000	DSHP Komuna
6	Sigurimi i transportit të mbeturinave të klasifikuara në objektet publike (vazhdimësi e projektit- klasifikim i mbeturinave në burim).	I Lartë	Afatgjatë	I Ulët	2022- 2030	€50,000	DSHP Komuna

5.5.3. Prioritetet strategjike për infrastrukturë të transportit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023- 2025	€1,100,000	Komuna MI
2	Ndërtimi i Terminusit në afërsi të hekurudhës	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	2023-2024	€300,000	BERZH Komuna MI
3	Modernizimi i hekurudhës, linja 10 e hekurudhës Fushë Kosovë-Mitrovicë-Hani i Elezit (Plan i për modernizimin e hekurudhave të Kosovës)	I Lartë	Afatgjatë	I lartë	2023- 2030	/	BERZH Komuna MI
4	Ndërtimi i rrugëve në lagjen Hade e Re	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€1,199,879	DSHP
5	"Asfaltimi i rrugës Palaj-Lajthishtë-Sibovc-Hamidi-Plemetin"	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€336,917	DSHP
6	Asfaltimi I rrugëve: A. Frashëri, Ilaz Hashani segmenti 1, 2, 3, 4 Te Parku, Llapi segmenti 1, Tropoja, N. Kelmendi segmenti 1, Liburnia, F. Grajqevci segmenti 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 H. Prishtina segmenti, Rozafa, P. Vasa , H. Zeka ,Llapi segmenti 2, Janina segmenti F. Konica, A. Rama, Isa Boletini	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€162,308	DSHP
7	Asfaltimi I rrugëve: Musli Krasniqi –Sibovc, Jusuf Pllana dhe K. Devojka – Plemetin	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€165,450	DSHP
8	Asfaltimi i rrugëve: Obiliq Qendër & Obiliq nën Hekurudhë	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€385,452	DSHP

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
9	" Asfaltimi i rrugëve në fshati Dardhishtë & Mazgit, Milloshevë, Raskovë, Llazarevë & Raskovë	I mesëm	Afatshkurtër	I ulët	2023-2024	€882,970	DSHP
10	Mirëmbajtja e rrjetit rrugor (riasfaltimi dhe sinjalizimi sipas nevojave) gjatë 2022-2029	I mesëm	Afatgjatë	I mesëm	2023- 2024	€2,000,055	DA MASHT

5.5.4. Prioritetet strategjike për arsim

5.5.4.1. Ndërtimi i shkollave fillore të mesme të ulëta në Obiliq dhe Baimofc

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët në Obiliq	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€450,000	DA MASHT
2	Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët në Baimofc	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023- 2024	€200,055	DA MASHT

5.5.4.2. Ndërtimi i institucioneve parashkollore në Mazgit, Milloshevë, Hade e Re, Lajthishtë dhe Krushefc

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në Mazgit	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€120,000	DA MASHT
2	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në Milloshevë	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€120,000	DA MASHT
3	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në Haden e Re	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€120,000	DA MASHT
4	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në Lajthishte	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€120,000	DA MASHT
5	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në Krushevc	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2024	€120,000	DA MASHT

5.5.4.3. Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU ”Naim Frashëri“ në Breznicë, SHFMU” Migjeni“ në Sibovc, SHFMU ”Abdurrahmon Gërguri“ në Kryshefc

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU ”Naim Frashëri“ në Breznicë	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€250,000	DA
2	Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU” Migjeni“ në Sibovc	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€250,000	DA
3	Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU ”Abdurrahmon Gërguri“ në Kryshefc	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€250,000	DA

5.5.5. Prioritetet strategjike për shëndetësi

5.5.5.1. Ndërtimi i Qendrës së re Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Obiliqit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i Qendrës së re Kryesore Mjekësore Familjare në qytetin e Obiliqit ne lokacionin ekzistues	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2025	€250,000	DSHMS

5.5.6. Prioritetet strategjike për mirëqenie sociale dhe komunitet

5.5.6.1. Ndërtimi i banimit kolektiv me 50 njësi për rastet sociale dhe i 50 shtëpive për rastet sociale ne komunën e Obiliqit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i banimit kolektiv me 50 njësi për rastet sociale	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2023-2025	€1,500,000	DSHMS
2	Ndërtimi i 50 shtëpive për rastet sociale ne komunën e Obiliqit	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2022-2024	€1,100,000	DSHMS
3	Ndërtimi i një qendre për strehim të përkohshëm për se paku 20 familje	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	€500,000	DSHMS
4	Ndërtimi i një qendre për strehim për persona të moshuar	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	€300,000	DSHMS

5.5.7. Prioritetet strategjike për hapësirat kulturore

5.5.7.1. Ndërtimi i Bibliotekës Komunale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i Bibliotekës Komunale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	DKRS	€400,000	DKRS

5.5.8. Prioritetet strategjike për hapësira sportive dhe të gjelbra

5.5.8.1. Revitalizimi i stadiumit të qytetit Agron Rama dhe krijimi i brezave të gjelbër

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Revitalizimi i stadiumit të qytetit Agron Rama	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2022-2025	3,000,000	DKRS
2	Krijimi i brezave të gjelbër përreth TCA, TCB dhe Lumi Sitnica.	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022-2025	€500,000	DKRS

5.5.8.2. Rregullimi i fushave sportive në shkolla në Raskovë, Kozaricë, Sibovc, Plemetin dhe Palaj

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i fushave sportive në shkolla në Raskovë	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€40,000	DA
2	Ndërtimi i fushave sportive në shkolla në Kozaricë	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€40,000	DA
3	Ndërtimi i fushave sportive në shkolla në Sibovc	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€40,000	DA

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
4	Ndërtimi i fushave sportive në shkolla në Plemetin	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€40,000	DA
5	Ndërtimi i fushave sportive në shkolla në Palaj	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€40,000	DA

5.5.9. Prioritetet strategjike për hapësira të hapura publike

5.5.9.1. Ndërtimi i sheshit te qytetit dhe ndërtimi i parqeve të reja

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i sheshit të qytetit Adem Preniqi	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	€300,000	DKRS
2	Ndërtimi i parqeve në qytet dhe fshatra	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022- 2025	€480,000	DKRS

5.5.10. Prioritetet strategjike për varreza

5.5.10.1. Zgjerimi i varrezave

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Grabofc i Epërm në dy lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€25,000	DSHPE
3	Shipitullë	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€6,317	DSHPE
4	Lajthishtë	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€13,101	DSHPE
5	Palaj (varreza ortodokse)	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€15,726	DSHPE
6	Palaj	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€10,051	DSHPE
7	Hade	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€19,917	DSHPE
8	Obiliq qytet	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€68,396	DSHPE
9	Obiliq qytet	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€7,845	DSHPE
10	Mazgit në tre lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€25,000	DSHPE
11	Obiliq (varreza ortodokse) në dy lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€25,000	DSHPE
12	Plemetin (varreza ortodokse) në dy lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€10,000	DSHPE
13	Plemetin në dy lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€32,000	DSHPE
14	Hamidi	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€6,158	DSHPE
15	Sibovc	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€3,086	DSHPE
16	Baimofc (varreza ortodokse) në dy lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€74,000	DSHPE
17	Baimofc	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€70,784	DSHPE
18	Milloshevë (varreza ortodokse)	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€14,514.	DSHPE
19	Milloshevë	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€11,593	DSHPE
20	Dardhishtë (varreza ortodokse)	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€4,716	DSHPE
21	Dardhishtë	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€13,334	DSHPE
22	Shkabaj	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€757	DSHPE
23	Kozaricë	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€843	DSHPE
24	Breznicë në 4 lokacione	I Lartë	Afatgjatë	I mesëm	2022- 2030	€10,000	DSHPE

5.5.11. Prioritetet strategjike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

5.5.11.1. Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore - arkeologjike	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTKM
2	Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore - arkitekturale	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTKM
3	Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë kulturore - peizazhet kulturore	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTKM
4	Përcaktimi i planit 10-vjeçar të investimeve në bashkëpunim me MRKS dhe QRTK të Obiliqit për asetet e trashëgimisë kulturore	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTKM

5.5.11.2. Përcaktimi i kufijve të sipërfaqes së mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe kushteve zhvillimore përmes Hartës Zonale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për asetet e trashëgimisë kulturore në hartën zonale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTK
2	Përcaktimi i kushteve të veçanta zhvillimore dhe ndërtimore për sipërfaqet të mbrojtura në hartën zonale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	N/A	DKRS, MKRS, QRTK

5.5.11.3. Promovimi i trashëgimisë kulturore si dhe aftësimi, ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Hartimi i listës së trashëgimisë kulturore në rrezik dhe programit për shpëtimin e tyre.	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022-2024	N/A	DMM
2	Përgatitja e Planit të Konservimit për asetet e trashëgimisë kulturore	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€60,000	DMM

5.5.11.4. Përcaktimi i masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për asetet e trashëgimisë natyrore në hartën zonale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	N/A	DMM
2	Përcaktimi i masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore në hartën zonale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2023-2024	N/A	DMM

5.5.12. Përcaktimi i masave mbrojtëse për mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Inkapsulimi i deponive të hirit	I lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2027	€1,500,000	DMM KEK, MIA, MEPTINIS
2	Vendosja e filtrave ne TC Kosova B.	I lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€75,000,000	BB KE Komuna
3	Shtimi i pikave të matësve për monitorimin e cilësisë së Ajrit	I lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€200,000	DMM IHMK KEK, KOMUNA, Instituti
4	Mbjellja e pemëve gjethembajtëse te deponitë e Hirit dhe mbeturinave.	I lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2023-2024	€150,000	DMM Komuna, KEK, BB
5	Pyllëzimi i sipërfaqeve ku janë të rrezikuara nga zjarret në Breznicë, Grabofc i Epërm.	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	2022-2024	€70,000.00	DBZHR Komuna, Agjencia e pyjeve
6	Rregullimi i sistemit të kullimit (drenazhimit) të sipërfaqeve të përmbytura pranë lumenjve Sitnicë, Drenica dhe Llapi	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	2022-2024	€200,000	DMM KOMUNA
7	Zhvillimi i një Strehimore për qentë endacak	I lartë	Afatmesëm	I ulët	2029-2025	€20,000	Komuna DSHPE

5.5.12.1. Prioritetet strategjike për sipërfaqet me Rrezikshmëri

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2024	€300,000	DMSH
2	Hartimi i projektit kryesor për zhvillim të Rregullimi i shtratit Sitnica	I Lartë	Afatshkurtër	I ulët	2022-2023	€50,000	DMSH
3	Zhvillimi i projektit Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica	I Lartë	Afatmesëm	I Lartë	2022-2025	€2,000,000	DMSH
4	Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Drenica	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2024	€300,000	DMSH
5	Ndërtimi i një rezervari të ujit për nevoja të zjarrfikësve në Grabofc të Epërm	I Lartë	Afatshkurtër	I ulët	2022-2023	€20,000	DMSH
6	Zgjerimi i Rrugëve malore në Zonat ku janë te afektuar nga zjarret	I Lartë	Afatshkurtër	I ulët	2022-2023	€20,000	DMSH

5.5.13. Prioritetet strategjike për vendbanimet

5.5.13.1. Prioritetet strategjike për kompaktësimin e qëndrueshëm i zonës urbane

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Planifikimi për plotësim të parcelave të pa-shfrytëzuara dhe inkurajimi i dendësimit ose rizhvillimit të tokës në qytet dhe vendbanime rurale	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2023	N/A	DPU

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
2	Hartimi i Hartës Zonale Komunale	I Lartë	Afatmesëm	I lartë	2022- 2025	€ 110,000	DPU

5.5.13.2. Prioritetet strategjike për zhvillimin e ekuilibruar i vendbanimeve rurale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Promovimi i modelit kompakt ekzistues të zhvillimit në vendbanime rurale	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU
2	Kontrolli i vazhdueshëm i zgjerimit të pakontrolluar të vendbanimeve rurale jashtë kufijve ndërtimor	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU
3	Eliminimi i pabarazisë së shpërndarjes së infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndërmjet qytetit dhe vendbanimeve rurale si dhe në mes të vendbanimeve rurale	I Mesëm	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU
4	Hartimi i Planit të Hollësishëm Dinamik për Zhvendosje të Organizuar të Komunitetit	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU

5.5.13.3. Prioritetet strategjike për krijimin e hapësirave të mirëfillta për banim, me të gjitha elementet e nevojshme përcjellëse

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ruajtja dhe zhvillimi i zonave me interes për komunën: zonave të banimit, hapësirat e lira, hapësirat komerciale, hapësirave të rekreimit.	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU
3	Promovimi i dizajnit dhe materialeve kualitative	I Ulët	Afatshkurtër	I mesëm	N/A	N/A	DPU

5.5.13.4. Prioritetet strategjike për krijimin e hapësirave të gjelbra dhe rekreative në funksion të të gjitha vendbanimeve

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ruajtja dhe forcimi i pasurive natyrore	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU
2	Krijimi i lidhjes së qendrës, nën-qendrave dhe vendbanimeve me hapësira rekreative, në funksion të ofrimit të qasjes për të gjithë	I Ulët	Afatshkurtër	I mesëm	N/A	N/A	DPU

5.5.13.5. Prioritetet strategjike për ofrimin e qasjes së barabartë në shërbime për të gjithë banorët e komunës

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ofrimi i objekteve të nevojshme për shërbime adekuate në vendbanime me prioritet për komunën	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	N/A	N/A	DPU

5.5.14. Prioritetet strategjike për vendbanimet joformale

5.5.14.1. Prioritetet strategjike për trajtimin e vendbanimeve joformale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Trajtimi i aspektit pronësoro juridik të vendbanimit joformal - Subotiqët	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2026		DPU

5.5.14.2.

5.5.14.3. Prioritetet strategjike për legalizimin e ndërtimeve pa leje

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zhvillimi i inspektimeve dhe lëshimi i certifikatave të legalizimit	I Lartë	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2023	€ 200,000	DPU

5.5.15. Prioritetet strategjike për banim

5.5.15.1. Prioritetet strategjike për sigurimin e banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Sigurimi i banimit për së paku 200 familje të identifikuara si raste të pastreha	I Lartë	Afatmesëm	I mesëm	2022- 2026	N/A	DPU
2	Krijimin e një fondi të banimit të përballueshëm, i cili mbështeten nga tarifat e duhura për zhvillimin ekonomik.	I Ulët	Afatshkurtër	I mesëm	2022-2023	N/A	DPU

5.5.16. Prioritetet strategjike për shfrytëzim të tokës.

5.5.16.1.1. Prioritetet strategjike për zhvillimet hapësinore bazuar në shfrytëzimin e planifikuar të tokës.

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Shfrytëzimi i 135.78ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë rekreative-turistike konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
2	Shfrytëzimi i 1237.92ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë banimi konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
3	Shfrytëzimi i 97.27ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë të shërbimeve konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
4	Shfrytëzimi i 11.32ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë të mbrojtur arkeologjike-historike konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
5	Shfrytëzimi i 976.46ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë-	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
	minierë e xeheve metaleve konform shfrytëzimit të përcaktuar						
6	Shfrytëzimi i 4186.54ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë bujqësore konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
7	Shfrytëzimi i 1396.82ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë pyjore konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
8	Shfrytëzimi i 1087.20ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë komerciale konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
9	Shfrytëzimi i 85.32ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë e komunikacionit transportit konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
10	Shfrytëzimi i 1087.20ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë industriale konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
11	Shfrytëzimi i 1088.0ha të sipërfaqes ekzistuese dhe të planifikuar për zonë të shfrytëzimit të përzier konform shfrytëzimit të përcaktuar	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
12	Planin Rregullues të Hollësishëm për korridorin N2	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU
13	Planin Rregullues të Hollësishëm për zonën komerciale Obiliq-Prishtinë	I Lartë	Afatgjatë	I vogël	DPU	N/A	DPU

6. ZBATIMI DHE MONITORIMI

6.1. Dispozitat për zbatim

6.1.1. Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit). Pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunale në Kuvend Komunale, dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësit ligjore që ka lidhur për zbatimin e Planit Zhvillimor të Komunës, në ketë drejtim drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal varët nga shumë faktorë në mënyrë direkt dhe indirekte dhe përpos punës brenda sektorëve të komunës, në funksion të krijimit të një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm, sistem i cili prezanton edhe një nga kërkesat ligjore, duhet punuar edhe me grupet tjera të interesit, e cila nuk mund të bëhet pa ngritur edhe cilësinë e informimit dhe komunikimit si dhe fuqizimin e faktorëve tjerë.

APKPMH dhe Ekipi punues në rend të parë zbatimin do e bëjnë në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim të Planit Zhvillimor të Obiliqit, duke punuar Planet e Zbatimit Sektoriale të secilës Drejtori të Komunës së Obiliqit.

6.1.1.1. Formimi i ekipit

Një nga faktorët fillestar dhe të rëndësishëm të zbatimit të PZHK-së është krijimi i Ekipit Komunal të Obiliqit, ky Ekipi komunal do ketë obligimet për përkrahje në zbatim të PZHK-së, por edhe për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në të njëjtën kohë pasi që Komuna e Obiliqit nuk ka Ekip edhe për zbatim dhe monitorim të HZK-së, ky Ekip duhet ti kryej edhe ato detyra.

Komuna e Obiliqit në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të PZHK-së, si pjesë e këtij dokumenti, e parasheh krijimin e këtij Ekipi, që për pos rëndësisë së madhe në zbatim, do shërbej edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Ky Ekip Punues duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili bazuar në kompetencat ligjore që ka ose e themelon vet ose i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e Ekipit Punues për zbatimin e Planit Zhvillimor të Obiliqit, si dhe për Monitorim dhe Raportim lidhur me zbatimin e Planit, për arsye praktike Ekipi i njëjtë do ketë obligimet e njëjta edhe për HZK-në e Obiliqit.

Në kuadër të vendimit duhet përshkruhet përbërja e Ekipi, detyrat lidhur me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, periudhat e raportimit, kompensimin nëse aplikohet etj.

Ekipi Punues përbëhet nga përgjegjësit e të gjitha drejtorive, e udhëheqësi i Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit) është edhe koordinatori i Ekipit.

Detyrat e Ekipit janë të koordinoj dhe bashkërendoj aktivitetet, lidhur me përgatitjen e Planeve Vjetore, për çdo drejtori brenda komunës së Obiliqit, Planet vjetore duhet përgatitur për Drejtoritë: Urbanizëm dhe Planifikim, Ekonomi dhe Financa, Administrata e përgjithshme, Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë, Arsim, Administrata e përgjithshme, Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë.

Është detyrë e secilit përgjegjës që është pjesë e ekipit, nga secila drejtori të kujdesën për këto Plane Vjetore, dhe e koordinatorit të Ekipit të kujdeset për planin e drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim, por në cilësinë e koordinatorit dhe si udhëheqës i Ekipit Punues edhe koordinoj dhe ndihmojë edhe planet vjetore të drejtorive tjera.

Detyrë tjetër është që të verifikoj se Planet Vjetore Sektoriale të jenë të bazuara dhe në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim nga PZHK-ja si dhe të:

- Përcjell, koordinoj dhe bashkërendoj zbatimin praktik të projekteve dhe komponentë-s hapësinore në baza ditore, javore e mujore të punës.
- Merr edhe shënime për mundësitë, sfidat dhe problemet e zbatimit ashtu që të mundësoj përmirësimin e zbatimit në vitin tjetër të radhës.
- Bashkëpunojnë me anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë sistemin e Zbatimit të Planit si dhe Raportimin.
- Informojë, nëpërmjet Zyrës për Informim, edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planit, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe

projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, Mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të Fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që të:

- Kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat;
- Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet;
- Definojnë masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet;
- Zhvillojnë tubimet e rregullta publike;
- Zhvillojnë takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatimit të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane.

Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të planit zhvillimore komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që (së paku) të organizojë dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore.

Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët, dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të Transparencës, dhe në këtë mënyrë komunat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

6.1.1.2. Informimi dhe komunikimi në procesin e zbatimit të PZHK-s së Obiliqit

Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Obiliqit luajnë një rol të jashtë zakonshëm, andaj Komuna e Obiliqit dhe aktorët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për zbatimin e Planit Zhvillimor .

Fusha e informimit dhe e komunikimit ,në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, do jetë një mbështetje e madhe e drejtuesve të institucioneve, dhe të vet institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatoj kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushte edhe këtë kërkesë, nga kuadri ligjor.

Në vijim, Komuna e Obiliqit do të respektojnë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor. Plani i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të PZHK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë aktorët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzoj të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshëm në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe aktorët e tjerë relevant.

Në këtë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të këtë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë aktorët, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve, botojeni atë dhe bëjeni le të shihet në gazeta, Postoni atë në Ueb faqen tuaj të Internetit dhe, Referojuni sa më shpesh që të jetë e mundur në mënyra të

ndryshme dokumenteve të planifikimit. Këto udhëzime, do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Planin Zhvillimor Komunal aktual dhe me këtë rast nga dhe anëtarët e grupeve të tjera të interes, mund të kërkohen komente dhe sugjerime lidhur me informimin, me komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes.

Si shumë me interes për zbatim të Planit konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë aktorët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

6.1.1.3. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve

Përkundër që në Komuna e Obiliqit mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësorë gjatë përgatitjes së PZHK-së në kuptimin e gjithëpërfshirës edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, për kundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë por, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Në këtë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Planit, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga PZHK-ja.

Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për projektet, objektivat qëllimet dhe përmbajtjet tjera të PZHK-së por edhe aktivitetet tjera që janë rezultat i Planit, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe projektet, objektivat, qëllimet dhe dimensionin hapësinor të dokumentit.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësoj komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj aktorëve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Planit, dhe mundëson informim dhe koordinimin efikas, cilësorë, dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë aktorëve relevant. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Planit, i projekteve, objektivave, qëllimeve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për tu analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektoratit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaftë i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimor në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera.

Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria e Urbanizmit por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Edhe Drejtoritë tjera komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë. pasi që shumë projekte, zhvillime të parapara me PZHK duhet të jenë pjesë e parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hapë më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal në këtë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet .

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planit duhet zgjeruar edhe me gjykatat për disa lëndë potenciale, edhe me byrotë projektuese për tu sqaruar për zonat dhe kufijtë ku lejohen ndërtimet ,e në ketë vij edhe projektimet edhe shoqëria civile për rolin, rëndësinë por edhe interesat që mbrojnë.

6.1.1.4. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror

Pasi që PZHK-ja është dokument multisektorial, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushë veprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të PZHK-së.

Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të PZHK-së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPHI-ja, MBPZHR-ja Ministria e infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministritë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të PZHK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të PZHK-së. Dihet se ministritë e ndryshme si për shembull MMPHI-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit., duke i ditur edhe kompetencat për ujin, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPHI-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPHI-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndështkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, për pos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MMPHI.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të PZHK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendrorë. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspektorati i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të PZHK-së.

Pasi që planifikimi është multisektorial, gati të gjitha ministritë dhe të gjitha agjensionet e tjera publike, kanë një fushë-veprimtari, kompetencë dhe ndikim që prekë edhe zbatimin e PZHK-së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të PZHK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e grandeve që vijnë nga niveli qendror. Lirishtë, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtjesore për zbatim të PZHK-së.

6.1.1.5. Mbështetja administrative

Komuna e Obiliqit, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të PZHK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj.

Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për zbatimin e projekteve, objektivave dhe qëllimeve janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim por, edhe për transparencë në zbatim.

Për tu mundësuar zbatimi i PZHK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e hartimit të Hartës Zonale të Komunës ,më të cilën mund të epen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar edhe me PRRH.

Kështu mbështetja administrative përpos transparencës, përgjegjësisë shkon edhe në kompletimin me dokumentet tjerë të nevojshëm për zbatim të plotë të PZHK-së.

6.1.2. Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së

Brenda kapitullit Dispozitat për Zbatim, ekipet hartuese të Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit kanë sqaruar edhe përgjegjësit dhe kompetencat lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunale në Kuvend Komunale, dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësit ligjore që ka lidhur edhe me monitorimin e zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës, në ketë drejtim drejtoria e Urbanizmit do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se monitorimi i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal është një aktivitet i vazhdueshëm me qëllim të sigurimit të informatave në mënyrë të rregullt dhe sistematike, në për mes treguesve kuantitativ dhe kualitativ të cilët do matin progresin e arritur në zbatimin e PZHK-së së Obiliqit, me qëllim të vlerësimit se a janë arritur rezultateve e planifikuara por edhe identifikuar vështirësitë, sfidat dhe problemet.

Monitorimi trajton në mënyrë sistematike raportin ndërmjet gjendjes së zbatuar dhe asaj që është planifikuar me PZHK por edhe pritjeve bazuar në treguesit e paracaktuar.

Është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve sektoriale për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit.

Monitorimi, është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit do të sigurohen që projektet, objektivat, qëllimet janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në PZHK dhe brenda afateve të caktuara.

Është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e PZHK-së me dhe standardet e caktuara për të vlerësuar nëse, po bëhet progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen, dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën brenda detyrimeve të tyre.

Në ketë drejtim mundemi të konstatojmë se mundet të bëhet edhe Anulimi apo shtyrja e zbatimi të ndonjë aktiviteti të Planit të Veprimit të PZHK-së për arsyet e caktuara objektive por edhe subjektive që janë rezultat i procesit të monitorimit të zbatimit, shtyrja ose anulimi bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Kuvendit të Komunës, dhe nëse bëhet një vendim për shtyrjen apo anulimin e një aktiviteti, Plani i Veprimit do të përditësohet me vendimin e ri, dhe pas përditësimit drejtoritë komunale përgatisin Planin Sektorial Vjetor për zbatim të vitit vijues bazuar në Planin e Veprimit të përditësuar për Zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit është proces sistematik dhe i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, për një ndërhyrje të caktuar.

Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës Plani: po zbatohen, në përputhje me planin e Veprimit për zbatim të PZHK-së ose edhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së.

Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit e sidomos PZHK-së në ketë rast, Komuna e Obiliqit është e bindur se përpos një planifikim të qëndrueshëm dhe hartimit të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm edhe aplikimi i tij në praktike dhe përkrahja më të madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë është për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim.

Komuna e Obiliqit e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të monitorimit dhe vlerësimit të planit në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor.

Komuna e Obiliqit ka edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të monitoruar zbatimin e PZHK-së, dhe njëkohësish të përgatiten raportet e nevojshëm për Kuvendin Komunal, MMPHI-në dhe që i duhen çdo pale të interesuar për zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit të PZHK-së së Obiliqit bëhet në baza ditore, ndërsa Raportimi i monitorimit kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime praktike më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore, por edhe për çdo vit radhazi, pasi që PZHK-ja është dokument i cili planifikohet për së paku 8 vite, intervalet tjera kohore për raportin e monitorimit mund të caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të PZHK-së përgatitet nga Ekipi Punues i cili udhëhiqet nga koordinatori, e koordinatori raportin përfundimisht e trajton dhe përmbyll brenda Autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit), raport i cili prezanton Monitorim dhe Vlerësim e zbatimit të PZHK-së, edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore për nevoja të brendshme të komunës, dhe vjetore i cili është për nevoja të brendshme të komunës por edhe për raportim në MMPHI.

Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së bazohet në: Projektet, aktivitetet, masat dhe përmbajtjet tjera të parapara në Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, plan i cili duhet jetë bazë për përgatitjen e planeve vjetore sektorial për secilën drejtori në lidhje me zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit trajton edhe projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të cilat nuk janë paraparë me Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, rrjedhimisht as me plan vjetor sektorial të zbatimit të PZHK-së, dhe të cilat mundë të konsiderohen si zhvillime të momentit, të pa planifikuara .

6.1.2.1. Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit

Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që mund të ndryshon nga drejtoria në drejtori, por edhe nga projektet, masat dhe aktivitetet që do monitorohen (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performancës së Komunës të jetë pjesë e procesit të monitorimit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Komunës në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale të komunës.

Drejtoritë komunale sektoriale brenda komunës së Obiliqit përgatisin raportin monitorues të zbatimit të planeve zhvillimore sektoriale në baza vjetore si obligim ligjor dhe sipas nevojës bazuar në intervalet e lartpërmendura, Raportet vjetore duhet përgatitur për të gjitha drejtoritë, nga të gjitha këto raporte përgatitet Raporti Monitorues i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës dhe e dorëzon në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, pasi të jetë integruar nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Urbanizmit) dhe pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit nga Kuvendi i Komunës, në baza vjetore dorëzon në Ministri raportin informues për gjendjen e zbatimin të Planit Zhvillimor të Komunës.

Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim (anulim ose shtyrje të ndonjë aktiviteti) dhe prezantohen para Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë me statistika financiare, në baza vjetore, së paku për tetë (8) vite.

Raportet vjetore të monitorimit bazohen në analizat e:

Informatave bazë: gjatë gjithë procesit duhet sigurohen informata, informatat duhet siguruar në të gjitha drejtoritë dhe instancat tjera, këto informata sigurojnë bazë të mirë për analizën dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së së Obiliqit.

Raporti vjetore i monitorimit dhe raportet sektoriale bazohen në analizat e këtyre informatave bazë .

Cilët janë treguesit?

Për të pasur një monitorim të zbatimit të PZHK-së së Obiliqit duhet siguruar që informatat bazë të pasqyrojnë treguesit adekuat për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ.

Çdo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së përgatit Planin vjetor sektorial për Zbatimin e PZHK-së, dhe brenda këtij plani duhet definuar edhe treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të kushteve, zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara.

Si i përcaktojmë treguesit për zbatim?

Duhet të Sigurohemi që ka një pajtim mbi treguesit para aplikimit të tyre (gjatë përgatitjes së planit sektorial vjetor për zbatim nga të gjithë amtarët e ekipit).

- Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm.
- Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistent.
- Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal.
- Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mund të azhurnohen lehtë.
- Miratoni tregues që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera.
- Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit.
- Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, zonave rurale, fondit të ndërtimeve, etj.
- Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit që, të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

Për ilustrim:

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së së Obiliqit kemi potencuar se për vitin 2019 synohet të ndërtohet rruga e caktuar, treguesi do jetë normal numër dhe në fund të vitit bazuar në informatat bazë mund të

themi se kemi realizuar komplet rrugën prej 7 km, ose 7000 m tregues që paraqet të gjitha përmbajtjet e rrugës, të dakorduar kur e kemi krye planin sektorial të zbatimit .

Caktimi i standardeve të monitorimit:
Standardet e monitorimit i përcaktojmë në fazën e planifikimit të monitorimit dhe bëhen me marrëveshje të Ekipit Zbatues.

Cila do jetë metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Obiliqit?

Duke e trajtuar metodologjinë si tërësinë e metodave që përdoren në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Zbatimit të PZHK-së së Obiliqit në përgjithësi për dokumentin por edhe në fusha të caktuara sektoriale.

Lirisht mundet të thuhet se këto metoda bazohen në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së si dhe në Planet Sektoriale për Zbatim ku janë paraparë: projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore, kostot financiare dhe pritjet nga zbatimi i tyre, thjesht duke krahasuar gjendjen e planifikuar dhe gjendjen e realizuar.

Metoda e cila preferohet të shfrytëzohet është metoda e orientuara në rezultate dhe në gjendjen faktike në teren.

Ekipi punues duhet përdorë metodat statistikore dhe mundet të përdorë edhe metodat tjera sipas nevojës dhe përcaktimeve edhe në plan pune për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.

metodologjia e punës do të ndjek hapat e njëjtë të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale, duke ndjekur këta hapa:

Hapi 1. Identifikimi:

Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik.

Hapi 2. Definimi i treguesve:

Në varësi të asaj se çka është pjesë e planit të veprimit për zbatim të PZHK-së, dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik duhet përcaktohen tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje)dhe tregues kualitativ për më shumë në materialin e lart përmendur: Cilët janë treguesit dhe materialet tjera.

Hapi 3. Përcakto metodat e grumbullimit të të dhënave dhe afatet kohore:

Grumbullimi i të dhënave:

Grumbullimi i të dhënave bëhet bazuar në formularët e përgatitur për monitorim sipas specifikave të zhvillimeve dhe drejtorive.

Treguesit kuantitativ dhe kualitativ mblidhen në baza ditore , dhe hedhja e tyre në databazë bëhet në baza javore;

Në rast se mund të duket e nevojshme mundë organizohen intervista, pyetësorë dhe metoda tjera të grumbullimit të informatave.

Grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare të komunës.

Hapi 4. Identifikoni Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit:

Në kuadër të planit të monitorimit përcaktohen edhe Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit për përgjegjësit e drejtorive, stafit brenda secilës drejtori për më shumë shih materialin më lartë :Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe materialet tjera

Hapi 5. Krijo një Plan Vlerësimi dhe Format të Raportimit:

Duke konsideruar se të dhënat bazë (treguesit dhe të dhënat tjera) duhet vlerësuar për të konstatuar dhe raportuar progresin e zbatimit, duhet hartuar një Plan transparent dhe profesional Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Hapi 6. Kompletimi i Raportit dhe raportimi në Kuvend komunale të Obiliqit dhe në MMPHI:

Kompletimi i Raportit përfundimtar duhet bëhet nga autoriteti kompetent komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor duke e integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilës drejtori lidhur me vlerësimin e zbatimit, raport i cili duhet prezantohet në Kuvend komunale të Obiliqit dhe në MMPHI.

6.1.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës

6.1.4. Kuptimi i vlerësimit

Vlerësimi, do të thotë gjetja e vlerës në përqindje (%) të realizimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe cilësisë së zbatimit.

Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të faktit të gjetur, të cilët janë grumbulluar dhe sistemuar gjatë procesit të monitorimit.

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo zhvillimet, masat, aktivitetet, projektet në përputhje me rezultatet e planifikuara në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së, Planet sektoriale të Zbatimit dhe me standardet e pranuara përgjithësisht profesionale.

Komuna e Obiliqit do orientohet kryesisht në Vlerësimin e brendshëm i cili është bërë në nga stafi komunës, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Mirëpo Komuna e Obiliqit mundë të angazhoj edhe vlerësim dhe monitorim të jashtëm, ky vlerësim mund të bëhet nga një trupi jashtë strukturave të komunës

6.1.5. Autoritetet kompetente për Zbatim dhe Monitorimin e zbatimit të PZHK-së së Obiliqit

Fillimisht duhet sqaruar se Kuvendi i Komunës së Obiliqit është përgjegjës për alokimin e fondeve për zbatimin e PZHK-së.

Ekipi punues mundë të angazhohet në përgatitje të Raportit të Monitorimit, ky ekip përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e drejtorive, më tutje do të sqarohen se kush do përgatit raportin e monitorimit nga organet e caktuara duke e kuptuar se ekipi punues do bartë ketë proces.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për zbatimin e PZHK-së së Obiliqit, Monitorimin e zbatimit të PZHK-së si dhe përgatitjen e Raportit të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit, Drejtoritë komunale sektoriale zhvillojnë edhe aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre lidhur me përgatitjen e Raportit sektorial të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë Raportet sektoriale vjetore të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna mund të angazhoj kompani konsulentë për kapitullin monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit. e cila do të përkrahë Ekipin dhe Autoritetet në ketë proces.

Raportimi nga Ekipi Komunal Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh, dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e PZHK-së, Ky raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit, dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

7. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

7.1. Hyrja në fuqi

- Ky Plan do të hyn në fuqi 15 ditë pasi që të miratohet nga Kuvendi Komunal.

7.2. Validiteti / vlefshmëria

- Ky Plan do të jetë i vlefshëm për 8 vite.

7.3. Vlerësimi

- PZHK do të vlerësohen rregullisht, p.sh. një herë në vit.
- Gjithashtu do të konsiderohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banime dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.

Procedura e rregullt e rishikimit është 4 vite pas ditës së miratimit të këtij dokumenti nga Kuvendi Komunal.

Me hyrjen në fuqi të kësaj PZHK 2022- 2030 të Komunës së Obiliqit, shfuqizohen të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit lokal të komunës së Obiliqit, si PZHKU 2009- 2020+.